JETA E SAHABËVE

JETA E SAHABËVE

1

Muhamed Jusuf KANDEHLEUI

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

Titulli i librit
Jeta e Sahabëve (variant i shkurtuar)

Titulli i origjinalit
Hajatu's-Sahabe

Autor
Muhamed Jusuf Kandehleui

Përktheu
Silvester Manaj

Redaktoi
Andrin Rasha
Mehmet Disha
Detin Kotrri

Korrektoi
Dorian Demetja

Kopertina & Grafika
Indrit Isufi

ISBN 978-9928-194-85-5

©KMSH - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Tiranë, 2021

DY FJALË LEXUESIT

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Rëndësia e sahabëve, në fenë Islame, është jashtëzakonisht e madhe, sepse ata kanë përcjellë në detaje me mijëra situata, kanë ndikuar shumë në përcjelljen e fjalëve, sjelljeve, këshillave, sugjerimeve, ndalimeve ose shpjegimeve, të cilat i ka bërë Profeti Muhamed (a.s.) në atë kohë. Ata i dhanë besën të Dërguarit të Allahut në rrugën e besimit dhe sakrifikuan shumë në këtë drejtim. Sahabët u shpërndanë në të gjitha anët e botës për të përcjellë mesazhin e Krijuesit. Gjatë këtij veprimi, ata harruan kënaqësitë personale, braktisën rehatinë, lanë shtëpitë dhe shpenzuan jetën e pasurinë e tyre. Dhe kështu, udhëzimi u përhap në të gjithë botën dhe njerëzit, turma-turma, filluan të përqafojnë Islamin. Librat e historisë janë përplot me tregime dhe kronika të Islamit, që shënojnë të dhënat e tyre. Historia e sahabëve ka mbetur gjithmonë burim i ringjalljes dhe përtëritjes së jetës së myslimanëve.

Ky botim në dy vëllime, vjen nga Komuniteti Mysliman jo vetëm si një përmbledhje fragmentesh nga jeta shembullore e sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), por është edhe një histori e mirëfilltë e Islamit dhe pasqyrim i hollësishëm i jetës së Profetit tonë, pasi këtu, jeta e sahabëve, si dhe shumë nga ngjarjet që rrëfehen si të transmetuara nga burimet më të besueshme të Islamit, janë të paraqitura sipas një kategorizimi dhe prezantimi në kapituj të hartuar sipas kriterit tematik. Pra, dobia e prurjes së këtij libri në gjuhën shqipe, është se ai përmbush tri qëllime:

a) Një njohje më nga afër me përmasën e të qenët sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilën e garanton pasuria dhe larmia e

historive të treguara në të.

b) Sjell në gjuhën shqipe një histori të Islamit në fillimet e tij, të parë si mënyrë jetese e pandarë nga jeta e përditshme.

c) Një dimension të posaçëm të përditshmërisë së jetës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilin një biografi e ka shumë të vështirë që ta paraqesë në tërësinë e tij, për shkak të pasurisë së informacionit.

Jam i bindur se kjo vepër do t'i shërbejë shumë myftinjve, imamëve dhe predikuesve të ndryshëm anembanë vendit. Gjithashtu, shpresoj që kjo vepër të gjejë edhe pritshmërinë e duhur mes besimtarëve dhe t'u shërbejë atyre në përmirësimin e jetës fetare.

H. Bujar Spahiu
Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

HYRJE

1. AJETE DHE HADITHE QË URDHËROJNË BINDJEN NDAJ ALLAHUT DHE TË DËRGUARIT TË TIJ

Detyra e profetësisë së Profetit tonë të dashur

"**O Profet! Ne të kemi dërguar Ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht** (të kemi çuar) **si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.**" (Ahzab, 33/45-46)

"**Ne të kemi dërguar ty** (o Muhamed) **vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.**" (Sebe', 34/28)

"**Ne të kemi dërguar ty vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues.**" (Furkan, 25/56)

"**Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty** (o Muhamed)**, veçse si mëshirë për botët.**" (Enbija, 21/107)

"**Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.**" (Saf, 61/9)

Profeti ynë i dashur, përshkruhet kështu në Fjalën e Allahut (xh.

sh.), Zotit të botëve:

"**Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!**" (Al 'Imran, 3/51)

"**Thuaj: "Me të vërtetë, Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë, në fenë e vërtetë, fenë e pastër të Ibrahimit besimplotë, i cili nuk ka qenë adhurues i idhujve."; Thuaj: "Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve." Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.**" (En'am, 6/161-163)

Bindja ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij

"**O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos ia ktheni shpinën, ndërkohë që e dëgjoni** (të vërtetën)**!**" (Enfal, 8/20)

"**Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.**" (Enfal, 8/46)

"**O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.**" (Nisa, 4/59)

Resulullahu (alejhis'salatu ues'selam) thotë: "*Kush më bindet mua, nuk ka dyshim që i është bindur Allahut. E kush më kundërshton mua, nuk ka dyshim që ka kundërshtuar Allahun.*"

Sërish, Profeti ynë i dashur (alejhis'salatu ues'selam) shprehet: "*Përveç atyre që refuzojnë, i gjithë umeti im do të hyjë në Xhenet.*" E atyre që e pyesnin: "Po kush janë këta që refuzojnë?!", - ai u përgjigjej: *"Kush më bindet mua hyn në Xhenet, ndërsa refuzues janë ata që tregohen kryengritës* (duke mos u bindur)."[1]

"**Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: 'Dëgjojmë dhe bindemi'. Pikërisht këta janë të shpëtuarit.; Ata që i binden Allahut**

[1]. Buhari, *Sahih,* 6/2655 (6851).

dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë nga Allahu e i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë." (Nur, 24/51-52)

"**Besimtarët dhe besimtaret janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu. Se, Allahu, me të vërtetë, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.**" (Teube, 9/71)

Profeti dërgohet për t'iu bindur

"**Çfarëdo që Allahu i dhuroi të Dërguarit të Tij si plaçkë** (të marrë) **nga popujt e vendbanimeve, i takon: Allahut, të Dërguarit, të afërmve të tij, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve të mbetur rrugës, në mënyrë që ajo të mos qarkullojë vetëm në duart e të pasurve nga mesi juaj. Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'jua ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu dënon vërtet ashpër.**" (Hashr, 59/7)

"**Ne i kemi nisur të dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t'u binden atyre. Dhe, në qoftë se ata, kurdo që ta ngarkonin veten** (me gjynahe)**, të vinin te ti për t'i kërkuar falje Allahut dhe i Dërguari t'i lutej Allahut për shfajësimin e tyre, do ta vërenin, se Allahu, me të vërtetë, është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.**" (Nisa, 4/64)

Çfarë do të fitojnë ata që u binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij?

"**Thuaj: 'Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit!' Nëse shmangeni,** (ta dini se) **ai është përgjegjës për detyrën e tij, ndërsa ju për atë që jeni ngarkuar. E, nëse i bindeni atij, do të jeni në rrugën e drejtë, kurse i Dërguari është i detyruar vetëm që të përcjellë qartë** (Mesazhin Hyjnor)**. Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të**

më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim)**. Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë** (besimin)**, pikërisht ata janë të mbrapshtët. Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!**" (Nur, 24/54-56)

"**Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën** (e Allahut)**.**" (Al 'Imran, 3/132)

"**O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t'jua bekojë veprat tuaja dhe do t'jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.**" (Ahzab, 33/70-71)

"**Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë të gjithë këta! Kjo dhunti është nga Allahu, e mjafton që Allahu e di çdo gjë.**" (Nisa, 4/69-70)

"**Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojë përherë. Kjo është fitorja e madhe.**" (Nisa, 4/13)

"**Thuaju** (o Muhamed)**: 'Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.**" (Al 'Imran, 3/31)

"**Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.**" (Ahzab, 33/21)

"**Thuaj** (o Muhamed)**: 'O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!'**" (A'raf, 7/158)

Siç na është transmetuar prej Enesit (radijallahu anhu), Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë:

"*Kush ringjall një sunet, që pas meje është lënë nga njerëzit, kjo do të thotë për*

të se ai më do mua. E ai që më do, është përherë me mua."[2]

Po ashtu, bashkë me këtë, transmetohen edhe sihariqet e tjera: "*Kush lidhet fort pas sunetit tim hyn në Xhenet.*"[3] "*Kush i bindet sunetit tim, në një kohë kur umeti im është prishur, merr shpërblimin e njëqind dëshmorëve.*"[4] "*Kush jetëson sunetin tim, më do mua, e ne do të jemi bashkë në Xhenet me të gjithë ata që më duan mua.*"[5]

"*T'i bindesh sunetit të Profetit Fisnik, në një kohë kur umeti gjendet në mosmarrëveshje, është si të mbash në duar prush të ndezur.*"[6]

Çfarë i pret ata që nuk i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij?

"**O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyn midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!**" (Enfal, 8/24)

"**Thuaju: 'Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!' Në qoftë se kthejnë shpinën,** (dijeni se) **Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.**" (Al 'Imran, 3/32)

"**Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.**" (Nisa, 4/14)

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati thënë në lidhje me ngjarjet që do të ndodhnin në të ardhmen: "*Ato që u ndodhën bijve të Izraelit, do t'u ndodhin po njësoj edhe umetit tim. Asisoj, që nëse në mesin e tyre të ketë pasur të atillë që të kenë ardhur hapur pranë nënës së tyre, medoemos që edhe prej umetit tim do të ketë të atillë që do ta bëjnë këtë veprim të shëmtuar. Si përfundim, bijtë e Izraelit qenë ndarë në shtatëdhjetë e dy popuj. Edhe umeti im do të ndahet në shtatëdhjetë e tre grupe. Përveç njërit, të gjithë të tjerët do të jenë të zjarrit e do digjen.*"

E patën pyetur, se cili ishte ky grup dhe ai iu qe përgjigjur, se "Janë ata që nuk largohen nga ajo udhë nëpër të cilën jemi unë dhe sahabët e mi."[7]

---

[2]. Taberani, *Muxh'emu's-Sagir,* 2/100.
[3]. Tirmidhi, *Sunen,* 5/46.
[4]. Mundhiri, *et-Tergibu ue't-Terhib,* 1/41.
[5]. Taberani, *Muxh'emu's-Sagir,* 2/100.
[6]. El-Hindi, *Kenzu'l-Umal,* 1/328.
[7]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 8/152.

Një nga sahabët, të cilin e quanin Irbad ibni Sarije (radijallahu anhu), tregon se: Një ditë, Profeti i nderuar na fali namazin, mandej, me të mbaruar, e ktheu kokën nga xhemati dhe mbajti një ligjëratë tejet retorike dhe kuptimplotë. Asisoj që sytë e dëgjuesve u mbushën me lot, ndërsa zemrat u galduan në emocione. Madje, nga xhemati u dëgjua të thuhej: "O i Dërguari i Allahut, pse po na flet kështu, sikur kjo të ishte një fjalë lamtumire? Çfarë po na këshillon të bëjmë?" - Resulullahu heshti për pak kohë, pastaj u përgjigj: "*Unë ju këshilloj që të jeni të devotshëm përballë Allahut; që edhe sikur një skllav nga Abisinia t'ju vihet mbi krye, prapësepraprë ta dëgjoni e t'i bindeni atij. Pasi atyre që do të kenë jetë dhe do të jetojnë gjatë, kanë për t'u parë sytë shumë mosmarrëveshje kur unë të mos jem më. Andaj, unë po ju kujtoj juve sunetin tim dhe jetën e katër kalifëve të mëdhenj, mjafton t'u bindeni duke u përqafuar sa më fort pas tyre. Veç kësaj, ju këshilloj që të tregoheni tejet të kujdesshëm dhe tejet të kthjellët për ato që do të ndodhin e do të shfaqen më pas, sepse çdo gjë e nxjerrë rishtazi, që nuk bën pjesë në sunetin tim është bid'at* (sajesë)*, dhe çdo i tillë është një devijim, një shthurje*."[8]

Lidhja mes Resulullahut dhe Umetit të tij

Lidhja mes Allahut dhe umetit të Profetit Muhamed (s.a.s.) i ngjan gjendjes së këtij njeriu: "*Dikush ndërton një shtëpi të re, kësodore për shtëpinë e re shtron një gosti, e natyrisht për t'i ftuar njerëzit që ka vendosur të tubojë, dërgon një lajmëtar. Ata që i përgjigjen ftesës, futen brenda dhe përfitojnë prej gjithë të mirave të shtraura në atë gosti. Ndërsa ata që nuk vijnë, as nuk e shohin dot shtëpinë e re, e as nuk shijojnë dot prej ushqimeve të gostisë.*" Mësimi i këtij shembulli është ky: Ajo shtëpi është Xheneti, i zoti asaj shtëpie është Allahu (xhel'le xhelaluhu), lajmëtari që çon ftesën është Muhamedi (alejhis'salatu ues'selam). Ai që i përgjigjet ftesës së Tij cilësohet se i është bindur Allahut (xh.sh.), ndërsa ai që nuk i përgjigjet është ai që ka kundërshtuar Allahun e Madhërishëm. Profeti ynë i nderuar (paqja e Zotit qoftë mbi Të) ka shpërfaqur dallimin mes njerëzve (atyre që besojnë dhe atyre që nuk besojnë).[9]

Po ende Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shprehet

[8]. Ebu Daud, *Sunen,* 2/610.
[9]. Buhari, *Sahih,* 6/2655.

kështu: "*Gjendja ime me ftesën që Allahu Fuqiplotë ka dërguar përmes meje i ngjan gjendjes së atij njeriut, që: Një burrë shkon njëherë pranë të afërmve të tij dhe u thotë: 'Unë i pashë ushtritë e armiqve me këta dy sy, kështu që po ju bëj të ditur rrezikun që ju kanoset, duhet të merrni menjëherë të gjitha masat!' - Një pjesë e popullit e dëgjon këshillën e tij, e me të rënë nata, i mbledh gjithë ç'ka dhe largohet paq. Kurse pjesa tjetër nuk ia vë asfare veshin fjalëve të tij, madje edhe i përgënjeshtron, duke mos lëvizur aspak nga vendi. Mirëpo, vjen mëngjesi dhe që të gjithë zihen robër dhe vriten nga ushtria armike. Ja, ky shembull e paraqet më së miri ndryshimin mes atyre që u binden fjalëve të mia dhe atyre që nuk i pranojnë ato, madje edhe i mohojnë ato që unë i kam sjellë prej Allahut të Madhërishëm.*"[10]

Muhamedi, paqja e Allahut qoftë mbi Të, shprehet: "*Historia ime është si ajo historia e atij burrit që ndez një zjarr. Kur zjarri bëhet bubulak e zë të ndriçojë rreth e rrotull, fluturat dhe disa gjallesa të tjera, që e duan dritën, vërsulen për t'u hedhur në mes të flakëve. I gjori burrë, ç'të bëjë, orvatet të bëjë ç'të mundë, që t'i pengojë, por ato fillojnë të hidhen tufa-tufa drejt e në zjarr. Edhe unë, porsi ai burri, ju tërheq ju nga pas, që ju të mos bini në flakët e zjarrit, kurse ju vazhdoni të rendni me sa të mundni drejt tyre.*"[11]

2. AJETE RRETH PROFETIT (a.s.) DHE SAHABËVE TË TIJ

"**A nuk i sheh ata të cilët, edhe pse iu është ndaluar të kurdisin fshehtësisht, kthehen tek ajo që u është ndaluar dhe kurdisin për gjynahe, armiqësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit? Kur vijnë tek ti, ata të përshëndesin me fjalë, me të cilat Allahu nuk të përshëndet kurrë dhe thonë me vete: "Pse nuk na dënon Allahu për këtë që po flasim?" Xhehenemi është një dënim i mjaftueshëm për ata. Në flakët e tij do të digjen. Eh, sa vendbanim i tmerrshëm që është ai! O besimtarë! Kur të bisedoni fshehtas mes jush, mos flisni për gjynahe, armiqësi dhe mosbindje ndaj të Dërguarit; por bisedoni për mirësi dhe drejtësi. Kijeni frikë Allahun, para të Cilit do të tuboheni.**" (Fet'h, 58/8-9)

Një umet i mbarë dhe i ekuilibruar

"**Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri**

[10]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 5/60.
[11]. Buhari, *Sahih,* 5/2379.

i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhamed) **dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.**" (Nahl, 16/89)

"**Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju. Ne nuk e kemi bërë kthimin tënd nga Qabeja** (o Muhamed) **për tjetër arsye, por vetëm për t'i dalluar ata që i shkojnë pas të Dërguarit, nga ata që kthehen nga thembrat** (që tërhiqen nga besimi tek ai)**. Kjo provë ka qenë e rëndë** (për njerëzit)**, por jo për ata që Allahu i ka udhëzuar. Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin tuaj** (d.m.th. namazin që keni falur nga Kudsi)**. Në të vërtetë, Allahu është Përdëllimtar dhe i Mëshirshëm me njerëzit.**" (Bekare, 2/143)

"**Luftoni në rrugën e Allahut, ashtu si duhet luftuar. Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur juve myslimanë qysh më parë** (në Shkrimet e Shenjta) **dhe në këtë** (Kuran)**, me qëllim që i Dërguari të jetë dëshmitar mbi ju dhe që ju të jeni dëshmitarë mbi njerëzit e tjerë. Andaj, faleni namazin, jepni zeqatin dhe mbështetuni tek Allahu! Ai është Mbrojtësi juaj. Sa Mbrojtës dhe Ndihmës i mrekullueshëm është Ai!**" (Haxh, 22/78)

Profeti i një umeti të mbarë dhe të ekuilibruar

"**Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin** (Kuranin) **e urtësinë** (diturinë e thellë fetare)**, edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.**" (Al 'Imran, 3/164)

"**Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.**" (Teube, 9/128)

"**Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta** (o Muhamed)**! Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe**

këshillohu me ta për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai." (Al 'Imran, 3/159)

Veçoritë e sahabëve të tij janë të shkruara edhe në Teurat e Ungjill

"**[...] dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe në Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.**" (Araf, 7/157)

"**Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit.** (Kështu përshkruhen ata) **me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.**" (Fet'h, 48/29)

Si vlerësohen sahabët në Kur'anin Famëlartë

"**Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore.**" (Teube, 9/100)

"**Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt e me një plaçkë të madhe që do ta fitojnë. Allahu është i plotfuqishëm dhe i Urtë.**" (Fet'h, 48/18-19)

"**Pa dyshim, Allahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve, të cilët shkuan pas atij në çastin e vështirë, pasi zemrat e disave prej tyre për një fije qenë afër shmangies** (nga detyra)**, pastaj Allahu pranoi pendimin e tyre. Vërtet, Ai është i Butë dhe i Mëshirshëm me ta.**" (Teube, 9/117-118)

Sahabët, përmendore të besnikërisë dhe sinqeritetit në besim

"**Një pjesë e plaçkës u takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e sinqertë. Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.**" (Hashr, 59/8-9)

"**Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre. Nuk ka dyshim se Allahu do t'i shpërblejë të sinqertët për sinqeritetin e tyre e do t'i dënojë hipokritët, nëse do ose do t'u pranojë pendimin. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**" (Ahzab, 33/23-24)

3. KARAKTERISTIKAT E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Sipas transmetimeve, pamja e jashtme e Profetit të profetëve përshkruhet me këto fjalë: Ai kishte një trup të madh, i cili i jepte Atij një pamje madhështore. Gjymtyrët e trupit i kishte në raporte

të ekuilibruara, pra krejt të natyrshme edhe në lidhjen që kishin me njëra-tjetrën.[12] Fytyra i ndriçonte, seç kishte një vezullim të veçantë, sikur hëna e plotë. Ashtu siç nuk e kishte fytyrën të shëndoshë, as i rrumbullakët e topolak nuk ishte. Vetëm në fytyrë i dallohej një rrumbullakësi e lehtë. Ajo ishte fytyra më e buzëqeshur ndër të gjithë njerëzit. Trupi i Tij kishte një veçori që nuk bënte asnjëherë hije pas vetes. Edhe kur qëndronte përballë diellit, vezullimi i fytyrës së tij e mposhtte dritën e diellit.[13] Kur kënaqej Krenaria e Njerëzimit, fytyra i shkëlqente sikur të ishte një copë prej hënës. Kësisoj kuptohej nëse ishte apo jo i gëzuar.[14]

Nuk ishte tejet i gjatë, pak më i gjatë se një trup mesatar. Ndërsa ecte, dukej një njeri me trup të mesëm. Kur i afrohej pranë ndokush që ishte më i gjatë në trup, trupi i tij të krijonte përshtypjen se tjetri ishte më i gjatë sesa Ai. Shpatullat i kishte të larguara nga njëra-tjetra.[15] Vendet e kyçeve dhe shpinën i kishte pak sa të fryra. Jeleku që vishte, kur i binte poshtë shpatullave, ngjante njësoj si një mbulojë e argjendtë e derdhur mbi një kallëp të gatshëm.[16] Mes dy kockave të shpatullave, pak më sipër asaj të majtës gjendej vula e profetësisë, e cila ngjante paksa me gjysmëhënën, paksa me vezët e pëllumbit, në një ngjyrë me lëkurën, e që rrinte në formën e një grushti.[17]

Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte një gjoks të gjerë, i cili ishte në të njëjtën vijë me barkun. Nuk kishte bark të madh. Edhe shpinën, nuk e kishte as të mbushur, as shumë të dobët. Në bark kishte tri pjesë si ndarje të lakuara. Nga sipër gjoksit deri në fund të barkut kishte një si vijë të hollë qimesh. Nuk kishte të tjera të tilla, as në pjesë të tjera të gjoksit, as të barkut. Kishte, por më pak, edhe mbi supe apo mbi pjesët pak më sipër zemrës.[18]

Gishtat e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishin të gjatë dhe të hollë si shufra argjendi, me maja paksa të trasha, pëllëmbë të

---

12. Muslim, *Sahih,* 11/491.
13. Dimashki, *Opusi për Profetin,* 2/41.
14. El-Hindi, *Kenzu'l-Um'mal,* 7/50.
15. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/50.
16. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/314.
17. Buhari, *Sahih,* 1/81.
18. El-Hindi, *Kenzu'l-Um'mal,* 7/314.

fryrë, ndërsa kockat, si të duarve, ashtu edhe të këmbëve, i kishte krejtësisht të drejta. Me poshtësupe të mbushura, kocka krahësh të gjatë dhe kyçe të fryra mbi kockë.

Këmbët i kishte të mëdha. Thembrat vetëm fare pak të mishta. Nënkëmba ishte gropë, kurse pjesa e sipërme e butë dhe jashtëzakonisht e drejtë.[19]

Koka e Profetit të Universit ishte jo e vogël, me flokët as të drejta e as me kaçurrela; diçka midis të dyjave, i dallgëzuar... Flokët i zbrisnin deri në mes të veshëve, e nganjëherë i kishte më të gjatë, aq sa i kalonin mes dy veshëve deri poshtë, duke u derdhur mbi shpatulla.[20] Nganjëherë e ndante atë në mes, me balluket të lëshuara që i zbritnin deri fare pranë syve.[21] Ndodhte që edhe t'i thurte flokët plot katër herë. Dy syresh i kalonte mbi veshin e djathtë, e dy të tjera mbi veshin e majtë. Veshët, që i dalloheshin pas flokëve të zinj, të kujtonin yjet e vegjël e vezullues.[22] Kur e krihte me krehër, floku i bëhej vija-vija, njësoj si rrathët e formuar mbi rërën e shkretëtirës prej erës, apo valët e formuara mbi sipërfaqen e një uji kur hedhim diçka mbi të.[23] Ngjyra e tyre ishte një e zezë e errët. Krenaria e Njerëzimit kishte një ballë të hapur e të gjerë, me një lëkurë të lëmuar dhe pa as më të voglën shenjë vrazhdësie.[24] .

Me vetullat të holla, të cilat i ktheheshin drejt cepave të syve, herë-herë të dukej sikur ato i bashkoheshin me njëra-tjetrën, e sikur nuk ishin të ndara. Në mes vetullave kishte një damar, i cili i fryhej sa herë që i duhej t'i mrrolte vetullat kur mund të ndodhte që të nxehej nga ndonjë gjë e pahijshme.[25] Balli, kur i dukej më i hapur prej ballukeve, apo kur dilte përballë njerëzve në mbrëmje, i shndriste dhe vezullonte porsi një pishtar i ndezur.

E zeza e syve ishte plotësisht e zezë, ndërsa e bardha e bardhë dëborë; një e bardhë si të ish e përzier me të kuqen.[26] Sytë i kishte të

[19]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/314.
[20]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 22/155.
[21]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 6/20.
[22]. Dimashki, *Opusi për Profetin,* 2/24.
[23]. Dimashki, *Opusi për Profetin,* 2/22.
[24]. Tirmidhi, *Shemail,* 1/36.
[25]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 22/155.
[26]. Muslim, *Sahih,* 4/1280.

mëdhenj. Qerpikët të gjatë dhe të lakuar.[27] Sytë e tij shikonin edhe ç'kishte pas, po ashtu siç shikonin çfarë gjendej përpara.[28]

Resulullahu (paqja e Zotit qoftë mbi Të) kishte dëgjim të plotë. Nganjëherë shikonte edhe ato çfarë të tjerët nuk i shihnin dot, e dëgjonte ato çfarë ata nuk kishin mundësi që t'i dëgjonin.[29]

Hunda e Profetit të mbarë njerëzimit (alejhis'salatu ues'selam) ishte e gjatë, me mesin paksa të ngritur, majën të hollë, elegante dhe të drejtë. Kush e shihte për herë të parë, mendonte se e kishte hundën më të lartë dhe më të lakuar sesa një hundë e zakonshme. Faqet nuk i kishte të fryra, por as të zbrazëta. I kishte të drejta. Me pak tul, por me një lëkurë të lëmuar.[30]

Goja e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) ishte e madhe, e gjerë aq saç duhet të jetë për t'u cilësuar elegante. Ajo bënte që dhëmbët e përparmë të ishin të dukshëm, të bardhë si kristal dhe të mprehtë. Dhëmbët e Tij të dukeshin sikur të ishin disa kokrra breshëri të rreshtuara me rregull njëra pas tjetrës.[31] Kur fliste, dhe ti ishe duke e dëgjuar, dukej sikur nga goja nuk i derdheshin fjalë, por një nur i ëmbël. E po ashtu njomështia e gojës së Tij ishte një tjetër çështje mrekullie apo dhurate e mirësisë hyjnore. Ajo erëmonte përherë një aromë të këndshme. Njëherë patën hedhur pak prej njomështisë së gojës së Tij mbi grykën e një pusi dhe uji i tij pati filluar të mbante një erë të mirë.[32] Pikërisht me këtë pështymë ia pati fërkuar trupin e mbushur me puçrra Utbe ibni Ferkadit, i cili megjithëse nuk qe lyer me kurrfarë erëmire, mbartte një aromë tejet të këndshme.[33] Edhe pusi që gjendej në shtëpinë e Enes ibni Malikut (radijallahu anhu) qe kthyer në depozitën e ujit më të ëmbël në mbarë Medinën.

Ai e kishte fytyrën me një mjekër të dendur, të shpeshtë dhe të madhe[34] Pjesën mes buzës së poshtme dhe mjekrës e kishte të hapur.

---

27. Tirmidhi, *Sunen,* 5/599.
28. El-Hindi, *Kenzu'l-Um'mal,* 7/1063.
29. Tirmidhi, *Sunen,* 5/599.
30. Tirmidhi, *Shemail,* 1/36.
31. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 16/27.
32. Tirmidhi, *Shemail,* 1/38.
33. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 12/65.
34. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 2/152.

Rreth e qark saj dalloheshin dy-tri fije të zbardhura, me një të bardhë si prej kristali. Edhe në flokë apo mjekrën në tërësi, veç tri-katër fije mund t'i dalloheshin si të thinjura. Nuk i pati lyer asnjëherë, as flokët, as mjekrën.[35] Por edhe flokët nuk iu thinjën asnjëherë tërësisht. Allahu nuk ia zbardhi flokët, nuk deshi që ta tregonte të moshuar. Ato pak qime të thinjura të mjekrës rrinin aty pak më sipër fundit të mjekrës.[36]

Lëkurën e kishte më se të lëmuar. Më e lëmuar edhe se mëndafshi. Me një erëmim më të ëmbël edhe se vetë aroma e miskut e amberit.[37] Trupi i Krenarisë së Gjithësisë djersiste mjaft shpesh. Ummu Sulejmi ia mblidhte ndonjëherë djersën nëpër shishe të vockla, që më pas, duke i hedhur nëpër shishkat e aromave të mira, t'i bënte ato që mbanin erë akoma më të këndshme dhe me to bënte parfume.[38] Daç të hidheshin ato parfume, daç të mos hidheshin, dora e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) do të lëshonte përherë një erë shumë të mirë; edhe dora e atij që shtrëngonte dorë me të gjatë ditës, mbante aromë gjer në mbrëmje.

Profeti ynë (s.a.s.) ecte shumë shpejt; sikur toka të përkulej për t'iu përshtatur këmbëve të Tij, që Ai të ecte sa më lehtësisht.[39] Kushdo që rendte pas Tij e kishte të pamundur që ta arrinte.[40] Nuk kishte hije pas Tij, as ditës për diell, e as natës për hënë. I qe pranuar menjëherë lutja që i pati bërë Allahut (xh.sh.): "*O Zot, bëmë mua dritë!*"[41]

Krenaria e Njerëzisë kishte një zë kumbues, me një ton aq të ëmbël.[42] Sahabët tregonin shpesh: "Na foli në Mina, dhe na bëri që të na hapeshin veshët. Madje ne arrinim t'ia dëgjonim zërin edhe që nga shtëpia."[43] Ndonjëherë ndodhte që nga çardakët e shtëpive të Medinës të vinte zëri i ëmbël i Profetit fisnik teksa fliste në *Faltoren Profetike*.[44] Ai ishte folësi më i qartë i gjuhës në mbarë arabët.

---

35. Muslim, *Sahih,* 4/1821.
36. Dimashki, *Opusi për Profetin,* 2/24.
37. Muslim, *Sahih,* 4/1814.
38. Muslim, *Sahih,* 4/1816.
39. Ahmed, *Musned,* 2/350.
40. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 1/100.
41. Muslim, *Sahih,* 44/1816.
42. Muslim, *Sahih,* 1/525.
43. Dimashki, *Opusi për Profetin,* 2/86.
44. Ibn Maxhe, *Sunen,* 1/429.

4. VEÇORITË E SAHABËVE

Sahabët që Allahu (xhel'le xhelaluhu) ia zgjodhi dhe ia dhuroi të Dërguarit të Tij (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishin individët më të mbarë në krejt shoqërinë. Edhe Kur'ani Famëlartë e shpreh qartë se umeti i Profetit Muhamed (s.a.s.) është më i nderuari ndër gjithë umetet.

"**Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin:** (sepse) **ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej atyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.**" (Al 'Imran, 3/110)

Sipas asaj që është transmetuar, në kohën e hilafetit, Omeri (radijallahu anhu) ka thënë këto fjalë kur është rrekur që t'i japë kuptim këtij ajeti: "Po të donte Allahu (xh.xh.) në vend të frazës "*ju ishit*" në ajet, mund të përdorte trajtën e saj "*jeni ju*" dhe kësodore, në përmbajtjen e këtij ajeti mund të ishin të përfshirë të gjithë. Mirëpo, me atë "*ju ishit*" del mjaft qartë se me këtë nënkuptoheshin vetëm sahabët. Andaj, kush u ngjan atyre, duke kryer vepra si ato që bënë ata, arrin të bëhet pjesë e bashkësisë më të mbarë, më fisnike e më të përzgjedhur të gjithë njerëzimit."

Në një transmetim tjetër, Omeri (radijallahu anhu), në kohën e Haxhit, pasi kishte parë disa sjellje të pahijshme prej disa njerëzve, u pati lexuar atyre këtë ajet, duke shtuar: "O njerëz, kush dëshiron që të jetë prej asaj bashkësie të cilën e ka përzgjedhur Allahu (xhel'le sha'nuhu), t'i plotësojë të gjitha konditat që parashtron përfshirja brenda saj." Kësodore ai e pati këshilluar popullin e tij, që në çdo veprim, qoftë përsa i përket udhëzimit për mirë apo ndalesës nga e keqja, qoftë në çfarëdolloj çështjeje tjetër, ata të merrnin si shembull sahabët, duke bërë çmos që t'u ngjanin atyre sa më shumë.[45]

I Vërteti Allah (xh.sh.), i Cili i njeh më së miri zemrat e njerëzve, zgjodhi pikërisht Muhamedin (s.a.s.), Krenarinë e Njerëzimit, për ta përgëzuar me detyrën e profetësisë. Mandej, sërish duke i vështruar

[45]. El-Hindi, *Kenzu'l-Um'mal,* 2/492.

zemrat e njerëzve zgjodhi bashkësinë e sahabëve që të ishte e denjë për të qenë umet i Profetit Muhamed (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), duke bërë që të ishin ata ndihmëtarët e parë të fesë islame, me përfaqësimin sa më të përkryer të asaj që do të ishte feja e madhërishme e Allahut (xh.xh.). Andaj, për sa i përket kënaqësisë së Allahut, kush i pëlqen e i merr shembull sahabët është i pëlqyer, e kush nuk i pëlqen si shembullin, ai nuk mund të jetë i tillë.[46]

Abdullah ibni Omeri (radijallahu anhu), një prej prijësve të sahabëve, teksa flet për ta, ai shprehet me këto fjalë: "Ata që duan të ndjekin një rrugë të drejtë, le të ndjekin rrugën e të parëve të tyre. E ata janë sahabët fisnikë të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ata janë më të mirët e umetit të tij. Më të thellët, për sa i përket dijes, më të pastrit nga zemra; me pak fjalë, njerëz për të cilët është i pamundur kundërshtimi i ndonjë prej cilësive të tyre. Ata janë një shoqëri aq e lartë, sa që Allahu i Madhërishëm i pa ata të denjë për Profetin e Tij më të zgjedhur, Muhamedin (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Ishte pikërisht kjo shoqëri me të cilët Ai e mishëroi fenë e Vet. E meqë është kështu, ejani edhe ju, përftoni moral prej moralit të tyre, e ecni në të njëjtën rrugë ku ecën dhe ata, sepse ata nuk janë tjetër, veçse shoqëria më e zgjedhur e Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ju betohem për Zotin e Qabes, se ata patën ecur në rrugën e drejtë."[47]

Përmendorja e madhe e dijes, Abdullah ibni Mesudi (radijallahu anhu), i cili ishte i afërm me të, aq sa t'i hynte pa teklif (drojë) në banesë, kaq mprehtë i qorton tabiinët: "Ju si tabiinë ndoshta mund të agjëroni edhe më tepër se sahabët, mund të falni më shumë namaz, e mund të lodheni më tepër sesa ata duke i shërbyer Islamit. Por mos harroni se ata ishin gjithsesi më të mirë e më të mbarë se ju." E kur e pyetën se përse ishte kështu, ai iu përgjigj: "Sepse ata (me zemër) nuk ishin asfare të interesuar për asgjë të kësaj bote, e jashtëzakonisht të dhënë pas jetës së përtejme."[48] Çdonjërit prej dijetarëve ndër sahabë që do t'i bënit një pyetje, përgjigjja që do të merrnit do të ishte përherë

[46]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/375.
[47]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/305-306.
[48]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 136.

e njëjta përgjigje. Gishtërinjtë e tyre tregonin përherë kah varret e Ebu Bekrit dhe Omerit të nderuar (radijallahu anhuma).[49]

Një ditë, Aliu (radijallahu anhu) u fali besimtarëve namazin dhe iu drejtua xhematit të tij me këto fjalë: "Unë i kam parë sahabët e Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i kam njohur shumë mirë të gjithë një e nga një. E sot unë nuk shoh askënd që t'u ngjajë atyre. Uallahi atyre u shterej fuqia nga të falurit namaz pareshtur, flokët u djersiteshin e u shprisheshin, ndërsa fytyra u pluhurosej nga tërë ato ulje të njëpasnjëshme në sexhde. E gdhinin çdo ditë, ose duke lexuar Kur'an, ose duke falur namaz. Me t'u përmendur Allahu në praninë e tyre, ata fillonin të lëkundeshin sikur degët e pemëve kur fryjnë erëra të forta. Nga sytë u derdheshin lot sikur të ishte duke rënë shi i dendur, uallahi, ju betohem, aq shumë lot derdhnin, sa që edhe teshat në trup u lageshin. Të më besoni, më vjen keq, por unë besoj se sot njerëzit i kalojnë netët e tyre të topitur e larg kësi ndjenjash."[50] Pasi tha këto fjalë, Aliu (radijallahu anhu) u ngrit për t'u larguar së andejmi, e deri në ditën kur ra dëshmor nga dora e të shthururit armik të Allahut, Ibni Mulxhemit.

[49]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/307.
[50]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 8/6.

FTESA, THIRRJA PËR TEK ALLAHU DHE I DËRGUARI I TIJ

Si u bë ftesa e njerëzve për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, puna më e dashur, si për Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ashtu edhe për sahabët e tij? Sa shumë e dëshironin ata që njerëzit të hynin në rrugën e drejtë, të pranonin fenë e Allahut, duke u përfshirë kësisoj tërësej në mëshirën e Tij? Çfarë përpjekjesh bënë ata, për t'i bërë njerëzit që të njihnin Allahun, më të Drejtin e të Vërtetin?

1. DASHURIA PËR T'U TREGUAR NJERËZVE PËR MË TË DREJTIN

Si i Dërguari i Allahut digjej si qiriri, vetëm që njerëzit të besonin

Krenaria e Gjithësisë donte shumë që të gjithë njerëzit të besonin dhe t'i bindeshin Allahut, Atij që është më i Drejti dhe më i Vërteti. Ja se si e përshkruan ajeti kur'anor këtë dëshirë të tyren. "**Duket sikur do të hash veten nga mërzia pse njerëzit nuk po besojnë. Po të donim, ne u zbritnim atyre një mrekulli të atillë prej qiellit, që duan s'duan do**

të binden." (Shu'ara, 26/3-4) Vetëm se, Allahu, me këtë ajet, tha: "**Disa njerëz janë fatkëqinj, e disa të tjerë janë të lumtur.**" (Hud, 11/105). Në përmasën e kaderit, disa janë të përshtatshëm për të besuar, e disa të tjerë janë shumë larg prej tij, ndaj edhe janë fatkëqij.[1]

Thirrja që i bëri Resulullahu fisit të tij kur vdiq xhaxhai i Tij, Ebu Talibi

Kur Ebu Talibi u sëmur, një grup nga kurejshët, i përbërë nga Utbe bin Rebia, Shejbe bin Rabia, Ebu Xhehl bin Hishami, Umeje bin Halefi dhe Ebu Sufjan bin Harbi, erdhën pranë dhe i folën Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) duke i thënë: "Nipi juaj po i shan zotat tanë, madje nuk ka lënë gjë pa u bërë dhe pa thënë për ta. Sikur ta qortoni dhe ai të heqë dorë nga kjo punë. O Ebu Talib! Ti je i yni. Tani ti je duke vdekur, dhe ne jemi shumë të shqetësuar për ty. Ti e di shumë mirë problemin që ne kemi me nipin tënd. Thirre dhe kërkoji atij që të të japë fjalën. Të mos ngatërrohet më me ne, e as ne nuk do të ngatërrohemi me të. Të mos merret me fenë tonë, e as ne nuk do të ngatërrohemi me fenë e tij." Pasi i dëgjoi, Ebu Talibi dërgoi fjalë që t'a thërrisnin nipin e tij, Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). I Dërguari i Allahut erdhi menjëherë. Në mes të të gjithë atyre që ishin të pranishëm dhe xhaxhait të Tij kishte vend sa për t'u ulur veç një njeri i vetëm. Që i Dërguari i Allahut të mos ulej pranë Ebu Talibit, Ebu Xhehli e zuri menjëherë atë vend, duke e penguar kësisoj Profetin e nderuar (alejhis'selam) të ulej pranë xhaxhait të vet. Sepse, nëse Resulullahu do të ulej në atë vend, xhaxhait do t'i vinte keq për nipin dhe sakaq mund të shpallte edhe ai besimin në Islam. Edhe i Dërguari i Allahut, kur pa se nuk kishte ndopak vend që Ai të mund të ulej diku pranë xhaxhait, u ul pranë derës. Ebu Talibi i tha: "Nipi im! Ç'është ky shqetësim i fisit për ty? Më thonë se nuk ke lënë fjalë të keqe pa thënë për zotat tanë."

Sipas një transmetimi tjetër, Ebu Talibi i pati thënë këto fjalë të Dërguarit të Allahut, duke na treguar se ajo bisedë ka qenë më prekëse: "Shiko, o biri i tim vëllai! Që kurse të kam njohur ti kurrë nuk e ke

[1]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 7/196 (11243).

kursyer respektin ndaj meje. Por, këta njerëz që kanë ardhur këtu, më thonë se ti shkon në Qabe dhe thua fjalë të rënda për të gjithë. Si thua, sikur të heqësh dorë nga kjo punë, hë si thua, nipi im!" Krenaria e Gjithësisë i pati ngritur sytë drejt qiellit dhe i pati thënë xhaxhait:

"Ju betohem, se ashtu siç ju nuk keni fuqi as për të kapur qoftë edhe një rreze të vetme të këtij dielli, as unë nuk kam fuqi, pasi nuk është në dorën time, që të heq dorë nga kjo detyrë e profetësisë që Zoti më ka ngarkuar mbi supe."[2]

Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër Ebu Talibi i ka thënë:

"Nipi im! Diç më thanë këta njerëz që kanë ardhur tek unë. Të lutem, të të vijë pak keq edhe për mua, edhe për veten! Mos më ngarko mua me një barrë, për të cilën nuk kemi fuqi që ta përballojmë! Hiq dorë nga të folurit e fjalëve që nuk u pëlqejnë njerëzve të popullit tonë!"

Aty, kur dëgjoi këto fjalë nga goja e xhaxhait të Tij, të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) seç e kaploi një ndjesi se ai po i thosh se nuk do të ishte më i gatshëm për ta ndihmuar, duke e lënë kështu pa kurrfarë mbështetjeje, ndaj iu përgjigj me këto fjalë: "O Xhaxhai im! Sikur të ma vënë diellin në të djathtën dhe hënën të ma vënë në të majtën, unë nuk heq kurrë dorë nga misioni im. Deri në atë ditë, kur ose Allahu do të shpallë ngadhënjimin e fesë së Tij, ose unë do të vdes në këtë rrugë." Mandej Krenarisë së Njerëzimit iu mbushën sytë me lot dhe filloi të qante.[3]

Në atë kohë, paria e Kurejshëve që ishte e pranishme aty filluan të thoshin gjithfarë fjalësh kundër Profetit të Gjithësisë. Disa prej tyre thanë: "Ore! Nëse ke nevojë për ndonjë gjë, na thuaj, të mbledhim pasuri për ty sa të duash; të bëhesh ti më i pasuri i mbarë Kurejshëve! Nëse do që të kesh shumë gra, eja dhe zgjidh kë të duash prej grave, eja, po të duash, të të martojmë me dhjetë prej tyre njëkohësisht!"[4]

"Shiko, kushëriri im! Në mesin e familjes sonë ti je një njeri i zakonshëm; por në sytë e mi ti qëndron mbi të gjithë ne. Por, me sa

---

[2]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/8 (6809).
[3]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/42.
[4]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/62.

po më shohin sytë, ti po përpiqesh që të futësh në mes të njerëzve tanë një ngatërresë të atillë, që deri më sot askush nuk ka guxuar që ta bëjë. Nëse, me këto që thua, qëllim ke që të bëhesh i pasur, populli është i gatshëm që të bëjë ç'të jetë e mundur për ty, e mund të bëhesh ti më i pasuri ndër të gjithë ne. Nëse është nderi ai që kërkon, na thuaj e ne do të të ofrojmë ç'pozicion që të duash, madje jemi të gatshëm të të ofrojmë edhe atë më të lartin. Edhe nëse të kanë goditur shpirtrat e këqinj, e prandaj i thua të gjitha këto dhe e ke shumë të vështirë që të shpëtosh prej tyre, ne jemi gati që ta sakrifikojmë gjithçka, për të të kuruar, që vetëm ti të shpëtosh. Por jo, nëse dëshira e qëllimi yt është të bëhesh mbret, atëherë ne jemi gati që të të bëjmë edhe mbret." – i pati thënë Utbe bin Rebia.

Ndërkaq, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk iu përgjigj fjalëve të tyre, por u këndoi nga sureja "Fussilet" deri në ajetin e tridhjeteshtatë të saj.[5]

Resulullahu u kthye sërish nga xhaxhai i Tij dhe i tha: "Unë ata po i ftoj në një fjalë, që nëse ata e thonë atë me sinqeritet, duke e pranuar, kjo do t'i bëjë ata që të gjithë arabët dhe të gjithë axhemët (të huajt) t'i paguajnë *xhizje*.

Grupi i kurejshëve, e dinin se me atë fjalë Ai kishte parasysh fjalën e dëshmisë së njëjësisë së Zotit, ndaj zunë menjëherë të ulërinin: "Ç'na qenkësh! Vetëm një fjalë e vetme! Të mos guxosh të na e zësh më në gojë atë fjalë! Për hir të babait tënd, ne bashkohemi rreth çdo fjale tjetër që ti mund të na kërkosh ta pranojmë, por për këtë jo." Përplasnin duart të gjithë dhe kundërshtonin. Ebu Talibi, i cili i pati dëgjuar të gjitha sa u thanë, u drejtua edhe njëherë nga i nipi dhe e pyeti: "E ç'fjalë është kjo, o nipi im?" Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu përgjigj duke thënë: "*La ilahe il'lallah*". Me të dëgjuar atë fjalë, grupi i kurejshëve, të mbërthyer nga një shqetësim çmeritës, si të zënë në panik, u çuan menjëherë vendit. U çuan dhe thanë: "I është ngulitur në mendje, do që t'i shndërrojë tërë ata zota në një të

[5]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/62.

vetëm! Kjo është për t'u habitur, është e çuditshme!" (Sad, 38/5)[6] Kur e kuptuan se nuk mund të arrinin asgjë prej Profetit tonë të nderuar, u larguan të gjithë. Ebu Talibi i foli nipit të tij: "Nipi im! Më beso, ti nuk u the atyre asgjë që e kalon cakun!" Profeti ynë, duke menduar se nëse do t'i fliste xhaxhait të tij që e donte aq shumë, në ato çaste, ai do të pranonte e do të besonte, ndaj i tha: "Xhaxha, atëherë thuaje edhe ti atë fjalë, në mënyrë që, në ditën e kiametit, unë të mund të hyj si ndërmjetës për ty." Ebu Talibi e kuptoi mjaft mirë se me sa përzemërsi po ia thoshte këto fjalë nipi i tij i drejtë, dhe iu përgjigj:

"Nipi im, sikur të mos kisha frikë se ata mund të të bëjnë keq ty dhe njerëzve pranë teje dhe të mos druhesha prej fjalëve që do të thoshin kurejshët, se "e pranoi atë fjalë ngase pati frikë nga vdekja, do ta kisha thënë atë fjalë, qoftë edhe vetëm për të të gëzuar ty."[7]

Në një transmetim tjetër,[8] Profeti ynë i dashur është afruar pranë xhaxhait të Tij që ishte në çastet e fundit në këtë jetë. Aty ka qenë i pranishëm edhe Ebu Xhehli. Resulullahu i ka thënë: "Xhaxha, eja, thuaje fjalën e dëshmisë, në mënyrë që unë të mund të të mbroj përpara Zotit."

Ebu Xhehli dhe idhujtarët e tjerë, ushtronin vazhdimisht trysni mbi Ebu Talibin, duke i thënë: "Si, po heq dorë nga feja jote?" Vetëm kur u tha: "Jo, unë po vdes në fenë e Abdulmutalibit", ata u qetësuan dhe e lanë të qetë. I Dërguari i Zotit, me zemrën të plagosur, nuk tha gjë tjetër, pos fjalëve: "Gjersa të më ndalohet, do të vazhdoj t'i lutem Zotit, që Ai të të falë." Më vonë, u zbritën ajetet, "**Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit.**" (Teube, 9/113) dhe "**Vërtet, ti** (Muhamed) **nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar.**" (Kasas, 28/56)[9]

---

6. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/123.
7. Ibn Hisham, *Sire,* 2/265.
8. Buhari, *Sahih,* 3/1409 (3671).
9. Buhari, *Sahih,* 4/1717 (4398).

Këmbëngulja e të Dërguarit të Allahut dhe e sahabëve në thirrjen e njerëzve për tek e drejta dhe e vërteta

I Dërguari i Allahut (alejhis'selam) ishte nisur për luftë nga Medina për në Hudejbije. Teksa udhëtonin, përpara u doli Budejl bin Uerkaja, së bashku me një grup nga fisi i Hudhaave. Hudhaatët bënin pjesë në fiset Tihame dhe ishin miq dhe ndanin të njëjtat të fshehta me të Dërguarin e Allahut.

Budejli shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha se kishte parë familjet mekase të Kab bin Luejit dhe Amir bin Luejit, të cilit kishin marrë devetë e tyre me qumësht bashkë me të vegjël dhe kishin zënë vend në ujërat e Hudejbijes. Ata kanë ndërmend të luftojnë me Ty. Druhem mos të pengojnë e nuk të lënë që ta vizitosh Shtëpinë e Allahut! Resulullahu (alejhis'salatu ues'selam) e dëgjoi dhe tha këto fjalë:

"Ne nuk kemi ardhur këtu për të luftuar me askënd. Ne kemi ardhur për të kryer umren! Por, me sa duket, kurejshëve u ka hyrë në gjak të luftuarit, megjithëse kanë pësuar shumë dëme nga lufta. Nëse duan, unë mund të bëj paqe me ta e t'u jap kohë, ndërsa ata do të tërhiqen e nuk do të më pengojnë që të takohem me njerëzit e tjerë. Nëse unë dal fitimtar mbi të tjerët, atëherë kurejshët, po të duan, mund të vendosin që të bëjnë paqe me mua me dëshirën e tyre. Nëse nuk dal unë fitimtar, atëherë kurejshët shpëtojnë nga mundimi për të luftuar me mua, dhe dalin sakaq më të fituar. Por ka edhe diçka, se nëse kurejshët do ta kundërshtojnë edhe këtë propozim që unë po u bëj, atëherë ju betohem për Allahun, në duart e të Cilit është shpirti im, se, për misionin tim, unë do të luftoj me ta derisa koka të më ndahet prej trupit e të vdes. Sepse, nuk ka dyshim, se Allahu do ta përmbushë premtimin e Tij, që ky mision që më ka ngarkuar mua një ditë do të përmbushet."[10]

Profeti me nam tha: "Turp për kurejshët. I paska brejtur nga brenda ambicia e tepruar për të luftuar. Po çfarë kanë kështu vallë! Nëse arabët e tjerë do të dalin fitimtarë kundër meje, ata do ta kenë arritur qëllimin e tyre pa u munduar fare. Nëse Allahu më bën mua që të ngadhënjej mbi ata njerëz, atëherë njerëzit do të pranojnë Islamin të gjithë. Nëse

[10]. Buhari, *Sahih,* 2/974 (2581).

nuk pranojnë, atëherë mund të mbledhin sërish forcat dhe të luftojnë edhe njëherë. Çfarë pandehin kurejshët? Betohem tek Allahu, i Vërteti, se ose do të luftoj derisa Zoti të më nxjerrë ngadhënjimtar në këtë të vërtetë të Islamit, ose kjo kokë do të ndahet prej trupit tim.[11] Ose do të sundojë e drejta, ose ne do të vdesim të gjithë!"

Gjatë rrethimit të kështjellës së Hajberit, kur ngadhënjimi mbi kështjellën po zgjaste, Krenaria e Gjithësisë tha këto fjalë: "Nesër, flamurin do t'ia jap një njeriu të atillë, që me duart e tij Allahu ka për të na e mundësuar ngadhënjimin. Ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe Allahu dhe i Dërguari i Tij e duan atë." Atë natë të gjithë e kaluan duke folur se kush do të ishte ai njeri i veçantë që do të merrte flamurin. Të gjithë mezi e pritën atë agim, duke shpresuar secili që të ishte ai që do t'i jepej flamuri dhe kur mbërritën pranë Krenarisë së Gjithësisë, Resulullahu filloi t'u fliste: "*Ku është Aliu?*" Sahabët thanë: "Ai është sëmurë nga sytë." "*Dërgoni dikë që ta thërrasë.*", – tha i Dërguari i Allahut. Më në fund, Aliu erdhi. Prijësi i Profetëve, mori pak pështymë nga goja e Tij e bekuar dhe me të ia fërkoi sytë Aliut, duke u lutur. Aliut iu shëruan sytë, sikur të mos kishte pasur asnjë dhimbje deri në ato çaste. Profeti ynë ia dorëzoi atij flamurin. Aliu i nderuar (r.a.) e mori flamurin dhe tha:

"O i Dërguar i Allahut! Do të mundem me hebrenjtë e Hajberit derisa ata të bëhen të gjithë myslimanë."

Resulullahu (s.a.s.) e dëgjoi dhe i tha:

"*O Ali! Sillu me maturi dhe tregohu i qetë derisa të zbresësh në fushën e hajberasve dhe të ngresh çadrën tënde. Mandej ftoji ata në Islam dhe lajmëroi ata për atë që Allahu na e ka shpallur të domosdoshme nëpërmjet Islamit. Të betohem për Allahun, se nëse Allahu i tregon përmes teje rrugën e drejtë qoftë edhe një njeriu të vetëm, kjo për ty do të jetë më e mirë e më e hairit se sa të merrje shumë deve të kuqe.*"[12]

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Gjatë ngadhënjimit mbi qytetin e Tusterit (Shushter) në Iran, Ebu Musa el-Eshariu më solli mua pranë Omerit (radijallahu anhu). Asokohe gjashtë njerëz nga familja e Bekr

[11]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 4/323 (18930).
[12]. Buhari, *Sahih,* 3/1096 (2847).

bin Uailit kishin hequr dorë nga Islami dhe ishin përfshirë në radhët e idhujtarëve. Omeri (radijallahu anhu) më pyeti: "Në ç'gjendje është ai grupi i të larguarve nga feja?"

Unë iu përgjigja: "O i pari i besimtarëve, ata janë një grup që u larguan prej Islamit, për t'u bashkuar me idhujtarët. Nuk kemi se ç'të bëjmë me ta, ndaj duhet t'i vrasim." Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "Nëse i kap ata të gjallë, shëndoshë e mirë, kjo do të jetë më e vyer se sa i gjithë floriri dhe argjendi që ndriçohet nga drita e atij dielli."

- "O i pari i besimtarëve! Nëse do t'i kapje, çfarë do t'u bëje?", – e pyeta sërish.

- "Do t'i ftoja që të ktheheshin dhe të hynin sërish nga ajo portë që dolën njëherë. Nëse do të kthenin, do ta pranoja kthimin e tyre. Në të kundërt, do t'i mbyllja në burg.", – m'u përgjigj.[13]

Durimi që ka treguar i Dërguari i Allahut teksa ftonte Hakem bin Kejsanin në Islam

Mikdad bin Amri (radijallahu anhu) tregon: Hakem bin Kejsanin e pata marrë peng. Komandanti ynë donte ta vriste. Unë i thashë: "Ma lër mua, ta çoj tek i Dërguari i Allahut" - dhe e çuam. Resulullahu filloi t'i bënte thirrje atij që të hynte në Islam. Këmbëngulte vazhdimisht, që të besonte edhe ai. Mikdad bin Amri ndërhyri: "O i Dërguari i Allahut, po pse flet kaq gjatë me këtë njeri? Ky nuk e pranon kurrë Islamin. Ma lër mua, t'ia fluturoj kokën nga trupi dhe të shkojë të rrokulliset në fund të Xhehenemit!" Krenaria e Gjithësisë (paqja e Zotit qoftë mbi Të) nuk i kushtoi shumë rëndësi këtij propozimi të Mikdad bin Amrit. Në fund, Hakem bin Kejsani u bë mysliman. Mikdad bin Amri, një të parë se edhe Hakemi u bë mysliman, u ndje në turp për sjelljen që kishte shfaqur përpara të Dërguarit të Allahut dhe tha me vete: "Si guxova unë t'i dilja kundër Resulullahut, i Cili i di gjërat shumë më mirë se unë!" - Më vonë, Mikdadi, për shkak edhe të ndjeshmërisë së lartë që kishte për punët e fesë, e ka menduar shumë herë këtë kundërshtim ndaj të Dërguarit të Allahut dhe ka dashur që të qetësojë

[13]. Bejheki, *Sunen,* 8/207 (16665).

veten njëfarësoj.

Mikdad bin Amri ka thënë: "Hakemi pranoi Islamin si fe dhe u bë mysliman. Madje ai u bë një mysliman shumë i mirë. Luftoi në rrugën e Allahut, deri në ditën që ra edhe dëshmor gjatë luftës së Bi'ri Meunes. I Dërguari i Allahut (alejhis'selam) ishte shumë i kënaqur me të dhe kështu ai u përfshi në mesin e banorëve të Xhenetit."[14]

Si u bë mysliman Uahshiu, nga dora e të cilit ra dëshmor Hamzai (r.a.)

Uahshiu, pasi vrau Hamzanë (radijallahu anhu) dhe ky i fundit hyri në radhët e dëshmorëve, u kthye për në Mekë. Kur myslimanët ngadhënjyen mbi Mekën, ai u arratis në Taif. Por edhe banorët e Taifit kishin filluar të shkonin të gjithë për të pranuar Islamin. Nuk kishte ngelur më asnjë vend ku të mund të fshihej Uahshiu.

Krenaria e Gjithësisë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi lajm se ai e ftonte Uahshiun që të pranonte fenë islame dhe të bëhej mysliman. Ndërsa Uahshiu i ktheu këtë përgjigje të Dërguarit të Allahut: "O Muhamed! Si është e mundur që ti më fton mua të pranoj Islamin? Ata që i bëjnë *shirk* Allahut [*shirk* ~ t'i bësh Zotit bashkëshoqërim, apo ortakëri, në krijim dhe në adhurim], që vrasin padrejtësisht një jetë të pafajshme dhe bëjnë zina do të vuajnë dënimin e tyre. Në ditën e Kiametit, kur të vijë çasti i asaj përballjeje të madhe, ndëshkimi i tyre do të jetë i shumëfishtë e ata do të qëndrojnë në të, të mbërthyer nga vuajtjet dhe poshtërimi. E unë i kam bërë të gjitha këto. A mund të ketë shpëtim për një njeri si unë?" Menjëherë pas kësaj, Allahu (xhel'le xhelaluhu) zbriti këtë ajet: "**Përjashtim bën ai që pendohet, beson dhe punon vepra të mira. Një njeriu të tillë Allahu ia ndërron veprat e këqija në të mira. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.**" (Furkan, 25/70)

Kur mori vesh këto fjalë, Uahshiu tha: "O Muhamed! 'Të kthesh e të besosh dhe të bësh punë të mira' është një kusht shumë i rëndë për mua. Po të jetë për mua unë nuk mendoj se mund ta përballoj dot diçka të këtillë."

---

[14]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 4/137.

Fill pas kësaj përgjigjeje pati zbritur edhe një tjetër ajet: "**Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut** (në adhurim)**, ka bërë gjynah të tmerrshëm.**" (Nisa, 4/48)

Prapëseprapë, Uahshiu, megjithëse e dëgjoi ajetin, i ktheu përgjigje Profetit tonë të nderuar: "O Muhamed! Çfarë mendimi ke ti për këtë çështje? Të falurit varet nga urtësia dhe vullneti i Allahut. Nuk e di; a më fal, apo nuk më fal Ai mua?" – kësisoj duke e pyetur të Dërguarin e Allahut. Edhe për këtë zbriti menjëherë një ajet tjetër, në të cilin thuhej: "**Thuaj: 'O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.'**" (Zumer, 39/53)

Uahshiu kishte marrë pikërisht përgjigjen që po kërkonte. U bë menjëherë mysliman. Madje disa njerëz thanë: "O i Dërguari i Allahut! Edhe ne kemi bërë të këqija njësoj si Uahshiu. A janë të vlefshme edhe për ne këto kushte?"

- "*Këto kushte janë të vlefshme për të gjithë myslimanët.*", – u përgjigj Krenaria e Gjithësisë.[15]

Kur Fatimja (r.a.) zuri të qajë nga vështirësitë që kishte gjatë kohës që Resulullahu ftonte njerëzit në besim

Ebu Thalebe el-Husheniu tregon: "I Dërguari i Allahut (alejhis'selam) sapo ishte kthyer nga lufta. Hyri drejt e në xhami dhe fali dy rekate namaz. Puna e parë që Krenaria e Gjithësisë bënte kur kthehej nga ndonjë betejë ishte falja e dy rekateve namaz, mandej shkonte menjëherë për tek e bija, Fatimja, për ta pyetur se si ishte dhe a kishte ndonjë gjë që e kishte mërzitur, pastaj shkonte pranë grave të tjera. Njëherë, kur u kthye, fali dy rekate namaz në xhami, pastaj, pa shkuar tek asnjë prej grave të Tij, shkoi menjëherë pranë vajzës së Tij, Fatimes. E bija e priti që te porta. Fatimja zuri ta puthte babanë nga fytyra dhe sytë dhe filloi të qante. I Dërguari i Allahut e pyeti të bijën:

[15]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 11/197 (11480).

- "*Pse po qan?*" Fatimja iu përgjigj:

- "O i Dërguari i Allahut! Shoh që të është zbehur lëkura e rrobat të qenkan vjetëruar!"

I Dërguari i Allahut tha:

- "*Mos qaj, bija ime! Allahu e ka dërguar babanë tënd me një mision të atillë, që ai do të arrijë në çdo familje, në çdo fushë, në çdo fshat, në çdo qytet dhe në çdo kontinent ku vjen nata. Prej kësaj kauze ata njerëz ose do të besojnë dhe do të lartësohen, ose do të mohojnë dhe do të bëjnë një jetë prej të poshtëruarish.*"[16]

Një prej sahabëve, Temim ed-Dariu na tregon: "Unë e kam parë vetë me sytë e mi, tek të afërmit, se si ata që besuan u lartësuan, dhe ata që nuk besuan u poshtëruan. Të gjithë ata që u bënë myslimanë, Zoti i shpërbleu me shumë të mira e mirësi, duke i bërë ata njerëz më të nderuar e më të pushtetshëm në sytë e njerëzve. Kurse ata që këmbëngulën në mohim, mbetën ashtu, të përbuzur e të përçmuar nga të gjithë, duke jetuar të detyruar që të paguajnë taksën e *xhizje*-s përgjatë gjithë jetës."[17]

2. ATA QË U BËNË MYSLIMANË ME THIRRJEN PËR NË ISLAM TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

Ebu Bekri (r.a.) bëhet mysliman

Aishja (radijallahu anha) tregon: Një ditë, babai doli nga shtëpia dhe, me ç'dukej, do të shkonte pranë Krenarisë së Gjithësisë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Zaten kishin qenë miq shumë të mirë edhe para se të zbritej feja e Islamit. E njihnin shumë mirë njëri-tjetrin. Ebu Bekri shkoi pranë mikut të tij të vjetër dhe i tha:

- "O Ebu'l-Kasem, u bë kohë që nuk merr më pjesë në mbledhjet e popullit, të gjithë e kanë ndjerë mungesën tënde. Ata të akuzojnë ty se ti po përpiqesh të shkelësh e të përdhosësh të shkuarën tënde." Resulullahu u përgjigj:

- "*Unë jam i Dërguari i Allahut, ndaj të ftoj edhe ty që të besosh tek Ai.*"

Një të mbaruar fjalët e të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekri (radijallahu

[16]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/506 (1448).
[17]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 4/103 (16998).

anhu) u bë menjëherë mysliman. Resulullahu u kënaq aq shumë që Ebu Bekri u bë mysliman, saqë kur u largua prej tij, përreth të gjithë maleve që rrethojnë Mekën vështirë të kishte njeri më të gëzuar sesa i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

Profeti i profetëve ka thënë:

- "*Kushdo që i kam bërë thirrje për në Islam, pa dyshim, që ka pasur një periudhë të lëkundjes dhe të pritjes, për t'u menduar njëherë. Por Ebu Bekri bën dallim nga të gjithë.*" Madje, i Dërguari i Allahut e pati vlerësuar si një kredi shumë të rëndësishme besimin e Ebu Bekrit pa u lëkundur, madje, një ditë, pati thënë:

- "*Nuk ka dyshim, se Allahu më ka dërguar mua si profet. Kur unë jua shpalla juve këtë, ju të gjithë më thatë: 'Po na gënjen!' Vetëm Ebu Bekri më tha: 'Nuk ka dyshim që ti thua të drejtën!', dhe më ka ndihmuar me jetën dhe pasurinë e tij, mandej u pati përsëritur dy herë: 'Tani, ju nuk do ta mërzitni mikun tim, apo jo, e të ma lini mua?'*" - duke iu drejtuar njëherë të gjithë të pranishmëve përreth tij, e më tej, duke iu drejtuar gjithë umetit të Tij.[18]

Ebu Bekri (radijallahu anhu) u çua menjëherë së andejmi dhe shkoi pranë Osmanit, Talha bin Ubejdullahut, Zubejr bin Auamit dhe Sad bin Ebi Uakasit (radijallahu anhum) dhe u foli edhe atyre për ato që kishte dëgjuar me veshët e tij. Edhe ata u bënë menjëherë myslimanë, duke e pranuar thirrjen për në Islam. Ditën tjetër, Ebu Bekri pati shkuar tek Osman bin Madhuni, Ebu Ubejde bin Xherrahu, Abdurrahman bin Aufi, Ebu Seleme bin Abdulesedi dhe Erkam bin Ebi'l-Erkami, që ishin gjithashtu ndër të parët që e kishin pranuar fenë islame, të cilët e pranuan po ashtu menjëherë ftesën e Ebu Bekrit të nderuar.[19]

Si u bë mysliman Omeri (r.a.)

Omeri (radijallahu anhu) u bë mysliman gjatë vitit të pestë a të gjastë të profetësisë, kur ai ishte ende njëzet e gjashtë vjeç. Ndërsa, lidhur me pranimin e Islamit nga ana e tij, ka shumë transmetime të ndryshme.

Skllavi i Omerit (radijallahu anhu), Eslemi tregon: "Omeri na pati

[18]. Ibn Hisham, *Sire,* 2/90.
[19]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/29.

pyetur:

- "A doni që t'ju tregoj se si jam bërë mysliman?"

- "Po!", – i thamë ne. Aty pati filluar të na tregonte:

- "Unë isha një ndër ata që ishin jashtëzakonisht të nxehur me Resulullahun. Një ditë, teksa ishim të ulur me parinë e kurejshëve, Ebu Xhehli na tha: 'O njerëz! Muhamedi po i shan të gjithë zotat tanë, madje na ka ofenduar duke thënë se mendja jonë është tejet e cekët dhe se të gjithë të parët tanë kanë shkuar në Xhehenem. Kushdo që e vret Muhamedin, prej meje do të marrë një shpërblim prej njëqind devesh të kuqe dhe të zeza, si edhe shumë para, me të cilat do të mund të bëjë një jetë madhështore.'"

Mandej, Omeri (radijallahu anhu) vijoi së na treguari:

- "Unë lidha menjëherë shpatën pas belit, mora pak ushqim me vete dhe dola nga shtëpia. Po shkoja të vrisja Profetin e Gjithësisë." Rrugës teksa ecte përballë i pati dalë kushëriri i tij, Nuajm bin Abdullahu, i cili gjithashtu ishte bërë mysliman, por që e fshihte ende këtë fakt. Ky njeri iu drejtua Omerit (radijallahu anhu) dhe e pyeti:

- "Për ku po shkon kështu, o biri i Hatabit?"

- "Po shkoj të vras atë njeri që ka prishur unitetin dhe bashkimin e Kurejshëve, që na quan se nuk kemi mend, që përdhos fenë e të parëve tanë dhe nuk ka lënë fjalë të keqe pa thënë për zotat tanë.", – iu përgjigj Omeri.

- "Ta dish mirë, o Omer! Ti kështu nuk bën tjetër, veçse mashtron veten. Ti pandeh se kur të vrasësh Muhamedin, fisi i Adij bin Ka'bit (fisi i të Dërguarit të Allahut) do të të lejojnë që të shëtitësh i lirë mbi tokë? Më lejo të të them diçka. Edhe familja jote dhe e kunatit tënd janë bërë myslimanë, duke të braktisur ty, edhe fenë tënde të trilluar.", – tha Nuajmi.

Aq iu desh Omerit (radijallahu anhu), dëgjoi këto fjalë të Nuajmit, nuk priti dot asnjë çast dhe e pyeti menjëherë:

- "E kush janë këta familjarë të mi?"

- "Kunati yt, djali i xhaxhait tënd, Said bin Zejd bin Omeri dhe motra jote, Fatime binti el-Hattabi."

Nuajmi e pati bërë gjithë këtë, që tregoi dy myslimanë të tjerë, për të shmangur si e si që Omeri (radijallahu anhu) të hiqte dorë nga qëllimi i tij për t'i bërë keq Krenarisë së Gjithësisë. Kur dëgjoi këto fjalë, Omeri frymën e mbajti drejt e në shtëpinë e motrës së tij. Nisi të trokiste në portën e tyre me vërtik. Në atë kohë, njëri prej sahabëve, që ishte i dashuruar pas të Dërguarit të Allahut, Habab bin Ereti (radijallahu anhu), po i mësonte motrës së Omerit (radijallahu anhu) suren "Taha". E motra, kur e pa Omerin, e dinte se ai mund t'u bënte keq, ndaj e fshehu menjëherë atë pjesë të Kur'anit që mbanin në duar. Kurse Hababi u fsheh në një cep të shtëpisë. Teksa po i afrohej shtëpisë, Omeri e pati dëgjuar se Hababi diç po u lexonte, ndaj, një të hyrë në shtëpi, pyetja e parë që bëri ishte:

- "Ç'ishin ato fjalë pa kuptim që këndonit, që i dëgjova teksa i afrohesha shtëpisë?"

- "Po bisedonim, ato mund t'i kesh dëgjuar, sepse ne nuk po këndonim asgjë.", – u përgjigjën ata.

Megjithatë, Omeri vijonte të këmbëngulte se kishte dëgjuar diçka krejt ndryshe.

- "Me ç'më kanë treguar, ju paskeni hyrë në fenë e Muhamedit.", – tha dhe u vërsul menjëherë mbi trupin e kunatit të tij, Saidit. Pavarësisht se e motra u përpoq të hynte mes tyre, për t'i ndarë, Omeri e pati rrahur atë, madje duke i lënë edhe plagë në trup. Pas kësaj, si e motra, ashtu edhe kunati, duke mbledhur një guxim të pashpjegueshëm brenda vetes, i thanë atij:

- "Po, myslimanë jemi bërë. Kemi besuar tek Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ja, kjo është e vërteta, ndaj tani mund të na bësh ç'ke për të na bërë!", – duke iu përgjigjur kësisoj në një mënyrë që donin t'i tregonin se ata nuk i trembeshin më atij.

Omeri (radijallahu anhu), pa njollat e gjakut mbi trupin e së motrës dhe thellë brenda vetes ndjeu pendesë, ndaj dhe u tërhoq.

- "Ma sill edhe mua, ta lexoj njëherë atë që po lexonit pak më parë! Ta shoh njëherë, çfarë ju thotë juve kështu ky Muhamedi!" Omeri ishte njeri që dinte të lexonte dhe të shkruante shumë mirë. Këto fjalë e trembën shumë motrën e tij, ndaj, e shqetësuar, ajo i tha atij:

- "Kemi frikë se ti do të na e prishësh atë që ishim duke lexuar."

- "Mos ki frikë.", – i tha Omeri, duke iu betuar se vetëm do ta lexonte dhe do t'ua kthente atë sërish.

E motra, kur e pa dëshirën e madhe që kishte Omeri për ta lexuar atë letër, duke shpresuar se mos bëhej edhe ai mysliman kur ta lexonte, ia dha, duke i thënë:

- "Vëlla i dashur, ti nuk mund ta prekësh atë, sepse tani ti je një prej idhujtarëve. Atë me dorë mund ta prekin vetëm ata që janë të pastër."

Aty, Omeri u çua dhe u la, mori gusul. E motra ia dha atë pjesë të Kur'anit në dorë. Omeri nisi ta lexonte. Kur mbaroi fillimin e sures "Taha", tha:

- "Ç'është kështu kjo fjalë, kaq e bukur dhe kaq e vyer!"

Kur pa se Omeri ishte zbutur ndjeshëm, Hababi doli nga ai vend ku po qëndronte i fshehur dhe i tha:

- "O Omer, të kesh besim tek unë, se unë kam shumë shpresë se lutja e të Dërguarit të Allahut për ty të pranohet, sepse dje, i Dërguari i Lartësuar iu lut Allahut duke iu përgjëruar me këto fjalë:

- "*O Zot! Lartësoje Islamin me Omer bin Hatabin ose Ebu'l-Hakem bin Hishamin.*"[20] Për Zotin, nuk e di, por kjo më ngjan diç si një përkim i bekuar me lutjen e djeshme!"

Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër, kur Hababi tha fjalët e përmendura më sipër, Omeri i pati kërkuar atij që ta çonte atë menjëherë për tek i Dërguari i Allahut, pasi donte edhe ai të bëhej mysliman. I Dërguari i Allahut, së bashku me një grup prej sahabëve të tij ishin duke qëndruar në një shtëpi në afërsi të kodrës së Safasë. Omeri shkoi drejt e te Krenaria e Gjithësisë (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Omeri kishte edhe shpatë në brez. Sahabët u trembën, kur e panë ashtu, të armatosur. Në atë kohë, atje gjendej edhe Hamzai (radijallahu anhu), i cili u tha:

- "Lëreni, le të vijë! Nëse ka ardhur me qëllim të mirë, atëherë ia japim atë që kërkon. Por, edhe nëse ka ardhur i nxitur nga qëllime të këqija, atëherë e vrasim me shpatën e vet." Kurse i Dërguari i Allahut

[20]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/80.

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha:

- "*Hapeni portën. Nëse Allahu do mbarësinë e Omerit, Ai mund ta shpjerë atë drejt udhëzimit.*"

Porta u hap. Dy sahabë e morën Omerin për krahësh dhe e prunë përballë Resulullahut.

- "Lëshojeni, lëreni të lirë.", – u tha i Dërguari i Allahut sahabëve të tij. Krenaria e Gjithësisë e priti Omerin në këmbë. E kapi me shpejtësi nga xhybeja e tij dhe i tha:

- "*O Omer! Pse ke ardhur! Nuk dua të shoh që Allahu të zbresë ajete përçmuese dhe poshtëruese edhe për ty.*"

- "O i Dërguari i Allahut! Kam ardhur për të dëshmuar e për të shpallur besimin tim. Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe, po ashtu, unë dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij." Veç kësaj, ai bërtiti:

- "Allahu Ekber". kur kuptuan se Omeri ishte bërë mysliman, sahabët që gjendeshin në atë shtëpi, zunë të thoshin të gjithë tekbirë. Zëri kumbonjës i asaj shtëpie u dëgjua deri edhe nëpër rrugicat e Mekës.[21]

Si u bë mysliman Osmani (r.a.)

Osmani (radijallahu anhu) na tregon: "Një ditë pata shkuar për vizitë te tezja ime, Abdulmuttalib binti Eruaja. Kur, ç'të shoh, brenda hyri i Dërguari i Allahut. Vazhdimisht nuk i ndaja dot sytë prej Tij. Atë ditë diç duhej t'i kishte ndodhur. U kthye nga unë dhe më pyeti:

- "*Pse më shikon ashtu?*"

- "Habitem kur shoh personalitetin tuaj, vendin që zini ju këtu mes nesh dhe ato që thuhen për ju?!", – iu përgjigj Osmani.

- "*La ilahe il'lallah.*", – tha Ai.

Të më besoni, por kjo fjalë e tij bëri të më rrëqethej i tërë trupi. Mandej më lexoi prej këtij ajeti: "**Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë? Në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar. Betohem për Zotin**

[21]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/41.

e qiellit dhe të Tokës, se kjo (që ju premtohet) **është e vërtetë, ashtu siç është të folurit tuaj.**" (Dharijat, 51/20-23). Kur mbaroi, u largua së andejmi. Unë e ndoqa nga pas, gjersa e arrita dhe u bëra mysliman.[22]

Si u bë mysliman Aliu (r.a.)

Familja e Ebu Talibit ishte një familje shumë e madhe dhe Ebu Talibi e kishte shumë të vështirë që të kujdesej për mbajtjen e të gjithë atyre njerëzve. Andaj, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e pati marrë Aliun (radijallahu anhu) në shtëpinë e tij, duke bërë që ai të ishte një fëmijë i shtëpisë së Tij deri në ditën kur i erdhi profetësia. Më vonë, një ditë, i Dërguari i Allahut dhe bashkëshortja e vyer e tij, nëna jonë, Hatixhja (radijallahu anha) po falnin namaz. Pikërisht në ato çaste, teksa ishin duke u falur, Aliu i nderuar hyri në shtëpi dhe i habitur i pyeti:

- "Çfarë po bëni kështu ju?" I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu përgjigj:

- "*Kjo është feja që ka zgjedhur Ai që është Zoti i botëve, për të cilën edhe ka dërguar profetë. Unë të ftoj edhe ty që t'i besosh Allahut, i cili është i Vetëm dhe nuk ka shok, që ta adhurosh atë dhe të heqësh dorë nga idhujt e Latit dhe Uzzas, duke i mohuar ata.*"

- "Kjo është diçka që nuk e kam dëgjuar kurrë më parë, dhe unë nuk mund të vendos me mendjen time për diçka të këtillë. Me lejo që të këshillohem njëherë me babanë." Profeti ynë, duke qenë se nuk i kishte zbritur ende asnjë urdhër që ai ta shpallte fenë e Allahut haptazi, nuk deshi që kjo çështje të shkonte deri tek Ebu Talibi, ndaj e porositi:

- "*O Ali! Edhe pse mund të të duhet pak kohë për t'u bërë mysliman, të mos e bisedosh me askënd këtë çështje!*"

Të gjithë natën e asaj dite Aliu e kaloi duke menduar për atë që kishte dëgjuar. Kështu, Allahu i mundësoi edhe atij udhëzimin për tek e drejta dhe e vërteta. Në mëngjes, me të gdhirë, ai shkoi pranë të Dërguarit të Allahut dhe e pyeti:

- "Çfarë ishte ajo që më pate këshilluar dje?"

---

[22]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 4/225.

- "*Do të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Ai është Një i Vetëm dhe që nuk ka shok në krijim dhe në adhurim. Do t'i mohosh idhujt e Latit dhe Udhas dhe do t'i qëndrosh larg çdo lloji të idhujtarisë.*", – iu përgjigj Profeti ynë.

Aliu (radijallahu anhu) ishte gati për një gjë të këtillë, ndaj edhe u bë menjëherë, në atë çast, mysliman. Por, i shqetësuar se çfarë do të mendonte i ati, për njëfarë kohe ai e fshehu besimin e tij.[23] Më vonë, Ebu Talibi i pati parë ata duke falur namaz, por nuk u pati thënë asgjë.

Si u bë mysliman Amr bin Abeseja

Tregon vetë Amr bin Abeseja: "Në kohën e injorancës, më ndodhte mjaft shpesh që t'i shikoja njerëzit që jetonin një jetë krejtësisht të ç'udhëzuar dhe besoja se prej atyre idhujve që u besonin njerëzit nuk kish se si të vinte asnjë e mirë. Kur dëgjova se në Mekë kishte dalë dikush, që fliste për disa lajme shumë të rëndësishme, i hipa menjëherë kafshës sime të rrugës dhe erdha në Mekë. Në atë kohë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk e kishte nisur ende shpalljen haptazi të fesë. Megjithatë, lajmi i profetësisë kishte filluar të përhapej e të shëtiste nga njëri vesh në tjetrin mes qytetarëve të Mekës. Andaj edhe mekasit e kishin rrethuar atë, për ta mbajtur nën kontroll, në mënyrë që të mund ta pengonin me çdo kusht, nëse ai do të vendoste të bënte ndonjë veprim haptas. Dhe unë, duke u treguar sa më i kujdesshëm që gjithçka të ndodhte në fshehtësi, shkova drejt e tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pa pyetur njeri dhe iu drejtova atij me këto fjalë:

- "Kush jeni ju?", – e pyeta.

- "*Unë jam Profeti i Allahut.*", – m'u përgjigj ai.

- "Çfarë do të thotë 'i Dërguar i Allahut'?"

- "*I Dërguari i Allahut do të thotë të jesh mëkëmbës i Tij, që vjen pranë njerëzve për të sjellë urdhëresat që ka Zoti ndaj njerëzve.*"

- "Domethënë, Ty të ka dërguar Zoti!?"

- "*Po, mua më ka dërguar Zoti.*", – m'u përgjigj i Dërguari i Allahut.

[23]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/24.

- "E çfarë na ke sjellë ti prej Zotit?"

- "*Allahu do të njihet si Një i Vetëm, nuk do t'i bëhet asnjë shok ose ortak në krijimin e gjithçkaje; idhujt që adhurojnë njerëzit do të thyhen dhe ne duhet të kujdesemi për më të mirën e të afërmve tanë dhe t'ua ruajmë atyre të drejtat që ata kanë, duke mos derdhur as edhe një pikë gjaku të vetme padrejtësisht dhe të gjithëve do t'u sigurohet që të mund të udhëtojnë të sigurt.*"

- "Po Ti na paske sjellë gjëra shumë të bukura! Unë jua shpall menjëherë këtu besimin tim. Unë të pranoj ty. Kush i ka pranuar deri më tani të gjitha këto urdhëresa që ti i ke sjellë prej Zotit për ne?"

- "*Ebu Bekri dhe skllavi i tij, Bilal Habeshiu.*"

- "Unë dua të jem një prej ndjekësve të tu."

- "*Sot, kushtet nuk janë shumë të vështira që ti të jesh një prej ndjekësve të mi këtu në Mekë, andaj më e mira është që tani të kthehesh pranë familjes sate dhe kur të shohësh se unë do të kem filluar që ta shpall haptazi fenë e Allahut dhe se e vërteta po fillon të dalë faqeza, atëherë eja.*"

Amri tregon: "Unë u bëra mysliman dhe u ktheva pranë familjes sime. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nisi ta shpallte haptazi të vërtetën. Mandej ai mërgoi për në Medinë. Merrja vazhdimisht lajme për të. Në fund, nga Medina erdhi një grup që e kishte nisur ai vetë. Në një mënyrë të tërthortë, i pyeta:

- "Ç'thonë ata mekasit që janë strehuar pranë jush?"

- "Në fund, populli i tij deshi që ta vriste atë, por ata nuk ia dolën dot. Allahu nuk lejoi që të ndodhte diçka e këtillë. Ndaj kemi ardhur edhe ne, se njerëzit po ngarendin për t'i shpallur atij besimin dhe mbështetjen.", – m'u përgjigjën ata mua.

Amr bin Abeseja, me t'i dëgjuar këto fjalë, u hodh mbi kafshën e tij dhe u nis me shpejtësi për në Medinë. Shkoi pranë Krenarisë së Gjithësisë dhe e pyeti:

- "O i Dërguari i Allahut! A më njohët mua?"

- "*Po!*", – m'u përgjigj i Dërguari i Allahut, - "*ti je ai njeri që pate ardhur të bëheshe ndjekësi im që kur se ne ishim ende në Mekë, apo jo?*"

Aty Amr bin Abeseja gati sa s'fluturoi nga gëzimi, duke thënë:

- "Po, o i Dërguari i Allahut! M'i mësoni, ju lutem, të gjitha ato gjëra që Zoti jua ka mësuar ju dhe që unë nuk i di."[24]

Halid bin Said bin el-Asi bëhet mysliman

Siç na e rrëfen e bija, Halid bin Saidi kishte parë një ëndërr dhe kish qenë kjo ëndërr që e pati çuar drejt besimit, e ai u qe bërë mysliman. Ja se si ishte ajo ëndërr që kishte parë ai: "Dukej sikur Mekën e kishte mbuluar një errësirë e plotë. Aq errësirë ishte, saqë njerëzit nuk arrinin të shihnin as atë që kishin në duar. Kur, një çast, nga burimi i Zemzemit drejt qiellit u lartësua një dritë, që e ndriçoi të gjithë hapësirën përreth Qabes. Mandej, ai nur e kaploi mbarë Mekën. Ajo dritë u drejtua kah hurmishtet e Jethribit (Medinës), duke e mbushur edhe qiellin e saj plot dritë. Një dritë aq e fortë, saqë syri mund të dallonte çdo kokërr hurme të varur në pemë."

Halid bin Saidi, kur u zgjua, ia pati treguar ëndrrën e tij edhe të vëllait, Amr bin Saidit. Amri ishte njeri i ditur dhe largpamës.

- "Vëllai i dashur! Diçka shumë e madhe e pret fisin e Abdulmutalibit. Nuk e sheh, kjo dritë që ti po më tregon mua ka dalë pikërisht nga ai burim që e kanë hapur etërit e tyre me aq mund.", – iu përgjigj i vëllai.

Halidi na e thotë vetë:

- "Ishte pikërisht kjo ëndërr që më udhëzoi mua, duke më çuar drejt pranimit të fesë islame."

Kurse, kur nëna e Halidit shkoi për t'ia treguar të Dërguarit të Allahut këtë ëndërr që kishte parë i biri, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati thënë:

- "*O Halid! Pasha Zotin, ajo dritë jam unë dhe unë jam i Dërguari i Allahut.*" Dhe, prej kësaj thirrjeje të Resulullahut, i biri e pranoi menjëherë Islamin, duke u bërë kështu një ndër myslimanët e parë.[25]

Ëndrra që ka parë Halid bin Saidi është pak më ndryshe sipas një transmetimi tjetër: Në ëndërr Halid bin Saidi qëndronte ndanë një zjarri që vetëm Allahu e dinte, babai i tij përpiqej ta shtynte drejt atij

[24]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 2/500.
[25]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/277 (5082).

zjarri, ndërsa ai shihte se ai vetë i kërkonte ndihmë të Dërguarit të Allahut, që ta mbronte e të mos e linte që të binte në atë zjarr përvëlues. Nga frika i del gjumi dhe fjalët e para që thotë janë: "Betohem për Zotin, se kjo ëndërr është një ëndërr e vërtetë." Takohet me Ebu Bekrin (radijallahu anhu) dhe ia tregon edhe atij ëndrrën që ka parë. Ebu Bekri i thotë:

- "Allahu e bëftë hajr. Ai është i Dërguari i Allahut. Nxito të bëhesh edhe ti një prej ndjekësve të tij. Ke për të parë, se edhe ti do të jesh shumë shpejt një prej njerëzve që kanë besuar tek ai, duke u bërë menjëherë mysliman. Ai që përpiqet të të ruajë prej zjarrit në ëndërr nuk është askush tjetër, pos Islamit. Kurse babai yt nuk do të besojë, dhe do të hyjë në zjarr." Pas këtyre fjalëve, Halid bin Saidi u takua me Krenarinë e Gjithësisë në lagjen e quajtur Exhjad, dhe e pati pyetur:

- "O Muhamed! Për ku na fton ti ne?

- "*Unë ju ftoj ju për tek Allahu, që është Një i Vetëm dhe që nuk ka shok tjetër si Vetja, dhe që të pranoni se Muhamedi në fillim është robi, pastaj i Dërguari, i Allahut në Tokë. Të ftoj që t'i qëndrosh sa më larg adhurimit të atyre idhujve të bërë vetë prej gurit, të cilët as që janë në dijeni se ka njerëz që i adhurojnë, që nuk mund të sjellin as dobi e as dëm për njeriun, pasi as nuk shohin, as nuk dëgjojnë.*"

Pas këtyre fjalëve, Halid bin Saidi nuk vonoi dhe tha:

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Dhe, dëshmoj se Ti je i Dërguari i Allahut." Këto fjalë e gëzuan pa masë Profetin tonë (alejhis'salatu ue sel'lem).

Kur e mori vesh i ati, se Halidi ishte bërë mysliman, Halidi filloi të mos shfaqej më shumë para babait të tij, duke lëvizur më tepër nëpër rrethinat përreth Mekës. Dhe, kur sahabët emigruan për herë të dytë në drejtim të Etiopisë, ndër të parët që emigruan ishte edhe ai.

Babai i Halidit, Said bin el-As bin Umejeja, pati ngarkuar një nga djemtë e tij të tjerë, që nuk ishte mysliman dhe skllavin e tij Rafiun, që ta gjenin dhe t'ia sillnin në shtëpi të birin e bërë mysliman. Pas njëfarë kohe ata e gjetën Halidin dhe e prunë para të atit.

- "Megjithëse e pe që Muhamedi vepron kundër popullit të tij, duke i turpëruar atyre zotat dhe duke i poshtëruar ata të gjithë në sytë

e njerëzve, ti prapëseprapë iu binde atij, kështu hë?", – i tha babai atij, i nxehur dhe duke i bërtitur e duke iu kanosur. E goditi me një copë druri që mbante në dorë dhe nga koka nisi t'i rridhte gjak. Megjithatë, Halidi nuk hoqi dorë nga e tija dhe i tha babait:

- "Ai thotë të vërtetën, ndaj po, unë i bindem atij."

Kjo ia shtoi edhe më shumë nevrikosjen të atit, duke e bërë që ai t'i thoshte të birit:

- "I poshtër! Shko ku të duash! Unë nuk të jap më të hash."

- "Mos më jep, edhe po nuk më dhe ti mua, është Allahu që do të më ushqejë!"

Saidi e përzuri jashtë Halidin dhe i paralajmëroi të gjithë djemtë e tjerë:

- "Me të nuk do të flasë më askush. Nëse marr vesh se ndonjëri prej jush i afrohet dhe i flet, ta dini se atë që i bëra atij do t'ua bëj edhe atyre që do të flasin me të."

Halidi shkoi drejt e tek i Dërguari i Allahut. Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e mori pranë dhe që nga ajo ditë nuk e ndau më nga vetja.[26]

Babanë e Halidit (radijallahu anhu), Said ibnu'l-As bin el-Umejjen dikur e zuri një sëmundje dhe ai pati thënë:

- "Nëse Zoti do të më ngrejë një ditë nga shtrati i kësaj sëmundjeje, do të bëj që zoti i të birit të Ebu Kebshes – duke pasur parasysh Resulullahun me këto fjalë – të mos adhurohet më kurrë në Mekë." Ndërsa i biri, Halidi, e mallkoi duke thënë:

- "O Zot! Mos i fal asnjë të mirë këtij njeriu!" Në të vërtetë as ai nuk arriti që të shpëtonte dot më prej sëmundjes që e pati kapur, derisa vdiq.[27]

Dimadi (r.a.) bëhet mysliman

Dimadi i përkiste fisit të Edhdishenues. Ai merrej me magji. Pati ardhur në Mekë për të vizituar Qaben. Kur dëgjoi që shumë njerëz

[26]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/32.
[27]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 4/95.

të pamend në radhët e mekasve thoshin për Krenarinë e Gjithësisë "është i çmendur", nuk ngurroi, por i pyeti menjëherë:

- "Ku është ai njeri? Ndoshta Zoti e shpëton atë me ndonjë shërim që mund t'i vijë nga duart e mia?"

Ja se si e tregon ai vetë se çfarë ndodhi atë ditë: "Isha ulur në një vend me Ebu Xhehlin, Utbe bin Rebian dhe Umeje bin Halefin. Ebu Xhehli tha:

- "Ja ku është ai njeri që na e ka prishur bashkimin, duke na përçarë, që e ka tepruar dhe po na bën gazin e botës, duke na e quajtur të shthurur të shkuarën e lavdishme e që nuk ka lënë asgjë pa thënë për zotat tanë."

- "Nuk ka më asnjë dyshim, ky njeri është çmendur!", – tha Umeje bin Halefi.

Më bënë shumë përshtypje këto fjalë të Umejes.

Të pranishmëve u thashë se unë "mund t'i fryja e ta shëroja" dhe menjëherë u largova së andejmi. Fillova të kërkoja për të, por më kot, sepse atë ditë nuk e gjeta dot. Ditën tjetër shkova pranë vendit të Ibrahimit në Qabe dhe e gjeta duke u falur, në pozicion ulur. Prita pak, sa të mbaronte së faluri. Kur mbaroi faljen iu afrova pranë dhe i fola:

- "O nipi i Abdulmutalibit!"

- "*Më thuaj, si mund të të ndihmoj?*", – më tha.

- "Fryma ime është e mirë dhe unë mund të të bëj magji duke të fryrë. Po të duash, mund të të shëroj duke përdorur mënyrat e mia të shërimit. Hë, si thua, mos lejo që gjendja në të cilën je të përkeqësohet! Unë kam shëruar edhe shumë të tjerë, të cilët kanë qenë shumë herë më keq se ty! I kam dëgjuar të gjitha se ç'thotë populli yt për ty, e të gjitha ishin gjëra jo shumë të hijshme; disa thonë 'e ka tepruar, e na ka poshtëruar në sytë e njerëzve', disa të tjerë thonë 'na ka përçarë', disa të tjerë thonë 'ai na e fajëson të shkuarën me mëkatin e shthurjes', e disa të tjerë thonë 'ai po na i përbuz të gjithë zotat që ne besojmë'. Kur i pyeta ata se përse e bëje këtë gjë, ata më thanë se 'ishe çmendur'." Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili i kishte dëgjuar të gjitha fjalët që thoshte ky njeri, i tha:

- "*Lëvdimi i takon vetëm Allahut. Unë e lëvdoj Allahun dhe përherë vetëm prej Tij kërkoj ndihmë. Unë tek Ai kam besuar dhe tek Ai jam dorëzuar i tëri me mish e me shpirt. Atë që e udhëzon Ai, askush nuk mund ta devijojë nga rruga e drejtë e së vërtetës. Dhe këdo që Ai e nxjerr nga rruga e duhur, atë nuk ka më fuqi që ta udhëzojë kah e drejta. Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut. Ai është Një. Nuk ka as shok, as ortak, në krijimin e gjithçkaje.*"

- "Të betohem, se deri më sot nuk kam dëgjuar ndonjëherë fjalë më të bukura se këto që më the ti tani!", – i thashë të Dërguarit të Allahut, duke i kërkuar nëse mund t'i përsëritë edhe njëherë. Ai m'i përsëriti edhe njëherë.

- "Për ku na fton ti ne?", – e pyeta unë.

Resulullahu u përgjigj:

- "*Unë ju ftoj ju që ju t'i besoni Allahut, se Ai është Një dhe i Vetëm dhe që nuk ka asnjë shok a të ngjashëm me Veten; që t'i nxirrni idhujt nga jeta juaj dhe të dëshmoni se unë jam i Dërguari i Allahut.*"

- "Po nëse unë i pranoj të gjitha këto, çfarë më premtohet mua?", – vijova ta pyesja.

- "*Parajsa e përjetshme!*", – m'u përgjigj.

Nuk kisha se ç't'i thosha veçse:

- "Nuk kam asnjë dyshim dhe me sinqeritet e pranoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut. Ai është Një, i Vetëm. Është i Pashoq. Po i nxjerr nga jeta ime të gjithë idhujt që kam dashur gjer më sot, duke u larguar njëherë e mirë syresh. E po ashtu dëshmoj se ti je robi dhe i Dërguari i Tij."

Dimadi, i cili po i bindej e po i jepte besën të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në emër të vet dhe të të gjithë fisit të tij, qëndroi pranë Resulullahut edhe për njëfarë kohe. Pasi mësoi një numër të konsiderueshëm suresh nga Kur'ani, u nis për t'u kthyer pranë fisit të tij.

Nga ajo çfarë na është transmetuar kuptohet se të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pati pëlqyer shumë sinqeriteti i fjalëve të Dimadit, ndaj edhe ishte i bindur se Dimadi kishte tashmë një besim të shëndoshë, sepse grupi i armatosur që kishte ngarkuar

me detyrë i Dërguari i Allahut pati shkuar edhe pranë fisit të Dimadit. Komandanti i këtij grupi i pati pyetur ushtarët:

- "A morët dot gjë prej atij fisi?"

- "Po!", – qe përgjigjur njëri nga ushtarët, – "morëm një tullumb me ujë."

- "Atëherë, të ktheheni e t'ua jepni mbrapsht, sepse ai është fisi i Dimadit.", – pati thënë komandanti dhe ushtarët e patën kthyer mbrapsht atë çfarë kishin marrë prej njerëzve të Dimadit.[28]

Husajni, babai i Imranit, bëhet mysliman

Kurejshët e respektonin shumë Husajnin, ndaj vendosën që të shkonin pranë tij e të këshilloheshin me të. Kur u takuan, i thanë:

- "Të kishe folur njëherë, edhe në emrin tonë, me atë njeri. I merr nëpër gojë të gjithë zotat tanë dhe nuk lë asnjë rast pa i mallkuar." Dhe, kësisoj, e morën Husajnin dhe e sollën pranë të Dërguarit të Allahut. Ishin të shumtë në numër. I Dërguari i Allahut, kur i pa, tha:

- "*Hapuni vend më të mëdhenjve!*" Husajni, që po përpiqej të kuptonte sa më shumë nga çdo fjalë e nga çdo sjellje, tha:

- "Thonë se ti i mallkon zotat tanë dhe nuk i heq asnjëherë nga goja, sa herë që të jepet mundësia për t'i përbuzur. Mirëpo, babai yt ishte njeri i mençur dhe ishte një njeri që i mbronte fenë dhe traditat tona. Si qëndron puna me këto lajme që më kanë ardhur në vesh?"

- "*O Husajn! Si babai im, ashtu edhe babai yt janë në zjarr tani. Po ti, sa zotave u beson?*", – tha i Dërguari i Allahut.

- "Unë besoj te tetë zota; shtatë prej tyre janë në tokë, ndërsa njëri në qiell.", – u përgjigj Husajni.

Kur i Dërguari i Allahut e pyeti:

- "*Po kur përballesh me ndonjë rrezik, cilit prej tyre i përgjërohesh, atyre që janë në tokë, apo atij që është qiell?*" Husajni iu përgjigj:

- "Atij që është në qiell i lutem."

- "*Po kur të dëmtohet pasuria, cilit prej tyre i përgjërohesh? Atyre që janë në*

[28]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/210; Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/36.

tokë, apo atij që është në qiell?"

- "Atij që është në qiell i përgjërohem!"

- "*Po kur Ai që t'i dëgjon lutjet dhe të jep gjithë ç'të nevojitet, është Një, atëherë pse i bën Atij ortak në realizimin e nevojave të tua. Kujton se duke i falënderuar dhe lëvduar të gjithë e bën Atë të jetë prapëseprapë i kënaqur me ty? Apo, mos vallë ke frikë se mos ndonjëra prej tyre të vë në vështirësi në punët e tua?*"

- "Asnjë nga këto.", – u përgjigj Husajni.

Deri në atë çast, Husajni nuk ishte takuar me asnjë njeri si Resulullahu. Këtë e kishte kuptuar më së miri thellë brenda vetes. Mandej fjalën e vijoi Krenaria e Gjithësisë, duke i thënë atij:

- "*Bëhu mysliman, që të gjesh shpëtim.*"

- "Po kam kushërinjtë dhe fisin, po atyre çfarë t'u them?", – tha Husajni.

- "*O Zoti im! Ma dhuro mua udhëzimin, që të mund ta gjej rrugën e drejtë dhe falmë me shumicë prej dijes dobiprurëse.*", – e mësoi Resulullahu që të lutej.

Pasi e bëri këtë dua, Husajni priti edhe ca kohë, mandej u bë mysliman. Kur u ngrit në këmbë, i biri, Imrani, u ngrit dhe e puthi babanë në krye, në duar dhe në këmbë. Krenaria e Njerëzimit, kur e pa këtë sjellje, filloi të qante dhe nga ajo gojë e bekuar filluan të dilnin këto fjalë:

- "*Qava nga sjellja e Imranit. Kur babai, Husajni, hyri këtu si mohues ai as që u çua në këmbë, as nuk pa asnjëherë kah i ati. Mirëpo, një të pranuar Islamin, ai nuk ngurroi për as edhe një çast të vetëm që të tregonte respektin e merituar, duke e kryer siç duhej detyrën e të qenët djalë. Ishte ajo delikatesë e veçantë që më përloti.*"

Kur erdhi koha që Husajni do të ngrihej, për t'u larguar që aty, Resulullahu u drejtua nga shokët e Tij dhe u tha:

- "*Ngrihuni dhe përcilleni atë deri në shtëpinë e tij.*"

Teksa po dilte nga dera, kurejshët e panë qëndrimin e Husajnit dhe e kuptuan se çfarë kishte ndodhur, ndaj thanë:

- "E braktisi edhe Husajni fenë e të parëve të tij." - dhe u larguan

të shpërndarë së andejmi pa i thënë asnjë fjalë.[29]

Kur bëhet mysliman një prej fisit të el-Huxhejmëve

Pranë të Dërguarit të Allahut erdhi një nga fisi i el-Huxhejmëve, i cili e pyeti:

- "Ti je i Dërguari i Allahut?"

- "*Po!*", – iu përgjigj Resulullahu.

- "Po çfarë është ajo ku po i fton ti njerëzit?", – vijoi ai me pyetjet e tij.

- "*I ftoj njerëzit që t'i besojnë Allahut, i Cili është Një i Vetëm, që është i Shenjtë dhe i Gjithëpushtetshëm. Ai është një Zot i atillë që, nëse ti dëmtohesh ose të kaplon ndonjë vështirësi dhe ti kërkon ndihmë, atëherë Ai të shpëton ty nga dëmi, duke ta hequr vështirësinë që të bren në shpirt. Nëse përballesh me ndonjë thatësirë, varfëri, apo mungesë begatie, kur ti i lutesh Atij, thatësira zhduket, varfëria shpërbëhet dhe begatia e mbulon gjithë mungesën e vet. Sikur në mes të shkretëtirës së paanë të humbasësh rrugën, kur ti të prekësh në dorezën e portës së mëshirës së Tij me lutje, sheh se si do të gjesh menjëherë rrugën.*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

Ky huxhejmas, të cilit nuk i është përcaktuar emri, u bë menjëherë mysliman dhe tha:

- "O i Dërguari i Allahut! Më jep një këshillë të mirë."

- "*Mos shaj askënd dhe asgjë.*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Pas asaj fjale, unë nuk shava më asgjë, frymor a jofrymor; askënd, në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme."[30]

Muauije bin Hajde bëhet mysliman

Muauije bin Hajde erdhi pranë Resulullahut. Ai ishte betuar shumë herë se nuk do të shkonte kurrë pranë Krenarisë së Gjithësisë, cilatdo të ishin kushtet, dhe se nuk do ta pranonte kurrë fenë me të cilën Ai pretendonte se ishte zbritur. Megjithatë, nuk mund ta mohonte se ishte i magjepsur pas Tij. Ishte pikërisht kjo magjepsje që e kishte

[29]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 1/337.
[30]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 8/138 (13003).

prurë deri afër të Dërguarit të Allahut, për t'i thënë:

- "Ti po na flet për diçka të qenësishme, mirëpo unë nuk di asgjë tjetër, pos asaj që më ka mësuar Zoti." Kërkonte ndonjë hapësirë të lirë, ndonjë portë të hapur. Shkoi dhe i tha të Dërguarit të Allahut:

- "Të lutem, për hir të Zotit, me çfarë të ka dërguar Zoti ty te ne?"

- "*Me fenë e Islamit.*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Çfarë është kjo fe e Islamit?"

- "*Ajo do të thotë që të thuash 'unë e ktheva fytyrën kah Zoti dhe e braktisa çdo gjë tjetër veç Tij'. Do të falësh namazin ashtu siç duhet, pa kurrfarë të mete dhe do të japësh zekatin. Po ashtu, duhet ta dish shumë mirë, se gjaku i myslimanëve është haram (i ndaluar) për njëri-tjetrin. Asnjë mysliman nuk vret dot padrejtësisht një mysliman tjetër. Myslimani është vëlla i myslimanit dhe ata i vijnë gjithmonë në ndihmë njëri-tjetrit. Allahu nuk e pranon veprën e një myslimani që bie në politeizëm e idhujtari pasi është bërë mysliman, derisa ai të ndahet e të largohet prej idhujtarëve. E si mund të më njihet mua kjo përgjegjësi për ta shpëtuar prej zjarrit atë njeri që gjendet në këtë gjendje? Ta dini mirë, se Zoti im do të më thërrasë edhe mua, për të më pyetur: 'A ua tregove robërve të mi të drejtën?' Dhe unë do t'i përgjigjem: 'Pa dyshim, ua shpalla.' Këtë duhet ta ngulitni njëherë e mirë në mendje. Ata që janë këtu dhe i dëgjojnë këto fjalë, t'ua transmetojnë edhe atyre që nuk janë të pranishëm! T'ua vini veshin këtyre fjalëve dhe të më dëgjoni mirë. Në Ditën e Gjykimit, kur të vini atje, në praninë e Zotit, atje nuk do t'ju lejojnë të flisni. Ato gjëra që ju ngurroni t'i pranoni, do të jenë organet tuaja që do t'ju nxjerrin zbuluar, duke treguar të vërtetën ashtu siç është.*"

- "Kjo është përmbajtja e fesë sonë, o i Dërguari i Allahut?", – e pyeti Muauije bin Hajde të Dërguarin e Allahut, i cili iu përgjigj me fjalët:

- "*Kjo është feja jonë. Nëse i kryen siç duhet të gjitha ato që të thashë, atëherë kjo do të jetë e mjaftueshme.*"[31]

Adij bin Hatimi bëhet mysliman

Kur lajmi se Krenaria e Gjithësisë ishte një profet që u përhap gjithandej, ai mbërriti edhe tek Adij bin Hatimi, mirëpo atij nuk i pëlqyen fare ato fjalë që dëgjoi. Madje, një t'i dëgjuar këto fjalë, u

[31]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 1/323.

ngrit, nga vendi ku jetonte dhe shkoi në lagjen e bizantinëve. Madje, nuk u mjaftua vetëm me kaq, por vendosi që të shkonte edhe te vetë mbreti bizantin. Mirëpo, edhe aty qe bezdisur pa masë. E ema e kishte këshilluar edhe më parë, që të shkonte njëherë te Resulullahu.

Ngjarja, në një transmetim, rrëfehet kështu:

Kur Adij bin Hatimi gjendej në Mekë, në vendin e quajtur Akreb, kalorësit e Resulullahut kishin ardhur dhe kishin marrë hallën e tij dhe shumë të tjerë, për t'i çuar tek ai. Halla e tij i pati thënë të Dërguarit të Allahut:

- "O i Dërguari i Allahut! Bashkë me mua ishte edhe një shërbëtor, mirëpo ai mbeti shumë prapa. Unë jam një grua e moshuar dhe nuk kam askënd që të më ndihmojë. Sikur të më bësh një të mirë, që Allahu të të ndihmojë edhe ty."

- "*Kush ishte ndihmësi juaj?*", – e pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Adij bin Hatimi.", – iu përgjigj ajo.

Resulullahu e dëgjoi emrin dhe shtoi:

- "*Kush, ai burri që kërkon të na shmanget, Allahut dhe pastaj mua?*"

- "Ndihmësi im tani nuk është këtu, ndaj të lutem që të më ndihmosh ti.", – iu përgjërua edhe njëherë gruaja.

Kur i dëgjoi të gjitha këto, Adij bin Hatimi i bëri një të mirë hallës së tij.

Teksa ajo grua po merrte ndihmën e kërkuar, me shumë gjasa ishte Aliu (radijallahu anhu), që i tha:

- "Kërkoji Resulullahut të të japë edhe një kafshë rruge!"

Ashtu bëri, kërkoi edhe një kafshë dhe i Dërguari i Allahut ia dha.

Gruaja po largohej shumë e gëzuar së andejmi. Kur u kthye tek i nipi, ajo i tha atij:

- "Ti bëre diçka, që babai yt nuk do ta kishte bërë kurrë. Me dëshirë ose pa dëshirë, të lutem, shko njëherë tek ai njeri."

Adij bin Hatimi thoshte me vete:

- "E ç'do të më ndodhë nëse shkoj tek ai njeri. Edhe sikur të jetë gënjeshtar, prapë ai nuk ka se ç'të keqe të më bëjë. Nëse thotë të

vërtetën, atëherë unë do të kem mësuar se si qëndron e vërteta." U kthye pas dhe u nis për te Resulullahu. I Dërguari i Allahut kishte shkuar në faltore dhe po qëndronte ashtu, i ulur. Ata që gjendeshin aty i thanë se kishte ardhur Adij bin Hatimi. Vazhdimin e ndodhisë e tregon vetë Adij bin Hatimi:

- "Pata shkuar drejt e tek ai, pa kërkuar as mbrojtjen e ndokujt dhe pa pasur kurrfarë reference nga ndonjë tjetër. Kur më çuan pranë tij, ai më kapi për dore. Krenaria e Gjithësisë e kishte thënë edhe më parë, se '*i ishte lutur shumë herë Allahut, duke iu përgjëruar me shumë dëshirë, që një ditë ta vinte dorën mbi dorën time.*' Qëndroi për njëfarë kohe me mua. Ndërkohë, te Resulullahu erdhi një grua me një djalë të vogël, të cilët i thanë: "Ne duam diçka prej Teje." Resulullahu qëndroi bashkë me ta, në këmbë, derisa ua përmbushi nevojën që kishin. Mandej, më kapi për dore dhe më çoi në shtëpinë e tij. Ajo ishte hera e parë që unë pata mundësinë të ulesha përballë Krenarisë së Gjithësisë."

Gruaja dhe fëmijët qëndronin të ulur aq pranë me Profetin tonë, saqë Adij bin Hatimi e pati kuptuar menjëherë, se ai nuk ishte si sundimtarët e Iranit dhe Bizantit. Sikur të ishte duke lexuar enkas për të, i Dërguari i Allahut recitoi tri herë:

- "*O Adij! Bëhu mysliman dhe shpëto!*"

- "Unë e kam fenë time.", – u përgjigj Adij bin Hatimi.

- "*Unë e njoh më mirë se ti fenë tënde.*", – i tha i Dërguari i Allahut.

- "Si, ti e njeh fenë time më mirë se unë?", – e pyeti Adiji Resulullahun i habitur.

- "*Po! Ti, a nuk i përket fesë së Rekuthijes* [emërtimi i një feje që është një përzierje e fesë së krishterë me mandeizmin]*? A nuk i ha ti një të katërtat e gjithë plaçkës dhe pasurisë që siguron fisi juaj?*"

Adiji i pohoi edhe njëherë të gjitha këto që po i thoshte i Dërguari i Allahut.

- "*Në fakt, kjo nuk është e lejuar as në fenë që ti i përket.*", – vijoi fjalën Krenaria e Gjithësisë.

Adij bin Hatimi nuk kundërshtoi asnjë fjalë nga sa u thanë. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) vijoi fjalën e tij:

- "*Unë e di shumë mirë edhe se çfarë të pengon që të pranosh Islamin. Ti nuk beson, sepse ata që më kanë besuar mua janë kryesisht nga njerëz të dobët në radhët e shoqërisë, të cilët arabët i përçmojnë se janë të varfër, ndaj edhe i lënë mënjanë. A e di qytetin e Hires ti?*"

- "Jo!, – u përgjigj Adiji, – nuk e kam parë kurrë atë vend. Por kam dëgjuar të flitet për të."

- "*Të betohem për Allahun, sepse Fuqia e Tij e ka në dorë jetën time, një ditë Ai ka për ta plotësuar këtë fe. Madje, do të vijë një ditë, që një grua e vetme do të hyjë në një shportë rruge mbi shpinën e devesë dhe do të mund të udhëtojë e sigurt nga Hireja* [një qytet i vogël në afërsi të Kufes] *në Mekë, do të vizitojë Qaben. Do të vijë një ditë që do të ngadhënjehet edhe mbi thesaret e Hurmuzit, mbretit të Iranit.*"

- "Si? Hurmuzi, mbreti i Iranit?", – pyeti Adij bin Hatimi.

- "*Madje edhe shumë më shumë, të ardhurat do të shtohen aq shumë, saqë të gjithë do të jenë të ngopur dhe askujt nuk do t'i shkojë më mendja e nuk do të denjojë për ndonjë gjë tjetër që nuk e ka.*"

Erdhi një ditë, që këto lajme që Resulullahu kishte dhënë për të ardhmen u realizuan të gjitha një e nga një. Madje ato i pa edhe Adij bin Hatimi me sytë e tij.[32]

Adij bin Hatimi u bë menjëherë mysliman, që aty. Fytyra e Krenarisë së Gjithësisë shkëlqente nga gëzimi. Njerëzit pranë tij i kërkuan disa gjëra dhe ai pasi lëvdoi dhe falënderoi thellësisht Allahun, tha këto fjalë:

- "*O njerëz! Çdo e mirë që do të bëni ka për të qenë pasuria juaj. Njeriu, sado pak, apo shumë, mirësi t'i falë Allahu, kur ai të vijë dita e të shkojë pranë Krijuesit të vet me këto mirësi, Allahu ka për t'i thënë: 'A nuk të dhashë unë ty shqisën e të shikuarit, të të dëgjuarit? A nuk të dhashë unë ty pasuri dhe fëmijë? Tani më thuaj ti, çfarë dërgove për ahiretin që sa ishe në jetë mbi Tokë?' Aty, nëse ai njeri nuk ka dërguar asgjë, do të shohë njëherë pas, njëherë para, majtas, pastaj djathtas, mirëpo nuk do të shohë dot asgjë. Në atë çast nuk do të ketë asnjë rrugëzgjidhje e shpëtim tjetër pos mëshirës së Allahut. Ruajeni veten prej zjarrit, qoftë edhe me një gjysmë hurme të vetme. Nëse nuk e keni as këtë, atëherë thoni të paktën një fjalë të butë e të ëmbël. T'ju them*

[32]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/66.

të vërtetën, unë nuk kam frikë se mos mbeteni të varfër. Nuk ka dyshim se Allahu do t'ju ndihmojë me shumë të mira e ndihmën e Tij, duke ju falur ngadhënjime të njëpasnjëshme. Madje edhe ajo grua e ulur mbi samarin e devesë, do të udhëtojë e vetme nga qyteti i Hiresë, deri në Medinë, e askush nuk do t'i bëjë keq."[33]

Dhulxheusheni bëhet mysliman

Dhulxheusheni mbërriti te Resulullahu pas betejës së Bedrit. Me vete kishte edhe një mëz të vogël. Kur u afrua, i tha të Dërguarit të Allahut:

- "Këtë mëz e kam prurë për ju. Ta keni që të vogël e ta rritni për veten."

- "*Unë nuk kam nevojë për të*, – iu përgjigj i Dërguari i Allahut, – *por, nëse dëshiron, mund ta shkëmbejmë me ndonjë prej mburojave që i kemi marrë si plaçkë lufte në Bedër.*"

Dhulxheusheni e dëgjoi dhe i tha:

- "Sot nuk kam dëshirë që të ndërroj një kalë të fisëm me një mburojë të përftuar si plaçkë lufte."

- "*Po mirë, por unë sot nuk kam nevojë për mëzin që më ke sjellë ti. Shiko, Dhulxheushen, lëre këtë çështjen e kalit dhe shih se ç'dua të të them: Pse nuk e pranon Islamin, a nuk do që ti të jesh prej të parëve të kësaj çështjeje?*"

- "Jo!", – u përgjigj Dhulxheusheni.

- "*Po pse kështu?*", – e pyeti sërish Resulullahu.

- "Sepse sot po shoh që i gjithë populli po këmbëngul për të të ndjekur e dëmtuar. Unë e di, që populli yt të ka përzënë, të përgënjeshtrojnë në çdo rast dhe se kanë filluar edhe të luftojnë me ty."

- "*Po mirë, ty nuk të ka ardhur lajmi se si ata ranë të gjithë në Bedër, se si u poshtëruan?*"

- "Po, e mora vesh.", – u përgjigj Dhulxheusheni.

Kur dëgjoi këto fjalë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha:

---

[33]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 17/99.

- "*Prit, të t'i tregojmë një e nga një se çfarë ndodhi atë ditë.*"

- "Jo Bedrin, por kur të kesh ngadhënjyer mbi Qaben dhe të vendosesh atje përfundimisht, atëherë do t'i pranoj ato që më thua.", – u përgjigj Dhulxheusheni.

- "*Mirë atëherë, po të kesh jetë gjer atëherë edhe atë do ta shohësh.*"

Pas kësaj bisede që kaloi mes tyre Resulullahu (alejhis'selam) iu drejtua Bilalit nga Abisinia dhe e urdhëroi:

- "*Merre torbën e tij dhe mbusheni me hurma të Medinës, që t'i ketë për rrugës.*" Kur Dhulxheusheni u largua, Krenaria e Gjithësisë iu drejtua atyre që ishin të pranishëm, duke u thënë:

- "*Ta dini, ky burrë është një prej heronjve më të mbarë të Beni Amirit.*"

Dhulxheusheni nuk u bë mysliman deri në ngadhënjimin mbi Mekën. Kur Profeti i profetëve u kthye në Mekë si ngadhënjimtar, Dhulxheusheni tha:

- "Aman, o Zot! Si nuk u bëra mysliman që atë ditë kur Resulullahu më tha, '*Eja, bëhu mysliman!*' Tani mund t'i kisha kërkuar gjithë Hiren. Pa diskutim, që do të kisha marrë shumë plaçkë lufte prej atij qyteti.[34]

Beshir bin Mabedi bëhet mysliman

Beshir bin Mabedin, duke qenë se tërthorazi i përkiste edhe fisit të "Hasasijes", e thërrisnin edhe Beshir bin el-Hasasije.

Një ditë, Beshiri u nis dhe shkoi për te Profeti i nderuar (alejhis'selam). Resulullahu fillimisht e ftoi atë njëherë të pranonte Islamin. Mandej e pyeti:

- "*Si të quajnë?*" Ai iu përgjigj:

- "Nedhir!" që do të thotë "i frikshëm". Resulullahu i tha se do t'ia ndërronte emrin me emrin "Beshir", që do të thotë "lajmëtar i së mirës". Mandej e mirëpriti atë në Suffe.

Krenaria e Njerëzimit, Profeti ynë, kur i sillnin ndonjë dhuratë, nuk ikte pa u dhënë edhe të tjerëve prej saj. Edhe kur i binin sadaka, ai ua ndante atë gjithmonë miqve apo shokëve që i gjendeshin pranë

[34]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/237 (10228).

në ato çaste. Një natë, Krenaria e Gjithësisë doli jashtë. Beshiri po e ndiqte nga pas. I Dërguari i Allahut mbërriti në varrezat "Baki" dhe i përshëndeti ata që ishin në ato varre me këto fjalë:

- "*Përshëndetje të gjithë juve! O ju banorë të tokës së shumë fiseve besimtare! Një ditë, edhe ne do të vijmë pranë jush, sepse edhe ne Zotit i përkasim. Kur të vijë ajo kohë, nuk ka dyshim, se edhe ne tek Ai do të kthehemi. Mirëpo, e vërteta është kjo, se ju ikët me shumë mbarësi, e pas latë një të keqe që zgjat shumë.*"

Kur Resulullahu përfundoi lutjen dhe u kthye pas, e ndjeu menjëherë se dikush po e ndiqte nga pas, ndaj thirri:

- "*Kush është aty?*"

- "Beshiri jam.", – u përgjigj një zë.

- "*A nuk je i kënaqur që Zoti yt të zgjodhi pikërisht ty nga mesi i fisit* Rabia, *për të cilët Allahu ka thënë se 'sikur të mos ekzistonte, atëherë gjithë ç'ka ky rruzull e këta qiej do të shkatërroheshin në vend'. A nuk duhet ta falënderosh Zotin për këtë?*"

- "Po, o i Dërguari i Allahut.", – u përgjigj Beshiri.

- "*Atëherë ç'të ka bërë që të më ndjekësh nga pas, në këtë orë të natës, deri këtu?*", – e pyeti Resulullahu (alejhis'selam).

- "Po ti dole jashtë qytetit në këtë orë të vonë të natës, kisha frikë se mos pengoheshe gjëkundi e rrëzoheshe, apo mos ndonjë kafshë helmuese të bënte keq, ndaj të erdha nga pas, për të të mbrojtur."[35], – iu përgjigj Beshiri, duke dhënë një përgjigje plot dhembshuri.

Kur një prej fisit Beladeuije bëhet mysliman

Një panair shumë i madh ishte ngritur. Në Medinë erdhi një njeri nga fisi i Beladeuijes, dhe për të pushuar, u vendos në një prej luginave që ishin aty pranë. Dy vetë po bënin pazar me njëri-tjetrin për një dhi që kishin me vete. Le ta dëgjojmë se si vijon historia, ashtu siç na vjen e transmetuar nga vetë ky njeri:

"Ai që ishte blerësi, i kërkoi tjetrit që t'ia ulte pak çmimin. Në atë çast, papritur, aty pranë iu shfaq një njeri, që kishte një pamje madhështore,

[35]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 2/26.

me ballin të gjerë, hundën të hollë dhe vetullat të mprehta, i cili ishte veshur me disa rroba të vjetra dhe na përshëndeti. Me vete thashë njëherë: "Flasin se nga bijtë e Hashimit ka dalë një njeri që po përpiqet të shtrembërojë zakonet e njerëzve. Mos vallë ky është ai njeri." Nejse, e përshëndetëm edhe ne. Ai që po blinte, iu drejtua atij njeriu:

- "O i Dërguari i Allahut! Thuaji këtij shitësi, të ma ulë pak çmimin e kësaj dhie." Resulullahu zgjati njërën dorë dhe tha:

- "*Kontrolli i plotë mbi pasurinë tuaj ju takon vetëm juve. Unë dua, që kur të vijë dita e Kiametit dhe të dalim përpara Allahut, asnjë prej jush të mos ketë mundësi të thotë se unë kam bërë padrejtësi me pasurinë, jetën, apo nderin e ndonjërit prej jush. Allahu pastë mëshirë për atë që bën lëshime (lehtësim) në tregti, atij që tregohet i butë e i duruar me atë që ka për t'i paguar një borxh dhe atij që nuk e bën të vështirë kur ka për të blerë diçka.*"

Mandej iku dhe vazhdoi rrugën për nga ishte nisur. Sërish, thashë me vete: "Sido që të jetë e vërteta, unë do të shkoj te ky njeri dhe do t'i them se i pranoj ato që tha. Sa të ëmbël që e kishte fjalën." I shkova nga pas dhe e thirra:

- "O Muhamed!", - Nuk ktheu vetëm kokën, por u kthye menjëherë i tëri nga unë.

- "*Çfarë kërkon?*", – më pyeti.

- "Ti je ai njeri, për të cilin thonë se 'po i shthur njerëzit, po u shkakton gjithfarë fatkeqësish dhe po u bëhesh atyre pengesë që të adhurojnë zotat e të parëve të vet?", – e pyeta unë.

- "Po!"

- "Për ku i fton ti njerëzit?"

- "*Unë i ftoj për tek Allahu të gjithë robërit e Tij.*"

- "E çfarë tjetër u thua ti atyre?"

- "*Unë dua që ti të pranosh se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se unë jam i dërguar i Allahut, që t'i besosh asaj që më është zbritur mua, t'i mohosh Latin dhe Uzzan, ta falësh namazin më së miri dhe të japësh zekatin e pasurisë sate.*"

- "E çfarë është zekati?"

- "*Ajo pjesë e pasurisë së të pasurit, e cila duhet t'u jepet të varfërve.*"

- "Sa e bukur qenka kjo ku ti po na ftoke!..", – i thashë.

Tani mund të thosha me plot gojën se e kisha njohur mjaft mirë atë njeri. U kthye nga unë dhe më pyeti:

- "*A më kuptove mirë, si mua, ashtu edhe ftesën që të bëra?*"

- "Po, o i Dërguari i Allahut.", – iu përgjigja unë.

Kur e dëgjoi këtë fjalë, atëherë më kërkoi që ta përsëritja, duke më thënë:

- "*Domethënë, tani, ti po pranon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut dhe, njëkohësisht, po i beson edhe asaj që më është zbritur mua?*"

- "Po, o i Dërguari i Allahut, i besoj.", – përsërita unë.

Ai njeri nga Beladeuijet thotë se: "Më beso, më parë, nuk besoj të ketë pasur njeri të gjallë mbi rruzullin tokësor që ta ketë urryer më shumë se unë atë njeri. Por, e vërteta është, se, që tani, atë njeri e dua më shumë edhe se nënën, babanë dhe fëmijët e mi, sepse ai është njeriu më i dashur ndër gjithë njerëzinë."

Ai njeri, më vonë shkoi në lagjen ku banonin të afërmit e tij dhe i ftoi që të gjithë të pranonin Islamin. Të gjithë erdhën dhe u bënë myslimanë dhe Krenaria e Gjithësisë i fërkoi kokën këtij njeriu dhe e përgëzoi për atë që kishte bërë me të afërmit e tij.[36]

Ebu Kuhafeja bëhet mysliman

Ditën që ndodhi ngadhënjimi mbi Mekën, i Dërguari i Allahut hyri i qetë dhe fare i heshtur deri në Mesxhidu'l Haram. Ebu Bekri (radijallahu anhu) e mori të atin, Ebu Kuhafen (Osman bin Amir) për dore dhe e pruri drejt e tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Krenaria e Njerëzimit, kur e pa këtë njeri, i tha Ebu Bekrit:

- "*O Ebu Bekr! Pse e mundove këtë burrë të moshuar, e nuk e le të qëndronte atje ku ishte. Mund të shkonim ne tek ai.*"

- "O i Dërguari i Allahut, po a nuk duhet që të vijë ai tek ti dhe jo

[36]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 8/580 (14208).

të shkosh ti te këmbët e tij?", – e pyeti Ebu Bekri.

Profeti ynë e mori atë burrë të moshuar dhe e uli para vetes. E zgjati dorën e tij të bekuar, ia vuri drejt zemrës dhe i tha:

- "*Bëhu mysliman, që të gjesh qetësinë në shpirt.*" Aty, ai tha menjëherë dhe me sinqeritet fjalën e dëshmisë, duke u bërë sakaq mysliman.[37]

3. ATA QË FTOHESHIN NË ISLAM NGA DY E NGA TRE

Ebu Sufjani dhe e shoqja e Ebu Sufjanit, Hindi

Na e tregon Muauija (radijallahu anhu): "Një ditë, babai im, Ebu Sufjani, mori edhe nënën time, Hindin, në kalin e tij dhe dolën nëpër shkretëtirë. Atëherë unë isha një djalë i ri, hipa mbi gomar dhe iu vura nga pas me ngadalë. Aty, fare papritur, dëgjuam zërin e Profetit (alejhis'selam). Babai më tha:

- "Zbrit ti, të hipë Muhamedi." Zbrita dhe mbi gomar hipi i Dërguari i Allahut dhe filloi të ecte me ngadalë duke na prirë të gjithëve. Mandej, u kthye nga ne dhe na tha:

- "*O Ebu Sufjan! Dhe ti, Hind! Nuk ka pikë dyshimi se një ditë ju do të vdisni dhe sërish do të ringjalleni. Ata që janë të mirë, do të hyjnë në Xhenet, ndërsa ata që janë të këqinj, do të shkojnë në Xhehenem. Unë jam duke ju thënë të vërtetën. Kjo është hera e parë që këto të vërteta po jua them të gjithëve bashkë.*"

Mandej na lexoi prej fillimit të sures "Fussilet", deri në ajetin e njëmbëdhjetë.

- "Kaq kishe për të thënë?", – e pyeti babai.

- "*Po!*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut dhe zbriti nga gomari dhe mbi të hipa sërish unë.

Nëna u kthye nga babai dhe tha (hasha):

- "Për këtë magjistar ma zbrite djalin nga gomari, që të ulej ai?"

- "Jo, – iu përgjigj babai, – për Zotin, ai nuk është as magjistar, as gënjeshtar."[38]

---

[37]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 5/451.
[38]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/17 (9825).

Resulullahu fton Osmanin dhe Talha bin Ubejdullahun në Islam

Osman bin Afani dhe Talha bin Ubejdullahu (radijallahu anhuma) po vinin pas Zubejr bin Auamit për te Resulullahu. I Dërguari i Allahut u shpjegoi atyre Islamin, duke u lexuar edhe disa pjesë nga Kur'ani. U tregoi atyre të drejtat dhe detyrat që lindin fill me pranimin e Islamit. U përshkroi atyre të gjitha të mirat që Allahu do t'u falte, nëse ata do të bëheshin myslimanë. Pasi e dëgjuan mirë e mirë, ata e pranuan të gjithë Islamin dhe besuan, duke i pranuar e përsëritur të gjitha ato gjëra që u kishte treguar i Dërguari Fisnik i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Osmani (radijallahu anhu), tha:

- "O i Dërguari i Allahut! Ne ishim në një vend që ndodhet mes Maanit dhe Zerkas. Edhe pak dhe po na zinte gjumi. Dikush na thirri:

- "O ju që po flini! Zgjohuni nga gjumi, sepse në Mekë është shfaqur i Përlëvduari (Ahmedi) (alejhis'selam) dhe ju ka prurë fenë e Islamit!", - dhe kur hymë në Mekë, ç'të dëgjonim, morëm vesh se ty të është zbritur profetësia."[39] Kurse Osmani (radijallahu anhu) është bërë mysliman shumë kohë më parë, edhe mëpërpara se i Dërguari i Allahut të hynte në shtëpinë e Erkamit.

Amari dhe Suhejbi bëhen myslimanë

Amar bin Jasiri, te porta e shtëpisë së Erkamit, ku gjendej edhe Resulullahu, takoi Suhejb bin Sinanin.

- "Çfarë kërkon këtej?", – e pyeti ai Suhejbin.

- "Mirë unë, po ti çfarë kërkon?", – iu përgjigj ai po me pyetje.

- "Kam ardhur se dua të shkoj te Muhamedi dhe të dëgjoj ato që thotë.", – u përgjigj Amari i pari.

- "Edhe unë, prandaj kam ardhur.", – u përgjigj edhe Suhejbi.

Kështu, ata hynë të dy tok. Krenaria e Gjithësisë u foli atyre për Islamin. Ata e dëgjuan dhe u bënë myslimanë. Kësisoj, me hyrjen edhe të tyre në Islam, numri i meshkujve që ishin bërë myslimanë kaloi numrin tridhjetë.[40]

---

[39]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/55.
[40]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/247.

Ftimi në Islam i Es'ad bin Zurares dhe Dhekuan bin Abdikajsit

Es'ad bin Zurareja dhe Dhekuani, të cilët jetonin në Medinë, kishin një çështje të pazgjidhur mes veti, e cila kishte nevojë për gjyqësi. Për këtë arsye, ata erdhën në Mekë, për të kërkuar që çështjen t'ua zgjidhte Utbe bin Rabiaja. Kur dëgjuan rreth të Dërguarit të Allahut, ndërruan mendje dhe vendosën që të shkonin njëherë tek Ai më parë. Profeti i profetëve u foli atyre për Islamin, duke u lexuar edhe disa ajete nga Kur'ani. Edhe ata e pranuan menjëherë dhe i besuan çdo fjale që u kishte thënë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Pa shkuar fare tek Utbeja, u kthyen drejt e në Medinë. Këta dy sahabë me nam ishin ndër të parët që çuan Islamin në Medinë.[41]

4. ATA QË NUK E PRANUAN FTESËN E RESULULLAHUT PËR NË ISLAM

Ebu Xhehli

Mugire bin Shubeja tregon: "Resulullahun, për herë të parë, e kam njohur teksa po i propozonte Ebu Xhehlit që të bëhej mysliman. Bashkë me Ebu Xhehlin ne ishim duke ecur në një prej sokakëve të Mekës, kur përballë rastisëm me të Dërguarin e Allahut. I Dërguari i Allahut tha:

- "*Shiko, o Ebu'l-Hakem! Eja tek Allahu, i Dërguari dhe Libri i Tij! Unë ty nuk po të ftoj veçse që ti të pranosh Allahun.*"

- "O Muhamed! Kur do të heqësh dorë së mallkuari zotat tanë? Ti do që ne të pranojmë atë që ke ardhur të na shpallësh ti? Nëse ato që na thua janë të vërteta, unë do të dëshmoj përpara Allahut se ti e kreve detyrën tënde, duke ma shpallur profetësinë tënde. Zaten, unë do të të isha bindur e do të të kisha ndjekur, sikur unë të dija se ato që thua ti janë të vërteta!", – iu përgjigj Ebu Xhehli.

Mugireja tregon: Kur Resulullahu u largua prej andej, Ebu Xhehli më pati thënë:

- "Pse të të gënjej; unë e di se të gjitha që ai thotë janë të vërteta,

[41]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/608.

mirëpo ka diçka që më pengon: gjyshi i tyre, Beni Kusaji, pati thënë se përkujdesja për Qaben u takonte atyre, dhe ne e pranuam; thanë se detyra e gostitjes me ujë e atyre që vijnë për të vizituar Qaben u takonte atyre, edhe këtë e pranuam; thanë se këshillat që vendosin për luftërat dhe paqen dhe që japin këshilla për martesat mes banorëve u takonin atyre, edhe këtë ua pranuam; kur duhet të dërgohen ushtarë në një vend, na thanë se detyra e vendosjes së flamurit në vendin ku do të mblidhen luftëtarët u takonte po atyre, edhe për këtë nuk kundërshtuam dhe pranuam. Edhe ata ushqejnë shumë njerëz, edhe ne ushqejmë shumë njerëz. Tani, që, më në fund, ne jemi të barabartë me ta, ata po ngrihen e po na thonë: 'Ja, edhe profeti doli nga mesi ynë.' Jo, për Zotin, unë këtë nuk mund ta duroj dot!"[42]

Uelid bin Mugireja

Një ditë, Uelid bin Mugireja erdhi te Resulullahu. Krenaria e Gjithësisë i lexoi atij pjesë nga Kur'ani. Uelid bin Mugireja u duk sikur u zbut për pak. Mirëpo, ky lajm mbërriti menjëherë në veshin e Ebu Xhehlit. Ebu Xhehli erdhi menjëherë tek Uelidi dhe i tha:

- "Xhaxha! Njerëzit kanë zënë të mbledhin pasuri për ty."

- "E pse?", – e pyeti ai.

- "Duan të t'i japin ty. Të gjithë thonë se ti ke ardhur te Muhamedi që të pranosh shpalljen e tij."

- "Mos fol kot! I gjithë Kurejshi e di që unë jam shumë i pasur."

- "Për Zotin, atëherë më thuaj ti diçka, çfarë t'u them unë njerëzve tanë, kur të kthehem tek ata, që ata të binden se ti nuk e ke pranuar Muhamedin."

- "Po, mirë, çfarë të të them? Ti e di, që në mesin tuaj nuk ka njeri që e njeh poezinë më mirë se unë. Po ashtu, edhe metrikën e poezisë arabe dhe shtatë vargëzimet e saj, vështirë të gjendet një njeri që i njeh më mirë se unë. Unë të siguroj, se ato që thotë Muhamedi nuk ngjajnë kurrkund me asnjë prej tyre. Seç ka një ëmbëlsi, një shkëlqim dhe një bukuri të veçantë në ato që ai thotë. Pjesa e sipërme e asaj

[42]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/64.

peme ka fruta të ëmbla, ndërsa e poshtmja është shumë e thellë dhe domethënëse. E vërteta është se ajo do të mbizotërojë dhe asgjë nuk do të mund të ngjitet dot ndonjëherë mbi të. Ajo ka për t'i mposhtur të gjitha gjërat që do të rreken të përballen me të."

- "Imzot, nëse ti thua kështu, atëherë ta dini, se fisi nuk ka për të qenë asnjëherë i kënaqur me ty!"

- "Atëherë, prit, të mendohem pak."

Në fund, Uelid bin Mugireja u mendua, i peshoi mirë e mirë mendimet që i vinin në kokë dhe tha:

- "Kjo është një magji e transmetuar, magjistar pas magjistari, e cila prek çdokënd nga ata që e dëgjojnë."[43] Menjëherë pas këtyre fjalëve zbritën këto ajete: "**Më ler Vetëm** (të merrem) **me atë që e krijova të vetëm, pa pasuri e pa familje dhe i dhashë pasuri të pamasë e djem pranë vetes, dhe nderë e prestigj i kam dhuruar.**" (Mudeththir, 74/11-14).

5. SHPALLJA E ISLAMIT PARA GRUPESH TË MËDHA ME NJERËZ

Shpallja e Islamit aristokracisë së Kurejshëve

Utbeja, Shejbeja, Ebu Sufjani dhe pjesa tjetër e parisë së Kurejshëve, kishte perënduar dielli dhe ata ishin mbledhur në pjesën e pasme të Qabes dhe po flisnin me njëri-tjetrin: "Dërgoni një grup njerëzish te Muhamedi, t'i tregojnë atij se ne kemi të drejtë që kundërshtojmë e ta bisedojnë me kujdes këtë çështje dhe t'ia shprehin haptazi se ne nuk duam ta pranojmë shpalljen e tij."

Pasi i folën të gjitha këto, shkuan dhe e thirrën Resulullahun që të vinte aty. Resulullahu nuk ngurroi dhe erdhi menjëherë pranë tyre. Sepse mendonte se ata do të hiqnin dorë dhe shpresonte se do të bëheshin myslimanë. E dëshironte shumë që ata të bëheshin myslimanë dhe mërzitej jashtë mase nga inati, vuajtjet dhe ngatërresat që ata shkaktonin në mesin e njerëzve. Shkoi te ta dhe u ul mes tyre. Ata e pritën duke i thënë:

- "O Muhamed! Ne të thirrëm për të të njoftuar se ne kemi një arsye

[43]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/60.

shumë të fortë që të kundërshtojmë. Ja se si qëndron e vërteta, asnjë arab më parë nuk ka guxuar të fusë kaq shumë ngatërresa në mesin e arabëve, sa ç'ke bërë ti duke futur ngatërresa në mesin tonë. E çfarë ke lënë ti pa bërë! Ke mallkuar të parët tanë, duke e përbuzur fenë e tyre, je tallur me mendimet dhe jetën e tyre dhe, për më tepër, nuk ke lënë zot pa e sharë. Ti e ke prishur të gjithë përbashkimin që ekzistonte në mesin e arabëve. Ti nuk ke lënë shëmti pa futur në mesin tonë. Nëse e ke prurë këtë fe të re, sepse synon që të mbledhësh pasuri, atëherë na thuaj se ne mund të mbledhim pasuri për ty sa të duash, madje ne mund të të bëjmë që ti të bëhesh më i pasur nga të gjithë ne. Nëse janë fama dhe nderimet ato që kërkon, atëherë ne mund të të zgjedhim ty mbi krye. Por jo, edhe nëse do që të bëhesh mbret, atëherë mjafton të na e thuash, e ne mund të të zgjedhim ty si mbret. Edhe nëse të ka pushtuar ndonjë xhind dhe e ke të pamundur të shpëtosh dot prej tij, atëherë na trego, sepse ne jemi gati ta shpenzojmë të gjithë pasurinë vetëm që ti të shërohesh e të shpëtosh."

Krenaria e Gjithësisë i dëgjoi mirë e mirë, me vëmendje, dhe shtoi:

- "*Unë nuk kam asnjërën prej atyre që ju numëruat. Unë nuk dua as para, as nderime e as mbretërim në këmbim të detyrës së shtrenjtë të profetësisë që më është ngarkuar. E vërteta është se unë kam ardhur për t'ju sjellë urdhëresat e Zotit tonë. Dhe nuk po punoj veçse për të mirën tuaj. Nëse ju e pranoni atë që unë kam ardhur t'ju shpall, atëherë ky ka për të qenë fitimi juaj, si në këtë jetë, ashtu edhe në përjetësi. Por, nëse e mohoni dhe nuk e pranoni, atëherë unë nuk kam se ç'të bëj, veçse të pres derisa Zoti të japë një vendim mes meje dhe jush.*"

Idhujtarët e Kurejshit e ngatërruan edhe më shumë bisedën, duke kërkuar gjëra nga më të pazakontat:

- "O Muhamed, nëse asnjë prej atyre që ne po të ofrojmë nuk është e mundur, atëherë të paktën të bësh këtë: ti e di, kufijtë e atdheut tonë janë shumë të ngushtë, pasuritë i ka të kufizuara dhe këtu jeta nuk është edhe aq e lehtë. Kërkoji Zotit që t'i shtyjë ca më tutje këto male që e rrethojnë Mekën rreth e përqark. Ose t'i sheshojë e t'i shndërrojë në fusha të rrafshëta. Të sjellë edhe lumenj, që të kalojnë mespërmes atdheut tonë, njësoj si lumenjtë e Sirisë dhe të Irakut. Hë, të mos harrojmë, kërkoji Atij edhe që të na ringjallë edhe të parët tanë. Për

shembull, mes tyre të jetë edhe Kusaj bin Kilabi. Sepse ai ka qenë një njeri shumë i respektuar ndër të parët tanë, i cili thoshte gjithmonë të drejtën. Kështu, duke i pyetur edhe ata për ty, ne mund të mësojmë, nëse je duke na thënë të drejtën, apo jo. Nëse, pavarësisht të gjithave, ata do të të pranojnë ty e do të qëndrojnë në anën tënde, atëherë ta dish se do të të pranojmë edhe ne. Do të kuptojmë më mirë vendin tënd pranë Zotit, duke e pranuar se ti je një profet i dërguar prej Tij."

I Dërguari i Allahut, pasi i dëgjoi të gjitha këto përçartje një e nga një, tha:

- "*Mua nuk më është dhënë detyra e profetësisë që të përmbush kërkesat tuaja. Unë ju bëj të ditur atë që Allahu më ka urdhëruar t'jua bëj të ditur. Unë e kreva detyrën time të shpalljes hyjnore. Nëse ju e pranoni, nuk ka dyshim që do t'ia shihni të mirën, si në këtë jetë, ashtu edhe në ahiret. Por, nëse më mohoni, atëherë unë nuk kam se ç'të bëj veçse të duroj, gjersa Allahu të marrë një vendim të prerë mes meje dhe jush.*"

Pas kësaj, idhujtarët i kërkuan Mbretit të Profetëve që t'u tregonte ndonjë engjëll që e provonte profetësinë e tij, kopshtije dhe vreshta, thesare dhe ndërtesa të argjendta..."**E ata thanë: 'Ç'është me këtë të dërguar, i cili ha ushqim dhe ec nëpër tregje? Përse të mos i jetë dërguar një engjëll së bashku me të, e të jetë qortues?'**" (Furkan, 25/7)

Edhe këtyre fjalëve Resulullahu (alejhis'salatu ues'selam) u dha të njëjtën përgjigje si më sipër. Ata vijuan të kërkonin sërish gjëra që nuk mund të kërkohen. Dhe fjalët i thoshin me një ton ironik dhe fyes. I thanë:

- "Nëse është e vërtetë, që Zoti ty të jep gjithçka që i kërkon, kur i lutesh, atëherë kërkoji që të na e rrëzojë në tokë pjesë-pjesë këtë qiell që qëndron mbi kryet tona. Nëse nuk e bën, as ne nuk të besojmë." Krenaria e Gjithësisë iu përgjigj sërish, se "*kjo është në dorën e Zotit, nëse do, Ai mund ta bëjë këtë për ju.*"

Idhujtarët e tepruan edhe më shumë, duke i thënë kërcënueshëm:

- "O Muhamed! Zoti yt nuk e dinte që ne të thirrëm këtu për të të pyetur në lidhje me Të, që nuk të këshilloi më parë, e të të tregonte se çfarë do të të kërkonim; pse nuk të informoi e nuk t'i mësoi një e nga një, fjalë për fjalë, se si duhet të na këshilloje. Hë, nuk jua ka mësuar

se si do të veproni e ç'rrugë duhet të zgjidhni për të ndjekur, nëse ne nuk e pranojmë fenë tuaj. Me ç'na kanë thënë, në Jemame jeton një njeri, të cilin e quajnë Rahman dhe ty t'i paska mësuar ai të gjitha ato që thua. Na beso, por ne kurrsesi nuk do t'ua vëmë veshin fjalëve të një njeriu si Rahmani. Tani, ne t'i treguam të gjitha arsyet se pse nuk të besojmë. Ta dish, ne nuk do ta lëmë me kaq. Ose do të zhdukemi ne, ose do të zhdukesh ti."

Njëri, që ishte ndër më fanatikët në mosbesim u hodh e tha: "**Nëse nuk na e sjell Allahun dhe engjëjt e Tij që të na dëshmojnë se ti je profet, ne ty nuk kemi për të të besuar kurrë.**" (Isra', 17/92)

Kur arritën të thoshin edhe këtë fjalë, atëherë i Dërguari i Allahut u ngrit të largohej që aty. Në atë kohë u ngrit edhe djali i hallës së tij, Abdullah bin Ebi Umejje dhe iu drejtua duke i thënë:

- "O Muhamed! Populli t'i tha ç'kishte për të të thënë, por ti nuk pranove asnjë nga fjalët e tyre. Ata të kërkuan disa gjëra që janë shumë të rëndësishme, për të kuptuar se cili është vendi yt te Zoti; nuk i bëre. Në fund ata të kërkuan që ti t'ua provoje dënimin me të cilin ti iu kanose në emër të Zotit, nëse ata nuk do të besonin, e as këtë nuk e bëre. Ta dish mirë, se nëse nuk ngre shkallë që ngjiten drejt qiellit, e të na zbresë që andej një libër i shkruar që dëshmon se fjalët e tua janë të vërteta, bashkë me katër engjëj, as unë nuk kam për të të besuar ty. Të betohem, se nëse nuk e bën këtë as unë nuk mund të të besoj!" I tha këto fjalë dhe u largua nga i Dërguari i Allahut.

Edhe i Dërguari i Allahut u largua shumë i trishtuar nga njerëzit e tij, pasi donte aq shumë që ata t'i besonin, por ata sërish këmbëngulën në mohim, dhe shkoi pranë familjes së tij. Këtij grupi të Kurejshëve ua kishin verbuar sytë inati, mohimi, padrejtësia dhe armiqësia që ndienin kundrejt së mirës."[44]

Kur Islami iu kumtua Ebu'l-Hajthemit dhe një grupi të rinjsh

Emri i vërtetë i këtij sahabi të njohur aq shumë nga të gjithë ishte Enes bin Rafi. Bashkë me një grup të rinjsh, kishte ardhur në Mekë,

[44]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/62.

për të kërkuar ndihmën e kurejshëve, që t'i mbronin ata nga fisi i Hazrexhëve. Krenaria e Gjithësisë, kur dëgjoi se kishte ardhur një grup të rinjsh nga Medina, u nis menjëherë për t'i takuar. Ai iu drejtua atyre me fjalët:

- "*A nuk doni që unë t'ju tregoj diçka më të hairit sesa ajo që ju ka sjellë deri këtu?*"

- "E çfarë është ajo?", – e pyetën ata.

- "*Unë jam i Dërguari i Allahut. Allahu më ka dërguar mua që t'u prijësoj njerëzve kah udhëzimi, që të adhurojnë vetëmse Allahun dhe të mos i bëjnë Atij asnjë shok, apo ortak, në krijimin e gjithçkaje. Veç kësaj, mua Ai më ka zbritur edhe një Libër, që unë t'jua shpall juve të vërtetat e tij.*"

Pasi u tha këto fjalë, Ai u shpjegoi atyre Islamin në vija të përgjithshme, duke u lexuar edhe pjesë të ndryshme nga Kur'ani. Një ndër djemtë e rinj të atij grupi, i cili quhej Ijas bin Muadh, u tha shokëve:

- "Për Zotin, kjo që po na tregon ky njeri është shumë herë më e mirë se sa ajo për çfarë ne kemi ardhur deri këtu." Enes bin Rafiu mori një grusht guralecë nga toka dhe ia lëshoi Ijasit drejt e në fytyrë, dhe i tha:

- "Zhduku nga grupi ynë! Ta dish, se ne kemi ardhur deri këtu për një arsye tjetër shumë të madhe." Ijasi heshti dhe nuk i ktheu përgjigje. Edhe Krenaria e Njerëzimit u ngrit që aty dhe, sakaq, edhe ata u ngritën që të ktheheshin në Medinë.

Nuk kaloi shumë kohë dhe mes fiseve Eus dhe Hazrexh plasi një luftë, e cila u quajt edhe si lufta e Buathit. Ijas bin Muadhi (radijallahu anhu) dëshmor pikërisht gjatë kësaj lufte. Sipas asaj që tregojnë transmetuesit; dikush e kishte parë, dhe teksa po jepte shpirt, Ijasi kishte thënë: "La ilahe il'lallah, Allahu Ekber, Subhanallah". Aty ishin mbledhur edhe njerëz nga fisi i tij, për të dëgjuar se çfarë thoshte. Nuk kishte asfare dyshim se ai qe ndarë nga kjo jetë si mysliman. Ijas bin Muadhi ishte bërë mysliman qysh kur e kishte parë fytyrën e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahua alejhi ue sel'lem) për herë të parë.[45]

[45]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 5/427 (23668).

Resulullahu fton kushërinjtë e Tij në Islam

Kur zbriti ajeti i dyqindekatërmbëdhjetë i sures Shuara, "**Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm**" (Shuara, 26/214), Profeti i profetëve vendosi të ngjitej në kodrën e Merues ose Safasë, që t'u fliste kushërinjve të Tij për të vërtetën e Allahut:

- "*O fis i Fihriut!*" Aty u mblodhën edhe shumë kurejshë. Ebu Lehebi tha:

- "Ja tek e ke fisin e Fihriut! Thuaje, ç'ke për të thënë!" Resulullahu vijoi fjalën e vet: -

- "*O fis i Galibit!*" Nga fisi i Fihrit erdhën Beni Muharibi dhe Beni Harithi.

- "*O fisi i Luej bin Galibit!*", – vijoi të thërriste i Dërguari i Allahut. Erdhi Beni Tejmi. Kur thirri: "*O fisi i Kab bin Luejit!*", aty erdhi Amir bin Lueji. Po ashtu, nga familjet e Beni Adit, Beni Sehmit, Beni Xhumah bin Amrit dhe Kilab bin Murres erdhën Beni Makhzumi, Beni Tejm bin Murreja; nga fisi i Beni Kusajit Dhuhre bin Kilabi; nga fisi i Abdimenafit erdhën Beni Abdid'dar bin Kusaji, por të ftuar ishin edhe Beni Abdilesed bin Abdil'uzza dhe Beni Abd bin Kusai.

Ebu Lehebi u kthye nga Profeti i nderuar dhe i tha:

- "Ja tek janë të gjithë pasardhësit e bijve të Abdu Menafit. Ç'ke për të thënë, thuajua këtyre!"

I Dërguari i Allahut filloi të fliste:

- "*Allahu më ka urdhëruar që unë t'i paralajmëroj të gjithë të afërmit e kushërinjtë e mi. Dhe ju jeni prej Kurejshit, kushërinjtë e mi më të afërt. Nëse nuk thoni La ilahe il'lallah, unë nuk kam se si t'ju ndihmoj as në këtë jetë, as në tjetrën. Por, nëse e thoni, atëherë unë do të jem dëshmitari juaj përpara Allahut. Nëse e pranoni dhe besoni, atëherë të gjithë arabët do t'ju përulen e do t'ju respektojnë, e po falë këtij dëshmimi, të gjithë ata që nuk janë arabë do të ulen në gjunjë përpara jush.*"

Ebu Lehebi, priti sa ta mbaronte fjalën dhe i tha:

- "Turp të kesh... Mallkuar qofsh, si ti, ashtu edhe ato që ti thua..." Menjëherë pas mallkimit të Ebu Lehebit zbriti sureja "Tebbet", e cila

fillonte me ajetin: "**Duart iu thafshin Ebu Lehebit**".[46]

Sipas një transmetimi tjetër, i Dërguari i Allahut zuri t'i thërriste një e nga një të gjitha degët e Kurejshit. Ata që u thirrej emri mblidheshin në kodrën e Safasë dhe Merues. Ndërsa ata që e kishin të pamundur të ishin të pranishëm, dërgonin nga një mëkëmbës në vend të tyre. Një nga ata ishte edhe Ebu Lehebi.

I Dërguari i Allahut tha:

- "*Unë kam për t'ju dhënë një lajm më të rëndësishëm sesa po t'ju thosha se janë nisur armiqtë dhe po vijnë për të na pushtuar. Si mendoni? Nëse do t'ju thosha se pas këtyre maleve gjendet një grup kalorësish banditë, të cilët duan që t'ju sulmojnë e t'ju bëjnë keq, a do të më besonit?*"

- "Po, do të të besonim.", – iu përgjigjën ata. – "Ne, sa herë që të kemi dhënë ndonjë punë, apo të kemi kërkuar ndonjë mendim, kemi parë se ti je një njeri që nuk thua asgjë tjetër përveçse të vërtetën."

- "*Atëherë unë po ju njoftoj dhe paralajmëroj për një dënim shumë të ashpër që ju pret në të ardhmen.*", – tha Krenaria e Gjithësisë.

Pas këtyre fjalëve, Ebu Lehebi tha ato fjalë të pahijshme që u përmendën edhe më sipër dhe u largua së andejmi.[47]

Sipas një transmetimi tjetër, kur zbriti ajeti i 214 i sures "Shuara", që e përmendëm edhe në krye, Profeti i profetëve u ngrit në këmbë dhe tha:

- "*O njerëz të Kurejshëve! Shitjani veten tuaj Allahut, sepse unë nuk mund t'ju shpëtoj dot prej ndëshkimit të Allahut, qoftë edhe për gjënë më të vogël. O bijtë e Abdimenafit! Edhe ju t'ia shitni veten tuaj Allahut; sepse as për ju nuk kam se ç'të bëj në Ditën e Gjykimit, nëse ju nuk besoni. Edhe ti, o Abbas, që je xhaxhai im! Nuk të shpëtoj dot nga ndëshkimi i Allahut! Edhe ti halla ime! As ty nuk të shpëtoj dot prej dënimit të Allahut. O Fatime! Bija ime! Më kërko ç'të duash nga ajo që është e imja dhe unë do të ta jap menjëherë; mirëpo prej dënimit të Allahut unë nuk mund të të heq dot ty as edhe një grimcë të vetme.*"[48]

Me sa duket, ai donte t'u tregonte se tani ishte duke iu shpallur të vërtetën e Zotit. "Ju duhet të besoni në këtë fe, që të ruheni nga

[46]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/39.
[47]. Buhari, *Sahih,* 1/470 (1330).
[48]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/427 (18852).

dënimi i ashpër i Allahut. Përndryshe, të mos mbani shpresa kot tek lidhja jonë farefisnore."

I Dërguari i Allahut u tregon Islamin fiseve të Beni Amirit dhe Beni Muharribit

Profeti ynë, përgjatë tri viteve të para, e shpallte Islamin fshehtas. Në vitin e katërt, ai nisi ta shpallte atë haptazi dhe kjo vijoi kështu, e pa ndryshuar, për dhjetë vite me radhë. Për të predikuar ai zgjidhte veçanërisht panairet që zhvilloheshin asokohe nëpër vende të ndryshme afër Mekës dhe stinën e Haxhit. Ai shkonte nëpër vendet e panaireve që ngriheshin nga haxhilerët në Ukadh, Mexhene dhe Dhulmexhaz dhe u kërkonte atyre që t'u ofronin mundësitë që i nevojiteshin për të bërë shpalljen e tij, ndërsa në këmbim u jepte atyre sihariqin e bekuar të Xhenetit. Shkonte fis më fis, derë më derë, dhe i pyeste të gjithë se ç'mendim kishin, mirëpo, nuk pati arritur të gjente qoftë edhe një fytyrë të vetme të pastër.

Ndërkaq, radha i erdhi që të shkonte edhe pranë fisit të Beni Amirit. Por ç'e do se aty e trajtuan më keq nga çdo vend tjetër ku ai kishte shkuar. Kur u largua së andejmi, ata e ndoqën nga pas duke e goditur me gurë. Mandej, Profeti i profetëve shkoi te Beni Muharibi. Në mes tyre gjendej edhe një burrë i moshuar njëqindenjëzetvjeçar. I Dërguari i Allahut foli me atë njeri dhe e ftoi që të besonte tek Islami; madje i kërkoi ndihmë që ta ndihmonte që në Islam të besonin edhe të tjerët. Mirëpo plaku, jo vetëm që nuk besoi në fenë e prurë prej Vulës së profetëve, por mbajti një qëndrim që nuk pritej prej tij:

- "O njeri me nam! Populli yt i di shumë mirë ato që ti thua. Një njeri që të beson ty dhe kthehet te fisi i tij duke të besuar, gjithë të njohurit do t'ia quajnë se ai ka bërë më të keqen punë që mund të bëjë njeriu. Unë nuk kam se ç'të të them tjetër, ndaj ik, largohu nga unë!"

Kur ky njeri shfaqi një sjellje kaq të shëmtuar ndaj Profetit të profetëve, aty, nga pas, ia behu menjëherë ai që ishte më fanatiku i mohimit ndaj Zotit, me ato flokët e kuqe që e dallonin, Ebu Lehebi, i cili nuk i ndahej ndonjëherë Resulullahut, për ta penguar me çdo çmim e në çdo rast. Ebu Lehebi e përgëzoi burrin e moshuar për

qëndrimin e drejtë, që kishte mbajtur duke i thënë:

- "Sikur të gjithë ata që janë mbledhur sot këtu, për të kryer Haxhin, edhe ai vetë do të kish hequr dorë nga ajo fe e tija. Ai është një gënjeshtar, që ka hequr dorë nga feja e të parëve të tij, ja se çfarë është."

Plaku i moshuar e dëgjoi dhe i tha:

- "Ti e njeh më mirë atë, sepse është nipi yt dhe i përket farës e fisit tënd. O Ebu Leheb! Ka gjasa që ai të jetë një i çmendur. Te ne gjendet një burrë që i shëron këta lloj njerëzish." Ebu Lehebi nuk iu përgjigj fjalëve të burrit të moshuar.[49]

I Dërguari Fisnik u shpjegon Islamin bijve të Absit

Na është transmetuar nga Abdullah bin Uabisatu'l-Absi: "Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi aty ku gjendeshim edhe ne, në Mina. Ne po zbrisnim në Xhemren e parë, që vjen fill pas Faltores së Hajfit. Edhe ai ishte i hipur mbi kafshën e tij. Nga pas i vinte Zejd bin Harithi. Për të kishim dëgjuar edhe më parë, që ai vinte nëpër panaire dhe i ftonte njerëzit që të pranonin e të hynin në Islam. Na qëndronte te kryet të gjithëve dhe na shpjegonte fenë e Islamit. Megjithatë ne nuk i thamë 'po!' Pranë nesh ishte edhe Mejsere bin Mesruk el-Abesiu. Ai na tha:

- "Unë betohem për Zotin, se për ne do të ishte më mirë nëse do ta pranonim atë njeri dhe ta shihnim në anën tonë. Për Zotin, kauza e tij ka për të dalë ngadhënjimtare dhe do të mbizotërojë fuqishëm mbi të gjitha vlerat tona gjer më sot." Një prej shokëve e dëgjoi dhe i tha:

- "Qëndro larg prej nesh, e mos na shkakto probleme të cilave nuk mund t'u bëjmë dot ballë!"

Të Dërguarin e Allahut e kaploi njëfarë shprese kur dëgjoi fjalët e Mejseres, ndaj iu afrua që të fliste me të. Kur i shkoi pranë, Mejsereja i tha:

- "Sa të bukura që i kishe ato fjalë! Sa të shkëlqyera!"

- "*Mirëpo, i gjithë populli më kundërshton dhe një njeri vetëm kur ka mbështetjen e fisit të tij mund t'ia dalë të mëkëmbet. Nëse nuk e ndihmojnë të*

[49]. Ebu Nu'ajm, *Delail,* 1/255.

afërmit, atëherë si mund ta ndihmojnë armiqtë?!", – iu përgjigj Profeti ynë.

Kur i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u largua së andejmi dhe ai fis doli nga Meka dhe u kthyen të gjithë pranë familjeve të tyre. Mejsereja u foli atyre:

- "Ejani, të shkojmë në Fedek dhe të pyesim hebrenjtë se si qëndron puna me këtë njeri, cila është e vërteta." U ngritën menjëherë dhe u nisën për te hebrenjtë. Hebrenjtë nxorën menjëherë një libër përpara tyre. Kërkuan për vendin ku flitej për të Dërguarin e Allahut dhe pasi i lexuan ato pjesë, nisën të flisnin rreth tyre:

- "Ai është një arab dhe një profet i pakënduar. Hipën mbi deve dhe është aq i përkorë, saqë mjaftohet me thërrimet e bukës. Nuk është as i gjatë, as i shkurtër. Edhe flokët nuk i ka as kaçurrela, as krejt të drejtë, por i ka pak si të dallgëzuara. Në sy ka një ngjyrë të kuqe dhe lëkurën e ka ezmere."

Aty u ngrit dikush dhe tha:

- "Nëse ai që ju ftoi është një burrë që i ngjan këtij përshkrimi, atëherë duhet ta ndiqni menjëherë dhe të hyni në fenë që ai ka sjellë. Ne nuk do t'i bindemi për shkak të hasetit që kemi ndaj tij, sepse për shkak të tij ne do të kalojmë shumë fatkeqësi nëpër vende të ndryshme. Atë asnjë arab nuk do të mund ta shpërfillë dot, por, ose do t'i bindet, ose do të luftojë me të. Prandaj, më e mira për ju është që t'i bindeni e ta ndiqni rrugën e tij."

Mejsereja u kthye pranë të afërmve dhe u tha:

- "O populli im! Tanimë kjo punë u qartësua paq!

- "Vitin tjetër, kur të vijë sërish stina e Haxhit, ne do të shkojmë atje dhe do ta gjejmë atë njeri.", – thanë edhe të tjerët dhe sakaq u larguan së andejmi.

Vitin tjetër, paria e fisit ua ndaloi atyre që të shkonin në haxh, ndaj edhe asnjë prej tyre nuk iu bashkua dot Profetit, për t'i shpallur besimin. Mandej i Dërguari i Allahut mërgoi për në Medinë. Atë vit kur përmbushi Haxhin e Lamtumirës, Mejsereja arriti të takohej me të Dërguarin e Allahut dhe e njohu:

- "O i Dërguari i Allahut!", – i tha. – "Unë të betohem për Zotin,

se që prej asaj dite kur ti erdhe pranë nesh, për të na shpallur fenë e vërtetë të Allahut, unë kam dashur kaq shumë që të takohem me ty dhe të të shpall se e kam pranuar besimin islam. Ato çfarë ndodhën ndodhën. Siç e sheh, Allahu e vonoi për pak kohë hyrjen time në Islam. Të gjithë ata që më shoqëronin asaj dite, kur u takuam, sot kanë vdekur. Në ç'vend të jetës së përtejme kanë shkuar ata njerëz?"

- "*Çdokush që vdes në ndonjë gjendje tjetër, përpos vdekjes me besimin islam, vendin e ka në zjarrin e Xhehenemit!*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Lëvduar qoftë Allahu që mua më shpëtoi.", – shtoi Mejsereja, duke u bërë kësisoj mysliman.[50]

Profeti ynë u shpall Islamin bashkësisë së Kindes

Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi në vendin ku rrinte bashkësia e Kindes në panairin e Ukadhit. Deri më tani, Atij nuk i kishte rënë për hise që të takohej me ndonjë fis arab që të ishte më i butë se ta. Kur pa se ata ishin njerëz të butë dhe të arsyeshëm, Ai nisi të fliste me ta pa humbur kohë, duke u thënë këto fjalë:

- "*Unë ju thërras që të pranoni Allahun, i Cili është Një dhe i Vetëm. Ai nuk ka kurrfarë ortaku në krijimin e gjithësisë. Unë ju kërkoj, se ashtu siç ruani e mbroni jetët tuaja të më ruani e të më mbroni edhe mua. Nëse do të jem unë ai që do të ngadhënjejë, atëherë jeni të lirë që të vazhdoni të më mbroni ose jo.*"

Shumica thanë:

- "Ç'është kjo fjalë kaq e bukur! Mirëpo ne adhurojmë ata zota që adhuronin edhe të parët tanë!"

Kurse ata që ishin ndër më të vegjlit e bashkësisë thanë:

- "O popull, nxitoni që ta pranoni ju të parët, para se atë ta kenë pranuar gjithë të tjerët. Për Zotin, si të krishterët, ashtu edhe hebrenjtë, thonë se ka afruar koha që nga mesi i arabëve do të dalë një profet."

Një burrë me defekt në shikim, që gjendej aty, u tha:

- "Prisni, më dëgjoni mua! Atë e kanë përzënë gjithë të afërmit e

[50]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/145.

farefisi i vet, ju do ta merrni në mbrojtje e do të përkujdeseni për të? E dini se kjo do të thotë që t'u hapni luftë gjithë arabëve. Jo, jo! Jo, këtë mos e bëni!"

Profeti ynë u largua i trishtuar së andejmi. Edhe ata njerëz u kthyen pranë familjeve të veta dhe ua treguan edhe atyre se çfarë kishte ndodhur atë ditë. Një hebre, që ishte i pranishëm aty, u tha:

- "Për Zotin, ju jeni duke e humbur zogun e fatit që ju ka ardhur deri në dritaret e shtëpive. Nëse e ndiqni atë njeri, atëherë ju do të jeni sundimtarët e gjithë arabëve. Ne i njohim cilësitë e tij, sepse i kemi lexuar në librat tanë." Kur ai hebre u tregoi atyre të gjitha cilësitë e Profetit tonë, ata që e kishin parë Resulullahun, thanë:

- "Ai njeri ishte pikërisht ashtu siç e përshkrove ti." Mandej, hebreu i vijoi më tej fjalët e tij duke thënë:

- "Ne e dinim se një ditë ai do të dilte nga mesi i Mekës. Vendi ku ai do të mërgojë dhe do të strehohet është Jethribi (Medina)."

Edhe pjesëtarët e këtij fisi ranë në një mendje, që vitin e ardhshëm, kur të vinte stina e Haxhit, ata të shkonin tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Megjithatë, paria e tyre ua ndaloi që të shkonin në Haxh atë ditë, ndaj edhe asnjëri prej tyre nuk mundi të takohej me të Dërguarin e Allahut. Më vonë edhe ai hebre, që kishte përshkruar të Dërguarin e Allahut, vdiq. Thonë se teksa po jepte shpirt, ai pranoi vërtetësinë e Muhamed Mustafasë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), duke shpallur se kishte besuar.[51]

Profeti ynë fton në Islam bijtë e Ka'bit

Abdurrahman el-Amiri, ato që ka dëgjuar prej parisë së fisit të tij, ja se si i transmeton: "Kur ishim në panairin e Ukadhit, te ne erdhi i Dërguari i Allahut dhe na pyeti: "*Të kujt jeni ju?*" - "Nga bijtë e Amir bin Sa'saasë," – iu përgjigjëm ne. - "*Cilët bij të Amirit?*" – na pyeti ai sërish. – "Nga bijtë e Ka'b bin Rebiasë," – i thamë ne. Atëherë Profeti ynë u tha: "*Po mirë, a keni fuqi për ta ruajtur dhe për t'i ardhur në ndihmë dikujt, nëse ai do të vinte te ju për t'ju kërkuar ndihmë?*"

[51]. Ebu Nu'ajm, *Delail,* 1/259.

- "Asgjë që gjendet në anën tonë nuk mund të preket, e askush nuk mund të ngatërrohet me diçka që është në mbrojtjen tonë!" – u përgjigjëm ne.

I Dërguari i Allahut tha: "*Unë jam Profeti i Allahut. Kam ardhur t'ju kërkoj ndihmë, që ju të më mbroni e unë të mund t'u shpall njerëzve urdhëresat e zbritura prej Allahut. Unë nuk do t'i vendos detyrime asnjërit prej jush, e nuk do t'ju shkaktoj asnjë vështirësi.*" Pasi dëgjuam këto fjalë, e pyetëm Profetin tonë: "Nga cila degë e Kurejshit vjen ti?" – "*Nga bijtë e Abdulmuttalibit.*" – u përgjigj Resulullahu. – "Po mirë, ç'marrëdhënie ke me bijtë e Abdimenafit, si i ke punët me ta?" – e pyetën ata. – "*Ata qenë të parët që më përgënjeshtruan dhe më përzunë!*" – u tha i Dërguari i Allahut. Atëherë ata i thanë: - "Ne nuk do të të përzëmë, por as nuk do të besojmë tek ty. Por ne do të të mbështesim që ti të mund t'i shpallësh urdhëresat që Zoti të ka dërguar."

Transmetuesi tregon se: Pas këtyre fjalëve Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkoi pranë tyre. Teksa ky fis vazhdonte të bënte tregtinë e zakonshme, pranë tyre erdhi Buxhre bin Kajs el-Kurejshi, i cili u foli: "Kush është ky burrë që po shoh në mesin tuaj?" – "Muhamed bin Abdullahi'l-Kurejsh." – iu përgjigjën ata.

- "Po mirë, ç'ju lidh ju me këtë njeri?" – vijuan të pyesnin ata.

- "Ai na tha se ai është i Dërguari i Allahut dhe na kërkoi që ta mbështesim që ai të shpallë urdhëresat e Allahut."

- "Po ju, ç'përgjigje i dhatë?"

- "Mirë se të kesh ardhur! Rri i qetë, se ne do të të çojmë ty në atdheun tonë dhe atje do të kujdesemi për sigurinë tënde njësoj siç ruajmë edhe vetë jetët tona."

Atëherë Buxhreja na tha:

- "Unë nuk njoh bashkësi tjetër në këtë panair, që ta ketë kapluar e keqja më shumë se ju. Ju do të viheni në shënjestër të të gjithë njerëzisë, e do t'ju duhet të përballeni me të gjithë arabët njëherësh. Populli i tij e njeh më mirë se ju atë njeri dhe sikur të shpresonin se do t'u vinte ndonjë e mirë prej tij, atëherë ata do të ishin më të lumtur se kushdo tjetër që t'i dilnin në mbrojtje. Ju po i besoni dikujt që edhe fisi i vet e ka përzënë, ndërsa, tani doni edhe ta strehoni e t'i vini në ndihmë. Ky

vendim që keni marrë nuk është aspak i mirë!"

Mandej, duke u kthyer nga Resulullahu, i tha:

- "Çohu, shko pranë fisit tënd! Për Zotin, sikur të mos dija se ke mbrojtjen e fisit tim, do të ta kisha prerë kokën."

Resulullahu u ngrit dhe hipi mbi devenë e tij. Buxhreja i mallkuar, e ngacmoi ijën e devesë, deveja u shkund dhe e rrëzoi përdhe të Dërguarin e Allahut. Dubaja, e bija e Amir bin Kurtit – e cila ishte një nga gratë e para të Mekës, që kishte pranuar Islamin – kishte ardhur te fëmijët e xhaxhait për vizitë dhe gjendej aty atë ditë. Kur pa fyerjet që po i bëheshin të Dërguarit të Allahut tha: "O bijtë e Amirit! Për mua bijtë e Amirit nuk ekzistojnë më! Ç'janë këto që po më shohin sytë, që po i bëhen të Dërguarit të Allahut përpara syve tuaj dhe asnjë prej jush nuk ngrihet t'i vijë në ndihmë, ta mbrojë."

Kur dëgjuan këto fjalë, nga djemtë e xhaxhallarëve të Dubaasë u ngritën tri prej tyre dhe iu vërsulën Buxhres dhe dy të tjerëve që e kishin ndihmuar në atë paturpësi që ishte bërë. I kapën dhe i përplasën përdhe që të tre, iu ulën mbi kraharor dhe filluan t'ua grushtonin fytyrat. I gjendur përballë një pamjeje të këtillë, i Dërguari i Allahut nisi menjëherë të lutej: "O Zot! Falu të mira e begati këtyre e të tjerët mallkoji!"

Që të tre ata njerëz që i erdhën në ndihmë Resulullahut u bënë myslimanë dhe ranë që të tre dëshmorë në rrugën e Allahut, kurse të tjerët u shfarosën të mallkuar.[52]

Profeti ynë fton në Islam fisin Bekr

Abbasi (radijallahu anhu) tregon: "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më ka treguar se:

- "*Ti dhe vëllai yt nuk po më ndihmoni dhe nuk po më dilni fare krah. Hajde, më ço nesër në panair, që të shkoj aty ku do të jenë mbledhur shumë fise, e t'u flas atyre për Islamin.*"

Panairi ishte një vend ku mblidheshin të gjithë arabët mbarë. Kur

[52]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/141.

mbërritëm atje, unë i thashë:

- "Këta që sheh këtu janë prej fisit të Kindes dhe ata që rrinë rreth tyre i përkasin popullit të Jemenit, që janë edhe njerëzit më të nderuar që vizitojnë Qaben. Ja, ky është vendi ku bujti familja e Bekr bin Uailit. Ndërsa ai atje tej është vendi ku qëndrojnë familja e Beni Amir bin Sasaasë. Zgjidh ti, se te kush do të shkosh më parë për t'i folur."

Ai shkoi njëherë te bashkësia e Kindes dhe i pyeti:

- "*Të kujt jeni ju?*"

- "Ne jemi nga populli i Jemenit."

- "*Nga cili fis i Jemenit?*"

- "Nga njerëzit e Kindes."

- "*Nga cila degë e Kindes?*"

- "Nga bijtë e Amr bin Muauijes."

- "*A do ta pranonit, nëse unë ju tregoj juve një punë shumë të mbarë?*"

- "Ç'është ajo punë?"

- "*Të pranoni e të dëshmoni se nuk ka zot tjetër, përpos Allahut, të falni namazin dhe t'i besoni çdo gjëje që na është zbritur prej Zotit.*"

Sipas një transmetimi tjetër, kindasit i thanë të Dërguarit të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të):

- "Po në rast se ti del ngadhënjimtar, pas vdekjes tënde, a do të na e lësh neve pastaj mbretërinë tënde?" I Dërguari i Allahut i dëgjoi dhe iu përgjigj:

- "*Pasuria dhe mbretërimi i takojnë vetëm Allahut, e Ai ua jep ato kujt të dojë.*" Kindasit i dëgjuan mirë ato fjalë dhe thanë:

- "Atëherë ne nuk kemi nevojë për atë që ti na ke sjellë.", – duke i dhënë kësisoj një përgjigje të turpshme të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

Ebu Lehebi e ndiqte Profetin tonë këmba-këmbës, kudo që të shkonte, dhe u thoshte njerëzve:

- "Të mos pranoni asnjë fjalë nga ato që ju thotë ai njeri!"

Edhe atë ditë, kur pa se Profeti i nderuar po largohej nga mesi i

atyre njerëzve, ai shkoi menjëherë pranë tyre. Ata i thanë:

- "A e njeh këtë njeri?"

- "Po, për atë njeri në majë të Minës e keni fjalën? Çfarë doni të dini për të?", – i pyeti Ebu Lehebi.

- "Na tha se është i Dërguar prej Allahut."

- "Mos ua vini veshin fjalëve të tij, ai është i çmendur e flet përçart.", – iu përgjigj Ebu Lehebi.

- "Po!", – thanë ata, – "Këtë e patëm kuptuar edhe ne kur dëgjuam se çfarë thoshte lidhur me popullin e Iranit."[53]

Profeti ynë u shpjegon Islamin një grupi njerëzish në Mina

Mudriku (radijallahu anhu) na tregon: "Teksa ishim në Haxh bashkë me babanë, e ishim vendosur të qëndronim në Mina, aty rastisëm në një grup të madh njerëzish. Aty i thashë babait: "Ç'të jetë gjithë kjo rrëmujë, gjithë ky grumbull njerëzish?"

- "Duhet të jetë ai njeriu i ç'udhëzuar, që ka braktisur fenë e tij, rreth tij duhet të jenë mbledhur.", – mu përgjigj babai.

Aty, në atë çast, dëgjova të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) teksa thoshte:

- "*O njerëz, thoni 'La ilahe il'lallah', që të mund të shpëtoni!*"[54]

Kur Profeti ynë fton në Islam bijtë e Shejbanit

Aliu (radijallahu anhu) tregon: "Kur Allahu i urdhëroi Profetit të Tij, që ai t'ua shpallte fenë e Allahut të gjitha fiseve arabe, atëherë Profeti ynë u ngjit në Mina. Bashkë me të ishim edhe unë me Ebu Bekrin. Kur iu afruam një grupi arabësh, ai bëri përpara, bashkë me Ebu Bekrin, dhe i përshëndetën. Ebu Bekri ishte i pari në çdo punë të mirë që do të bëhej. Veç kësaj ai edhe i njihte më mirë se kushdo fiset arabe.

Më në fund, patëm mbërritur pranë një kuvendi njerëzish, ku

[53]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/140.
[54]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 20/343 (806).

mbizotëronte heshtja, qetësia dhe serioziteti. Aty gjendeshin të ulur burra në moshë, të veshur të gjithë me veshje të mira e me shpata; dukeshin që ishin burra të fuqishëm. Ebu Bekri u afrua dhe i pyeti:

- "*Të kujt jeni ju?*"

- "Ne jemi prej bijve të Shejban bin Thalebesë.", – u përgjigjën ata.

Ebu Bekri u kthye kah i Dërguari i Allahut dhe i tha: "T'u bëfshin kurban Ty, si nëna, ashtu edhe babai im, ndër të gjitha fiset është e pamundur që të gjesh dot njerëz më të ndershëm se këta!"

Aty ishin të pranishëm edhe paria e fisit, si Mefruk bin Amri, Hani bin Kabisaja, Muthenna bin Haritheja dhe Numan bin Sheriku. Ai me të cilin kishte më shumë afrimitet Ebu Bekri ishte Mefruk bin Amri. Ky ishte një personalitet, të cilin të gjithë e njihnin për aftësinë e veçantë që kishte për të folur bukur. Rreth qafës e kraharorit i vareshin dy gërsheta shumë të bukur. Ai ishte ulur pranë Ebu Bekrit. Ebu Bekri e pyeti: "Sa bëheni ju gjithsej?"

- "Ne jemi më shumë se njëmijë vetë," – u përgjigj Mefruk bin Amri.

- "Po fuqi, a keni?" – vazhdoi t'i pyeste Ebu Bekri.

- "Ne mund ta përdorim tërë forcën që kemi, por çdo familje ka edhe fatin e saj."

- "Si kanë shkuar luftërat që keni bërë me armiqtë tuaj?"

- "Kur përballemi, ne jemi shumë të egër e të pamëshirshëm karshi tyre. Kuajt që vrapojnë më mirë ne ua japim fëmijëve, ndërsa ne të armatosurit pëlqejmë t'i hipim mbi deve. Patjetër, kemi edhe ndihmën e Zotit. Nganjëherë na nxjerr fitimtarë, nganjëherë të humbur. Me shumë gjasa, ti duhet të jesh nga kurejshët."

- "Ma merr mendja se duhet të keni dëgjuar për lajmin e të Dërguarit të Allahut; ja ky është ai njeri."

- "Po, kemi dëgjuar për të. Thuhet se është Profeti i Allahut!", – tha Mefruku dhe u drejtua nga Resulullahu:

- "O vëlla i Kurejshëve! Ç'është ajo, në të cilën ti na fton të gjithëve?"

Profeti ynë bëri pak më përpara dhe u ul aty. Edhe Ebu Bekri u ngrit dhe ngriti një rrobë të tijën, për t'i bërë hije të Dërguarit të Allahut.

- "*Unë ju ftoj juve që të besoni se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut, që është Një dhe i Vetëm, të më mbroni, mbështetni dhe të më ndihmoni, derisa unë t'i kryej të gjitha ato që më ka urdhëruar Allahu. Kurejshët janë mbledhur të gjithë me njëri-tjetrin, që të luftojnë kundër fesë së Allahut, duke përgënjeshtruar Profetin e Zotit, e duke zgjedhur të gënjeshtërtën kundrejt asaj që është e drejtë dhe e vërtetë. Allahu nuk ka nevojë për askënd dhe Ai meriton çdo lloj lëvdimi.*", – tha i Dërguari i Allahut.

- "O vëlla i Kurejshit, po për ku na fton tjetër?", – vazhdoi të pyeste Mefruku.

I Dërguari i Allahut nisi të këndojë këto ajete: "**Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë** (në adhurim)**; që të silleni mirë me prindërit; që të mos i vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë; sepse ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos u afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta, apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia** (e Ligji)**. Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni. Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Kryejeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësojani besën e dhënë Allahut! Këtë ju porosit Ai që të mos harroni. Kjo është rruga Ime e Drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t'u ruajtur nga të këqijat.**" (En'am, 6/151-153)

- "Për ku na fton tjetër?", – vijoi të pyeste Mefruku, – "Për Zotin, këto nuk janë fjalë që i përkasin kësaj bote, se po të ishin, nuk ka dyshim që ne do t'i kishim dëgjuar edhe më parë gjer më sot."

I Dërguari i Allahut iu përgjigj duke i kënduar këtë ajet:

"**Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t'ia vini veshin.**" (Nahl, 16/90)

- "Uallahi, o kurejsh! Ti po na fton për te morali më i përkryer, për te punët më të mira. Populli që të ka përgënjeshtruar e të ka përzënë ty, duke të kundërshtuar, është gënjeshtar."

Mandej, sikur të donte që në bisedë të ndërhynte edhe Hani bin Kabisaja, ai tha:

- "Ja, ky është Hani bin Kabisaja, një ndër njerëzit më të respektuar ndër ne dhe ne atë dëgjojmë kur bëhet fjalë për çështje të fesë."

Hani ndërhyri:

- "O vëllai i Kurejshëve! Unë i dëgjova fjalët e tua dhe i pranoj të gjitha ato që ti the. Mendoj se do të ishte e gabuar, nëse ne do ta linim fenë tonë menjëherë, pa parë njëherë se si do t'i shkojë puna kësaj fesë sate, pa u menduar njëherë mirë e mirë rreth gjithë sa biseduam sot, e të të bindeshim e të të ndiqnim ty menjëherë. Kësisoj ne do të tregoheshim mendjengushtë dhe të gjithë do të na merrnin për budallenj. Të gjitha gabimet burimin e kanë te nxitimi. Kur, në fakt, ne kemi edhe një fis të tërë nga pas, ndaj nuk do të ishte aspak e këndshme nëse ne do të bënim një marrëveshje me ty pa u këshilluar njëherë me ta më parë. Tani ti ik, edhe ne do të ikim; të mendohemi njëherë mirë e mirë të dyja palët, pastaj të vendosim."

Sikur të donte që në bisedë të merrte pjesë edhe ai, Muthenna bin Haritheja, tha:

- "Ja, ky është Muthennaja! Një ndër të parët tanë; është ai që i kontrollon të gjitha punët e luftës, kur na duhet të luftojmë."

- "O vëlla i Kurejshëve! Unë t'i dëgjova të gjitha ato që na the dhe që të gjitha i pëlqeva shumë, por edhe më habitën të gjitha sa na the. Unë kam të njëjtën përgjigje si ajo që të dha edhe Hani bin Kabisaja. Ne jemi një fis i vendosur mes dy burimesh kryesore të ujit. Njëri është Jemameja, ndërsa tjetri Semaueja.", – tha Muthennaja.

- "*Çfarë doni të thoni me këto dy burime?*", – ndërhyri me një pyetje i Dërguari i Allahut.

- "Njëri janë vendet e larta të tokave arabe, ndërsa tjetra fusha e persëve, ku shtrihen lumenjtë e Kisrës. Kur u vendosëm atje, Kisra na kërkoi që t'i premtonim se nuk do t'i nxirrnim shqetësime dhe se nuk do të strehonim vrasës, të cilët i kërkon shteti. Dhe kjo e vërtetë, në të cilën ti je duke na ftuar duhet të jetë diç që mbretërit nuk do ta honepsnin dot. Ndërsa, për sa u përket ngjarjeve që kanë ndodhur në tokat e arabëve, kushdo që i shkakton, falet, dhe i pranohet kërkesa për

t'u falur. Por ata që nxjerrin ngatërresa dhe ngjarje të papëlqyeshme në tokat e persëve nuk falen dhe nuk u pranohet asnjë justifikim. Me pak fjalë, nëse do që të të ndihmojmë në tokat arabe, ne kaq mund ta bëjmë!"

Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha atyre:

- "*Përgjigja që më dhatë nuk është e keqe, madje ju e shprehët shumë mirë të vërtetën, sepse, askush nuk mund t'i dalë dot zot fesë së Allahut, më mirë se sa ata që e kuptojnë më së miri atë.*" Mandej, e kapi Ebu Bekrin (radijallahu anhu) për krahu dhe u larguan që aty. Më vonë, ne mbërritëm pranë kuvendeve të Eusëve dhe Hazrexhëve. Ata e pranuan të Dërguarin e Allahut ende pa u larguar ne që andej. Aliu (radijallahu anhu) ka thënë:

- "Njerëzit e Eusit dhe të Hazrexhit ishin njerëz shumë të drejtë e të duruar."[55]

Profeti ynë fton në Islam fiset e Eusit dhe të Hazrexhëve

Aliu (radijallahu anhu), një ditë, teksa po fliste rreth ensarëve, epërsisë së tyre dhe shërbimeve të pashoqe që ata kishin dhënë në të shkuarën, pati thënë edhe këto fjalë:

"Kush nuk do ensarët dhe nuk përpiqet që të jetë sa më i denjë për ta, nuk mund të quhet besimtar i vërtetë. Për Zotin ata janë si ai mëzi i rritur me të gjithë kujdesin e nevojshëm dhe janë ata që, me shpatat, kuajt dhe me gjuhën e zhdërvjellët dhe bujarinë e tyre, e sollën Islamin deri në ditët e sotme. Unë ju betohem për Allahun, se Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dilte nëpër panaire dhe i ftonte fiset e ndryshme që të pranonin Islamin dhe shumë herë nuk qëllonte asnjë njeri i vetëm që ta pranonte e t'i besonte. Shkonte pranë fiseve të vendosura në Mexhene, Ukadh dhe Mina dhe ua përsëriste vazhdimisht ftesën e Tij, pa u bezdisur asnjëherë. Aq sa kishte grupe të atilla, që i thoshin: "Po mirë, o njeri, a ende nuk e ke humbur shpresën tek ne?" Derisa, më në fund, Allahu shprehu vendimin e Tij lidhur me këto dy fise dhe Profeti i profetëve shkoi pranë tyre për t'u shpallur fenë islame. Ata e pranuan menjëherë dhe e morën Profetin

[55]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/142.

dhe e strehuan, e morën nën mbrojtje dhe u kujdesën që ta ndihmonin me gjithçka që do të kishte nevojë. Allahu i shpërbleftë me të mirat më të mëdha ensarët. Ne shkuam pranë tyre dhe jetuam në të njëjtat shtëpi me ta. Ata na pritën me një shpirt të pashoq sakrifice, duke na zgjedhur ne në vend të dëshirave të veta. Dukej sikur garonin me njëri-tjetrin, se kush do të shfaqte më shumë bujari ndaj nesh, madje, herë-herë, dukej sikur hidhnin edhe short për këtë gjë. Mandej ata filluan të pranonin me zemër të qetë, se më e shumta e pasurisë do të na takonte neve. Ata sakrifikuan deri edhe jetën, pa u menduar dy herë, për të Dërguarin e Allahut. Paqja dhe kujtimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Allahut dhe të gjithë ata."

E ëma e Sad bin Rabias, Umu Sadi (radijallahu anhuma) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur ishte në Mekë, i ftonte të gjitha fiset një e nga një, që ato të pranonin Islamin. U bënte thirrje drejt shpëtimit, por përballej veç me përbuzje, vuajtje dhe fyerje nga më të padurueshmet. Më në fund, Allahu i Madhërishëm zgjodhi që ta nderonte këtë fis të ensarëve dhe i Dërguari i Allahut mbërriti në Akabe për të folur me ta. Në atë kohë ata ishin të gjithë duke qethur flokët."

Sad bin Rabia tregon: "E pyeta nënën, kush ishin ata njerëz."

"Ishin rreth gjashtë a shtatë vetë. Tre prej tyre ishin nga fisi i Beni Nexharëve. Ata ishin Es'ad bin Zurareja dhe dy djemtë e Afrasë. (Nuk m'i tha emrat e të tjerëve.) Resulullahu u ul pranë këtij grupi dhe u bëri thirrje që t'i besonin Allahut të Shenjtë e të Gjithëfuqishëm, që është Një i Vetëm, duke u kënduar edhe pjesë nga Kur'ani. Kjo është Akabeja e parë. Akabeja e dytë ka ndodhur kohë më vonë."

Iu drejtova nënës dhe e pyeta:

- "Sa kohë ndenji Resulullahu në Mekë?"

- "A nuk e dëgjove se çfarë tha Ebu Sirma Kajs bin Ebi Enesi?", – më tha.

- "Nuk e di çfarë tha.", – iu përgjigja unë.

Aty Ebu Sirma nisi të lexonte këtë varg:

"Në mes të Kurejshëve, më se dhjetë vite ai ndenji

Të drejtën i tregoi, sa herë që një mik besnik e gjeti."[56]

Zuhri tregon: Kur idhujtarët e shtuan edhe më shumë valën e padrejtësive ndaj Profeti tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i Dërguari i Allahut shkoi te xhaxhai i Tij, Abas bin Abdulmutalibi, dhe i tha:

- "*Xhaxha, Allahu, që është i Shenjtë dhe i Gjithëfuqishëm, do ta ndihmojë fenë e Tij me një popull të atillë, që ai popull do ta ketë shumë të lehtë që t'i tërheqë me hundë përdhe të gjithë Kurejshët. Hajde të shkojmë në panairin që mbahet në Ukadh, më trego për vendet ku janë vendosur fiset arabe, e unë t'i ftoj ato që t'i besojnë Allahut; t'u kërkoj atyre që të më mbështetin e të më mbrojnë derisa t'i kem shpallur mesazhet që më ka dërguar Allahu.*"

- "Mirë, nipi im.", - i tha Abbasi. – "Ti shko në Ukadh dhe unë me ty po vij, që të të tregoj vendet ku rrinë, ku janë vendosur fiset arabe."

I Dërguari i Allahut shkoi njëherë pranë fisit të Thekifit. Mandej shëtiti dhe i vizitoi të gjitha fiset e tjera një e nga një. Vitin tjetër – që është edhe viti kur atij iu ngarkua përgjegjësia që t'i ftojë haptazi njerëzit – ai u njoh me gjashtë njerëz që u përkisnin fiseve të Eusit dhe Hazrexhit. Ata quheshin Es'ad bin Zurare, Ebu'l-Hejthem bin Et-Tahijjan, Abdullah bin Reuaha, Sad bin Rabi, Numan bin Harithe dhe Ubade bin Samit. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) qe njohur me këtë grup pranë Xhemresë së Akabesë, në Mina, gjatë natës. U ul pranë tyre dhe u bëri thirrje për tek Allahu, që ta adhurojnë Atë, që ta ndihmonin dhe ta mbështetnin atë në fenë që Allahu ka dërguar nëpërmjet profetëve dhe të dërguarve. Dhe ata i kërkuan që t'u lexonte ndonjë pjesë nga ajo që Zoti i kishte zbritur. Kësisoj, Resulullahu nisi të lexonte prej sures Ibrahim, duke filluar nga ajeti i tridhjetepestë:

"(Kujtoje) **kur Ibrahimi tha: 'O Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet** [Mekën] **dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve! O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz nga rruga e drejtë. Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë. O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit tanë, në një luginë që nuk mbillet, afër shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim**

[56]. El-Hakim, *Mustedrek,* 2/683 (4255).

që ata të të falënderojnë. O Zoti ynë, Ti e di vërtet çfarë fshehim e çfarë shfaqim haptazi. Allahut nuk i fshihet asgjë as në Tokë, as në Qiell. Qoftë lavdëruar Allahu, i Cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is'hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet! O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet! O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën kur do të jepet llogari!' Mos mendo kurrsesi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) **deri në Ditën kur sytë e tyre do të zgurdullohen** (nga tmerret që do të shohin)**, dhe, duke vrapuar, me kokë lart, nuk do të mund t'i lëvizin sytë, ndërsa zemrat e tyre do të jenë të zbrazëta** (nga tmerri)**. Ti** (o Muhamed) **paralajmëroji njerëzit për Ditën që atyre do t'u vijë dënimi e keqbërësit do të thonë: 'O Zoti ynë, na lër edhe për pak kohë! Ne do t'i përgjigjemi thirrjes Tënde dhe do t'i pasojmë të Dërguarit!' Por, atyre do t'u thuhet: 'Vallë, a nuk betoheshit më parë se nuk do të kishte zhdukje për ju? Ju banuat në vendbanimet e atyre që e kishin ngarkuar veten me gjynahe dhe e kishit të qartë se si kishim vepruar me ta. Dhe Ne ju kishim treguar shumë shembuj.' Ata kurdisin dredhitë e tyre, por Allahu i di dredhitë e tyre. Edhe sikur prej dredhive të tyre të shembeshin malet, ata nuk do t'ia dalin mbanë. As mos mendo se Allahu nuk do t'ua mbajë premtimin e Vet të dërguarve. Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim. Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjyesit Allah. Dhe atë ditë do t'i shohësh keqbërësit të lidhur në pranga; rrobat do t'i kenë prej katrani e zjarri do t'ua mbështjellë fytyrat,** (Kështu do të jetë) **në mënyrë që Allahu të shpërblejë cilindo për atë që ka punuar. Allahu është vërtet i shpejtë në llogari. Ky** (Kur'an) **është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i Vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!**" (Ibrahim, 14/35-52).

Ata u tronditën kur i dëgjuan këto që po thoshte i Dërguari i Allahut dhe e pranuan menjëherë ftesën që Ai ua kishte bërë vetëm pak minuta më parë. Teksa Resulullahu po fliste me ta, aty pranë kaloi edhe xhaxhai i tij, Abasi, i cili e njohu menjëherë nga zëri nipin e tij.

- "Kush janë këta njerëz, që janë me ty?", – e pyeti ai Profetin tonë.

- "*O xhaxha, këta janë prej Eusëve dhe Hazrexhëve, qytetarë të Medinës. I ftova ata tek e njëjta gjë, ku kam ftuar edhe gjithë fiset e tjera arabe dhe ata më pranuan, madje po më thonë se do të më marrin me vete për në tokat e tyre.*"

Abasi (radijallahu anhu) zbriti nga kafsha ku kishte hipur dhe u foli:

- "O Eusë dhe Hazrexhë, ky është nipi im! Ky është njeriu që unë dua më shumë në familje. Ju e pranuat, i besuat Atij, madje edhe i keni dhënë fjalën se do ta merrni me vete, por më parë duhet të më jepni mua fjalën se nuk do t'i bëni keq dhe nuk do të lejoni askënd që ta mashtrojë atë. Të gjithë fqinjët tuaj janë hebrenj dhe ju e dini mjaft mirë se sa e hidhur është armiqësia e tyre. Nuk ndihem edhe aq i sigurt për të, sepse ata mund t'i ngrenë ndonjë kurth."

Es'ad bin Zurare (radijallahu anhu), i cili u kthye në një njeri të tërbuar nga fjalët plot mosbesim që Abasi (radijallahu anhu) u kish thënë atij dhe shokëve të tij, u hodh menjëherë dhe tha:

- "O i Dërguari i Allahut! Më lejoni, që, pa ju fyer ju dhe pa thënë ndonjë gjë të pahijshme, që nuk do t'ju pëlqejë, t'i kthejmë përgjigje këtij njeriu e t'i tregojmë se ne të kemi pranuar dhe të kemi besuar të gjithë!"

- "*Po mirë, mund t'i ktheni përgjigje pa bërë askënd të ndihet keq.*", – tha i Dërguari i Allahut. Ndërkaq, Es'ad bin Zurare e ktheu kokën drejt Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), duke thënë:

- "O i Dërguari i Allahut, çdo thirrje ka edhe anën e butë, edhe anën e ashpër, sido që të jetë. Ti sot po i fton njerëzit rreth një kauze shumë të vështirë e që po aq të shumta i ka edhe mundimet. Ti na kërkove që të braktisim fenë tonë dhe t'i bindemi fesë që tënde. Kjo është një kërkesë mjaft e vështirë; megjithatë, ne t'u bindëm ty pa të kundërshtuar. Ti na the se do të na duhet t'i shkëpusim lidhjet me shumë fqinj e kushërinj, të afërt, apo të largët, pak rëndësi ka. Edhe këtë kërkesë kaq të vështirë për ne ta pranuam. Ndërkohë që ne jemi njerëz të fuqishëm edhe atje ku jetojmë, në një vend që askush nuk guxon të na kanoset, ti na kërkove që ne të vëmë mbi krye një njeri që e kanë përzënë edhe xhaxhallarët e vet. Po ende, megjithëse edhe kjo është diçka shumë e zorshme për ne, ne edhe për këtë të thamë se do ta bëjmë. Asnjë nga këto nuk do t'u pëlqejë njerëzve. Këto mund t'i

pëlqejnë vetëm ata, për të Cilët Allahu ka vendosur që të shndërrohen në krijesa të përkryera dhe ka uruar që të kenë një fund të pëlqyeshëm. Por, ne t'u bindëm, duke të besuar me gjuhë, me zemër dhe me duar e me këmbë, sepse e kuptuam se ç'vend ka në zemër kjo e vërtetë që ti e ndave me ne. Ne të japim besën në të gjitha këto që ti na ftove, e po të shprehim lidhjen tonë të fortë si ndaj Zotit tënd, ashtu edhe ndaj Zotit tonë. Mbi duart tona le të jetë dora e Zotit! Gjaku ynë qoftë i bashkuar në gjakun tënd, e duart tona le të jenë edhe duart e tua. Ty do të të mbrojmë ashtu siç mbrojmë edhe jetën, fëmijët dhe gratë tona. Dhe, këtë fjalë do ta mbajmë, sepse duam të jemi besëplotë përpara Zotit. Nëse nuk e mbajmë, atëherë ne do të kemi tradhtuar Zotin tonë. Kësisoj, për ne vështirë të ketë fat më të kobshëm. O i Dërguari i Allahut, ja, po të japim dorën e besës! I Vetmi, tek i Cili mund të kërkojmë ndihmë, kur jemi në vështirësi, nuk mund të jetë vetëm se Allahu."

Pasi i mbaroi së thëni këto fjalë, Es'ad bin Zurare (radijallahu anhu) u kthye nga Abas bin Abdulmutalibi dhe i tha:

- "O ti njeri që kërkon të hahesh me fjalë me ne në praninë e një Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem)! Ti po na thua, se qëllimin e vërtetë vetëm Zoti mund ta dijë, se i Dërguari i Allahut është nipi yt dhe se ti e do atë më shumë se çdokënd tjetër. Ne i shkëputëm marrëdhëniet me të gjithë ç'kishim e ku i kishim, kushërinj të afërm, apo të largët. Dëshmojmë se ai është Profeti i Zotit. Atë e ka dërguar vetë Allahu nga lartësitë e paimagjinueshme të Tij. Ai nuk mund të jetë kurrsesi një gënjeshtar. As fjalët që thotë nuk i ngjajnë fjalëve të askujt tjetër. Na the se, nëse nuk merr një garanci prej nesh, nuk do të ndihesh mirë. Ti po na kërkon një garanci, që, për të Dërguarin e Allahut ne mund t'ia japim gjithkujt, po të na e kërkojë, ndaj mund ta quash se ke marrë çdo lloj garancie nga ana jonë!"

Pastaj, u kthye kah Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe vazhdoi fjalën duke thënë:

- "O Resulullah, na kërko ç'të duash për veten tënde dhe na vendos çfarëdo kushti që të duash në emër të Allahut, sepse ne na pëlqen çdo urdhër yti!"[57]

[57]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/533 (1525).

6. PROFETI YNË FTON NJERËZIT NË ISLAM DUKE SHËTITUR RRUGË MË RRUGË E PAZAR MË PAZAR

Rabia bin Ubadi ka thënë: Gjatë kohës së injorancës, e pashë njëherë të Dërguarin e Allahut në pazarin e Dhul-Mexhazit, teksa u thoshte njerëzve:

- "*O njerëz! Thoni 'La ilahe il'lallah', që të mund të shpëtoni.*" Dhe njerëzit e mbledhur përreth tij sa vinin e shtoheshin edhe më shumë. Nga pas i vinte një burrë me dy gërsheta të bukura, me sytë pak me defekt, por fytyrën të shndritshme, që i vinte nga pas dhe thoshte:

- "Ai është një gënjeshtar, që ka braktisur fenë e të parëve të tij!" Pyeta, se kush ishte ky njeri: "Më thanë, ky është xhaxhai i Tij, Ebu Lehebi."[58]

Në një tjetër transmetim të këtij hadithi, ka edhe një informacion tjetër, që është i rëndësishëm: "I Dërguari i Allahut i ikte Ebu Lehebit, ndërsa ky gjente çdo mundësi për ta ndjekur nga pas." Ndërsa, një tjetër transmetues e paraqet asisoj, që, në të mund të gjejmë edhe këtë shprehje: "Rreth të Dërguarit të Allahut ishin mbledhur aq shumë njerëz, saqë dukej sikur do të shkelnin njëri-tjetrin. Nuk kisha parë ndonjëherë një njeri që të fliste kaq bukur pa e ndërprerë fjalën."[59]

Tarik bin Abdullahu rrëfen: "Një ditë, teksa gjendesha në pazarin e Dhul-Mexhazit, pashë një burrë të veshur me një triko të kuqe, i cili po fliste: "*O njerëz! Thoni 'La ilahe il'lallah', që të arrini shpëtimin.*" Nga pas i rrinte një burrë, i cili i kishte këmbët dhe gjunjët të mbuluar nga gjaku. Ai u thoshte njerëzve: "O popull! Ai gënjen, mos ia vini veshin." Shkova dhe e pyeta, se përse thoshte kështu: "Ai është një djalosh nga bijtë e Hashimit; pretendon se është profet i Allahut, ndërsa ai tjetri është xhaxhai i tij, Ebu Lehebi, rob i idhullit të Uzas."[60]

Një burrë nga fisi i Malik bin Kinanes tregon: "Në tregun e Dhul-Mexhazit pashë të Dërguarin e Allahut, i cili shëtiste nëpër të dhe thoshte këto fjalë: "*O njerëz! Thoni 'La ilahe il'lallah', që të arrini shpëtimin.*" Ndërkohë, Ebu Xhehli e godiste me grushte balte dhe thoshte:

---

[58]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/41.
[59]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/20 (9834).
[60]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/20 (9835).

- "Ky njeri kërkon që t'ju largojë prej fesë suaj! Kërkon që t'ju shthurë! Ai po ju kërkon të braktisni zotat tuaj, zotat e Latit dhe të Uzas!" Ndërkohë, i Dërguari i Allahut as që i kthente fare sytë nga ai."

Transmetuesi thotë: Unë i kërkova atij njeriu që të ma përshkruante njëherë të Dërguarin e Allahut. Ai më tha: "Ai është një me trup mesatar, por të mbushur, që vesh një triko të kuqe; fytyrën e ka të bukur, flokët shumë të zinj e të dendur, ndërsa lëkurën e ka të bardhë."[61]

7. PROFETI YNË FTON TË AFËRMIT E TIJ NË ISLAM

Profeti ynë i fton të afërmit e tij në një gosti, për t'u bërë atyre thirrje që të pranojnë fenë e Islamit

Në një transmetim që vjen prej Aliut (radijallahu anhu) thuhet: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i ftoi të gjithë bijtë e Abdulmutalibit në një gosti. Bëheshin diku te dhjetë vetë. Secili prej tyre mund të hante deri në një qengj të pjekur më vete dhe mund të pinin më shumë se shtatë-tetë litra çdonjëri. Ndërsa i Dërguari i Allahut kishte gatuar vetëm një tenxhere me ushqim për të gjithë. Hëngrën të gjithë, derisa u ngopën. Ndërkohë, ushqimi ishte ende në tenxhere, sikur të mos ishte zënë fare me dorë. Në fund, i Dërguari i Allahut kërkoi diçka për të pirë në një gotë të vogël. Piu prej saj, derisa shoi etjen. Prapëseprapë, pija ishte ende në gotë, sikur të mos kishte pirë asgjë. Paskëtaj, i Dërguari i Allahut tha:

- "*O bijtë e Abdulmutalibit! Zoti më ka dërguar mua si profet, si për ju, ashtu edhe për mbarë njerëzimin. Këtu ju i patë vetë edhe mrekullitë e begatisë së Allahut* (xhel'le xhelaluhu). *Kush nga ju do të më japë besën, se do të jetë edhe vëlla edhe shok me mua?*"

Asnjë nuk u ngrit në këmbë. Megjithëse unë isha më i vogli, u ngrita unë.

- "Ti ulu.", – më tha mua i Dërguari i Allahut. Mandej e përsëriti edhe plot tri herë të tjera pyetjen.

[61]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/139.

Çdo herë i vetmi që ngrihej isha unë, ndërsa Ai më thoshte të ulesha. Herën e fundit, nuk më tha gjë, por e vuri dorën time pranë dorës së tij dhe e pranoi besëlidhjen."[62]

8. PROFETI YNË I FTON NJERËZIT NË ISLAM GJATË UDHËTIMEVE

Profeti ynë fton në Islam një beduin

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Gjatë një udhëtimi ne ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut. Rrugës u përballëm me një beduin. Kur iu afrua, i Dërguari i Allahut e pyeti atë njeri se ku po shkonte. Beduini iu përgjigj: - "Jam duke shkuar për te familja ime."

- "*A do që të bësh një të mirë?*", – e pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Çfarë të mire?", – u përgjigj beduini.

- "*A mund të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, se Ai nuk ka as shok, as ortak në krijim dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij?*"

- "Po ti, a ke ndonjë provë se fjalët e tua janë të vërteta?"

- "*Ja, kjo pemë, edhe ajo ka për të dëshmuar se unë po të them të vërtetën.*"

I Dërguari i Allahut e thirri atë pemë, e cila gjendej në anën e djathtë të luginës. Pema lëvizi nga vendi dhe qëndroi përpara të Dërguarit Fisnik të Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Resulullahu e bëri që të dëshmonte për vërtetësinë e profetësisë së tij për tri herë me radhë atë pemë. Kësisoj, pema dëshmoi për të Dërguarin e Allahut, se ai po thoshte të vërtetën dhe u kthye prapë te vendi i saj. Ai beduin, teksa po kthehej për te familja e tij, po thoshte këto fjalë: "Nëse do të ma dëgjojnë, unë do t'i sjell të gjithë tek ti. Nëse nuk më dëgjojnë, atëherë unë do të vij tek ti i vetëm, e të qëndroj këtu bashkë me ty."[63]

---

[62]. Ibn Kethir, *Tefsir,* 3/350.
[63]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 6/125.

9. PROFETI YNË UDHËTONTE NË KËMBË, QË TË MUND T'U FLISTE DHE T'I FTONTE NË ISLAM TË GJITHË NJERËZIT QË TAKONTE GJATË RRUGËS

Kur shkoi në Taif në këmbë

Abdullah bin Xhaferi (radijallahu anhu) ja se çfarë na tregon: "Kur vdiq Ebu Talibi, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkoi në Taif në këmbë. I ftoi banorët e Taifit në Islam, mirëpo, asnjë prej tyre nuk ia pranoi ftesën. Nuk kishte ç'të bënte, ndaj u kthye sërish pas. Qëndroi nën hijen e një peme për të pushuar, fali dy rekate namaz dhe gjendjen që e kishte kapluar ia shprehu Allahut duke u lutur me këto fjalë:

"*O Zot! Unë vetëm Ty mund të ta shpreh e të të ankohem, që ndihem kaq i dobët dhe jam aq i pafuqishëm për t'i bindur njerëzit.*

O Zoti im, që je më i Mëshirshmi i të gjithë të mëshirshmëve! Vetëm Ti je Erhamu'r-Rahimin! Në duart e kujt do të më lësh mua? Do të më lësh në duart e armiqve, që më trajtojnë aq keq, apo do të më lësh në duart e të afërmve të mi që e drejtojnë atë vend?

O Zot! Mjafton që Ti të mos jesh i mërzitur me mua, pa nuk ka asgjë tjetër që mund të më shqetësojë. Falja jote është kaq e pakufishme e kaq e gjerë.

O Zot! Unë nuk mund të strehohem, për të kërkuar ndihmë, vetëm se tek Ti, që i fal dritën errësirës dhe i mban në një rend e harmoni të përsosur gjithë trupat e kësaj gjithësie, nga frika që kam se Ti mund të jesh i pakënaqur me mua.

O Zoti im! Unë të lutem e të përgjërohem, falma mua faljen Tënde derisa të jesh i kënaqur me mua. Nuk ka asnjë forcë e asnjë fuqi, që të jetë e pavarur prej Teje, sepse prej Teje buron e tërë forca e fuqia."[64]

10. FTESA NË ISLAM NËPËR FUSHËBETEJA

Profeti ynë nuk ka luftuar me askënd, pa e ftuar njëherë në Islam

Ibni Abbasi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk ka luftuar me asnjë grup njerëzish

[64]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/37 (9851).

pa i thirrur e ftuar njëherë me të mirë që të pranojnë fenë e Islamit."[65]

Urdhri që Profeti ynë u pati dhënë të gjithë taborëve para se të niseshin për luftë

Abdurrahman bin Aidhi (radijallahu anhu) transmeton: "Sa herë që Resulullahu dërgonte ndonjë ekspeditë në ndonjë vend, i porosiste njëherë duke u thënë: '*Silluni mirë me njerëzit dhe mos sulmoni askënd pa u folur njëherë për Islamin. Në asnjë vend të rruzullit tokësor, apo në territoret e pabanuara, nuk ka gjë më të pëlqyeshme e që të më kënaqë mua më shumë se sa të gjeni një grup njerëzish që do të pranojë Islamin, të cilët do të vijnë këtu tek unë me ju si mysliman, se sa të merrni peng burra, gra e fëmijë, apo t'ua vrisni burrat.*'"[66]

11. PROFETI YNË CAKTON MËSUES, QË TË SHKONIN NËPËR QYTEZA TË NDRYSHME DHE T'U MËSONIN NJERËZVE ISLAMIN

Në Medinë dërgon Musab bin Umejrin

Uruetu bin Zubejri (radijallahu anhu) tregon: "Kur ensarët u bindën, me mendje dhe me zemër, për të gjitha të vërtetat ku i kishte ftuar i Dërguari i Allahut, pasi i kishin dëgjuar me vëmendje të gjitha fjalët e tij, besuan dhe i shprehën besën e plotë që mund të kishte tek ata. (Siç u trajtua edhe më parë, ata gjashtë njerëz që u takuan me të Dërguarin e Allahut në Akabenë e Parë, e që u kthyen për në Medinë me premtimin se do të ktheheshin sërish vitin e ardhshëm, për të kryer detyrimin e Haxhit; ky kthim në Medinë u shndërrua në një të mirë shumë të madhe për ata njerëz.) Po, ata gjashtë njerëz i patën dërguar lajm të Dërguarit të Allahut, ku i thoshin:

- "Na dërgo një njeri nga ata që ke pranë vetes, që t'i ftojë njerëzit, t'i binden Librit të Allahut. Kjo ka për të ndihmuar që njerëzit të njihen më shpejt me Librin." Ata që e prunë këtë lajm, sipas transmetimit, ishin Muadh bin Afra dhe Rafi bin Maliku.

Pas kësaj kërkese i Dërguari i Allahut dërgoi atje Musab bin Umejrin,

[65]. Darimi, *Sunen,* 2/286 (2444).
[66]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/758 (11300).

që ishte vëlla me bijtë e Abdudarit. Në Medinë Musabi qëndroi në shtëpinë e Es'ad bin Zurares (radijallahu anhu), i cili i përkiste fisit të Beni Ganemit. Bisedonte me ta dhe u lexonte vazhdimisht pjesë të Kur'anit. Bijtë e Nexharit nisën të ushtronin trysni mbi Es'ad bin Zuraren, e, kështu, ata u detyruan që ta largonin Musabin nga shtëpia e tyre. Atëherë Musabi u zhvendos në shtëpinë e Sad bin Muadhit. Ai e ndihmoi shumë shpirtërisht, duke i thirrur njerëzit vazhdimisht për te feja e vërtetë e Allahut. Nëpërmjet tij Allahu po i udhëzonte një e nga një të gjithë ensarët, aq sa në tërë shtëpitë e ensarëve vetëm shumë pak shtëpi kishin mbetur pa pranuar fenë islame. Me Islamin qe nderuar edhe Amr bin Xhemuhu dhe i gjithë besimi që ai kishte pasur tek idhujt i ishte zhbërë. Musab bin Umejri (radijallahu anhu) u kthye pranë të Dërguarit të Allahut dhe paskëtaj Musabi nisi të thirrej me emrin "Mukri", që do të thotë "Mësues i Kur'anit."[67]

Profeti ynë cakton mësues për vendasit, Ebu Umamen

Ebu Umameja (radijallahu anhu) tregon: "I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi mua, që t'i ftoja njerëzit në fenë e Islamit dhe t'u shpallja atyre shtyllat dhe kushtet e besimit. Kur shkova pranë tyre, ata kishin çuar devetë për të pirë ujë dhe qumështin ua kishin pirë. Kur më panë, thanë:

- "Përshëndetje, Sudaj bin Axhlan! Kemi dëgjuar se edhe ti e ke braktisur fenë dhe ke kaluar në anën e atij njeriu."

- "Jo, unë kam besuar tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij. Resulullahu më ka dërguar që t'ju flas për Islamin dhe urdhëresat e tij.", – u përgjigja unë.

Pastaj, ata shtruan pjata plot me gjak dhe filluan të mblidheshin rreth njëri-tjetrit, për të ngrënë. Më thanë edhe mua:

- "Eja të hash, Sudaj!"

- "Turp t'ju vijë! Unë vij tek ju prej Profetit që e ka shpallur të ndaluar këtë që po hani, sepse e lejuar (hallall), për t'u ngrënë, nuk mund të jetë veçse ajo që është prerë, duke u përmendur emri i

[67]. Ibnu'l-Xheuzi, *Sifetu's-Safue,* 1/391.

Allahut."

- "E ç'na paskësh thënë kështu ai njeri?", – pyetën ata.

- Atij i është zbritur një ajet lidhur me këtë çështje: "**Është e ndaluar për ju ngrënia e cofëtinës, e gjakut, e mishit të derrit, e mishit të kafshës që është therur jo në emër të Allahut, e mishit të kafshës së mbytur në fyt, e mishit të kafshës që është rrahur dhe ka ngordhur, e mishit të kafshës që është vrarë nga rrëzimi, apo nga brirët e kafshëve të tjera, e mishit të asaj që është kafshuar nga egërsirat e tjera – përveç atyre që i therni ju para se të ngordhin. Gjithashtu, është e ndaluar për ju edhe ngrënia e mishit të kafshëve që janë therur për nder të idhujve, apo për të kërkuar fatin në fall. Të gjitha këto që u përmendën, janë gjynah. Sot, dëshpërohen ata që nuk besojnë dhe kanë humbur çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje! Sot, jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj. Por kushdo që është i shtrënguar nga uria** (dhe ha çfarë është e ndaluar)**, pa pasur qëllim të bëjë gjynah, do ta shohë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.**" (Maide, 5/3)

Unë nisa t'i ftoja ata të pranonin Islamin, mirëpo, se ç'kish diçka që i bënte të ngurronin.

- "Turp t'ju vijë! Më jepni të paktën një gllënjkë ujë, të pi, se po digjem nga etja!" – u thashë.

- "Nuk kemi për të të dhënë ujë, por do të lëmë të vdesësh, kështu, nga etja!"

Me vete kisha edhe çallmën, të cilën e lidha rreth kokës dhe dola, por më kishte zënë gjumi dhe kur u zgjova e gjeta veten të shtrirë mbi rërën përvëluese. Në gjumë erdhi dikush e më dha diçka për të pirë. Ishte një pije, shijen e së cilës nuk e kisha provuar asnjëherë më parë. Ai ma dha atë pije dhe unë e piva; kur e mbarova më doli gjumi. Vërtet, pasi piva atë pije, mua nuk më zuri më asnjëherë etja."[68]

[68]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 8/279 (8074).

12. FTESË PËR TË PËRMBUSHUR PARIMET KRYESORE TË ISLAMIT

Profeti ynë e fton Xheririn, të besojë në Islam dhe të përmbushë detyrimet e fesë

Xherir bin Abdullahu (radijallahu anhu) tregon: "Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi lajm se donte që të shkoja pranë tij. Kur shkova, Ai më pyeti:

- "*Për çfarë ke ardhur, o Xherir?*"

- "O i Dërguari i Allahut! Unë kam ardhur këtu për të të thënë se dua të bëhem mysliman."

Ai më hodhi në shpinë një rrobë dhe pastaj u kthye nga sahabët dhe u tha:

- "*Kur t'ju vijë ndonjë prej parisë së njerëzve, qeraseni atë me gjënë më të mirë që ju gjendet.*" Ndërkaq, pas pak çastesh, u drejtua nga unë dhe më tha:

- "*Xherir, të ftoj që të dëshmosh se nuk ka zot tjetër pos Allahut, se unë jam i Dërguari i Allahut, si dhe të besosh tek Allahu, te Dita e Gjykimit dhe Kaderi, e t'i falësh të gjitha namazet e detyruara e ta japësh zekatin.*"

Unë pranova menjëherë, duke i dhënë fjalën se do t'i bëja të gjitha ato që më tha. Pas atij çasti, sa herë që qëlloja të isha ballë për ballë me të Dërguarin e Allahut, ai më buzëqeshte."[69]

Porosia e Profetit tonë për Muadh bin Xhebelin në lidhje me këtë çështje

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur e pati dërguar Muadh bin Xhebelin (radijallahu anhu) si vali në Jemen, e pati urdhëruar me këto fjalë:

- "*O Muadh! Ti po shkon pranë një populli ku të gjithë janë njerëz të librit. Kur të shkosh atje, ftoji njerëzit që të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër, veç Allahut, që meriton të adhurohet, si edhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Nëse ata i pranojnë të dyja këto dëshmi, duke t'u bindur, atëherë bëju të ditur se Allahu u ka urdhëruar robërve të Tij që të falin pesë namaze në ditë, çdo ditë,*

[69]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/78.

nga mëngjesi në mbrëmje. Nëse e pranojnë edhe këtë, atëherë thuaju edhe se Allahu ua ka shpallur detyrim, që një pjesë të pasurisë së tyre ta japin si zekat për më të varfrit. Nëse do të të binden edhe në këtë pikë, atëherë ngurro që të marrësh prej tyre më të mirat e mallrave të tyre! Frikësoju lutjes së njeriut që i është bërë një e padrejtë, sepse mes lutjes së njeriut që ka rënë pre e padrejtësisë dhe Allahut nuk ka asnjë pengesë."[70]

Profeti ynë i bën thirrje Hausheb Dhi-Zulejmit që të përmbushë detyrimet e caktuara prej Allahut

Hausheb Dhi-Dhulejmi na rrëfen: "Kur Allahu i Madhërishëm e nxori ngadhënjimtar Muhamedin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), unë dërgova plot dyzet kalorës nën komandën e Abdi-Sherrit. Kur lajmësit e mi mbërritën në Medinë, bashkë me letrën që unë kisha dërguar për të Dërguarin e Allahut, Abdi-Sherri thirri: "Kush është Muhamedi nga ju?"

- "Ky është.", – më treguan me dorë.

- "Çfarë ke prurë ti? Nëse ajo që ti na ke prurë është diçka e mirë dhe e vërtetë, atëherë ne do të bindemi."

- "*Do të falni namazin, do të jepni zekatin, nuk do të derdhni gjak njeriu, do të urdhëroni për të mirë dhe do ta ndaloni kryerjen e së keqes.*", – tha.

- "Epo, qenkan të mrekullueshme këto mësime që ti na ke sjellë! Zgjate dorën të të shprehim besëlidhjen."

- "*Po ty, si të quajnë?*", – e pyeti Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

- "Abdi-Sherr!", – u përgjigj ai.

- "*Përkundrazi, ti duhet të quhesh Abdi-Hair.*", – tha i Dërguari i Allahut.

Ai që e transmeton këtë ndodhi thotë se ky njeri i besoi të Dërguarit të Allahut dhe i shprehu Atij besën e plotë. Profeti ynë i dërgoi Hauxheb bin Dhi-Dhulejmit përgjigje me të, edhe Haushebi besoi në Allahun dhe të Dërguarin e Tij."[71]

---

[70]. Buhari, *Sahih,* 2/544.
[71]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/535 (1531).

Profeti ynë fton bashkësinë e Abdulkajsit, që të përmbushin detyrimet e caktuara prej Allahut (farzet)

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Kur erdhën mëkëmbësit e drejtuar prej Abdulkajsit te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ai u tha atyre:

- "*Mirë se keni ardhur! Inshaallah, ju nuk do të pendoheni që keni ardhur deri këtu; nuk ka për t'ju ndodhur asgjë e keqe.*"

- "O i Dërguari i Allahut, mes nesh dhe jush qëndron një grup idhujtarësh nga Mudari, ndaj vetëm gjatë muajve të ndaluar neve na jepet mundësia të vijmë tek ju. Prandaj edhe kemi ardhur, të na thuash ndonjë prej kumtesave të tua të bukura, që ne ta përmbushin, e të shkojmë në Xhenet, madje t'i ftojmë edhe të tjerët drejt asaj mirësie."

- "*Katër janë gjërat që unë po ju urdhëroj, katër janë gjërat që po jua ndaloj. Katër të parat janë këto; të jeni të palëkundur në besimin se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, të falni namazin, të jepni zekatin, të agjëroni gjatë muajit të Ramazanit dhe të jepni një të pestën e fitimeve nga plaçka e luftës për të varfrit. Dhe katër gjërat që jua ndaloj janë; shtambat e përbëra nga kungulli i ujit, bardakët prej balte dhe enët e lyera me zift e katran dhe çanakun e bërë prej rrënjës së hurmës* (enë të cilat jua ndaloj që t'i mbushni me shirën e rrushit, apo të hurmave). *Këto t'i mbani mend mirë dhe të mos i harroni, madje t'ua bëni edhe të tjerëve të ditura.*"[72]

Hadithi i Alkames për të vërtetën e besimit

Alkame bin Harithi (radijallahu anhu) tregon: "Gjashtë të tjerë nga familja jonë, e unë shtatë, erdhëm tek i Dërguari i Allahut. E përshëndetëm e na përshëndeti edhe ai ne. Biseduam me të dhe të gjitha sa i thamë atij i pëlqyen shumë. Ja se si u zhvillua ajo bisedë mes nesh:

- "*Të kujt jeni ju? Çfarë jeni ju?*", – na pyeti.

- "Ne jemi besimtarë!", – iu përgjigjëm ne.

- "Bukur, por çdo fjalë ka të vërtetën e saj; cila është e vërteta e

[72]. Muslim, *Sahih,* 1/46 (23).

besimit tuaj?"

- "Ajo është e përbërë nga pesëmbëdhjetë kritere. Asisoj, që pesë prej tyre na i ke urdhëruar ti, pesë të tjera na i kanë urdhëruar mëkëmbësit e tu, ndërsa pesë të tjera që i kemi fituar gjatë kohës së injorancës, e që sot janë pjesë e moralit tonë. Por, nëse ti na i ndalon edhe ato, atëherë kjo është tjetër gjë. Ne nuk i bindemi asgjëje tjetër, veç asaj që do të na urdhërosh ti."

- "*Cilat janë ato pesë gjërat që jua kam urdhëruar unë?*"

- "Ti na ke urdhëruar që t'i besojmë Allahut, engjëjve, librave, profetëve dhe të besojmë se e mira dhe e keqja ndodh me caktimin e Allahut."

- "*Po ato pesë kriteret që jua kanë urdhëruar mëkëmbësit e mi, cilat janë?*", – vazhdoi të pyeste i Dërguari i Allahut.

- "Mëkëmbësit e tu, na kanë urdhëruar që të pranojmë se nuk ka asnjë zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet, që të besojmë se Ai nuk mund të ketë as shok, as ortak në krijimin e gjithësisë, si dhe na kanë urdhëruar që të dëshmojmë se ti je robi dhe i Dërguari i Tij, të falim pesë kohët e namazit, të cilat janë shpallur si detyrim për të gjithë, të japim zekatin e caktuar, të agjërojmë gjatë muajit të Ramazanit dhe me aq sa të na jepen mundësitë, të vijmë e të vizitojmë Shtëpinë e Allahut (Bejtullahun).", – i thamë ne.

- "*Po ato pesë vese a huqe, që ju kanë mbetur qysh prej kohës së injorancës, cilat janë?*"

- "Të jemi falënderues kur kemi, të bëjmë durim ndaj fatkeqësive që na vijnë dhe të jemi besnikë kur përballemi me armiqtë, si dhe të mos kënaqemi as me fatkeqësinë qoftë edhe të armiqve."

Pasi i dëgjoi të gjitha një e nga një, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha: "*O njerëz të mirë, që i keni kuptuar gjërat kaq mirë e që dini edhe se si t'i shprehni ato me fjalë!.. Këta njerëz, duke i ndjekur me përpikëri të gjitha këto cilësi, thuajse i janë afruar horizontit të profetësisë!*", – dhe u buzëqeshi njëherë të gjithëve dhe tha këto fjalë: "*Unë do t'ju mësoj juve pesë cilësi, në mënyrë që Allahu t'jua përsosë krejtësisht të gjitha sjelljet tuaja: 'Mos mblidhni pasuri më shumë se sa mund të hani, mos ndërtoni shtëpi, në të cilën nuk do të jetoni, mos u përplasni me njëri-tjetrin për hir të interesit të kësaj bote, e*

cila, një ditë, do t'ju ikë e tëra nga duart, e frikësojuni dënimit të ashpër të Allahut, tek i Cili do të mblidheni të gjithë (atë ditë)*; më mirë për ju është që të ngarendni me dëshirë drejt atdheut të amshuar, ku edhe do të jetoni në përjetësi!"*"[73]

13. PROFETI YNË U DËRGON LETËR MBRETËRVE TË KOHËS PËR T'I FTUAR EDHE ATA NË ISLAM

Profeti ynë i nxit sahabët që të përhapin mesazhin e Islamit

Misuer bin Makhremeja (radijallahu anhu) tregon: "Një ditë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi pranë sahabëve dhe tha: "*Allahu i Madhërishëm më dërgoi Mua si mëshirë për mbarë njerëzimin. Atëherë – Zoti ju faltë – edhe ju ta kryeni detyrën e predikimit të Islamit në emrin tim. Mos u përplasni me njërit-tjetrin, siç pati ndodhur me apostujt e profetit Isa, sepse edhe profeti Isa u pati bërë thirrje apostujve të tij, njësoj siç po ju bëj edhe unë juve; mirëpo, ata nuk deshën të shkonin në toka të largëta. Isai, i biri i Merjemes, iu lut Allahut, duke ia shfaqur vetëm Atij tërë trishtimin që e pati kapluar si pasojë e kësaj sjelljeje. Dhe, në shumë pak kohë, secili prej apostujve kuptoi se dinte të fliste gjuhën e atij vendi ku do të shkonin për të shpallur fenë e Allahut. Atëherë Isai* (alejhis'selam) *tha: 'Kjo është, pa dyshim, një detyrë që Allahu kërkon që ta kryeni ju.'*" Atëherë, pasi i dëgjuan këto fjalë, sahabët thanë: "O i Dërguari i Allahut, edhe ne do ta kryejmë çdo detyrë që do të na e ngarkosh ti, ndaj ta dish se ti ne mund të na dërgosh ku të duash."

Kur mori këtë përgjigje nga sahabët e Tij, Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi Abdullah bin Hudhafen (radijallahu anhu) te Kisra; Selit bin Amrin (radijallahu anhu) te valiu i Jemames, Heuzeja; Ala bin Hadramin (radijallahu anhu) te valiu i Hexherit, Mundhir bin Sauij; Amr bin Asin (radijallahu anhu) te dy mbretërit e Mbretërisë së Omanit, dy djemtë e Xhulendiut, Xhejferi dhe Ubadi; Dihjetu'l-Kelbin (radijallahu anhu) te Kajseri; Shuxha bin Uehbin (radijallahu anhu), i cili ishte prej ensarëve, te Mundhir bin Harithi i Gassanive; dhe Amr bin Umejete ed-Damri (radijallahu anhu) te Nexhashiu. Të gjithë këta të dërguar, përveç Ala bin Hadramiut, u kthyen në Medinë para se i Dërguari i Allahut të ndërronte jetë. Vetëm Ala bin Hadremiu

[73]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/476 (1363).

gjendej në Bahrejn në kohën kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ndërroi jetë."[74]

Ibni Haxheri, në veprën e tij "*Fet'hu'l-Barî*", thotë se: "Historianët që janë marrë me jetën e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), për ta studiuar, kanë vërejtur se në mesin e emrave të sahabëve të dërguar si mëkëmbës prej tij, kanë qenë veçanërisht këta emra: "Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka dërguar te Harith bin Abdi Kulali Muhaxhir bin Ebi Umejjen (radijallahu anhu), te Dhul-Kelaja Xheririn (radijallahu anhu), te Musejlemeja Saibin (radijallahu anhu) dhe te Mukaukisi Hatib bin Ebi Beltean (radijallahu anhu)."[75]

Letra e Profetit tonë për Nexhashiun, mbretin e Abisinisë

Ibni Is'haku tregon: "Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati caktuar Amr bin Umejete ed-Damri (radijallahu anhu) për ta dërguar te Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, që të çonin një letër lidhur me gjendjen e Xhafer bin Ebi Talibit dhe shokëve të tij. Në letër shkruhej:

"*Bismil'lahir-Rahmani'r-Rahim! Kjo është një letër e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, për mbretin e Abisinisë, Nexhashi As'hamin. Përshëndetjet e Zotit qofshin me ty. Lëvduar dhe falënderuar qoftë Allahu, i Cili është zotëruesi më i mirë i cilësive 'Mbret(ërues), i Shenjtë, Besues dhe Mbrojtës Besnik'. Unë të dëshmoj se Isai (alejhis'selam) ishte një shpirt i dërguar prej Allahut, i cili erdhi si një fjalë e Tij, lënë amanet Merjemes, e cila ishte një grua e pastër, e dëlirë dhe shembull i ndershmërisë. Merjemja u zu në barrë me Isain. Allahu i Madhërishëm e frymoi shpirtin e frymën e tij njësoj siç pati krijuar edhe Ademin në fillim, me duart e Tij dhe ia pati frymuar frymën e shpirtin nga shpirti i Vet. Unë të ftoj që t'i besosh Allahut, që është Një dhe i Vetëm, e që nuk ka asnjë ortak në krijimin e gjithçkaje, t'u bindesh urdhrave të Tij, të më ndiqni mua dhe të më besoni, si mua, ashtu edhe atyre të vërtetave që kam sjellë unë. Nuk ka dyshim se unë jam i Dërguari i Allahut. Tek ti kam dërguar djalin e xhaxhait tim, Xhaferin, dhe disa besimtarë të tjerë, të cilët të kërkoj që t'i presësh mirë, e të ruhesh prej fanatizmit. Unë të ftoj, ty dhe ushtarët e tu, që të pranoni fenë e Allahut. Unë e kreva shpalljen time, e t'i kam dhënë të gjitha këshillat e nevojshme. Tani ju*

[74]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 20/8 (12).
[75]. Ibn Haxher, *Fet'hu'l-Bari,* 8/128.

takon juve, që të bëni atë që është më e mira dhe e duhura. Paqja e Allahut qoftë me ata që ndjekin rrugën e drejtë."[76]

Letra që Nexhashiu i dërgon Profetit tonë të nderuar

"Bismil'lahir-Rahmani'r-Rahim!

Kjo është një letër e Nexhashi As'hamit, i biri i Ebxherit, për të Dërguarin e Allahut, Muhamedin:

"O ti Profet i dërguar prej Zotit, të përshëndes nga larg me përshëndetjen e Zotit! Mbi ty qofshin mëshira dhe begatitë e Zotit! Nuk ka zot tjetër, veç Atij që më udhëzoi mua në Islam. O i Dërguari i Allahut! Letra që më kishe dërguar për Isain (alejhis'selam) mbërriti tek unë dhe e lexova. Të betohem për Zotin e tokës dhe të qiejve, se Isai nuk ka asnjë cilësi më shumë sesa ato me të cilat ti e kishe përshkruar në letrën tënde. Dëshmitarët e tu që na kishe dërguar, djalin e xhaxhait dhe të tjerët, i mirëpritëm. Unë dëshmoj përpara Allahut, se ti je i Dërguari i drejtë dhe i provuar i Allahut. Unë iu binda e lidha besën me ty e djalin e xhaxhait tënd. Në sajë të tij unë iu dorëzova Allahut, që është i vetmi Zot i botëve. O Profeti i Allahut! Së bashku me këtë letër po të dërgoj edhe tim bir, Berihanë. Unë nuk mund të dal garant për askënd, përveçse për pjesëtarët e familjes sime. Tek të tjerët nuk më ka vlerë fjala. Nëse do që të vij edhe unë tek ti, më thuaj dhe unë do të vij. O i Dërguari i Allahut! Unë dëshmoj dhe pranoj se çdo fjalë e jotja është e vërtetë dhe e drejtë."[77]

Letra e Profetit tonë për Kajserin, mbret i Bizantit

Dihjetul-Kelbi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dha një letër dhe më dërgoi për te Kajseri. Ashtu bëra, shkova pranë Kajserit dhe ia dorëzova letrën. Në atë kohë, pranë Kajserit qëndronte i ulur edhe djali i vëllait të tij, një njeri me fytyrë të kuqe, sytë bojëqielli dhe flokët fare të drejtë. Kur Kajseri nisi ta lexonte atë letër, e cila niste me fjalët: "*Kjo është një letër e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, për sundimtarin e Bizantit, Herakliun.*",

[76]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/83.
[77]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/83.

nipi i tij u pezmatua dhe tha: "Një letër e tillë nuk lexohet!"

- "Pse?", – e pyeti mbreti Kajser.

- "Sepse është nisur me emrin e tij, mandej është shkruar *sundimtari i Bizantit*; nuk shkruhet 'Mbreti i Bizantit"'.

- "Megjithatë, të ma lexosh!", – urdhëroi Kajseri.

Kur nisi të lexohej ajo letër, të gjithë të pranishmit dolën jashtë. Kajseri më mori pranë, dërgoi lajm që të thërrisnin edhe peshkopin, i cili erdhi menjëherë. Kur Kajseri i tregoi se si qëndronte puna dhe kërkoi që ajo letër t'i lexohej edhe njëherë, peshkopi tha: "Ky është ai njeri, të cilin kemi kohë që e kërkojmë, se mos ka ardhur, sihariqin për ardhjen e të cilit na e ka thënë edhe Isai."

- "Po mirë, ç'më këshillon të bëj?"

- "Unë e pranoj Atë dhe që sot e tutje do të jem një ndjekës i Tij.", – tha peshkopi.

- "Por, nëse unë veproj siç më thua ti, mua do të më dalë duarsh e gjithë mbretëria.", – ndërhyri mbreti Kajser.

Mandej ne u larguam së andejmi. Në atë kohë aty gjendej i pranishëm edhe Ebu Sufjani. Kajseri i dërgoi lajm Ebu Sufjanit që të vinte aty dhe kur ai erdhi, Kajseri i tha, nëpërmjet përkthyesit: "Më fol për atë njeriun e veçantë që është shfaqur në tokat tuaja, kush është ai njeri?"

- "Është një i ri në moshë.", – u përgjigj Ebu Sufjani.

Aty, mes tyre nisi një bashkëbisedim, të cilin po e paraqesim edhe këtu:

Kajseri: - "Në ç'lartësi është soji i tij në mesin tuaj, a janë ata njerëz të lartë?"

Ebu Sufjani: - "Për nga prejardhja, asnjë nga ne nuk është më i lartë se ai."

Kajseri: - "Ja, edhe kjo është një ndër shenjat e profetësisë. Po mirë, si qëndron e vërteta e kësaj pune?"

Ebu Sufjani: - "Ai është një njeri që nuk ka gënjyer kurrë në jetën e tij."

Kajseri: - "Edhe kjo është një nga tiparet emblemë të profetësisë! Po shumë mirë, a ka pasur në mesin tuaj njerëz, të cilët e kanë pranuar fenë e tij, pastaj janë kthyer sërish në fenë e të parëve tuaj?"

Ebu Sufjani: - "Jo, nuk ka pasur."

Kajseri: - "Edhe kjo shenjë e profetësisë është. A ka pasur ndonjëherë, kur është nisur për në luftë, bashkë me shokët e tij, dhe është kthyer i humbur?"

Ebu Sufjani: - "Të gjithë ata që kanë qenë kundër tij kanë luftuar me të. Ndonjëherë ka fituar ai, ndonjëherë kanë fituar kundërshtarët."

Kajseri: - "Edhe kjo, shenjë e profetësisë është."

Dihjeja (radijallahu anhu) thotë se: Kajseri më thirri mua më vonë dhe më tha që t'u thosha shokëve të mi, se ai e dinte që ai ishte një profet, por nuk mund ta braktiste mbretërinë."

Kurse, për sa i përket peshkopit; njerëzit vinin tek ai çdo të diel. Ai dilte përpara tyre dhe u fliste e i këshillonte, duke u dhënë edhe mësime të mira. Një të diel ai nuk doli përpara njerëzve. As të dielën tjetër nuk doli, por qëndroi në shtëpi. Ndërkohë unë shkoja vazhdimisht tek ai; fliste me mua dhe më bënte pyetje nga më të ndryshmet. Të dielën e radhës, të krishterët e pritën, por ai sërish nuk doli; u tha se ishte i sëmurë. Këtë e përsëriti edhe disa herë të tjera. Derisa, më në fund, e pyetën: "Ose do të dalësh përballë nesh, ose do të vijmë ne tek ti dhe do të të vrasim. Nuk na pëlqen fare gjendja jote që kur ka ardhur ky arabi." Pas gjithë asaj trysnie, peshkopi më dha një letër dhe më tha: "Merre këtë letër dhe çoja shokut tënd, duke e përshëndetur atë nga ana ime! Thuaji se unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër, veç Allahut, që meriton të adhurohet dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut; thuaji se i kam besuar, se e pranoj vërtetësinë e çdo fjale që thotë ai; shpjegoji se njerëzit kanë filluar të mos e pëlqejnë më gjendjen e sundimtarit të tyre, me pak fjalë, tregoji atij për të gjitha sa kanë ndodhur këtu." Dhe, sakaq, vetë doli në mesin e të krishterëve. Ata e vranë.[78]

Ashtu siç e transmeton Ibni Is'haku prej një dijetari të kohës,

[78]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 5/557 (9591).

Herakliu i kish thënë Dihjes:

- "Për Zotin unë e di shumë mirë, shoku yt është një profet i dërguar prej Allahut. Ai është ai njeri për cilësitë e të cilit flitet edhe në librin tonë dhe ne ardhjen e tij e kemi pritur për një kohë mjaft të gjatë. Mirëpo, unë kam frikë për sigurinë e jetës sime, pasi bizantinët mund të më bëjnë keq. Sikur të mos i druhesha kësaj, unë atij do t'i isha bindur menjëherë. Shko te peshkopi dhe foli atij për gjendjen e shokut tënd. Në mesin e bizantinëve ai është më i nderuar edhe sesa unë dhe fjala e tij ka më shumë peshë te njerëzit."

Pas kësaj, Dihjeja shkoi te peshkopi dhe e njoftoi për gjithë sa kishte ndodhur. Edhe ai i tha: "Për Zotin, shoku yt është një mëkëmbës i dërguar prej Allahut. Ne i dimë cilësitë dhe emrin e tij." Mandej, peshkopi hyri brenda, veshi një veshje në ngjyrë të bardhë dhe u kthye tek unë për të thënë fjalën e dëshmisë. Bizantinët, një të marrë vesh për të, erdhën dhe e vranë në vend.[79]

Ndërsa, sipas një tjetër transmetimi lidhur me këtë çështje, thuhet:

Tregon Said bin Ebi Rashidi: "Pashë lajmëtarin që Herakliu kishte dërguar për te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai ishte një fqinji im në Humus, i cili ishte aq i moshuar, sa mendoje se nga çasti në çast mund të vdiste. Shkova dhe e pyeta: "Mund të më tregosh, se çfarë shkruhej në letrat që Profeti ynë ka këmbyer me Herakliun?"

- "Po, t'i tregoj unë.", – më tha. – "I Dërguari i Allahut pati ardhur në Tebuk. Aty dërgoi Dihjetul-Kelbin për te Herakliu. Kur i erdhi letra prej Resulullahut, Herakliu i thirri të gjithë, peshkopët dhe murgjit bizantinë. Pati mbyllur të gjitha portat dhe pati nisur t'u fliste:

"Ai njeri (duke pasur parasysh të Dërguarin e Allahut) ka ardhur, ashtu siç e keni lexuar edhe ju. Më ka dërguar lajm dhe më fton që të zgjedh mes tri mundësive: Ose t'i bindem fesë së tij, ose t'i japim atij një pjesë të mallrave që prodhojnë tokat tona si taksa, ose të zgjedhim e të luftojmë me të. Për Zotin, ne e dimë shumë mirë, se kur ai të vijë, edhe këto toka do të merren e do t'i takojnë atij një ditë. Si thoni, të bëhemi ndjekës të fesë së tij, apo t'i japim prej prodhimeve tona

[79]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/216.

pjesën që na kërkon." Të gjithë ata që ishin të pranishëm, mrrolën njëherë buzë e vetulla, hoqën mbulesat e shërbimit që mbanin në krye dhe thanë: "Çfarë po na thua, që të pranojmë se ti do të braktisësh Krishterimin, e do të bëhesh skllavi i një beduini që na vjen nga shkretëtira?"

Kur ata u larguan, Herakliu, i shqetësuar se ata do të nxitnin të gjithë popullin kundër tij, e ndjeu se herët a vonë ata edhe sundimin do t'ia merrnin nga duart: "Unë çfarë ju thashë, jua thashë të gjitha për të provuar besnikërinë dhe lidhjen e fortë që keni ju me fenë tuaj."

Mandej, Herakliu thirri një prijës të arabëve të krishterë, që i përkiste familjes së Tuxhibëve, e i tha: "Më thirr dikë që e njeh shumë mirë gjuhën e arabëve, që ta ketë kujtesën shumë të fortë; t'i kthej përgjigje letrës që më ka dërguar ai njeri."

Njeriu që sollën për të përkthyer isha unë. Herakliu më solli një letër të shkruar në një eshtër kraharori dhe më porositi: "Çoja këtë letër atij njeriu dhe bëj kujdes që t'i mbash mend të gjitha sa do të fliten aty: A do të flasë për letrën që më ka dërguar mua? A do të flasë për natën kur do të ketë lexuar letrën time? Si dhe bëj shumë kujdes që t'i shohësh shpinën, a do të dallosh ndonjë gjë të çuditshme në të?"

E mora letrën dhe u nisa për rrugë. Mbërrita në Tebuk. Profeti ishte ulur ndanë një hauzi me ujë, së bashku me sahabët e tij.

- "Ku është i madhi juaj?", – pyeta unë.

- "Ja tek është.", – m'u përgjigjën ata duke ma treguar me dorë.

U drejtova kah ai dhe eca derisa u ula përballë Resulullahut. I dhashë letrën, e vuri në prehër dhe më pyeti: "*Po ti, nga cilët je?*"

- "Nga fisi i Tenuhut.", – iu përgjigja unë.

- "*Si thua, sikur t'i bindesh e të ndjekësh fenë e Hanifit, që është feja e vërtetë e të parit tënd, Ibrahimit?*"

- "Unë jam thjesht një lajmës i dërguar nga njerëzit e tij dhe u përkas po fesë së tyre. Nuk mund të heq dorë prej fesë sime pa u kthyer njëherë pranë tyre.", – iu përgjigja.

Atëherë pushoi për pak çaste dhe më lexoi një ajet kur'anor: "**Vërtet, ti** (Muhamed) **nuk mund të udhëzosh kë të duash, por**

është Allahu që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar." (Kasas, 28/56)[80]

Biseda e Ebu Sufjanit me mbretin e Bizantit

Ibni Abasi (radijallahu anhu) transmeton: "Siç më ka lajmëruar Ebu Sufjani, në vitet kur Profeti ynë pati bërë një marrëveshje paqeje me Ebu Sufjanin dhe shumë mohues të Kurejshëve, në mes tyre ishte edhe një karvan që udhëtonte drejt Sirisë për tregti. Në atë kohë, Herakliu dërgoi lajm se e ftonte Ebu Sufjanin t'i shkonte në pallat. Ebu Sufjani, bashkë me të pranishmit e tjerë, u nisën menjëherë për te Herakliu. Në fakt, Herakliu dhe njerëzit e tij ishin të vendosur në zonën e quajtur Bejtul-Makdis. Herakliu i pati thirrur ata në kuvend. Rreth tij ishin të pranishëm edhe e gjithë paria e vendit. Mandej pati kërkuar që të vinte edhe një përkthyes. Përkthyesi tha: "Kush nga ju është më i afërt me atë njeri që thotë se është profeti i Zotit?"

- "Unë.", – u përgjigj Ebu Sufjani.

- "Ma sillni pranë, bashkë me shokët e tij, por ata të rrinë pas tij!", – urdhëroi Herakliu, për Ebu Sufjanin dhe ata që e shoqëronin. Pastaj, u drejtua nga ai që po përkthente dhe i tha:

- "Thuaju, (duke treguar me dorë Ebu Sufjanin) që unë do t'i pyes ata rreth atij njeriu dhe nëse më gënjen për ndonjë gjë, shokët e tij ta ndreqin, duke më thënë se po më gënjen!"

Më vonë Ebu Sufjani ka thënë: "Uallahi, sikur të mos ngurroja e të mos druhesha se shokët do të më vinin në pah se isha duke gënjyer, atë ditë do të kisha gënjyer. Ja se cila ishte pyetja e parë që më bëri:

- "Si është fisi nga e ka prejardhjen ai njeri?"

- "Ai vjen nga një fis shumë i mirë.", – iu përgjigja unë.

- "Në mesin tuaj, a ka pasur të tjerë që e kanë thënë këtë edhe më parë (se kanë qenë profetë të Zotit)?"

- "Jo.", – u përgjigja unë.

- "A ka pasur mbret ndër të parët e tij?"

---

[80]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 8/427 (13894).

- "Jo."

- "A i bindet fisnikëria e popullit, apo janë më shumë të dobëtit që i shkojnë nga pas?"

- "Të dobëtit janë ata që e ndjekin më së shumti."

- "Numri i atyre që po e ndjekin është duke u shtuar, apo duke u pakësuar?"

- "Vazhdimisht po shtohen.", – u përgjigja unë.

- "A ka të atillë, që pasi e pranojnë fenë e tij, e braktisin, pasi kanë vërejtur ndonjë gjë që atyre nuk u ka pëlqyer?"

- "Jo.", – iu përgjigja.

- "A e keni akuzuar ndonjëherë atë njeri, para se të shpallte profetësinë, se ju ka gënjyer për ndonjë gjë?"

- "Jo.", – iu përgjigja.

- "A ka qëlluar ndonjëherë që ai të mos e mbajë fjalën e dhënë?"

- "Jo.", – u përgjigja unë, – "por, hë për hë, ne kemi vendosur paqen me të, e nuk e dimë se çfarë do të bëjë."

Ebu Sufjani tregon: "Nuk dija se ç'të thosha më shumë, për t'ua ngatërruar mendjen." Herakliu vijoi të më pyesë:

- "Po mirë, a keni luftuar ju ndonjëherë më parë me të?"

- "Po.", – iu përgjigja unë.

- "Si kanë përfunduar ato luftëra që keni bërë?"

- "Me radhë, herë kemi dalë fitimtarë ne, herë ka qenë ai që na ka mundur."

- "Çfarë ju urdhëron ai njeri të bëni?"

- "Ai na urdhëron të adhurojmë Allahun, që është Një dhe i Vetëm, e të mos i bëjmë Atij asnjë shok në krijimin e asgjëje, si dhe që t'i braktisim të gjitha ato që na kanë mësuar të parët tanë. Ai na urdhëron neve faljen e namazin, përhapjen e së drejtës dhe të së vërtetës, si dhe që të ruajmë nderin e të duam fort familjen."

Herakliu u kthye nga përkthyesi dhe i tha këto fjalë:

"Të pyeta për prejardhjen e atij njeriu, e ti më the se ai është një

njeri i fisëm. Profetët dërgohen përherë nga mesi i njerëzve më të fisëm. Ju pyeta, nëse ka pasur më parë në mesin tuaj, të cilët kanë pretenduar të njëjtën gjë, dhe ju më thatë se nuk ka pasur. Nëse do të më kishit thënë se po, ka pasur, atëherë do të mendoja se edhe ky është duke imituar fjalët e atij që ka dalë më përpara. Të pyeta, nëse ka pasur ndonjë mbret nga të parët e tyre. Ti më the se jo, nuk ka pasur. Nëse nga mesi i të parëve të tij do të kishte pasur ndonjë mbret, atëherë do të thosha se ky njeri është në kërkim të trashëgimit të mbretërisë së babait të tij dhe nuk do t'i jepja rëndësi më shumë nga sa është e nevojshme. Të thashë, a ka ndodhur ndonjëherë më parë që ju ta keni akuzuar atë njeri, se ju ka gënjyer. Përgjigja që më dhe ishte 'jo', nuk ka ndodhur. Unë e di mjaft mirë se ai njeri që nuk i gënjen njerëzit nuk ka se si të gënjejë karshi Zotit. Të pyeta, kush e ndjek më shumë atë, paria e njerëzve, apo më të varfrit e më të dobëtit, e ti më the që janë të dobëtit ata që e ndjekin më së shumti. Po, ata janë që bëhen zakonisht ndjekësit më besnikë të profetëve. Të thashë, po shtohen, apo po pakësohen dhe ti më the se janë duke u shtuar, e zakonisht kështu ndodh, që ata vetëm shtohen e shtohen, derisa feja të arrijë përsosmërinë e saj kështu do të vazhdojë. Unë të pyeta, 'a ka të atillë që e kanë pranuar fenë e tij, por që më pas kanë hequr dorë dhe janë kthyer në fenë e mëparshme, pasi ka pasur diçka që nuk u ka pëlqyer?' Ti më the jo, nuk ka pasur, sepse kështu ndodh kur besimi zë vend në zemrën e njeriut dhe aty nis të mbizotërojë paqja. Të pyeta a është kthyer ndonjëherë dhe nuk e ka mbajtur fjalën e dhënë. Përgjigja jote ishte jo. Të tillë janë profetët, nuk i gënjejnë njerëzit dhe nuk kthejnë kurrë nga ajo fjalë që japin. Po çfarë ju urdhëron juve të bëni ju pyeta. Ti më the se ju ka urdhëruar të adhuroni Allahun, të mos i bëni asnjë shok ose ortak Zotit në krijim; jua ka ndaluar që të adhuroni e të kryeni rituale për idhujt e krijuar prej jush vetë, të falni namazin, të jeni të drejtë, si dhe të jetoni një jetë që e dallon ndershmëria. Nëse të gjitha këto që the janë të vërteta, atëherë, nuk do të kalojë shumë kohë dhe ai do të bëhet zotëruesi i kësaj toke ku po shkelin këmbët e mia tani. Unë e dija që ai do të vinte. Por nuk prisja që të dilte nga mesi juaj. Sikur ta di se do të mund të mbërrija deri tek ai, do t'i pranoja të gjitha vështirësitë me të cilat do të më duhet të përballem. Ah sikur të isha pranë tij e të isha unë ai që do t'ia laja këmbët!"

Mandej, Herakliu i kërkoi Dihjes (radijallahu anhu) që t'i jepte letrën që kishte çuar te sundimtari i Busras dhe përgjigjen që ai i kish kthyer. Në atë letër shkruhej:

"*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit! Kjo është një letër e robit dhe të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, për të parin e Bizantit, Herakliun.*

Përshëndetje për të gjithë ata që kanë ndjekur rrugën e udhëzimit. E thënë siç e do fjala, unë të ftoj që të pranosh Islamin. Bëhu mysliman, që të mund të gjesh paqen e shpëtimin, në mënyrë që edhe Allahu i Madhërishëm ta dyfishojë shpërblimin për ty. Nëse nuk e pranon, atëherë ta dish, se përgjegjësia do të jetë e jotja edhe për arsyen se populli nuk do të njihet me fenë e Allahut.

"**... O njerëz të librit! Të biem në një mendje me njëri-tjetrin rreth asaj që na bashkon dhe që është e përbashkët dhe e drejtë për të dyja palët, si për ju, ashtu edhe për ne: 'Të mos adhurojmë askënd tjetër pos Allahut. Të mos i bëjmë Atij asnjë shok a ortak në krijim, e as nga ju, as nga ne të mos ketë asnjë njeri që adhuron tjetërkënd vetëm se Allahun.' Nëse e refuzojnë këtë thirrje, atëherë: 'Thuajuni: Të paktën bëhuni dëshmitarë se ne jemi besimtarë, që u bindemi urdhrave të Allahut.'**" (Al 'Imran, 3/64)

Ebu Sufjani thotë: "Herakliu e tha ç'kishte për të thënë dhe, pasi e lexoi letrën, në mesin e njerëzve filluan të shtoheshin zhurmat dhe gumëzhima e zërave të tyre. Zërat filluan të ngriheshin. Ne na nxorën prej aty. Kur dolëm, unë u thashë shokëve: "Kjo puna e Ibni Ebi Kebshes (Ky ishte një ndër llagapet e Resulullahut nisur nga emri i burrit të mëndeshës së Tij dhe idhujtarët e Kurejshëve e përdornin atë veçanërisht për t'u tallur.) u zmadhua edhe më shumë, duke u bërë edhe më e rëndësishme. Atij filloi t'i frikësohej edhe mbreti i Bizantit. Besimi që kisha se këtej e tutje profeti do të dilte fitimtar nuk reshti së ekzistuari në mua, derisa Zoti e bëri Islamin të dashur për zemrën time.

Valiu i asaj kohe i Jerusalemit, i cili ishte njëherazi mik i Herakliut, peshkopi i të krishterëve të Sirisë, Ibnu-Naturi, ka treguar: "Kur Herakliu erdhi në Jerusalem, të gjithë e panë se ai ishte shumë i trishtuar. Njëri prej patriarkëve e pati pyetur: "Nuk po e kuptojmë, pse je bërë kështu?"

Herakliu ishte edhe falltar, pasi dinte të lexonte yjet. Kur i bënë këtë pyetje, ai u përgjigj: "Kam parë yjet dhe pashë se ai që është mbreti i të rrethprerëve është zhvendosur drejt qendrës. Cili nga vendet përreth jush është i banuar nga njerëz që bëhen synet?"

"Këtej rrotull i vetmi popull që bëhen synet janë hebrenjtë, nuk ka të tjerë. Po pse të të shqetësojë gjendja e tyre, ti mund t'u shkruash një letër njerëzve që kontrollojnë territoret e tua, e t'i vrasin të gjithë hebrenjtë që jetojnë nëpër to."

Ndërsa ata flisnin me këtë gjuhë, në praninë e Herakliut sollën një burrë, të cilin e kishte dërguar sundimtari i Gassanit. Ai i solli atij të reja lidhur me të Dërguarin e Allahut. Kur dëgjoi lajmet për Profetin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) Herakliu tha:

"Shkoni e kërkoni njëherë, të mësoni a është ai rrethprerë, apo jo?" Kërkuan dhe i thanë se, po, ai ishte rrethprerë. I pyeti për arabët. A e kishin edhe ata zakon të bëheshin synet? Po, i thanë, edhe ata e kanë zakon, që të bëhen synet. Atëherë Herakliu tha: "Atëherë ky njeri do të bëhet i pari i atij populli, më në fund ka ardhur!" Mandej, Herakliu vendosi t'i shkruante një letër një miku të tij, që jetonte në Romë, e që ishte jo më pak i ditur se ai vetë dhe u nis të shkonte në Humus. Ende pa u larguar nga Humusi, nga miku i tij i mbërriti një letër. I shkruante se ai ishte i të njëjtit mendim me Herakliun, se ai, më në fund, ishte shfaqur dhe se ishte e vërtetë, ai ishte një profet. Pas kësaj, Herakliu ftoi në sarajet e tij në Humus të mblidhej gjithë paria e bizantinëve. Të gjithë i urdhëroi që dyert të qëndronin mbyllur. Në fund, u ngjit në një vend të ngritur dhe filloi të fliste:

"O njerëz të Bizantit! A doni që të fitoni si lumturinë e kësaj bote, ashtu edhe lumturinë e amshuar në jetën e përtejme? Nëse doni që pasuria që keni të mbetet po në duart tuaja, atëherë duhet t'i bindeni atij profeti!"

Të gjithë sa ishin të pranishëm, sikur të ishin zebra të trembura, vërshuan drejt portave për t'u larguar së andejmi me një frymë. Kur Herakliu dëshmoi gjithë atë mllef prej tyre dhe e humbi shpresën se ata do të besonin, atëherë iu drejtua ushtarëve: "Sillini drejt meje."

- "Ato që ju thashë pak më parë ishin të gjitha fjalë për t'ju vënë në

provë se sa të fortë e keni lidhjen me fenë tuaj dhe e dëshmova me sytë e mi se sa fort të lidhur jeni ju me besimin tuaj."

Të gjithë të pranishmit u qetësuan dhe i thanë se kjo sprovë u kishte pëlqyer tej mase, kështu që u larguan prej aty duke ndierë edhe më shumë respekt për mbretin e tyre. Ja, me pak fjalë, kjo ishte gjendja përfundimtare e Herakliut."[81]

Letra e Profetit tonë për mbretin e Persisë, Kisran

Ebu Seleme bin Abdurrahmani (radijallahu anhu) tregon: "Kur letra e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i mbërriti Kisrës, ai, një ta lexuar letrën, e grisi atë, e bëri copë-copë. Mandej i shkroi një letër valiut të tij në Jemen, Bazanit: "Dërgo dy prej njerëzve më të fortë që ke te ky burri që ka dalë në Arabi, që ta marrin e ta sjellin tek unë." Edhe Bazani, bashkë me një letër në persisht që i drejtohej të Dërguarit të Allahut, dërgoi tek ai mëkëmbësin e tij, Ebanuhun, i cili ishte njeri i zgjuar që dinte shkrim e këndim. Si shoqërues, me vete i dha edhe një pers, të cilin e quanin "Xhed Xhemire". Në letër i urdhëronte që të merrnin të Dërguarin e Allahut dhe bashkë me të të shkonin drejt e te Kisra. Mëkëmbësit i pati thënë: "Shikoje njëherë atë njeri, cila është e vërteta që thonë njerëzit? A është e vërtetë? Fol njëherë me të dhe më sill ndonjë të re që do të mësosh rreth tij!" U nisën dhe kur mbërritën në Taif aty u takuan me një sërë tregtarësh kurejshitë. I pyetën rreth të Dërguarit të Allahut. Ata që ishin aty, i thanë se ai ishte tanimë në Jethrib (Medinë). Idhujtarët e Kurejshëve u kënaqën jashtë mase (që në këtë çështje po përfshihej edhe Kisra) dhe filluan të flisnin me njëri-tjetrin:

- "Tani ka për t'ia treguar Kisra qejfin, tani do të shpëtoni nga njeriu ynë!"

Ata të dy dolën nga Taifi dhe u nisën për në drejtim të Medinës. Kur shkuan pranë të Dërguarit të Allahut, Ebanuhu i tha të Dërguarit të Allahut:

- "Kisra i ka shkruar një letër Bazanit. Ai i ka urdhëruar atij që të

[81]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/266.

sjellë njerëzit e tij për të të marrë e të të çojnë te Kisra. Për këtë Bazani më ka ngarkuar mua, që të vij e të të marr."

- "*Ju tani ikni dhe ejani nesër të flasim.*"

Ditën tjetër, kur ata dy burra erdhën pranë Resulullahut, Ai u tregoi atyre se Allahu i Madhërishëm ka vendosur ta ndëshkojë Kisrën me dorën e djalit të vet, Shireuejhit, në aksh natë të filan muaji, duke e vrarë babanë. Ata dy burra mbetën të shtangur:

- "Çfarë thua, a e di se çfarë thua? Mos do që këtë t'ia njoftojmë Bazanit, duke i shkruar një letër?"

- "*Po, shkruajani. Veç kësaj t'i thoni edhe: 'Nëse do të bëhesh mysliman, atëherë të gjitha zotërimet në territoret tuaja do të t'i jap ty.'*"

Pastaj, i Dërguari i Allahut, i dha Xhed Xhemirës dhuratë një brez shumë të bukur prej ari dhe argjendi, të cilën edhe atij ia kishin dhuruar. Ata u kthyen të dy pranë Bazanit dhe e njoftuan për gjithë ç'kishte ndodhur. Bazani, i dëgjoi të gjitha dhe tha:

- "Uallahi këto nuk janë fjalë sundimtari. Duhet të presim e të shohim njëherë, nëse janë të vërteta e a do të ndodhin ato që na thotë." Nuk kaloi shumë kohë dhe atij i erdhi një letër prej Shireuejhit. Në të shkruhej:

"Për të mirën e popullit pers e vrava Kisrën, sepse ai po i vriste të gjithë fisnikët e Persisë. Prano në emrin tim besnikërinë e shpallur ndaj meje nga të gjithë ata që gjenden përreth teje. Ndërsa, për sa i përket atij njeriu (d.m.th. Profetit a.s.), kujdes, në asnjë mënyrë, të mos thuash asnjë fjalë të keqe e të mos shfaqësh asnjë sjellje të shëmtuar!" Bazani, kur e lexoi atë letër tha: "Ky njeri është një profet i dërguar prej Allahut." U bë menjëherë mysliman. Bashkë me të, Islamin e pranuan edhe të gjithë njerëzit më të nderuar në mesin e persëve, që jetonin asokohe në Jemen."[82]

Letra e Profetit tonë për mbretin e Aleksandrisë, Mukaukisin

Abdullah bin Abdulkariu (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi te më i madhi i Aleksandrisë,

[82]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 1/259.

Mukaukisi, Hatib bin Ebi Beltean (radijallahu anhu). Kur i shkoi letra e Profetit tonë, Mukaukisi, fillimisht, e puthi atë letër. E gostiti njëherë mirë e mirë Hatibin, duke e pritur më së miri. Pastaj, pasi e veshi në tesha të reja e të bukura, i dha atij edhe një mushkë dhe dy robinja (njëra nga këto dy robinja ishte edhe Maria, nëna e Ibrahimit, djalit të Profetit tonë), ai e nisi Hatibin për te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem)." Robinjën tjetër, i Dërguari i Allahut ia pati dhuruar Muhamed bin Kajs el-Abdiut.[83]

Hatib bin Ebi Beltea (radijallahu anhu) tregon: Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi mua te mbreti i Aleksandrisë, Mukaukisi. Kur ia dhashë Mukaukisit letrën e vyer që i pata çuar, Mukaukisi më priti në shtëpinë e tij, ku edhe qëndrova për njëfarë kohe. Një ditë, ai mblodhi të gjithë njerëzit më të ngritur që punonin për të dhe më thirri edhe mua, e më tha:

- "Unë do të të pyes për disa gjëra dhe shpresoj se do të më kuptosh."

- "Patjetër, të më pyesni.", – iu përgjigja unë.

- "Tani do të më thuash, haptazi: I madhi yt është një profet, apo jo?"

- "Po, ai është i Dërguari i Allahut."

- "Po mirë, kur populli vendosi që ta përzërë nga atdheu i vet, atëherë përse nuk iu lut ai Zotit, duke i mallkuar ata njerëz që Allahu t'i shkatërronte e t'i bënte njësh me dheun?"

- "Shumë mirë, po ti a dëshmon se Isai i biri i Merjemes ishte një profet i Allahut?", – iu përgjigja unë, duke i bërë një pyetje.

- "Patjetër që e dëshmoj këtë të vërtetë."

- "Po mirë, Isai (alejhis'selam), kur populli i tij e kapi atë dhe deshën ta varnin, nuk iu lut Allahut që t'i shkatërronte ata, por Allahu e lartësoi atë drejt qiejve dhe e shpëtoi."

Kur i dëgjoi këto fjalë, ai m'u drejtua me këto fjalë:

- "Nuk ka dyshim se ti vjen prej një njeriu të urtë, që e njeh shumë mirë urtësinë e Zotit, por, edhe ti je një njeri shumë i mençur! Ja, këto

[83]. Ibn Kethir, *Sire,* 3/514.

janë dhuratat e mia për ju... Të gjitha këto do t'i nis bashkë me ty për te Muhamedi. Veç kësaj, do të të jap me vete edhe disa ushtarë që t'ju mbrojnë gjatë rrugës, gjersa të arrini në toka ku nuk të kanoset asnjëfarë rreziku."

Hatibi thotë se: "Mukaukisi, bashkë me shumë dhurata më dha edhe tri robinja për t'i çuar tek i Dërguari i Allahut. Njëra syresh, më vonë, u nderua me privilegjin që të ishte bashkëshorte e Profetit tonë; nëna jonë nga e cila erdhi në jetë djali i Profetit tonë, Ibrahimi. Një tjetër prej tyre Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ia pati dhuruar poetit të njohur Hasan bin Thabit el-Ensarit."[84]

Letra që Profeti ynë i pati dërguar popullit të Nexhranit

Bejhakiu transmeton prej Junus bin Bukejrit: "Para se t'i zbritej surja 'Neml', Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pati shkruar popullit të Nexhranit një letër. Le të paraqesim përmbledhtazi dhe duke perifrazuar se çfarë shkruhej në atë letër:

"*Me emrin e Zotit të Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit.*

Një letër e Muhamedit, të Dërguarit të Allahut, për peshkopin e Nexhranit dhe nexhranasit. Ju përshëndes duke përlëvduar Zotin e Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit. Unë ju ftoj ju të hiqni dorë nga robërimi ndaj robërve, e të mos robërohen vetëm se ndaj Allahut. Të hiqni dorë nga besimi në miqësinë dhe mbrojtjen e robërve dhe të bëheni miq të Zotit e të mos kërkoni mbrojtje tjetër pos mbrojtjes së Tij. Nëse nuk e pranoni këtë ftesë timen, atëherë duhet të jepni detyrimin e xhizjes. Nëse ngurroni edhe për pagesën e xhizjes, atëherë ta dini mirë se mua do të më duhet që t'ju shpall luftë. Paqja qoftë mbi ju!"

Peshkopi, kur e lexoi letrën, e kaploi njëfarë shqetësimi dhe filloi ta zërë frika. Për të kërkuar një mendim, shkoi menjëherë te një burrë, banor i Nexhranit, të cilin e quanin Shurahbil bin Uedaaja i Hemdanit. Përgjithësisht, sa herë që përballej me ndonjë shqetësim shumë të madh, populli i Nexhranit, para se të shkonin të kërkonin ndihmë te tre prijësit më të mëdhenj të tyre, Ejhemi, Sejidi dhe Akibi, shkonin njëherë më parë te ky njeri. Peshkopi ia dha letrën e Resulullahut që ta

[84]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/272.

lexonte njëherë dhe Shurahbili e lexoi.

- "Më thuaj, o Ebu Merjem, ç'mendim ke për të?"

- "Unë e di që Allahu ka premtuar se nga soji i Ismailit, të birit të Ibrahimit (alejhis'selam), ka për të ardhur një profet. Ndoshta ky njeri është pikërisht profeti i premtuar. E kam të pamundur që të them ndonjë gjë përfundimtare lidhur me profetësinë e tij. Po të ishte ndonjë çështje e lidhur me punët e kësaj bote, do të kisha bërë çmos që të të gjeja një rrugëzgjidhje."

- "Atëherë kalo këtej dhe ulu."

Dhe ai u ul. Mandej, peshkopi thirri Abdullah bin Shurahbilin, një njeri që vinte nga dega Dhi-Esbah e fisit të Himjerit nga populli i Nexhranit. I kërkoi mendim edhe atij. Por edhe ai, të njëjtën përgjigje i ktheu. Atëherë, peshkopi i tha edhe atij: "Mirë, ulu në anë." Dhe ai u ul.

Kësaj here peshkopi thirri Xhebar bin Fejzin, po ashtu nga populli i Nexhranit. E pyeti se ç'mendim kishte lidhur me çështjen. Por edhe ai, diçka të ngjashme me atë që kishin thënë të tjerët pohoi. Peshkopi tha: "Kalo këtej, ulu." Dhe ai u ul.

Kur pa se të gjithë ishin në një mendje, peshkopi kërkoi që të binin kambanat, të ndizeshin zjarre dhe nëpër manastire të ngriheshin flamujt. Kështu bënin sa herë që gjatë ditës ndodhte ndonjë gjë e papritur. Kur merrnin ndonjë lajm të atypëratyshëm gjatë natës (duke qenë se flamujt nuk do të mund t'i dallonte dot asnjë) binin vetëm kambanat, ndërsa në kullat e manastireve ndizeshin zjarre që do të shiheshin lirshëm nga të gjithë. Kur dëgjuan kambanat teksa binin, panë zjarret, flakët e të cilëve nisën të fluturonin drejt qiellit dhe thellë luginës ishin ngritur flamujt, populli u mblodh menjëherë. Lugina ishte aq e gjatë, saqë një kali do t'i duhej një ditë e plotë për ta përshkuar fund e krye. Në të përfshiheshin shtatëdhjetë e tri fshatra dhe jetonin njëqind e njëzetmijë luftëtarë. Peshkopi u lexoi atyre letrën e ardhur nga i Dërguari i Allahut dhe i pyeti se ç'mendim kishin për të. Ata që ishin të aftë për të dhënë një mendim, i thanë mendimet e tyre përmbledhtazi kështu:

"Të dërgojmë Shurahbil bin Uedatul-Hemdaniun, Abdullah bin

Shurahbil el-Esbahun dhe Xhebar bin Fejz el-Harithin, që të na sjellin më shumë informacion rreth Resulullahut."

Ai grup u nis për rrugë. Kur mbërritën në Medinë, i hoqën teshat e rrugës, u veshën me rrobat më të mira, duke vënë edhe të gjitha unazat më të bukura, të cilat i kishin marrë qëllimisht me vete. Mandej, shkuan tek i Dërguari i Allahut dhe e përshëndetën. Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk ua ktheu përshëndetjen. Megjithëse kishin veshur rrobat me stolitë më të bukura e në gishta kishin vënë unazat me gurët më të çmuar, ata u përpoqën gjatë gjithë ditës të bisedonin me të. Por Resulullahu sërish nuk i priti ashtu siç ata kishin pritur, duke u lëvduar pamjen dhe lartësinë e pretenduar. Pastaj, kur e panë se e kishin paksa të vështirë që t'ia arrinin qëllimit, kërkuan për Osman bin Afanin dhe Abdurrahman bin Aufin, të cilët i njihnin më parë. Ata i gjetën të ulur në mes të një kuvendi me muhaxhirë dhe ensarë.

- "O Osman, o Abdurrahman! Profeti juaj na ka dërguar një letër dhe ne kemi ardhur që t'i përgjigjemi ftesës së tij. E përshëndetëm kur erdhëm, mirëpo ai nuk e pranoi përshëndetjen tonë; gjatë gjithë ditës jemi përpjekur të takohemi e të flasim me të, mirëpo nuk na priti; më duket se nuk na dha shumë rëndësi. Ju çfarë mendimi keni? A të kthehemi andej nga erdhëm?"

Osmani dhe Abdurrahmani (radijallahu anhuma) iu drejtuan Aliut (radijallahu anhu), i cili gjendej po ashtu në atë kuvend:

- "Po ti ç'thua për këto që thonë këta njerëz, o Ebu'l-Hasen?"

- "Unë u këshilloj që t'i ndërrojnë këto rroba që kanë veshur dhe t'i heqin ato unazat që kanë vënë ndër gishta dhe të provojnë të shkojnë edhe njëherë tek i Dërguari i Allahut."

Dhe ata burra ashtu vepruan. Mandej shkuan prapë tek i Dërguari i Allahut dhe e përshëndetën. Profeti ynë ua pranoi përshëndetjen dhe u tha:

- "*Pasha Zotin tim, i Cili më ka dërguar mua me të vërtetën, kur erdhët herën e parë, bashkë me ju kishte ardhur edhe djalli.*" Pastaj, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u bëri atyre vazhdimisht pyetje, e edhe ata e pyetën të Dërguarin e Allahut për çdo gjë që donin të kuptonin më mirë. Në fund, ata e pyetën Resulullahun:

- "Çfarë mendon ti për Isain? Ne jemi të krishterë dhe do të kthehemi te populli ynë. Nëse ti je një profet, atëherë ne do të kënaqeshim shumë, nëse do të na tregoje diçka për Isain, sepse ne na pëlqejnë shumë ato që thuhen për Isain." Atëherë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Tani unë nuk kam këtu asnjë të dhënë rreth Isait. Prisni, derisa Zoti ynë të më shpallë rreth Isait dhe me të ardhur shpallja unë do t'i ndaj të vërtetat me ju.*"

Ditën tjetër, Allahu zbriti këto ajete, kuptimi i të cilave është: "**Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: 'Bëhu!' dhe ai u bë. E vërteta është nga Zoti yt, ndaj mos u bëj nga ata që dyshojnë! Ata që të kundërshtojnë ty për çështjen e Isait, pasi të ka ardhur njohuria, thuaju: 'Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, veten tonë dhe ju vetë, pastaj, të lutemi që mallkimi i Allahut t'i godasë gënjeshtarët!**" (Al 'Imran, 3/59-61)

Ata nuk i pranuan të vërtetat e thëna në këto ajete. Veç kësaj, Profeti ynë (i thirri ata që të mallkoheshin në mënyrë reciproke, siç e kërkonte edhe përmbajtja e shpalljes hyjnore të Allahut.) Mëngjesin tjetër, i Dërguari i Allahut i pati mbështjellë dy nipërit e Tij, Hasanin dhe Husejnin (radijallahu anhuma) me qilimin e kadifenjtë që i gjendej; atë ditë, megjithëse kishte disa bashkëshorte, nga pas kishte vetëm vajzën e tij Fatimen dhe shkoi pranë tyre për të bërë mallkimin e kushtëzuar ndërsjellazi[85]. Shurahbili u drejtua nga dy shokët e tij dhe u tha:

- "Ju e dini, se po të mblidhen të gjithë banorët që jetojnë, si në pjesën e poshtme, ashtu edhe në pjesën e sipërme të luginës, ata do të ma dëgjojnë fjalën. Uallahi, më duket se kjo nuk do të jetë aspak e mirë për ne. Nëse ky njeri është vërtet profet, atëherë ne do të jemi të parët që do të poshtërohemi në mesin e arabëve, pasi do ta kemi kundërshtuar të vërtetën e zbritjes së tij. Ne nuk do të shpëtojmë dot prej tij, pa i humbur të gjitha me mall e me pasuri e familje, gjithë ç'kemi. Kur këta janë fqinjët tanë më të afërt ndër arabë. Ky njeri, nëse është një profet i dërguar nga Allahu, e ne mallkohemi, ta dini

[85]. Mula'ane – mallkim i ndërsjelltë i kushtëzuar, ku të dyja palët mallkojnë që ndëshkimi të bjerë mbi ata që janë duke gënjyer, apo nuk thonë të vërtetën për diçka.

se nuk do të na mbetet më as nam, as nishan mbi këtë botë! Do të shkatërrohemi! Do të zhdukemi!"

Shokët, të cilët e kishin dëgjuar me vëmendje, thanë:

- "Po mirë, o Ebu Merjem, ti i ç'mendimi je, si të veprojmë?"

Ebu Merjemi:

- "Ta vëmë atë si gjykatës mes nesh, sepse e shoh, që është njeri që nuk do t'i bënte askujt keq."

- "Atëherë shko dhe zgjidheni ju me njëri-tjetrin këtë çështje.", – thanë ata.

Shurahbili shkoi te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- "Para se të mallkojmë njëri-tjetrin, mua më erdhi një mendim më i mirë."

- "*Ç'mendim është ky?*", – pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Mendohu njëherë deri nesër në mëngjes dhe ne do të pranojmë, cilido që të jetë vendimi yt për ne."

- "*Po sikur ata që vijnë pas teje të akuzojnë se ke vepruar gabim, pasi unë t'ju kem thënë mendimin tim?*"

- "Mund të shkojmë t'i pyesim edhe dy shokët e mi."

Dhe i Dërguari i Allahut i pyeti të dy dhe ata i thanë se "askush nuk zbret në luginë pa lejen e Shurahbilit, e askujt nuk i shkon nëpër mend të largohet nga lugina pa pyetur njëherë atë."

Atëherë Profeti ynë nuk e bëri mallkimin e kushtëzuar me të vërtetën. Ditën tjetër nexhranasit erdhën tek i Dërguari i Allahut. Kurse ai u shkroi këtë letër, të cilën po e paraqesim këtu:

"*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit dhe Mëshirëplotit.*

Kjo është një letër e të Dërguarit të Allahut, Muhamedit, për popullin e Nexhranit, që përmban marrëveshjen e paqes – nëse ka fuqi mbi ta për të bërë këtë marrëveshje: Për çdo frut që tepron pasi janë përmbushur nevojat, florinjtë dhe argjendin, apo çdo lloj guri i çmuar, do të vendoset një taksë. Por e gjitha kjo taksë u është lënë atyre në formën e dymijë pjesëve, njëmijë prej të cilave t'u jepen

në muajin Regaib, ndërsa njëmijë të tjera gjatë muajit Safer."[86]

Në këtë transmetim të përfshirë edhe në "El-Bidaje" do të vërejmë se ka edhe më shumë të dhëna: Në shkrimin e marrëveshjes së paqes së të Dërguarit të Allahut me nexhranasit ishin dëshmitarë edhe Ebu Sufjan bin Harbi, Gajlan bin Amri, Malik bin Aufi nga Beni Nasrët, Akra bin Habis el-Handhali dhe Mugireja. Grupi i nexhranasve i morën letrat e marrëveshjes dhe u kthyen për në Nexhran. Peshkopi i Nexhranit kishte një djalë xhaxhai, të cilin e quanin Bishr bin Muauije, por e thërrisnin me llagapin Ebu Alkame. Grupi i përfaqësuesve ia dorëzoi letrën peshkopit. Teksa po e lexonin marrëveshjen, ndanë peshkopit qëndronte djali i xhaxhait të tij, Bishri; të dy po ecnin me ngadalë mbi deve. Kur, sa hap e mbyll sytë, deveja e Bishrit u pengua diku dhe u rrëzua dhe Bishri përmendi emrin e të Dërguarit të Allahut dhe tha:

- "Zoti të mallkoftë!" Atëherë, peshkopi, i cili e dëgjoi mallkimin e kushëririt të tij, i tha atij:

- "Uallahi, ti sapo mallkove një profet të dërguar nga Allahu!" Dhe Bishri tha:

- "Atëherë, për Zotin, edhe unë do të shkoj menjëherë tek i Dërguari i Allahut, pa i zgjidhur frerët e devesë." Dhe u dha këmbëve në drejtim të Medinës. Pas tij shkoi edhe peshkopi duke i dhënë nxitim devesë ku kishte hipur.

- "Për ato që të thashë duhet të më kuptosh drejt. Pavarësisht, unë të gjitha sa thashë, i thashë jo se i kemi marrë atij ndonjë gjë, apo se nuk i pranuam ato që na tha ai, por se doja që ashtu të na dëgjonin arabët, se megjithëse ne jemi më të fortët e të fuqishmit në mesin e tyre, ne pranuam të binim dakord me një njeri që as njerëzit e vet nuk e kanë pranuar.", – i tha ai kushëririt të tij, por Bishri iu përgjigj: - "Jo, për Zotin, unë nuk mund të pranoj dot më asgjë që vjen prej mendjes sate!" I ktheu shpinën peshkopit dhe i ra kamxhikut deveve dhe shkoi drejt Medinës duke mërmëritur një poezi nëpër dhëmbë.

Bishri shkoi tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe u bë mysliman. Nuk u nda më kurrë prej tij, derisa ra dëshmor në

[86]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/55.

rrugën e Zotit të Botëve.

Në vijim transmetuesi tregon: "Grupi që kishte marrë pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes u kthye në Nexhran. Ibni Ebi Shemr ez-Zebijdij shkoi te prifti që ishte ngjitur në majën e kullës së manastirit dhe i tha:

- "Në Hixhaz është dërguar një profet."

Ai i tregoi priftit edhe se një grup nga nexhranasit kishin shkuar tek ai dhe se ai u kishte propozuar një mallkim të kushtëzuar me të vërtetën, mirëpo ata nuk e kishin pranuar diçka të atillë, madje edhe se Bishr bin Muauijeja kishte shkuar në Medinë dhe kishte pranuar sakaq Islamin. Prifti i kishte dëgjuar të gjitha dhe i kishte thënë: "Më zbrit që këtu, ose do të hidhem nga këtu e teposhtë!"

E zbritën. Ai murg mori disa dhurata me vete dhe u nis për tek i Dërguari i Allahut. Një pjesë e atyre dhuratave ishte një triko e veshur nga mbretër, një kërrabë dhe një gotë e madhe dhe e trashë. Murgu qëndroi për njëfarë kohe pranë të Dërguarit të Allahut. I dëgjonte të gjitha shpalljet hyjnore, pra ajetet kur'anore që i zbriteshin Profetit tonë. Një ditë u kthye pranë grigjës së tij. Ai nuk arriti të bëhej dot mysliman. Pati premtuar se do të rikthehej, por nuk qe e shkruar, sepse Profeti ynë ndërroi jetë. Kurse peshkopi mori me vete Ebul-Harithin, Sejidin dhe Akibin, nga paria e popullit, dhe shkuan tek i Dërguari i Allahut. Për ca kohë ata dëgjuan të gjitha ajetet që sapo i zbrisnin të Dërguarit të Allahut.

I Dërguari i Allahut i kërkoi Mugire bin Shubes që të shkruante një letër për atë prift dhe gjithë priftërinjtë e tjerë:

"*Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit.*

Nga Profeti Muhamed për peshkopin Ebu'l-Harith dhe të gjithë peshkopët e Nexhranit!

Të gjithëve, falltarëve, parashikuesve, murgjve dhe të gjithë atyre që punojnë për ta!

Kërkimi i mbrojtjes tek Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk do t'ia marrë nga duart as murgut murgërimin, as priftit priftërimin, as fallin falltarëve e parashikuesve dhe nuk do t'u shkelet asnjë e drejtë. Asnjë përgjegjësi e asnjë ofiq

nuk do t'u merret nga duart! Për aq kohë sa do të jenë në anën e paqes, e nuk do t'i bëjnë padrejtësi askujt, duke i këshilluar njerëzit për mirë, mbrojtja e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij ka për të qenë përherë mbi ta."[87]

14. MORALI I LARTË I RESULULLAHUT DHE SJELLJET E TIJ, QË U BËNË SHKAK PËR UDHËZIMIN E NJERËZVE

Abdullah bin Selami (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Kur Allahu dëshiroi udhëzimin e Zejd bin Sunes, Zejdi tha: "Nga të gjitha shenjat e profetësisë, sado qofshin ato, përveç dy syresh, unë i kam dalluar të gjitha në atë fytyrën e bukur të tij. Për ato dy cilësi nuk kisha dëgjuar asgjë të thuhej. Ato dy cilësi ishin të qenët i butë, i dashur dhe që butësia t'ia kalonte e ta mbulonte çdo çast nervozizmi dhe që gabimet dhe sjelljet e pahijshme që i bëheshin t'ia shtonin edhe më tepër butësinë e ndjenjën faljes." Ja se si vijon të tregojë Zejdi më tej:

"Një ditë, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), bashkë me Aliun (radijallahu anhu), dolën nga porta e dhomës së njërës prej bashkëshorteve të tij. Në atë moment, aty pranë kaloi një beduin i hipur mbi deve, i cili u tha:

- "O i Dërguari i Allahut! Në aksh vend kisha disa njerëz të mitë, ishin bërë myslimanë. U pata thënë, 'nëse bëheni myslimanë, atëherë si malli, si pasuria do t'ju shtohen, do t'ju shumëfishohen'. Mirëpo, nga mungesa e shirave dhe thatësira ata kanë mbetur shumë ngushtë. O Resulullah, kam shumë frikë, se ashtu siç e pranuan Islamin nga tamahu për më shumë pasuri, mund të heqin dorë sërish e të kthehen edhe njëherë në fenë e tyre të mëparshme. Po deshe t'u dërgosh ndonjë ndihmë, mund të ma japësh mua e ua çoj unë."

Në atë kohë, i Dërguari i Allahut hodhi njëherë vështrimin nga Aliu (radijallahu anhu) që e kishte përkrah. Ai njeri i tha:

- "Nuk na ka mbetur më asgjë, o i Dërguar i Allahut!"

Atëherë unë (Zejd bin Sune) iu afrova dhe i thashë:

- "O Muhamed! A mundet, që, për njëfarë kohe, të na e shesësh një pjesë të hurmave të filanëve me një çmim të ulët?"

[87]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/55.

- "*Mos më përcakto një vend të caktuar, si pemishtja e hurmave të filanit, apo të ndonjë tjetri.*", – më tha i Dërguari i Allahut.

- "Në rregull.", – i thashë unë, dhe kësisoj u morëm vesh. E hapa trastën dhe për një pjesë të hurmave, për një kohë të caktuar, i pagova plot tetëdhjetëmijë monedha floriri. Ndërsa ai ia dha të gjitha monedhat atij beduini, të cilit i tha:

- "*Shko dhe ndihmoji ata njerëz të përmbushin nevojat e tyre!*"

Zejd bin Suneja, në vijim, thotë: Kishin mbetur edhe dy-tri ditë nga koha që ishim marrë vesh për përdorimin e hurmave. Erdhën Profeti ynë bashkë me Ebu Bekrin, Omerin, Osmanin dhe disa sahabë të tjerë. Pasi falën namazin e xhenazes, u afruan të uleshin ndanë një muri. Shkova menjëherë pranë tyre dhe e kapa nga këmisha që kishte veshur, e pashë si me një fytyrë paksa të ashpër dhe i thashë:

- "O Muhamed, duhet të më paguash! Uallahi, ju bijtë e Abdulmuttalibit nuk dini gjë tjetër, veçse të shtyni pagesën e borxheve. Unë kam marrëdhënie të shumta me ju dhe ju njoh mjaft mirë."

Në atë kohë pashë njëherë edhe nga Omeri, sytë i lëviznin me rrëmbim, e dukej që ishte nevrikosur tej mase. Më hodhi një shikim dhe më tha:

- "More armik i Allahut! Si guxon t'i flasësh kështu të Dërguarit të Allahut? Si guxon ta prekësh kështu të Dërguarin e Allahut? Të betohem për Allahun, se po të mos ngurroja se do të fillosh të urresh Islamin, do ta nxirrja shpatën nga brezi e do të ta kisha ndarë atë kokë nga ato shpatulla!"

I Dërguari i Allahut po më shihte gjithë qetësi dhe me një seriozitet të pashoq, i palëkundur. Pastaj pa njëherë nga Omeri dhe i tha:

- "*Omer, neve na nevojitet diçka tjetër, jo kjo sjellje e jotja! Ti duhet të më kështilloje mua që t'ia paguaj borxhin këtij njeriu dhe atë ta kështilloje që ta kërkonte me të mirë kthimin e borxhit! Hajde, Omer, shko me të dhe paguaja sa i bën haka dhe t'i japësh edhe njëzet hurma më shumë, meqë e trembe!*"

Omeri më mori me vete. Përveç asaj që më takonte, më dha edhe njëzet masa me hurma më shumë.

- "O Omer, po pse kaq shumë?", – e pyeta.

- "Kështu më porositi i Dërguari i Allahut.", – u përgjigj ai. – "Meqë të tremba."

- "Po mua, nuk më njohe, o Omer?", – e pyeta unë.

- "Jo, nuk të njoha."

- "Unë jam Zejd bin Suneja."

- "Rabini?!", – pyeti ai i habitur.

- "Po, rabini Zejd."

- "Po pse u solle ashtu me të Dërguarin e Allahut, pse i fole ashtu?", – më pyeti ai.

- "O Omer, përveç dy shenjave të profetësisë, të gjitha të tjerat unë i kisha dalluar në fytyrën e ndritur të të Dërguarit të Allahut që kur e takova atë për herë të parë. Por për këto dy shenja nuk kam dëgjuar kurrë asgjë: kur butësia ia mposht nevrikosjen dhe ajo e shtimit edhe më shumë të butësisë kur dikush tregohet i pasjellshëm me të, apo kur shfaq mungesë respekti. Ja pra, duke vepruar kështu, i mësova edhe ato. Ja, o Omer, të kam ty dëshmitar, se unë jam i kënaqur me Allahun si Zot, me Islamin si fe dhe me Muhamedin si profet dhe i Dërguar i Allahut. Të kam ty dëshmitar, që gjysmën e pasurisë, e ti e di se unë jam shumë i pasur, e jap si lëmoshë për umetin e Muhamedit!", – iu përgjigja unë.

- "Thuaj më mirë 'një pjese të umetit të Muhamedit', se nuk mjaftojnë për të gjithë umetin e tij."

Kësisoj, edhe unë e rregullova atë shprehje të testamentit tim, duke thënë 'një pjese të umetit të Profetit Muhamed'.

Transmetuesi i hadithit thotë: "Omeri dhe Zejdi (radijallahu anhuma) u kthyen tek i Dërguari i Allahut, Zejdi tha fjalën e dëshmisë, duke shpallur sakaq besimin e tij tek i Dërguari i Allahut. Kështu e shprehu ai besëlidhjen e vet. Dhe, tok me Profetin tonë, ai mori pjesë në shumë beteja që u bënë në emër të Islamit. Jetën e humbi gjatë betejës së Tebukut. Allahu e trajtoftë me mëshirë Zejdin."[88]

[88]. Ibn Hibban, *Sahih,* 1/521 (288); Ibn Haxher, *el-Isabe,* 1/566.

15. PAQJA E HUDEJBIJES

Kurejshët e pengojnë të Dërguarin e Allahut që të vizitojë Qaben

Misuer bin Makhrameja dhe Meruani tregojnë: "Ato ditë kur është bërë marrëveshja e paqes së Hudejbijes, i Dërguari i Allahut ishte nisur për rrugë bashkë me sahabët e tij. Kur mbërritën në një pjesë të rrugës, Profeti ynë tha: "*Halid bin Uelidi me kalorësit e Kurejshëve janë vendosur në vendin e quajtur 'Gamim'. Mbrohuni mirë nga krahu i djathtë.*" Uallahi, pa kaluar shumë kohë, erdhi Halidi dhe, një të vënë re pluhurin që ngrihej nga hapat e ushtarëve, u kthye menjëherë pas, që të vinte në dijeni kurejshët. Ndërkohë, i Dërguari Fisnik, së bashku me sahabët e tij, u ngjitën në një kodër aty afër, kur panë se deveja e tij përtheu këmbët dhe bëri të ulej. Megjithëse të gjithë u përpoqën shumë për ta ngritur edhe njëherë në këmbë, ajo nuk ngrihej që nuk ngrihej. "Kasuaja nuk ngrihet vendit! Kasuaja nuk ngrihet dot!"

- "*Jo,*", – tha i Dërguari i Allahut!, – "*nuk është se nuk ngrihet dot; atë e bëri të ulet Ai (xh.sh.) që bëri edhe elefantin e Ebrehesë të ulej, sepse ajo nuk e ka bërë ndonjëherë diçka të tillë. Ju betohem në emër të Allahut, se çfarëdo që të më kërkojnë, vetëm që cilësitë e Allahut të respektohen, unë do ta pranoj.*" Pastaj e ngacmoi devenë dhe deveja u ngrit vendit sikur një fuqi shumë e madhe ta kishte vërvitur nga vendi dhe filloi të ecë. Shkoi në anën më të largët të Hudejbijes dhe zbriti nga deveja. Me vete u kishte mbetur shumë pak ujë. Xhemati e piu ujin pak e nga pak secili, derisa uji mbaroi i gjithi. Pak më vonë, ata erdhën tek i Dërguari i Allahut dhe i thanë se i kishte marrë etja. Profeti ynë nxori një shigjetë nga torba e shigjetave që kishte me vete dhe urdhëroi që shigjeta të binte në burimin e ujit. Uallahi, aty ku ishte ngulur shigjeta doli ujë. Pimë të gjithë derisa u ngopëm, madje mbushëm edhe të gjitha enët e ujit që kishim me vete."

Lajmi i Budejlit për të Dërguarin e Allahut

Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe sahabët e tij, ishin në këtë gjendje, kur aty erdhën Budejl bin Uereka el-Khuzai, që ishte edhe më besniku i të Dërguarit të Allahut nga fisi i Khuzaijve, së bashku me

disa të tjerë dhe i tha:

- "Kur po kaloja afër tyre, pashë se Kab bin Lueji dhe Amir bin Lueji i kishin vendosur familjet e tyre pranë burimeve më të pasura të ujit. Pranë tyre kishin edhe shumë deve në qumësht bashkë me të vegjlit e tyre. Duket që duan të luftojnë me ty, për të të penguar, që të mos e vizitosh Qaben."

Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha: "*Ne nuk kemi ardhur këtu për të luftuar me ndokënd, por vetëm sa për të përmbushur umren. Veç kësaj, betejat e Bedrit dhe e Hendekut u shkaktuan humbje shumë të mëdha gjithë kurejshëve. Po të duan, ne mund të caktojmë një afat armëpushimi, por edhe ata të mos ndërhyjnë mes meje dhe njerëzve të tjerë. Nëse dal unë fitimtar, po deshën, mund ta pranojnë edhe ata Islamin, njësoj si të tjerët. Nëse i humbur dal unë, atëherë ata do të shpëtojnë prej meje, duke arritur sakaq rehatinë e dëshiruar aq shumë. Nëse nuk e pranojnë këtë propozim, që unë po u bëj për armëpushim, unë betohem për Allahun se unë do të luftoj për këtë kauzë derisa të më ndahet koka prej trupit. Nuk ka dyshim, se Allahu do ta përmbushë premtimin e Tij!*"

- "Unë do t'ua transmetoj atyre fjalët e tua një për një!", – tha Budejli dhe u kthye, për të shkuar edhe njëherë pranë kurejshëve.

Ata u thanë atyre: - "Ne po vijmë prej atij njeriu, po deshëm t'jua themi se çfarë dëgjuam prej tij."

Pjesa më e pacipë e Kurejshëve filloi të talleshin me Budejlin: - "Ne nuk kemi nevojë për informatat e tua nga ai njeri." Kurse ata që e kishin mendjen disi në vend thanë: - "Hajdeni, na i thoni, çfarë dëgjuat nga goja e tij!"

Dhe ai ua transmetoi një më një të gjitha ç'kishte dëgjuar nga goja e Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kur i dëgjoi, i pari u ngrit Urue bin Mesudi, i cili tha: - "O popull i Kurejshëve! A nuk ju kam unë ju në vend të babait?"

- "Po, ne na ke si në vend të babait.", – u përgjigjën kurejshët.

- "Po mirë, a nuk më keni ju mua si fëmijën tuaj?"

- "Po!"

- "A keni ju ndonjë dyshim ndaj meje?"

- "Jo!"

- "Juve ju kujtohet, se si i pata thirrur të gjithë banorët e Ukadhit, që t'ju vinin në ndihmë dhe kur ata patën ngurruar, unë erdha vetë me gjithë familjen, fëmijët e mi dhe të gjithë ata të tjerët që e dëgjuan fjalën time, apo jo?"

- "Po!", – iu përgjigjën ata.

- "Atëherë, më dëgjoni. Ky njeri (për Profetin tonë) po ju bën një propozim të hairit, andaj më e mira për ju është që ta pranoni. Më lejoni mua, të shkoj e të flas njëherë me të."

- "Po, mirë, shko atëherë, po të duash."

Urueja erdhi tek i Dërguari i Allahut. Filloi t'ia shpjegonte të Dërguarit të Allahut, një e nga një, të gjitha, se si e ku qëndronte puna. Edhe i Dërguari i Allahut Urues iu përgjigj duke i thënë gati-gati të njëjtat gjëra. Kur Profeti ynë i tha:

- "*Nëse Kurejshët nuk e pranojnë armëpushimin, atëherë unë do të luftoj me ta gjersa të dalë dikush që do të m'i ndajë kryet nga ky trup.*" Urueja i tha:

- "O Muhamed! Nëse ti e shfaros të gjithë fisin tënd, atëherë, a mund të më thuash; a ke dëgjuar ndonjëherë, që në mesin e arabëve të ketë dalë ndonjë që ka shfarosur popullin e vet? Po sikur të ndodhë ndryshe? Uallahi, unë shoh se mes parisë, të cilët i njoh nga fytyra, ka edhe shumë njerëz të tjerë, që janë grumbulluar nga fise e familje të tjera. Ti e di, që shumë prej këtyre ikin nga sytë këmbët kur fillon lufta, mos të lënë vetëm pastaj."

- "Ik, mor ti, kush do t'i ikë luftës, ne?! Ne do ta lëmë vetëm?", – ndërhyri Ebu Bekri (radijallahu anhu), i cili dukej se ishte nevrikosur tej mase.

- "Kush është ky burrë?", – pyeti Urueja.

- "*Ai është Ebu Bekri!*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Unë ju betohem për Zotin, se po të mos ishte për ato të mira që më ke bërë, që ende nuk t'i kam shpërblyer dot, unë do të të isha përgjigjur!"

Urueja filloi të fliste sërish me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Sa herë që fliste, me dorë prekte dhe fërkonte mjekrën e Resulullahut (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Mugire bin Shubeja, me

shpatën në dorë dhe përkrenaren në kokë, rrinte te kryet e Resulullahut. Sa herë që dora e Urues zgjatej drejt mjekrës së bekuar të të Dërguarit të Allahut Mugireja zgjaste shpatën drejt dorës së tij dhe i thoshte:

- "Hiqe menjëherë atë dorë nga mjekra e të Dërguarit të Allahut!"

- "Kush është ky?", – pyeti Urueja, duke ngritur kokën.

- "*Ai është Mugire bin Shubeja.*"

- "Ah, mor' mosmirënjohës! Po sa jam përpjekur unë për të mbuluar padrejtësitë e tua?"

Gjatë kohës së injorancës, Mugireja kishte vrarë disa nga njerëzit me të cilët bashkëpunonte dhe ua kishte marrë atyre të gjithë pasurinë që kishin në zotërim; pastaj qe bërë mysliman. Kur pati shkuar tek i Dërguari i Allahut për t'i dhënë të gjitha ç'kishte e ku i kishte, i Dërguari i Allahut i pati thënë:

- "*Që u bëre mysliman e pranoj, por pasurinë tënde nuk mund ta zë me dorë!*"

Pastaj Urueja filloi t'i hidhte sytë drejt sahabëve edhe njëherë dhe tha: "Për Zotin, ç'është gjithë ky respekt! Të mos urdhërojë diçka i Dërguari i Allahut, sepse ngarendin kush e kush ta bëjë i pari. Edhe kur marrin abdes, duket sikur garojnë me njëri-tjetrin se kush do të marrë abdes me ujin që ka tepruar nga ujët që është larë ai! Kur flasin dhe ai është aty, e ulin zërin dhe nga respekti nuk i ngrenë sytë as për ta parë në fytyrë!"

Kur u kthye pranë shokëve të tij kurejshë, ai u tregoi atyre:

- "O njerëzit e popullit tim! Uallahi, unë kam shkuar te shumë mbretër si lajmës. Sa e sa herë më keni dërguar ju mua edhe si mëkëmbës, te Kajseri, te Kisra, apo te Nexhashiu. Lëvduar qoftë Zoti, por respektin që tregojnë për Muhamedin sahabët e tij nuk e kam rastisur kurrë në asnjë vend; nuk kam parë asnjë popull tjetër që të tregojë kaq shumë respekt karshi sundimtarit të vet! Edhe kur merrte abdes, ata dukej sikur garonin kush e kush të merrte më parë abdes me ujin që rridhte prej duarve të tij, kur fliste të gjithë heshtnin dhe e dëgjonin me vëmendjen më të madhe, madje, deri aty sa që nga respekti ata nuk guxonin as ta shihnin në sy teksa flisnin me të. Ai na ka bërë një propozim shumë të mirë, të cilin unë ju këshilloj që ta

pranoni."

Një burrë nga bijtë e Kinanes, pasi i dëgjoi të gjitha fjalët e Urues, u drejtua nga kurejshët dhe u tha:

- "Më lejoni të shkoj njëherë edhe unë tek ai!"

- "Po mirë, shko edhe ti njëherë.", – i thanë ata njëzëri.

Kur ai burrë po vinte drejt Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe sahabëve të tij, i Dërguari i Allahut tha: "Ky është filani dhe vjen nga një familje që ka respekt për devetë që bëjnë kurban ata që vijnë për të kryer haxhin në Qabe. Lëshojini menjëherë të gjitha devetë përpara, që t'i shohë kur të vijë." Devetë u lëshuan të gjitha. Sahabët nisën të thoshin: "Leb'bejk Allahum'me leb'bejk". Kështu e pritën atë njeri. Ai, kur e pa këtë pamje, nuk e mbajti dot veten pa thënë:

- "Subhanallah! Nuk shkon që ta pengojmë këtë bashkësi që të vizitojnë Qaben."

Kur u kthye pranë kurejshëve, ai u tha atyre: "Unë pashë sa e sa deve të tëra, të cilave u ishin varur në qafë varëse të bukura, të shenjuara në anën e djathtë të barkut, që tregonin se ishin për t'u prerë si kurban në Qabe. Nuk më duket e drejtë që t'i pengojmë të mos vizitojnë Qaben."

Atëherë në këmbë u ngrit dikush tjetër, të cilin e quanin Mikrez bin Hafs, i cili tha:

- "Më lejoni të shkoj edhe unë njëherë."

- "Po mirë, shko edhe ti kësaj here.", – i thanë kurejshët.

Mikrezi, teksa po vinte drejt të Dërguarit të Allahut dhe sahabëve të Tij, i Dërguari i Allahut tha:

- "*Ky që po vjen është Mikrezi, njeri shumë i keq!*"

Mikrezi filloi të fliste me Profetin tonë. Në atë kohë ia behu Suhejl bin Amri. Kur erdhi Suhejli, Profeti ynë u drejtua nga sahabët e tij dhe u tha:

- "*Tani gjithçka është shumë e lehtë.*", – duke përdorur një fjalë me nënkuptim zvogëlues, zbutës dhe lehtësues, që do të thoshte edhe 'më se e lehtë'. Suhejli, një të mbërritur, i tha Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem):

- "Eja, na i sill letrën dhe penën, e të bëjmë një marrëveshje paqeje të shkruar me ty." I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) thirri dikë që të shkruante. Kurse shkruesit i tha:

- "*Shkruaj 'Bismil'lahi'r-Rahmani'r-Rahim!*" Suhejli ndërhyri: - "Rahman? Unë nuk e di se ç'është kjo. Shkruaj siç kanë shkruar të parët tanë, 'Bismikellahum'me' (shën. ynë. ~ me emrin e Zotit tonë, Allahut).

- "Uallahi ne nuk shkruajmë asgjë tjetër përveçse 'Bismil'lahi'r-Rahmani'r-Rahim'," – reaguan njëzëri të gjithë myslimanët.

I Dërguari i Allahut tha: - "*Shkruaj 'Bismikellahum'me'.*" Pastaj i kërkoi atij të shtonte: "*Kjo është një marrëveshje e paqes e Profetit të Allahut, Muhamedit, të cilën kurejshët e kanë pranuar.*"

- "Uallahi, nëse ne do të kishim pranuar se ti je profet, ne nuk të pengonim që ta vizitoje Qaben, e as nuk do të kishim luftuar me ty!", – ndërhyri Suhejli. – "Gjë që nuk bëhet, thuaji që aty të shkruajnë Muhamedi, i biri i Abdullahut!"

- "*Edhe sikur ju të më përgënjeshtroni, pasha Allahun, unë, prapëseprapë, i Dërguari i Allahut jam.*", – tha Resulullahu dhe e urdhëroi shkruesin: – "*Shkruaj, Muhamedi, i biri i Abdullahut!*"

Zuhriu, që është një prej transmetuesve të këtij hadithi, tregon se: Arsyeja pse Resulullahu po i pranonte të gjitha kërkesat e Suhejlit ishte kjo: Profeti ynë, më herët na kishte thënë: "*Për të vizituar, në shenjë respekti, të gjitha ato territore të brendshme të Allahut, të cilat Ai i ka shpallur të bekuara, unë do t'u jap kurejshëve gjithë ç'të më kërkojnë!*"

Atëherë Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha Suhejlit:

- "*Tërhiquni, e mos na pengoni që ta vizitojmë Qaben!*" Megjithëkëtë, Suhejli iu përgjigj duke i thënë:

- "Këtë vit është e pamundur, nuk mund t'ju lëmë të hyni, në të kundërt të gjithë arabët do të na përflasin; do të thonë se ju na pushtuat, ndaj ishim të detyruar t'ju pranonim. Por, nëse doni të vizitoni Qaben, duke filluar nga viti tjetër ju mund të vini e ta vizitoni." Ja, kështu u vendos për këtë pikë të marrëveshjes.

Suhejli tha:

- "Nëse ndonjëri prej nesh, që ka pranuar fenë tënde, vjen tek ju, ju duhet ta ktheni atë tek ne."

- "Subhanallah! Si mund t'u jepet idhujtarëve mbrapsht ai që bëhet mysliman?" – kundërshtuan myslimanët.

Bash në atë kohë, aty erdhi djali i Suhejlit, Ebu Xhendeli (radijallahu anhu), i cili çalonte, pasi këmbët i kishte të lidhura me pranga. Ebu Xhendelin e kishin burgosur idhujtarët, sepse kishte pranuar Islamin, duke u bërë mysliman. Kishte bërë si kishte bërë dhe ia kishte dalë të arratisej nga vendi ku e kishin mbyllur dhe e kishte mbajtur frymën te myslimanët.

- "Kjo është vetëm e para nga pikat mbi të cilat ne do të arrijmë bashkë një marrëveshje! Ti duhet të ma japësh mua atë."

- "*Ne nuk e kemi nënshkruar ende marrëveshjen.*", – tha ai.

- "Po nuk ma dhe, uallahi unë nuk kam për të nënshkruar asnjë marrëveshje me ty.

- "*Atëherë, na e fal këtë, pastaj nënshkruaje marrëveshjen.*"

- "Nuk jua fal dot!"

- "*Bëje për mua këtë!*", – i kërkoi Profeti ynë.

- "Nuk mund ta bëj!", – u përgjigj Suhejli.

Në atë kohë, përfaqësuesi tjetër i kurejshëve u hodh e tha:

- "Në rregull, atë ta kemi falur." Megjithatë, Suhejli ende nuk pranonte. Ebu Xhendeli, i cili po e humbte shpresën se babai mund të hiqte dorë nga e tija, ulëriti:

- "O myslimanë! Unë kam ardhur tek ju si mysliman, ç'do të bëni, do të më ktheni pas, duke më lënë në duar të idhujtarëve? A nuk e shihni se si më kanë katandisur?"

Vërtet, Ebu Xhendeli kishte duruar shumë tortura të rënda në emër të Allahut. Omeri (radijallahu anhu) tregon: Shkova pranë Profetit tonë dhe i thashë:

- "A nuk je ti Profeti i Vërtetë i Allahut?"

- "*Po, Profeti i Allahut jam.*"

- "A nuk jemi ne në të drejtë dhe armiqtë tanë në të rremen?"

- "*Po, ashtu është!*", – m'u përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Atëherë, pse duhet të bëjmë ne lëshim prej fesë sonë, e të poshtërojmë veten kundrejt kësi njerëzish të padrejtë?", – e pyeta.

- "*Unë jam Profeti i Tij, e unë nuk e kam kundërshtuar Atë. Ai (xh.sh.) është Ndihmësi im!*"

- "Po mirë, a nuk na pate thënë ti, se shumë shpejt ne do të mund ta vizitojmë Qaben dhe do të mund t'i vijmë asaj përreth?"

- "*Po, e vërtetë është, jua kam thënë! Por, a të kam thënë se do të shkojmë ta vizitojmë sivjet?*"

- "Jo, asnjëherë! Asnjëherë nuk na ke thënë se do të shkojmë sivjet!"

- "*Atëherë, nuk ka dyshim, se ti do të shkosh një ditë e do t'i vish Qabes rrotull!*", – më tha.

Pastaj shkova pranë Ebu Bekrit dhe i thashë: "O Ebu Bekr! A nuk është ai Profeti i Vërtetë i Allahut?"

- "Profeti i së vërtetës është!", – m'u përgjigj ai.

- "Atëherë, a nuk jemi ne në të drejtë, ndërsa armiqtë tanë në të rremen?", – e pyeta.

- "Po, kjo është e vërteta!"

- "Atëherë, pse jemi ne ata që duhet të bëjmë lëshim prej fesë sonë, e të pranojmë që të poshtërohemi prej tyre?"

- "More njeri! Ai është i Dërguari i Allahut dhe për këtë nuk ka grimcë dyshimi! As nuk po ngre krye, në asnjë mënyrë, ndaj Zotit të Tij! Ai, medoemos që do ta ndihmojë. Ti mjafton që të qëndrosh i lidhur sa më fort pas urdhrave të tij. Për Zotin, ai është në anën e së vërtetës!"

- "Dakord, por a nuk na thoshte ai, se shumë shpejt ne do të shkojmë në Qabe dhe do të mund ta vizitojmë shtëpinë e Zotit?", – e pyeta unë.

- "Po, kështu na thoshte.", – m'u përgjigj Ebu Bekri, duke më pyetur: – "Por, a të ka thënë ndonjëherë se do ta vizitosh këtë vit?"

- "Jo.", – iu përgjigja unë.

- "Atëherë, nuk ka asnjë dyshim, se ti një ditë do të shkosh në Qabe

dhe do ta vizitosh e do të kesh mundësi të shëtitësh rreth saj."

Omeri (radijallahu anhu) thotë: "Jam penduar shumë për ato fjalë që kam thënë atë ditë dhe kam dhënë shumë lëmoshë, kam falur shumë namaz, kam mbajtur shumë agjërim dhe kam liruar shumë skllevër, e kam bërë shumë të mira të tjera, vetëm e vetëm për të shpëtuar nga barra e atij gabimi."

Transmetuesi i hadithit tregon se: "Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur kishin mbaruar të gjitha punët e shkrimit dhe të gjitha rregullimet e nevojshme mbi shkrimin e marrëveshjes, u drejtua nga sahabët, për t'u thënë:

- "*Tani, ngrihuni, pritini kurbanet tuaja dhe qethini flokët.*"

Uallahi, asnjëri prej tyre nuk u ngrit. Madje, i Dërguari i Allahut e përsëriti plot tri herë këtë urdhër. Kur pa se askush nuk po ngrihej, Profeti ynë shkoi pranë Umu Selemes, njëra prej grave të tij; i tregoi se sahabët nuk po ia dëgjonin fjalën. Umu Selemeja, e cila ia kuptoi menjëherë trishtimin, i tha:

- "O i Dërguari i Allahut, a doni që ata t'jua dëgjojnë fjalën e të bëjnë atë që ju i kërkoni? Atëherë dilni atje dhe mos flisni me asnjërin prej tyre, derisa t'i keni prerë ju njëherë kurbanet tona dhe të kesh qethur flokët!" Dhe i Dërguari i Allahut ashtu bëri, pa folur me askënd, preu devetë që kishte ndarë si kurbane për veten, thirri berberin e tij dhe i kërkoi që t'i priste flokët. Sahabët, kur e panë se i Dërguari i Allahut i kishte prerë të gjitha kurbanet e veta dhe tanimë ishte duke u qethur, nisën të gjithë të thernin secili kurbanet e veta, e të ndihmonin njëri-tjetrin për të prerë flokët. Madje, teksa qetheshin ishin aq të mërzitur, saqë dukej sikur do të ngriheshin në këmbë e do të hanin njëri-tjetrin me dhëmbë. Kur mbaroi prerja e flokëve e të Dërguarit të Allahut, pranë tij erdhën besimtaret gra. Pikërisht në atë çast Allahu zbriti këtë ajet:

"**O besimtarë, kur ju vijnë besimtaret të mërguara, provoni** (besimin) **tek ato. Allahu e di më mirë besimin e tyre. Nëse bindeni se ato janë besimtare, mos i ktheni te jobesimtarët. Ato nuk janë** (bashkëshorte) **të ligjshme për ata dhe as ata nuk janë** (bashkëshortë) **të ligjshëm për ato. Kthejuni jobesimtarëve pajën, që u kishin dhënë atyre. Nuk ka**

pengesë që t'i merrni ato për bashkëshorte, pasi t'u jepni pajën e martesës. Mos qëndroni në martesë me idhujtare. Kërkoni atë që keni dhënë (si pajë)**, por dhe jobesimtarët le të kërkojnë atë që kanë dhënë. Ky është ligji i Allahut, Ai ju gjykon ju; Allahu di çdo gjë dhe është i Gjithëdijshëm e i Urtë.**" (Mumtehine, 60/10)

Kur zbriti ky ajet, atë ditë Omeri (radijallahu anhu) i ndau menjëherë dy gratë e tij që ishin idhujtare. Me njërën prej tyre u martua Muauije bin Ebu Sufjani, ndërsa me tjetrën u martua Safuan bin Umejjeja.

Një herë tjetër, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u kthye në Medinë. Pas tij, për t'u takuar me të, aty erdhi Ebu Basiri (radijallahu anhu) nga radhët e kurejshëve, i cili ishte bërë mysliman. Kurejshët dërguan dy përfaqësues për ta marrë mbrapsht: - "Na ke dhënë fjalën, të kujtohet?", – i thanë ata të Dërguarit të Allahut. I Dërguari i Allahut ua dorëzoi Ebu Basirin dhe ata u nisën për rrugë, që të ktheheshin në Mekë. Kur mbërritën në vendin e quajtur Dhul-Hulejfe, ata vendosën të ndalonin e të hanin nga hurmat që kishin me vete. Ebu Basiri iu drejtua njërit prej tyre dhe i tha: - "Më duket se ti paske një shpatë shumë të mirë."

- "Po, për Zotin e kam shumë të mirë shpatën; e kam provuar disa herë.", – u përgjigj ai menjëherë, duke e nxjerrë shpatën nga milli.

- "Do të ma japësh që ta shoh pak?", – e pyeti Ebu Basiri dhe ia mori menjëherë nga dora, duke përfituar nga rasti dhe një të goditur i jep atij njeriu dhe e la të vrarë në vend.

Tjetri u arratis nga sytë këmbët dhe u kthye prapë drejt Medinës. Shkoi në faltore dhe kur e pa në këtë gjendje, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e pyeti: - "Këtij njeriu duhet t'i kenë parë sytë diçka shumë të tmerrshme."

- "U vra! Uallahi, shoku im u vra! Do të më vrasin edhe mua!", – tha ai, kur u afrua tek i Dërguari i Allahut.

Në atë kohë vjen Ebu Basiri dhe thotë: - "O Resulullah, ti e mbajte fjalën e dhënë duke më dorëzuar tek ata. Pastaj Allahu më shpëtoi mua nga duart e tyre."

Atëherë, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha: "Aman! Ebu Basiri do të na prishë marrëveshjen!" Kur e dëgjoi Ebu Basiri, që

i Dërguari i Allahut tha këto fjalë, e kuptoi menjëherë se ai do ta dorëzonte sërish te kurejshët. Doli menjëherë dhe frymën e mbajti në drejtim të bregut të detit.

Transmetuesi thotë se: "Edhe djali i Suhejlit, Ebu Xhendeli, u shpëtoi kurejshëve dhe u bashkua me Ebu Basirin. Hyri në Islam. Çdokush që arratisej nga kurejshët shkonte tek Ebu Basiri. Në fund, ata u bënë një bashkësi shumë e madhe. Uallahi, kur dëgjonin që një karvan i kurejshëve ishte vënë në rrugë për të shkuar në Siri, ata i sulmonin, vrisnin udhëtarët dhe tregtarët dhe u merrnin pasurinë. Kur panë se si po shkonte kjo punë, kurejshët i dërguan lajm të Dërguarit të Allahut, që ai t'i çonte lajm Ebu Basirit dhe ua kishin lejuar që ata t'u bashkoheshin radhëve të besimtarëve. Kësisoj, ata pranuan vetë se po hiqnin dorë nga ajo pikë e marrëveshjes, e cila e detyronte të Dërguarin e Allahut që t'ua kthente kurejshëve të gjithë ata që do të bëheshin myslimanë, pas marrëveshjes, dhe shkonin në Medinë. Ata e siguruan të Dërguarin e Allahut se nuk do t'i kërkonin që t'ua dorëzonte Ebu Basirin dhe besimtarët e tjerë që ishin me të. Kështu, edhe i Dërguari i Allahut i dërgoi lajm Ebu Basirit dhe shokëve të tij, që mund të shkonin në Medinë. Pas kësaj, Allahu i Madhërishëm zbriti këto ajete: "**Është Ai që i ka penguar duart e tyre ndaj jush dhe duart tuaja ndaj tyre në Mekë, pasi ju dha fitoren mbi ata. Allahu i sheh të gjitha çfarë bëni ju. Jobesimtarët ju ndaluan t'i afroheni Xhamisë së Shenjtë dhe** (penguan) **kafshët për kurban, që të arrinin në vend. Po të mos kishte qenë për disa besimtarë e besimtare** (në Mekë) **që ju nuk i njihnit, e kështu mund t'i merrnit nëpër këmbë, duke bërë gjynah kundrejt tyre pa e ditur, Allahu do t'ju kishte urdhëruar t'i luftonit ata. Sikur ata të ishin veç, Ne do t'i ndëshkonim me dënim të dhembshëm ata** (banorë të Mekës)**, që nuk besuan. Dhe, kur në zemrat e mohuesve u shfaq zelltaria pagane, Allahu zbriti qetësinë e Tij në zemrën e të Dërguarit të Tij dhe të besimtarëve, e i bëri ata të mbështeten fort në fjalën e përkushtimit** (ndaj Allahut)**. Ata kishin me të drejtë e qenë më të denjë për të. Allahu është i gjithëdijshëm për çdo gjë.**" (Fet'h, 48/24-26)

Injoranca dhe fanatizmi i tyre më i madh, ishte të mohonin se Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte i Dërguar i Allahut; nuk

pranonin as *besmelenë*, si dhe që t'i pengonin besimtarët me çdo çmim, që ata të mos e vizitonin Qaben.[89]

Profeti ynë dërgon Osmanin (r.a.) në Mekë

Urveja (radijallahu anhu) tregon: "Kurejshët i kaploi frika se mos Profeti ynë zbriste në Hudejbije. Prandaj, i Dërguari i Allahut deshi të dërgonte njëherë një prej tyre tek ata. Për këtë punë thirri Omerin (radijallahu anhu).

- "O Resulullah, po unë nuk them asgjë veç mallkimeve për ata njerëz. Megjithëse nuk kanë lënë asnjë torturë apo të keqe pa më bërë, nuk ka asnjë prej bijve të Kabit që të më vijë në ndihmë për të më mbrojtur. Dërgo më mirë Osmanin, se ai ka atje të gjithë familjen dhe fisin; ai mund t'ua transmetojë më lehtë lajmet tuaja."

Kështu, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ngarkoi me këtë punë Osmanin (radijallahu anhu) dhe kur e nisi e urdhëroi:

- "*Thuaju atyre se nuk po shkojmë për të luftuar, por për të vizituar Qaben* (për Umre). *Si edhe mos harro t'i ftosh ata të pranojnë Islamin.*" Veç kësaj, ai e porositi Osmanin (radijallahu anhu) të shkonte të vizitonte edhe burrat e gratë besimtare të Mekës, t'i qetësonte ata dhe t'u thoshte se Allahu kishte dhënë sihariqin e ngadhënjimit të Islamit në Mekë. Osmani u nis për rrugë. Në një vend të quajtur Beldah, fare pranë Mekës, ai u takua me kurejshët.

- "Ku shkon kështu?", – e pyetën ata Osmanin.

- "Kam ardhur t'ju ftoj që t'i besoni Allahut të Shenjtë e të Gjithëfuqishëm dhe ta pranoni Islamin. Nuk kam ardhur këtu për të luftuar me ju; Më ka dërguar i Dërguari i Allahut t'ju lajmëroj se ne do të vijmë për Umre.", – u përgjigj ai, duke ua bërë të ditura të tëra porositë që i kishte dhënë Resulullahu.

- "Në rregull, i dëgjuam ç'kishe për të na thënë. Tani vazhdo, bëj çfarë ke për të bërë.", – i thanë kurejshët.

Eban bin Said el-Asi u çua, shkoi pranë Osmanit (radijallahu anhu) dhe e priti, duke i thënë: - "Mirë se erdhe!" I rregulloi frerët e kalit dhe

[89]. Buhari, 2/974.

e mori nën mbrojtje dhe, ja kështu hynë ata në Mekë...”[90]

Mendimi i Omerit (r.a.) për Paqen e Hudejbijes

Ibni Abasi (radijallahu anhu) ka treguar se Omeri (radijallahu anhu) ka thënë kështu: “I Dërguari i Allahut u mor vesh me popullin e Mekës në një pikë të atillë, duke u njohur atyre një privilegj aq të madh, që sikur Profeti ynë (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) të më kishte vendosur një prijës mbi krye dhe ai të vepronte njësoj siç veproi Resulullahu as nuk do ta dëgjoja, as nuk do t’i bindesha. Ja se cila ishte ajo pikë: “Ata që bëheshin myslimanë dhe arratiseshin nga radhët e idhujtarëve dhe vinin për t’u strehuar te myslimanët, pala e besimtarëve duhet t’i kthente sërish mbrapsht tek idhujtarët. Kurse ata nuk do t’i kthenin të kthyerit që shkonin për të kërkuar strehim pranë tyre.”[91]

Mendimi i Ebu Bekrit (r.a.) për Paqen e Hudejbijes

Ebu Bekri (radijallahu anhu) thoshte kështu: “Asnjë ngadhënjim i arritur prej Islamit nuk ka qenë një fitore aq madhështore sa ç’ishte ngadhënjimi i Mekës. Por, atë ditë, me direktivat e Zotit tonë dhe të Profetit të profetëve, horizonti i njerëzve nuk ishte edhe aq i gjerë. Njerëzit nguteshin. Mirëpo, Allahu nuk ngutet, siç bëjnë rëndom robt e Tij, derisa të vijë çasti i duhur, që punët hyjnë në vijën e tyre. Gjatë Haxhit të Lamtumirës, pashë njëherë Suhejl bin Amrin, i cili kishte qenë mëkëmbës e përfaqësues i kurejshëve për Marrëveshjen e Hudejbijes. Qëndronte në këmbë në vendin ku ishin duke u therur kurbanet, e Resulullahu sillte një e nga një devetë e caktuara për kurban. Pastaj Profeti ynë thirri berberin, i cili na preu flokun të gjithëve. Unë rrija dhe sytë i hidhja andej nga Suhejli. I Dërguari i Allahut i mblidhte flokët e prerë dhe më duket se i vinte mbi flokë. Në atë çast m’u kujtua kundërshtimi i tij në Hudejbije, që nuk pranonte me ngulm që të shkruhej ‘Bismil’lahi’r-Rahmani’r-Rahim’, apo ‘Muhamedi, i Dërguari i Allahut’ dhe falënderova Allahun që tanimë e kishte nderuar atë me pranimin e Islamit!”[92]

[90]. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal,* 10/754 (30152).
[91]. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal,* 10/749 (30137).
[92]. El-Hindi, *Kenzu’l-Ummal,* 10/749 (30137).

16. HISTORIA SE SI U BË MYSLIMAN AMR BIN ASI

Amr bin Asi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Ditën që u kthyem nga beteja e Hendekut, i mblodha të gjithë ata kurejshë që i pranonin dhe i vlerësonin mendimet e mia, e që ma dëgjonin fjalën, dhe u thashë: "Uallahi, edhe ju e dini që unë po shoh se misioni i Muhamedit po përjeton një zhvillim të jashtëzakonshëm dhe sa vjen e po pranohet më shumë nga njerëzit. Unë kam një mendim, si thoni?"

- "Çfarë mendimi ke?", – më pyetën ata.

- "Të shkojmë në Abisini, të kërkojmë strehim atje. Të qëndrojmë atje. Nëse ne jemi nën mbrojtjen Nexhaxhiut dhe Muhamedi e mund popullin tonë, atëherë do të jemi më mirë nën mbrojtjen e mbretit, se sa nën urdhrat e Muhamedit. Nëse fitimtar del populli ynë, ata na njohin dhe prej tyre neve nuk na vjen asnjë e keqe."

- "Ky qenka një mendim me të vërtetë shumë i mirë!", – thanë ata të gjithë njëzëri.

- "Atëherë filloni të mblidhni dhurata të mëdha, që t'ia japim Nexhashiut, kur të na nxjerrin përpara tij."

Dhurata më e mirë që ne mund t'i çonim nga trevat tona ishte lëkura e punuar. Mblodhëm shumë lëkurë dhe u nisëm, derisa, më në fund, udhëtimit tonë i erdhi fundi dhe ne mbërritëm te Nexhashiu. Kur ishim përballë tij, përpara na doli Amr bin Umejetu-Damriu, të cilin e kishin dërguar të interesohej për gjendjen e Ebu Xhaferit dhe shokëve të tij. Erdhi te Nexhashiu dhe pasi qëndroi i heshtur për pak çaste, doli. Unë u thashë shokëve të mi: "Ky është Amr bin Umejeja! Kur të dal përpara Nexhashiut, do t'i kërkoj që të ma japë mua dhe unë do ta marr e do ta vras. Po e bëra këtë, kurejshët do të më përgëzojnë, e do të më quajnë se kam vrarë lajmësin e Muhamedit."

Dola përpara Nexhashiut dhe ashtu siç kisha bërë përherë, iu përula në sexhde. Nexhashiu më priti, duke më thënë:

- "Mirë se erdhe, miku im! A më ke sjellë ndonjë dhuratë nga vendi juaj?"

- "Po, o sundimtar! Të kam prurë shumë lëkurë të mira.", – iu përgjigja unë dhe ia shtrova lëkurët përpara këmbëve. Dukej që i

pëlqyen shumë dhe mbeti menjëherë shumë i kënaqur.

- "O mbret! Pashë një burrë që ishte këtu pak më parë. Ai është lajmësi i armikut tonë. Ma jep mua ta vras; ai ka vrarë e ka dëmtuar shumë prej njerëzve më të nderuar në radhët tona."

Nexhashiu u nxeh. Sikur të ishte çarë toka në mes e të isha futur në dhe më mirë, se sa të më pushtonte gjithë ajo frikë që ma pushtoi zemrën. Pastaj, për ta zbutur, i thashë: "O sundimtar, për Zotin, po ta dija se kjo kërkesë imja do të të mërziste kaq shumë, nuk do të ta kisha kërkuar!"

- "Domethënë ti kërkon lejen time për të vrarë kasnecin e një njeriu, të cilit i ka ardhur Zbritësi i Shpalljes (Xhibrili), ai që dikur i pat ardhur edhe Musait?"

- "Imzot, pse një njeri i atillë është ai?", – e pyeta unë.

- "Turp të kesh, o Amr! Më dëgjo mua dhe bindju atij njeriu. Uallahi ai është në të drejtë. Ai ka për të dalë fitimtar mbi armiqtë e tij, njësoj siç Musa bin Imrani doli fitimtar kundër faraonit dhe gjithë ushtrive të tij!", – tha Nexhashiu.

- "A e pranon ndërmjetësinë time, nëse unë e lidh besën me ty në emër të tij?", – e pyeta unë

- "Po, e pranoj.", – m'u përgjigj ai.

Zgjati dorën dhe unë pranova Islamin. Pastaj, kur u ktheva te shokët e mi, patjetër që kisha hequr dorë nga mendimi me të cilin kisha hyrë te Nexhashiu; megjithatë ua mbajta të fshehtë që isha bërë mysliman. Dhe, kësisoj, u largova nga Abisinia, për të shkuar tek i Dërguari i Allahut. Në rrugë takova Halid bin Uelidin. Ishte pak kohë para se të ndodhte ngadhënjimi i Mekës. Halidi po vinte nga Meka. I thashë:

- "Për ku je nisur kështu, o Ebu Sulejman?"

- "Uallahi, fitimtar doli ai (duke pasur parasysh Profetin tonë). Ai është vërtet profet i Zotit! Tani po shkoj për tek ai. Do të bëhem mysliman! Deri kur do të vazhdojë kështu kjo luftë?"

- "Uallahi, edhe unë nuk kam ndonjë qëllim tjetër, pasi edhe unë kam ardhur të bëhem mysliman.", – i thashë unë.

Shkuam në Medinë, pranë Profetit të nderuar. I pari hyri Halidi dhe

pranoi Islamin. Pastaj u afrova unë dhe i thashë:

- "O Resulullah, unë do ta lidh besën me ty, vetëm nëse do të m'i falësh të gjitha gabimet e së shkuarës. Të mos i them që tani mëkatet që do të bëj në të ardhmen."

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili e dëgjoi kërkesën time, tha: - "Eja, o Amr, bindu, sepse Islami i fshin të gjithë mëkatet e kryera para ardhjes së tij. Mërgimi i fshin edhe më shpejt të gjitha të këqijat e njeriut."

Kështu, unë iu binda, pranova Islamin dhe u ktheva andej nga kisha ardhur."[93]

Mjaft interesante janë edhe hollësitë e përshkruara në transmetimin e Bejhakiut, i cili na vjen nëpërmjet Uakidiut:

"... (Amr bin Asi thotë se:) Pastaj unë vijova rrugën. Kur mbërrita në vendin e quajtur Hidde, që gjendej diku mes Taifit dhe Mekës; jo shumë kohë, por pak përpara meje, aty kishin ardhur dy burra, të cilët ishin duke hyrë në çadër. Njëri qëndronte brenda çadrës, ndërsa tjetri jashtë, mbante edhe dy kafshët e rrugës. Pashë njëherë; ishte Halid bin Uelidi.

- "Për ku je nisur kështu?", – e pyeta.

- "Për te Muhamedi po shkoj. Nuk mbeti më njeri me mend në kokë pa hyrë në Islam. Uallahi, mendoj se po u vonova edhe pak, edhe ne kanë për të na kapur për zverku, ashtu siç kapen hienat!", – m'u përgjigj.

- "Uallahi, edhe unë për te Muhamedi jam nisur, kam vendosur të bëhem mysliman.", – i thashë.

Pashë njëherë, nga çadra doli Osman bin Talhaja, i cili më tha: - "Mirë se erdhe!" Aty qëndruam të tre, duke u marrë vesh se do ta bënim bashkë pjesën e mbetur të rrugës deri në Medinë. Kur iu afruam pusit të Ebu Utbes, nuk e harroj që dëgjova një burrë që thërriste: "O Rebbah! O Rebbah!" Na u dukën si ogur ato fjalë të atij njeriu, të cilat kishin kuptimin e "fitimit" dhe vazhduam rrugën. Pastaj pamë se ai burrë po shihte nga ne dhe ma merr mendja se e kishte me Halidin kur mërmëriste:

[93]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 4/198 (17812).

- "Përderisa po e pranojnë edhe këta të dy Islamin, kjo do të thotë se Meka i dorëzoi përfundimisht çelësat e saj."

Ai burrë filloi të rendte dhe shkoi drejt e në faltore. Ma merr mendja se po lajmëronte të Dërguarin e Allahut për ardhjen tonë. Dhe ashtu siç pandeha unë edhe ndodhi. I ulëm devetë në gjunjë në vendin e quajtur Harre dhe u veshëm me rrobat tona më të mira. Pak më vonë u këndua ezani i ikindisë. Shkuam tek i Dërguari i Allahut. Fytyra i shndriste ashtu siç shndrin hëna e plotë. Të gjithë myslimanët kishin krijuar një hallkë të bukur rreth tij. Ishin shumë të lumtur, që ne kishim pranuar Islamin. I pari hyri Halid bin Uelidi, i cili shprehu se andej e tutje kishte pranuar Islamin. Pas tij u afrua Osman bin Talhaja dhe pas tij hyra unë. Uallahi, nga turpi, kur iu ula përballë, nuk i ngrija dot sytë që ta shihja në fytyrë. Nuk më shkoi mendja që t'ia thosha mëkatet që do të bëja në të ardhmen. Por ai më tha: "Islami i pastron e i fshin të gjitha mëkatet e kryera përpara tij, ndërsa mërgimi i fshin të gjitha gabimet e së shkuarës."

Ju betohem në Allahun, se që nga ai çast që u bëmë myslimanë, Resulullahu nuk ka mbajtur kurrë asnjë sahab tjetër të tij më lart se ne, në çdo çështje që për të ishte e rëndësishme."[94]

17. HALID BIN UELIDI PRANON ISLAMIN

Halidi (radijallahu anhu) tregon: "Kur Allahu vendosi më të mirën për mua, duke më hedhur në zemër një shkëndijë dashurie për Islamin, atëherë mund të them se më erdhi mendja në vend. Thashë njëherë me vete: 'Unë kam marrë pjesë në të gjitha luftërat që janë bërë kundër Muhamedit. Sa herë që kthehesha nga lufta, e ndieja se isha duke u munduar për një punë të kotë dhe e shihja se herët a vonë do të ishte Muhamedi ai që do të dilte ngadhënjimtar.' Kur Resulullahu u doli në Hudejbije, mora edhe unë një grup kalorësish dhe dola atje. Atë e hasa në vendin e quajtur Usfan, ishte bashkë me disa nga sahabët e tij. Bëra ca hapa përpara, në mënyrë që të ishim në të njëjtin drejtim e ai të mund të më dallonte. Doli përpara tyre dhe u fali atyre namazin e drekës. Edhe pse donim t'i sulmonim, e kishim të pamundur. Kjo

[94]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/238.

duhet të kishte një domethënie të veçantë. Duhet ta kishte kuptuar se ç'kishim në mendje, që i lidhi të dy namazet me njëri-tjetrin, duke u falur sahabëve edhe namazin e ikindisë. Kjo më preku shumë; 'këtë njeri vërtet që e mbron një Fuqi e veçantë.'"

U largua nga ne, duke marrë në të djathtë. Kur bëri paqe me kurejshët në Hudejbije dhe kurejshët e detyruan të kthehej mbrapsht, andej nga kishte ardhur, atëherë thashë me vete: "E ç'më mbeti mua? Po tani, ku të shkoj? A të shkoj te Nexhashiu? Po edhe ai i besoi Muhamedit dhe tashmë tek ai jetojnë të sigurt edhe sahabët. Të shkoj te Herakliu, të braktis fenë time e të pranoj të bëhem i krishterë ose jahudi? Apo të qëndroj në Iran? Apo të kthehem në Mekë, dhe të qëndroj në vendlindjen time, bashkë me të tjerët, njësoj si ta? Dhe, ja, teksa mendjen e kisha të zënë me gjithë këto mendime, në Mekë po vinte Profeti për të bërë kazanë e umres që nuk e kishte bërë dot një vit më parë, si pasojë e Marrëveshjes së Hudejbijes. Duke qenë se atëherë përpiqesha të mos takohesha me askënd, as atë nuk e pashë dot. Në Mekë, bashkë me të Dërguarin e Allahut kishte ardhur edhe vëllai im, Uelid bin Uelidi, i cili më kishte kërkuar gjithandej dhe kur nuk më kishte gjetur dot, kish lënë këtë letër:

"Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit... Nuk kam parë ndonjëherë gjë më të habitshme se kjo; si ka mundësi që një njeri si ti, kaq i zgjuar, i shmanget Islamit, duke u rrekur që si e si që të mos e pranojë atë. Kush është ai njeri që mund të dojë të mbetet i paditur karshi një feje si Islami? I Dërguari i Allahut më ka pyetur, '*Ku është Halidi?*', – dhe unë gjithmonë i jam përgjigjur: - 'Do ta sjellë Allahu.' Ndërsa ai më thotë gjithmonë: - '*Si ka mundësi, është shumë për t'u habitur që një njeri si Halidi të mos e kuptojë e të mos e pranojë Islamin! Sikur me trimërinë dhe seriozitetin e tij të gjendej në radhët e myslimanëve, kjo do të kishte qenë shumë herë më e mirë për të, e ne do ta mbanim atë më lart se të tjerët.*' Kështu që, vëllai im, të duhet të heqësh dorë e të mos i humbasësh më të gjitha këto të mira e mbarësi që të kanë aq shumë hije."

Halid bin Uelidi (radijallahu anhu) thotë se: "Kur më erdhi letra që vëllai kishte lënë për mua, seç ndjeva njëfarë lehtësimi dhe më dukej se tani mund të dilja mes njerëzve. M'u shtua edhe më shumë simpatia për Islamin. Ndërsa fakti që vetë Resulullahu kishte pyetur për mua

me emër më gëzoi pa masë. Në ëndërr pashë sikur nga mesi i një shkretëtire të ngushtë dhe të thatë dola drejt një vendi të gjelbër e të paanë dhe në shpirt seç më vetiu sikur 'kjo ëndërr do të bëhej realitet.' Kur të shkoj në Medinë, do t'ia tregoj ëndrrën njëherë Ebu Bekrit. Ia tregova dhe ai ma interpretoi kështu:

- "Ai vend i gjelbër, plot gjelbërim, dhe i gjerë e i paanë është shenjë se Allahu ka vendosur udhëzimin tënd në Islam. Ndërsa vendi i ngushtë ku je tani është idhujtaria."

"Kur vendosa të dilja përpara të Dërguarit të Allahut, me kë të shkoj thashë me vete. Në rrugë u hasa me Safuan bin Umejen. E pyeta: "O Ebu Uehb, a nuk e sheh se si jemi katandisur, kemi mbetur një grusht njerëzish; po sikur të shkojmë e t'i besojmë Islamit! Nderimet për Muhamedin do të jenë edhe nderimet tona!" Si i çmeritur m'u përgjigj: "Sikur të gjithë t'i bashkohen atij dhe të mos mbetet askush tjetër përveç meje, prapë as nuk e pranoj, as nuk e ndjek!"

U ndamë nga njëri-tjetri. Me vete thashë: "Ky ka humbur vëllanë dhe babanë në Bedër." Takova djalin e Ebu Xhehlit, Ikrimen, e edhe atij të njëjtat gjëra i thashë. Edhe ai m'u përgjigj po njësoj. – "Mirë.", – i thashë Ikrimes, – "këto që folëm të mbeten mes nesh." – "Në rregull, mos ki merak.", – m'u përgjigj. Shkova në shtëpi dhe u kërkova që të më përgatitnin kafshën, se do të nisesha për rrugë. U nisa. Në rrugë rastisa Osman bin Talhanë. Me vete thashë, "ky është shoku im, po sikur t'ia them ato që më shkojnë nëpër mend." Pastaj, kur kujtova se edhe atij i ishin vrarë shumë kushërinj, u stepa. Do të vazhdoj rrugën, pastaj i thashë vetes: "Ç'të duhet ty me kushërinjtë e tij, më e mira është t'i them njëherë."

- "Ne jemi si dhelpra në fund të pusit, që po të hedhë dikush një kovë me ujë, dalim menjëherë.", – i thashë atij, duke shtuar edhe të gjitha ato që u kisha thënë dy miqve të mi. Ai e pranoi menjëherë ftesën time.

- "Unë u nisa sot dhe dua të vazhdoj rrugën, ja ku e kam edhe kafshën e transportit.", – i thashë.

U morëm vesh dhe e lamë të takoheshim në vendin e quajtur Jexhuxh. Kush mbërrinte i pari do të priste tjetrin. U nisëm në agim. Ende pa dalë mirë dielli, u takuam me njëri-tjetrin, siç e kishim lënë,

në Jexhuxh. Vazhduam rrugën pa ndërprerje, deri kur mbërritëm në Hide. Atje u takuam me Amr bin Asin. – "Mirë se keni ardhur.", – na tha. – "Mirë se ke ardhur edhe ti.", – ia pritëm edhe ne.

- "Për ku jeni nisur kështu?", – na pyeti Amri.

- "Po ty ç'të ka shtyrë që e ke marrë këtë rrugë?", – i thamë ne, por edhe ai të njëjtën pyetje na bëri.

- "Kemi ardhur të pranojmë Islamin dhe t'i besojmë Muhamedit.", – iu përgjigjëm ne.

- "Edhe mua po i njëjti mendim më ka shtyrë që ta marr këtë rrugë.", – qe përgjigja e tij.

Kështu u bëmë bashkudhëtarë, sepse të gjithë rrugën e mbetur deri në Medinë e bëmë të pandarë nga njëri-tjetri. Kur erdhëm, me sa dukej atë e lajmëruan menjëherë. Edhe ai ishte kënaqur shumë për ardhjen tonë. Vesha menjëherë rrobat më të mira që kisha marrë me vete dhe u nisa duke ecur, të shkoja te Resulullahu. Doli të më priste vëllai im Uelidi, duke na thënë: - "Nxito! I Dërguari i Allahut ka marrë vesh se ke ardhur ti dhe është shumë i kënaqur; po ju pret!"

Aty i nxituam hapat. Shkova menjëherë pranë tij. Më buzëqeshte pareshtur. Qëndrova mu përballë tij; unë e përshëndeta atë ashtu siç përshëndeten profetët. E pranoi përshëndetjen tonë me atë buzëqeshjen e tij aq të bukur. Unë i thashë: - "Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut, që meriton të adhurohet dhe nuk ka kurrfarë dyshimi se ti je i Dërguari i Allahut."

- "*Eja, lëvduar qoftë Allahu që të udhëzoi ty në të drejtën. Të kam njohur përherë si njeri të zgjuar. Gjithmonë kam dashur që ajo mendje të të printe ty veçse kah më e mira!*", – m'u përgjigj ai.

- "O Resulallah, në çdo luftë që është bërë me ty, unë kam parë se unë luftoja me të Drejtën (Hakk'un-Allahun) më shumë nga inati. Lutju Allahut, që të m'i falë mëkatet që kam bërë."

- "*Me Islamin fshihen të gjitha mëkatet e bëra para pranimit të tij, o Halid. Megjithatë, mirë është që ju të vazhdoni t'i luteni Allahut që Ai t'ju falë!*"

Nuk ma prishi dhe filloi të lutej: "*O Zoti im! Falja Halid bin Uelidit të gjitha të këqijat e ato që ka bërë për t'i larguar njerëzit nga udha Jote!*"[95]

[95]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/238; El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/352 (37024).

18. NGADHËNJIMI I MEKËS

Kur i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u vendos në Merru'dh-Dhahran, Abasi (radijallahu anhu) i tha:

- "Mjerë për kurejshët! Uallahi, nëse i Dërguari i Allahut do të hyjë në Mekë me forcë, pa i kërkuar njëherë kurejshët të falur, atëherë ta dini se për kurejshët nuk ka më shpëtim!"

Pastaj vazhdoi të thoshte: - "Hipa në mushkën e bardhë të të Dërguarit të Allahut dhe duke dalë nga radhët e ushtrisë, mbi shpinën e saj, arrita në zonën e Erakut. Thashë mos takohem me ndonjë që ka dalë për drurë, ndonjë çoban, apo ndonjë që ka dalë për ndonjë punë tjetër të tijën dhe i them; ai shkon dhe lajmëron mekasit se ku ndodhet i Dërguari i Allahut dhe ata vijnë që t'i kërkojnë të falur; kësisoj, i Dërguari i Allahut nuk do të ndihet i detyruar të përdorë forcën kundër Mekës."

Uallahi; ndërkohë që unë po përpiqesha të përmbushja qëllimin e largimit nga ushtria, i hipur mbi mushkë, dëgjova fjalët e Ebu Sufjanit dhe Budejl bin Uerekas, të cilët po ktheheshin në Mekë. Ebu Sufjani thoshte kështu: "Nuk kam parë ndonjëherë as zjarr, as ushtri si kjo e sotmja! Budejli thoshte: "Uallahi ky ishte zjarri i fisit të Khuza'ave! Zjarri që ndizet gjithmonë nga lufta." Ndërsa Ebu Sufjani thoshte: - "As zjarri, as ushtria e Khuza'ave nuk mund të jenë kaq të mëdha, unë e di, janë më pak." Ebu Sufjanin e njoha nga zëri dhe i fola: - "Ebu Handhale!" - Edhe ai më njohu mua, duke thënë: - "Ebu'l-Fadl, ti je?"

- "Po, unë jam!", – u përgjigja unë.

- "T'u bëfshin kurban nëna e babai im, po ti, çfarë kërkon këtu?", – më pyeti.

- "Turp të kesh, o Ebu Sufjan! Ja ku është Profeti në krye të ushtrisë! Uallahi, kurejshët nuk e kanë fare të lehtë kësaj here!"

- "Po mirë, si t'ia bëjmë? Çfarë na këshillon ti?"

- "Po të kapën, ata do të të vrasin. Eja me mua, në mushkën time, të të çoj unë tek ai dhe t'i kërkoji që të të falë."

Ebu Sufjani hipi në pjesën e pasme të shpinës së mushkës dhe u nisëm vetëm pasi ishin larguar të gjithë shokët e tij. Sa herë që kaloja

pranë zjarreve të ndezura nga myslimanët, ata pyesnin: - "Kush është ky?" - Kur panë mushkën e Profetit tonë, po thoshin: - "Është mushka e Profetit tonë, duhet të jetë xhaxhai i tij."

Kur u afrova pranë zjarrit që kishte ndezur Omer bin Hatabi (radijallahu anhu), Omeri (radijallahu anhu) tha: - "Kush është ky?" - dhe bëri të ecë drejt meje. Pastaj, kur pa që në pjesën e pasme të shpinës së mushkës ishte ulur Ebu Sufjani, tha: - "Ebu Sufjani! Armiku i Allahut! Lëvduar qoftë Allahu, që të solli këtu pa lejen e të Dërguarit të Allahut!" - Pastaj u largua dhe shkoi me nxitim për atje ku ndodhej i Dërguari i Allahut. E ngacmova mushkën me thembrat e këmbëve dhe me një shpejtësi pak më të lartë se ajo që ia kalon një njeriu të mbushur, ia kalova Omerit dhe e lashë pas, zbrita nga mushka dhe hyra për tek i Dërguari i Allahut. Në atë kohë hyri edhe Omeri, i cili tha:

- "O Resulullah! Ky është Ebu Sufjani! Allahu i Madhërishëm e pruri vetë, pa e kërkuar ti. Me lejo t'ia ndaj kokën prej trupit!"

- "O Resulullah! Po unë e prura atë këtu duke i garantuar se do ta mbroja unë vetë, nëse do të ishte nevoja.", – thashë unë dhe shkova e u ula pranë Profetit tonë. - "Jo, për Zotin, sonte pranë tij nuk do të qëndrojë asnjë tjetër, veç meje!"

Kur Omeri filloi të këmbëngulte më shumë, nuk durova dhe i thashë:

- "Hesht tani, Omer! Uallahi, po të kishte qenë ndonjë prej bijve të Adijit, me të cilët ke lidhje farefisnore, ti nuk do të kishe folur kështu; ti e di që ai është prej bijve të Abdi Menafit, ndaj edhe i thua këto!"

- "Mbylle gojën, o Abas! Se kënaqësinë që kam ndierë unë kur u bëre mysliman ti, nuk do ta kisha ndierë edhe sikur të ishte bërë mysliman vetë babai im, sepse kënaqësia që ndjeu i Dërguari i Allahut kur u bëre ti mysliman më kënaqi edhe më shumë se sa po të ishte i gjallë Hatabi dhe të hynte në Islam.", – reagoi Omeri (radijallahu anhu).

Aty reagoi Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem):

- "*Hajde, o Abas! Merre atë dhe çoje në çadrën tënde dhe kur të agojë sille tek unë.*" Kësisoj, unë e mora Ebu Sufjanin në çadër dhe ai e kaloi natën

bashkë me mua. Kur agoi, shkova tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili, kur e pa Ebu Sufjanin, tha:

- "*Turp të kesh, o Ebu Sufjan! A nuk ka ardhur koha që të dëshmosh edhe ti se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet?!*"

- "T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im! Sa njeri bujar që je ti! Je kaq i butë dhe i dashur! Dhe je i lidhur dhe i respekton kaq shumë të drejtat e të afërmve! Edhe kur mendoja se ka edhe zota të tjerë, veç Allahut, pandehja se ata mund të më vinin në ndihmë për gjëra të caktuara.", – u përgjigj Ebu Sufjani.

- "*Ah, mor Ebu Sufjan! A nuk ka ardhur ende koha që të pranosh se unë jam i Dërguari i Allahut?*"

- "Sa njeri i butë që je ti dhe, për më tepër, trim! Vështirë të gjesh një njeri që të jetë kaq shumë i lidhur me familjen! Uallahi, deri më sot, kam pasur disa dyshime dhe shumë pyetje në kokë."

Abasi (radijallahu anhu) tregon: - "Shiko, Ebu Sufjan! Nëse të vjen ndopak keq për veten, pranoje Islamin para se të të pritet koka! Hajde, dëshmo se nuk ka zot tjetër, veç Allahut, që meriton të adhurohet, dhe se Muhamedi është profeti i Allahut.", – i thashë unë Ebu Sufjanit. Dhe, me t'i thënë kështu, Ebu Sufjani dëshmoi me të vërtetë dhe u bë sakaq mysliman.

Në vijim Abasi (radijallahu anhu) i tha kështu Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem): - "O Resulallah! Ebu Sufjani është njeri që i pëlqejnë shumë nderimet, lavdërimet dhe privilegjet, sikur ta përgëzosh me ndonjë gjë që do ta bënte atë të ndihej krenar!"

- "*Po mirë, kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit, ta dijë se atje do të jetë i sigurt, ashtu siç është i sigurt kushdo që shkon në shtëpinë e vet dhe e mbyll derën. I sigurt është edhe ai që hyn në Xhaminë e Shenjtë.*"

Kur Ebu Sufjani u ngrit në këmbë, për t'u kthyer, Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Abas! Merre dhe çojë në ndonjë shteg në rrugën e malit dhe mos u largoni nga lugina, që të shohë ushtrinë e Allahut, kur të kalojë së andejmi!*"

Dolëm bashkë. Ashtu siç më pati urdhëruar i Dërguari i Allahut, e çova Ebu Sufjanin në një vend përgjatë luginës, nga ku mund të

shihnim ushtrinë teksa kalonte atypari. Fiset filluan të kalonin të gjitha përpara Ebu Sufjanit, një e nga një, secila me bajrakun e vet. Sa herë që kalonte ndonjë nga fiset që kishin pranuar Islamin, Ebu Sufjani thoshte: - "Po këta, kush janë?" - Dhe unë i thosha, "bijtë e Sulejmanit", e ai më përgjigjej duke më pyetur:

- "Po ç'problem kemi ne me bijtë e Sulejmanit, që ata po vijnë sot deri këtu?"

Sa herë që kalonte ndonjë nga fiset Ebu Sufjani bënte të njëjtën pyetje dhe unë i përgjigjesha, "bijtë e filanit". E ai më thoshte:

- "Po ç'problem kemi ne me ta, që kanë ardhur deri këtu?" Kështu kaluan të gjitha fiset një e nga një. Më në fund, erdhi tabori i atyre që kishin veshur parzmore hekuri, e që nuk u dallohej asnjë pjesë tjetër e trupit, veç syve, të cilët përbëheshin nga Muhaxhirët dhe Ensarët, e që mes tyre ishte edhe Resulullahu, që kaluan me gjithë lavdinë dhe madhështinë e tyre. Ebu Sufjani tha: "Subhanallah! Po këta, kush janë kështu?"

- "Ndërsa këta janë grupi i Muhaxhirëve dhe i Ensarëve, mes të cilëve është edhe i Dërguari i Allahut.", – iu përgjigja unë.

- "O Ebu'l-Fadl, uallahi këtyre nuk mund t'u dalë askush përballë, pasi askujt nuk i mjafton forca për t'u përballur me ta. Lëvduar qoftë madhështia e shtetit që ka ngritur djali i vëllait tënd!", – tha Ebu Sufjani.

- "Jo, ai nuk ka ngritur as shtet, as mbretëri; kjo është profetësia e tij.", – i thashë unë.

- "Po, mirë, ashtu qoftë!", – m'u përgjigj ai.

- "Tani nisu për te njerëzit e tu!", – i thashë unë.

U largua. Kur mbërriti pranë të afërmve të tij, Ebu Sufjani filloi të bërtiste duke thënë: - "O Kurejshë! Ky që po vjen është Muhamedi! Ai po vjen dhe ka mbledhur një forcë të atillë, së cilës ajo pak forcë që keni ju nuk mund t'i bëjë ballë. Kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit do të jetë i sigurt, pasi do t'ia garantoj unë jetën."

Kur dëgjoi këto fjalë, gruaja e tij Hindi u çua menjëherë në këmbë, e kapi për mustaqesh dhe klithi:

- "Vriteni këtë poshtërsirë! Nuk arriti të mbronte dot as familjen e tij!"

- "As mos të të shkojë nëpër mend! Të mos ju mashtrojë kjo grua! Po ju them të vërtetën, forca me të cilën po vjen Muhamedi është aq e madhe, sa që ju nuk mund t'i bëni dot ballë. Kushdo që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit të ndihet i sigurt për jetën.

- "Turp të të vijë! E ku na mjafton ne vetëm shtëpia jote?", – i thanë ata. Pastaj, duke u transmetuar atyre fjalët që i kishte thënë i Dërguari i Allahut, Ebu Sufjani tha kështu:

- "Edhe ata që hyjnë në shtëpitë e tyre dhe e mbyllin derën nga brenda mund të ndihen të sigurt, se nuk do t'i prekë askush." Kaq u tha dhe të gjithë njerëzit u shpërndanë, ca nëpër shtëpitë e tyre, ca nëpër faltore."[96]

Ai që e transmeton këtë histori thotë:

- "Në taborin e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte plot dymijë ushtarë të veshur vetëm në hekur. Resulullahu flamurin ia kishte dhënë Sad bin Ubades (radijallahu anhu). Në krye të tyre qëndronte Sadi dhe teksa po kalonte pranë Ebu Sufjanit, me sanxhakun e Profetit tonë në duar, i tha atij këto fjalë:

- "O Ebu Sufjan! Sot është ditë lufte! Sot është dita që lejohet derdhja e gjakut! Kjo është dita që Allahu i Madhërishëm poshtëroi kurejshët!"

Në atë kohë, nga përballë po vinte i Dërguari i Allahut. Pikërisht kur u afrua tek Ebu Sufjani, Ebu Sufjani tha:

- "O Resulullah! Çfarë ke urdhëruar, që të vritet populli yt? Sadi dhe ata që ishin krah tij, kur po kalonin përpara meje, më tha:

- "O Ebu Sufjan! Sot është ditë lufte! Sot është dita që lejohet derdhja e gjakut! Kjo është dita që Allahu i Madhërishëm poshtëroi kurejshët." Për hir të Allahut, unë të kërkoj të tregohesh i mëshirshëm me popullin tënd. Nuk ka dyshim se ti je më i miri ndër njerëz, e nuk ka tjetër njeri që të jetë më i drejtë se ti me njerëzit e vet!"

Atëherë, Abdurrahman bin Aufi dhe Osman bin Affani thanë:

[96]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 7/76 (6419).

- "O Resulullah! Nuk jemi të sigurt se Sadi nuk do t'i sulmojë kurejshët!", – duke i shprehur shqetësimin e madh që kishin të Dërguarit të Allahut.

Pasi i dëgjoi Abdurrahmanin dhe Osmanin (radijallahu anhuma), Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*O Ebu Sufjan! Sot është dita e mëshirës, sepse kjo është dita që Allahu i Madhërishëm vendosi t'i lartësojë kurejshët.*"

Pastaj Profeti i Lëvduar i dërgoi lajm Sadit, se ia kishte hequr detyrën e komandantit. Dhe që të mos i thyhej zemra, e urdhëroi që sanxhakun t'ia jepte të birit, Kajsit. Sadi u tha atyre se nuk do ta dorëzonte atë flamur pa i ardhur një shenjë nga vetë Profeti ynë. Andaj, Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi çallmën e tij. Kur Sadi mori në dorë çallmën, sanxhakun ia dorëzoi të birit, Kajsit."[97]

Si e pranoi Islamin Suhejl bin Amri duke u bërë dëshmitar i moralit të lartë të Profetit tonë

Suhejl bin Amri (radijallahu anhu) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) hyri në Mekë dhe kur arriti fitoren e plotë, unë u mbylla në shtëpinë time. Pastaj i dërgova lajm djalit tim, Abdullahut, që t'u kërkonte myslimanëve që të jem i sigurt. Kështu, Abdullahu shkoi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha:

- "O Resulullah, babai më ka dërguar që t'ju kërkoj ta falni atë." E ai m'u përgjigj:

- "*Po Suhejl, thuaji babait se me lejen e Allahut ai është i sigurt, ndaj mund të dalë nga shtëpia.*"

Mandej u kthye nga të tjerët që ishin përreth tij dhe u tha:

- "*Kushdo që takohet me Suhejlin, të mos e shohë me sy të keq, të mos e përbuzë, por të vazhdojë rrugën të shkojë për ku është nisur. Ju betohem se Suhejli është një njeri shumë i zgjuar dhe i nderuar. Një njeri si Suhejli nuk mund të qëndrojë indiferent ndaj Islamit. E vërtetë është ajo që ka vendosur Allahu! Dhe atë që e ka vendosur Ai nuk ka asnjë forcë që ta pengojë!*"

[97]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/291.

Transmetuesi thotë: "Abdullahu u kthye te babai i tij dhe ia transmetoi një për një të gjitha fjalët që i kishte thënë i Dërguari i Allahut.

- "Uallahi, Muhamedi edhe kur ishte i vogël ishte i mirë, i këtillë paska mbetur edhe tani që është rritur, nuk paskësh ndryshuar!"

Suhejli u nis për të shkuar tek i Dërguari i Allahut, por gjithmonë kthehej prapë mbrapsht. Bashkë me të Dërguarin e Allahut; ende pa u bërë mysliman, Suhejli pati marrë pjesë edhe në luftën e Hunejnit dhe në vendin e quajtur Xhi'rane hyri në Islam. Atë ditë, Profeti ynë i dha atij plot njëqind deve si plaçkë lufte."[98]

Fjalimi që mbajti Profeti ynë para mekasve në ditën e ngadhënjimit

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: "Atë ditë që u ngadhënjye mbi Mekën, Profeti ynë dërgoi lajm se donte të takohej me Safuan bin Umejjen, Ebu Sufjan bin Harbin dhe Harith bin Hishamin. Thashë njëherë me vete:

"Tani Allahu më dha mundësinë që t'ua marr hakun për të gjitha të këqijat që më kanë bërë!" Mirëpo, ky mendim imi nuk zgjati më shumë se sa deri kur i Dërguari i Allahut u tha atyre:

- "*Gjendja ime me ju i ngjan gjendjes së profetit Jusuf me vëllezërit e tij. Edhe ai, u pati thënë vëllezërve:* "**Ai u tha: Sot s'ka qortim për ju; Allahu do t'ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!**" (Jusuf, 12/92)

Omeri thotë se: "Më erdhi turp nga i Dërguari i Allahut për ato mendime që më kishin kaluar nëpër mend nga inati që kisha ndaj atyre njerëzve. Profeti ynë u tha atyre ato gjëra që duhet t'u thoshte."[99]

Edhe Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) e ka transmetuar kështu atë ngjarje: "Pasi u çlirua Meka, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi në Qabe. Kapi dy menteshat e portës me dorë dhe tha:

- "*Si mendoni se do të sillem unë me ju?*"

- "Ti je djali i vëllait tonë, madje nipi më i butë dhe më i mëshirshëm që ne kemi!", – thanë ata duke e përsëritur këtë plot tri herë. Atëherë,

[98]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/317 (5225).
[99]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/757 (30158).

Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u foli atyre:

- "*Edhe unë, njësoj si profeti Jusuf, që u tha vëllezërve të tij,* '**sot s'ka qortim për ju!**' *edhe unë po ju them se unë nuk do t'ju qortoj, as nuk do t'ju dënoj. Lus Zotin që t'ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve. Jeni të gjithë të lirë të jetoni si të doni.*"[100]

19. HYRJA NË ISLAM E IKRIMES, DJALIT TË EBU XHEHLIT

Abdullah bin Zubejri (radijallahu anhu) rrëfen: "Atë ditë që u çlirua Meka, kur Ummu Hakimi, gruaja e Ikrimes, djalit të Ebu Xhehlit, u bë myslimane, ajo i tha të Dërguarit të Allahut:

- "O i Dërguari i Allahut, Ikrime, nga frika se mos ti e vrisje, u arratis drejt Jemenit. Sikur t'i jepni garanci për jetën, që nuk do ta vrisni, e të kthehet."

- "*Po, mirë, thuajini të kthehet se nuk do ta prekë askush!*", – iu përgjigj Profeti ynë i dashur.

Me të marrë këtë fjalë, Ummu Hakimi mori edhe një skllav bizantin dhe u vunë në kërkim të burrit të saj. Në rrugë e sipër, skllavi, duke përfituar nga vetmia dhe i rënë pre e dëshirave trupore, tentoi ta ngacmojë. Edhe ajo, duke e shkujdesur atë, mezi gjeti mundësinë për t'u afruar deri te një familje e fisit "Akk". U kërkoi atyre që ta ndihmonin. Edhe ata e morën skllavin dhe e lidhën mirë e mirë. Ummu Hakimi arriti ta gjente Ikrimen të fshehur në një qoshe në brigjet e Hixhazit. Kur e gjeti, Ikrimeja sapo kishte hipur në një anije. Kapiteni i anijes i tha atij:

- "Na thuaj diçka që do të të shpëtojë!"

- "Çfarë t'ju them?", – ia ktheu Ikrimeja.

- "Thuaj: Nuk ka zot tjetër përveç Allahut që meriton të adhurohet!"

- "Po unë, prandaj u arratisa, që të mos pranoj e të mos them diçka të tillë!"

Teksa mes Ikrimes dhe kapitenit po zhvillohej kjo bisedë, aty ia behu Umu Hakimi. Ajo i kërkoi Ikrimes me këmbëngulje:

---

[100]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/677 (29931).

- "Po vij nga ai që është më mirënjohësi, më i miri dhe më i mbari ndër gjithë njerëzinë; rri i qetë, nuk ke pse të mërzitesh kaq shumë!"

Ikrimeja u qetësua kur i dëgjoi këto fjalë. Umu Hakimi i shkoi pranë dhe i tha:

- "Unë i kërkova të Dërguarit të Allahut garanci për jetën tënde."

- "Ti e bëre këtë?", – tha Ikrimeja.

- "Po, unë i kërkova atij që të tregohej i mëshirshëm dhe ai më garantoi se ty nuk do të ndodhte asgjë e keqe.", – u përgjigj Umu Hakimi.

U kthyen të dy bashkë. Kur e shoqja i tregoi për ato që i kishte bërë skllavi i saj, Ikrimeja e vrau menjëherë skllavin e tij. Në atë kohë Ikrimeja nuk ishte bërë ende mysliman. Kur iu afruan Mekës, Profeti ynë u tha sahabëve: "*Po vjen i biri i Ebu Xhehlit, Ikrimeja, si mysliman dhe mërgimtar. Askush të mos ia shajë të atin, sepse, vërtet, të sharët e të vdekurit nuk u bën asnjë të keqe të vdekurve, por prek e hidhëron të gjallët!*"

Transmetuesi thotë: "Ikrimeja po kthehej në Mekë bashkë me të shoqen, dhe sa herë që ai përpiqej t'i afrohej të shoqes, ajo i shmangej dhe e kundërshtonte duke i thënë: "Ti je një mohues, kurse unë jam myslimane!" Ndërsa Ikrimeja i thoshte: "Kjo kauzë që arriti të të largojë ty prej meje duhet të jetë shumë e madhe."

Profeti ynë, kur e pa Ikrimen, u çua menjëherë në këmbë nga gëzimi. Ikrimeja qëndroi përballë të Dërguarit të Allahut. Pranë vetes kishte edhe të shoqen.

- "O Muhamed, (dhe duke bërë me shenjë nga e shoqja) kjo grua më tha se ti i ke dhënë garanci për jetën time, e vërtetë është kjo?"

- "*E vërtetë është dhe ti ke garancinë time!*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Çfarë është ajo ku ti na fton?"

- "*Të ftoj të besosh se nuk ka asnjë zot tjetër veç Allahut, që meriton të adhurohet, dhe që unë jam profeti i Allahut; të falësh namazin, të japësh zekatin, si dhe të bësh atë e këtë gjë.*", – duke numëruar kësisoj të gjithë parimet bazë të Islamit.

- "Uallahi, ti po më fton të bëj diçka shumë të mirë, po më fton për

tek e vërteta. Unë të betohem për Allahun, se ende pa ma bërë ti këtë ftesë, unë e dija se ti ishe njeriu më i drejtë dhe që e doje të mirën më shumë se kushdo tjetër mes nesh. Unë dëshmoj se nuk ka të Adhuruar tjetër të Vërtetë përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij!"

I Dërguari i Allahut u kënaq shumë nga përgjigjja që dha Ikrimeja. Pastaj Ikrimeja tha:

- "O Resulullah, më mëso një fjalë që do të jetë më e mira e më e mbara që do të kem thënë ndonjëherë."

- "*Atëherë thuaj: 'Esh'hedu en la ilahe il'lallah ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue Resuluh'*."

- "Po tjetër, çfarë të them?"

Atëherë Profeti ynë Fisnik i tha:

- "*Le ta dëgjojnë e të jenë dëshmitarë, Allahu dhe gjithë të pranishmit; të thuash: 'Unë tani jam një mysliman, një luftëtar në rrugën e Allahut dhe një mërgimtar.'*" Dhe Ikrimeja ashtu bëri, i tha edhe këto fjalë.

Lutjet e Profetit tonë për Ikrimen

Profeti ynë i Dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha Ikrimes:

- "*Kërkomë sot gjithçka që mund t'i jap unë dikujt, sepse medoemos që do të ta jap.*"

- "Dua që t'i lutesh Allahut për mua, që Ai të më falë mua për çdo armiqësi që të kam bërë, çdo hap që kam hedhur për të të bërë ty ndonjë të keqe, çdo vend që kam zënë për të të bërë keq dhe për çdo fjalë të keqe që kam thënë për ty, në sy, apo që ua kam thënë të tjerëve pa qenë ti i pranishëm.", – u përgjigj Ikrimeja.

- "O Resulullah, unë jam i kënaqur prej teje! Uallahi, o i Dërguari i Allahut, këtej e tutje energjinë që kam përdorur për t'i penguar njerëzit nga rruga e Allahut do të përdor dyfishin e gjithë energjisë që kam në rrugën e Allahut. Sërish do të bëj për hir të Allahut edhe dyfishin e luftërave (përpjekjeve) që kam bërë për t'i penguar njerëzit të besojnë!"

Që prej asaj dite, Ikrimeja luftoi me mish e me shpirt në çdo luftë ku mori pjesë. Ai ra dëshmor në luftën e Uxhnadejnit, e cila u zhvillua në kohën kur në krye të kalifatit ishte Ebu Bekri (radijallahu anhu). Atë vit që i Dërguari i Allahut kreu Haxhin e Lamtumirës, ai e pati ngarkuar Ikrimen me detyrën e mbledhjes së zekatit të të gjithë besimtarëve. Kur Profeti ynë ndërroi jetë, Ikrimeja ishte i ngarkuar me detyrë në qytezën e Tebales.[101]

20. HYRJA E SAFUAN BIN UMEJES NË ISLAM

Abdullah bin Zubejri (radijallahu anhu) transmeton: "Ditën e ngadhënjimit mbi Mekën, gruaja e Safuan bin Umejes, El-Begum binti El-Muadeli, e cila i përkiste fisit të Kinanes, pranoi Islamin. Ndërkohë që burri i saj, Safuani, dhe skllavi i tij Jesari u arratisën, për të jetuar në arrati në rrethinat e Shi'bit. Në udhëtim e sipër ai i tha Jesarit, për ta paralajmëruar:

- "Herë pas here shih nga pas, se mos është duke na ndjekur ndokush."

- "Ja, Umejr bin Uehbi!", – i tha njëherë skllavi, i cili shikonte herë pas here, se mos ishte ndokush duke i ndjekur.

- "E ç'punë kam unë me Umejrin? Uallahi, ai do të ketë ardhur për të më vrarë mua. Ai i ka dalë krah Muhamedit për të më vrarë mua."

Kur Umejri u afrua, Safuani e priti me fjalët:

- "O Umejr, nuk mjaftuan ato çfarë më ke bërë deri tani? Edhe borxhet dhe mbajtjen e familjes unë t'i kam paguar; tani ç'të ka shkuar ndërmend të bësh, ke ardhur të më vrasësh, apo jo?

- "O Ebu Uehb, t'u bëfsha kurban. Unë tek ty po vij nga ai që është më i miri i njerëzve dhe nga më i sinqerti nga të gjithë të afërmit e tu.", – u përgjigj Umejri. Mirëpo ai i kishte thënë Profetit tonë:

- "O i Dërguari i Allahut! I pari i fisit tonë ia mbathi nga frika, kam frikë se do të hidhet në det, për t'u mbytur. Kishte frikë se ti nuk do t'ia falje jetën. T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im, jepi garanci se nuk do t'i bësh asgjë të keqe."

---

[101]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/270 (5057).

- "*Ia kam dhënë!*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

Menjëherë pas kësaj, Umejri doli për të kërkuar Safuanin. Andaj edhe ai këmbëngulte:

- "I Dërguari i Allahut të ka garantuar jetën!" Mirëpo, Safuani iu përgjigj:

- "Uallahi, po nuk më solle një provë bindëse, unë nuk mund të kthehem me ty!"

Umejri u kthye dhe lajmëroi të Dërguarin e Allahut. Resulullahu tha:

- "*Merr çallmën time, çoja!*" Dhe ai kështu bëri, mori çallmën e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe u kthye për te Safuani. Kjo është çallma që kishte Profeti ynë kur pati hyrë në Mekë. E kishte mbështjellë mirë rreth kokës, me njërin cep që i varej përpara, drejt fytyrës. Kur Umejri u nis për herë të dytë, që të kërkonte Safuanin dhe e gjeti, ai i tha:

- "O Ebu Uehb, tani po vij nga më i miri njeri, nga ai që është më besniku ndaj familjes, më i buti dhe që e do më shumë se kushdo bamirësinë. Nderi i tij është nderi yt, forca e tij është edhe jotja, pasuria e tij është edhe jotja. Po të them që ta kujtosh edhe njëherë Allahun!"

- "Kam frikë se mos më vrasin!"

- "Ai të ka ftuar në Islam. Po të pëlqeu, mund të pranosh Islamin, po nuk të pëlqeu, atëherë ai do që të të mbajë për dy muaj kohë me vete. Ai është më besniku e më mirënjohësi ndër njerëz, nuk ka njeri tjetër që ta dojë bamirësinë më shumë se ai. Ja tek të ka dërguar jelekun e tij, të cilin e pati lidhur si çallmë me njërin bisht që i varej përpara.", – dhe nxori çallmën.

Safuani tha:

- "Po, ajo, ajo qenka!", – duke e njohur menjëherë çallmën, me të cilën Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati hyrë në Mekë. Kur erdhi tek i Dërguari i Allahut, ai po falte namazin e ikindisë në Mesxhidul-Haram (Xhaminë e Shenjtë). Pritën për pak, sa mbaruan. Safuani pyeti:

- "Sa herë falet namaz gjatë një ditë-nate?"

- "Pesë herë."

- "Muhamedi i drejton të gjitha faljet?"

- "Po."

Kur Profeti ynë dha selam dhe e përfundoi faljen, Safuani bërtiti me zë të lartë:

- "O i Dërguari i Allahut! Umejr bin Uehbi më pruri çallmën tënde. Më tha se më kishe folur të vija tek ti dhe po të më pëlqente, do të pranoja Islamin, në mos të qëndroja për dy muaj me ty."

- "*Eja brenda, o Ebu Uehb!*", – u përgjigj Resulullahu.

- "Jo, për Zotin, nuk kam për të hyrë, derisa të më shpjegosh se si qëndron puna."

- "*Ty, ndryshe nga të gjithë të tjerët, do të të njoh plot katër muaj kohë!*"

Pas këtyre fjalëve, Safuani zbriti poshtë.

Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) doli në anën e Heuazinit dhe mori edhe Safuanin me vete. Nuk ishte bërë ende mysliman. I Dërguari i Allahut i dërgoi atij lajm që t'i jepte armët, që do të dorëzonte në të ardhmen. Dhe ai, bashkë me armët, i dërgoi si amanet edhe njëqind parzmore. Safuani e pyeti:

- "Po m'i kërkon që t'i jap me zemër, apo po m'i kërkon me zor?"

- "*Po t'i kërkoj që të m'i lësh mua dhe unë do të t'i kthej prapë.*", – iu përgjigj Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

Dhe ai ia dha. Pastaj, me urdhrin e të Dërguarit të Allahut ato armë u çuan në Hunejn. Prandaj, ai qe i pranishëm në luftën e Hunejnit dhe e pa me sytë e tij përleshjen e Taifit. Menjëherë pas saj i Dërguari i Allahut u kthye në Xhi'rane. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po shëtiste bashkë me Safuanin mes plaçkës së luftës, kur Safuanit i shkuan sytë te delet, devetë dhe barinjtë që kishin dalë për të kullotur në shtratin e malit. Edhe Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po e ndiqte atë me bisht të syrit në çdo lëvizje që bënte.

- "*O Ebu Uehb, më duket se të pëlqeu faqja e këtij mali?*", – tha i Dërguari i Allahut.

- "Po!", – tha Ebu Uehbi.

- "*Atëherë, qoftë e jotja me gjithë ç'ka mbi të.*", – i tha atij Resulullahu.

Safuani, kur dëgjoi çfarë i tha i Dërguari i Allahut, tha:

- "Askush, përveçse një profet, nuk mund të jetë kaq bujar! Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut që meriton adhurimin dhe përsëri unë dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.", – dëshmoi ai, duke u bërë kështu mysliman.[102]

Sipas transmetimit të Ahmed bin Hanbelit; ditën e Hunejnit, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i kërkoi Safuan bin Umejes t'i linte në përdorim ca parzmore. Safuani iu qe përgjigjur:

- "Me forcë po m'i kërkon, o Muhamed?"

- "*Jo, me kusht që do të t'i paguaj, po t'i kërkoj që të m'i lësh t'i përdor unë.*", – iu qe përgjigjur i Dërguari i Allahut.

Transmetuesi thotë se: Kur një pjesë e parzmoreve u dëmtuan, i Dërguari i Allahut kërkoi që t'ia paguante Safuanit. Mirëpo Safuani i pati dhënë këtë përgjigje:

- "O Resulullah! Ato parzmore që shkuan dëm mua nuk më shërbejnë për asgjë. Sot unë dua të bëhem mysliman."[103]

21. PRANIMI I ISLAMIT NGA URUE BIN MESUDI DHE FISI I THAKIFËVE TË TAIFIT

Ibni Is'haku tregon: "Kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po kthehej nga Thakifi, atë e ndoqi nga pas Uruete bin Mes'udi. Ai e arriti Resulullahun ende pa mbërritur në Medinë, pranoi Islamin dhe i kërkoi leje që të kthehej tek të afërmit e tij, që t'ua mësonte edhe atyre Islamin.

- "*Ata do të të vrasin!*", – foli i Dërguari i Allahut.

Profeti ynë pati dalluar se njerëzit e Thakifit kishin një veçori, që nuk u pëlqente t'ua dëgjonin fjalën të tjerëve, dhe kjo u buronte nga krenaria e tepruar. Urueja iu përgjigj:

- "O Resulullah! Ata më duan mua më shumë se ç'duan edhe vajzat e tyre!"

---

[102]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/761 (30170).
[103]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 3/400 (15337).

Vërtet, populli i tij e donte dhe kishte shumë respekt për Uruen. Ai u kthye pranë njerëzve të vet, që t'i ftonte dhe ata të pranonin Islamin. Kishte ndërmend dashurinë që ata kishin për të, ndaj edhe mendonte se medoemos do t'i pranonin fjalët që kishte për t'u thënë. U ngjit në tarracën e shtëpisë. Kur thakifasit dëgjuan që ai po i ftonte të bëheshin myslimanë, duke u bërë thirrje që të pranonin Islamin, ata nxorën harqet dhe filluan ta goditnin me shigjeta. Një prej atyre shigjetave e kapi dhe ende pa dhënë shpirt i thanë:

- "O Urue! Çfarë sheh te ky gjak që po të rrjedh?"

- "Shoh shpërblimin e Allahut! Shoh se si Allahu po ma heq etjen, duke më dhënë të pi prej lëngut të dëshmimit të së vërtetës. Janë të shumta shpërblimet e atyre që bien dëshmorë në anën e të Dërguarit të Allahut (duke pasur parasysh të rënët e përleshjes së Taifit), kështu si puna ime. Amaneti im është që të më varrosni pranë tyre.", – tha ai.

Ashtu bënë, e varrosën Uruen në varrezat e dëshmorëve. Sipas transmetimeve, thuhet se Profeti ynë ka thënë kështu për Uruen:

- "*Gjendja e Urues me popullin e tij i ngjan gjendjes së atij njeriut në suren 'Jasin', i cili u përball me njerëzit e vet* (Bëhet fjalë për një njeri të quajtur Habibi Nexhar, i cili i bën thirrje popullit të Antakias t'i besojnë mëkëmbësve të Isait [alejhis'selam]. Banorët e Antakias e patën vrarë atë njeri që po i ftonte kah e drejta.)"

Pasi ra dëshmor, thakifasit pritën edhe për disa muaj të tjerë. Mandej, u këshilluan me njëri-tjetrin. E kuptuan se nuk u kishte mbetur edhe shumë forcë për t'u bërë ballë arabëve, kështu që vendosën të pranonin Islamin, duke i shprehur besëlidhjen Profetit. Dhe, për ta realizuar këtë, ata vendosën të zgjidhnin një grup njerëzish që do të shkonte te Profeti ynë për të biseduar. Zgjodhën dy vetë prej bashkëpunëtorëve të tyre dhe tre nga bijtë e Malikut, me në krye Abdi Jalejlin. Kur ky grup iu afrua Medinës, ata vendosën të qëndronin njëfarë kohe në një luginë që gjendej aty pranë. Atje gjetën edhe Mugire bin Shuben. Duke qenë se Mugireja ishte rojë atë ditë, kishte dalë ai për t'i kullotur devetë e sahabëve. Kur i pa ata, ai rendi menjëherë t'ua jepte edhe të tjerëve sihariqin e ardhjes së tyre. Në rrugë takuan edhe Ebu Bekrin. Ai i tha atij se kishte ardhur një grup nga Thakifi, të cilët donin të

lidhnin besë me të Dërguarin e Allahut dhe të pranonin Islamin dhe nëse i Dërguari i Allahut kishte për t'u vënë ndonjë kusht, ata do t'ua dërgonin atë popullit të tyre me shkrim, e vetëm mandej do të merrnin një vendim. Ebu Bekri u përgjigj:

- "Më lër, aman, t'ia them unë të Dërguarit të Allahut!" Mugireja pranoi.

Ebu Bekri (radijallahu anhu) hyri brenda dhe ia shprehu të Dërguarit Fisnik se ata që kishin ardhur donin të vinin të takoheshin me Resulullahun. Mugireja u kthye pranë grupit nga Thakifi. Teksa vinin, mbi deve, ai u mësoi atyre se si ta përshëndetnin të Dërguarin e Allahut. Megjithatë, prapëseprapë, ata e përshëndetën atë njësoj siç përshëndeteshin me njëri-tjetrin gjatë kohës së injorancës. Në faltore u ngrit një çadër, enkas për grupin e mysafirëve nga Thakifi. Mes tyre dhe Profetit tonë shërbente si mëkëmbës Halid bin Said bin Asi. Kur ai u solli atyre për të ngrënë, ata nuk pranonin të hanin pa ngrënë njëherë ai. Edhe tekstin e marrëveshjes, e pati shkruar Halidi për ta.

Një ndër kushtet që ata i parashtruan të Dërguarit të Allahut ishte edhe ky: "Për tri vite, ai do t'ua linte atyre të paprekur statujat e idhullit Lat." Kur kjo kërkesë nuk iu pranua, provuan ta ulnin kohëzgjatjen, njëherë në dy vjet, mandej në një vit. Por kur as kjo nuk u pranua, atëherë kërkuan si afat vetëm një muaj, të paktën sa të mësoheshin njerëzit e zakonshëm, që nuk duhet të adhuronin më idhujt e vjetër. I Dërguari i Allahut as këtë nuk ua pranoi. Ai u tha atyre se bashkë me ta do të dërgonte edhe Ebu Sufjan bin Harbin dhe Mugire bin Shuben, që t'i thyenin gjithë ç'kishte që mund të quheshin idhuj. Kur grupi filloi të vendosë edhe kushte, si, për shembull, të mos falnin namaz dhe të mos i thyenin me duart e tyre idhujt e vet, atëherë i Dërguari i Allahut foli:

- "*Në rregull, po ju lirojmë nga barra që t'i thyeni vetë, me duart tuaja, idhujt që u keni besuar deri më tani. Por, kur bëhet fjalë për namazin; nuk ka mbarësi në atë fe ku mungon namazi!*"

Atëherë, ata thanë:

- "Edhe pse është shumë e rëndë për ne, për ty ne do ta kryejmë."[104]

[104]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/30.

22. HUUEJTIB BIN ABDUL'UZZA PRANON ISLAMIN

Huuejtibi, djali i Abduluzzas, tregon: "Vitin e çlirimit të Mekës, kur i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) hyri në Mekë unë u frikësova shumë, dola nga shtëpia dhe i çova familjen dhe fëmijët në një vend ku mund të ndiheshin më të sigurt. Ndërsa vetë shkova në një kopsht hurmash të Aufit. Ndërsa qëndroja atje, kur ç'të shoh, po vinte Ebu Dherr Gifari. Kishim një miqësi shumë të vjetër me njëri-tjetrin. Dhe ai që konsiderohej mik as që mund të mendohej se do t'i bënte keq atij që e kishte quajtur njëherë mik. Megjithatë, kur e pashë u përpoqa të ikja prej aty. Nga pas më erdhi një zë:

- "O Eba Muhamed!"

- "Urdhëro!", – iu përgjigja unë.

- "Çfarë të ka ndodhur?", – më pyeti ai.

- "Kam frikë!"

- "Nuk ka pse të kesh frikë! Të jesh i sigurt, se Zoti ju ka garantuar, ashtu siç i keni të sigurta edhe pasurinë edhe jetën!"

U ktheva dhe e përshëndeta.

- "Ec, kthehu në shtëpi tani!", – më tha.

- "A jam i sigurt se nuk do të më gjejë asgjë gjatë rrugës? Nuk ma merr mendja se do të mbërrij dot i gjallë, nëse dal prej këtu. Ndoshta më kapin dhe më vrasin, ose mund të më vijnë në shtëpi e të më vrasin. Në të vërtetë edhe fëmijët e familjen i kam tjetërkund!"

- "Merri fëmijët dhe familjen e mblidhuni të gjithë në një vend, sepse do të vij edhe unë me ty.", – më tha ai dhe më shoqëroi përgjatë gjithë rrugës. Teksa po ecnim, Ebu Dherri u thoshte njerëzve: - "Huuejtibi është në duar të sigurta, askush të mos e prekë atë!" Pastaj, Ebu Dherri u kthye pranë të Dërguarit të Allahut dhe pasi e lajmëroi për të gjitha çfarë kishin ndodhur, e pyeti:

- "Përveç atyre që na ke urdhëruar t'i vrasim, të gjithë të tjerët janë të mbrojtur, apo jo?"

Kur mori prej tij pohimin se kjo ishte e vërtetë, atëherë në shpirt ndjeva një qetësim të thellë dhe shkova menjëherë të mblidhesha me

të gjithë familjen në shtëpinë time. Më vonë Ebu Dherri erdhi sërish tek unë dhe më tha:

- "Hë, edhe për sa kohë do të vazhdojë kjo gjendje kështu? Në shumë luftëra nuk ke marrë pjesë dhe shumë shpërblime hyjnore të kanë ikur nga duart. Por ka edhe shumë të mira të tjera, të cilat ka ende kohë e mund t'i kapësh. Eja, të shkojmë bashkë te Profeti ynë i nderuar dhe pranoje Islamin, që kështu të gjesh edhe ti qetësinë e shpirtit. Ai është më bamirësi ndër njerëz dhe më besniku e më mirënjohësi ndaj të afërmve të tij. Nuk ka njeri që të jetë më i dashur e më i butë se ai. Nderi i tij të jetë edhe nderi yt, e forca e tij të jetë edhe forca jote."

- "Po mirë, meqë kjo është ajo që ti më kërkon të bëj, atëherë eja të shkojmë tek ai të dy tok!", – iu përgjigja unë.

Shkuam dhe e gjetëm në vendin e quajtur Batha, teksa rrinte i ulur bashkë me Ebu Bekrin dhe Omerin (radijallahu anhu). Ebu Dherrit, pasi ky kishte pak çaste që po i qëndronte mbi krye, i thashë:

- "Si duhet ta përshëndes unë atë?"

- "Es'selamu alejke ejjuhen'nebijju ue rahmetullahi ue berekatuh, t'i thuash.", – m'u përgjigj Ebu Dherri.

Edhe unë ashtu e përshëndeta. Resulullahu ma ktheu përshëndetjen duke më thënë: - "*Edhe për ty më të mirat përshëndetje, o Huuejtib!*"

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet. Nuk ka dyshim se ti je i Dërguari i Allahut."

- "*Lëvduar qoftë Allahu që të udhëzoi në të drejtë!*", – ma ktheu ai.

Dukej, ishte shumë i kënaqur që unë po bëhesha mysliman. Më kërkoi ca para borxh dhe unë i dhashë dyzetmijë dirhemë. Bashkë morëm pjesë në Luftën e Hunejnit, si dhe në Ekspeditën e Taifit. Nga plaçka e fituar gjatë Hunejnit, ai më pati dhënë mua plot njëqind deve."[105]

Në një tjetër transmetim të Hakimit, është regjistruar se Huuejtibi ka thënë kështu:

"Asnjë nga paria e kurejshëve, të cilët kishin ruajtur fenë e të parëve, nuk qe prekur ndonjëherë më shumë nga luftërat, sa ç'qe

[105]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/561 (6084)

prekur atë ditë nga humbja e Mekës. Por, i tillë është kaderi! Në luftën e Bedrit kisha qenë në anën e idhujtarëve, ku sytë më kanë parë gjëra nga më kuptimplotat, kam parë engjëjt që dukeshin tej në horizont, të cilët vrisnin prej njerëzve tanë dhe disa syresh i merrnin peng. Njëherë thashë me vete: 'Është e pamundur, ky njeri duhet të ketë ndonjë mbështetje shpirtërore shumë të fortë.' Megjithatë, për ato që më kishin parë sytë nuk i fola askujt. Dolëm të humbur dhe të katandisur si mos më keq, mezi u kthyem në Mekë. Qëndruam atje, mirëpo burrat e kurejshëve po e pranonin të gjithë, një e nga një, Islamin. Edhe në Marrëveshjen e Hudejbijes pata qenë i pranishëm si mëkëmbës. Kam punuar derisa u realizua e tërë marrëveshja e paqes. Unë isha dëshmitari i fundit i Marrëveshjes së Paqes që u nënshkrua aty. Me vete thashë: 'Kurejshët nuk po shohin veçse keq nga ato çfarë po i bëjnë Muhamedit. Edhe prej kësaj, në fund, po kurejshët do të dalin të humbur.' Unë pata dashur që kurejshët t'i qëndronin përherë kundërshtarë, me heshta në duar. Kur Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi vitin tjetër në Mekë, për të kryer Umren në Qabe, ashtu siç ishim marrë vesh në Marrëveshjen e Hudejbijes, kurejshët u larguan të tërë nga Meka. Unë dhe Suhejl bin Amri nuk dolëm, ishim ndër ata që zgjodhën të mos largoheshin. Donim që të ishim aty, për ta përzënë të Dërguarin e Allahut kur të kalonte kohëzgjatja e vizitës, siç ishte përcaktuar në marrëveshje. Kur mbaruan tri ditët, bashkë me Suhejl bin Amrin shkuam tek ai dhe i thamë:

- "Koha për vizitën tuaj ka mbaruar!"

- "*O Bilal, lajmëroji të gjithë, ende pa perënduar mirë dielli, në Mekë të mos mbetet asnjë prej myslimanëve që kanë ardhur me ne!*" – i tha ai Bilalit."[106]

23. SAHABËT FTOJNË NJERËZIT NË ISLAM NJË E NGA NJË

Ebu Bekri (r.a.) fton njerëzit të besojnë në Islam

Ibni Is'haku tregon: "Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) pranoi fenë islame dhe shpalli se ishte bërë mysliman, ai filloi menjëherë t'i ftonte edhe të tjerët, një e nga një, të pranonin besimin në Islam. Ebu Bekri

[106]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/561 (6084).

(radijallahu anhu) ishte një njeri shumë i butë dhe njerëzit e donin shumë. Ai e njihte shumë racën e kurejshëve, si me anët e mira, ashtu edhe me anët e këqija të tyre. Ishte një tregtar shumë i sjellshëm, që tregohej përherë i drejtë dhe i vërtetë. Duke qenë se ishte një njeri shumë i ditur dhe ishte shumë i këndshëm në muhabet, shumë prej pjesëtarëve të fisit të tij vinin dhe ia dëgjonin fjalën. Edhe ai, të gjithë ata që i besonin, e respektonin, i mbante përherë pranë vetes dhe i ftonte që t'i besonin Allahut dhe fesë së Tij, Islamit. Me sa di unë, me udhëzimet dhe këshillat e tij kanë hyrë në Islam shumë sahabë të njohur, si Zubejr bin Auami, Osman bin Afani, Talha bin Ubejdullahu, Sad bin Ebi Uekasi, Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhum). Të gjithë këta patën shkuar me Ebu Bekrin te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Aty ai u mësoi atyre Islamin, u lexoi Kur'an, si dhe u dëshmoi se feja e Islamit ishte feja e vërtetë e së drejtës dhe e së vërtetës. Dhe ata e besuan. Këta ishin burrat e parë që e pranuan Islamin dhe ishin po këto personalitete që e aprovuan menjëherë profetësinë e të Dërguarit të Allahut dhe u besuan të gjitha ajeteve që ai u kishte sjellë nga lartësitë hyjnore të Allahut të Madhërishëm."[107]

Musab bin Umejri fton në Islam Usejd bin Hudajrin

Ibni Is'haku tregon: "Es'ad bin Zurare, bashkë me Musab bin Umejrin iu vunë rrugës për të shkuar në trevat e bijve të Abdulesh'helit dhe Dhafrit. Sad bin Muadhi ishte kushëriri i Es'ad bin Zurares. Ata u ulën të pushonin diku aty afër pusit të Merakut, në kopshtet me hurma të bijve të Dhafrit. Rreth tyre u mblodhën edhe disa burra që e kishin pranuar rishtazi Islamin. Në ato kohë Sad bin Muadhi dhe Usejd bin Hudajri ishin nga liderët e Abdulesh'helit. Njëkohësisht, asnjë prej të dyve nuk ishte bërë ende mysliman. Kur dëgjuan se kishin ardhur Musabi me Es'adin, Sad bin Muadhi i tha Usejdit:

- "Për kokë të babait! Shko njëherë tek ata njerëz që kanë ardhur këtu të mashtrojnë njerëzit e paditur, përzëri dhe thuaju që të mos vënë më këmbë këtu. Po të mos e kisha kushëri atë Es'adin, nuk të dërgoja ty, por do të kisha shkuar vetë. E kam djalë tezeje; nuk është

[107]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/29.

mirë që të shkoj e ta përzë unë."

Pas kësaj, Usejd bin Hudejri mori heshtën dhe u nis drejt tyre. Es'ad bin Zurareja, kur pa se kishte ardhur Usejdi, i tha Musabit:

- "Shikoje njëherë këtë që po vjen, ky është i pari i fisit tënd dhe me sa duket për ty është duke ardhur." Musabi iu përgjigj:

-"Nëse ulet, do t'i flas."

Usejdi u afrua duke u thënë atyre gjithfarë fjalësh fyese dhe kur arriti mbi kryet e tyre, u tha:

- "Pse keni ardhur këtu tek ne? Që të gjeni njerëz të paditur dhe t'i mashtroni? Ikni menjëherë që këtu, nëse e doni ende jetën dhe doni të vazhdoni të jetoni."

- "Pse nuk ulesh më mirë, të na dëgjosh njëherë? Nëse të pëlqejnë ato që do të të themi, mund t'i pranosh, nëse nuk të pëlqejnë, atëherë ti mund të zgjedhësh e të na qëndrosh larg. Hë si thua?", - i foli Musabi.

- "Mirë fole!", – tha Usejdi dhe sakaq e nguli heshtën në tokë dhe u ul pranë tyre.

Musabi i foli atij për Islamin, madje duke i lexuar edhe disa pjesë nga Kur'ani. Transmetohet se Musabi me shokun e tij i thanë kështu: "Uallahi, ende pa folur fare, nga shkëlqimi dhe drita e fytyrës së Usejdit, ne e kuptuam se ai do të pranonte Islamin dhe do të bëhej mysliman." Mandej, Usejdi tha kështu:

- "Ç'fjalë të bukura janë këto që po thoni, shumë tërheqëse! Çfarë bëtë ju, kur deshët të pranonit Islamin?"

- "Duhet të lahesh, të marrësh gusul dhe të pastrohesh mirë. T'i pastrosh teshat që ke mbi trup, të thuash fjalën e dëshmisë dhe të falësh namazin."

Kështu, ai u çua, mori gusl, pastroi teshat e bardha dhe tha fjalën e dëshmisë. Pastaj fali dy rekate namaz. Menjëherë pas tyre tha:

- "Shikoni, pas meje është edhe dikush tjetër. Nëse edhe ai i pranon fjalët tuaja, atëherë nuk ka njeri nga fisi i tij që të mos ia dëgjojë fjalën dhe nuk do ta ndiqte pas në çfarëdo rrethanë. Po e nis menjëherë për te ju. Ai është Sad bin Muadhi."

Musab bin Umejri fton Sad bin Muadhin në Islam

Mandej, Usejdi mori heshtën që e kishte ngulur në dhe e u kthye për te njerëzit e tij. Ata ishin mbledhur dhe po rrinin të ulur në dhomën e kuvendit. Kur pa Usejdin që po vinte nga përtej, Sad bin Muadhi u tha të tjerëve që ishin aty:

- "Uallahi, fytyra e Usejdit se si më duket, ka ndryshuar, nuk ngjan më i njëjti njeri me atë që iku!"

Kur Usejdi erdhi në dhomën e kuvendit, Sadi e priti me fjalët:

- "Çfarë bëre?"

- "Fola me ata të dy. Të them të vërtetën, nuk m'u dukën njerëz edhe aq të rrezikshëm. U thashë: 'Mos qëndroni shumë këtej vërdallë!' Dhe ata m'u përgjigjën duke më thënë: 'Në rregull'. Me ç'kam dëgjuar, bijtë e Harithes janë nisur për të gjetur Es'ad bin Zuraren, pasi duan ta vrasin dhe qëllimin kryesor kanë që të të vënë ty në një pozitë sa më të vështirë, duke e vrarë në tokat e tua, sepse e ditkan që Es'adi është kushëriri yt.", – tha Usejdi.

Sad bin Muadhi, kur dëgjoi këtë lajm, i nervozuar dhe njëkohësisht i shqetësuar, u ngrit nga vendi ku ishte ulur me vërtik, mori në dorë heshtën dhe tha:

- "Zaten kush ka parë ndonjëherë që ti të kesh bërë ndonjë punë nga fillimi deri në fund deri më sot!" E sakaq u nis vetë për tek ata dy sahabë.

Sad bin Muadhi, kur i pa ata, ashtu, fare të pashqetësuar, në rehatinë e tyre, e kuptoi se Usejdi e kish mashtruar, që të sigurohej se ai do të shkonte atje dhe do t'ua dëgjonte ato që kishin për të thënë. I shau sa i shau, kur iu afrua dhe duke u kthyer nga Es'ad bin Zurareja, iu hakërrye:

- "Shiko këtu, o Eba Umame! Po të mos kishim lidhje gjaku me njëri-tjetrin, nuk do të ma kishe kërkuar diçka të tillë. Çfarë ke ndërmend të bësh, edhe në shtëpinë time do që të më turpërosh?"

Es'adi e dëgjoi njëherë dhe i tha Musabit duke pëshpëritur:

- "Shiko, Musab, uallahi ky njeri që ka ardhur sot tek ti është i pari i tërë këtij fisi. Nëse u bindet fjalëve që ti ke për t'i thënë, atëherë nga

fisi i tij nuk do të mbetet asnjë që nuk do ta ndjekë nga pas!"

- "A mund të ulesh të na dëgjosh pak? Nëse të pëlqen e do të të interesojë ajo që duam të të tregojmë, mund ta pranosh, nëse nuk të pëlqen, atëherë ne do të largohemi vetë!"

- "Nuk fole keq.", – iu përgjigj edhe Sadi dhe sakaq e nguli edhe ai heshtën në tokë, njëlloj siç kishte bërë Usejdi pak më parë, dhe u ul.

Musabi i foli atij për Islamin. Pastaj i lexoi atij ajetet e para të sures "Zuhruf":

"**Bismil'lahi'r-Rahmani'r-Rahim. Ha. Mim. Betohem në Librin e qartë, që shpjegon të vërtetën. Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kur'anin në gjuhën arabe, që ju të mund të mendoheni e të kuptoni, e Ai është te ne, në Librin kryesor (Leuhi Mahfudh), i lartësuar dhe plot urtësi. A ta tërheqim Përkujtimin (Kur'anin) prej jush ngaqë jeni popull i shfrenuar?**" (Zuhruf, 43/1-5)

Sahabët e përmendur edhe më lart kanë thënë se, "Uallahi edhe nga shkëlqimi dhe ndriçimi që buronte prej fytyrës së Sadit e kuptuam se ai do ta pranonte Islamin, duke u bërë mysliman."

Sad bin Muadhi i pyeti ata: "Çfarë keni bërë ju për t'u bërë myslimanë? Si e keni pranuar fenë islame?"

"Duhet të marrësh gusul, që të pastrohesh nga çdo papastërti; të pastrosh rrobat e brendshme dhe teshat që ke veshur sipër, të thuash fjalën e dëshmisë dhe, në fund, të falësh dy rekate namaz."

Ai u ngrit, iku dhe mori gusul të tërë trupit, pastroi mirë e mirë të gjitha teshat që kishte veshur mbi trup dhe fali dy rekate namaz. Pastaj, mori heshtën dhe bashkë me Usejd bin Hudejrin u kthyen për në dhomën e kuvendit.

Sad bin Muadhi fton në Islam bijtë e Abdulesh'helit

Njerëzit e tij e panë Sadin tek po vinte nga përtej dhe filluan të flisnin me njëri-tjetrin: "Uallahi po vjen Sadi dhe seç ka një çehre tjetër!" Sadi erdhi pranë tyre dhe u tha: "O ju bijtë e Abdulesh'helit! Për ç'njeri më njihni ju mua?"

- "Ti je zotëria ynë, që ke mendimet më të vyera dhe nga të gjithë

ne ti je më i fuqishmi!", – i thanë ata.

- "Mirë, meqë ju mendoni kështu për mua, atëherë ta dini se unë e kam të ndaluar të flas me burrat dhe gratë tuaja, derisa ju t'i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij! E kam vendosur dhe nuk do t'i flas asnjërit prej jush!", – foli Sadi.

Pasi tha këto fjalë, atë ditë, ende pa ardhur mirë muzgu, në fisin e bijve të Abdulesh'helit nuk mbeti më asnjë burrë e asnjë grua pa u bërë mysliman. Es'adi me Musabin shkuan në shtëpinë e Sad bin Muadhit. Musabi qëndroi aty, për t'u mësuar njerëzve mësimet e Islamit. Kjo qe një ftesë aq e vyer dhe e begatë, saqë, pos familjes së Umeje bin Zejdit, Hatmes, Uailit dhe Uakëfit, nga fisi i Eusit nuk mbeti asnjë familje pa u bërë të gjithë myslimanë."[108]

Ftesa dhe pranimi i Islamit nga Umejr bin Uehbi (r.a.)

Uruete bin Zubejri ka thënë kështu: "Pas disfatës në Bedër, Umejr bin Uehb el-Xhumehiu dhe Safuan bin Umejeja u vendosën në Hixhr të Mekës. Umejr bin Uehbi ishte një prej idhujtarëve më të paepur të Kurejshëve dhe nuk kishte njeri tjetër që t'u kishte shkaktuar më shumë vuajtje të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe sahabëve të tij më shumë sesa ai. Sa ishte në Mekë, myslimanët patën parë shumë të këqija prej tij. Një prej atyre që ishin marrë peng gjatë Bedrit, ishte edhe i biri i tij, Uehb bin Umejri. Umejri foli për (As'habi Kalib) sahabët e Profetit Muhamed që i kishin vrarë në Bedër dhe i patën hedhur të gjithë në një gropë. Safuani i tha:

- "Për faj të tyre jetës nuk i mbeti më pikë lezeti."

- "Ke të drejtë. Për Zotin, po të mos kisha frikë se do të vuanim shumë familjarisht, pasi të paguaja borxhin që më duhet të paguaj, do të shkoja te Muhamedi dhe do ta kisha vrarë, sepse edhe arsyen e kam: më kanë marrë djalin peng.", – ia pat Umejri.

Safuan bin Umejeja, duke përfituar nga këto fjalë:

- "Po mirë, do të ta paguaj unë të gjithë borxhin. Edhe fëmijët e familja le të rrinë të gjithë bashkë me familjen time. Për sa të kenë jetë

[108]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/153.

do t'i ndihmoj unë, nuk do të lejoj që t'u mungojë asgjë."

- "Në rregull, e pranoj!", – u përgjigj Umejri.

Mandej Umejri i urdhëroi të tijtë t'i mprihnin shpatën dhe t'ia lyenin atë me një helm shumë të fortë. Pa humbur kohë u nis për rrugë dhe shkoi në Medinë. Në atë kohë Omer bin Hatabi kishte mbledhur disa myslimanë dhe po u fliste atyre për Luftën e Bedrit, si dhe për mirësitë dhe ndihmën që kish dhënë Allahu atë ditë, çka i kishte bërë armiqtë e Allahut të pësonin një disfatë të tmerrshme. Omeri i nderuar e dalloi ardhjen e Umejr bin Uehbit. Umejri pati lënë devenë në hyrje të faltores dhe po priste me shpatën në mill. Atëherë Omeri tha me vete: "Ky Umejri është një qen, është armik i Allahut; me siguri, kushedi se ç'të keqe ka kurdisur në mendje dhe ka ardhur deri këtu. Ky është ai që donte të fuste ngatërresa mes nesh gjatë luftës, duke përhapur hamendësime rreth numrit se sa vetë ishim ne gjithsej." Kësisoj, shkoi pranë Profetit tonë.

- "O Profeti i Allahut! Ka ardhur ky armiku i Allahut, Umejri, është i armatosur me shpatë dhe ka ardhur deri te porta, po pret!"

- "Ma sill këtu atë, o Omer!", – i tha i Dërguari i Allahut.

Omeri u kthye dhe e kapi Umejrin nga kaishi i shpatës, të cilën e kishte lidhur rreth shpatullës dhe filloi ta tërhiqte me shpinë. Ndërsa ensarëve që ishin pranë u tha:

- "Ejani pranë të Dërguarit të Allahut dhe uluni pranë tij. Ta kini kujdes këtë njeri, sepse nuk është i besueshëm."

Kështu e futi Umejrin brenda. Profeti ynë, kur e pa Umejrin në atë gjendje, tha:

- "*O Omer, lëshoje atë! Ndërsa ti, Umejr, afrohu!*"

Umejri u afrua dhe e përshëndeti të Dërguarin e Allahut, duke i thënë: "Mirëmëngjes!"

- "*O Umejr, Allahu na ka nderuar duke na përshëndetur me një përshëndetje që është më e mirë se përshëndetja jote, me përshëndetjen e Allahut, me atë përshëndetje që banorët e Xhenetit përshëndetin njëri-tjetrin!*"

- "Uallahi, o Muhamed, unë tani po e dëgjoj për herë të parë këtë përshëndetje."

- "*O Umejr, pse ke ardhur?*", – e pyeti Profeti ynë.

- "Kam ardhur për djalin, që ma keni marrë peng; t'ju kërkoj që të silleni mirë me të!"

- "*Po, atëherë, ç'e ke atë shpatë që ke lidhur pas shpine?*"

- "Zoti i mallkoftë këto shpata, nuk na shërbyen për asgjë.", – mallkoi ai.

- "*Thuamë të vërtetën, përse ke ardhur?*", – e pyeti sërish i Dërguari i Allahut.

- "Për asgjë tjetër nuk kam ardhur, siç ju thashë kam ardhur për djalin!" – u përgjigj sërish Umejri, por Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha:

- "*Nuk është e vërtetë! Ju po rrinit ulur bashkë me Safuan bin Umejen në Hixhr dhe po flisnit rreth parisë suaj, të cilën e humbët në Bedër. Pastaj, ti i the Safuanit: 'Të mos kisha borxhet dhe të mos isha i shqetësuar për familjen, do ta kisha vrarë Muhamedin.' Ndërsa Safuani të tha se, me kusht që të më vrisje mua, ai do të t'i paguante të gjitha borxhet dhe do të merrte përsipër çdo përkujdesje që do t'i nevojitej familjes sate. Mirëpo Allahu hyri në mesin tuaj dhe nuk ta dha mundësinë që ti t'ia arrije qëllimit!*" Umejri, kur i dëgjoi ato fjalë, tha:

- "Unë dëshmoj se ti je i Dërguari i Allahut! O Resulallah! Ne të kemi përgënjeshtruar, duke i mohuar të gjitha lajmet që ti na i sillje prej qiejve dhe të gjitha ajetet që ty t'i ka zbritur Zoti. E vërtetë, ne ishim duke folur me Safuanin rreth kësaj çështjeje, e përveç nesh aty nuk ishte asnjë njeri tjetër. Tani jam më se i sigurt, se të gjitha këto lajme ty të vijnë prej Allahut. E lëvdoj me zemër Allahun që më udhëzoi në rrugën e drejtë dhe që më përfshiu në mesin e atyre që kanë zgjedhur të drejtën e të vërtetën!", – duke pranuar, se kësisoj edhe ai u bë mysliman.

Profeti ynë i tha:

- "*Mësojani mirë fenë vëllait tuaj, mësojini Kur'anin dhe lëreni të lirë robin që kemi zënë peng nga familja e tij.*" Sahabët u vunë menjëherë në lëvizje, që të bënin ashtu siç u kërkoi Profeti i tyre. Atëherë Umejri tha:

- "O Resulallah, unë jam përpjekur aq shumë për ta shuar dritën e Allahut. Sa e sa herë, i kam torturuar të gjithë ata që ishin të lidhur

fort pas fesë së Allahut. Më lejoni, të shkoj në Mekë dhe unë t'i ftoj të gjithë mekasit që të pranojnë dhe t'i besojnë edhe ata Allahut, të Dërguarit të Tij dhe fesë islame. Ku i dihet, mbase Allahu u jep edhe atyre mundësinë e udhëzimit. Nëse nuk pranojnë, atëherë, ashtu siç kam bërë me sahabët e tu, do t'i bëj edhe ata që të heqin keq prej meje."

Profeti ynë i dha leje Umejrit dhe kështu Umejri u kthye në Mekë.

Qëkurse Umejr bin Uehbi kishte shkuar tek i Dërguari i Allahut, për ta vrarë, Safuan bin Umejeja u pati thënë tërë mekasve:

- "Së shpejti kam për t'ju dhënë një sihariq aq të madh, sa që do ta harroni fare atë ç'ndodhi në Bedër!" Prandaj, ai u dilte para të gjithë karvanëve që u shkonte udha andejpari, nëse e kishin hasur Umejr bin Uehbin gjëkundi. Derisa, një ditë, erdhi dikush, i cili i tha se Umejri ishte bërë mysliman dhe Safuani, një t'i dëgjuar këto fjalë, vendosi që nuk do t'i fliste më kurrë, sa të kishte jetë, e të mos e ndihmonte asnjëherë për asgjë dhe atë ditë e kaloi të gjithën duke pirë."[109]

Urue bin Zubejri tregon: "Kur Umejri u bë mysliman, të gjithë besimtarët u gëzuan jashtë mase. Madje Omeri (radijallahu anhu) tha kështu: "Kur erdhi rishtazi, edhe derri më dukej më i dashur se ai. Mirëpo tani e dua më shumë edhe se disa prej fëmijëve të mi!"[110]

Uakidiu përcjell: "Pasi u bë mysliman, Umejr bin Uehbi u kthye menjëherë në Mekë dhe gjëja e parë që bëri, shkoi pranë familjes së vet. Te Safuan bin Umejeja nuk shkoi fare. U sqaroi atyre se ishte bërë mysliman dhe u bëri të gjithëve thirrje që të pranonin fenë islame." Safuani, kur i dëgjoi këto, tha:

- "Këtë unë e pata kuptuar që kur e pashë që shkoi fillimisht në shtëpi, pa u kthyer njëherë tek unë. Ra edhe ai pre e së keqes, braktisi fenë e të parëve. Nuk kam për t'i folur më dhe asnjërin nga fëmijët nuk kam për t'ia ndihmuar."

Gjatë kohës që Safuani qëndronte në Hixhr, Umejri i shkoi pranë dhe i thirri. Safuani ktheu fytyrën në anën tjetër, për t'i bërë të ditur se

[109]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/313.
[110]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 8/508 (14064).

nuk donte ta dëgjonte. Atëherë Umejri i tha:

- "Ti, një prej njerëzve më të nderuar ndër ne! Adhuronim gurët dhe për ta thernim kurbane. Pa më thuaj, fe është kjo, të therësh kurbane për gurët? Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet. Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij."

Safuani nuk nxori nga goja qoftë edhe një fjalë të vetme.[111]

Ebu Hurejreja (r.a.) u bën thirrje nënës dhe babait të tij, që të pranojnë Islamin

Ja çfarë ka thënë Ebu Hurejreja (radijallahu anhu): "Unë kisha kohë që e ftoja nënën, e cila ishte idhujtare, që të pranonte Islamin dhe të bëhej myslimane. Një ditë, kur dola sërish i humbur nga një diskutim i gjatë me të, ajo më tha disa gjëra aspak të këndshme për Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Duke qarë shkova tek i Dërguari i Allahut dhe i thashë:

- "O i Dërguari i Allahut, i kam bërë vazhdimisht thirrje nënës sime, që të pranojë Islamin, e të bëhet myslimane, mirëpo nuk pranon. E provova edhe sot. Mirëpo, ajo më tha ca gjëra për ty që nuk më pëlqyen fare. Lutju Allahut, që ta udhëzojë edhe nënën time."

- "*O Zot! Udhëzoje në rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës nënën e Ebu Hurejres!*", – u lut i Dërguari i Allahut.

Unë dola jashtë i kapluar nga një gëzim i papërshkrueshëm. Kur shkova në shtëpi dhe iu afrova portës, pashë që ishte e mbyllur. Nëna kishte dëgjuar zhurmën e hapave të mi.

- "Prit, Ebu Hurejre.", – më tha.

Dëgjova që nga brenda vinte një zhurmë uji që rridhte. Pastaj pashë që nëna kishte veshur rroba të pastra, kishte mbuluar kokën, kur më hapi derën dhe më tha:

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut që meriton të adhurohet. Unë dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut."

Unë u ktheva menjëherë dhe shkova drejt e te Profeti ynë, për ta

[111]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 2/486.

njoftuar për gjithë çfarë më kishte ndodhur me nënën. Aty ai lëvdoi Allahun dhe tha: "*Qoftë e hairit!*"[112]

Umu Sulejmi fton në Islam Ebu Talhanë, i cili donte të martohej me të

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Ende pa u bërë mysliman, Ebu Talhaja i pati kërkuar nënës sime, Umu Sulejmit, që të martohej me të. Mirëpo, Ummu Sulejmi i tha:

- "O Ebu Talha, po ti, a nuk e di se të gjithë zotat, të cilëve ti u beson, janë të bërë prej baltës?"

- "Po, e di!", – iu përgjigj ai.

- "Po mirë, po që adhuron pemët, a nuk të vjen turp? Po u bëre mysliman, atëherë ta dish, se unë nuk do të të kërkoj asgjë tjetër si *kusht të bashkëshortësisë*."

- "Më duhet të mendohem për këtë.", – tha Ebu Talhaja. Pastaj erdhi dhe tha:

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër, veç Allahut dhe se Muhamedi është profeti i Tij.", – duke u bërë sa ora mysliman.

Veç kësaj, Umu Sulejmi më tha mua: "Enes, ndihmoje Talhanë në punët e martesës." Dhe unë e ndihmova për gjithçka që i nevojitej.[113]

24. SAHABËT U BËJNË THIRRJE FISEVE ARABE QË TË PRANOJNË ISLAMIN

Dimam bin Thalebe fton fisin e bijve të Sadit, që të pranojnë Islamin

Ibni Abasi (radijallahu anhu) ka përcjellë se: "Fisi i familjes së Sad bin Bekrit, pati dërguar si përfaqësues Dimam bin Thalebe te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Dimami erdhi në Medinë, uli devenë pranë portës së faltores dhe e lidhi. Pastaj hyri brenda në faltore. I Dërguari ishte ulur dhe po bisedonte me një hallkë prej

[112]. Muslim, *Sahih,* 4/1938 (2491).
[113]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/461.

sahabëve të tij. Dimami kishte një trup të mbushur, flokët i kish të dendur dhe i kishte ndarë në formë gërsheti, në të dyja anët. Bëri disa hapa përpara dhe kur qëndroi para të Dërguarit të Allahut, tha: - "Kush është nipi i Abdulmutalibit?" - Resulallahu iu përgjigj:

- "*Unë jam i nipi i Abdulmutalibit.*"

- "Shiko, o nipi i Abdulmuttalibit, kam ardhur të të pyes hakçe-hakçe disa pyetje, po mos të të vijë keq!

- "*Nuk do të ndihem i fyer, po më pyet ç'të të vijë nëpër mendje!*", – iu përgjigj i Dërguari Fisnik.

- "Thuamë, për hir të Allahut, që pruri të gjithë ata që kanë ardhur përpara teje, e që do të vazhdojë të sjellë edhe gjithë të tjerët që do të vijnë pas teje, a të ka dërguar ty Allahu si profet, që ti të na udhëzosh ne në rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës?"

- "*Po, Allahu më ka dërguar!*", – tha i Dërguari i Allahut.

- "Po mirë, më thuaj, për hir të Allahut, që pruri të gjithë ata që kanë ardhur përpara teje, e që do të vazhdojë të sjellë edhe gjithë të tjerët që do të vijnë pas teje, Allahu të ka thënë ty, që të na thuash se nuk duhet të adhurojmë askënd tjetër, pos Atij, që të mos konsiderojmë askënd tjetër si ortak të Tij në krijimin e gjithësisë, si dhe që t'i hedhim poshtë të gjithë këta idhuj që ne adhurojmë edhe sot e kësaj dite?"

- "*Po, Allahu!*", – qe edhe kësaj radhe përgjigjja e tij.

- "Ai që është Zoti yt, i të gjithë atyre që kanë ardhur përpara teje dhe i gjithë atyre që kanë për të ardhur pas teje, të ka urdhëruar se duhet të falim pesë kohë të namazit?"

- "*Allahu më ka urdhëruar! Po, Allahu më ka urdhëruar!*", – tha Profeti ynë.

Ibni Abasi thotë: Dimami, kur dëgjoi këto përgjigje, e pyeti Profetin tonë edhe për të gjitha farzet e tjera të Islamit, për zekatin, agjërimin dhe haxhin, një e nga një, duke i drejtuar atij pyetje edhe për shtyllat dhe kushtet e tjera të Islamit dhe për të gjitha pyetjet që bënte, betohej njëherë me emrin e Allahut. Kur i përfundoi pyetjet, tha:

- "Esh'hedu en la ilahe il'lallah ue esh'hedu enne Muhammeden abduhu ue Resuluh, - duke shtuar, - unë do t'i kryej të gjitha këto farze që ju më thatë dhe do t'u shmangem të gjitha ndalesave që Zoti na

ka vënë, e nuk do të bëj asgjë më shumë e asgjë më pak. I Dërguari i Allahut tha:

- "*Nëse ky burrë me dy gërsheta e mban fjalën, ai do të hyjë në Xhenet.*"

Dimami shkoi te deveja, i zgjidhi litarin dhe u largua nga Medina. Kur mbërriti pranë njerëzve të tij, të gjithë u mblodhën njëherazi përreth tij. Kjo ishte fjala e parë që u tha atyre:

- "Ç'zota të këqinj që qenkan Lati dhe Uzza!"

- "Mbylle gojën, o Dimam! Do të goditesh, do të të godasë ndonjë shpirt, e mund të çmendesh! Ç'i ke këto fjalë që po nxjerr nga goja?", – filluan t'i flisnin ata.

- "Turp t'ju vijë juve! Për Zotin, ata idhuj as nuk ju bëjnë dot keq, as nuk ju vijnë dot në ndihmë. Allahu i Madhërishëm ka dërguar një profet, të cilit i ka zbritur edhe një libër, dhe ai do të na nxjerrë nga errësira në të cilën jemi zhytur. Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut, që nuk ka shok e ortak në krijimin e gjithësisë dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. Kam ardhur që t'ju bëj të ditura urdhëresat dhe ndalesat që Zoti na ka parashtruar."

Transmetuesi i hadithit thotë se: "Ju betohem në Allahun e Madhërishëm, se ende pa rënë muzgu i asaj dite, në fisin e Dimamit nuk mbeti asnjë burrë dhe asnjë grua pa u bërë të gjithë myslimanë. Ata ndërtuan edhe një faltore dhe filluan ta thërrisnin vetë ezanin, për të kryer faljen e namazit."[114]

Ftesa që iu bë Amr bin Murre el-Xhuheniut për të pranuar Islamin dhe si u bë ai mysliman

Amr bin Murre el-Xhuheniu (radijallahu anhu) tregon: "Në kohën e injorancës, bashkë me një grup njerëzish nga fisi ynë, u nisëm për të kryer haxhin. Kur ishim në Mekë, pashë në ëndërr sikur prej Qabes po përhapej një nur që i bënte të shndritnin, si malin e Jethribit, ashtu edhe malin Es'ar të fisit Xhuhejne. Nga mesi i tërë asaj drite dëgjova një zë teksa ngrihej: "Errësira u zhbë dhe gjithandej është përhapur drita; u dërgua i fundmi i profetëve." Pastaj pjesën përpara meje e

[114]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/601.

ndriçoi një tjetër dritë. Pashë shtëpitë e bukura të qytetit të Ta Hires dhe vilat e bukura të bardha të Medainit. Dhe nga brendësia e kësaj drite më erdhi një zë, i cili më thoshte: "Është shpallur Islami, u thyen të gjithë idhujt dhe u bënë edhe njëherë më të forta lidhjet familjare!" Më doli gjumi menjëherë dhe brenda vetes ndihesha i frikësuar. U thashë shokëve:

- "Uallahi, shumë shpejt, në mesin e kurejshëve ka për të ndodhur diçka shumë e madhe!", – duke u treguar atyre edhe ëndrrën që kisha parë."

Kur mbërritëm në qytezën tonë, na erdhi lajmi se ishte dërguar një profet me emrin "Ahmed". Dola menjëherë për rrugë. Shkova pranë të Dërguarit të Allahut dhe i tregova ëndrrën që kisha parë. Ai më tha:

- "*O Amr bin Murre, unë jam një profet i dërguar për mbarë robt e Allahut! Kam ardhur t'i ftoj ata në Islam, si dhe t'i këshilloj, që ata të kujdesen për veten e të ruajnë jetën, të mos i ndërpresin marrëdhëniet me familjen dhe të afërmit e tyre, të mos adhurojnë vetëm se Allahun, të braktisin çdo idhull, të kryejnë haxhin në Qabe dhe të agjëronte përgjatë plot një muaji nga dymbëdhjetë muaj që ka viti, në Ramazan. Ai që e pranon ftesën time, do të fitojë Xhenetin dhe kush e mohon, duke e kërkuar shpëtimin në tjetër anë, do të digjet në zjarrin e Xhehenemit! Andaj, o Amr, beso, që Allahu të të ruajë prej vuajtjeve të Xhehenemit!*"

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet dhe nuk kam dyshim se ti je i Dërguari i Allahut. U kam besuar të gjitha gjërave që Ai i ka lejuar, ashtu si edhe të gjitha ndalesave që Ai na ka vendosur.", – shpalli besimin e tij Amri. Në atë kohë i thashë edhe vargjet që pata thurur kur dëgjova se kishte ardhur një profet.

- "Kishim një idhull, që shërbente si shërbyes i babait tim. Kur dëgjova emrin e Profetit, e mora idhullin dhe e theva. Mandej, iu bashkova karvanit të të Dërguarit të Allahut, duke recituar këto vargje:

"*Allahun e Drejtë e dëshmova,*
e idhujt prej guri, poshtë, i pari unë i hodha
përvesha mirë mëngët për rrugë

që pengesë a ndalesë a lartësi në udhën
e më të mbarit ndër njerëz, pengesë të mos kisha
që prej të parëve shokë të tij unë të isha.
Që përtej qiejsh, Lajmëtar i Zotërisë së njerëzimit na erdhi!"

Pasi e dëgjoi, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha:

- "*Mirë se erdhe, o Amr!*"

- "T'u bëfshin kurban nënë e babë! Më dërgo te familja ime. Kam shpresë, se ashtu siç Zoti më fali mua mirësinë për t'u njohur me ty, do të më nderojë edhe me mirësinë që të bëhen edhe ata myslimanë.", – i thashë unë, në atë kohë, të Dërguarit të Allahut.

Në fund, më dërgoi dhe, para se të nisesha, më paralajmëroi: - "*Të jesh sa më i butë! Thuaj vetëm të vërtetën dhe mos u trego i ashpër, t'i shmangesh mendjemadhësisë dhe t'i qëndrosh larg smirës!*" Erdha pranë familjes sime dhe u thashë:

- "O bijtë e Rifait! Jo, jo! O bashkësi e Xhuhejnes! Këtë herë unë kam ardhur tek ju si mëkëmbës i të Dërguarit të Allahut, që t'ju ftoj të pranoni fenë islame e të bëheni myslimanë. Unë ju urdhëroj të mos derdhni gjak, t'i mbani sa më të forta lidhjet me familjen, të adhuroni Allahun, që është Një dhe i Vetëm, t'i braktisni idhujt, të vizitoni Qaben dhe të agjëroni përgjatë gjithë muajit të Ramazanit. Kush pranon, vendin do ta ketë në Xhenet, ndërsa ata që kundërshtojnë i pret zjarri!

O njerëz të Xhuhejnes, Allahu ju ka shpallur ju si më të zgjedhurit në mesin e arabëve, ku edhe bëni pjesë. Ai ju bëri, që shumë gjëra që pjesës tjetër të arabëve u dukeshin si të këndshme, juve t'ju dukeshin të shëmtuara. Ata, për shembull, i martonin edhe dy motra me të njëjtin burrë, luftonin gjatë muajit të ndaluar dhe martoheshin me njerkat e tyre. Kurse ju nuk jeni si ata. Me pak fjalë, ejani ta ndjekim këtë profet që ka ardhur nga mesi i familjes së Luej bin Galibit dhe nga kjo botë të fitojmë mirësitë më të arrira të amshimit."

Pas kësaj fjale, syresh vetëm njëri erdhi tek unë dhe më tha:

- "Zoti të vraftë, o Amr bin Murre! Si guxon të na urdhërosh të

braktisim zotat tanë, të përçahemi dhe t'i kthejmë shpinën asaj feje të lartësuar që na e kanë lënë trashëgim të parët tanë? Si guxon të na thërresësh ne të të ndjekim për atje ku na thërrasin ata kurejshë? Ti je i pacipë dhe i pa dinjitet!"

Pastaj, ai njeri i urryer i lexoi këto vargje:

- "Fjalë që tha Amri, i biri i Murres
që njeri me mend në kokë jo s'i thotë
e di, çdo fjalë që tha e që mendon
një ditë si e keqe do e pushton,
se gjithë të parët tanë të çmendur i numëron.
Se jo, atë që të parët e vet shan, asgjë s'e shëron!"

Amri tregon: "Edhe unë i thashë atij:

- "Kush gënjen prej nesh, atij Allahu t'ia bëjë jetën helm, t'ia marrë gjuhën, e dritën e syve t'ia shuajë!"

Uallahi, ende pa vdekur, atij njeriu goja iu shtrembërua, sytë iu verbuan dhe nuk kishte mundësi të shijonte dot asnjë prej ushqimeve që i shtroheshin për të ngrënë.

Transmetuesi thotë: "Amri, bashkë me ata që u bënë myslimanë prej familjes së tij, u nisën dhe shkuan pranë të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). I Dërguari i Allahut i përshëndeti, duke u thënë:

- "*Mirë se erdhët!*" U shkroi këtë letër dhe ua dha:

"*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.*

Kjo është një letër e Profetit të Allahut, i cili ia dërgon fisit të bijve të Zejdit përmes Amr bin Murres. Të gjitha tokat, malet dhe kullotat, deri edhe thellësitë e luginës, të cilat i përdorni për të kullotur gjedhët, si dhe ujin që e përdorni për të pirë, jua kam lënë juve, me kushtin që të jepni një të pestën e asaj që përftoni dhe të falni të pesë kohët e namazit. Kur kopetë e deleve dhe lopëve janë të bashkuara, si taksë do të jepen nga dy dele, ndërsa, kur janë të ndara, vetëm nga një. Ndërsa, për kafshët e rrugës dhe ato që ju i përdorni për të mbartur ujin nga puset nuk ka taksë. Allahu dhe myslimanët që janë këtu të pranishëm janë dëshmitarë të kësaj marrëveshjeje mes meje dhe jush."[115]

[115]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 2/351.

Kur ftohet në Islam fisi i Tufejl bin Amr ed-Deusit

Muhamed bin Is'haku tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), megjithëse kishte hequr shumë keq e shumë vuajtje nga njerëzit e tij, ai, prapëseprapë, sillej mirë me ta, i ndihmonte, pa reshtur kurrë së ftuari drejt shpëtimit të madh. Kur Allahu e lartësoi atë mbi mbarë kurejshët, kësaj here ata nisën të kërcënonin çdo arab, madje mbarë popullsinë, se nuk do t'ua falnin kurrë, nëse ata i përgjigjeshin ftesës së tij për të pranuar Islamin. Siç na e përcjell Tufejl bin Amr ed-Deusi, kur i Dërguari i Allahut ishte ende në Mekë, atje shkonte edhe Tufejli. Ky ishte një njeri shumë i respektuar, i zgjuar dhe, për më tepër, një ndër poetët më të dashur për popullin. Kur mbërriti në Mekë, tek ai u mblodhën menjëherë disa kurejshë, për t'i thënë:

- "O Tufejl, ti je një i huaj i sapoardhur në qytezën tonë. Nga radhët tona ka dalë një njeri, i cili na i ka ngatërruar të gjitha punët, e ka përçarë shoqërinë në dy fronte dhe fjalët i ka si magji! Ndan birin nga i ati, vëllezërit me njëri-tjetrin, madje edhe burrin nga gruaja. Kemi frikë se ato që na kanë ndodhur ne, do të të ngjasin edhe ty, kështu që bëj ç'të bësh dhe ruaju që të mos flasësh fare me të, e mos prano që ta dëgjosh, po të kërkoi të flasë me ty!"

Tufejli thotë: "Aq shumë këmbëngulën, saqë me vete vendosa: 'Nuk do ta dëgjoj atë njeri, madje nuk do të flas fare me të. Aq sa, kur shkova në Xhaminë e Shenjtë, i mbusha veshët me pambuk, që të mos dëgjoja asgjë nga ato që do të thuheshin. Kur, sa hap e mbyll sytë veten e gjeta në Qabe. Pashë njëherë, Profeti ishte në këmbë përpara Qabes, po falej. Qëndrova në një vend aty pranë tij. Me sa duket, sado që unë nuk doja, Allahu kishte vendosur që unë do ta dëgjoja. Fjalët që dëgjova prej tij ishin shumë të bukura. Thashë me vete: "Një njeri si unë, i zgjuar, poet, di shumë mirë si ta dallojë fjalën e bukur nga fjala e shëmtuar, që nuk ka kurrfarë peshe. Çfarë mund të më pengojë nga të dëgjuarit e fjalëve që po thotë kështu ky njeri? Nëse thotë ndonjë gjë që është e drejtë, atëherë mund ta pranoj, nëse thotë gjëra të shëmtuara e pa kuptim, atëherë, mund të largohem fare lehtë dhe aq më bën." Kështu, vendosa të prisja derisa ai të përfundonte faljen. Më në fund, mbaroi dhe mori rrugën për të shkuar në shtëpinë e vet. E ndoqa nga

pas. Kur sa do të hynte në shtëpi, iu afrova dhe i fola:

- "O Muhamed, njerëzit më kanë thënë kështu e kështu për ty. Dhe aq shumë ma kallën frikën me ato që më thanë, saqë ja, edhe veshët i mbylla me pambuk, që të mos dëgjoja asnjë fjalë nga fjalët e tua. Mirëpo, me sa duket, Allahu ka dashur medoemos që unë t'i dëgjoja ato që ti po thoshe teksa faleshe, dhe ato që dëgjova ishin fjalët më të bukura që kam dëgjuar ndonjëherë. Eja, tregoma edhe mua detyrën tënde, për të cilin u ke folur edhe të tjerëve!"

I Dërguari i Allahut filloi të më shpjegonte Islamin, duke më lexuar edhe pjesë të ndryshme nga Kur'ani. Uallahi, deri atë ditë nuk kisha dëgjuar ndonjëherë ndonjë fjalë më të përsosur se fjalët e Kur'anit dhe nuk kisha dëgjuar për ndonjë mision, i cili të ishte më i përkryer se misioni i tij. U bëra menjëherë mysliman, duke thënë fjalën e dëshmisë, ndërsa të Dërguarit të Allahut i thashë:

- "O Resulullah, mua të gjithë më respektojnë. Më lejo të kthehem pranë njerëzve të mi dhe t'i ftoj që ta pranojnë edhe ata Islamin. Lutju Allahut për mua, që kur t'u bëj thirrje për të pranuar Islamin, Allahu të më ndihmojë me ndonjë shenjë a ndonjë ndihmë tjetër dhe ata të mos ngurrojnë, por ta pranojnë fjalën time."

- "*O Zot! Fali atij një shenjë që t'i vijë në ndihmë.*", – u lut i Dërguari i Allahut.

Pastaj, unë u largova nga Meka, për të shkuar pranë njerëzve të mi. Me të mbërritur në luginën prej nga fillonte të dukej fshati ynë, mes dy syve m'u shfaq një dritë e ngjashme me flakën e kandilit. Aty iu luta Allahut:

- "O Zot! Sikur ta kisha këtë dritë në një pjesë tjetër të trupit, që, kur t'u flas për Islamin, të mos mendojnë se ky është një ndëshkim për mua, ngaqë kam braktisur fenë e të parëve!"

Atëherë ai nur u zhvendos menjëherë në fundin e kamxhikut tim. Teksa njerëzit orvateshin të kuptonin se ç'ishte ashtu ajo dritë, në fundin e atij kamxhiku, unë po përpiqesha të zbrisja teposhtë luginës. Shkova pranë fisit tim. Kur zbrita për në shtëpinë time, tek unë erdhi babai, të cilin e kisha shumë të moshuar.

- "Baba, përpiqu të rrish larg meje, se as unë nuk jam i yti, e as ti

nuk je i imi!", – i thashë babait tim.

- "Po pse, o bir?", – më pyeti ai.

- "Unë jam bërë mysliman, sepse pranova fenë e Muhamedit.

- "O bir, po edhe unë, të njëjtën fe që ke ti kam."

Dhe, sakaq, mori gusul, veshi tesha të pastra dhe u kthye sërish tek unë. Unë i shpjegova atij Islamin dhe ai e pranoi atë menjëherë, duke u bërë sakaq mysliman. Pastaj, tek unë erdhi im shoqe. Edhe asaj i thashë të njëjtat fjalë:

- "Qëndro larg prej meje, sepse ne nuk kemi më asnjë lidhje me njëri-tjetrin."

- "T'u bëfshin kurban nënë e babë, e pse kështu?", – më pyeti ajo.

- "Islami na ndau ne prej njëri-tjetrit."

Kështu, edhe ajo pranoi, e u bë menjëherë myslimane. Kurse fisi im, ai i Deusit, nuk e pranoi edhe aq lehtë ftesën që u bëra unë. Fill pas kësaj, unë shkova sërish në Mekë, tek i Dërguari i Allahut, të cilit i thashë:

- "O Resulallah! Deusët dolën më të fortë nga unë, kam ardhur të të kërkoj që t'i mallkosh ata."

Mirëpo, ai nuk i mallkoi ata, përkundrazi u lut duke thënë:

- "*O Zot, udhëzoje fisin e Deusit në rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës.*"

- "*Shko tani, kthehu edhe njëherë pranë fisit tënd dhe ftoji ata në Islam dhe kujdesu që të sillesh me sa më shumë butësi me ta.*", – më porositi.

Dhe unë u ktheva edhe njëherë pranë fisit tim. Nuk reshtja së bëri të gjithëve thirrje që të pranonin Islamin. Ndërkaq, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte mërguar për në Medinë. Kishte bërë edhe tri luftëra, atë të Bedrit, të Uhudit dhe të Hendekut. Më vonë, në Medinë shkova edhe unë bashkë me besimtarët e shtatëdhjetë a tetëdhjetë familjeve, që ishin bërë tërësisht myslimane. Kur mbërritëm në Medinë, i Dërguari i Allahut gjendej në Hajber."[116]

Ndërsa në transmetimin e Ebu'l-Ferexh el-Isbahanit do të vërejmë edhe disa hollësi të tjera: "Kur Tufejli erdhi në Mekë, shumë njerëz

[116]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/100.

të kurejshëve e paralajmëruan atë për Profetin dhe i kërkuan që t'i shmangej atij me sa të mundte. Megjithatë ai shkoi te Resulullahu, që t'i lexonte atij prej poezive të veta. Ndërkohë, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i recitoi atij suret "Ihlas" dhe "Muauidhetejn" ("Felek" dhe "Nas"). Tufejli e pranoi Islamin menjëherë dhe kësisoj u kthye për te fisi i tij si mysliman.

Të parin Tufejli ftoi në Islam të atin. Edhe ai u bë menjëherë mysliman, kurse nëna nuk pranoi. Ftoi fisin, por askush nuk ia pranoi atë ftesë, përveç Ebu Hurejres (radijallahu anhu). Pastaj, Tufejli erdhi sërish te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), për t'i thënë: "A ke fuqi ta kthesh përmbys gjithë tokën ku jetojnë Deusët?" I Dërguari i Allahut iu përgjigj kërkesës së tij, jo me mallkim, por duke u lutur për pjesëtarët e fisit të Deusit, Tufejli i tha:

- "Po unë nuk të kërkova që të luteshe për ta!" Dhe, i Dërguari i Allahut i dha këtë përgjigje:

- "*Po në mesin e tyre ka shumë njerëz si ti.*"

Xhundub bin Amr ed-Deusi, në kohën e injorancës, vazhdimisht thoshte: "E tërë kjo gjithësi medoemos që e ka një krijues! Po se kush e ka krijuar, nuk e di."

Kur dëgjoi për Profetin tonë të nderuar, ky njeri u nis menjëherë, bashkë me shtatëdhjetë e pesë vetë të tjerë, për të shkuar tek ai. Ebu Hurejreja na thotë se: "Xhundubi ia pati prezantuar një e nga një të Dërguarit të Allahut, të gjithë shokët e tij, të cilët kishin pranuar Islamin."[117]

25. KUR SAHABËT FISNIKË DËRGOHEN SI MËKËMBËS PËR TË FTUAR NJERËZIT NË ISLAM

Hisham bin Asin dhe shokët e tij i dërgon te Herakliu

Tregon Hisham bin As el-Emeuiu: "Në kohën e kalifatit të Ebu Bekrit (radijallahu anhu), bashkë me një shok, mua më dërguan si mëkëmbës te Herakliu. Do t'i bënim ftesë që të pranonte fenë islame dhe të bëhej mysliman. U nisëm. Kur mbërritëm në Damask, na priti

[117]. Ibn Haxher, *Fet'hu'l-Bari,* 8/102 (4131).

Xhebele bin Ejhem el-Gassaniu në shtëpinë e tij. Me të mbërritur tek ai, e gjetëm të ulur në kolltukun e tij. Dërgoi dikë për të folur me të.

- "Uallahi, kjo është një punë që nuk bëhet me lajmëtarë! Këtu na kanë dërguar, që të flasim vetë me mbretin, nëse do të na pranojë, duam të flasim me të, në të kundërt ne nuk do të flasim nëpërmjet një lajmëtari."

Mëkëmbësi i mbretit u kthye mbrapsht, për t'i bërë të ditur Herakliut kërkesën tonë. Ai e pranoi kërkesën tonë dhe na dërgoi lajm, duke na thënë:

- "Ejani, ma thoni çfarë keni për të më thënë."

Fjalën i pari e mori Hisham bin Asi, i cili i shpjegoi mbretit Islamin. Mbreti kishte veshur mbi trup një petk të zi.

- "Po këtë veshje të zezë, përse e mban?", – e pyeti Hishami.

- "Jam betuar, – iu përgjigj mbreti, – që nuk do ta heq këtë petk të zi nga trupi, derisa t'ju kem përzënë të gjithëve ju nga Damasku!"

- "Uallahi, ne, edhe atë kolltuk ku rri i ulur tani do të ta marrim nga duart. Të mos kesh kurrfarë dyshimi, se edhe sundimtarit të madh, Kisras, një ditë, do t'ia marrim sundimin nga duart! Këtë lajm na e ka dhënë Profeti ynë, Muhamedi."

- "Këtë nuk do ta bëni ju. Asaj dite do t'ia arrijë vetëm një shoqëri që ditën e kalon duke agjëruar, ndërsa natën duke falur namaz!", – u përgjigj Herakliu.[118]

26. SAHABËT DËRGOJNË LETRA PËR T'I THIRRUR NJERËZIT NË ISLAM

Ja se ç'ka thënë Zijad bin Harith es-Sudaiu (radijallahu anhu): "Erdha tek i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Lidha besën me të. Në atë çast mora vesh se Resulullahu kishte dërguar ushtarë pranë popullit tim."

- "O Resulullah! Të lutem, tërhiqi mbrapsht ata ushtarë. Unë të garantoj se njerëzit e fisit tim do ta pranojnë Islamin, duke u bërë të

[118]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/817 (30309).

gjithë myslimanë."

- "*Po mirë, atëherë, shko ti dhe ktheji mbrapsht ata ushtarë.*", – u përgjigj Profeti ynë.

- "O Resulallah, shkoj unë, por kafshën e rrugës e kam shumë të lodhur."

Atëherë, ai dërgoi dikë, që t'u thoshte ushtarëve të ktheheshin pas. Në vijim, unë i dërgova një letër njerëzve të mi. Fill pas letrës, fisi im dërgoi një përfaqësi, e cila i bëri të Dërguarit të Allahut të ditur se ata ishin bërë tashmë myslimanë.

- "*Vëlla nga Sudai, ti paske qenë vërtet një njeri i respektuar në mesin e njerëzve të tu!*", – më tha mua Resulullahu.

- "Përkundrazi, është Allahu që zgjodhi t'i udhëzonte ata në rrugën e drejtë.", – i thashë unë.

- "*A do që të të caktoj ty si prijës në krye të tyre?*"

- "Si të duash ti, o Resulallah.", – iu përgjigja.

Atëherë, i Dërguari i Allahut shkroi një letër, ku i njoftonte ata se si udhëheqës të tyre më caktonte mua.

- "O Resulallah, po sikur t'u shkruash edhe që një pjesë të zekatit të tyre të ma japin mua.", – i kërkova unë.

- "Në rregull.", – qe përgjigjja e tij, kështu që shkroi edhe një letër tjetër.

Kjo pati ndodhur gjatë njërës prej ekspeditave që kishte ndërmarrë i Dërguari i Allahut. Kur Resulullahu u vendos në një krahinë aty pranë, erdhën disa njerëz vendas, të cilët zunë t'i ankoheshin për udhëheqësit e tyre, duke i thënë:

- "Në të shkuarën, në kohën e injorancës, mes fisit të tij dhe atyre kishte ndodhur një ngjarje e pakëndshme, kështu që tani ata janë duke marrë hakun e saj."

- "*Vërtet e ka bërë diçka të këtillë?*", – pyeti .i.

- "Po!", – iu përgjigjën ata.

Profeti i profetëve u kthye nga sahabët e tij (mes tyre isha edhe unë) dhe përnjëherësh tha: "*Asnjë e mirë nuk i vjen besimtarit nga udhëheqja e të tjerëve!*"

Sudaiu thotë se kjo fjalë e të Dërguarit të Allahut la gjurmë të pashlyeshme tek unë. Në atë kohë pati ardhur edhe dikush tjetër që i tha:

- "O Resulallah! Jepmë diçka."

- "*Kushdo që kërkon diçka nga njerëzit, pa pasur vërtet nevojë për të, ajo nuk ka për t'i shërbyer atij, veçse për t'i shkaktuar telashe dhe shqetësime!*"

Ai njeri që kërkoi t'i jepnin diçka, i tha atëherë:

- "Atëherë më jep diçka prej zekatit!"

Resulullahu tha:

- "*Allahu i Madhërishëm, për sa i përket zekatit, nuk është i kënaqur as me gjykimet e Profetit, as me ato të të tjerëve. Vendimin për zekatin Ai e ka marrë Vetë, duke i ndarë në tetë kategoritë e njerëzve që mund të përfitojnë prej tij. Nëse ti bën pjesë në njërin prej këtyre tetë grupeve, atëherë, nuk ka dyshim që unë do të të jap edhe ty.*"

Më preku shumë kjo fjalë e Profetit tonë. Edhe pse isha shumë i pasur, unë i pata kërkuar të Dërguarit të Allahut lëmoshë. Ai, pasi fali edhe njëherë kazanë e namazit, i prura ato dy letrat që më kishte dhënë dhe i thashë:

- "Më falni, o Resulullah, më falni edhe për të dyja këto letra."

- "*Çfarë të shkoi nëpër mend?*"

- "O Resulallah, unë të dëgjova ty pak më parë, kur the: '*Asnjë e mirë nuk i vjen besimtarit nga udhëheqja e të tjerëve!*' Kurse unë i besoj Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe, po ashtu, prej teje dëgjova edhe teksa the: '*Kushdo që kërkon nga njerëzit diçka, pa pasur nevojë për të, ajo nuk ka për t'i shërbyer atij veçse për t'i shkaktuar telashe dhe shqetësime*'. Mirëpo edhe unë ta kërkova diçka të tillë, pavarësisht se jam shumë i pasur dhe në gjendje të mirë."

Atëherë, i Dërguari i Allahut më tha:

- "*Kështu është, në daç pranoje, në daç hiq dorë, ti e di.*"

- "Po heq dorë.", – iu përgjigja unë.

- "*Atëherë, tregomë një njeri, të cilin mund ta vendos në mesin tuaj si udhëheqës.*", – tha i Dërguari i Allahut.

Unë i tregova për njërin nga ata që kishin ardhur bashkë me ne në grup dhe ai e caktoi atë si prijës të bashkësisë sonë."[119]

27. NË KOHËN E PROFETIT TONË, SAHABËT I FTONIN NJERËZIT NË ISLAM EDHE KUR ISHIN NË FUSHËN E BETEJËS

Ftesa e Muslim bin Harith et-Temimiut

Harith bin Muslimi tregon se babai i tij ka transmetuar: "Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na pati dërguar diku në grup. Kur mbërritëm në vendin e përplasjes, unë i dhashë kalit pak më shpejt, duke i lënë shokët pas. Përballë na u shfaq një fis që po vinte me një vrungullimë. Unë u thashë atyre menjëherë:

- "Thoni 'La ilahe il'lallah', që të shpëtoni." E ata e pranuan menjëherë kërkesën time. Kur erdhën shokët, më qortuan duke më thënë:

- "Na hoqe nga duart një plaçkë lufte që ishte fati ynë."

Kur u kthyem pas, ata ia treguan edhe të Dërguarit të Allahut atë që kishte ndodhur. Profeti ynë më thirri mua dhe, duke thënë se i kishte pëlqyer shumë ajo sjellje e imja, filloi të numëronte lavdërime të njëpasnjëshme për mua:

- "*Ta dish, se Allahu i Madhërishëm të ka shkruar aksh e aksh shpërblim për secilin nga ata njerëz, të cilët pranuan se nuk ka zot tjetër veç Allahut, sepse ti u bërë shkak për shpëtimin e tyre.*" Dhe Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) vijoi të thoshte:

- "*Shiko, unë do t'u shkruaj edhe imamëve të myslimanëve që do të vijnë pas meje për ty, ku do t'u kërkoj që të të ndihmojnë dhe të të bëhen gjithmonë krah.*" Dhe e bëri atë që më tha. E vulosi letrën, ma dha mua dhe pastaj më tha kështu:

- "*Kur të falësh namazin e sabahut, pa folur me askënd asnjë fjalë të thuash shtatë herë: 'O Zot! Ruamë mua prej zjarrit!' Nëse ti vdes atë ditë, atëherë Allahu për ty do të shkruajë, se 'Ky njeri është i mbrojtur nga zjarri.' Edhe kur të falësh*

[119]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/375 (37075).

namazin e akshamit, pa folur asnjë fjalë me askënd do të thuash: 'O Zot! Ruajmë mua prej zjarrit.' Nëse vdes atë natë, atëherë Allahu për ty do të shkruajë se 'Është i ruajtur prej zjarrit.'"

Kur Allahu i Madhërishëm e largoi prej nesh shpirtin e Profetit të Tij, unë atë letër ia solla Ebu Bekrit (radijallahu anhu). E hapi dhe e lexoi, pastaj u urdhëroi të gjithëve që të më vinin në ndihmë për gjithçka që kisha nevojë, pastaj e vulosi edhe njëherë letrën dhe ma ktheu pas. Edhe më vonë, unë atë letër ia çova edhe Omerit (radijallahu anhu), e edhe ai bëri të njëjtën gjë. Pastaj e çova tek Osmani (radijallahu anhu), edhe ai po njësoj veproi."

Djali i këtij njeriu, Muslimi, thotë se: "Babai im, Harithi, vdiq në kohën e kalifatit të Osmanit (radijallahu anhu). Atë letër e kemi pasur ne deri kur u bë kalif Omer bin Abdulazizi. Në kohën që atë detyrë të lartë e mori përsipër Omer bin Abdulazizi, valiut të krahinës sonë i erdhi ky urdhër: "Muslim bin Harithin, bashkë me letrën që Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pati shkruar babait të tij, dërgojeni për tek unë!" - Dhe unë ashtu bëra, ia çova letrën. E lexoi, i urdhëroi njerëzit e tij që të më ndihmonin, pastaj e vulosi edhe ai."[120]

28. KUR SAHABËT PËRHAPNIN ISLAMIN NË KOHË LUFTE GJATË KALIFATIT TË EBU BEKRIT (r.a.)

Urdhri i Ebu Bekrit për komandantët

Said bin Musejebi tregon: Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) vendosi t'i dërgonte ushtritë në drejtim të Damaskut, si komandantë caktoi Jezid bin Ebi Sufjanin, Amr bin Asin dhe Shurahbil bin Hasene. Ushtarët u hipën kuajve dhe deveve dhe Ebu Bekri eci në këmbë bashkë me ta, deri në vendin ku i patën pritur bashkë me të Dërguarin e Allahut teksa hynin në Medinë, për t'i përcjellë, dhe u kthye. Ushtarët i thanë: "Si, ne të ecim mbi kuaj e mbi deve, e ti të na vish nga pas, kështu, në këmbë!"

- "Mos u shqetësoni, sepse këta hapa më duket sikur jam duke i bërë për tek Allahu."

[120]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/343.

E sakaq u dha atyre disa këshilla:

- "Ju këshilloj që ta ruani veten nga rënia në kundërshti me urdhëresat e Allahut. Luftoni në rrugën e Allahut. Luftoni me ata që nuk i besojnë Allahut. Allahu është ndihmësi më i madh i fesë së Tij. Mos vidhni nga malli i luftës, mos e tradhtoni njëri-tjetrin, mos kini frikë, mos nxirrni ngatërresa mbi Tokë dhe mos i kundërshtoni ato urdhra që ju jepen. Dashtë Allahu, kur të përballeni me armikun, t'i ftoni ata që të pranojnë tri gjëra. Nëse i pranojnë, atëherë edhe ju pranojini dhe mos i prekni ata. Pastaj bëjuni atyre thirrje që të mërgojnë drejt Medinës, sepse ajo është atdheu i mërgimtarëve. Nëse e bëjnë, atëherë bëjuni atyre të ditur se të gjitha të drejtat dhe detyrat e mërgimtarëve i gëzojnë e u takojnë edhe atyre po njësoj. Nëse bëhen myslimanë, por duan që të qëndrojnë në trevat e tyre, atëherë urdhërojuni atyre që t'i përmbushin të gjitha detyrimet e Islamit; bëjuni atyre të ditur, se derisa të fillojnë të marrin pjesë në luftë atyre nuk do t'u jepet asnjë pjesë nga malli i siguruar gjatë luftërave. Nëse nuk e pranojnë Islamin, atëherë t'u kërkoni që të paguajnë xhizjen. Nëse thonë, 'Po, pranuam!', edhe ju pranojini dhe mos prekni me dorë asnjeri prej tyre. Por edhe nëse nuk e pranojnë as këtë, atëherë lutjuni Allahut që t'ju ndihmojë dhe luftoni me ta. Mos i prisni pemët e hurmave, mos prishni asgjë, mos vrisni kafshë dhe mos vini dorë mbi drurët me fruta. Mos u bëni dëm faltoreve të të krishterëve dhe të hebrenjve dhe mos vrisni fëmijë, pleq ose gra! Atje do të gjeni shumë njerëz, që janë shumë të lidhur pas kishave. Për sa kohë që nuk ngatërrohen në luftë me ju, lërini të qetë në punën e tyre. Atje do të gjeni edhe ca të tjerë: njerëz që për shejtanin kanë qethur pjesën e mesit të kokës. Po hasët në ta, vritini ata menjëherë."[121]

Halidi (r.a.) fton në Islam komandantin bizantin Xherexhen dhe ai bëhet mysliman

Uakidiu dhe shumë të tjerë transmetojnë: "Në luftën e Jermukut, Xherexheja ishte njëri nga komandantët bizantinë. Ai pati dalë nga radhët e veta, për t'u takuar me Halid bin Uelidin. Halidi erdhi atje ku

[121]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/654 (11008).

e thirrën. U afruan aq shumë me njëri-tjetrin, saqë dukej sikur edhe pak edhe do të prekeshin trup më trup. Xherexheja i tha:

- "O Halid, thuamë të vërtetën, pa më gënjyer, sepse ai që është i lirë, nuk gënjen. As mos u përpiq të ma hedhësh, sepse ai që është fisnik dhe ka marrë përsipër detyrën e të qenët mëkëmbës i Allahut, nuk përpiqet t'ia hedhë askujt! Allahu i ka dërguar profetit tuaj një shpatë nga qielli, e ai atë ta ka dhënë ty. Kur ti e nxjerr atë shpatë dhe bëhesh gati për t'u përleshur, ty askush nuk mund të të bëjë ballë, sepse nuk ka dyshim që fitimtari do të jesh ti, e vërtetë është kjo?"

- "Jo.", – u përgjigj Halidi.

- "Po mirë, atëherë, ty pse të thërrasin të gjithë "Shpata e Allahut"? Duhet të ma shpjegosh edhe këtë!"

- "Allahu na ka dërguar neve një profet. Ai na ftoi ne që të pranonim fenë islame. Edhe ne, në fillim u orvatëm t'i qëndronim sa më larg, për të mos e pranuar të vërtetën që ai na kishte sjellë. Me kalimin e kohës, disa e pranuan, disa të tjerë e mohuan dhe vazhduan ta kundërshtonin. Edhe unë isha njëri prej këtyre që i qëndruan larg. Mirëpo, më vonë, ishte mirësia e Allahut që më fali edhe mua udhëzimin në rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës. Dhe ne lidhëm besën me Profetin tonë të nderuar. Aty ai më tha:

- "*Këtej e tutje, ti do të jesh një prej shpatave të Allahut, që Allahu ua nxjerr idhujtarëve!*", – dhe sakaq iu lut Allahut që të më ndihmonte. Prandaj edhe mua më thërrasin "Sejfullah" [Shpata e Allahut].

- "Ndër myslimanë unë jam një prej armiqve më të paepur të idhujtarëve.", – vijoi të thoshte Halidi.

- "Po mirë, për ku më fton ti mua, o Halid?", – e pyeti Xherexheja

- "Që të besosh dhe të dëshmosh se nuk zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet, se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Allahut dhe t'u besosh të gjitha urdhëresave që kanë ardhur nga vetë Allahu!"

- "Çfarë qëndrimi mbani ju ndaj atyre që nuk e pranojnë ftesën tuaj?", – e pyeti Xherexheja.

- "Kërkojmë të na paguhet taksa e xhizjes. Nëse e paguajnë, ne i

mbrojmë ata."

- "Po nëse nuk e paguajnë?

- "Do t'u shpallim luftë dhe do të luftojmë me ta."

- "Cili është pozicioni që zë ai që e pranon ftesën tuaj sot dhe përfshihet në radhët tuaja?"

- "Përballë urdhëresave që Allahu na i ka vendosur si detyrim, mes fisnikëve dhe popullit të thjeshtë, si edhe mes atyre që janë bërë të parët myslimanë dhe atyre që janë bërë më vonë, nuk ka asnjë dallim, sepse ata kanë të njëjtin pozicion."

- "Domethënë, shpërblimi i atij që përfshihet sot në radhët tuaja është i njëjtë me shpërblimin tuaj?"

- "Po, madje edhe më shumë."

- "Po mirë, po si është e mundur, që ai të jetë i barabartë me ju, kur ju jeni bërë më parë myslimanë?"

- "Ne, kur e pranuam këtë mision, nuk është se kishim mundësi që të bënim ndonjë zgjedhje tjetër. Duhet ta bënim tonën. Kur lidhëm besën me Profetin tonë, ai ishte ende mes nesh dhe nga qielli i vinin ende urdhëresa, ku na jepeshin mësime nëpërmjet Kur'anit dhe besimi na përforcohej prej mrekullive që Allahu i falte të Dërguarit të Tij. Kushdo që shihte ato që shihnim ne dhe dëgjonte ato që ne dëgjonim, patjetër që do të bëhej mysliman. Mirëpo, ju as nuk keni parë, as nuk keni dëgjuar ndonjë prej mrekullive që ne i pamë me sy dhe i dëgjuam me veshët tanë! Prandaj, ata që hyjnë sot në Islam, njëfarësoj, qëndrojnë më lart se ne."

- "Të thuash të vërtetën për hir të Allahut, ti nuk më the asgjë pos së vërtetës. Nuk më gënjeve dhe nuk deshe të ma hidhje."

- "Uallahi unë të thashë të vërtetën, sepse përgjigjet që unë të dhashë, për ato që më pyete, nuk janë përgjigjet e mia, por të Allahut."

Atëherë Xherexheja hoqi mburojën nga trupi dhe kaloi në krah të Halidit, e i tha:

- "Më mëso Islamin."

Halidi e mori dhe e çoi në çadrën e tij. Pasi i derdhi një ibrik me ujë, i tha të falte dy rekate namaz. Kur bizantinët panë se Xherexheja

po kthehej bashkë me Halidin, ata i sulmuan aq ashpër myslimanët, saqë veç taborëve që ishin nën komandën e Ikrime bin Ebi Xhehlit dhe Harith bin Hishamit, të gjithë të tjerët u detyruan të tërhiqeshin. Atëherë Halidi dhe Xherexheja u hipën kuajve. Në atë kohë, bizantinët kishin hyrë deri në mesin e radhëve të myslimanëve. Halidi i foli ushtrisë dhe myslimanët kaluan në sulm të menjëhershëm. Ai u urdhëroi atyre të nxirrnin shpatat dhe nuk zgjati shumë, kur shpatat filluan të vringëllinin me njëra-tjetrën. Halidi me Xherexhenë shkundën shpatat që kur dielli filloi të ngrihej lart në qiell e derisa perëndoi. Namazet e drekës dhe ikindisë myslimanët i falën me gjeste. Xherexheja ra dëshmor, Zoti e mëshiroftë. Nuk fali dot më asnjë namaz tjetër, veç atyre dy rekateve që ai i pati falur me Halidin."[122]

29. KUR SAHABËT PËRHAPNIN ISLAMIN NË KOHË LUFTE GJATË KALIFATIT TË OMERIT (r.a.)

Rib'i bin Amiri (r.a.) fton në Islam Rustemin

Ata që ishin aty atë ditë tregojnë: "Me kërkesën e Rustemit, Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) dërgoi tek ai Rib'i bin Amirin. Kur shkoi te Rustemi, Rib'iu ç'të shihte! Kuvendi i Rustemit ishte plot jastëkë të thurur me florinj, e me sa e sa stoli të tjera të kushtueshme! Edhe Rustemi, qëndronte i ulur mbi një fron të bërë prej druri dhe në kokë mbante një kurorë prej floriri. Kurse Rib'iu kishte veshur rroba të vjetruara dhe veç mburojës dhe një kali me këmbë të shkurtra, ai nuk kishte asgjë tjetër. Me kalë filloi të ecte mbi tapetet e trasha të mëndafshit të Rustemit. Pastaj zbriti nga kali dhe e lidhi atë afër njërit prej atyre jastëkëve. Me vete kishte edhe një shpatë, në shpinë parzmoren, ndërsa në kokë kishte helmetën. Ata e pritën me fjalët:

- "Armët duhet t'i dorëzosh!"

- "Nuk kam ardhur vetë, ju më keni ftuar. Nëse doni, unë do të hyj kështu, përndryshe unë kthehem dhe iki.", – u përgjigj Rib'iu.

- "Lëreni të vijë.", – thirri Rustemi.

Dhe ai u afrua për te Rustemi, duke ecur mbi heshtë, e cila i shponte

[122]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/12.

tapetet aty ku hidhej.

- "Përse ke ardhur?", – e pyetën ata.

Ai iu përgjigj:

- "Ne na ka dërguar Allahu. Detyra jonë është, që ata që do Ai t'i shpëtojmë nga robërimi ndaj robërve të tjerë dhe t'i drejtojmë ata kah robërimi ndaj Allahut. Që t'i shpëtojmë ata nga varfëria dhe t'i bëjmë të pasur; t'i shpëtojmë ata nga shtypja dhe padrejtësitë, duke u ofruar drejtësinë e Allahut. Allahu na ka dërguar ne te njerëzit me fenë e vërtetë, që t'i ftojmë ata të pranojnë fjalën e Zotit. Kushdo që e pranon atë, edhe ne do ta pranojmë fjalën e tij dhe nuk e prekim. Nëse nuk priren të na pranojnë, atëherë ne do të luftojmë me ta derisa të biem dëshmorë të gjithë."

- "Cili është premtimi i Allahut?", – e pyeti Rustemi.

- "Allahu u premton Xhenetin atyre që vdesin duke luftuar për Të, ndërsa për ata që mbeten gjallë fitoren."

- "I Dëgjova fjalët e tua, tani mund të na lësh ca kohë, që edhe ne të mendohemi? Kësisoj, edhe ne do të keni kohë për t'u menduar, por edhe ju."

- "Në rregull, si të doni! Sa kohë ju duhet, një ditë, apo dy ditë?"

- "Jo! Jo, më shumë, sepse duhet të këshillohemi me të gjithë këshilltarët dhe t'u dërgojmë letra gjithë parisë sonë, ndaj na duhet më shumë kohë."

- "Sa herë që jemi përballur me armiqtë, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk na ka ngarkuar asnjëherë me përgjegjësinë që t'u njohim kohë atyre më shumë se tri ditë. Ti, bashkë me popullin tënd, mendohuni dhe pas tri ditësh, të zgjidhni njërin prej këtyre të triave: Të bëheni myslimanë, të paguani xhizjen ose të luftoni."

- "Ti je i pari i tyre?", – e pyeti Rustemi.

- "Jo! Por myslimanët janë si një trup i vetëm, si ata që qëndrojnë lart, si ata që qëndrojnë poshtë fare; mund të japin të njëjtën garanci në emër të mbarë myslimanëve."

Pas këtyre fjalëve, Rustemi mblodhi gjithë parinë e popullit të tij dhe u tha:

- "A keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë fjalë më të fuqishme e që ia vlen më së shumti të zgjidhet sesa kjo që thotë ky njeri?"

- "Mos e dhëntë Zoti! Edhe ti po ua vë veshin fjalëve të tyre? Çfarë do të bësh, do të braktisësh fenë tënde dhe do t'i shkosh pas atij qeni? A nuk e sheh se si është veshur, e sa të vjetra i ka rrobat?", – i thanë ata.

- "Turp t'ju vijë! Ju nuk duhet të shihni rrobat e tij, por bindjet, fjalët dhe sjelljet. Kur ju e dini mjaft mirë, se arabët nuk u japin shumë rëndësi as veshjeve, as ushqimeve, por ruajtjes së fisnikërisë."

Përpara se të luftojnë, Sad bin Ebi Uekasi i dërgon Kisrës një grup nga shokët e tij

Siç tregon Ebu Uaili: "Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) erdhi dhe u vendos në vendin e quajtur Kadisije. Nuk e di me saktësi; por nuk ishim më shumë se shtatë-a tetëmijë vetë. Kurse idhujtarët ishin të paktën tridhjetëmijë. (Siç e përcjellin Ibni Kethiri në *El-Bidaje*-n e tij, Sejfi, por edhe shumë historianë të tjerë, atë ditë, armiqtë ishin të paktën tetëdhjetëmijë vetë. Ndërsa, në një transmetim tjetër thuhet se në anën e Rustemit ishin njëqind e njëzetmijë ushtarë, tetëdhjetëmijë prej të cilëve qëndronin rezervë.) Veç kësaj, ushtria e Rustemit kishte me vete edhe tridhjetë e tre elefantë. Elefanti i bardhë ishte elefanti i Kisrës, të cilin e quanin Sabur. Më i madhi ishte ai që qëndronte në krye, kurse të tjerët i vinin nga pas.

Të parët folën persët:

- "Ju nuk keni fuqi për t'u përballur me ne! As armatimet nuk ju mjaftojnë. Pse keni ardhur? Hajde, kthehuni më mirë andej nga keni ardhur!"

- "Nuk do të kthehemi!", – iu përgjigjëm ne.

Ata shikonin shigjetat tona dhe qeshnin me njëri-tjetrin, duke thënë: "*Duk dukig, ig*", që do të thoshte se shpatat tona po i ngjasonin me furkat që përdoreshin për tjerrjen e leshit. Kur ne ua bëmë të ditur se nuk do të ktheheshim, atëherë ata thirrën:

- "Na dërgoni dikë që është më i mençuri në radhët tuaja, të na tregojë arsyen se pse keni ardhur."

Mugire bin Shubeja (radijallahu anhu) u hodh i pari dhe tha:

- "Shkoj unë!", – dhe sakaq kaloi në anën e tyre, u ul ndanë Rustemit në fronin e tij, mirëpo persët ngërdhesheshin.

- "Fakti që po ulem këtu as nuk ma shton nderin mua, as nuk ia pakëson të zotit të tij."

- "Ke të drejtë. Po pse keni ardhur?", – i tha Rustemi.

- "Ne ishim të zhytur gjer në gju në punë të shëmtuara e shthurje. Allahu i Madhërishëm na dërgoi neve një profet, i cili na tregoi rrugën e drejtë, e pos kësaj, na mundësoi edhe shumë të mira të tjera. Mirëpo, pasi i provuam kokrrat e grurit të këtyre tokave dhe ua dhamë edhe fëmijëve tanë që t'i shijonin, tani themi: "U mësuam me këtë grurë, nuk durojmë dot pa të! Na çoni në ato toka, që të hamë nga buka e atij gruri!"

- "Nëse është kështu, atëherë ne më e mira është që t'ju vrasim!"

- "Po na vratë, ne do të shkojmë në parajsë, por po ju vramë ne ju, ju do të shkoni në ferr, dhe ata që do të mbeten pas jush do të na paguajnë neve taksën e xhizjes. Kështu që e keni më mirë që të na jepni direkt xhizjen.", – tha Mugireja.

Fytyrat e persëve u vrenjtën dhe disa syresh zunë edhe të bërtisnin:

- "Është e pamundur që ne të bëjmë paqe me ju!"

- "Bukur fort, atëherë të luftojmë, do të suleni ju drejt radhëve tona, apo të sulemi ne?", – i pyeti Mugireja ata.

- "Ne do të kalojmë mes jush!"

Kësisoj, ushtria myslimane u tërhoq dhe kur persët kaluan, myslimanët iu turrën në mënyrë të befasishme dhe i shkatërruan."[123]

Muauije bin Kurre (radijallahu anhu) tregon: "Atë ditë që u zhvillua lufta e Kadisijes, myslimanët dërguan Mugire bin Shuben (radijallahu anhu) në anën e udhëheqësve të persëve. Mugireja kërkoi që bashkë me të, të shkonin edhe dhjetë vetë të tjerë. Kjo kërkesë iu përmbush. Mugireja i lidhi fort teshat dhe me vete mori vetëm mburojën të cilën e kishte prej lëkure. Kur e çuan pranë komandantit pers, ai u tha shokëve:

[123]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/38.

- "Vendosni një mburojë në tokë.", – dhe u ul mbi mburojë. Një burrë i gjatë nga persët i tha:

- "Arabë! Unë e di se për ç'arsye keni ardhur. Ju nuk gjeni dot ushqim, për të mbushur barkun, në tokat tuaja. Ejani, t'ju japim sa ushqim që t'ju duhet. Ne jemi një popull që adhuron zjarrin, e nuk duam t'ju vrasim, sepse, duke ju vrarë ju ne ndotim tokën."

- "Uallahi, ne nuk na kanë shtyrë këto mendime, që të vijmë tek ju. Ne kemi qenë një popull që adhuronte gurët dhe idhujt. Kur gjenim një gur më të bukur se ai që adhuronim asokohe, atëherë e hidhnim poshtë atë dhe merrnim tjetrin. Derisa, më në fund, Allahu na dërgoi neve një profet nga mesi ynë. Ai na ftoi në Islam dhe ne nuk ngurruam që ta ndiqnim në udhëzimin e tij. Ne nuk kemi ardhur kurrsesi për të siguruar ushqim. Detyra që na është ngarkuar është të luftojmë me armiqtë që nuk pranojnë fenë islame. Kemi ardhur që t'i vrasim ata që do të luftojnë me ne dhe t'i marrim peng ata që do të mbeten të gjallë prej tyre. Ndërsa, për sa i përket çështjes së ushqimit, ju betohem se kishte herë që ne nuk gjenim dot ushqim as sa për të mbushur barkun; madje nganjëherë nuk gjenim dot as ujë sa për të shuar etjen. Por, në tokat tuaja kemi gjetur, si ushqim, ashtu edhe ujë me bollëk. Uallahi, ne nuk kemi ndërmend t'i lëmë aq lehtë këto mirësi, ato do të jenë o tuajat, o tonat!"

- "Tha të vërtetën.", – tha Rustemi në gjuhën perse. Pastaj u drejtua nga Mugireja dhe i tha:

- "Nesër do të ta nxjerrim syrin vendit."

Mirëpo, të nesërmen, si pasojë e një shigjete që e goditi në sy, ishte ai vetë që humbi njërin nga sytë dhe jo Mugireja."[124]

Në *El-Bidaje*-n e historianit Sejf shkruhet se është përcjellë se: "Sad bin Ebi Uekasi, para se të luftonte, i dërgoi Kisrës një grup nga shokët e tij. Ata do t'i bënin atij thirrje që të pranonte Islamin. Ata kërkuan leje që t'i çonin te Kisra dhe leja iu dha. Banorët dolën të gjithë në rrugë, për të parë veshjet e grupit të myslimanëve që kishin ardhur. Kur, ajo që panë ishin disa kuaj me njerëz sipër që në trup kishin vetëm një jelek, në duar kamxhikë, në këmbë sandale! U habitën pa

[124]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/510 (5901).

masë. Si do t'ia dilnin këta burra të mundnin ushtrinë e tyre, e cila ishte shumë herë më e madhe në numër dhe mundësitë luftarake i kishte shumë herë më të mëdha?

Kur grupi i myslimanëve mbërriti te mbreti Jezduxherd, mbreti i ftoi ata të uleshin përpara tij. Jezduxherdi ishte një njeri shumë mendjemadh, i paedukatë dhe tejet i ashpër. Filloi t'i pyeste myslimanët se si quheshin jeleku, sandalet dhe kamxhikët që kishin me vete. Dhe çdo përgjigje që merrte syresh i dukej sikur dëgjonte ndonjë ogur të mirë. Mirëpo, Allahu, të gjitha ato që atij po fillonin t'i dukeshin në dobi të vet, ia ktheu në dëmin e vet. Mandej, ai i pyeti ata:

- "Çfarë ju ka prurë ju në këto toka? Çfarë ju shtyu të guxoni, ngatërresat dhe përplasjet që ne kemi mes veti?"

Numan bin Mukarrini i dha këtë përgjigje:

- "Allahu na mëshiroi duke na dërguar një profet. Ai na tregoi të mirën dhe na urdhëroi që të bëjmë veç mirë; na bëri të ditur të keqen dhe na urdhëroi që t'i shmangemi asaj. Na premtonte se nëse do t'i bindeshim atij, atëherë të gjitha të mirat e kësaj bote dhe të amshimit do të ishin tonat. Cilëndo shoqëri a fis që e ftoi në Islam, ata u përçanë me njëri-tjetrin. Islamin e pranonin më të zgjedhurit e fisit. Ai profet qëndroi në këtë gjendje aq sa deshi Allahu, derisa një ditë ai e urdhëroi atë që t'u përgjigjej arabëve e të përballej me ta edhe duke luftuar. Dhe ai kështu veproi. Paskëtaj, arabët zunë vend krah tij në dy mënyra: disa me zor, e disa të tjerë duke hyrë në Islam me dëshirën e vet. Ata që u bënë myslimanë pa dashur, panë se mbetën shumë të kënaqur me zgjedhjen që kishin bërë. Kurse atyre që u bënë myslimanë me dëshirën e vet iu shtua edhe më shumë dëshira e dashuria për të. Ne e kuptuam shumë mirë, se feja që ai na kish sjellë ishte shumë herë më e mirë se sa armiqësitë tona mes veti. Ai na kështilloi, që përhapjes së Islamit t'ia nisnim njëherë nga popujt fqinj, të cilët ishin më afër nesh, e t'i ftonim ata tek ajo që është më e drejta. E ne, andaj kemi ardhur, t'ju ftojmë që të pranoni fenë tonë dhe të bëheni myslimanë. Kjo është feja islame. Një fe që e do atë që është e bukur dhe e urren dhe e mallkon atë që është e shëmtuar. Nëse ju nuk e pranoni atë, ne do të luftojmë me ju, nëse e pranoni fenë tonë dhe bëheni myslimanë,

atëherë ne do t'ju japim juve librin e Allahut, që ju të veproni sipas tij, atëherë ne do të kthehemi andej nga kemi ardhur dhe nuk kemi pse të ngatërrohemi me ju. Nëse do të na e sillni xhizjen, do t'jua pranojmë dhe do t'ju ruajmë, në të kundërt ta dini se ne do të luftojmë me ju."

- "Unë nuk njoh ndonjë popull mbi tokë më barbar se ju, më i tërbuar, që as me njëri-tjetrin nuk shkojnë, e që i kanë të gjitha veset e këqija. Deri më sot jua kemi lënë fshatrat në periferi dhe nuk kemi nxjerrë zë. Persët nuk ju luftonin, por edhe ju nuk ngrinit krye kundër tyre. Të mos ju gënjejë fakti që jeni shtuar në numër dhe tani jeni më shumë. Nëse ishte nevoja për të mbijetuar ajo që ju shtyu të vinit deri këtu, atëherë ne mund t'ju japim ushqime, derisa t'ju mbulojë bollëku, u njohim edhe privilegje të parëve tuaj po të doni, madje mund t'ju veshim të gjithëve me tesha të reja. Veç këtyre, mund t'ju vëmë edhe një mbret të butë mbi krye, që të sillet mirë me ju dhe t'ju prijë me drejtësi."

Grupi i myslimanëve heshti. Mugire bin Shubeja u ngrit në këmbë dhe tha:

- "O sundimtar i Persisë! Këta që sheh ti janë prijësit e arabëve dhe janë të tërë njerëz fisnikë. Fisnikëve u vjen turp nga fisnikët; fisnikët vetëm ata që janë fisnikë mund t'i shpërblejnë dhe vetëm njerëzit e nderuar mund të kujdesen për drejtësinë e njerëzve të nderuar. Ata nuk ta sqaruan plotësisht arsyen pse kanë ardhur deri këtu, duke mos iu përgjigjur të gjitha pyetjeve që ti u drejtove. Dhe mirë bënë! Kjo u ka hije njerëzve si ata. Më kërko mua ç'përgjigje do, të t'i them unë të vërtetat që do të dish dhe le të jenë edhe ata dëshmitarë. Ti na fyeve me disa cilësi, të cilat ti vetë nuk i njeh!

The se ne jemi në gjendje shumë të vështirë, e vërtetë! Vështirë të ketë njerëz në gjendje më të keqe se kjo e jona. Uria jonë nuk i ngjante urisë së askujt tjetër; arrinim deri atje, sa hanim edhe krimba, akrepa dhe gjarpërinj, aq sa u mësuam dhe filluan të na dukeshin ushqime të zakonshme. Banesë të vetme kishim, ngurtësinë e tokës, ndërsa veshjet përpiqeshim t'i sajonim nga leshi i deveve dhe deleve. Fe kishim vrasjen dhe padrejtësinë ndaj njëri-tjetrit. Kishte nga ata, që vetëm se do t'u bëheshin pjesë e do të hanin nga ushqimi i paktë

që kishin, i varrosnin vajzat e lindura për së gjalli. E këtillë ka qenë gjendja jonë. Më vonë, Allahu na dërgoi ne si Profet një njeri të cilin ne e njihnim mjaft mirë. Ne e njihnim mjaft mirë sojin, personalitetin dhe familjen e atij njeriu. Në gjithë tokat tona, soji i tij ishte më i fismi ndër të gjithë ne; shtëpia e tij ishte më e mirë nga të gjithë ne dhe familja e tyre ishte më e privilegjuara ndër të gjitha familjet tona. Edhe para se të bëhej profet, ai kishte një personalitet shumë të fortë, ishte më i drejti dhe më i buti nga të gjithë ne.

Ai na bëri ne thirrje që të mblidheshim rreth një misioni të atillë, që askush përveç shokut dhe mikut të tij më të mirë, Ebu Bekrit, që më vonë u bë edhe kalif i tij, nuk e ndoqi nga pas. Ai thoshte diçka, ne thoshim të kundërtën; ai ulëriti të vërtetën, ne e përgënjeshtruam! Mirëpo, teksa ai shtohej në numër, ne pakësoheshim. Kështu ndodhi ajo që ndodhi mes nesh dhe Zotit tonë të Madhërishëm! Ajo që ai na thoshte dhe na urdhëronte nuk ishte tjetër, pos fjalës së Allahut. Ai na tha neve se Zoti thoshte: 'Zoti jam unë! Jam i Vetëm dhe nuk kam shok, as ortak. Nuk kishte hiçasgjë, kur Unë isha. Unë jam i Pashoq dhe i Patjetërsueshëm, kurse çdo gjë tjetër një ditë do të zhduket! Të gjitha gjallesat unë i krijova. Çdo gjë tek Unë ka për t'u kthyer. E patë se si ju mbështolli mëshira Ime? Ja, po ju dërgoj këtë njeri, që t'ju tregojë rrugën se si do t'ju shpëtoj nga ndëshkimi i ashpër pas vdekjes, që t'ju vendos të jetoni në atdheun e paqes, në parajsë!'

Ndaj, ne jemi dëshmitarë se atë e ka Dërguar Allahu, që është më i Vërteti e më i Drejti i shkallës së Drejtësisë. Allahu i Madhërishëm i mësoi Profetit tonë të na thoshte neve: 'Kushdo që ju bindet juve dhe bën punë për të mirën tuaj, të mirën e ka bërë për vete, e kushdo që ju bën keq, ta dijë se të keqen ia ka bërë vetvetes. Kurse ata që nuk pranojnë, por japin xhizjen, atëherë ruajini ata dhe mbrojini ashtu siç ruani dhe mbroni veten. Ndërsa me ata që nuk pranojnë të paguajnë as xhizjen, luftoni, sepse gjyqtar në mesin tuaj jam Unë. Kushdo që humb jetën prej jush do ta marr në parajsën Time. Ndërsa atyre që do të mbeten gjallë do t'u vij në ndihmë që ta mposhtin armikun.'"

Pasi i përcolli këto mendime, Mugireja i tha atij:

- "Tani, po deshe jep xhizjen si i përbuzur dhe i poshtëruar, po

deshe zgjidh shpatën! Po deshe prano Islamin dhe shpëto shpirtin."

- "Kundër meje i thua ti këto fjalë?"

- "Unë këto fjalë ia them kujtdo që po flet me mua; po të isha duke folur me ndokënd tjetër, nuk kisha pse të t'i thosha ty këto fjalë!"

- "Po të mos ishte kusht që mëkëmbësit dhe lajmëtarët nuk vriten, do t'ju kisha vrarë mu këtu te këmbët e mia. Unë nuk kam asgjë për t'u dhënë njerëzve si ju!", – tha Jezduxherdi dhe sakaq u tha njerëzve të tij:

- "Sillni një thes me baltë dhe ngarkojani në shpinë atij që është më i fismi nga këta, pastaj shoqërojeni dhe ruajeni që ta mbajë në shpinë, derisa të dalin nga territori i Medainit.", – kurse komandantëve myslimanë u tha:

- "Kthehuni te komandanti juaj dhe t'i thoni se bashkë me ju po i dërgoj edhe Rustemin, që t'ju vrasin të gjithëve e bashkë me ushtri t'ju groposin atje, mu në hendekët e Kadisijes, në mënyrë që të gjithë sa jeni të merrni ndëshkimin e merituar. Pastaj, Rustemin do ta dërgoj edhe në shtetin tuaj dhe do t'u bëj njerëzve tuaj tortura shumë herë më të rënda edhe se ato të Kisra Saburit, duke ju bërë kësisoj armiq të njëri-tjetrit!" Pasi tha këto fjalë, pyeti:

- "Kush është më fisniku, më i respektuari nga ju?"

Asnjëri nuk nxori zë. Vetëm Asim bin Amri (radijallahu anhu), për ta mbajtur ai thesin me baltë, tha:

- "Unë jam më i fismi nga të pranishmit, madje unë jam zotëria i tyre, ngarkomani mua thesin."

- "E vërtetë është kjo, ky është më fisniku nga ju?", – pyeti Jezduxherdi.

- "Po.", – iu përgjigjën ata.

Asimi e mori thesin me dhe mbi shpinë dhe kaloi mes shtëpive dhe banorëve të shumtë që e shikonin. Kur u afrua te kafsha e rrugës, e zbriti nga supi dhe e ngarkoi mbi të. U nisën. Asimi ua kaloi shokëve dhe kur kaloi edhe portën e Kudejsit, tha:

- "Çojini komandantit sihariqin e fitores! Me lejen e Zotit, ne do të dalim fitimtarë!"

Vazhduan rrugën dhe thesin e lëshoi në tokat arabe. Pastaj u kthye te kryekomandanti i tyre, Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) dhe i shpjegoi atij të gjitha sa kishin ndodhur, duke i thënë:

- "Ky është një sihariq! Uallahi, Allahu na i dha neve çelësat e tërë pasurisë së tyre!"

Ushtria Islame e interpretoi si një ogur i mirë thesin me dhe që Jezduxherdi i pati ngarkuar Asimit mbi supe, duke e parë si shenjë se ata do të ishin ngadhënjimtarë ndaj persëve."[125]

Amr bin Asi (r.a.) fton njerëzit në Islam gjatë ngadhënjimit të Egjiptit

Halidi dhe Ubadeja (radijallahu anhuma) tregojnë: "Kur Omeri (radijallahu anhu) u kthye në Medinë, Amr bin Asi u nis të shkonte në Egjipt. Pati shkuar deri në portën e Eljunit në Egjipt, kur nga pas, me të shkoi edhe Zubejri. Aty ata i priti Ebu Merjemi, që ishte prijësi i të krishterëve që jetonin në tokat islame. Në krah kishte edhe peshkopin, i cili ishte në krye të ushtrisë që kishte dërguar Mukaukisi, për të mbrojtur territorin e tij. Kur Amr bin Asi (radijallahu anhu) u afrua tek ata, ata mbajtën pozicion lufte. Komandanti i Islamit u dërgoi lajm:

- "Mos u ngutni, për të luftuar me ne. Na lini t'ju shpjegojmë njëherë pse kemi ardhur, pastaj ju mund të na thoni mendimet tuaja.

Kështu, ata i tërhoqën ushtarët. Amri u dërgoi sërish fjalë:

- "Unë po vij drejt jush. Edhe nga ju të më dalin para Ebu Merjemi me Ebu Mirjamin."

E pranuan edhe këtë kërkesë. Pasi i dhanë garanci njëri-tjetrit, Amri u tha atyre të dyve:

- "Ju jeni murgj të këtyre tokave, ndaj më dëgjoni mirë: 'Allahu i Madhërishëm ka dërguar Muhamedin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) me fenë e vërtetë, duke i urdhëruar më të drejtën e të vërtetën. Muhamedi (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), çdo urdhër na e ka transmetuar edhe neve. Pastaj ai, mëshira dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, mërgoi në

[125]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/41; Taberi, *Tarih,* 4/94.

amshim; kryerjen e detyrës së tij na e la neve si detyrë të ndjekjes së traditës dhe të mësimeve të tij. Një prej urdhëresave që ai na ka dërguar është edhe që t'ua mësojmë edhe të tjerëve kauzën tonë. Ndaj edhe kemi ardhur këtu, t'ju ftojmë që të pranoni Islamin dhe kushdo që i përgjigjet thirrjes sonë, duke u bërë mysliman, ta dijë se këtej e tutje ai është një prej nesh, i barabartë me ne. Ai që nuk e pranon, ne i propozojmë që të paguajë xhizjen, e në këmbim ne do t'i mbrojmë ata me tërë forcën që kemi. Profeti ynë na e ka lajmëruar më parë, se ne do të ngadhënjejmë mbi shtetin tuaj, e, duke pasur parasysh se sa afër jemi (Sepse nëna e Ismailit [alejhis'selam], Haxherja, ishte nga Koptët e Egjiptit. I Dërguari i Allahut këtë fakt neve na e ka quajtur gjithmonë si një lidhje farefisnie me ju.), nëse na bindeni, atëherë ne do të jemi shumë herë më pranë njëri-tjetrit, e miqësia jonë do të jetë shumë herë më e fortë. Përveç kësaj, i pari i besimtarëve, Omeri (radijallahu anhu) na ka porositur: "Silluni mirë me koptët, sepse Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na ka këshilluar që të sillemi mirë me ta."

- "Një lidhje kaq të vjetër farefisnore, e përshkallëzuar kaq shumë përgjatë viteve, vetëm Profetët mund ta respektojnë. Po, Haxherja ka qenë një grua fisnike, pasi ajo ishte e bija e sundimtarit tonë; i përkiste familjes së Menfit dhe ata e zotëronin të gjithë pasurinë dhe salltanetin e kohës. Pastaj populli Ajni Shems (Syri i Diellit) i mundi ata, duke i vrarë e duke ua marrë gjithçka kishin, e ata që mbetën gjallë mërguan. Andaj, Haxherja shkoi tek Ibrahimi (alejhis'selam). Po, kjo është e vërteta. Po mirë, o Amr, mirë se keni ardhur atëherë! Na jep pak kohë, të flasim me njëri-tjetrin dhe pastaj t'ju kthejmë përgjigje."

- "Një njeri si unë nuk mashtrohet lehtë, andaj po ju jap tri ditë kohë, që të flisni me njëri-tjetrin dhe me popullin, përndryshe do të luftojmë!"

- "Sikur të na e zgjatni pak më shumë afatin?", – thanë egjiptianët.

Atëherë, Amri u dha edhe një ditë më shumë. Ata kërkuan prapë që t'ua shtonte. Amri (radijallahu anhu) ua shtoi edhe një ditë tjetër. Mandej, ata u kthyen te Mukaukisi. Mukaukisi mendoi se do të ishte më mirë që, njëherë për njëherë, të bënte paqe me ta. Mirëpo komandanti bizantin, që gjendej asokohe pranë Mukaukisit, Ertabuni, për t'u bërë

pengesë, se mos jepnin ndonjë përgjigje pozitive, u tha atyre që të sulmonin dhe t'u shpallnin luftë myslimanëve. Ata dy murgj thanë:

- "Ne do të përpiqemi t'ju mbrojmë me sa forcë të kemi, por nuk do të kthehemi më te myslimanët. Kemi edhe katër ditë kohë. Gjatë kësaj kohe, asgjë e keqe nuk do t'ju ndodhë, ndihuni të sigurt."

Një natë, fare papritur, Amrin dhe Zubejrin (radijallahu anhuma) i sulmuan në vendin e quajtur Ferekab. Mirëpo Amri ishte i përgatitur, e mbërtheu atë bashkë me të tjerët dhe i vrau, bashkë me shokët. Kështu, Amri me Zubejrin (radijallahu anhuma) u zhvendosën në zonën e popullit Ajni Shemsit."[126]

Ebu Harithe dhe Ebu Osmani tregojnë: Në kohën që Amr bin Asi (radijallahu anhu) ishte vendosur në Ajni Shems, fare pranë egjiptianëve, populli i Egjiptit i thoshte sundimtarit të vet:

- "Çfarë ke ndërmend të bësh me një popull që kanë mundur Kisrën dhe Kajserin, duke ua shkatërruar gjithë ato ushtri aq të mëdha? Bëj menjëherë një marrëveshje me ta; mos na vër të gjithëve në rrezik!"

Kjo bisedë u zhvillua në ditën e katërt të pesë ditëve që Amri (radijallahu anhu) u kishte njohur atyre si afat, që të mendoheshin. Sundimtarit nuk i pëlqeu shumë ky mendim i ardhur nga radhët e popullit. Vendosi ta sulmojë ushtrinë e myslimanëve. Përleshja kishte filluar, kur Zubejri (radijallahu anhu) u ngjit në bedenat e qytetit. Kur e pa populli i Egjiptit Zubejrin atje, ngjitur mbi bedena, Amri (radijallahu anhu) hapi portat e qytetit; ata ngarendën për tek ai, që t'i kërkonin paqe. Amr bin Asi ua pranoi kërkesën, derisa aty zbriti Zubejri (radijallahu anhu), sikur të kish zbritur nga qielli, duke i rrethuar të gjithë."[127]

Sahabët, nën komandën e Seleme bin Kajs el-Eshxheij (r.a.), u bëjnë thirrje kundërshtarëve që të bëhen myslimanë

Sulejman bin Burejdeja tregon: "Sa herë që grumbullohej ndonjë ushtri myslimanësh, për t'u dërguar gjëkundi, Omeri (radijallahu anhu), në krye të ushtrisë vendoste si komandant dikë që ishte i

[126]. Taberi, *Tarih,* 4/227.
[127]. Taberi, *Tarih,* 4/288.

ditur dhe që e njihte mirë jurisprudencën. Njëherë, ushtrisë, që ishte grumbulluar përpara tij, në krye i vuri Seleme bin Kajs el-Eshxheij, të cilit i dha këto këshilla:

- "Ec në emër të Allahut dhe lufto në rrugën e Tij me të gjithë ata që e mohojnë Atë. Kur të përballeni me armiqtë idhujtarë, bëjuni atyre thirrje për tri gjëra: Fillimisht, ftojini ata të pranojnë Islamin. Nëse bëhen myslimanë dhe duan të jetojnë në tokat e tyre, thojuni se nga pasuria e tyre do t'u merret zekati dhe nga plaçka e luftës nuk do t'ju jepet gjë, në rast se duan t'ju bashkohen juve dhe të luftojnë krah për krah me ju, atëherë thojuni se duhet të jenë në anë të asaj që jeni edhe ju, e kundër asaj që edhe ju kundërshtoni. Nëse nuk bëhen myslimanë, bëjuni thirrje që të paguajnë xhizjen. Nëse pranojnë, atëherë mbrojini ata nga kundërshtarët e tyre, po mos u kërkoni xhizje më shumë se ç'mund të paguajnë. Nëse nuk pranojnë as që t'ju paguajnë xhizjen, atëherë luftoni me ta. Allahu është ndihmësi juaj më i madh kundër tyre. Nëse ngujohen në ndonjë kështjellë a fortesë dhe ju thonë se do të zbresin së andejmi dhe se janë të kënaqur me urdhrat e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, atëherë mos pranoni, sepse kështu është urdhri i Allahut. Kjo sepse ju nuk mund ta dini se cili është vendimi i Allahut për ju dhe ata. Nëse ju kërkojnë garanci në emër të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, as këtë garanci mos ua jepni. Ju nuk mund të jepni fjalë vetëm se në emrin tuaj. Nëse luftojnë me ju, atëherë mos rrëmbeni prej plaçkës së luftës, sepse kjo është tradhti. Mos torturoni njeri, duke u prerë këmbët, duart, apo ndonjë pjesë tjetër të trupit dhe mos i vrisni fëmijët."

Selemeja (radijallahu anhu) thotë se: "Ecëm. U përballëm me armiqtë tanë idhujtarë. Sipas urdhrit të prijësit të besimtarëve, fillimisht u bëmë atyre thirrje që të bëheshin myslimanë; nuk pranuan. U bëmë thirrje të paguanin xhizjen, nuk u pëlqeu, prandaj nuk pranuan. Paskëtaj luftuam me ta, derisa Allahu na fali fitoren. Luftëtarët e tyre i vramë, ndërsa familjet ua morëm peng, ndërsa mallrat dhe plaçkat e tyre të dëmtuara i mblodhëm të gjitha, pa lejuar që të shkonte dëm asgjë."[128]

[128]. Taberi, *Tarih,* 5/9.

30. MORALI DHE SJELLJET E BUKURA TË SAHABËVE QË BËHESHIN SHKAS PËR NJERËZIT QË TË GJENIN UDHËZIMIN

Çfarë bëri Muadh bin Xhebeli që babai i tij, Amr bin Xhemuhu, të bëhej mysliman

Tregon Ibni Is'haku: "Kur Ensarët lidhën besën me Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në Akabe, dhe erdhën në Medinë, Islami këtu u forcua edhe më shumë. Megjithatë, në mesin e tyre kishte ende mbetje të idhujtarëve. Njëri prej tyre ishte edhe Amr bin Xhemuhu. I biri, Muadhi, ishte nga ata që kishin qenë të pranishëm në Akabe, dhe i kishte shpallur besën e tij Profetit tonë. Amri ishte njëri prej të mëdhenjve të fisit të bijve të Selemes dhe ishte njeri fisnik. Njësoj siç kishin bërë edhe familjet e tjera, ai kishte ndërtuar një idhull prej druri me emrin Menat. Përkujdesej për të çdo ditë, duke e pastruar dhe lyer me aromat më të mira. Muadh bin Xhebeli, i biri i Amr bin Xhemuhut, dhe një grup tjetër të rinjsh nga bijtë e Selemes pranuan Islamin dhe, në darkë, ia morën Amrit atë idhull dhe, kur nuk e gjeti, tha:

- "T'ju vijë turp! Kush e ka sulmuar zotin tonë gjatë natës?" Kërkoi gjithandej, për ta gjetur. Kur e gjeti, e pastroi mirë e mirë dhe po e lyente me aromë të mirë, duke thënë me vete:

- "Të betohem, se po e gjeta atë që ta bëri ty këtë, ka për të parë keq nga duart e mia."

Kur ra nata dhe Amri u shtri të flinte, të rinjtë iu vunë punës, për të bërë të njëjtën gjë. Kur kjo ndodhi u përsërit disa herë dhe Amri e gjeti sërish idhullin dhe po e pastronte, nxori shpatën dhe e vuri afër idhullit, duke thënë:

- "Ja tek është shpata, nëse i duket vetja kaq trim atij që ta bën ty këtë! Po e lë këtu që ta dijë mirë, se çfarë kam për t'i bërë nëse e zë."

Ra sërish nata, Amri u shtri dhe e zuri gjumi. Të rinjtë erdhën prapë, e larguan shpatën nga idhulli, e tërhoqën atë me pe dhe e hodhën në një prej gropave të banjës që përdornin bijtë e Selemes, duke e lidhur

pas një qeni të ngordhur. Në mëngjes, kur u ngrit Amri, dhe sërish nuk e gjeti në vend zotin e tij, iu vu punës, për ta gjetur. Kur e gjeti në atë gropë, bashkë me një qen të ngordhur, me qenin përsipër, shkoi të fliste me të afërmit e tij që ishin bërë myslimanë dhe pranoi Islamin. Madje ai u bë një besimtar shembullor."[129]

Kur bëhet mysliman Ebu'd-Derdaja dhe përpjekjet e Ibnu Reuahas që ai të pranonte fenë islame

Tek Uakidiu transmetohet se: "Ebu'd-Derdaja (radijallahu anhu) ishte pjesëtari i fundit i familjes së tij që u bë mysliman. Ishte ende i lidhur pas idhullit të tij. Madje, edhe fytyrën ia pati mbuluar me një shami të bardhë. Abdullah bin Reuaha e ftonte të pranonte fenë islame, mirëpo ai nuk pranonte që nuk pranonte, por vetëm kundërshtonte. Ibni Reuaha dhe Ebu'd-Derdaja ishin bërë vëllezër të njëri-tjetrit, shumë kohë para se ai të bëhej mysliman. Një ditë, Ibnu Reuaha po vinte për tek Ebu'd-Derdaja, mirëpo ai kishte dalë nga shtëpia dhe po shkonte diku tjetër. Hyri menjëherë në shtëpinë e tij, dhe e shoqja ishte duke krehur flokët.

- "Ku është Ebu'd-Derdaja?", – e pyeti ai.

- "Nuk ka shumë që doli.", – iu përgjigj ajo.

Ibnu Reuaha me një sqepar në dorë, shkoi te vendi ku rrinte idhulli dhe duke mërmëritur me vete emrat e djallit duke përsëritur këshillën "bëni kujdes, çdo gjë tjetër, që quhet zot, veç Allahut, është e rreme". Dhe, sakaq, një të goditur i bën dhe idhulli thyhet, duke u bërë copë-copë. E zonja e shtëpisë, dëgjoi zhurmën e sqeparit dhe erdhi menjëherë, duke bërtitur:

- "Më more në qafë, o Ibnu Reuaha!" Mirëpo, Ibnu Reuaha u largua pa thënë asnjë fjalë. Kur u kthye në shtëpi Ebu'd-Derdaja, të shoqen e gjeti duke qarë.

- "Ç'ke kështu? Çfarë ka ndodhur?", – e pyeti ai.

- "Erdhi vëllai yt, Ibnu Reuaha, dhe shih se ç'ka bërë."

---

[129]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/166.

Ebu'd-Derdaja u mërzit shumë, pastaj u mendua me vete, duke thënë:

- "Sikur të vinte ndonjë e mirë nga ky idhull, më e pakta ai do të kishte ruajtur veten e vet, e nuk do të ishte thyer kështu."

Më pas, Ebu'd-Derdaja, së bashku me Ibn Reuahan, shkoi te Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe pranoi Islamin.[130]

Letra që i dërgon Omeri (r.a.) Amr bin Asit për çështjen e xhizjes dhe të pengjeve të luftës

Zijad bin Xhez' ez-Zubejdi tregon: "Në kohën e kalifatit të Omerit (radijallahu anhu), pasi ishte ngadhënjyer mbi Aleksandrinë, ne u vendosëm në Belhib dhe po prisnim që të na vinte një letër prej Omerit (radijallahu anhu). Sakaq, letra mbërriti. Atë na e lexoi Amr bin Asi. Ja se çfarë shkruhej në të:

"E mora letrën tënde. Më shkruaje se u kishe propozuar atyre që të paguanin xhizjen, në mënyrë që ti t'i lije të lirë, sundimtarin e Aleksandrisë dhe pengjet e tjera. Unë ju betohem, se xhizja, që është një e ardhur më e vogël, por e vazhdueshme, ka për të qenë për myslimanët tani, por edhe për ata që do të vijnë më vonë, shumë herë më e mirë se pasuria dhe plaçka e siguruar nga vendosja e paqes me kusht, e cila mund të jetë më e madhe, por shpërndahet dhe shpenzohet shpejt, sepse nuk është e vazhdueshme. Prandaj, ju urdhëroj që t'i lini të lirë ata robër që keni zënë peng, që të zgjedhin mes fesë së tyre dhe fesë islame, ndërsa sundimtarit të Aleksandrisë t'i propozoni që ta lironi me kusht që ai të paguajë xhizjen. Robërve që do të zgjedhin fenë islame, bëjuni të ditur se, këtej e tutje, ata do të konsiderohen si të barabartë me të gjithë myslimanët. Ç'është e mirë a e keqe për myslimanët, do të jetë e mirë a e keqe edhe për ta. Kurse atyre që do të anojnë e do të zgjedhin fenë e të parëve të tyre, t'u ngarkohet përgjegjësia e pagimit të xhizjes. Ato pengje që u larguan, ca në Mekë, ca në Medinë, e ca në Jemen, tanimë ju nuk mund t'i ktheni dot pas. Andaj, ne nuk duam të bëjmë paqe, apo të merremi vesh, për një çështje nga e cila nuk ka kthim."

[130]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/380(5449).

Amri (radijallahu anhu), për t'i treguar atij përmbajtjen e letrës që kishte shkruar i prijësi i besimtarëve, dërgoi një lajmës te sundimtari i Aleksandrisë. Ai iu përgjigj se pranonte.

Ai që e transmeton këtë ngjarje thotë se:

- "Sipas marrëveshjes së arritur, ne i mblodhëm të gjitha pengjet që kishim kapur. Pjesë u bënë edhe të krishterët. Ata filluan të sillnin pengjet një e nga një, e ne i linim të lirë të zgjidhnin mes Islamit dhe Krishterimit. Kur ndonjëri syresh zgjidhte Islamin, këndonim tekbirë më të fortë edhe sesa ato që patëm kënduar kur ngadhënjyem mbi Aleksandrinë dhe, sakaq, e përqafonim të gjithë me radhë. Kur një tjetër zgjidhte Krishterimin, atëherë brohoritjet e gëzimit vinin prej të krishterëve, të cilët e mirëprisnin atë njeri edhe njëherë mes veti. Ndërkohë ne u shkruanim atyre xhizjen që duhet të paguanin. Njëherazi, mërziteshim jashtë mase, sikur të na kishte ikur dikush prej nesh, për t'u bërë i krishterë. Dhe kështu vijoi, deri në fund, kur përfunduan të gjithë.

Mes pengjeve që u sollën aty ishte edhe një njeri, të cilin e quanin Ebu Merjem Abdullah bin Abdur'rahman. Ai ishte dijetari i fisit të bijve të Zubejdit. E ndalëm dhe i kërkuam që të zgjidhte mes Islamit dhe Krishterimit. Ai burrë zgjodhi Islamin, megjithëse të gjithë të afërmit i kishte të krishterë, babanë, nënën dhe motrën. Dhe ne e morëm në anën tonë. Babai, nëna dhe motra e tij u përpoqën shumë që ta tërhiqnin, e të mos e linin që të vinte në anën tonë, aq sa, duke e tërhequr, i grisën rrobën që kishte veshur. Dhe, siç e shikoni, ai është sot njëri prej dijetarëve tanë..."[131]

Historia e mburojës e Aliut (r.a.) me një të krishterë dhe pranimi i Islamit nga ana e tij

Sipas një transmetimi të Hakimit nga Sha'biu, në ndodhinë e Xhemelit pati humbur mburoja e Aliut (radijallahu anhu). Dikush e kishte gjetur atë mburojë dhe e kishte shitur. Mburojën pamë që e mbante me vete një i krishterë. Kur e mori vesh, Aliu (radijallahu

[131]. Taberi, *Tarih,* 4/227.

anhu) e hodhi në gjyq te Shurejhu atë njeri. Për dëshmitar kishte djalin e tij, Hasanin, dhe skllavin e tij të liruar tanimë, Kanberin. Shurejhu tha:

- "Më nxirr edhe një dëshmitar tjetër përveç Hasanit."

- "Pse, nuk e pranon dëshminë që do të japë Hasani?", – e pyeti ai.

- "Unë prej teje e kam mësuar, – tha kadiu Shurejh, –që dëshmia e djalit në dobi të babait nuk është e pranuar."

Ndërsa, në një transmetim tjetër të Hakimit, vërehen edhe disa hollësi të tjera: Shurejhu iu drejtua Aliut (radijallahu anhu), duke i thënë:

- "Mund të pranojmë dëshminë e skllavit tënd të liruar. Por dëshminë e djalit tënd pro teje nuk mund ta pranojmë."

- "Të vraftë Zoti! Nuk e ke dëgjuar Omerin (radijallahu anhu) kur ka thënë: "E kam dëgjuar Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kur ka thënë: '*Hasani me Hysenin janë prijësit e gjithë të rinjve mes banorëve të Xhenetit.*?"

Pastaj Shurejhu mori vendim dhe i tha të krishterit:

- "Merre mburojën, është e jotja."

Ai i krishterë tha kështu: "Bashkë me Prijësin e Besimtarëve erdhëm para kadiut të myslimanëve. Kadiu vendosi kundër tij, e ai e pranoi me qetësi vendimin. O Prijësi i mbarë Besimtarëve, uallahi ti the të vërtetën, kjo është mburoja jote. Të pati rënë nga deveja dhe unë e pata marrë. Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet; Muhamedi është i Dërguari i Tij."

Kur ai njeri pranoi Islamin dhe u bë mysliman, tregojnë se Aliu (radijallahu anhu), jo vetëm që ia dhuroi atij atë mburojë, por i dha edhe një shpërblim prej shtatëqind dërhemësh. Në fund ai pati rënë dëshmor në Betejën e Siffinit."[132]

[132]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/44 (17795).

LIDHJA E BESËS

Si e lidhnin sahabët besën me Profetin tonë dhe me kalifët e tij? Cilat ishin bazat e lidhjes së besës?

1. LIDHJA E BESËS PËR T'U BËRË MYSLIMAN

Ka qenë Xheriri (radijallahu anhu) që ka transmetuar një hadith në lidhje me këtë çështje: "Ne lidhëm besën me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mbi ato baza që ai kishte lidhur besën edhe me gratë.[1] Kësisoj, që ai u premtonte parajsën të gjithë atyre që kishin vdekur pa kryer asnjë nga këto mëkate. Çdokush që ka bërë ndonjë mëkat të madh, por që e ka kryer dënimin relativ të kësaj bote, e pastaj ka vdekur, atëherë ky dënim mund t'i shërbejë atij si falje për ndëshkimin. Ashtu sikundër edhe ata që kanë kryer ndonjë nga mëkatet e mëdha,

[1]. Ndoshta këtu qëllimi duhet të ketë qenë ky ajet: "**O Profet, nëse vijnë tek ti besimtaret e të betohen se nuk do t'i shoqërojnë Allahut asgjë** (në adhurim)**, nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t'i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të sjellin ndonjë shpifje të sajuar nga ato vetë dhe se nuk do të të kundërshtojnë në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje betimin e tyre dhe lutju Allahut t'i falë. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**" (Mumtehine, 60/12)

por e kanë mbajtur atë të fshehtë, llogaridhënien për të do ta kenë vetëm përpara Allahut."[2]

Betimi i të gjithëve përpara Allahut dhe të Dërguarit të Tij në ditën e ngadhënjimit mbi Mekën

Esuedi (radijallahu anhu) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), atë ditë që u ngadhënjye mbi Mekën, ishte vendosur në kodrën e Safasë dhe po pranonte betimet e atyre që donin të bëheshin myslimanë dhe që po thoshin fjalën e dëshmisë. Unë e pyeta të Dërguarin e Allahut, se çfarë do të thoshte të lidhje besën për dëshminë e së vërtetës? Ai m'u përgjigj duke më thënë:

- "*Kjo do të thotë të pranosh se i ke besuar Allahut, se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, që meriton të adhurohet, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Allahut.*"

Ndërsa përcjellja që i bën Bejhakiu kësaj ngjarjeje, është e këtillë: "Ditën e ngadhënjimit, të mëdhenj e të vegjël, gra e burra, të gjithë erdhën tek i Dërguari i Allahut dhe ai ua pranoi atyre betimet mbi fjalën e dëshmisë dhe pranimin e fesë së Islamit."[3]

2. LIDHJA E BESËS PËR PRAKTIKAT E ISLAMIT

Betimi i Beshir bin Hasasijes

Beshiri ka thënë kështu: "Erdha te Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), që të lidhja besën me të dhe e pyeta:

- "Cilat janë pikat, mbi të cilat do që unë të lidh besën me ty, o i Dërguari i Allahut?"

I Dërguari i Allahut zgjati dorën dhe më tha:

- "*Do të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe i Vetëm, që meriton të adhurohet, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, do t'i falësh në kohë të pesë namazet e ditës, do të japësh zekatin, që të është caktuar si detyrim, do të agjërosh gjatë muajit të Ramazanit, do të vizitosh* (do

[2]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/40 (9856).
[3]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/318.

të kryesh haxhin) *Shtëpinë e Allahut dhe do të luftosh në rrugën e Allahut.*"

Unë i thashë:

- "O Resulallah, përveç dy prej tyre, të gjitha të tjerat unë kam mundësi që t'i kryej. Por dy prej tyre nuk mund t'i bëj dot, e kam të pamundur: njëri është zekati. Unë gjithsej dhjetë deve kam. Dhe ato me zor mjaftojnë për t'u siguruar pjesëtarëve të familjes qumësht dhe nevojat e udhëtimit. Ndërsa tjetra, që mendoj se nuk kam mundësi që ta kryej, është lufta. Unë jam një njeri shumë frikacak. Mirëpo, populli thotë se njerëzit që ngurrojnë të shkojnë në luftë, do të përballen me ndëshkimin e Allahut. Jam i shqetësuar, se kur të vijë thirrja për në luftë, mua mund të më pushtojë frika e mund të iki nga fusha e luftës. Kësisoj, nëse arratisem nga lufta, atëherë unë do të ndëshkohem prej Allahut."

Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i shtrëngoi dorën, pastaj i hapi duart dhe tha këto fjalë:

- "*Beshir! Ti po më thua se nuk mund të japësh zekatin dhe nuk mund të luftosh dot. Atëherë, a mund të më thuash me çfarë ke ndërmend të hysh në parajsë?*"

- "O Resulallah, zgjatma dorën të të betohem.", – i thashë unë.

I Dërguari i Allahut e zgjati dorën dhe unë lidha besën me të, se do t'i kryeja të gjitha detyrat që ai më pati parashtruar."[4]

Xherir bin Abdullahu jep besën për shtyllat e Islamit

Xheriri (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Unë i betohem Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), se do të fal namazin, do të jap zekatin dhe se do të përpiqem gjithmonë që t'i këshilloj veçse për mirë besimtarët e tjerë."

Ndërsa imam Ahmed bin Hanbeli, në një transmetim të ndryshëm nga ai i Xheririt (radijallahu anhu), thotë se Xheriri (radijallahu anhu) ka folur kështu: "O Resulullah, ti më thuaj për çfarë të të betohem, sepse ti mua më njeh më mirë seç e njoh unë veten."

I Dërguari i Allahut i tha: "*Betimin tënd do ta pranoj vetëm nëse më*

[4]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/281 (36865).

premton se do të adhurosh vetëm Allahun, që është Një dhe i Vetëm, nuk do t'i bësh asnjë shok a ortak Atij, do të falësh namazin, do të japësh zekatin dhe do t'i këshillosh besimtarët për mirë, si edhe do t'i qëndrosh larg çdo lloj forme të idhujtarisë."

Ndërsa në transmetimin e Taberaniut përshkruhet kështu: "Kur Xheriri (radijallahu anhu) erdhi te Profeti ynë, Resulullahu i tha atij:

- "*O Xherir, zgjatma dorën.*"

- "Për çfarë do që të të betohem o i Dërguari i Allahut?", – e pyeti Xheriri.

- "*Do të betohesh me mua me kushtin që do t'i dorëzohesh Allahut me gjithë qenien tënde dhe se do t'i këshillosh gjithmonë besimtarët për mirë.*"

Xheriri, i cili ishte një njeri shumë i zgjuar dhe i shkathët, i tha:

- "O Resulallah, unë do ta bëj këtë me sa të kem forcë."

Kjo fjalë që tha Xheriri, u shndërrua në një formulë besnikërie edhe për njerëzit që erdhën më vonë.[5]

Auf bin Maliku dhe shokët e tij betohen se do t'u përshtaten kushteve të Islamit dhe se nuk do të kërkojnë asgjë nga njerëzit

Auf bin Malik El-Eshxhai (radijallahu anhu) tregon: "Ne ishim nëntë ose tetë ose shtatë vetë, që gjendeshim pranë Resulullahut. Ai na tha neve:

- "*Po ju, nuk do ta lidhni besën me të Dërguarin e Allahut?*", - dhe këtë pyetje e përsëriti plot tri herë.

Dhe ne i zgjatëm duart, e ai na i pranoi betimet tona. Ne i thamë:

- "O Resulullah, ne t'u betuam; po për çfarë e mbi ç'baza t'u betuam?"

- "*Që do të adhuroni Allahun, nuk do t'i bëni Atij asnjë ortak a shok, do të falni pesë kohët e namazit,* – e duke vazhduar, shtoi edhe këtë fjali me zë të ulët, – ... *dhe nuk do të kërkoni asgjë nga njerëzit!*"

Transmetuesi thotë: "Unë i pashë disa nga ata që ishin pjesë e

[5]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/529 (2365).

këtij grupi: 'U binte shkopi nga dora dhe nuk i thoshin askujt ma jep pak atë shkop!' Zbrisnin nga kafsha ku kishin hipur dhe e merrnin vetë."[6]

Sehl bin Sadi dhe të tjerët lidhin besën me të Dërguarin e Allahut, se do t'u binden të gjithë urdhrave të fesë islame

Sehl bin Sadi (radijallahu anhu) tregon: "Unë, Ebu Dherri, Ubade bin Samiti, Ebu Saidi Hudriu, Muhamed bin Meslemeja dhe një njeri tjetër i gjashtë, iu betuam Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) se nuk do të ankoheshim për gjykimin e askujt që do të na gjykonte. Vetëm se i gjashti, kërkoi të prishej betimi që kishte bërë. Dhe Profeti ynë e prishi marrëveshjen e tij me të."[7]

Edhe Ubade bin Samiti (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Një nga ata gjashtë vetët që lidhën besën me Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) isha edhe unë. Iu betuam Allahut se nuk do t'i bënim Zotit asnjë shok a ortak, nuk do t'i merrnim jetën askujt, pasi Allahu na e kishte ndaluar, nuk do të sulmonim e grabisnim askënd, nuk do të vidhnim, nuk do t'i afroheshim zinasë (imoralitetit) dhe nuk do të ngrinim krye ndaj Allahut. Gjatë betimit, na u premtua parajsa nëse do t'i ndiqnim të gjitha këto kushte me përpikëri dhe, nëse shkelnim ndonjërin syresh, atëherë vendimi përfundimtar për ne do t'i përkiste vetëm Zotit."[8]

Siç e përcjell Ibni Xheriri nga Ubade bin Samiti, Ubadeja ka thënë kështu: "Një ditë ishim te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai na tha: '*Lidhni besën me mua se nuk do t'i bëni Allahut asnjë shok ose ortak dhe se nuk do të bini në zina. Shpërblimin atij që do të mbajë fjalën, do t'ia japë vetë Allahu. E kushdo që përzihet në ndonjë prej këtyre ligësive, e Allahu do t'jua fshehë, Ai do t'jua kërkojë vetë llogarinë e Tij: nëse dëshiron ju ndëshkon, nëse dëshiron ju fal.*'"[9]

---

6. Muslim, *Sahih,* 2/721 (1043).
7. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/530 (1516).
8. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/531 (1519).
9. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/531 (1521).

Betimet e Ubade bin Samitit (r.a.) dhe të shokëve të tij në Akabenë e Parë

Ubade bin Samiti ka thënë kështu: "Në Akabenë e Parë ne ishim njëmbëdhjetë vetë gjithsej. Ne e lidhëm besën me Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ashtu siç ishin betuar edhe gratë me të. Kjo ishte një lidhje bese që u realizua kohë para se lufta të shpallej detyrim (farz). Ne iu betuam të Dërguarit të Allahut mbi këto pika: "Nuk do t'i bëjmë asnjë shok a ortak Allahut, nuk do të vjedhim, nuk do të bëjmë zina, nuk do të shpifim për njerëzit e ndershëm, nuk do t'i vrasim fëmijët dhe nuk do të ngremë krye ndaj teje për asnjë të mirë."

Më vonë i Dërguari i Allahut na tha kështu: "*Për ata që do t'i qëndrojnë besnikë premtimit të tyre është parajsa. Kurse për ata që bëjnë ndonjë prej tyre, vendimin e ka në dorë Allahu: nëse dëshiron ju ndëshkon, nëse dëshiron ju fal!*"[10]

3. LIDHJA E BESËS PËR MËRGIM PAS NGADHËNJIMIT MBI MEKËN

Betimi i Ja'la bin Munies në vend të babait

Ja'la bin Munieja (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Në ditën e dytë pas ngadhënjimit mbi Mekën, shkova te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i thashë: "O Resulullah, pranoje betimin e babait tim për të mërguar."

- "*Jo,*", – m'u përgjigj i Dërguari i Allahut, – "*betimin e tij do ta pranoj vetëm për të luftuar, sepse, me ngadhënjimin mbi Mekën ka përfunduar edhe mërgimi, e, këtej e tutje, ai nuk është më i detyrueshëm.*"[11]

Besëlidhja e Muxhashiut dhe e vëllezërve të tij

Muxhashi bin Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë: "Shkova te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) bashkë me vëllanë dhe i thamë:

---

[10]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/150.
[11]. Bejheki, *Sunen,* 9/16 (17547).

- "O Resulullah, të lutemi pranoje betimin tonë për mërgim!" I Dërguari i Allahut u përgjigj:

- "*Po koha e mërgimit ka kaluar.*"

- "Atëherë, për çfarë do që të të betohemi?", – e pyetëm ne.

- "*Që do të jeni myslimanë dhe do të përpiqeni përherë që të fitoni kënaqësinë e pëlqimin e Allahut.*", – na këshilloi ai.[12]

4. LIDHJA E BESËS SE DO TA MBËSHTESNIN PROFETIN E ALLAHUT NË MISIONIN E TIJ TË PROFETËSISË

Shtatëdhjetë ensarë betohen në Akabe se do ta ndihmojnë Profetin e Allahut

Xhabiri (radijallahu anhu) ka thënë: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) qëndroi në Mekë për plot dhjetë vite. Shkonte të takohej me njerëz sa herë që ngriheshin panairet e Ukadhit dhe të Mexhenes, në stinën e haxhit; u shkonte nëpër çadra dhe u thoshte:

- "*Kush do të më mbështetë, kush do të më ruajë, kush do të më ndihmojë mua, kur të përhap mesazhet e Zotit? Për ata që do të më ndihmojnë është premtuar një parajsë ku ata do të mund të jetojnë përjetësisht!*" Mirëpo nuk po gjente dot as edhe një fytyrë të vetme, që t'i buzëqeshte sadopak dhe t'i thoshte se do t'i bëhej krah. Madje edhe kur doli ndokush prej atyre që kishin ardhur nga Jemeni, apo nga fisi i Mudarit, populli i vet dhe të afërmit vinin dhe i thoshin:

- "Qëndroi larg këtij djali nga kurejshët, e mos u gënje prej tij!"

Kur i Dërguari i Allahut shëtiste nëpër çadra, të gjithë njerëzit e tregonin atë me gisht. Derisa, më në fund, Allahu i Madh na mundësoi neve që të shkonim tek ai. E morëm ne në mbrojtje dhe i pranuam të gjitha të vërtetat që ai na i kishte sjellë prej Allahut. Sa herë që ndonjëri prej nesh besonte, duke u bërë mysliman, Profeti ynë i këndonte atij pjesë nga Kur'ani. Kur ai kthehej te familja e tij, Islamin e pranonte edhe familja dhe bëheshin sakaq të gjithë myslimanë. Kështu, në

[12]. Buhari, *Sahih,* 3/1086 (2802).

territorin e ensarëve nuk mbeti më as edhe një njeri i vetëm pa u bërë mysliman, pasi në çdo shtëpi kishte të paktën disa vetë që u mësonin të tjerëve Islamin. Derisa, njëherë, medinasit u mblodhën të këshilloheshin me njëri-tjetrin:

- "Edhe për sa kohë do ta lëmë të vetëm të Dërguarin e Allahut? Edhe për sa kohë do të bëjmë sikur nuk po ndodh asgjë e gabuar dhe ai të shëtisë nga njëri mal në tjetrin nëpër Mekë, duke e përzënë sa këtu, sa atje, dhe duke shkuar një jetë tejet të frikshme?"

Kur erdhi stina e haxhit, shtatëdhjetë vetë prej nesh shkuam tek ai. E lamë se do të takoheshim në Akabe. Filluam të mblidheshim atje nga dy e nga tre. Kur u mblodhën të gjithë, e pyetëm:

- "O Resulullah, për çfarë do që të të betohemi, e të lidhim besën me ty?"

- "*Që do të më dëgjoni gjithmonë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, do të më bindeni, do t'i ndani edhe me të tjerët ato që keni, kur të keni, ashtu edhe kur të jeni ngushtë, do të urdhëroni për mirë dhe do t'i ndaloni të tjerët nga e keqja, do të thoni veç të drejtën dhe të vërtetën në emër të Allahut, për hir të Allahut nuk do të ankoheni për gjykimin e askujt që do t'ju gjykojë, që do të më ruani e mbroni edhe mua, ashtu siç mbroni gratë, fëmijët dhe familjet tuaja dhe do të më mbështetni deri në fund. Në këmbim të këtyre, unë ju premtoj parajsën.*"

Ne shkuam menjëherë pranë tij. Ai që ishte më i riu nga të gjithë ne, Es'ad bin Zurareja preku dorën e të Dërguarit të Allahut dhe tha: "Shikoni, o banorë të Medinës! Mos u ngutni! Ne erdhëm këtu, ende pa marrë mirë frymë nga rruga, pa u ndalur askund, sepse ne besojmë që ai është i Dërguari i Allahut. Të pranojmë se do ta nxjerrim atë sot nga Meka, për ta çuar në Medinë, do të thotë t'u shpallim luftë të gjithë arabëve. Kështu, luftëtarët tanë më të mirë mund të vriten, e disa nga ne mund të mbeten të plagosur e të gjymtuar. Dilini atij në mbrojtje vetëm nëse i merrni parasysh të gjitha këto dhe do të duroni, e shpërblimin nuk ka dyshim që ka për t'jua dhënë Allahu. Nëse ka ndonjë që ka frikë për jetën e vet, të mendohet mirë dhe t'i thotë atij të vërtetën, sepse ai mund ta shpjegojë më mirë se ju justifikimin e gjendjes suaj përpara Allahut!"

Ata që ishin të pranishëm iu përgjigjën: "O Esad, largohu që aty!

Uallahi ne nuk heqim dorë nga kjo besëlidhje, e nuk do të lejojmë askënd që të na e rrëmbejë këtë zog të fatit që na ka ardhur vetë në duar!"

Me të mbaruar kjo bisedë, ne u çuam dhe iu betuam Profetit të profetëve. Ai mori garanci prej nesh dhe na shprehu disa prej kushteve që ai kishte dhe, në fund, na premtoi parajsën e amshuar, nëse ne do ta mbanim fjalën e dhënë.[13]

Transmetimi i Ibni Is'hakut lidhur me një çështje

Kab bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: "U mblodhëm në Akabe dhe po prisnim të vinte Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai erdhi bashkë me xhaxhanë e tij, Abasin. Abasi nuk ishte bërë ende mysliman. Megjithatë, ishte treguar i gatshëm, që, të paktën t'i bëhej mbështetje shpirtërore nipit të tij në ato ditë të vështira. Kur u ul i Dërguari i Allahut fjalën i pari e mori xhaxhai, Abas bin Abdulmuttalibi, e tha:

- "O popull i Hazrexhit! Siç e dini, Muhamedi është i yni. Deri më sot ne e kemi ruajtur atë nga të gjithë ata që janë në një mendje me ne. Ai është shumë i çmuar për popullin e tij dhe njerëzit e respektojnë jashtë mase. Mirëpo, ç'e do se ai do që të vijë në tokat tuaja dhe të bashkohet me ju. Nëse jeni të sigurt se ju mund ta mbështetni atë në atë ku ai ju ka ftuar dhe do ta ruani kundër armiqve, atëherë unë do ta lë atë në përgjegjësinë tuaj. Por, nëse pasi të ketë ardhur tek ju, ju e dorëzoni atë tek armiqtë e tij, duke e lënë pa mbështetje materiale dhe shpirtërore, ju them se do të ishte më mirë që të hiqnit dorë që sot, sepse ai zaten është i fuqishëm edhe mes njerëzve të tij dhe të gjithë e respektojnë dhe kujdesen për të."

- "O Abas, ne i dëgjuam fjalët e tua. Fol ti, o Resulullah; na kërko ç'të duash për vete dhe në emër të Zotit, sepse ne jemi të gatshëm për çdo gjë!"

I Dërguari i Allahut foli. Na këndoi disa ajete nga Kur'ani. Na ftoi në rrugën e Allahut dhe duke na treguar bukuritë e Islamit, u përpoq të na nxisë:

[13]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 3/322 (14496).

- "*Unë dua që të lidhim besën se ju do të më ruani e do të më mbroni edhe mua ashtu siç ruani dhe mbroni gratë dhe fëmijët tuaj.*" Një t'u thënë këto fjalë, ishte i pari Bera bin Ma'ruri që kapi dorën e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe tha:

- "Po! Unë i betohem Allahut, që të ka dërguar ty me fenë e vërtetë, që ne do të të mbrojmë edhe ty nga rreziqet, njësoj siç ruajmë edhe veten. Të lutemi, pranojeni betimin tonë, o Resulullah! Ne të betohemi për Zotin, o Resulullah, sepse ne jemi fëmijët e luftës që na ka mbetur trashëgim prej të parëve tanë."

Betimi i Ebu'l-Hejthemit dhe ato që u tha shokëve të tij

Urueja (radijallahu anhu) ka transmetuar: "I pari që lidhi besën me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte Ebu'l-Hejthemi bin et-Tejihani. Gjatë betimit ai tha:

- "O Resulullah, ne kemi marrëdhënie dhe marrëveshje me shumë njerëz të tjerë. Ma merr mendja se kur të të ndjekim këtu, ato marrëdhënie do të prishen. Po nëse ti kthehesh te njerëzit e tu dhe ne do t'i kemi shkëputur marrëdhëniet me të tjerët, çfarë do të ndodhë nëse ata vendosin prapë të na luftojnë?"

Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) buzëqeshi me fjalët e Ebu'l-Hejthemit, duke thënë:

- "*Gjaku im është bashkuar me gjakun tuaj, e edhe vdekja ime ka për të qenë e lidhur me vdekjen tuaj!*"

Ebu'l-Hejthemi mbeti shumë i kënaqur nga përgjigjja që i dha i Dërguari i Allahut, ndaj u kthye nga shokët e tij dhe u tha:

- "O bashkësi! Ky është vërtet i Dërguari i Allahut! Unë dëshmoj se ai është Besnik dhe meriton veç besnikëri, e nuk ka asfare dyshim që ai është duke na thënë të vërtetën. Sot, ai është nën mbrojtjen e Allahut, ka garancinë e Tij, në mes të njerëzve dhe të afërmve të tij. Ta dini mirë, se nëse ju e pranoni atë me dëshirë, atëherë arabët mund të bashkohen dhe t'ju mbulojnë me shigjeta. Nëse ju e merrni parasysh këtë rrezik me vullnetin tuaj, duke e sakrifikuar gjithë ç'keni, të afërm a pasuri, atëherë ftojeni atë në qytezën tuaj dhe pranojeni në mesin tuaj. E vërteta është se ai është i Dërguari i Allahut. Nëse druheni se

mos poshtëroheni dhe njerëzit fillojnë t'ju përbuzin, atëherë është më mirë që të hiqni dorë që tani!"

Mirëpo, ata dhanë një përgjigje të këtillë:

- "Ne e kemi pranuar që në fillim, pa kushte, çdo detyrë që mund të na ngarkojë Allahu dhe i Dërguari i Tij. O Resulullah, ne të japim fjalën se ne do ta braktisim pa na u dridhur qerpiku çdo gjë tonën për hir të gjërave që do të na kërkosh ti! Tërhiqu, o Ebu'l-Hejthem, të lidhim besën me të Dërguarin e Allahut!"

Ebu'l-Hejthemi tregon se: "Në fillim u betova unë. Pastaj, të gjithë të tjerët me radhë, lidhën besën me të Dërguarin e Allahut."[14]

Fjalët që tha Abas bin Ubadeja kur lidhi besën me të Dërguarin e Allahut

Transmeton Ibni Is'haku: "Kur ensarët u mblodhën për të lidhur besën me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) Abas bin Ubade bin Nadle, nga radhët e bijve të Salimit, tha kështu:

- "O popull i Hazrexhit! A dini gjë ju se për çfarë do ta lidhim besën me këtë njeri?"

- "Po!", – u përgjigjën ata.

- "Ju do të lidhni besën me të, se do të luftoni me të gjithë njerëzit, me ngjyrë, apo lëkurëkuq. Unë po ju pyes: Nëse shikoni se në fund të luftës po jua marrin të gjithë plaçkën, që po ju vrasin më të fismit tuaj, a do ta dorëzonit ju atë tek armiku? Nëse do t'ju shkojë në mendje diçka e këtillë, e ta poshtëroni veten, si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën, atëherë është më mirë që të hiqni dorë që tani. Përndryshe, nëse do të pranonit që të qëndronit në anën e tij edhe sikur të humbnit deri edhe gjithë plaçkën, apo t'jua vrisnin të gjithë më të fismit tuaj, atëherë më e mira për ju është që t'i dilni zot që sot. Uallahi, përkrahja dhe mbështetja e tij sot është puna më e mbarë që mund të bëhet në emër të kësaj bote dhe në emër të amshimit."

- "Ne do t'ia hapim krahët atij dhe do t'i bëhemi krah e do ta mbrojmë me çdo kusht, edhe sikur ta humbim gjithë ç'kemi, dhe të

[14]. Hejthemi, *Mexhmeu'ẕ-Zeuaid,* 6/56 (9885).

na vriten të gjithë njerëzit që duam më së shumti!", – thanë ata dhe iu drejtuan të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulullah, po nëse ne e mbajmë fjalën, cili është premtimi i Zotit për ne?"

- "*Xheneti!*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "Atëherë, zgjateni dorën, o i Dërguari i Allahut!"

I Dërguari i Allahut zgjati dorën dhe ata lidhën besën me të."[15]

Në një tjetër transmetim të Ibni Is'hakut gjendet edhe një tjetër e dhënë shtesë: "Në përmbyllje të lidhjes së besës, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha atyre:

- "*Hajdeni, tani shkoni pranë kuajve dhe deveve tuaja!*"

Abas bin Ubadeja i deklaroi:

- "O i Dërguari i Allahut! Unë të betohem për Allahun që të dërgoi ty me fenë e vërtetë, se po të na thuash ti, ne mund t'i mprehim shpatat dhe që nesër na ke mbi popullin e Minasë!"

- "*Jo! Ne nuk na është urdhëruar të sillemi kështu, kështu që kthehuni tani te kafshët tuaja të rrugës!*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.[16]

5. LIDHJA E BESËS PËR TË LUFTUAR

Enesi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Para se të fillonte lufta e Hendekut, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) doli të ecte drejt zonës ku po punonin sahabët. Ç'të shihte! Muhaxhirët dhe ensarët ishin duke hapur një hendek në atë të ftohtë të mëngjesit. Dhe nuk kishin asnjë ndihmës që t'i ndihmonte! Kur pa vështirësitë që po kalonin dhe e dinte që ishin të uritur, Ai filloi të lutej:

- "*O Zot! Jetë e vërtetë është jeta e përtejme; Fali Ti muhaxhirët dhe ensarët!*" Ndërsa ata që ishin aty të pranishëm, iu përgjigjën kështu të Dërguarit të Allahut:

- "Ne i jemi betuar Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) se për sa të kemi jetë nuk do të reshtim kurrë së luftuari për të."[17]

---

[15]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/162.
[16]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/164.
[17]. Buhari, *Sahih,* 4/1504 (3874).

6. LIDHJA E BESËS SE DO T'I DËGJOJNË FJALËN DHE DO T'I BINDEN

Fjalët e Ubade bin Samitit (r.a.)

Ubejdullah bin Rafiu (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Na kishin sjellë fuçitë e verës. Aty ishte edhe Ubade bin Samiti. Ubadeja i shpoi ato dhe tha:

- "Ne kemi dhënë besën se do t'i bindemi Allahut dhe të Dërguarit të Tij, si në rini, ashtu edhe në pleqëri, do të shpenzojmë në rrugën e Allahut, si kur të jemi mirë, edhe kur të jemi ngushtë, do të urdhërojmë të bëhet e mira, do t'i pengojmë keqbërësit nga e keqja, do të themi vetëm të vërtetën për hir të Allahut dhe nuk do t'i trembemi gjykimit të njerëzve që do të na gjykojnë, do ta ruajmë të Dërguarin Fisnik dhe do ta mbështesim me çdo çmim, ndaj çdo lloj rreziku, nëse ai na nderon me ardhjen e tij në Medinë, ashtu siç ruajmë e mbështesim gratë dhe fëmijët tanë. Dhe, në këmbim të kësaj, ai na premtoi parajsën. Ja, këto janë të gjitha pika për të cilat ne kemi lidhur besën me Profetin tonë."

Veçmas, në transmetimin që bën Ibni Is'haku lidhur me këtë hadith, do të vërejmë edhe disa fraza ndryshe: "Ubadeja (radijallahu anhu) ka thënë se:

- "Ne i jemi betuar Profetit tonë, njësoj siç janë betuar ata që kanë shkuar në luftë, se do t'ia dëgjojmë fjalën dhe do t'i bindemi, si në skamje, ashtu edhe në pasuri, si në ditë të lehta, ashtu edhe në ditë të vështira, edhe sikur ai të zgjedhë të tjerët përpara nesh, nuk do të përplasemi e nuk do të grindemi me udhëheqësit, do të themi vetëm të vërtetën, pavarësisht vendit dhe situatës ku do të gjendemi dhe se nuk do t'i trembemi asnjë gjykimi të njerëzve që do të na gjykojnë."[18]

7. BETIMI I GRAVE TË ENSARËVE, KUR PROFETI YNË SHKELI NË MEDINË

Tregon Umu Atija (radijallahu anha): Kur erdhi Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në Medinë, kërkoi që të gjitha gratë e ensarëve të

[18]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/163.

mblidheshin në një shtëpi. Pastaj dërgoi tek to Omer bin Hatabin (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu) shkoi dhe qëndroi te porta e shtëpisë. I përshëndeti gratë dhe ato e pranuan përshëndetjen e Omerit.

- "Mua më ka dërguar i Dërguari i Allahut.", – u tha Omeri atyre.

- "Përshëndetjet më të mira për të Dërguarin e Allahut dhe për mëkëmbësin e të Dërguarit të Allahut!", – u përgjigjën gratë njëzëri.

- "A do të betoheni se nuk do të mbani asgjë të barabartë me Zotin, nuk do të vidhni, nuk do të kryeni zina, nuk do t'i vrisni fëmijët, nuk do të gënjeni nga hiçi, duke shpifur për njerëzit, nuk do t'ia ngarkoni bashkëshortëve tuaj një fëmijë të gjetur e nuk do të bëni një fëmijë jashtë martese e t'ia ngarkoni edhe atë burrave tuaj dhe nuk do të ngrini krye për asgjë të mirë që do t'ju kërkohet?"

- "Po, betohemi!", – u përgjigjën ato.

Pas kësaj, Omeri (radijallahu anhu) zgjati dorën nga jashtë portës. Edhe gratë nxorën duart e tyre (njësoj sikur të ishin duke rënë dakord në një marrëveshje). Omeri (radijallahu anhu) iu drejtua Allahut: "O Allah, ji Ti dëshmitari im."

- "Për vajzat e reja që u kanë filluar zakonet dhe vajzat e reja që sapo janë rritur, u është dhënë leje të dalin gjatë dy bajrameve. Ju është ndaluar pjesëmarrja në varrim. E nuk na është caktuar si detyrim as falja e namazit të xhumasë. Megjithatë, o Omer, çfarë do të na thuash me këtë, "që nuk do të ngrini krye?", – e pyetën ato Omerin.

- "Të ngresh krye do të thotë të qash pas të vdekurit, duke e vajtuar me ligje."[19]

Tezja e Profetit tonë dhe Selma binti Kajsi (radijallahu anha), nga gratë e bijve të Adij bin Nexharit, që kishte falur namaz duke u drejtuar nga të dyja kiblet, ka thënë:

- "Shkova te Resulullahu. Iu betova bashkë me një bashkësi grash të tjera të ensarëve. Ai na vuri si kusht të betimit se nuk do t'i bënim Allahut asnjë send si shok, nuk do të vidhnim, do të ruheshim prej zinasë, nuk do t'i vrisnim fëmijët, nuk do të shpifnim për askënd dhe

[19]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/42 (9864).

nuk do të kundërshtonim për asnjë punë të mirë që do të na thuhej, si edhe na tha që '*të mos i tradhtonim burrat*'." Edhe ne i dhamë fjalën, duke lidhur besën. Pastaj, kur po ktheheshim për në shtëpi, unë i thashë njërës nga gratë:

- "Shko njëherë dhe pyete të Dërguarin e Allahut, se çfarë do të thotë 'të tradhtosh burrin', që ta mësojmë."

Ajo grua ashtu bëri, shkoi dhe e pyeti, ndërsa i Dërguari i Allahut iu përgjigj, duke i thënë:

- "*Të marrësh atë që i përket burrit tënd, pa dijeninë e tij, dhe t'ia japësh dikujt tjetër pa asnjë përfitim.*"[20]

Vajza e Ubejd bin Harithit, Gufejleja (Akijle) tregon: "Nëna jonë, Karireja, bashkë me disa nga gratë e muhaxhirëve shkuan te Profeti ynë dhe lidhën besë me të. I Dërguari i Allahut gjendej në çadrën që ishte ngritur në Abtah enkas për të. Ai e pranoi besimin tonë pasi na lexoi një ajet nga sureja "Mumtehine":

"**O Profet, nëse vijnë tek ti besimtaret e të betohen se nuk do t'i shoqërojnë Allahut asgjë** (në adhurim)**, nuk do të vjedhin, nuk do të kurvërojnë, nuk do t'i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të sjellin ndonjë shpifje të sajuar nga ato vetë dhe se nuk do të të kundërshtojnë në çfarë është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje betimin e tyre dhe lutju Allahut t'i falë. Vërtet, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**" (Mumtehine, 60/12)

Kur ne e pranuam kushtin e tij dhe i zgjatëm duart, ai tha: "Unë nuk ua jap dorën grave të huaja." Ai iu lut Allahut që të na falte. Kështu u betuam ne."[21]

Umejmeja, e bija e Rukajkës, ka thënë kështu: "Bashkë me disa gra të tjera, patëm shkuar te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) për të lidhur besë. Ne i thamë:

- "O Resulullah, ne kemi ardhur të të betohemi se nuk do t'i bëjmë asnjë shok a ortak Allahut, nuk do të vjedhim, nuk do të bëjmë zina, nuk do t'i vrasim fëmijët, nuk do të shpifim, nuk do të kundërshtojmë

[20]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/42 (9863).
[21]. Ibn Kethir, *Tefsir,* 4/353.

për asnjë lloj të mire që do të bëhet a që do të na kërkohet!"

- "*Për aq sa të keni fuqi.*", – na tha i Dërguari i Allahut.

Ndërsa ne i thamë:

- "Vërtet, Allahu dhe i Dërguari i Tij janë shumë herë më të mëshirshëm se ne! O Resulullah, zgjate dorën që edhe ne të të shprehim besnikërinë tonë!"

- "*Unë nuk ua jap dorën grave, e fjala ime e dhënë ndaj njëqind grave është njësoj si fjala që i kam dhënë një gruaje të vetme.*"[22]

Betimi i Umejme binti Rukajkës kur ajo u bë myslimane

Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) tregon: "Umejme binti Rukajka erdhi te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), për t'u bërë myslimane, dhe i kërkoi atij që ta lejonte që ajo t'i betohej. I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

- "*Do ta pranoj betimin tënd me kushtin që nuk do t'i bësh Zotit asnjë shok a ortak, nuk do të vjedhësh, nuk do të bësh zina, nuk do t'i vrasësh fëmijët, nuk do të shpifësh, nuk do t'i vajtosh* (me ligje) *të vdekurit e tu, e nuk do të dalësh jashtë të shëtisësh e hapur dhe e pambuluar, siç bënin gratë në kohën e injorancës.*"[23]

8. LIDHJA E BESËS ME FËMIJËT QË NUK E KISHIN ARRITUR ENDE MOSHËN E PUBERTETIT

Një prej nipave të Husejnit (radijallahu anhu), Muhamed bin Aliu, transmeton: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) lidhi besën me Hasanin, Husejnin, Abdullah bin Abasin dhe Abdullah bin Xhaferin, të cilit ishin ende fëmijë dhe që nuk u kishte dalë ende mjekra. Përveç fëmijëve të Ehli Bejtit (Pjesëtarët e familjes së bekuar), nuk është parë që ai të bëjë ndonjë besëlidhje tjetër, të veçantë, me fëmijë të tjerë."[24]

Taberaniu transmeton: "Abdullah bin Zubejri me Abdullah bin

[22]. Ibni Haxher, *el-Isabe,* 4/240.
[23]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/41.
[24]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/46 (9875).

Xhaferin (radijallahu anhuma), kur lidhën besën me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishin ende shtatë vjeç. I Dërguari i Allahut, kur i pa, buzëqeshi, u zgjati dorën dhe ua pranoi betimin."[25]

9. LIDHJA E BESËS SË SAHABËVE ME KALIFËT

Sahabët i betohen Ebu Bekrit (r.a.)

Ibrahim bin Munteshiri ka përcjellë: "Kur Allahu i Madhërishëm pati zbritur ajetin, "**Ata që janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut.**" (Fet'h, 48/10), me besëlidhje, betim, a lidhje të besës do të thoshte t'i jepje fjalën Allahut dhe t'i bindeshe Allahut me besnikëri. Kurse kur ishte Ebu Bekri (radijallahu anhu) që i pranonte betimet, ai thoshte: "Betohuni se do të më bindeni mua, për aq kohë sa unë do t'i bindem Allahut të Madhërishëm!" Ndërsa betimi që i bëhej Omerit (radijallahu anhu) dhe të gjithë kalifëve pas tij, ishte po i njëjti betim që ishte bërë edhe me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).[26]

Ibni Afifi (radijallahu anhu) ka treguar: "Pasi u nda nga jeta i Dërguari i Allahut, pashë Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Po pranonte betimet e njerëzve dhe po u thoshte njerëzve që i ishin mbledhur përreth:

- "A betoheni, duke dhënë fjalën se do ta dëgjoni Allahun dhe Librin e Tij, Kur'anin, e do t'i bindeni atij, pastaj do ta dëgjoni e do t'i bindeni edhe kalifit të tyre?"

Ata iu përgjigjën të gjithë njëzëri:

- "Po!"

Mandej, ai u ngrit në këmbë dhe ata lidhën besën me njëri-tjetrin me radhë.

Qëndrova pranë tij për njëfarë kohe dhe e ndoqa me kujdes. Në atë kohë sapo kisha hyrë në moshën e adoleshencës ose, ndoshta, ka gjasa të kem qenë pak më i madh. Kur mësova kushtet dhe kërkesat që kishin njerëzit teksa betoheshin, shkova pranë Ebu Bekrit (radijallahu

[25]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 9/466 (3402).
[26]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 3/458.

anhu) dhe i thashë:

- "Unë betohem se më parë do të dëgjoj e do t'i bindem Allahut dhe Librit të Tij, pastaj do t'u dëgjoj fjalën e do t'u bindem atyre që na drejtojnë."

Më pa njëherë me kujdes, sikur donte të më peshonte me shikim, pastaj i uli sytë përtokë. E kuptova që kishte mbetur shumë i kënaqur nga ai betim i imi.[27]

[27]. Bejheki, *Sunen,* 8/146 (16339).

VUAJTJET E PROFETIT TONË KUR I FTONTE NJERËZIT NË RRUGËN E ALLAHUT

Si i duruan, Profeti ynë i nderuar dhe sahabët e tij, e si u bënë ballë gjithë atyre vuajtjeve, vështirësive, torturave, urisë dhe etjes, teksa përpiqeshin të përhapnin Fenë Islame? Si e quajtën ata jetën e tyre hiçgjë në rrugën e lartësimit dhe madhërimit të emrit të Allahut?

1. VUAJTJET QË DUROI I DËRGUARI FISNIK

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: "*Nuk ka mbetur dhimbje e vuajtje që nuk e kam hequr!*"

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha kështu: "*Ju betohem se, në rrugën e Allahut, unë kam hequr vuajtjet që nuk i ka provuar njeri. Më kanë bërë torturat më të frikshme e të tmerrshme që mund t'i jenë bërë ndonjë njeriu për Allahun. Kam kaluar tridhjetë ditë e net, ku përveç atij ushqimi të cilin e kishte fshehur Bilali në gji, nuk kishte asgjë që mund ta hajë njeriu as për mua, as për Bilalin!*"[1]

[1]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/47.

Fjalët që i tha Profeti ynë xhaxhait të tij, kur mendoi se ai nuk do ta mbështeste më

Sipas transmetimit të Bejhakiut: "Ebu Talibi i pati thënë Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem):

"Nipi im! Njerëzit tanë erdhën tek unë dhe më thanë aksh e aksh gjë. Të të vijë pak keq për mua dhe për veten, mos na ngarko me barrë që nuk i mbajmë dot as unë, as ti. Hiq dorë, mos thuaj më gjëra që nuk i pëlqejnë popullit tënd!"

I Dërguari i Allahut, duke menduar se duke i thënë këto fjalë xhaxhai i tij kishte ndërruar mendje, kishte hequr dorë nga mbrojtja, e nuk do ta mbështeste më dhe do ta dorëzonte tek armiqtë e tij, i tha atij këto fjalë:

- "*O xhaxha! Sikur diellin të ma vënë mbi supin e djathtë, e hënën në të majtin, unë nuk heq dorë nga misioni im! Ose do të dalë fitimtare feja e Allahut, ose unë do të humb jetën në këtë rrugë!*" Pastaj, nuk i mbajti dot lotët dhe filloi të qajë. Kur u kthye, për t'u larguar, Ebu Talibi i tha:

- "Dëgjo, nipi im! Më shiko me kujdes!"

I Dërguari i Allahut u kthye.

- "Vazhdoje misionin tënd, e bëj ç'të duash. Të betohem për Allahun, se unë nuk kam për të të dorëzuar kurrë tek askush!"[2]

Torturat që iu bënë Profetit tonë pas vdekjes së xhaxhait të tij

Abdullah bin Xhaferi (radijallahu anhu) tregon: "Kur vdiq Ebu Talibi, te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi njëri prej njerëzve më të ndyrë të kurejshëve dhe i tha diçka fyese, duke i hedhur edhe një grusht me baltë. I Dërguari i Allahut u kthye në shtëpi. Njëra nga vajzat e priti duke qarë dhe filloi t'ia fshinte baltën që i kishte njollosur teshat. I Dërguari i Allahut i thoshte:

- "*Jeta ime, bija ime, mos qaj! Ki besim, sepse Allahu do ta mbrojë babanë tënd.*"

Pasi i tregoi se çfarë i kishte ndodhur jashtë, Krenaria e Gjithësisë, Profeti ynë tha:

---

[2]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/42.

"*Deri kur vdiq Ebu Talibi, kurejshët nuk patën guxuar kurrë të bënin ndonjë sjellje të pakëndshme ndaj meje. Tani, pas vdekjes së tij, filluan të sillen kështu.*"

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: "Pas vdekjes së Ebu Talibit, kurejshët filluan të silleshin më ashpër dhe më me egërsi ndaj Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Sa herë që e shihnin, mrrolnin fytyrën. Paskëtaj, i Dërguari i Allahut e pati shprehur me këto fjalë mallin për xhaxhain e ikur: "*Xhaxhai im i dashur! Sa shpejt që fillova ta ndiej mungesën tënde.*"[3]

Vuajtjet që i shkaktuan kurejshët Profetit tonë të nderuar dhe trishtimi i tij

Harith bin Harithi ka thënë kështu: "Një ditë i thashë babait: Ç'është gjithë ky kallaballëk?"

- "Janë mbledhur rreth atij burrit (magjistar) që ka lënë fenë e të parëve.", – m'u përgjigj ai.

Kur iu afrova më pranë, dëgjova që Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po u bënte thirrje njerëzve, që t'i besonin Allahut dhe atij. Ata nuk e pranonin ftesën e tij, madje edhe e fyenin. Derisa arriti mesi i ditës dhe njerëzit zunë të largoheshin të gjithë një e nga një. Nga përballë u shfaq një vajzë që rendte e shqetësuar, me qafën të hapur, në dorë kishte një shtambë me ujë dhe një copë si pecetë. I Dërguari i Allahut ia mori shtambën, piu ujë, mori abdes, pastaj ngriti kryet dhe tha:

- "*Bija ime, mbuloje qafën dhe në asnjë mënyrë mos u shqetëso për babanë!*"

Ne pyetëm:

- "Po kjo vajza kush është?"

- "Është e bija, Zejnebi.", – u përgjigjën ata që e njihnin.

Menbit el-Ezedij ka thënë: "Në kohën e injorancës, pashë Profetin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili po thoshte: 'O njerëz, thoni 'La ilahe il'lallah', në mënyrë që të gjeni shpëtimin!' Nga ata që e dëgjonin, disa e pështynin, disa e gjuanin me baltë, ndërsa të tjerë e shanin. Derisa u

[3]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/134.

bë drekë. Nga përballë erdhi një vajzë e re. Në dorë mbante një enë të madhe të mbushur me ujë. Pasi i Dërguari i Allahut lau duart dhe fytyrën me atë ujë, Ai i tha kështu:

- "*Bija ime, mos u tremb! Ata as e vrasin dot babanë tënd, as nuk e poshtërojnë dot!*"

Unë pyeta se kush ishte ajo vajzë dhe më thanë:

- "Ajo është Zejnebi, e bija e të Dërguarit të Allahut." - Ishte një vajzë shumë e bukur, me fytyrën të bardhë e të shndritshme."[4]

Uruete bin Zubejri (radijallahu anhu) tregon:

"Pyeta Ibnu'l-Asin:

- "A mund të më thuash, kush ka qenë fyerja më e rëndë që i kanë bërë idhujtarët Profetit, kur i shprehnin armiqësinë e tyre?"

Ai m'u përgjigj:

- "Një ditë, i Dërguari Fisnik po falte namazin në pjesën e Qabes që quhet Hixhr, kur aty ia behu Ukbete bin Ebi Muajti. Ia mori petkun dhe, me sa forcë kishte, ia hodhi mbi kokë, duke u përpjekur që ta mbyste. Mirëpo, aty erdhi menjëherë Ebu Bekri. Një të kapur i bëri Ukbes nga supet, e tërhoqi fort dhe i lexoi ajetin: - "Çfarë, pse doni ta vrisni këtë njeri, vetëm sepse thotë se ka zot Allahun? Kur ai ju ka sjellë kushedi se sa mrekulli prej Zotit tuaj. Veç kësaj, nëse është gënjeshtar, gënjeshtra e tij nuk i bën dëm kurrkujt, përveçse atij vetë, por, nëse thotë të vërtetën, atëherë bëhuni gati: qoftë edhe një pjesë e ndëshkimit të ashpër, me të cilin ai ju ka kërcënuar, do të vijë e do t'ju gjejë kudo që të jeni."[5]

Ibni Ebi Shejbeja na përcjell prej Amr bin Asit: "Unë mbaj mend një ditë, kur kurejshët deshën ta vrisnin Profetin tonë. Dhe, në atë ditë, pati ndodhur kështu: U mblodh paria e kurejshëve dhe u ulën në hijen e Qabes. Ndërsa, i Dërguari i Allahut, po falte namaz në Mekamin e Ibrahimit. U ngrit Ukbete bin Ebi Muajti, kapi petkun e Profetit tonë dhe ia lidhi rreth qafës, e filloi ta tërheqë fort. Resulullahu ra mbi dy kupat e gjunjëve. Populli pandehu se po vdiste, ndaj filluan të bërtisnin të gjithë. Ebu Bekri po vinte duke ngarendur nga ana tjetër. E kapi

[4]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 22/432 (1052).
[5]. Buhari, *Sahih,* 3/1400 (3643).

Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nga pas dhe e ngriti. Teksa e ngrinte, u tha të gjithëve: "Pse doni ta vrisni këtë njeri, vetëm sepse po thotë: 'Zoti im është Allahu!'?!"

Kur të gjithë të pranishmit u larguan nga i Dërguari i Allahut, ai vazhdoi të falte namazin. Kur mbaroi faljen, shkoi pranë kurejshëve, që vazhdonin të rrinin të ulur nën hijen e Qabes dhe u tha:

- "*O kurejsh! Unë ju betohem për Allahun, sepse Ai e ka në dorë jetën e Muhamedit*, – duke treguar me dorë fytin e tij, – *se Ai më ka dërguar mua që t'ju këpus juve qafën!"* U rëndoi shumë kjo fjalë e të Dërguarit të Allahut. Andaj, Ebu Xhehli i tha:

- "Ti nuk ke qenë kaq injorant dhe kaq i ashpër!", – po e gjykonte rëndë Profetin tonë, – por, në atë kohë, i Dërguari i Allahut u gjallërua dhe i foli: "*Edhe ti, një prej tyre je!* (d.m.th. edhe ti do të vdesësh)"[6]

Uruete bin Zubejri tregon: "I thashë Abdullah bin Amrit (radijallahu anhu): "Cilat kanë qenë sjelljet më të padurueshme që kurejshët kanë bërë ndaj Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur ia shfaqnin armiqësinë haptas e fare pa mëshirë?" Kështu, ai nisi të më tregojë:

"Një ditë, paria e Kurejshëve ishte mbledhur në zonën e quajtur Hixhr të Qabes. Kur shkova teka ta, i dëgjova që thoshin: 'Durimin që kemi bërë ndaj këtij njeriu, s'e kemi bërë për askënd tjetër. Na ka akuzuar, duke na quajtur budallenj të pamend, na ka sharë të parët tanë dhe na ka përgënjeshtruar fenë, na ka përçarë e nuk jemi më të bashkuar, siç kemi qenë më parë, e nuk ka lënë zot tonin pa e fyer. Shumë i kemi duruar fyerjet e tij.'"

Ndërkohë që ata flisnin kështu, nga larg u shfaq i Dërguari i Allahut. Po vinte duke ecur me ngadalë. Qëndroi përballë hyrjes dhe filloi të vijë rreth Qabes, duke kaluar edhe përpara tyre. Kur kaloi ai, kurejshët, të cilët po talleshin me të deri atë moment, i shkelnin sytë njëri-tjetrit. Atëherë, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha:

- "*O Kurejshë! A më dëgjoni? Unë ju betohem për Allahun, i Cili ka në dorë shpirtin e Muhamedit, se unë kam ardhur për t'ju këputur qafën juve.*"

---

[6]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 2/218 (7036).

Fjalët e Profetit tonë i prekën shumë ata që gjendeshin aty. Mbetën si të ngrirë të gjithë. Ata që deri në çastin kur i Dërguari i Allahut tha këto fjalë po jepnin mendime nga më të ndryshmet, se si mund ta torturonin atë, zunë kush e kush të thoshte fjalët më të bukura që mund t'i vinin në mendje, për ta qetësuar Resulullahun, aq sa i thoshin: "Ik o Eba'l-Kasem, ik, rri i qetë! Uallahi, ti nuk ke qenë një njeri i tillë, kaq i sertë dhe kaq i ashpër! Çfarë ka ndodhur kështu me ty!" I Dërguari i Allahut u largua së andejmi.

Ditën tjetër ata u mblodhën sërish, e aty isha edhe unë. Po flisnin me njëri-tjetrin dhe thoshin:

- "Ju i dini mirë se çfarë na ka bërë ai, e çfarë i kemi bërë ne, mirëpo asnjë prej jush nuk guxoi të reagonte!"

Teksa ata flisnin kësisoj mes veti, ia behu prapë i Dërguari i Allahut. Të gjithë bashkë, siç ishin, u ngritën dhe vrapuan drejt tij dhe e rrethuan:

- "Domethënë ti na fyen ne për zotat tanë dhe guxon të na shash fenë e të parëve?"

- "*Po, ashtu ju kam thënë!*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

Pos kësaj, një prej tyre e kapi Muhamed Mustafanë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nga rroba që kishte të veshur. Ebu Bekrin (radijallahu anhu) e kapluan lotët, megjithatë u fut mes atij njeriu dhe të Dërguarit të Allahut dhe i tha, duke qarë:

- "Çfarë bën, mos ke ndërmend që ta vrasësh vetëm pse thotë se Zoti i tij është Allahu?!"

Paskëtaj, ata u larguan prej Resulullahut. Ja, kjo ka qenë tortura më e rëndë që kurejshët i kanë bërë të Dërguarit të Allahut."[7]

Kur e kanë pyetur vajzën e Ebu Bekrit (radijallahu anhu), Esmanë: "Cila ka qenë vuajtja më e rëndë që ti ke parë, që i kanë shkaktuar idhujtarët Profetit tonë?" Ajo ka nisur të tregojë:

- "Një ditë, idhujtarët ishin ulur afër Qabes; po bisedonin për fjalët që Profeti ynë kishte thënë rreth idhujve që adhuronin kurejshët. Në atë kohë aty u shfaq i Dërguari i Allahut, e ata u ngritën të gjithë në

[7]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/9 (9812).

këmbë, për të shkuar drejt tij. Ebu Bekri dëgjoi një zë që thoshte: "Nxito, shko shpejt t'i vish në ndihmë shokut tënd!" Babai i kishte lidhur flokët në katër, mirëpo, pa i zgjidhur, doli menjëherë jashtë. Ja se ç'dëgjuam të thoshte:

- "Turp t'ju vijë! Mos do ta vrisni ngaqë thotë se Zoti i tij është Allahu?"

Atëhere, idhujtarët e lanë të Dërguarin Fisnik dhe iu kthyen Ebu Bekrit. Kur babai u kthye në shtëpi, e kishte në duar çdo thurimë të flokëve që kishte lidhur në shtëpi. Vetëm këto fjalë thoshte:

- "O Zot, Ti je zotëruesi i të gjithë forcës e i çdo të mire! Ti je kaq i Madhërishëm!"[8]

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Njëherë, idhujtarët e patën rrahur aq shumë Profetin tonë, saqë Profeti ynë pati mbetur përdhe pa ndjenja. U çua Ebu Bekri dhe po bërtiste:

- "Turp t'ju vijë! Çfarë, do ta vrisni vetëm sepse ju thotë se Zoti i tij është Allahu?" - Idhujtarët pyetën:

- "Po ky, kush është?" Dhe njerëzit përgjigjeshin duke thënë:

- "Është ai i çmenduri që e quajnë Ebu Bekr!"[9]

Si e vlerësonte Aliu trimërinë e Ebu Bekrit (r.a.)?

Muhamed bin Akili na tregon: "Në një fjalim të tijin, Aliu (radijallahu anhu) pyeti:

- "O njerëz, a e dini se kush është më trimi prej jush?"

- "Ti je, o Prijësi i Besimtarëve!", – iu përgjigjën ata.

- "Po, unë gjithmonë e kam mundur secilin prej atyre me të cilët jam përleshur; megjithatë, më trimi e më guximtari nuk jam unë. Ai është Ebu Bekri, sepse njëherë, ne patëm ndërtuar një çardak për Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem); kur thamë se kush do të rrijë pranë të Dërguarit të Allahut, që të mos vijnë idhujtarët e ta sulmojnë, uallahi, përveç Ebu Bekrit, askush prej nesh nuk guxoi ta merrte përsipër

[8]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/11 (9814).
[9]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/12 (9815).

një detyrë si ajo. Ai pati nxjerrë shpatën dhe i pati qëndruar te kryet të Dërguarit të Allahut, duke i treguar vendin çdokujt që guxonte të sulmonte Profetin tonë të dashur. Prandaj, për mendimin tim, ai është më trimi nga të gjithë njerëzit. Por edhe një ditë tjetër, unë e pashë vetë Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). E patën kapur kurejshët dhe ishin duke debatuar me njëri-tjetrin me zë të lartë. Herë-herë edhe e qëllonin, e shtynin dhe donin ta rrëzonin përdhe, duke i thënë:

- "Ti je ai që i ke bashkuar të gjithë zotat në një të vetëm?" Uallahi, në një kohë kur askush nuk guxonte të nxirrte zë, Ebu Bekri shkoi atje duke vrapuar. Qëlloi të parin, u përplas me të dytin, ndërsa të tretin e hodhi përtokë, dhe u thoshte atyre:

- "Turp t'ju vijë! Për çfarë do ta vrisni, vetëm sepse ju thotë se Zoti i tij është Allahu?"

Ai që e përcjellë ngjarjen thotë se: Më vonë, Aliu (radijallahu anhu) e hoqi trikon që kishte veshur dhe filloi të qante. Ka qarë aq shumë, saqë e tërë mjekra iu lag nga lotët. Më vonë tha:

- "Për Zotin, më thoni! Kush qëndron më lart, ai besimtar nga dinastia e faraonit, apo Ebu Bekri?"

- Meqë askush nuk tha asnjë fjalë, Aliu (radijallahu anhu) vazhdoi:

- "Ju betohem në Allahun, se një çast i Ebu Bekrit është më i hairit edhe se qindra çaste të atij besimtari nga dinastia e faraonit, madje edhe se të shumë besimtarëve të tjerë si ai, sepse ai e mbante të fshehtë besimin e tij. Kurse Ebu Bekri e shpallte haptas, ballë të gjithëve."[10]

Kurejshët Profetit tonë i patën vendosur plëndës mbi shpinë

Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë: "Një ditë, Profeti ynë ishte duke falur namazin në Qabe. Ebu Xhehli, djemtë e Rabiasë, Shejbeja dhe Utbeja, Ukbete bin Ebu Muajti, Umeje bin Halefi dhe dy të tjerë, ishin ulur në zonën e Hixhrit. Kur Resulullahu ra në sexhde dhe e zgjati shumë atë, Ebu Xhehli tha:

[10]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/271.

- "Kush do shkojë te djemtë e filanit dhe të marrë një plëndës nga ata të deveve që janë therur sot, e të ma sjellë mua? Do t'ia zbrazim Muhamedit mbi shpinë të gjithë plëndësin!"

Për ta marrë, shkoi ai që ishte më i pisti e më i ndyri i mbarë kurejshëve, Ukbete bin Ebi Muajti. E solli plëndësin që ishte plot ndyrësi dhe e zbrazi mbi shpinën e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), pikërisht në pjesën ku mbaron shpina."

Ibni Mesudi thotë se:

- "Edhe unë mbeta i shushatur, madje nuk arrija dot as të flisja! Nuk kisha fuqi, që t'u dilja kundër e t'i pengoja, e të mos e bënin atë që bënë! Sakaq, e bija e Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), me sa duket pati dëgjuar të qeshurat e kurejshëve, sepse erdhi menjëherë; e hoqi atë plëndës nga shpina e të atit. Shkoi përballë kurejshëve dhe nuk la gjë pa u thënë. Ata nuk iu përgjigjën fare Fatimes. I Dërguari i Allahut, përfundoi sexhden dhe ngriti kokën. Ndërsa, kur përfundoi të gjithë faljen, iu drejtua Allahut tri herë, duke iu lutur:

- "O Zot! Ti kam lënë Ty në dorë kurejshët! T'i kam lënë Ty, Utben, Ukben, Ebu Xhehlin dhe Shejben. Nuk kam ç'të bëj më shumë!"

Paskëtaj u largua nga Xhamia e Shenjtë. Teksa po ecte, në rrugë u takua me Ebu'l-Bahterin. Ebu el-Bakhterij po qëndronte i mbështetur mbi bastun; po rrinte. Kur e pa Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), nuk i pëlqeu aspak ajo ngjyrë që kishte marrë fytyra e Profetit tonë.

– "Çfarë të ka ngjarë kështu?", – e pyeti.

- "*M'u hiq nga rruga!*", – i tha i Dërguari i Allahut.

- "Zoti e di, unë nuk do të të hiqem nga rruga, derisa të më tregosh se çfarë të ka ndodhur. Diçka të ka ngjarë!"

I Dërguari i Allahut e pa këmbënguljen e tij dhe i foli:

- "*Ebu Xhehli dha urdhër që të më hidhnin ndyrësi mbi shpinë!*"

- "Eja me mua, atëherë.", – i tha Ebu el-Bakhteri dhe shkuan bashkë në Faltoren e Ndaluar. Ebu el-Bakhteri, iu drejtua Ebu Xhehlit dhe i tha:

- "Ebu'l-Hakem, ti e dhe urdhrin që Muhamedit t'i hidhej ndyrësi

mbi shpinë?"

- "Po!", – u përgjigj Ebu Xhehli.

Pasi mori këtë përgjigje, Ebu el-Bakhteri e ngriti bastunin dhe me sa forcë të kishte e lëshoi atë mbi kokën e Ebu Xhehlit. Ndërkaq, të gjithë filluan të sulmonin njëri-tjetrin. Ebu Xhehli bërtiti:

- "Turp të kesh! Po mban qëndrim në anën e tij! Muhamedi do që të na bëjë armiq të njëri-tjetrit, për të shpëtuar veten dhe shokët e tij!"[11]

Ndërsa, në përcjelljen që i bën Buhariu kësaj ngjarjeje thuhet kështu: "... Ukbete bin Ebi Muajti e hodhi plëndësin në shpinën e të Dërguarit të Allahut dhe, sakaq, të gjithë filluan të qeshnin me të madhe. Aq shumë qeshnin, saqë u merrej fryma dhe mbaheshin te njëri-tjetri, që të mos binin nga të qeshurit."

Dhe në transmetimin e Ahmed bin Hanbelit për këtë ngjarje ka edhe diçka tjetër, në të thuhet: "Abdullah bin Mesudi thotë se: 'Uallahi, ata idhujtarë që i Dërguari i Allahut ua përmendi emrat në lutje, duke ia lënë Allahut në dorë secilin prej tyre, vdiqën të gjithë, një e nga një, në Luftën e Bedrit.'"[12]

Torturat e Ebu Xhehlit ndaj Profetit tonë dhe si ia tregon vendin Ebu Xhehlit Hamzai (r.a.)

Taberani përcjell: "Një ditë, Ebu Xhehli e pati sharë Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në kodrën e Safasë, dhe kjo e pati prekur shumë atë. Hamzai (radijallahu anhu) ishte gjuetar. Edhe atë ditë kishte dalë si zakonisht për të gjuajtur. Kur u kthye, e shoqja, e cila kishte qenë dëshmitare e fyerjeve të vazhdueshme që Ebu Xhehli i kishte bërë Profetit tonë, i thotë atij:

- "O Eba Umare! Veç ta kishe parë se sa keq u soll Ebu Xhehli sot me djalin e vëllait tënd, Muhamedin!"

Hamzai (radijallahu anhu) u nevrikos shumë nga ato që dëgjoi, ndaj u çua me një frymë dhe doli nga shtëpia. Harkun e shigjetat i kishte ende mbi shpinë. Hyri në Xhaminë e Shenjtë dhe Ebu Xhehlin e gjeti

[11]. Hejthemi, *Mexhmeu'ẕ-Zeuaid,* 6/13 (9818).
[12]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/44.

në një prej kuvendeve të kurejshëve. Mori harkun pa thënë asnjë fjalë dhe ia shkoi Ebu Xhehlit në qafë. Ebu Xhehlit iu ça koka. Disa nga burrat e kurejshëve u ngritën dhe e kapën Hamzain (radijallahu anhu) nga krahët.

- "Feja ime është feja e Muhamedit, dëshmoj se ai është i Dërguari i Allahut. Dhe kurrë nuk kam për të kthyer nga ky besim. Nëse jeni kaq trima, po patët guxim, ejani e më pengoni mua po deshët!"

Profeti ynë dhe myslimanët u ndien shumë herë më të fortë me pranimin e Islamit nga Hamzai (radijallahu anhu). Tani edhe hapat i ndienin disi më të sigurt kur i hidhnin. Ndërsa kurejshët qenë frikësuar shumë, sepse mësuan që tani Profeti i profetëve do të gëzonte mbrojtjen e Hamzait (radijallahu anhu)."[13]

Vuajtjet që i shkaktuan Profetit tonë të nderuar fqinjët e tij, Ebu Lehebi dhe Ukbete bin Ebi Muajti

Rabia bin Ubejd ed-Diliu (radijallahu anhu) ka thënë: "Ju nuk po flisni fare për ato që i kanë bërë kurejshët Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Disa nga torturat e shumta, për të cilat unë jam dëshmitar, kanë qenë: "Shtëpia e të Dërguarit të Allahut gjendej mes shtëpisë së Ebu Lehebit dhe Ukbete bin Ebi Muajtit. Resulullahu, sa herë që kthehej për në shtëpi, te porta do të gjente gjithfarë mbeturinash, plëndësash dhe ndyrësish, që kurejshët ia hidhnin aty për inat. Ai i shtynte tej, me cepin e harkut dhe thoshte:

- "*Fqinjësi shumë e keqe kjo, o kurejshë!*"[14]

Torturat që hoqi i Dërguari Fisnik në Taif

Uruete bin Zubejri (radijallahu anhu) transmeton: "Kur vdiq Ebu Talibi, edhe vuajtjet e shqetësimet e të Dërguarit të Allahut u shtuan edhe më shumë. Me shpresën se do t'i vinin në ndihmë e do t'i bëheshin krah, ai shkoi pranë fisit të Thakifëve në Taif. Atje gjeti prijësit e fisit të Thakifëve, Abdi Jalejlin, Hubejbin dhe Mesudin. Ai iu

[13]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 3/140 (2926).
[14]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/18 (9120).

ankua atyre për vuajtjet dhe padrejtësitë që kurejshët u kishin bërë, si atij vetë, ashtu edhe shokëve të tij, duke u kërkuar sakaq që t'u vinin në ndihmë dhe t'i mbështesnin. Njëri nga këta tre vëllezër u hodh e tha:

- "Nëse Allahu të ka dërguar ty me një detyrë, atëherë unë e vjedh mbulesën e Qabes!"

- "Këtej e tutje unë nuk do të flas më, as edhe një fjalë të vetme, me ty, sepse, nëse ti je një profet, atëherë ty nuk ta lejon detyra që të flasësh me një njeri të thjeshtë e të zakonshëm si unë!", – tha i dyti.

Kurse i treti e priti me fjalët:

- "Allahu, nuk gjeti dikë tjetër, përveç teje, për të dërguar? Kaq i dobët është Ai, saqë nuk gjeti dot dikë më të mirë se ty?"

Këta njerëz nisën t'i përhapnin edhe në mesin e thakifasve të tjerë ato fjalë që u kishte thënë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kështu që nuk mjaftuan vetëm ata, por u mblodhën edhe pjesëtarët e tjerë të familjeve, që erdhën për t'u tallur me të Dërguarin e Allahut. Morën gurë nëpër duar dhe u bënë dy radhë të gjata nëpër të dyja anët e rrugës. Gurët godisnin trupin e bekuar të Resulullahut dhe ia plagosën gjunjët, megjithatë ata vazhdonin të qeshnin me marifetin që çoç kishin sajuar. Resulullahu qe larguar goxha prej tyre, mirëpo këmbët ia kishte mbuluar gjaku. Më në fund, ai arriti të strehohej në një vresht rrushi. Po dridhej nga dhimbjet dhe nga mërzia, gjeti një hije dhe u ul. Këmbët vazhdonin t'i rridhnin gjak, nuk kishte të reshtur gjithë ai gjak. Kur hyri në atë vresht, aty ishin edhe dy djemtë e Rabias, Utbeja dhe Shejbeja. Profeti (alejhis'selam), kur i pa, nuk deshi t'u shkonte pranë, sepse e dinte që ata ishin ndër armiqtë e tij më të paepur. Utbeja dhe Shejbeja i dhanë disa veshë rrushi skllavit të tyre nga Niniva, Adasit, i cili ishte i krishterë, dhe i thanë që t'ia çonte ata Profetit tonë. Adasi ia çoi rrushin dhe ia vuri përpara, ndërsa Profeti ynë tha:

- "*Bismil'lah.*"

Kjo ishte një fjalë që e habiti tej mase Adasin.

- "*Nga je ti kështu?*", – e pyeti Resulullahu.

- "Jam nga Niniva!", – u përgjigj Adasi.

- "*Pra, ti qenkëshe patrioti i njeriut të mirë, Junus bin Metasë, apo jo?*"

- "Nga e di ti emrin e Junus bin Metasë?", – e pyeti ai të Dërguarin e Allahut, i cili i tregoi shumë gjëra të reja, të cilat ai nuk i kish dëgjuar kurrë më parë në lidhje me profetin Junus.

Sipas një transmetimi tjetër, Profeti ynë i ka thënë:

- "*Ai është vëllai im, sepse ai është një profet. Edhe unë jam profet, njësoj si ai.*"

Profeti ynë i Dashur (paqja e Zotit qoftë mbi të), kur kryente detyrën e profetësisë, atë të përhapjes së fesë së vërtetë të Allahut, nuk nënvlerësonte askënd. Adasi iu përgjigj:

- "O Resulullah, a do të më flasësh mua më shumë për Junus bin Metanë?"

I Dërguari i Allahut i mësoi atij ajetet që i ishin zbritur lidhur me jetën e Junusit të nderuar (alejhis'selam), Adasi u përul në sexhde para Resulullahut dhe filloi t'i puthte këmbët, të cilat i kishte ende të mbuluara në gjak. Utbeja dhe Shejbeja nuk reaguan për sjelljen e shfaqur nga skllavi i tyre. Kur Adasi shkoi pranë tyre, ata i thanë:

- "Ç'e ke këtë gjendje? Çfarë ishte gjithë ajo përulësi e tërë ai respekt para Muhamedit, që i puthe edhe këmbët? Mes nesh ne nuk e kemi parë kurrë një sjellje si kjo!"

Adasi iu përgjigj atyre duke u thënë:

- "Ky është një njeri shumë i mirë, Ai më foli mua për të vërtetat e Junus bin Metasë, profetit që Zoti i pati dërguar qytetit tonë, madje e dinte se Junusi ishte i dërguar i Zotit."

Utbeja dhe Shejbeja qeshën pak me njëri-tjetrin dhe e paralajmëruan:

- "Bëj kujdes se mos të bën të braktisësh Krishterimin; ai është njeri shumë hileqar!"

Që aty, Profeti i profetëve u kthye prapë në Mekë."[15]

Lutja që bëri i Dërguari i Allahut teksa kthehej nga Taifi

Sipas asaj që na përcillet, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shpëtoi paq nga banorët e Taifit dhe kur gjeti një vend më të

[15]. Halebi, *Sire,* 2/56.

sigurt, Ai bëri këtë lutje:

"*O Zot! Nuk mund të të ankohem veçse Ty për pafuqinë, që jam kaq i dobët e që njerëzit më shohin me kaq shumë përbuzje. Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve, Ti je Zoti i atyre që nuk kanë asnjë mbështetje! Ti je Zoti im. Ti do të më mëshirosh mua, sa të mos më lësh në duart e dikujt që më vrenjt fytyrën, apo që të më lësh në duart dhe mëshirën e munguar të armiqve! Mjafton që Ti të mos jesh i mërzitur me mua, pa asgjë tjetër nuk më intereson. Mua më mjafton shëndeti dhe përkujdesja që do të më falësh Ti dhe e di se ajo është shumë herë më e madhe se sa këto që po përballem. Unë strehimin e kërkoj tek ai nuri Yt që ndriçon dhe i jep jetë kësaj bote e jetës së përjetshme, duke e bërë dritë errësirën, që të mund të shpëtoj prej ndëshkimit Tënd; të mos e meritoj atë ndëshkim. Nuk do të largohem nga pragu i portës Sate derisa Ti të kesh mbetur i kënaqur me mua. Vetëm tek Ti e ka burimin e tërë forca dhe fuqia dhe sajë Teje gjithçka arrin të qëndrojë në këmbë.*"[16]

Vuajtjet e Profetit tonë në luftën e Uhudit

Enesi (radijallahu anhu) ka transmetuar: "Një gur i hedhur ndaj Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i pati thyer atij njërin prej dhëmbëve të përparmë, duke e lënë kështu të plagosur. I Dërguari i Allahut fshiu gjakun që i mbuloi gojën dhe tha:

- "*E si mund të shpëtojë një popull që plagos profetin e vet, duke i thyer dhëmbët, kur ai po i fton ata që t'i besojnë Allahut?*"

Fill pas këtyre fjalëve të Profetit tonë, të Dërguarit Fisnik iu zbrit ajeti: "**Ti nuk ke asgjë në dorë, nëse do t'ua pranojë Ai pendimin, apo do t'i dënojë, ngase ata janë vërtet keqbërës ndaj vetes. Ti vetëm mund t'u tregosh atyre rrugën e drejtë.**" (Al 'Imran, 3/128)[17]

Aishja (radijallahu anha) ka thënë: "Sa herë që përmendej lufta e Uhudit, babai im, Ebu Bekri, na tregonte: "Ajo ditë ishte e tëra dita e Talhasë."

"Pas një disfate të përkohshme që patëm në luftën e Uhudit, i pari

[16]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/136.
[17]. Buhari, *Sahih,* 4/1493; Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/29.

që u kthye isha unë. Në atë çast pashë dikë, i cili, qëndronte para të Dërguarit të Allahut dhe po luftonte për Allahun me gjithë shpirt. Thashë me vete: "Sa shumë duhet të kem humbur; dashtë Zoti që ti të jesh Talhaja, sepse, nëse ky njeri që po lufton me kaq vendosmëri është ndonjë prej kushërinjve të mi, kjo do të më gëzonte e do të më kënaqte tej mase."

- Në mes të idhujtarëve ishte edhe një njeri të cilin unë nuk e njihja. Megjithatë, isha më afër të Dërguarit të Allahut. Ai njeri po ecte me shpejtësi, ndërsa unë nuk po e arrija dot. Pashë që ai njeri ishte Ebu Ubejde bin Xherrahu (radijallahu anhu). Kur shkova pranë Profetit tonë, ç'të shihja, një nga dhëmbët i ishte thyer, fytyrën e kishte të plagosur, e dy copa hekuri të shigjetës i kishin mbetur të ngulura në fytyrë. Nga plaga vazhdonte të rridhte gjak, megjithatë Resulullahu bënte me shenjë, duke na treguar Talhanë:

- "*Shkoni të ndihmoni shokun tuaj!*" Kur e pa se nuk po ia dëgjonin fjalën, ai një të gjallëruar bëri dhe tha:

- "*Betohem, po nuk më le, nuk do të ta bëj kurrë hallall hakun tim!*"

Dhe unë ia lashë Ebu Ubejdes, që t'i nxirrte ato copëza të shigjetës. Ebu Ubejdeja, nga frika se mos ajo do t'i shkaktonte dhimbje Resulullahut, e kapi pjesën e shigjetës me dhëmbë dhe e nxori. Bashkë me të ra edhe një prej dhëmbëve të përparmë të Ebu Ubejdes. Kur u përpoqa edhe unë që të bëja atë që kishte bërë Ebu Ubejdeja, Resulullahu u betua sërish, se nëse nuk e lija, ai nuk do të ma bënte hallall hakun e tij. Ebu Ubejdeja veproi po njësoj dhe e nxori edhe copën e dytë. Edhe kësaj here i ra edhe një tjetër dhëmb i përparmë. Me të vërtetë, Ebu Ubejdeja u bë njeriu më i bukur, edhe pse i mungonin dy dhëmbët e përparmë. Pasi mjekoi Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), shkuam te Talhaja, i cili ishte në njërën prej gropave aty. Kishte marrë plot shtatëdhjetë e kusur plagë, duke filluar nga ngulja e një heshte, deri te shigjetat dhe goditjet e shumta me kamë. Madje i kishin prerë edhe njërin prej gishtërinjve. E mjekuam edhe atë."[18]

[18]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/29; Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/298.

2. SI BËNIN DURIM NDAJ VUAJTJEVE SAHABËT FISNIKË

Durimi i Ebu Bekrit (r.a.) ndaj vuajtjeve dhe këmbënguljet e tij për ta shpallur fenë haptazi

Aishja (radijallahu anha) tregon: "Një ditë u mblodhën sahabët e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), – të gjithë bashkë bëheshin tridhjetë e tetë vetë, – kur Ebu Bekri i nderuar i kërkonte të Dërguarit të Allahut me këmbëngulje që të dilnin haptazi dhe t'ua shpallnin të gjithëve Fenë Islame. Ndërsa Profeti ynë i thoshte:

- "*Jemi ende shumë të paktë në numër për ta bërë këtë gjë!*" Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) vazhdoi të këmbëngulte, Resulullahu doli jashtë për t'i thirrur njerëzit haptazi në fe. Myslimanët u përhapën në të gjitha anët e faltores. Secili shkoi njëherë pranë të afërmve të vet. Ebu Bekri (radijallahu anhu) u çua dhe shkoi të flasë përpara njerëzve. Resulullahu po rrinte ulur. Me këtë fjalim, Ebu Bekri u shndërrua në myslimanin e parë që u bënte njerëzve thirrje në masë, që ata t'i besonin Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Idhujtarët i sulmuan Ebu Bekrin dhe të gjithë myslimanët e tjerë, duke i rrahur shumë keq myslimanët. Ebu Bekrin e shkelën me këmbë, pasi e patën rrahur më keq se të tjerët. Një nga më të këqijtë ishte Utbete bin Rabia, i cili iu afrua Ebu Bekrit dhe filloi ta rrahë me çizmet e tij me dhëmbë hekuri dhe, pasi e pati rrëzuar përtokë, i hipi sipër, për ta shkelur. Kërceu dhe filloi ta shkelte mbi bark. Aq keq, sa që babait vështirë t'ia dalloje gojën nga hunda. Bijtë e Tejmit erdhën me vrap, për t'i larguar idhujtarët që i ishin vërsulur Ebu Bekrit. E morën mbi një copë të madhe e prunë peshë në shtëpi. Nuk kishin më dyshim, për ta ai do të vdiste. Pastaj në Xhaminë e Shenjtë hynë bijtë e Tejmit, të cilët thanë:

- "Nëse vdes Ebu Bekri, ne do të vrasim Utbete bin Rabian!"

Ata u kthyen prapë te Ebu Bekri. Babai i tij Ebu Kuhafeja dhe bijtë e Tejmit po përpiqeshin ta bënin Ebu Bekrin të fliste ndonjë fjalë. Mirëpo ai nuk u përgjigj deri aty në të rënë të muzgut dhe fjala e parë që tha ishte:

- "Çfarë po bën Resulullahu, si është ai?" Ata që ishin të pranishëm e qortuan dhe u ngritën e ikën. Iu drejtuan nënës së tij, Umu'l-Hajrit, dhe i thanë:

- "Kujdesu mirë për të, jepi ndonjë gjë të mirë dhe mos harro t'i japësh të pijë ujë." Kur mbetën vetëm nënë e bir, ajo u përpoq t'i jepte atij diçka për të ngrënë. Megjithatë, Ebu Bekri nuk belbëzonte asgjë tjetër, veç fjalëve:

- "Po Resulullahu, çfarë po bën?" E ëma iu përgjigj:

- "Uallahi nuk di asgjë çfarë ka ndodhur me shokun tënd!"

- "Atëherë shko njëherë tek Umu Xhemil binti Hatabi dhe pyete se në ç'gjendje është i Dërguari i Allahut!", – i tha ai nënës.

Dhe ajo kështu bëri, doli dhe shkoi tek Umu Xhemili, për t'i pyetur:

- "Ebu Bekri më dërgoi të të pyes, si është Muhamedi?"

- "Unë nuk e njoh as Ebu Bekrin, as Muhamedin! Por, po deshe, të shkojmë bashkë te djali yt dhe të shohim se çfarë kërkon ai të dijë prej meje."

- "Mirë, shkojmë.", – i tha ajo dhe dolën bashkë, për t'u kthyer pranë Ebu Bekrit. Ebu Bekrin i kishte rënë të fikët kur u kthyen dhe plagët i kishte shumë të rënda. Me ta parë, Umu Xhemili lëshoi një klithmë të fortë, iu afrua Ebu Bekrit dhe i tha:

- "Uallahi, nuk ka dyshim, se ata që të kanë bërë ty kështu, janë njerëzit më të këqij, mohues egërsira e njerëz të shthurur. Kam shumë shpresë se Allahu do të ta marrë hakun ndaj tyre."

- "Çfarë bëri Profeti ynë? Si është ai?", – vazhdonte të pyeste Ebu Bekri.

- "Është nëna jote këtu, na dëgjon.", – i tha Umu Xhemili.

- "Nga ajo nuk të vjen asnjë e keqe, ndaj më trego."

- "Gjallë është, mirë është."

- "Ku është tani?"

- "Tani është në shtëpinë e Ibni Erkamit.", – u përgjigj ajo.

- "Të betohem në Allahun, se pa shkuar te Profeti as nuk fus gjë në gojë, as nuk pi asgjë!"

Nëna e Ebu Bekrit (radijallahu anhu) dhe Umu Xhemili qëndruan në pritje; kur panë se jashtë nuk kishte më asnjë zhurmë hapash dhe njerëzit dukej se ishin tërhequr të gjithë nëpër shtëpitë e tyre, e morën

Ebu Bekrin nga krahët dhe e çuan pranë Resulullahut. Profeti ynë dhe myslimanët u afruan të gjithë tek ai dhe i kërkuan që të qetësohej. Të Dërguarit të Allahut i pikoi në zemër kjo gjendje e tij. Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha:

- "Të qofshin falë nëna e babai im, o Resulullah! Nuk kam asgjë, përveç plagëve në fytyrë, ngase më qëlloi nga koka. Ja, kjo është nëna ime! Shih sa e dhembshur është për fëmijën e saj. Lutja Jote është e pranuar, ftoje atë, që t'i besojë Allahut dhe lutju Allahut për të. Ndoshta Allahu do ta shpëtojë atë nga flakët e Xhehenemit vetëm për hir të lutjes sate."

Dhe i Dërguari i Allahut u lut dhe e ftoi atë që të pranonte Zotin që është Një dhe i Vetëm, e që nuk ka asnjë tjetër veç Tij. Sa hap e mbyll sytë, ajo grua u bë menjëherë myslimane, duke e pranuar Islamin.

Myslimanët qëndruan plot një muaj në shtëpinë e Ibni Erkamit. Të gjithë bëheshin tridhjetë e nëntë vetë gjithsej. Atë ditën që u rrah Ebu Bekri, u bë mysliman edhe xhaxhai i Profetit tonë, Hamzai (radijallahu anhu)."[19]

Omeri (r.a.) bëhet mysliman me lutjen e Profetit tonë

Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i lutej Allahut, që Omeri (radijallahu anhu) ose Ebu Xhehli, të paktën njëri nga këta të dy, të bëhej mysliman. I Dërguari i Allahut u lut ditën e mërkurë, të enjten Omeri (radijallahu anhu) pranoi Islamin dhe u bë mysliman. Kur u bë mysliman Omeri, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe sahabët e tij qenë gëzuar aq shumë, saqë zëri i tyre pati jehuar deri në lagjet më të epërme të Mekës. Aq sa, edhe Ebu'l-Erkami që ishte i verbër dhe idhujtar, doli jashtë dhe tha:

- "O Zot! Falja Erkamit të shkretin djalë; sepse ai u bë mohues!"

Omeri (radijallahu anhu) u çua në këmbë dhe tha:

- "O Resulullah, pse e mbajmë të fshehtë fenë tonë ne, kur jemi ne ata që kemi të drejtë dhe ajo që themi është e vërteta? Nga ana tjetër, ato ku besojnë ata janë disa paçavure, e megjithatë, ata e shprehin sheshit besimin e tyre!"

[19]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/31.

- "*O Omer, ne jemi ende shumë të paktë në numër, ti e ke parë vetë se ç'të këqija kemi hequr deri më tani!*"

- "Të betohem në Allahun që të ka dërguar ty me të drejtën, se unë do të shkoj në të gjitha kuvendet ku kam qenë deri më sot i pranishëm si mohues dhe do t'ua deklaroj të gjithëve se jam bërë mysliman!" – dhe, sakaq, porsi një shigjetë, doli jashtë. Erdhi njëherë përreth Qabes Madhështore, pastaj shkoi pranë kurejshëve, të cilët po e ndiqnin me sy. Ebu Xhehli e priti Omerin (radijallahu anhu) duke i thënë:

- "O Omer, filani thotë se ti ke dalë nga feja, e vërtetë është kjo?"

- "Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Allahut, që meriton të adhurohet, Ai është Një, Ai nuk ka asnjë ortak në krijimin e asgjëje. Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij!"

Idhujtarët iu sulën Omerit. Omeri (radijallahu anhu) një të kërcyer bëri dhe u hodh mbi Utben. Edhe pak edhe do t'ia nxirrte sytë nga vendi me gishtërinj. Utbeja filloi të ulërinte. Kur ata që ishin të pranishëm u larguan, atëherë u ngrit Omeri nga Utbeja. Duke mbërthyer atë që ishte më i nderuari në mesin e atyre që e sulmuan, ai i kishte lënë të paralizuar të gjithë të tjerët që donin ta sulmonin. Në të njëjtën mënyrë, ai i shëtiti dhe i vizitoi edhe njëherë të gjitha kuvendet ku kishte hyrë e dalë gjatë kohës kur ishte mohues dhe ua shpallte besimin e tij pa iu dridhur qerpiku. Pas njëfarë kohe, ai u kthye tek i Dërguari i Allahut, i kishte mundur të gjithë idhujtarët që e kundërshtonin. Ai i tha të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulullah, t'u bëfshin kurban nëna dhe babai im, nuk guxon kush të vërë dorë mbi ty! Shkova në të gjitha kuvendet ku jam gjendur para se të bëhesha mysliman dhe ua shpalla besimin dhe që isha bërë mysliman, pa as frikën më të vogël!"

Kur e dëgjoi, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), meqenëse tani kishte me vete dy njerëz si Omeri dhe Hamzai (radijallahu anhuma), doli jashtë dhe shkoi të vizitojë Qaben. Fali namazin e drekës i qetë dhe i sigurt. Pastaj, bashkë me Omerin (radijallahu anhu), ata u kthyen në shtëpinë e Ibni Erkamit."[20]

[20]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/3; Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/447.

Ebu Bekri (r.a.) niset për të mërguar drejt Abisinisë

Aishja (radijallahu anha) ka thënë: "Qëkurse u rrita dhe kisha filluar t'i kuptoja gjërat, unë e mbaj mend babanë si mysliman. Nuk kishte asnjë ditë që kalonte, që në mbrëmje dhe në mëngjes te ne të mos vinte Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kur ndaj myslimanëve filluan të bëheshin gjithfarë torturash e t'u shkaktoheshin gjithfarë vuajtjesh, edhe Ebu Bekri u nis në drejtim të Abisinisë, për të mërguar. Kur mbërritën në vendin e quajtur Berku'l-Gimad, që ishte diku te pesë ditë larg Mekës, atje u takua me të madhin e fisit të Kares, Ibnu Dugunen, i cili i tha:

- "O Ebu Bekr, ku do të shkosh kështu?"

Ebu Bekri i tha:

- "Populli ynë na ka parë me hak që ne të bredhim rrugëve. Dua të udhëtoj, të shëtis rruzullin tokësor dhe të kem një vend ku të mund ta kryej i qetë adhurimin tim karshi Zotit."

- "Shiko, o Ebu Bekr, një njeri si ti as nuk del nga vendi i tij, as nuk guxon dot njeri që ta nxjerrë prej andej, sepse ti po ndan me njerëzit gjërat më të mira, ti je një njeri që përkujdesesh për familjen dhe të afërmit dhe u vjen gjithmonë në ndihmë nevojtarëve. Ti di si t'i presësh miqtë, e di si t'i mbështesësh ata që dëmtohen nga fatkeqësitë e natyrës. Shiko, ti je fqinji im. Kthehu pas dhe adhuroje Zotin në vendin tënd."

Kësisoj, Ebu Bekri u kthye pas bashkë me Ibnu Dugunen. Ibnu Duguneja atë natë i shëtiti të gjithë njerëzit më të respektuar dhe më të mëdhenj të kurejshëve dhe u tha këto fjalë:

- "Një njeri si Ebu Bekri as nuk nxirret nga atdheu, as nuk duhet të dalë. Si guxoni ju të përzini nga vendi i vet një njeri që i ndan me të tjerët ato gjëra që ata nuk i kanë, që kujdeset për të afërmit e kushërinjtë, që u bëhet krah të dobëtëve, i mirëpret miqtë dhe që di t'i ndihmojë ata që i prek fatkeqësia e natyrës?"

Kurejshët as nuk i përgënjeshtruan këto fjalë të Ibnu Dugunes, as nuk e kundërshtuan kur ai mori përsipër se, këtej e tutje, Ebu Bekri ishte nën mbrojtjen e tij. Ata i thanë atij:

- "Shiko, thuaji Ebu Bekrit, Zotin ta adhurojë në shtëpinë e tij, edhe namazin ta falë në shtëpinë e tij, e atje le të lexojë e këndojë ç't'i dojë zemra; por të mos na shqetësojë ne me ato që lexon. Të mos lexojë haptazi dhe në sy të të gjithëve, sepse kemi frikë mos tërheq vëmendjen e grave dhe fëmijëve tanë, e ata bien pre e fjalëve të tij!"

Ibnu Duguneja ia përcolli Ebu Bekrit (radijallahu anhu) një për një, të gjitha fjalët që i kishin thënë përfaqësuesit e kurejshëve. Kësisoj, ai pranoi të qëndronte në vendin e vet, duke pranuar këtë kusht. Tanimë ai e adhuronte Zotin në shtëpinë e vet dhe jashtë as nuk falte namaz, as nuk lexonte Kur'an. Më vonë, Ebu Bekrit (radijallahu anhu) i erdhi një mendim në kokë. I shkoi mendja të ndërtonte një vend për të falur namazin në avllinë e shtëpisë. Këtej e tutje, aty do të falte namazin dhe aty do të lexonte Kur'an. Dhe e bëri realitet këtë mendim. Gratë dhe fëmijët e idhujtarëve e ndiqnin me habi çdo sjellje të Ebu Bekrit dhe, pak e nga pak, kishin filluar të grumbulloheshin para shtëpisë së tij, për ta parë se ç'bënte ai, aq sa kallaballëku kishte filluar të shtohej aq shumë, saqë njerëzit dukej sikur do të shkelnin mbi njëri-tjetrin. Babai im kishte një zemër shumë të butë dhe ishte jashtëzakonisht i mëshirshëm; nuk i mbante dot lotët kur falte namaz. Kjo gjendje e Ebu Bekrit (radijallahu anhu) filloi t'i shqetësonte jashtë mase kurejshët idhujtarë. Ata i dërguan lajm Ibnu Dugunes dhe ai erdhi menjëherë. Ata i thanë atij:

- "Ne e patëm lejuar Ebu Bekrin, që ai t'i kryente në shtëpinë e tij adhurimet ndaj Zotit. Mirëpo Ebu Bekri e teproi, e ka kaluar cakun, e ka kthyer avllinë e shtëpisë në faltore dhe gjatë gjithë ditës e fal namazin hapur, në sy të të gjithëve; lexon Kur'an. Kemi frikë se do të na mashtrojë gratë dhe fëmijët. Thuaji të heqë dorë nga kjo sjellje. Thuaji, që nëse do ta adhurojë Zotin e tij, të futet e t'i kryejë brenda në shtëpi adhurimet që ka për të kryer. Nëse pranon, thuaji se garancia jonë do të vijojë të jetë e vlefshme, në të kundërt, nëse këmbëngul, e do të vazhdojë t'i falë haptas namazet, atëherë bëji të ditur se ti do ta tërheqësh mbrapsht garancinë që na ke dhënë për Ebu Bekrin. Ne nuk duam ta shkelim fjalën që të kemi dhënë. Por as adhurimin e Ebu Bekrit hapur, faqeza të gjithëve, nuk mund ta pranojmë në asnjë mënyrë!"

Ibnu Duguneja erdhi tek Ebu Bekri dhe i tha:

- "Dëgjo, o Ebu Bekr, ti e mban mend shumë mirë se si qemë marrë vesh bashkë. Ose do të mjaftohesh me kaq, ose duhet të ma kthesh mbrapsht fjalën që kam dhënë në emrin tënd, sepse unë nuk dua kurrsesi që arabët të dëgjojnë se unë e kam prishur fjalën që i kam dhënë dikujt!"

- "Atëherë, unë po ta kthej mbrapsht fjalën që të kam dhënë për ndihmën tënde. Jam i kënaqur me mbrojtjen që më jep Allahu! Më mjafton mbrojtja e Allahut!", – tha Ebu Bekri.[21]

Ebu Bekri (radijallahu anhu) nuk ishte më në mbrojtjen dhe garancinë e Ibnu Dugunes. Mirëpo, një ditë, teksa po shkonte në Qabe, një prej rrugaçëve të kurejshëve e gjuajti atë me një grusht baltë. Në atë kohë, aty po kalonin edhe Uelid bin Mugireja me As bin Uailin. Ebu Bekri (radijallahu anhu) u tha:

- "E shikoni ç'më bëri ai i poshtër?", – sikur po u ankohej atyre.

- "Ti ia bëre vetë të keqen vetes, me dorën tënde!"

Në moment, Ebu Bekri tha me vete:

"O Zot, sa i Butë që je Ti! Sa i butë që je Ti, o Zot! Sa i butë që je Ti, o Zot!"[22]

Omeri (r.a.) përballet me vështirësitë

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Kur u bë mysliman Omeri (radijallahu anhu), ai filloi të pyeste lart e poshtë:

- "Kush është ai që i përhap më shumë dhe më shpejt llafet në mesin e kurejshëve?"

- "Xhemil bin Ma'mer bin el-Xhumehi", - i thanë. Babai im doli të shkonte tek ai. Nga kureshtja që kisha për të parë se çfarë do të bënte, unë iu vura nga pas. Atëherë isha i vogël dhe e kuptoja menjëherë gjithçka që shihja. Babai shkoi te Xhemili dhe i tha:

- "Xhemil, e di, unë u bëra mysliman, kam pranuar fenë e Muhamedit."

[21]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/94.
[22]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/95.

Ende pa e mbaruar mirë fjalën Omeri (radijallahu anhu), Xhemili mori rrobën që kishte hedhur supeve dhe u çua. Ne e ndoqëm nga pas. Kur mbërriti në portën e Xhamisë së Shenjtë, filloi të thërriste kurejshët me sa zë që kishte:

- "O kurejshë, më dëgjoni mua me kujdes! I biri i Hatabit, Omeri, ka braktisur fenë e të parëve!"

Omeri (radijallahu anhu), që po i vinte nga pas, bërtiti:

- "Gënjen! Unë jam bërë mysliman, kam besuar se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut." Një të thënë ai kështu, të gjithë sa ishin, duke dëgjuar, iu sulën ta sulmonin babanë. Omeri (radijallahu anhu) u përlesh me ata deri sa dielli u ngjit mbi kryet e kodrave, derisa Omeri (radijallahu anhu) u lodh dhe u ul të çlodhej. Kurejshët nuk u larguan. Në atë kohë Omeri po thoshte:

- "Bëni si t'ju vijë nëpër mendje. Unë betohem në Allahun, se nëse ne do të ishim jo më shumë, por treqind vetë, ose ju do të na e dorëzonit vetë këtë vend, ose ne do t'jua dorëzonim atë juve!"

Ndërkohë që ata debatonin, aty u shfaq një nga pleqtë e kurejshëve, i cili kishte veshur një këmishë me motive të bukura dhe një triko të thurur Jemeni.

- "Ç'është kjo potere, kështu?", – pyeti ai.

- "Omeri, ka braktisur fenë e të parëve të tij!", – iu përgjigjën ata.

- "Lëreni të qetë. Ai ka bërë një zgjedhje për veten e tij. Po ju çfarë doni të bëni kështu? Çfarë mendoni ju, se bijtë e Adijit do t'jua lënë për kollaj djalin e tyre? Lëreni të shkojë.", – u tha ai.

Pasi dëgjuan fjalën e plakut, ata u larguan të gjithë nga kryet e Omerit. Kur babai mërgoi për në Medinë, unë i thashë atij:

- "Baba! Kush ishte ai burri që e largoi turmën që po zihej me ty atë ditë që u bëre mysliman?"

- "Biri im, ai njeri ishte As bin Uail es-Sehmiu.", – m'u përgjigj babai.[23]

[23]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/82.

Durimi që bënte Osman bin Afani (r.a.) ndaj trysnisë së ushtruar

Muhamed bin Ibrahimi përcjell: "Kur Osman bin Afani (radijallahu anhu) pranoi Islamin, xhaxhai i tij, Hakem bin Ebu'l-Asi e kapi atë dhe e lidhi fort, duke i thënë:

- "Domethënë do që të braktisësh fenë e paraardhësve të tu, për të hyrë në atë fenë e re, hë? Uallahi, nuk kam për të të zgjidhur, derisa të heqësh dorë përfundimisht nga ajo fe!"

Ja se cila ishte përgjigjja që i ktheu Osmani:

- "Të betohem në Allahun, se nuk kam për ta braktisur kurrë as fenë time, as Muhamedin!" Atëherë, xhaxhai e pa se sa e fortë ishte lidhja e Osmanit me fenë e re, kështu që e la të lirë të bënte çfarë të donte.[24]

Trysnia që i ushtrohej Talha bin Ubejdullahut dhe durimi i tij

Mesud bin Hirashi ka thënë: "Në kohën e injorancës, kur po vinim vërdallë nga Safaja në Merue, pamë një grup njerëzish, të cilët kishin kapur një njeri dhe ia kishin lidhur krahët pas qafës. Nga pas u vinte një grua, e cila e fyente ashpër atë djalosh të ri, duke i numëruar sharje dhe mallkime njërën pas tjetrës.

- "Ç'i kanë bërë kështu këtij djali?", – thashë unë.

- "Ai është Talha bin Ubejdullahu! Është kthyer nga feja e të parëve. Kurse ajo grua është nëna e tij, Sa'betu binti el-Hadremiu.", – më thanë.[25]

Përcjell Ibrahim bin Muhamed bin Talhaja: "Talha bin Ubejdullahu më pati thënë kështu: "Unë pata shkuar në panairin e Busras. Ç'të shoh, një murg, thoshte në manastirin e tij:

- "Pa pyetini njëherë ata që vijnë të vizitojnë panairin, ka ndonjë që vjen nga Meka?"

Unë u hodha menjëherë dhe thashë:

- "Po, jam unë!"

- "A ka ardhur Ahmedi?"

[24]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/37.
[25]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/410.

- "Kush është Ahmedi?", – iu përgjigja unë.

- "Ahmedi është i biri i Abdullah bin Abdulmutalibit! Ky është muaji që ai do të vijë, e ai është i fundmi i të gjithë profetëve. Nga mesi i Mekës ka për të dalë; pastaj, ai do të mërgojë drejt një toke pjellore në hurma, ku ka shumë gurë, me ujin dhe kripën të shumtë. Se mos e humbisni!"

Më prekën shumë ato fjalë që më tha ai murg. Dola nga Busra dhe kur u ktheva në Mekë, gjëja e parë që bëra ishte të pyesja:

- "Ka ndodhur ndonjë gjë e re?"

- "Po, ka ndodhur. Besniku, djali i Abdullahut, pretendon se është profet i Allahut. Madje këtë e beson edhe Ebu Bekri."

Unë dola të shkoja tek Ebu Bekri dhe e pyeta:

- "E vërtetë është që ti po e ndjek këtë njeri?"

- "Po! Shko dhe ti tek ai dhe shpalli besimin, sepse ai nuk po na fton veçse tek ajo që është më e drejta e më e vërteta."

Kur Talha bin Ubejdullahu i tregoi Ebu Bekrit të nderuar për ato ç'i pati thënë ai murg në Busra, ata shkuan bashkë te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Talhaja pranoi Islamin duke u bërë mysliman, pastaj, kur i tregoi të Dërguarit të Allahut për ato fjalë që i kishte thënë ai murg në panair, Profeti ynë u kënaq jashtëzakonisht shumë.

Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe Talhaja u bënë myslimanë, ata i kapi një njeri i quajtur Neufel bin Huvejlid, të cilin e thërrisnin ndryshe "luani i kurejshëve" dhe për të cilin i Dërguari i Allahut lutej kështu:

- "O Zot! Na ruaj ne nga e keqja e Ibnu'l-Adeuijes!", - i cili i lidhi ata me litar. As bijtë e Tejmit nuk e penguan. Andaj edhe Ebu Bekrit dhe Talhasë iu vu pseudonimi i përbashkët, "El-Karinejn", që do të thotë "të ngjiturit me njëri-tjetrin."[26]

[26]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/29.

Zubejr bin Auami përballet me gjithfarë vështirësish

Ebu'l-Esuedi transmeton: "Zubejr bin Auami ishte vetëm tetë vjeç kur u bë mysliman, ndërsa kur mbushi tetëmbëdhjetë, atij iu desh të mërgonte. Xhaxhai e pati mbështjellë Zubejrin me një qilim kashte dhe e mbante ndanë zjarrit, që ai të mohonte Islamin dhe të kthehej sërish në fenë e të parëve të tij. Ndërsa Zubejri vazhdimisht i përgjigjej:

- "Kurrë, nuk kam për ta mohuar kurrë!"[27]

Hafs bin Halidi na përcjell: "Një burrë i moshuar, që erdhi te ne nga Musulli, më pati thënë: Me Zubejr bin Auamin jemi bërë shok gjatë një rrugëtimi që kemi bërë bashkë. Ai kishte nevojë të lahej, pasi qe bërë xhunub në një vend të thatë e pa asnjë këmbë njeriu afër. Më tha mua:

- "Qëndro para meje, mbulomë, që të mos dukem." Unë e mbulova sa u la e u pastrua. Në një çast bishti i syrit pa nga trupi i tij; nuk kishte asnjë pjesë të trupit që të mos kishte shenja të të çarave me shpatë. "Uallahi, kaq shumë plagë shpate nuk kam parë ndonjëherë!", – i thashë.

- "I pe?", – më pyeti ai.

- "Po, t'i pashë!", – iu përgjigja unë.

- "Të betohem në Allahun e Madhërishëm se të gjitha ato plagë i kam marrë duke luftuar për Allahun, krah për krah me Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem)!"

Ndërsa, në një tjetër transmetim është treguar: "Ata që e kishin parë Zubejrin tregonin të gjithë. Në kraharor kishte thuajse pjesë të çara thellë nga shpatat, heshtat dhe shigjetat, të cilat qëndronin të dukshme, si të ishin zgavra sysh."[28]

Si e duronte trysninë e madhe që i ushtrohej Bilali (r.a.), myezini i Profetit tonë

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë: "Shtatë të parët që deklaruan

[27]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/406 (5547); Hejthemi, *Mexhmeu'ẕ-Zeuaid,* 9/212 (14833).
[28]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/90.

se ishin bërë myslimanë kanë qenë: Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Ebu Bekri, Amari, nëna e Amarit, Sumejeja, Suhejb Rumiu, Bilal Habeshiu dhe Mikdadi (radijallahu anhum)."

Duke qenë se të Dërguarin e Allahut e mbronte xhaxhai i tij, Ebu Talibi, ndërsa Ebu Bekrin e mbështeste fisi i tij, idhujtarët nuk u afroheshin dot atyre më shumë se sa dy e nga dy. Ndërsa, myslimanët e tjerë, ata i kapnin, u vishnin parzmore të hekurta dhe i linin ashtu, në nxehtësinë përvëluese të diellit të Mekës. Përveç Bilalit, të gjithë të tjerët patën bërë ashtu siç i patën kërkuar kurejshët. Vetëm Bilali e kishte vënë përfund egon e tij në rrugën e Allahut. Kurse fisi i tij, ngaqë nuk e vlerësonte edhe aq, e patën kapur dhe ia patën lënë fëmijëve në duar që të luanin me të si të donin. Ndërkohë që fëmijët e sorollatnin nga njëri sokak i Mekës në tjetrin, Bilali nuk thoshte asgjë tjetër, pos fjalëve: - "Ehad, Ehad, domethënë, Allahu është Një, i Vetëm! Allahu është Një, i Vetëm!"[29]

Megjithatë, në librin e Ebu Nuajmit do të gjejmë edhe disa të dhëna të tjera, të cilat po i paraqesim këtu: "Idhujtarët, Bilalit i kishin lidhur një litar pas qafe dhe e sillnin vërdallë ndërmjet dy maleve të Mekës."

Sipas transmetimit që i bën Urue bin Zubejri kësaj ndodhie, Bilali ishte skllavi i një gruaje nga fisi i bijve të Xhumahut. Ata e shtrinin Bilalin mbi rërën e nxehtë të drekës dhe e torturonin me çdo mënyrë, vetëm që ai t'i bënte shokë Allahut në krijimin dhe drejtimin e gjithësisë. Megjithatë, pavarësisht gjithë përpjekjeve të tyre, ai vazhdonte të thoshte: "Ehad! Ehad!" Ndërkohë që ai ishte në këtë gjendje, aty erdhi edhe Uaraka bin Neufeli, i cili i tha:

- "Ehad! Ehad! Thuaj o Bilal!", dhe shtoi:

- "Po e vratë këtë njeri, ta dini se varrin e tij do t'jua bëj përmendore!"[30]

Hisham bin Urueja na ka thënë se babai i tij ka transmetuar se: "Uaraka bin Neufeli vinte vazhdimisht te Bilali, i cili thoshte "Ehad! Ehad!", teksa e torturonin, dhe i tha atij: - "O Bilal, Ehad! Allahu është Një, i Vetëm!" Pastaj Uarakaja shkoi te Umejete bin Halefi që

[29]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/28.
[30]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 3/634.

ishte duke e torturuar dhe i tha:

- "Të betohem në Allahun, se po e vratë këtë njeri, varrin e tij do ta kthej në vend vizitash për njerëzit!"

Ndërsa një ditë tjetër, kur idhujtarët ishin duke torturuar Bilalin, pranë tyre erdhi Ebu Bekri, i cili i foli Umejes:

- "Nuk ke frikë nga Allahu, që sillesh kështu me atë të ngratë? Edhe për sa kohë do të vazhdoni ta torturoni?"

- "Po hajde shpëtoje ti, meqë ti ia more mendtë e kokës dhe e nxore nga rruga e drejtë!"

- "Unë kam një skllav me ngjyrë, që është më i bështëm dhe më i fuqishëm se ai. Veç kësaj, i përket edhe fesë sate. Hajde ta ndërrojmë me Bilalin, si thua?"

- "Në rregull, e pranoj.", – i tha Umejeja.

Ebu Bekri i dha atij skllavin e vet dhe me të marrë Bilalin, e shpalli atë të lirë nga ai çast e tutje. Numri i skllevërve që Ebu Bekri pati liruar ende pa mërguar për në Medinë, bashkë me Bilalin, arriti shtatë."

Ibni Is'haku përcjell: "Kur filloi vapa e padurueshme e drekës Umejeja e nxori Bilalin në shkretëtirë, e shtriu me shpinë mbi rërë dhe i vendosi një gur të madh mbi gjoks dhe i tha: - "Ose do të vuash kështu, derisa të të dalë shpirti, ose do të mohosh Muhamedin dhe do të adhurosh Latin dhe Uzza-n." Edhe pse përballë një torture të tillë, Bilali thoshte: - "Ehad! Ehad!.." Nuk hiqte dorë.

Amar bin Jasirit i kujtoheshin mjaft mirë vuajtjet që kishin hequr Bilali me shokët e tij, se si e pati liruar Ebu Bekri Bilalin dhe e përmendte atë vazhdimisht në vargje:

- "Zoti Bilalin dhe shokun e tij Atikun (Ebu Bekrin) i shpërbleftë me të mira! Mallkimin më të rëndë u dhëntë Fakih bin Mugires dhe Ebu Xhehlit. Një natë ata menduan t'i bënin diçka shumë të keqe Bilalit. T'i bënin diçka që nuk do t'i shkonte në mendje as më të ligut ndër njerëz. I vetmi faj që kish Bilali ish se besonte se Allahu ish Zoti i vetëm i mbarë njerëzimit dhe thoshte, "Zoti im është Allahu!" – "Të më vrasin po të duan; nga frika e vdekjes Mëshirëplotit shok s'i bëj!" - Ja se si lutej Bilali: "Shpëtomë mua, o Zoti i Ibrahimit, Junusit, Musait

dhe Isait! Mos më privo nga mirësia dhe drejtësia, mos më lër në dorë të ndërgjegjes së dinastisë së të zullumqarëve, që nuk dinë veçse të marrin kënaqësi prej padrejtësisë."[31]

Përballja me shumë vështirësi e Amarit (r.a.) dhe familjes së tij

Xhabiri (radijallahu anhu) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po kalonte pranë vendit ku kurejshët po torturonin Amarin dhe familjen e tij, kur i pa se ç'vuajtje po hiqnin, Ai u tha atyre:

- "Sihariqe për ju, o familja e Jasirit! Nuk ka dyshim, vendi i premtuar për ju është parajsa!"[32]

Osmani (radijallahu anhu) ka thënë: "Një ditë po ecnim bashkë me Profetin tonë në Bat'ha. Kur, ç'të shohim, Amarin, babanë dhe nënën e tij po i torturonin nën nxehtësinë përvëluese të diellit, që të ktheheshin prapë nga Islami. Babai i Amarit i tha atij ankueshëm:

- "O Resulullah, edhe për sa kohë do të vazhdojnë këto tortura?"

- "Bëni durim, o familja e Jasirit! Bëni durim.", – tha i Dërguari i Allahut, duke u lutur:

- "O Allah! Fale familjen e Jasirit! Shpresoj që t'i kesh falur edhe me kaq sa kanë vuajtur deri tani."[33]

Sipas një historie të përcjellë nga Muxhahidi, nëna e Amarit ka qenë dëshmorja e parë e Islamit. Ebu Xhehli e pati vrarë atë duke i ngulur një heshtë në trup."[34]

Si e torturonin Amarin (r.a.), që ai të kthehej sërish në mohim.

Ebu Ubejde bin Muhamed bin Amari transmeton: "Idhujtarët e kapën Amarin. Nuk do ta lëshonin, derisa ai të shante të Dërguarin e Allahut dhe të përmendte me përgëzim zotat e tyre. Kur Amari shkoi te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Profeti i profetëve i thoshte atij:

---

[31]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/148.
[32]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/432 (37369); Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/177.
[33]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/494 (37369); Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/177.
[34]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/59.

- "Çfarë ke lënë pas?"

- "Shumë të këqija, o Resulullah! Nuk më lanë të lirë pa të sharë ty, e pa përmendur me lëvdata zotat e tyre!", – iu përgjigj Amari.

- "Po në zemër si e ndjeve?", – vazhdoi ta pyesë i Dërguari ynë Fisnik.

- "Në zemër ndiej një besim të plotë dhe ndiej një qetësi shpirtërore që vështirë të ta shpjegoj dot!"

- "Nëse e bëjnë prapë diçka të tillë, atëherë vepro po njëlloj!", – i tha atëherë Profeti ynë."[35]

Muhamedi tregon: "Një ditë Profeti ynë u takua me Amarin dhe e gjeti atë duke qarë. I Dërguari i Allahut filloi t'i fshinte lotët Amarit, duke i thënë:

- "Mohuesit të zhytën në ujë, për të të mbytur, e ti u the kështu e ashtu. Po të bënë prapë të njëjtën gjë, ti përgjigju po njësoj!"

Sipas asaj që na e transmeton Amr bin Mejmuni, idhujtarët e patën vendosur Amar bin Jasirin në zjarr dhe donin ta digjnin. Profeti ynë i nderuar pati shkuar tek Amari, i pati përkëdhelur pak flokët dhe pati thënë:

- "*O zjarr! Bëhu i freskët dhe i paqtë edhe për Amarin, ashtu siç u bëre më parë edhe për Ibrahimin! Ty do të të vrasë një popull që e ka braktisur rrugën e drejtë.*"[36]

Durimi i Habab bin Eretit karshi torturave pa fund

Ebu Lejla el-Kindiu tregon: Habab bin Ereti (radijallahu anhu) pati ardhur tek Omeri (radijallahu anhu).

- "Afrohu! Në këtë kuvend, përveç Amar bin Jasirit, nuk ka njeri që ta meritojë më shumë të qenët këtu!", – i tha Omeri (radijallahu anhu).

Amari e hapi shpinën dhe u tregoi atyre gjurmët e plagëve që i kishin ngelur në trup nga torturat e idhujtarëve."[37]

Hababi (radijallahu anhu) tregon: "Unë isha hekurpunues. As bin

[35]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/140.
[36]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/177-178.
[37]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/353 (37026).

Uaili më kishte ca të holla borxh. Shkova që t'ia kërkoja dhe ai m'u përgjigj duke më thënë:

- "Jo! Uallahi, po nuk e mohove profetësinë e Muhamedit, ato para nuk kam për të t'i kthyer!"

- "Sikur ti të vdesësh, të ringjallesh prapë, unë nuk do ta mohoj kurrë Muhamedin!", – i thashë unë.

Dhe ai, sikur të donte të tallej me mua më tha:

- "Në rregull, kur të ringjallem pas vdekjes, eja tek unë, sepse atje do të jem edhe i pasur, do të kem edhe fëmijë! Atëherë do të ta paguaj borxhin!" Fill pas kësaj, Allahu i Madhërishëm zbriti këto ajete kur'anore:

"**A mos ndoshta ai di të padukshmen, apo ka marrë ndonjë premtim nga i Gjithëmëshirshmi? Kurrsesi! Ne do ta shënojmë në libër gjithçka që ai flet dhe do t'ia zgjasim vuajtjen. E gjithë pasuria dhe fëmijët që ai flet, do të na mbetet ne gjithçka, e ai do të vijë te ne i vetëm.**" (Merjem, 19/78-80)[38]

Habab bin Ereti (radijallahu anhu), gjithashtu, tregon se: "Një ditë kur idhujtarët po na torturonin mjaft rëndë, unë shkova te Profeti ynë. Trikon që kishte e kishte bërë jastëk dhe ishte shtrirë nën hijen e Qabes. Unë i fola:

- "Pse nuk i lutesh Allahut për ne?" U ngrit dhe qëndroi ulur. Fytyra i kishte marrë një ngjyrë të kuqe. Më tha kështu:

- "*Në mesin e popujve që erdhën përpara jush kishte njerëz të atillë, që ua hiqnin mishin nga eshtrat me krehra hekuri, ose që ua çanin deri edhe damarët, po prapë, asnjë torturë nuk i bënte të ktheheshin nga feja e tyre! Nuk ka dyshim, Allahu do ta përmbushë këtë mision. Do të vijë një kohë, që një kalorës nuk do të ketë frikë nga askush përveç Allahut, dhe ai do të mund të udhëtojë i qetë nga San'aja në Hadrameut. Vetëm se ju po nxitoheni pak!*"[39]

Ebu Dherr el-Gifari u bën ballë sa e sa vuajtjeve e torturave

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Ebu Dherri, kur dëgjoi se

[38]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 5/111 (21112).
[39]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/60.

ishte shfaqur i Dërguari i Allahut, i tha të vëllait: "Hipi asaj kafshe dhe shko në Mekë të takosh atë njeri që pretendon se është profet dhe se fjalët i vijnë nga qiejt. Na mblidh të dhëna, dëgjoja fjalët që thotë e bisedat që bën dhe kthehu shpejt tek unë!"

Vëllai i Ebu Dherrit (radijallahu anhu) shkoi në Mekë. Shkoi pranë Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i dëgjoi ato që thoshte ai, pastaj u kthye sërish pranë Ebu Dherrit (radijallahu anhu), të cilit i foli: "E pashë me sytë e mi, që ai ishte një njeri shumë i sjellshëm e i edukuar, dhe thoshte ca fjalë që nuk i ngjanin asnjë poezie që kam dëgjuar deri më tani." Atëherë, Ebu Dherri, që ia dëgjoi këto fjalë i tha të vëllait: "Nuk më ke prurë ato lajme që unë prisja, e që do të ma qetësonin e kënaqnin zemrën e shpirtin!", – kështu që mori ca ushqim për rrugë, një enë të vogël të vjetër me ujë dhe u nis për rrugë.

Kur mbërriti në Mekë, fillimisht shkoi në Xhaminë e Shenjtë. Zuri të kërkonte të Dërguarin e Allahut, të cilin nuk se e njihte si fytyrë. Por as të tjerët nuk donte që t'i pyeste. Kur ra nata, atij i erdhi gjumë, ndaj u shtri që ta kalonte natën aty, në Xhaminë e Shenjtë. Aliu (radijallahu anhu) e pa dhe e kuptoi se njeriu që po flinte aty atë natë ishte një i huaj. Shkoi ta ftonte në shtëpinë e vet, ftesë të cilën Ebu Dherri ia pranoi, kështu që e ndoqi nga pas Aliun (radijallahu anhu) e hynë në shtëpinë e tij. Që të dy, derisa agoi, nuk i bënë asnjë pyetje njëri-tjetrit, madje zëre se nuk folën asnjë fjalë. Ditën tjetër, Ebu Dherri mori torbën me ushqim që kishte me vete dhe mori rrugën për të kthyer sërish në Xhaminë e Shenjtë. Priti aty deri në mbrëmje, mirëpo prapë nuk e pa dot Profetin e profetëve. U tërhoq sërish në vendin ku kishte qëndruar shtrirë një natë më parë. Aliu (radijallahu anhu) shkoi prapë atje dhe tha me vete:

- "Po ky njeri akoma nuk e ka kuptuar se ku e ka vendin?" E kështu, e mori atë në shtëpi edhe atë natë. Edhe këtë natë nuk i bënë asnjë pyetje njëri-tjetrit. Më në fund, ditën e tretë Aliu (radijallahu anhu) shkoi tek Ebu Dherri dhe teksa po e merrte për ta çuar në shtëpi, e pyeti:

- "Nuk do të ma thuash se përse ke ardhur deri këtu?" Ebu Dherri iu përgjigj:

- "Nëse më jep fjalën se do të më ndihmosh për atë që kam ardhur, atëherë do të ta them." Dhe Aliu (radijallahu anhu) i dha fjalën se do ta ndihmonte, ndërsa Ebu Dherri i tregoi qëllimin për të cilin kishte ardhur.

- "Kjo është e vërtetë. Ai është i Dërguari i Allahut. Me të aguar hajde me mua. Kur të shkojmë, po hasëm në ndonjë vështirësi rrugës unë do të ta bëj me shenjë, do të bëj sikur po kryej nevojat. Kur të vazhdoj unë rrugën edhe ti eja pas meje, e hyr edhe ti aty ku do të hyj edhe unë.", – i tha Aliu (radijallahu anhu).

Ebu Dherri bëri ashtu siç i thanë, e ndoqi Aliun (radijallahu anhu) deri në fund. Kur Aliu (radijallahu anhu) shkoi tek i Dërguari i Allahut, bashkë me të hyri edhe Ebu Dherri. I dëgjoi fjalët e Resulullahut, duke u bërë sakaq mysliman. I Dërguari i Allahut e porositi atë:

- "*Shiko, Ebu Dherr, tani për tani këtë do ta mbash të fshehtë, nuk do t'ia tregosh askujt. Tani kthehu te njerëzit e tu dhe, kur të marrësh vesh se ne kemi filluar ta përhapim fenë haptazi, atëherë do të fillosh t'ua përhapësh atë edhe pjesëtarëve të familjes e të fisit.*" Ebu Dherri iu përgjigj:

- "Të betohem në Allahun e Madhërishëm se unë do ta gërthas me të madhe fjalën e dëshmisë së besimit mu përpara idhujtarëve me zë të lartë!"

Mandej doli nga i Dërguari i Allahut dhe shkoi në Qabe dhe me sa zë kishte në kokë, bërtiti:

- "Esh'hedu en la ilahe il'lallah ue esh'hedu enne Muhammeden Resulullah". Ata që gjendeshin aty u ngritën dhe e rrahën shumë keq. Erdhi Abasi menjëherë duke u bërtitur:

- "Turp t'ju vijë! Si e rrihni atë njeri, a nuk e dini që është nga Gifarët, tek ata që tregtarëve u bie gjithmonë rruga nga fshati i tyre kur shkojnë për në Damask.", - e sakaq e shpëtoi Ebu Dherrin nga duart e tyre.

Ditën tjetër, Ebu Dherri (radijallahu anhu) shkoi prapë në Xhaminë e Shenjtë dhe, në të njëjtën mënyrë e klithi prapë fjalën e dëshmisë. Idhujtarët e sulmuan prapë, duke e rrahur keqas. Ishte prapë Abasi që

e shpëtoi nga duart e tyre, duke e shpëtuar nga vdekja."[40]

I pari që e përshëndeti Profetin tonë sipas Islamit: Ebu Dherri

Te Muslimi historia e hyrjes së Ebu Dherrit në Islam paraqitet kështu: "Vëllai im iku, shkoi në Mekë. Kur u kthye, ai më tha mua:

- "Kur shkova në Mekë, u takova me një njeri. Njerëzit e quanin atë *të kthyer* (që ka braktisur fenë e të parëve). Ngjante shumë me ty." Unë ashtu udhëtova për në Mekë, nga ato që dëgjova nga vëllai im. Pashë një njeri që fliste për të.

- "Ku është ai që është konvertuar?", - i pyeta. Ai burrë më bërtiti me sa zë që kishte:

- "Ja ku është, ja ku është i konvertuari!", - duke ma treguar atë me dorë. Njerëzit filluan të më gjuanin me gurë. U leva i tëri në të kuqen e gjakut, ashtu siç lyhen gurët e kurbaneve, sepse nga i gjithë trupi kishte filluar të rridhte gjak. U futa mes murit të Qabes dhe mbulesës së saj dhe ndenja aty i fshehur për plot pesëmbëdhjetë ditë. Nuk kisha asgjë as për të pirë, as për të ngrënë, përveç ujit të Zemzemit. Derisa, një ditë, pashë që në Xhaminë e Shenjtë hyri Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) me Ebu Bekrin (radijallahu anhu).

Dhe si njeriu i parë, i cili ka përshëndetur me selamin e Islamit i thashë:

- "Es-selamu alejke ja Resulallah."

- "*Ue alejkumus-selam ue rahmetullah.*", - iu përgjigj ai selamit tim dhe më pyeti:

- "*Po ti, kush je?*"

- "Një njeri nga fisi i bijve të Gifarit!", - iu përgjigja unë.

- "O Resulullah, më lejoni, ta pres unë sot, në shtëpinë time, këtë mysafir!", - tha shkoku i tij, Ebu Bekri.

Ebu Bekri e çoi atë në shtëpinë e tij, e cila gjendej në zonën e poshtme të Mekës, ku më serviri një grusht rrushi të thatë.

Paskëtaj unë u ktheva te vëllai im dhe i thashë që isha bërë mysliman.

---

[40]. Buhari, *Sahih,* 3/1401 (3648).

Vëllai ma priti duke më thënë:

- "Atëherë, edhe unë do të hyj në fenë tënde." Pastaj shkuam te nëna. Nëna na tha:

- "Në fenë tuaj do të hyj edhe unë." Mandej, po njësoj, shkuam edhe te njerëzit tanë, për t'i ftuar edhe ata që të pranonin Islamin e të bëheshin myslimanë. Një pjesë e tyre pranuan dhe u bënë myslimanë."[41]

Durimi i Osman bin Madhunit ndaj vuajtjeve dhe vështirësive

Osman bin Madhuni, i cili mund të lëvizte lirshëm, pasi ishte nën mbrojtjen dhe garancinë e Uelid bin Mugires, kur pa vuajtjet dhe vështirësitë me të cilat po përballeshin i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij, tha me vete: "Uallahi, më vjen shumë turp, që ndërkohë që unë lëviz fare lirshëm me garancinë e atij njeriu, shokët dhe vëllezërit e fesë sime heqin kaq shumë vuajtje dhe vështirësi!" - kështu që u nis të shkonte te Uelid bin Mugireja, të cilit i tha:

- "Shiko, Ebu Abdi Shems! Unë kam ardhur të të them se nuk e dua më garancinë që më ke dhënë ti."

- "Po pse, nipi im? Mos të ka shqetësuar ndonjë nga pjesëtarët e fisit!"

- "Jo, nuk e dua mbështetjen tënde. Unë dua të jem në mbrojtjen e Allahut!"

- "Atëherë shko në Xhaminë e Shenjtë. Ashtu siç ta pata dhënë garancinë përpara të gjithëve, po para të gjithëve më duhet ta tërheq mbrapsht. Do të deklarosh para të gjithëve, se nuk e do më garancinë time."

Shkuam bashkë në Xhaminë e Shenjtë. Uelidi iu drejtua të pranishmëve:

- "O njerëz, Osmani nuk e do më mbrojtjen që unë i kam ofruar; do të ma kthejë mbrapsht."

- "Po, ashtu është, Uelidi ka të drejtë. Ai ka qenë gjithmonë fjalëdrejtë, e nuk mbaj mend ta ketë shkelur ndonjëherë fjalën. Vetëm

[41]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 7/127.

se unë nuk dua të kem asnjë mbrojtje tjetër, veç asaj që më ofron Zoti im, andaj edhe dua t'ia kthej mundësinë e tij për të më mbrojtur.", - tha Osmani.

Kur Osmani po kthehej, pa që në kuvendin e kurejshëve kishte ardhur Lebid bin Rabia, i cili po këndonte poezi për kurejshët. Shkoi edhe ai të ulej bashkë me ta. Lebidi tha:

- "Më dëgjoni me kujdes! Çdo gjë tjetër, pos Allahut, është kalimtare dhe e pavlerë." Një të dëgjuar këtë varg, Osmani i tha:

- "E vërtetë!"

- "Çdo e mirë, nuk ka dyshim, që një ditë do të na ikë nga duart!"

- "Nuk është e vërtetë!", - ndërhyri prapë Osmani.

- "Në parajsë të mirat do të vazhdojnë, madje do të jenë të përjetshme!"

- "O kurejshë! Uallahi, më përpara asnjë mysafir i juaji nuk bezdisej, që kur ka dalë ky adet i ri?"

- "Ky është një nga ata të marrët që kanë braktisur fenë e të parëve, mos ia vër re!", - iu përgjigj një prej atyre që ishin të pranishëm.

Kur Osmani i ktheu këtij burri përgjigje, sherri në mes tyre u përndez edhe më shumë. Ai njeri u ngrit dhe e goditi me grusht në sy Osmanin. Osmanit iu ënjt syri, duke u shndërruar shpejt në një ngjyrë mavi. Aty ishte i pranishëm edhe Uelid bin Mugireja, që po i shihte të gjitha çfarë po i bëheshin Osmanit.

- "Uallahi, o nipi im, më kot e plagose atë sy. A nuk të pëlqente që ishe nën mbrojtjen e një njeriu të fuqishëm!", - i tha atij Uelidi.

- "Të betohem për Allahun, se edhe syri tjetër ndien nevojë të plagoset si vëllai tjetër, në rrugën e Allahut. O Ebu Abdi Shems! Unë jam nën mbrojtjen e Dikujt që është shumë herë më i fuqishëm dhe shumë herë më i pushtetshëm se ti!", - dhe pasi tha këtë iu drejtua atij me vargjet e kësaj poezie:

"Nëse syri m'u dëmtua nga dora e dikujt që udhëzimin në rrugën e kënaqësisë së Allahut dot s'e ka gjetur, dyshimin fare s'e kam, që Allahu i Mëshirshëm mua shpërblimin një ditë do të ma japë. O njerëz, ai njeri, me të cilin Allahu mbetet i kënaqur, ai përjetësisht i lumtur

ka për të qenë! Edhe pse ju mund të thoni, 'Është kryengritës! Është budalla! Ka devijuar!', unë prapë fesë së Muhamedit do t'i përkas. Dhe me këtë pëlqimin hyjnor unë synoj. Sado padrejtësi që neve të na bëhet, sado cakun me ne ta kaloni, feja jonë nuk mund të jetë veçse feja e së vërtetës!"[42]

Durimi i Musab bin Umejrit karshi vështirësive

Muhamed el-Abderiu transmeton prej babait të tij: "Musab bin Umejri ishte një djalë i ri, i pashëm, të cilin e njihnin të gjithë, sepse kishte flokë shumë të bukur. Ishte një nga ata që e kishte zili dhe e tregonte me gisht e tërë Meka. Nënën e kishte shumë të pasur dhe ajo i blinte atij veshjet më të bukura e më të shtrenjta. Ndër të gjithë mekasit, Musabi lyhej me aromat më të mira, ndërsa këpucët që vishte ia porositnin nga Hadrameuti, sepse atje prodhoheshin më të mirat. Kur i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i përmendte atij këtë anë të jetës së tij, thoshte kështu: "Në Mekë nuk kam parë ndonjë njeri me flokë më të bukur, që vishte rrobat më të mira, e që i kishte gjithë të mirat si Musab bin Umejri!" Kur Musab bin Umejri dëgjoi se i Dërguari i Allahut po i ftonte njerëzit në Islam, nga shtëpia e Ibni Erkamit, shkoi menjëherë tek ai dhe i tha se donte të bëhej mysliman. E pati pranuar menjëherë, mirëpo e mbante të fshehtë, pasi e dinte se nëna dhe të afërmit e tjerë të fisit do të mërziteshin shumë dhe do të reagonin keq kur ta merrnin vesh. Edhe tek i Dërguari i Allahut fshehurazi shkonte. Një ditë atë e pati parë duke falur namaz Osman bin Talhaja dhe u pati thënë menjëherë nënës dhe të afërmve të tjerë të tij. Nëna dhe të afërmit, me të marrë vesh, e kapën dhe e izoluan. Izolimi i tij pati zgjatur deri në mërgimin e parë për në Abisini. Bashkë me myslimanët që emigruan në Abisini ishte edhe ai. Më vonë, që andej u kthye edhe ai. Kur u kthye dukej se ishte lodhur shumë dhe e pati humbur atë freskinë dhe tërheqjen e mëparshme që njerëzit e ndienin tek ai. Atëherë edhe nëna e tij hoqi dorë dhe nuk e qortoi më."[43]

[42]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/103.
[43]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/82.

Durimi i Abdullah bin Hudhafe es-Sehmiut ndaj torturave dhe torturat që i pati bërë atij sundimtari bizantin

Ebu Rafiu transmeton: "Omeri (radijallahu anhu) pati dërguar një ushtri kundër bizantinëve. Në ushtri bënte pjesë edhe njëri prej sahabëve të nderuar, i cili quhej Abdullah bin Hudhafe. Bizantinët e patën marrë peng dhe e patën çuar para mbretit të tyre dhe i thanë:

- "Ky është nga shokët e Muhamedit!" Sundimtari zullumqar e pyeti atë:

- "A do të bëheshe i krishterë, nëse unë të bëja edhe ty mbret e ortak në gjithë pasurinë time?"

- "Sikur, jo vetëm në pasurinë tënde, por edhe gjithë salltanetin e mbarë arabëve t'i shtosh asaj, e të m'i japësh mua të gjitha, unë nuk do të hiqja dorë nga feja e Muhamedit qoftë edhe për një të hapur e të mbyllur të qepallave të syve!"

- "Meqë nuk pranon, atëherë unë do të të vras!", - i tha mbreti.

- "Ti mund të vendosësh të bësh ç'të duash me mua!", - iu përgjigj Abdullahu.

Mbreti dha urdhër që ta kryqëzonin Abdullahun dhe u tha shigjetarëve:

- "Tani gjuajeni nga duart dhe këmbët!" Gjatë gjithë torturës ai e pyeste, nëse kishte ndërruar mendje dhe pranonte të bëhej i krishterë, apo jo, mirëpo ai nuk pranonte. Në fund u dha urdhër ushtarëve të tij dhe e zbritën nga kryqi. Kërkoi të binin një kazan të madh me ujë, të cilin e vunë të ziente nën një zjarr shumë të madh. Thirri dy myslimanë nga ata që ishin zënë robër dhe u propozoi edhe atyre që të bëheshin të krishterë. Kur nuk pranuan as ata, ai dha urdhër që t'i hidhnin në ujë të valuar. Kësaj here sundimtari dha urdhër që në kazan të hidhnin edhe Abdullah bin Hudhafetu's-Sehmiun. Abdullahu, kur e prunë po qante. Sundimtari, duke pandehur se atë e kishte zënë frika, u urdhëroi ushtarëve:

- "Ma bini pranë!" Kur ia prunë afër, mbreti i propozoi atij sërish të bëhej i krishterë. Abdullahu nuk pranoi as këtë herë.

- "Atëherë pse fillove të qash?", - e pyeti mbreti.

- "I thashë vetes, edhe pak dhe do të të hedhin në këtë kazan, e pas pak do të vdesësh. Do të doja të kisha jetë sa qimet që kam në trup, e të mund t'i sakrifikoja të gjitha kështu, duke i hedhur në kazan me ujë të valuar!", - u përgjigj Abdullahu (radijallahu anhu).

Kësaj here sundimtari e ndryshoi propozimin, duke i thënë:

- "Nëse pranon të puthësh kokën time, atëherë do të lë të lirë."

- "Do të ta puth kokën vetëm nëse do t'i lësh të lirë edhe robërit e tjerë myslimanë!"

- "Në rregull, e pranoj. Do t'i lë edhe ata të lirë bashkë me ty!"

Abdullahu tregonte se: "Me vete thashë: 'Ky njeri është një nga armiqtë më të paepur të Allahut. Më mirë t'i puth kokën dhe t'i lërë të lirë të gjithë myslimanët e tjerë; asgjë nuk humb nga kaq gjë!"

Abdullahu u afrua dhe e puthi sundimtarin në kokë. Edhe ai menjëherë i dorëzoi të gjithë robërit e luftës. Abdullahu i çoi ata të gjithë në Medinë. Lajmëroi Omerin (radijallahu anhu) për të gjitha ç'kishin ndodhur. Omeri (radijallahu anhu)i tha:

- "Tani të gjithë myslimanët e kanë për detyrë që të puthin kokën e Abdullah bin Hudhafes: po ia filloj unë i pari!", - u çua dhe e puthi Abdullahun në kokë.[44]

3. SAHABËT I BËNIN BALLË ÇDO VËSHTIRËSIE

Said bin Xhubejri transmeton: "E pyeta Ibni Abasin (radijallahu anhu): "A i torturonin idhujtarët sahabët e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), derisa ata të hynin në gradën "ma'dhur – i justifikuar", vetëm që ata ta pranonin së paku me gojë se kishin mohuar besimin e tyre?"

Ibni Abasi i pati dhënë këtë përgjigje:

- "Po, uallahi! Kur e kapnin një mysliman, aq shumë e rrihnin atë, e linin të etur e të uritur, saqë i detyronin myslimanët që të pranonin të thoshin fjalën e mohimit, për të shpëtuar nga vuajtjet e padurueshme që u shkaktoheshin. Madje, kur qëllonte ta pyesnin ndonjërin, 'A ka zot tjetër veç zotave të Latit dhe Uzza-s?', ata mund të thoshin edhe

[44]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/297.

'po'. U tregonin atyre insektet që mund të gjendeshin aty në atë kohë dhe i pyesnin: - "Kush është zoti yt, këto insekte?" Dhe ata, për të shpëtuar nga ato tortura, qoftë edhe përkohësisht, mund të thoshin 'po'."[45]

Gjendja e Profetit të nderuar dhe e sahabëve të tij pas mërgimit

Ubej bin Kabi (radijallahu anhu) ka thënë: "Pasi i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij erdhën në Medinë, dhe ensarët morën përsipër përkujdesjen dhe mbrojtjen e tyre, atëherë të gjithë mosbesimtarët arabë mblodhën forcat kundër tyre. Për këtë arsye myslimanët i mbanin gjithmonë pranë armët e tyre, nga mëngjesi deri në darkë. Madje, kur myslimanët filluan të thoshin: "Ju po e shihni se si po jetojmë që të ngrysemi të qetë e të sigurt! Megjithatë ne nuk i trembemi dhe nuk kemi frikë prej askujt përveç Allahut!", - për ta zbriti ajeti:

"**Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë** (në adhurim)**. Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë** (besimin)**, pikërisht ata janë të mbrapshtët.**" (Nur, 24/55)[46]

Vështirësitë e Profetit të nderuar dhe sahabëve të tij në betejën e Dhatu'r-Rikasë

Ebu Musai (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Ne ishim nisur në një ekspeditë luftarake bashkë me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ishim gjashtë vetë. Me vete kishim edhe një deve, tek e cila hipnim me radhë. Nga të ecurit, këmbët na ishin bërë plagë. Mua më ishin shpuar të dyja këmbët dhe kishin filluar të më binin thonjtë. Për këtë, ne i lidhnim këmbët me copa të ndryshme, që të mos ndienim aq shumë dhimbjen e plagëve. Prandaj edhe ajo luftë mori këtë emër, *Dhatu'r-Rika*, që do të thotë 'të arnuarit'."[47]

[45]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/59.
[46]. El-Hakim, *Mustedrek,* 2/434 (3512).
[47]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/260.

4. TË DURUARIT E URISË GJATË THIRRJES SË NJERËZVE PËR T'U BËRË MYSLIMANË

Si e duronte urinë Profeti ynë

Numan bin Beshiri (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Ju hani çfarë t'ju dojë goja të hani, apo jo? Ju betohem në Allahun e Madhërishëm, që unë mbaj mend edhe ditët kur i Dërguari Fisnik, Profeti ynë i dashur, nuk gjente dot as edhe një hurmë të vetme, qoftë edhe të prishur, për të hequr disi urinë."[48]

Ata që kanë vuajtur nga uria nuk do ta kenë të vështirë llogaridhënien

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: "Kur hyra te Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Ai ishte duke falur namazin ulur.

- "O Resulullah, po e fal namazin ulur, çfarë ke, je sëmurë?", - e pyeta.

- "*Nga uria, o Ebu Hurejre!*", - m'u përgjigj ai.

Më pushtuan lotët. I Dërguari i Allahut më pa dhe më tha:

- "*Mos qaj, o Ebu Hurejre! Ata që vuajnë nga uria, duke e pritur shpërblimin vetëm se nga Allahu, nuk do ta kenë të vështirë dhënien e llogarisë në ditën e Kiametit.*"[49]

Shpeshherë në shtëpinë e Profetit tonë nuk ndizej fare kandili dhe nuk ndizej zjarri në vatër

Urueja (radijallahu anhu) na transmeton se tezja e tij, Aishja (radijallahu anha), i ka thënë: "Uallahi, o nip; shpeshherë ne shihnim hënën e parë, hënën e dytë, domethënë shihnim tri hëna në dy muaj dhe në asnjë nga shtëpitë e bashkëshorteve të Profetit nuk ndizej fare oxhaku dhe nuk vihej asgjë për t'u gatuar.

---

[48]. Muslim, *Sahih,* 4/2285 (2978).
[49]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/348 (18628).

- "Po si jetonit ju ashtu, teze?", - e pyeta unë.

Aishja (radijallahu anha) m'u përgjigj duke më thënë: "Me dy të flamosura; domethënë me ujë dhe hurma! Por i Dërguari i Allahut kishte disa fqinj ensarë. U merrte atyre borxh nga pak qumësht nga devetë e tyre dhe ata i jepnin gjithmonë të Dërguarit të Allahut. Ai na jepte edhe neve të pinim prej atij qumështi."[50]

Mesruku tregon: "Një ditë shkova tek Aishja (radijallahu anha). Më nxori për të ngrënë dhe më tha: "Mua, sa herë që ha derisa ngopem, më vjen për të qarë."

- "Po pse të vjen për të qarë?", - e pyeta unë.

- "Në atë çast më kujtohet menjëherë gjendja e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), në çastet e fundit, para se të largohej nga kjo botë. Uallahi, Ai kurrë nuk i ka pasur dy herë rresht edhe bukën edhe mishin njëkohësisht, që të ndihej i ngopur!", - më tha nëna jonë e nderuar."[51]

Po Aishja (radijallahu anha) tregon se: "Pjesëtarët e shtëpisë së Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), nuk janë ngopur dot kurrë me bukë elbi."

Aishja (radijallahu anha) gjithashtu thotë se: "Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), mërgoi për në atdheun e amshimit pa u ngopur barkun e tij, pasi nuk kishte ngrënë asgjë veçse dy hurma që i thoshin të zeza dhe pak ujë."[52]

Nëna jonë Aishja (radijallahu anha) thotë se: "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka pasur herë që nuk ka ngrënë dot as bukë thatë, sa për t'u ngopur, për tri ditë me radhë. Po të donim, edhe ne mund të kishim ngrënë, por ai zgjidhte gjithmonë të tjerët para vetes dhe familjes."[53]

---

[50]. Buhari, *Sahih,* 2/907 (2428).
[51]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 4/579 (2356).
[52]. Tirmidhi, *Sunen,* 4/579 (2356).
[53]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/340 (18605).

Vështirësitë ekonomike të Profetit tonë për të mbajtur familjen

Hasani (radijallahu anhu) ka thënë kështu: Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i ndihmonte vetë njerëzit, ndërsa rrobat e veta i mbante gjithmonë të arnuara, duke i arnuar sa herë që i griseshin në ndonjë vend. Derisa shkoi pranë Krijuesit Mëshirëplotë. Ai nuk ka ngrënë kurrë edhe në mëngjes edhe në darkë për tri ditë rresht. Domethënë, nëse ka ngrënë në mëngjes, nuk ka ngrënë në darkë, dhe, nëse qëllonte që të hante në darkë, nuk hante në mëngjes."[54]

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk ka ngrënë kurrë në tavolinë të lartë. As nga buka e bërë me miellin e butë të grurit nuk pati ngrënë kurrë, përgjatë gjithë jetës së tij." Ndërsa, në një transmetim tjetër shtohet edhe se: "I Dërguari i Allahut, deri kur vdiq, nuk e ka parë kurrë një dele të plotë të pjekur të shtruar në një tavolinë për të gjithë."[55]

Ibni Abasi (radijallahu anhu) thotë: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe pjesëtarët e familjes së tij, duke qenë se nuk kishin asgjë për të ngrënë në darkë, shumë herë kanë rënë të flenë pa vënë asgjë në gojë. Buka që hanin zakonisht ishte bukë elbi."[56]

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: "Një ditë, Fatimja (radijallahu anha) i dha babait të saj, Krenarisë së Gjithësisë, një copë buke elbi. I Dërguari i Allahut i tha Fatimes:

- "*U bënë tri ditë dhe kjo është copa e parë e bukës që babai yt po vë në gojë.*"[57]

Kurse Taberani e ka përcjellë kështu këtë hadith: "Njëherë, kur Fatimja (radijallahu anha) i pati sjellë një copë bukë elbi babait të saj, Profeti ynë e pyeti:

- "*Ç'është ajo?*"

- "Kam pjekur një bukë të rrumbullakët. Nuk u ndjeva mirë, ndaj erdha të ta sjell ty këtë copë.", - iu përgjigj Fatimja (radijallahu anha).

---

[54]. Mundhiri, *et-Tergib,* 4/94 (4954).
[55]. Buhari, *Sahih,* 5/2369 (6085).
[56]. Ibn Haxher, *Fet'hu'l-Bari,* 11/293 (6094).
[57]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 3/213 (13246).

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) thotë se: "Një ditë Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem hëngri një copë buke të ngrohtë, të cilën ia patën sjellë, tha: '*Elhamdulil'lah! Ishte bërë goxha kohë që në stomakun tim nuk hynte bukë e ngrohtë!*"[58]

Ja se çfarë thotë Sehl bin Sadi (radijallahu anhu): "Që prej asaj dite, kur iu ngarkua misioni i profetësisë, e derisa u rikthye te Zoti, i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk pa kurrë bukë të bërë me miell të pastër e pa krunde."

- "A kishte sita të imëta në kohën e Resulullahut?", - e patën pyetur.

- "I Dërguari i Allahut nuk ka parë kurrë sitë me sy, që prej ditës kur ai u dërgua si Profet i Allahut, e deri në ditën kur shpirti iu mor për t'u rikthyer tek Allahu i Madhërishëm."

Më thanë:

- "Po mirë, si e hanit elbin e pasitur mirë?"

Ai iu përgjigj:

- "Ne e rrihnim elbin mirë e mirë, ato që shkonin dëm shkonin dëm, ndërsa pjesës tjetër i hidhnim ujë dhe e bënim brumë."[59]

Aishja (radijallahu anha) thoshte se: "Në sofrën e të Dërguarit Bujar nuk mbetej asnjë copë e madhe a e vogël buke prej elbi." Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet kështu: "Asnjë sofër e të Dërguarit të Allahut nuk është ngritur, duke hequr copat e mbetura dhe thërrimet e bukës."[60]

Kur i Dërguari Fisnik dhe sahabët e tij lidhnin gurë pas barkut, që të mos e ndienin urinë

Ebu Talhaja (radijallahu anhu) tregon: "Ne i qamë hallin të Dërguarit të Allahut, duke i thënë se ishim shumë të uritur. Madje ngritëm edhe rrobat, për t'i treguar atij gurët që kishim lidhur pas barkut që të mos e ndienim urinë. Ai na pa, pastaj ngriti edhe ai rrobën e vet. Ç'të shihnim:

---

[58]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 6/52.
[59]. Buhari, *Sahih,* 5/2066 (5097).
[60]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Ëusat,* 1/273 (891).

Ai nuk kishte lidhur një, por dy gurë pas barkut!"[61]

Ibni Buxhejri (radijallahu anhu) tregon: "Një ditë Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e kishte marrë shumë uria, (nuk kishte gjetur dot asgjë për të ngrënë), pati marrë një gur dhe e kishte lidhur pas barkut dhe u kishte thënë kështu:

- *"Dëgjojini fjalët e mia me kujdes: Ka aq shumë njerëz nëpër botë, të cilët notojnë mbi të mira e mund të hanë e të pinë çfarë të duan; në ditën e Kiametit ata do të jenë të uritur dhe pa asnjë rrobë në trup! Më dëgjoni mirë! Shumë prej atyre që mendojnë se janë duke u bërë një të mirë vetes së tyre, në të vërtetë janë duke i bërë asaj keq. Nga ana tjetër, ka shumë njerëz që nuk u japin shumë rëndësi dëshirave dhe kërkesave të tyre vetjake, që në fakt janë duke i bërë vetes një të mirë shumë të madhe."*[62]

Fjalët e Aishes (radijallahu anha) lidhur me të ngopurit me ushqim kanë qenë këto: "Pasi Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati mërguar drejt ahiretit, fatkeqësia e parë me të cilën do të përballet ky umet ka për të qenë fatkeqësia e të qenët të ngopur. Kur barku i myslimanëve u ngop dhe trupi i tyre zuri të dhjamoset, jeta e tyre e zemrës u dobësua, ndërsa epshi u tërbua!"[63]

Orvatjet e Profetit të mëshirës, bashkë me të të familjes së tij, të Ebu Bekrit (r.a.) dhe Omerit (r.a.) nga uria

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: Një mesditë shumë të nxehtë, Ebu Bekri doli nga shtëpia, për të shkuar në Xhaminë e Profetit. Omeri, kur dëgjoi se kishte ardhur Ebu Bekri, e pyeti atë:

- "O Ebu Bekr, çfarë kërkon jashtë në këtë orë?"

- "Nuk e durova dot më urinë, dola me shpresën se mos arrij të gjej ndonjë gjë për të futur në gojë!", - iu përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).

- "Uallahi, edhe unë prandaj kam dalë, o Ebu Bekr!", - i tha Omeri.

Ndërkohë që ata flisnin kështu me njëri-tjetrin, aty ia behu Profeti

---

61. Mundhiri, *et-Tergib,* 4/96 (4964).
62. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 15/1335 (43502).
63. Mundhiri, *et-Tergib,* 3/100 (3239).

ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe u tha:

- *"Çfarë ju ka shtyrë të dilni jashtë në këtë orë?"*

- "Uallahi, na ka marrë jashtëzakonisht shumë uria!"

- "*Uallahi, edhe unë prandaj kam dalë, nuk kam asnjë arsye tjetër! Hajde, çohuni të ikim.*", - tha i Dërguari i Allahut. U çuan dhe shkuan te porta e shtëpisë së Ebu Ejub el-Ensarit. Ebu Ejubi ndante përditë ushqim ose qumësht mënjanë për të Dërguarin e Allahut. Duke qenë se i Dërguari i Allahut nuk kishte shkuar në kohën që shkonte si zakonisht, ai ua kishte dhënë fëmijëve, ndërsa vetë kishte shkuar të punonte bahçen e hurmave. Kur trokitën te porta, para u doli e shoqja e Ebu Ejubit, e cila u tha:

- "Mirë se keni ardhur, o Profeti i Allahut dhe ju o shokët e tij!"

- *"Ku është Ebu Ejubi?"*, - e pyeti atë i Dërguari i Allahut. Ebu Ejubi e dëgjoi ardhjen e tyre, kështu që mbërriti menjëherë nga kopshti i hurmave ku po punonte.

- "Mirë se keni ardhur, o i Dashuri i Allahut dhe ju shokët e tij! Sot nuk ke ardhur si ditët e tjera, o i Dërguari i Allahut, qoftë për hair!"

- "Ke të drejtë, o Ebu Ejub, - i tha Resulullahu, - ke të drejtë."

Ebu Ejjubi shkoi menjëherë këputi një degë hurmash, në të cilën kishte hurma të thara, të njoma dhe disa që ishin ende të pabëra dhe ua solli atyre."

- "*Po unë nuk të kërkova këtë, sikur të na kisha mbledhur ca hurma të thara, do të kishe bërë mirë.*", - i tha i Dërguari i Allahut.

- "O i Dërguari i Allahut, po unë desha që të hanit nga të gjitha. Veç këtyre do të ther edhe një kafshë për ty."

- "Po there, mos ther nga ato që i ke me qumësht!", - e porositi i Dërguari i Allahut.

Ebu Ejubi kapi një kec femër që ende nuk i kishte mbushur dy vjetët, ndërsa sipas një transmetimi tjetër ai thonë se ka prerë një kec mashkull njëvjeçar. Kurse gruas i tha:

- "Bëj gati brumin, të na pjekësh një bukë të mirë!"

Gjysmën e kecit e zjeu, ndërsa gjysmën tjetër ua gatoi të pjekur.

Kur i tërë ai ushqim iu vu përpara të Dashurit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe shokëve të tij, i Dërguari i Allahut mori pak nga mishi i kecit, e vuri mbi një copë buke dhe i tha Ebu Ejjubit:

- "*Ebu Ejjub, merre këtë dhe çoja vajzës sime, Fatimes, të lutem. U bënë sa ditë që nuk ka ngrënë diçka kaq të mirë.*"

Dhe ai e mori atë dhe ia çoi Fatimes. Pasi kishin ngrënë dhe e kishin ngopur barkun Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Bukë, mish, hurma të thata, hurma të njoma dhe hurma të pjekura!*" Sytë i ishin mbushur me lot, kur tha:

- "*Ju betohem për Zotin, në ditën e Kiametit, do t'ju pyesin e do të jepni llogari për gjithë këto të mira!*" Kjo fjalë u erdhi shumë e rëndë sahabëve të tij, ndaj ai u tha:

- "*Kur t'ju jepen kaq shumë të mira, e t'i prekni me dorë, të thoni njëherë 'Bismil'lah'. Dhe, kur të ngopeni, thoni: 'Lëvduar qoftë Allahu, që na ngopi, na fali kaq të mira, madje edhe me tepri.*" Nëse e lëvdoni kështu, atëherë kjo është e mjaftueshme për ju."

Kur i Dërguari i Allahut u ngrit në këmbë, ai i tha Ebu Ejubit:

- "*Nesër eja nga ne!*" E kishte zakon, që atij që i bënte një të mirë Profetit tonë, ai donte medoemos që t'ia shpërblente në një mënyrë, apo në një tjetër. Ebu Ejubi nuk e dëgjoi fjalën e të Dërguarit të Allahut, ndaj Omeri (radijallahu anhu) i tha edhe njëherë:

- "Resulullahu do, që nesër t'i shkosh ti për vizitë."

Ditën tjetër, kur Ebu Ejubi shkoi tek i Dërguari i Allahut, ai i dhuroi atij një *xharije* - robinjë dhe i tha:

- "*Shiko, o Ebu Ejub, sillu mirë me të; nuk kemi parë veçse mirë prej saj për aq kohë sa ka qëndruar me ne!*"

Ebu Ejubi e mori *xharijen* dhe e çoi në shtëpi, por me vete tha:

- "Unë kështillën e të Dërguarit të Allahut më së miri mund ta plotësoj vetëm nëse i fal lirinë kësaj robinje.", - dhe sakaq e shpalli atë menjëherë të lirë.[64]

---

[64]. Ibn Hibban, *Sahih* 12/16 (5216). Taberani, në veprën e tij "*Mu'xhemu'l-Kebir*", na përcjell, se i Dërguari i Allahut, bashkë me Ebu Bekrin dhe Omerin, kanë shkuar njëherë edhe në shtëpinë e Ebu'l-Hejthem bin et-Tejjihan el-Ensarit.

Profeti ynë këshillon Umu Sulejmin, që ajo të bëjë durim

Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i ka thënë kështu Umu Sulejmit:

- "*Bëj durim! Të betohem në Allahun e Madhërishëm, se në shtëpinë e Muhamedit ka plot një javë që nuk ka asgjë për të ngrënë. Ka tri ditë që nuk është ndezur zjarr poshtë kazanëve të gjellës! Uallahi, po t'i kërkoja Allahut të m'i kthente në flori këto malet e Mekës, ai do të ma plotësonte lutjen!*"[65]

Vuajtja e Sad bin Ebi Uekasit (r.a.) nga uria

Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) thotë se: "Ne ishim një bashkësi, që bashkë me të Dërguarin e Allahut, kishim shumë vështirësi ekonomike. As familjen nuk arrinim që ta mbanim dot. E kishim pranuar të keqen e varfërisë, sepse tashmë ishim mësuar me të. Më kujtohen mjaft mirë ato ditë aq të vështira që kemi kaluar bashkë me të Dërguarin e Allahut: Një natë, dola jashtë për të urinuar, kur se çfarë preka nga toka. E pashë se çfarë ishte; ishte një copë lëkure deveje e tharë dhe e përzhitur! E mora dhe e lava mirë e mirë. E mbajta për njëfarë kohe në zjarr dhe e vura në mes dy gurësh. Vura në gojë një copë nga ajo lëkurë dhe u përpoqa ta shtyja me ujë. Pata shtyrë plot tri ditë të tëra me atë copë lëkure."[66]

Tregon Sad bin Ebi Uekasi: "Në rrugën e Allahut, arabi i parë që ka gjuajtur me shigjetë kam qenë unë. Bashkë me Profetin e profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) patëm dalë për të zhvilluar një ekspeditë ushtarake. Nuk kishim asgjë të hanim me vete, përveç ca frutave dhe gjetheve të bimës së hulbas (sanëza). Andaj edhe nevojat natyrore i kryenim njëlloj si gjedhët."[67]

Mikdad bin Esuedi (r.a.) dhe dy shokët e tij mbeten të uritur

Mikdad bin Esuedi tregon: Aq shumë na kishte marrë uria njëherë, sa që na dukej sikur nga çasti në çast do t'i humbnim, si shikimin,

---

[65]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/350 (18635).
[66]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/93.
[67]. Buhari, *Sahih,* 5/2371 (6088).

edhe dëgjimin, andaj, bashkë me dy shokë, u nisëm për te sahabët e të Dërguarit të Allahut. Mirëpo askush nuk na priti si mysafirë. Më në fund, Profeti i profetëve na çoi ne në vendin ku qëndronte edhe vetë. Në atë kohë, Familja e Bekuar kishin gjithsej vetëm tri dhi, të cilat i mbanin për qumësht. I Dërguari Fisnik na e ndau ne qumështin e mjelë prej tyre dhe ne i ndanim edhe atij pjesën e vet, që ta pinte kur të kthehej pranë nesh. Kur vinte na përshëndeste me një zë aq të ulët, sa që ata që ishin zgjuar mund ta dëgjonin, kurse ata që flinin nuk do të zgjoheshin nga ai zë. Një ditë shejtani më tha:

- "Çfarë do të ndodhë po pive pak më shumë! Profeti mund të shkojë tek Ensarët dhe ata mund ta gostitin me gjëra nga më të mirat." Kjo vesvese ma ngacmoi për një kohë bajagi të gjatë mendjen. Nuk durova dot dhe e piva. Mirëpo, kur e piva atë qumësht, atëherë filloi të më ngacmojë njëfarë ndjenje pendese:

- "Çfarë bëre? Tani do të vijë Muhamedi dhe kur të mos e gjejë qumështin do të të mallkojë, kështu që hajde të shpëtosh tani nga e keqja!" Dy shokët e mi kishin pirë qumështin dhe i kishte zënë gjumi. Kurse mua nuk më zinte që nuk më zinte gjumi. Sipër kisha hedhur një mbulesë që e pata marrë me vete, që kur mbuloja kokën më dilnin këmbët, ndërsa kur mbuloja këmbët, më zbulohej koka. Në atë moment erdhi i Dërguari i Allahut si gjithmonë dhe fali namaz për një kohë të gjatë. Pastaj nisi të kërkonte qumështin. Nuk e gjeti dhe kur nuk e gjeti, ngriti duart. Unë me vete mendova:

- "Tani do jetë duke më mallkuar, nuk e kam të gjatë, sepse do të më ndëshkojë Allahu." I Dërguari i Allahut u lut:

- "*Zoti im! Ngope atë që më ngop mua dhe jepi të pijë kujtdo që më jep mua për të pirë.*" Një t'i dëgjuar ato fjalë, e hodha tutje mbulojën time dhe siç e mora thikën time me gojë të gjerë shkova sa hap e mbyll sytë në kasollen e dhive. Doja të therja atë që ishte më e majmura. Por ç'të shihja, gjinjtë e dhive ishin plot me qumësht. Mora enën që përdorte familja e Profetit tonë për të mjelë ato dhi dhe nisa t'i milja. Qumështi u mbulua me shkumë. E mora atë qumësht dhe ia çova ta pinte i Dërguari i Allahut. Piu sa piu dhe më dha edhe mua të pija. Piva edhe unë. Më vonë kam qeshur aq shumë me këtë ndodhi, sa që e kam të

vështirë t'jua përshkruaj! Ai më tha mua:

- "*O Mikdad, bëj kujdes me pjesët e trupit, se të janë zbuluar!*" Unë përpiqesha t'i shpjegoja çfarë më kishte ndodhur. I Dërguari Fisnik ma priti me fjalët:

- "*Kjo është mëshira e Allahut. Sikur t'i kishe zgjuar edhe shokët dhe të kishin pirë edhe ata pjesën e tyre nga ai qumësht!*"

- "Unë të betohem në Allahun që të ka dërguar ty me fenë e vërtetë, se tani që ti pive dhe prej asaj që mbeti prej teje piva edhe unë, nuk mërzitem fare që i harrova shokët!"[68]

Nga uria, Ebu Hurejreja lidh gur pas barkut

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: "Uallahi, nga uria shtrihesha përmbys përdhe dhe lidhja një gur pas barkut. Një ditë, shkova dhe u ula në një vend ku kalonin të gjithë. Aty kaloi edhe Ebu Bekri (radijallahu anhu). Me shpresën se do të më merrte me vete dhe do të më priste në shtëpinë e tij, e pyeta për një ajet; po nuk më mori me vete. Pastaj kaloi Omeri (radijallahu anhu). Edhe atij i bëra një pyetje për një ajet nga libri i Allahut, por me të njëjtin qëllim. As ai nuk më ftoi në shtëpinë e tij. Kur, sakaq aty kaloi edhe i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ai më kuptoi nga çehrja se çfarë bluaja përbrenda, ndaj më tha:

- "*Ebu Hurejre!*"

- "Urdhëro, o Resulullah!", - iu përgjigja unë.

- "*Eja me mua, ikim!*"

Kur mbërritëm në shtëpinë e tij, i kërkova leje për të hyrë brenda; më lejoi. Gjeta një gotë me qumësht.

- "*Po ky qumësht nga doli?*", - pyeti i Dërguari i Allahut.

- "E pruri filani si dhuratë.", - i thanë.

- "*O Eba Hirr!*", - më foli ai mua.

- "Urdhëro, o i Dërguari i Allahut!"

- "*Shko thirr edhe popullin e Suffes të vijnë këtu.*"

[68]. Muslim, *Sahih,* 3/1325 (2055).

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) thotë se:

- "Sahabët e Suffes ishin mysafirët e tij. Nuk kishin as fëmijë, as pasuri. Sa herë që Profetit tonë i vinte ndonjë gjë dhuratë, Profeti ynë e ndante mënjanë një pjesë për veten, ndërsa gjithë pjesën tjetër ua dërgonte atyre. Edhe kur vinte ndonjë sadaka, ai ua dërgonte të gjithën sahabëve të Sufes, duke mos prekur vetë asfare me dorë. U mërzita shumë që Resulullahu më dërgoi të thërrisja edhe ata. Pata shpresuar se mos atë qumësht ma jepte ta pija unë dhe do të mund ta kaloja i qetë pjesën e mbetur të ditës dhe natën që kishim përpara. Me vete thashë:

- "Unë lajmës jam, kur të vijë i tërë xhemati, për mua nuk do të mbetet fare qumësht. Megjithatë më duhet të bëj ashtu siç më thotë i Dërguari i Allahut, t'i bindem deri më një Allahut dhe të Dërguarit të Tij!" Kështu që shkova te sahabët e Sufes dhe i ftova në emër të të Dërguarit të Allahut. Ata erdhën me mua dhe kur mbërritëm, kërkuan leje për të hyrë brenda; iu dha leje dhe ata hynë e u ulën në vendet e tyre. Pastaj, i Dërguari i Allahut më tha mua:

- "*O Eba Hirr, merre atë gotë me qumësht dhe jepua atyre!*" Dhe unë e mora gotën dhe fillova t'ua çoja të gjithëve një e nga një. Ai që i jepja gotën në dorë, pinte, pastaj ma kthente sërish mua. Në këtë mënyrë unë u dhashë të gjithë mysafirëve një e nga një. Në fund, gotën ia çova të Dërguarit të Allahut. E mori në dorë, brenda saj kishte mbetur shumë pak qumësht. Ngriti kokën, pa nga mua dhe më buzëqeshi, duke më thënë:

- "*O Eba Hirr!*"

- "Më thuaj, o i Dërguar i Allahut!", - iu përgjigja unë.

- "*Mbetëm vetëm ne të dy, unë edhe ti.*", - më tha ai.

- "Ashtu është, o Resulullah!"

- "*Mirë, ulu të pish edhe ti.*", - më tha i Dërguari i Allahut. U ula dhe piva. Pastaj më tha:

- "*Vazhdo, pi akoma!*" Vazhdimisht më thoshte 'pi akoma' dhe unë pija sa herë që ai më thoshte të pija. Në fund, i thashë:

- "Në rregull, mjafton, të betohem në Allahun që të ka dërguar ty me fenë e vërtetë se u ngopa mirë!" Kësisoj, ai më tha që t'ia jepja atij

gotën. Ia dhashë gotën dhe pjesën e mbetur të qumështit e piu ai të gjithën.[69]

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon: "Kisha plot tri ditë që nuk kisha vënë asgjë në gojë. Teksa po shkoja në Sufe, herë pas here më merreshin këmbët nga uria dhe rrëzohesha, por pastaj ngrihesha dhe vazhdoja të ecja. Edhe fëmijët patën filluar të thoshin 'Ebu Hurejreja qenka çmendur!' Kurse unë u përgjigjesha:

- "Të çmendur jeni vetë." Më në fund mbërrita në Sufe. Pashë se Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte sjellë dy enë plot me ushqim, të cilat ia kishte dhuruar dikush dhe po ushqente mysafirët, të cilët po hanin. Zgjata pakëz qafën, që të më dallonte i Dërguari i Allahut, me shpresën që mbase më ftonte edhe mua. Kur u çua xhemati, në enë nuk kishte asgjë vetëm çfarë kishte mbetur nëpër anë nga ushqimi. I Dërguari i Allahut u ngrit dhe i mblodhi. Të gjitha bashkë bënin a s'bënin një kafshatë të vetme. E mori të gjithën me gishtat e tij dhe më foli mua:

- "*Hajde, haje këtë duke thënë 'Bismil'lah*"! Betohem në Allahun e Madhërishëm se nga ajo kafshatë e vetme unë hëngra aq sa u ngopa."[70]

Ibni Sirini tregon se: "Një ditë ishim tek Ebu Hurejreja (radijallahu anhu). Kishte veshur një rrobë të kuqe, e cila ishte qepur nga dy copa të ndryshme nga njëra-tjetra. Me njërën prej tyre ai fshiu hundën dhe tha:

- "Shiko, shiko Ebu Hurejreja! Po i fshin hundët me copë! Uallahi mua më kujtohet shumë mirë, që ka pasur raste që mua më binte të fikët dhe rrëzohesha me fytyrë përtokë mes minberit të Profetit tonë dhe dhomës së Aishes (radijallahu anhu) dhe vetëm kur kalonte ndonjë njeri dhe më shkelte sipër, në qafë, e mendonte mos isha shumë i sëmurë. Por shkaku i të fikëtit e vilanisë nuk ishte asgjë tjetër, po uria e tejskajshme."[71]

Ka edhe një hollësi tjetër, e cila e shpjegon dhe e ilustron mjaft mirë gjendjen e Ebu Hurejres: "Uallahi më kujtohet njëherë: shkoja në shtëpinë e djalit të Affanit dhe vajzës së Gazuanit, për të punuar

---

[69]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 6/101.
[70]. Mundhiri, *et-Tergib,* 4/108 (5004).
[71]. Buhari, *Sahih,* 6/2670 (6893).

si hyzmeqar në këmbim që ata të më jepnin ushqim sa të ngopesha dhe ndonjë palë çorape. Kur kishin për të shkuar gjëkundi, u mbaja kafshët në lëvizje, ndërsa kur ishin në shtëpi i ndihmoja me punët që kishin për të bërë në shtëpi. Një ditë, e bija e Gazuanit më tha:

- "Do ta çosh devenë zbathur deri te ujët, ndërsa kur të kthehesh do t'i hipësh devesë pa e ulur atë askund! Më vonë, Allahu e pa të udhës që unë të martohesha me këtë grua. Tani jam unë ai që i them asaj:

- "Do ta çosh devenë tek ujët dhe kur të kthehesh t'i hipësh pa e rrëzuar devenë asgjëkund."[72]

Vuajtja e urisë nga Esmaja (r.a.), e bija e Ebu Bekrit (r.a.)

Esmaja (radijallahu anha) na tregon: "Një ditë, unë isha bashkë me Profetin tonë të nderuar në tokat e Beni Nadrit, të cilat ai i pati ndarë mes Ebu Selemes dhe Zubejrit. Zubejri kishte dalë me të Dërguarin e Allahut. Aty kishim edhe një fqinj hebre. Kishte therur një dele dhe po e piqte. Më kishte ardhur aroma e mishit dhe më kishte shkuar mendja keq për mish. Në atë kohë isha shtatzënë me Hatixhen. Nuk durova dot dhe duke menduar se do të më japë nëse i kërkoj, shkova tek ai hebre që ai të më ndihmonte me pak zjarr. Në fakt nuk kisha nevojë për zjarr. Kur ndjeva erën e mishit, edhe dëshira m'u ndez akoma edhe më shumë. Zjarrin që mora bëra sikur m'u fik. Shkova të kërkoja prapë zjarr. Pastaj kërkova edhe njëherë tjetër, kjo ishte hera e tretë. Mandej u ula dhe fillova të qaja, por edhe i lutesha Allahut. Në atë kohë kishte ardhur edhe i shoqi i asaj gruaje hebreje. Ai e kishte pyetur të shoqen:

- "Erdhi njeri gjatë kohës që nuk isha unë?"

- "Erdhi një grua arabe, më kërkoi zjarr.", - i ishte përgjigjur e shoqja.

- "Po nuk i çove edhe asaj gruaje nga ky mish, unë nuk kam për të vënë në gojë asnjë kafshatë prej tij.", - i qe përgjigjur i shoqi.

Paskëtaj, ata patën mbushur një lugë të madhe me mish dhe ma

[72]. Ibn Sa'd, *Tabakat,* 4/53.

prunë mua. Aq shumë u kënaqa, saqë asgjë në këtë botë nuk do të më kishte kënaqur më shumë sesa ato copa mishi.[73]

5. KUR SAHABËT PËRBALLESHIN ME URINË

Uria dhe i ftohti në betejën e Hendekut

Një ditë, Ebu Xhihadit, njërit prej sahabëve të Profetit Famëlartë, i afrohet pranë i biri dhe i thotë:

- "Babai im i dashur, ju e keni parë të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe shumë herë keni pasur edhe mundësi që të bisedoni me të. Për Zotin, sikur unë ta kisha parë atë, qoftë edhe njëherë të vetme, ç'nuk do të kisha bërë!" I ati e dëgjoi dhe i tha:

- "Biri im, frikësoju ndëshkimit të Allahut dhe fol drejtë! Të betohem për Allahun, se më kujtohet shumë mirë njëherë: Ishte ajo natë e asaj dite kur u zhvillua lufta e Hendekut. Ishim të gjithë pranë të Dërguarit të Allahut. Ai na pati thënë:

- "*Kush shkon deri në afërsi të armikut dhe merr informacione e na i sjell, në ditën e Kiametit, Zoti do ta marrë atë dhe ta sjellë menjëherë si komshi timin në Xhenetin e amshuar!*" Kur asnjëri prej atyre që ishin të pranishëm nuk u ngrit dot, nga uria dhe të ftohtit, i Dërguari i Allahut e përsëriti tri herë premtimin e tij dhe, në fund, tha:

- "*Shko ti, o Ebu Hudhejfe.*"[74]

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) na tregon: Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pa njëherë mirë fytyrat e të gjithë të pranishmëve, në të cilat lexohej uria që kishin ata sahabë të tij dhe u tha:

- "*Po ju jap një sihariq! Shumë shpejt secilit prej jush do t'u shtrohen enë plot shkëlqim, me dollma e me mish.*" Sahabët, të habitur, thanë:

- "O i Dërguari i Allahut, 'domethënë, kur të vijë ajo ditë, ne do të jemi shumë më mirë se sa sot'." I Dërguari i Allahut:

- "*Përkundrazi! Kjo gjendje e juaja sot është më e mbarë për ju, se sa gjendja në të cilën do të jeni në atë ditë!*"[75]

---

[73]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/284.
[74]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/35.
[75]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 10/581 (18278).

Muhamed bin Sirini ka thënë: "Kishte kohë të atilla, që ndonjë nga sahabët e Krenarisë së Gjithësisë, kalonin tri ditë njëra pas tjetrës, e ai nuk arrinte të gjente dot asgjë për të ngrënë, aq sa gjente ndonjë lëkurë kafshe dhe e skuqte dhe me të hiqte urinë. Po të mos e kishte as këtë, atëherë merrte ndonjë gur dhe e lidhte fort pas barkut, për të mos e ndierë urinë."[76]

Ndonjëherë, duke falur namazin, sahabët rrëzoheshin përtokë nga uria

Fudale bin Ubejdi (radijallahu anhu) ka thënë: "Kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u falte sahabëve të tij namazin, sahabët e Sufes, nga uria e tejskajshme, nuk kishin fuqi as sa për të qëndruar në këmbë dhe mund të qëllonte që të kishte syresh edhe që rrëzoheshin përdhe me fytyrë. Ata që nuk kuptonin asgjë nga gjërat që shihnin. Gojëlëshuarit, thoshin: "Këta më duket se janë çmendur." Kur i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mbaronte së faluri namazin, gjëja e parë që bënte ishte të kthehej nga ata dhe t'u thoshte:

- "*Sikur të ishit në dijeni dhe t'i dinit surprizat e përgatitura pranë Allahut për ju, do të kërkonit që të ishit akoma edhe më të varfër!*"[77]

Kur sahabët e përballonin urinë duke ngrënë gjethe bimësh

Enesi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Shtatë vetë nga sahabët e të Dërguarit Fisnik e thithnin të gjithë me radhë një hurmë të thatë, madje, nganjëherë, ata hanin edhe gjethet e pemëve që rrëzoheshin në tokë. Prandaj edhe u ishin ënjtur mishrat e faqeve brenda gojës."[78]

Ebu Hurerjeja (radijallahu anhu) ka thënë: "Një ditë ishim shtatë sahabë, që ishim shumë të uritur. Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dha mua shtatë hurma. Na binte të hanim nga një hurmë secili prej nesh."[79]

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) tregon se: "Një ditë dola nga

[76]. Mundhiri, *et-Tergib,* 4/109.
[77]. Tirmidhi, *Sunen,* 4/583 (2368).
[78]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 10/579 (18274).
[79]. Ibn Maxhe, *Sunen,* 2/1392 (4157).

shtëpia, për të shkuar në faltore. E vetmja arsye pse dola nga shtëpia në atë orë ishte vetëm se isha shumë i uritur. Në faltore gjeta edhe shtatë a tetë sahabë fisnikë të tjerë.

- "Për hair, o Ebu Hurejre, çfarë të ka shtyrë, në këtë orë, të dalësh nga shtëpia?", - më pyetën ata.

- "Uria.", - ia ktheva unë.

- "Uallahi, edhe ne nga uria erdhëm këtu.", - thanë ata. U çuam të gjithë bashkë siç ishim dhe shkuam atje ku ishte i Dërguari i Allahut.

- *"Cila është arsyeja që ju ka sjellë këtu, tani, në këtë orë?"*, - na pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Uria, o Resulallah!", - ia pritëm ne. Sakaq Profeti ynë kërkoi që t'i sillnin një tabaka me hurma. Në të kishte aq hurma sa ne na binin nga dy të tilla për kokë.

- *"Hajini ato dy hurma që ju takojnë secilit, pini edhe ujë dhe kaq ju mjafton për sot."*, - na tha ai. Në vijimësi Ebu Hurejreja thotë se:

- "Unë hëngra njërën nga hurmat, ndërsa tjetrën e vura brenda rripit me të cilin kisha lidhur teshat. I Dërguari i Allahut, i cili, me sa dukej më kishte parë, më tha:

- "*O Ebu Hurejre, ku e çove atë hurmë?*"

- "E ndava për nënën, o i Dërguari i Allahut.", - iu përgjigja unë.

- "*Haje ti atë! Të japim edhe dy të tjera për nënën.*", - tha i Dërguari Fisnik i Allahut, duke më dhënë kështu edhe dy hurma të tjera."[80]

Enesi (radijallahu anhu) përcjell se: "Profeti ynë erdhi në vendin ku ishte gërryer toka, për t'u hapur hendeku. Ensarët me Muhaxhirët ishin duke gërmuar, megjithëse ishte një mëngjes shumë i ftohtë. Me vete nuk kishin as skllevër, të cilët mund t'i vinin në punë, për të kryer punët më të vështira. Kur pa vështirësitë dhe lodhjen e sahabëve dhe e kuptoi se ata ishin pa ngrënë e të uritur, ai u lut për ta:

- "*O Zoti im! Jetë e vërtetë është jeta e ahiretit, Ti fali Ensarët dhe Muhaxhirët.*" Kurse sahabët iu përgjigjën atij duke i thënë:

- "Ne i jemi betuar Muhamedit, që sa të kemi jetë do të përpiqemi

[80]. Ibn Sa'd, *Tabakat,* 4/329.

e do të bëjmë gjithçka mundemi për të!"[81]

Xhabiri (radijallahu anhu) rrëfen: "Atë ditë që po gërmonim, për të hapur hendekun, prej nga e mori edhe emrin ajo ditë, u përballëm me një damar dheu shumë të fortë."

- "Dale të hyj njëherë edhe unë e ta shoh.", - tha i Dërguari i Allahut. Nga uria, drejt pjesës së barkut kishte lidhur një copë guri, për të mos e ndierë të pangrënët, sepse kishim plot tri ditë që nuk kishim vënë asgjë prej gjëje në gojë."[82]

Një grua që çdo të premte u jepte disa sahabëve për të ngrënë

Tregon Sehl bin Sadi (radijallahu anhu): "Ka qenë një grua nga ne, e cila të gjithë tokën e saj e mbillte me pazi. Kur vinte e premtja ajo mbushte një tenxhere me rrënjë pazie, pastaj bluante një dorë elb dhe i skuqte, ashtu, të përziera, pa shtuar as vaj, as gjalpë. Pazia, kur e gatuanin me gjithë rrënjë, zëre se zinte vendin e mishit me kockë në tavolinë. Të premten, pasi falnim edhe xhumanë ne ktheheshim në shtëpinë e asaj gruaje dhe e përshëndesnim. Ndërsa ajo na ushqente me ushqimin që kishte përgatitur. Prandaj ne mezi e prisnim që të vinte sërish dita e premte."[83]

6. ETJA E TEJSKAJSHME QË VUANIM KUR DILNIM TË FTONIM NJERËZIT NË ISLAM

Etja e sahabëve fisnikë gjatë betejës së Tebukut

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Ne i kërkuam Omerit (radijallahu anhu), nëse ai mund të na shpjegonte se çfarë dinte ai për togfjalëshin '*ora e vështirësisë*', që përmendet në Kur'an si '*saatu'l-usre*' (në ajetin 117 të sures "Teube)?" Dhe ai na përcolli këto të dhëna:

- "Një ditë shumë të nxehtë ishim nisur për në betejën e Tebukut. U ndalëm në një vend, që edhe të pushonim pak. Aq shumë na kishte marrë etja, saqë na dukej, sikur, nga çasti në çast, qafa do të na

[81]. Buhari, *Sahih,* 4/1504 (3873).
[82]. Buhari, *Sahih,* 4/1505 (3875).
[83]. Buhari, *Sahih,* 1/317 (896).

ndahej prej trupit. Madje disa prej nesh shkonin pranë familjes së vet në karvan dhe nuk kthehej më pas, nga frika se mos rrëzohej e nuk arrinte të mbërrinte i gjallë deri te ne. Madje edhe më keq; kishte që prisnin devenë dhe shtrydhnin plëndësin e devesë, se çfarë mund të dilte prej saj, e pinte lëngun që rridhte prej andej, ndërsa pjesën tjetër e fuste prapë pranë mushkërive të devesë. Në fund, Ebu Bekri tha: "O Resulullah, Allahu ty të mësoi që të bësh vetëm lutje të mbara vazhdimisht. Sikur të luteshe njëherë edhe për ne!"

I Dërguari i Allahut ia priti, duke i pyetur:

- "*Doni vërtet që të lutem për ju?*"

- "Po!", - i tha Ebu Bekri (radijallahu anhu). Atëherë i Dërguari i Allahut ngriti duart dhe filloi të lutej. Ende pa i ulur mirë duart, mbi kryet tona, në qiell, u shfaq një re e zezë. Ai shi që filloi të rigonte lehtë-lehtë, pas pak, filloi të binte me rrebeshe. Të gjithë nxorën enët që kishin me vete, e i mbushëm. Më vonë, ç'të shihnim, shi kishte rënë vetëm në territorin ku qenë vendosur ushtarët myslimanë dhe në vendet e tjera nuk kishte rënë as edhe një pikë e vetme shiu."[84]

Etja e skajshme që kishin Harithi, Ikrimeja dhe Ajashi në luftën e Jermukut

Habib bin Ebi Thabiti (radijallahu anhu) tregon: "Harith bin Hishami, Ikrime bin Ebi Xhehli dhe Ajash bin Ebi Rabia (ndërsa sipas një transmetimi tjetër, thuhet se aty ka qenë i pranishëm edhe Suhejl bin Amri.), në ditën e Jermukut, dolën në fushën e betejës. Por atje u plagosën aq rëndë, saqë këmbët nuk po u mbanin dot më. Harithi na kërkoi t'i jepnim pak ujë për të pirë. Kur ujin që solla për ta pirë ai e pa Ikrimeja, Harithi tha:

- "Jepi të pijë njëherë Ikrimeja!" Ikrimeja e mori ujin, por në anën tjetër pa Ajashin që po rrinte. Ikrimeja, kësaj here tha:

- "Jepja ujin, të pijë njëherë Ajashi." Ai që po u çonte ujin, ende pa ia çuar ujin mirë, Ajashi dha shpirt. Të tre pinë sherbetin e të rënit dëshmor ende pa vënë të paktën një pikë ujë në buzë."[85]

[84]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/9.
[85]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/792 (30255).

7. DURIMI I TË FTOHTIT TË ACARTË NË RRUGËN E ALLAHUT

Kur, gjatë luftës, për t'u ruajtur nga të ftohtët e acartë, sahabët hapën një gropë të madhe dhe hynë në të

Ebu Rejhaneja (radijallahu anhu) tregon: "Në një luftë, ne ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Gjatë natës u vendosëm në një kodër, mirëpo aty na kapi një i ftohtë shumë i ashpër. Madje, disa myslimanë patën hapur një gropë dhe patën hyrë në të dhe me mburojat e patën mbyllur pjesën e sipërme të gropës. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur e pa këtë situatë, tha:

- "*Kush do ta marrë përsipër detyrën për të na bërë roje sot? Unë do të lutem për të dhe të mirat për të do të jenë të mëdha.*"

- "*Ti kush je?*", – pyeti i Dërguari i Allahut njërin prej tyre.

- "Filani.", – iu përgjigj ai.

- "*Afrohu.*", - i tha atij i Dërguari i Allahut.

Profeti ynë e kapi atë njeri nga pëlhura që kishte veshur dhe filloi të lutej për të. Kur e dëgjova lutjen e Profetit tonë të dashur, unë u hodha e thashë:

- "*Jam edhe unë, që mund të bëj roje, o Resulullah!*"

- "*Po ti kush je?*", - m'u përgjigj i Dërguari i Allahut duke më pyetur.

- "*Jam Ebu Rejhaneja.*"

Pasi u përgjigja, i Dërguari i Allahut bëri një lutje edhe për mua, po më të shkurtër se ajo që bëri për shokun tim, duke thënë:

- "*Syri i atij që bën roje në rrugën e Allahut është bërë i ndaluar për Xhehenemin.*"[86]

8. VËSHTIRËSITË NË RRUGËN E ALLAHUT PËR T'U VESHUR

Habab bin Ereti (radijallahu anhu) tregon: "Pata qenë aty kur ra dëshmor Hamzai (radijallahu anhu); nuk patëm gjetur dot asgjë, pos

[86]. Ibn Haxher, *el-Isabe*, 2/156.

një trikoje, për ta përdorur si qefin për trupin e tij. Kur ia mbuluam këmbët me atë triko, pamë që koka i kishte mbetur e zbuluar, e kur provuam t'i mbulonim kokën, atëherë ishin këmbët, që mbeteshin zbuluar. Kësodore, ne ia mbuluam atij kokën me atë triko, ndërsa këmbët ia mbuluam me gjethe të bimës erëmirë të idhkhirit (bar limoni)."[87]

Historia e Shurahbil bin Hasenesë (r.a.)

Shifaja, e bija e Abdullahut, ka thënë: "Shkova te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i kërkova diçka. Ai më tha se nuk kishte asgjë se çfarë të më jepte, duke më kërkuar të falur, megjithëse unë me vete u mërzita shumë që po më përcillte ashtu. Kur, erdhi koha për të falur namazin. Dola menjëherë dhe shkova atje ku po kryhej nikahu i vajzës sime. Pashë, Shurahbili ishte në shtëpi. I thashë atij:

- "Çfarë bën ende në shtëpi, ka hyrë koha për të falur namazin?"

- "Teze, mos më qorto! Unë vetëm një rrobë kisha për të veshur, edhe atë ma kërkoi hua i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kështu që ia dhashë atij."

- "Nëna dhe babai im të qofshin falë!", - iu përgjigja.

Dhe unë, që deri atë ditë kisha filluar të mendoja jo mirë për të. Domethënë paska qenë e vërtetë.

- "E vërtetë, tani, i Dërguari i Allahut nuk ka asnjë rrobë tjetër, veç asaj që i dhamë ne, të cilën ne e kemi arnuar disa herë!", - më tha Shurahbili.[88]

Vështirësitë e Aliut (r.a.) dhe Fatimes (r.a.) për të gjetur diçka për të veshur

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Uallahi, kur u martova

[87]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 4/73 (3680).
[88]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/271.

me të bijën e Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), unë nuk kisha asgjë prej gjëje. Kishim një lëkurë dashi, të cilën, edhe atë ai na e kishte dhuruar, që e përdornim si dyshek gjatë natës, ndërsa gjatë ditës e përdornim për t'u hedhur tagji deveve që përdornim për të marrë ujë. Dhe Fatimja nuk kishte askënd tjetër që ta ndihmonte me punët e tjera të shtëpisë."[89]

Kur sahabët vishnin tesha prej leshi në atë të nxehtë të shkretëtirës

Ibni Burejdeja (radijallahu anhu) tregon: "Babai më ka thënë kështu: 'Ti të na kishe parë njëherë ne! Një ditë, ishim bashkë me Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe na zuri një shi i rrëmbyeshëm. Nga veshjet prej leshi, që kishim veshur atë ditë, të dy zumë të vinim erë deleje!'"[90]

Sahabët e Sufes nuk gjenin dot asgjë për të veshur

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Pashë se në Sufe ishin diku te shtatëdhjetë vetë, e asnjëri nuk kishte ndonjë teshë që t'i ngjante jelekut, apo xhaketës. Në trup kishin ose ndonjë si pelerinë të gjatë që e mbanin të lidhur pas qafës, me pak fjalë, të gjithë kishin veshur tesha fare të thjeshta. Disave ato u zbrisnin deri te kërcinjtë, disa të tjerë i kishin më të gjata, që u zgjateshin deri te thembrat e këmbëve. Madje, kishte edhe nga ata që i mbanin rrobat e tyre me dorë, që të mos u dukeshin pjesët intime të trupit."[91]

Transmetohet nga Aishja (radijallahu anha) se një ditë tek ajo erdhi një burrë. Në atë çast aty ndodhej edhe shërbëtorja e Aishes (radijallahu anha), e cila kishte veshur një rrobë në vlerën e pesë dërhemëve. Aishja (radijallahu anha) iu drejtua atij, duke i thënë:

- "Ngrije kryet dhe vështroje shërbëtoren time! Këtë rrobë që mban veshur nuk dëshiron që ta veshë as brenda shtëpisë! Ndërkohë

[89]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 8/22.
[90]. Ebu Daud, *Sunen,* 2/442 (4033).
[91]. Mundhiri, *et-Tergib,* 4/111 (5016).

që kur Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte gjallë, unë kisha një rrobë të vetme si kjo. Kur një grua në Medine dëshironte të vishej bukur dërgonte dikë që ta huazonte atë nga unë."[92]

9. PËRBALLJA ME GJITHFARË FRIKËRASH NË RRUGËN E ALLAHUT

Si e duruan sahabët fisnikë urinë, frikërat dhe të ftohtët e tejskajshëm në luftën e Hendekut

Hudhejfeja (radijallahu anhu) i ka treguar nipit të tij, Abdulazizit, se: "Kur xhaxhai im, Hudhejfeja (radijallahu anhu), po na tregonte për luftërat ku kishte marrë pjesë, bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ata që ishin të pranishëm në atë kuvend e pyetën:

- "Uallahi, sikur të kishim qenë ne në ato luftëra, medoemos do të kishim bërë këtë e atë gjë!"

- "Mos mendoni kështu! Uallahi, më kujtohet fare mirë ajo natë, të nesërmen e së cilës do të zhvillohej lufta e Hendekut: Ishim vendosur në formë radhësh. Armiqtë tanë, bashkë me Ebu Sufjanin, ishin vendosur sipër nesh, kurse poshtë ishin vendosur hebrenjtë e Kurejdhas. Ishim të shqetësuar se mos na sulmonin pjesëtarët e tjerë të familjeve tona. Deri në atë ditë nuk mbaj mend të kemi përjetuar ndonjëherë një natë të errët plus dhe që furtuna nuk kishte të pushuar. Furtuna shkaktonte bubullima dhe vetëtima të njëpasnjëshme. Aq errësirë ishte, saqë as gishtërinjtë tanë të dorës nuk i dallonim dot. Hipokritët, duke përfituar nga një situatë e tillë, i thanë Profetit tonë:

- "I kemi lënë shtëpitë pa njeri që t'u bëjë roje.", - duke nisur t'i kërkojnë leje për t'u larguar, megjithëse nuk i kishin familjet edhe aq pa njeri e të rrezikuara, por po i përdornin si gënjeshtër që t'i shpëtonin luftës. I Dërguari i Allahut po u jepte leje të gjithë atyre që i kërkonin leje për t'u larguar, e kështu ata largoheshin njëri pas tjetrit. Ishim a s'ishim diku te treqind vetë. Atëherë i Dërguari i Allahut u ngrit dhe filloi të na kontrollonte një e nga një. Përveç asaj veshjeje prej leshi

[92]. Buhari, *Sahih,* 2/926 (2485).

që më pati dhënë bashkëshortja me vete, e cila, më e shumta, mund të më ruante sadopak nga të ftohtët, me vete nuk kisha asgjë tjetër që të më mbronte kundër armikut, apo ndaj të ftohtit. Kur erdhi pranë meje, unë isha ulur në gjunjë dhe më kishin kapur ca të dridhura ngaqë kisha shumë ftohtë.

- "*Po ti, kush je? Si të quajnë?*", - më pyeti.

- "Hudhejfe.", - iu përgjigja unë.

- "*Hudhejfe!*"

Ngaqë ajo rrobë që kisha veshur më rrinte pak e shkurtër, por edhe ngaqë kisha shumë ftohtë, rrija paksa i kërrusur.

- "Urdhëroni, o Resulullah!", - i thashë të Dërguarit të Allahut dhe u ngrita në këmbë, edhe pse e kisha me siklet.

- "*Na kanë ardhur shumë lajme të ndryshme lidhur me armikun, shko shih e mos ka ndonjë gjë të re, e hajde të na thuash!*", - më tha ai.

Ndër të gjithë ushtarët, ai që kishte më shumë frikë dhe që e ndiente më shumë të ftohtin isha unë. U nisa, për të bërë atë që më pati thënë i Dërguari i Allahut. Profeti i profetëve ishte lutur enkas për mua, duke thënë:

- "*O Zot! Ruaje atë nga para e nga mbrapa, nga e djathta e nga e majta, nga sipër e nga poshtë!*" Uallahi, pas asaj lutjeje, Zoti nuk la më brenda meje as frikë nga armiku, as të ftohtë. Edhe ato që kisha ndjerë deri atëherë sikur u zhdukën të tëra brenda një çasti të vetëm. Tani nuk kisha as ftohtë, as frikë se mos më bënin armiqtë ndonjë të keqe. Kur po largohesha, Profeti ynë më pati porositur:

- "*Hudhejfe! Mos shkakto asnjë rrëmujë me armiqtë, derisa të kthehesh tek unë, të më lajmërosh se çfarë po bëjnë ata!*"

Shkova dhe iu afrova bazës së armikut me qetësinë më të madhe. I ndoqa me aq sa më lejonin flakët e zjarreve që kishin ndeshur ata. Pashë një burrë trupmadh, ezmer, i cili i ngrohte duart në zjarr dhe i fuste në kraharor, që u thoshte të tjerëve:

- "Të kthehemi, të kthehemi, ta lëmë këtë luftë." Nuk e kisha parë Ebu Sufjanin asnjëherë më parë. Me aq sa më lejonte drita e përhapur nga flakët e zjarrit, nxora nga trasta e harkëtarit një shigjetë me majë

të bardhë dhe e vura në hark, mirëpo, në atë çast, m'u kujtua urdhri i Profetit tonë, i cili më pati thënë: "*Mos shkakto asnjë rrëmujë me armiqtë, derisa të kthehesh tek unë, të më lajmërosh se çfarë po bëjnë ata!*", kështu që e vendosa prapë në trastë atë shigjetë. Pastaj brenda më erdhi një trimëri e pashpjegueshme, ndaj vendosa të hyja deri në radhët e ushtrisë, brenda. Më afër kisha bijtë e Amirit. Ata ishin duke i bërtitur njëri-tjetrit:

- "O bijtë e Amirit, të tërhiqemi, të tërhiqemi, këtu nuk rrihet, është e padurueshme!" Në zonën ku ishin vendosur ata frynte era më e fortë, ndërsa jashtë zonës së tyre nuk frynte fare. Uallahi, frynte aq shumë, saqë, nga era edhe gurët nën shtretërit e tyre lëviznin dhe zhurma e tyre vinte deri tek unë. Paskëtaj u largova që aty, për të shkuar pranë të Dërguarit të Allahut. Kur mbërrita thuajse në gjysmë të rrugës, pashë diku te njëzet kalorës me çallma në kokë, që më thanë:

- "Shko dhe thuaji shokut tënd, Allahu i ka dërguar atij ndihmën e mjaftueshme." Sapo mbërrita te Profeti ynë, shkova ta kërkoja dhe e gjeta duke falur namaz i mbështjellë me një mbulesë, të cilën me sa duket e kishte hedhur trupit për t'u mbrojtur nga të ftohtët. Ju betohem në Allahun e Madhërishëm, se kur u ktheva fillova të ndihesha prapë i frikësuar dhe ta ndieja edhe më të ftohtin. I Dërguari i Allahut, në namaz, ma bëri me shenjë. Iu afrova dhe ai ma hodhi mua në trup mbulojën e vet. Profeti ynë e kishte zakon, sa herë që përballej me ndonjë situatë shumë të vështirë, apo që ishte shumë e rëndësishme, falte namaz. I dhashë informatat që kisha mbledhur për armiqtë, duke i thënë:

- "Kur unë po vija këtu ata po largoheshin."

Hudhejfeja (radijallahu anhu) thotë se: "Lidhur me këtë ngjarje, Allahu i Madhërishëm pati zbritur disa ajete:

"**O besimtarë! Kujtoni dhuntinë e Allahut kur ju erdhi një ushtri** (idhujtarësh)**, e Ne dërguam mbi ata erë dhe një ushtri** (engjëjsh) **që ju nuk e shihnit; ndërsa Allahu i sheh të gjitha ato që bëni ju. Ata ju sulmuan nga lart dhe nga poshtë, kështu që sytë tuaj u errësuan, zemrat ju erdhën në fyt dhe besimi juaj tek Allahu u lëkund. Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e**

fuqishme. Por hipokritët dhe ata me zemra të sëmura e të dobëta, thanë: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit'! Dhe një grup prej tyre tha: 'O banorët e Jethribit, s'ka qëndrim këtu për ju, andaj kthehuni!' Një grup tjetër nga ata kërkoi leje prej të Dërguarit, duke thënë: 'Në të vërtetë, shtëpitë tona janë të pambrojtura'! Por ato nuk ishin të pambrojtura. Ata donin vetëm të iknin." (Ahzab, 33/9-13)[93]

10. DURIMI NDAJ PLAGËVE DHE SËMUNDJEVE NË RRUGËN E ALLAHUT

Historia e Amr bin Xhemuhut (r.a.)

Disa nga njerëzit më të nderuar të bijve të Selemes kanë treguar se: "Amr bin Xhemuhu (radijallahu anhu) kishte shumë probleme me këmbën e tij, nuk e përdorte dot mirë. Mirëpo kishte katër djem, të katërt si luanë ishin. Që të katërt merrnin pjesë në të gjitha luftërat ku merrte pjesë edhe i Dërguari i Allahut. Ata deshën ta pengonin të atin, që ai të mos merrte pjesë në luftën e Uhudit, pasi ai ishte i justifikuar, kishte këmbën të dëmtuar! Amri shkoi te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha: "O Resulullah, djemtë duan të më pengojnë, që unë të mos dal në luftë bashkë me ty. Uallahi, unë me këtë këmbë, kështu topall siç jam, dua të eci me këmbët e mia drejt parajsës!" Profeti i profetëve iu përgjigj:

- "*Allahu e pranon të metën tënde, prandaj ti nuk e ke detyrim xhihadin* (të luftuarit dhe të përpjekurit në rrugën e Allahut)*!*" Nga ana tjetër, i Dërguari i Allahut u tha djemve të Amrit:

- "*Nuk ju takon juve t'i bëheni pengesë babait tuaj, nuk e keni këtë të drejtë. Shpresoj që Allahu ta pranojë atë si një nga dëshmorët e Tij.*" Kështu, Amr bin Xhemuhu mori pjesë në luftën e Uhudit, krah për krah me të Dërguarin Fisnik, dhe ra dëshmor."[94]

Ebu Katadeja (radijallahu anhu), që ka qenë një nga dëshmitarët e kësaj ngjarjeje dhe i ka parë me sytë e tij të gjitha sa kanë ndodhur

[93]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/114.
[94]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/37).

thotë se: "Amr bin Xhemuhu erdhi te Profeti ynë i nderuar dhe i tha:

- "O Resulullah, si mendon ti? Po të dal e të luftoj e të kacafytem me armiqtë, në rrugën e Allahut, e të bie dëshmor, nuk do të mund të eci dot për të hyrë në parajsë lirshëm?" I Dërguari ynë Fisnik iu përgjigj duke i thënë:

- "*Ecën, si nuk ecën.*"

Në luftën e Uhudit, idhujtarët vranë atë, nipin e tij dhe një prej skllevërve që ai ia kishte dhënë vetë lirinë. Pas luftës, kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kaloi pranë trupit të Amrit, Ai tha:

- "*Tani më duket sikur po shoh se si Amri po hyn në Xhenet lirshëm, pavarësisht këmbës së tij të gjymtuar.*"[95]

[95]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 9/523 (15746).

HIXHRETI

Si e braktisën sahabët atdheun e tyre, për të mos u kthyer kurrë më atje, deri në vdekje? Si u shndërrua mërgimi nga shtëpitë dhe familjet e tyre në diçka më të dashur se kjo botë dhe gjithë pasuritë e saj? Nuk iu bëri fare përshtypje që po u iknin duarsh sa e sa të mira të kësaj bote, që çmuan më shumë besimin dhe e mbajtën fenë e tyre mbi çdo të mirë materiale? Si mërguan ata nga njëri vend në tjetrin, si e si që ta ruanin fenë e tyre të pastër nga çdo ngatërresë që të tjerët tentonin të fusnin mes tyre? Sikur ata të ishin krijuar enkas për ahiretin, ndërsa bota të ish krijuar enkas për ta!

1. HXHRETI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT DHE EBU BEKRIT (r.a.)

Paria e kurejshëve mblidhet për t'i ngritur kurth Profetit tonë të dashur

Urueja (radijallahu anhu) tregon: Aty drejt fundit të vitit të trembëdhjetë të profetësisë së Profetit tonë, pas Haxhit, ai qëndroi në Mekë edhe gjatë muajve të Muharremit dhe të Saferit. Ndërkohë idhujtarët e Mekës kishin marrë vesh se i Dërguari i Allahut do të largohej nga Meka dhe Allahu i Madhërishëm i kishte caktuar atij si

vend strehimi Medinën, e cila më vonë do të kthehej në kështjellën e myslimanëve; kishin dëgjuar se qytetarët e Medinës ishin bërë myslimanë dhe se të gjithë myslimanët për atje shkonin si mërgimtarë. Prandaj, ata po diskutonin e po thurnin plane me njëri-tjetrin, se si ta kapnin të Dërguarin e Allahut, ta vrisnin, ta burgosnin, apo thjesht ta dëbonin nga Meka. Allahu i Madhërishëm, ato kurthe që ata po orvateshin të thurnin, ia pati lajmëruar Profetit Famëlartë nëpërmjet këtyre ajeteve:

"**Kujto kur mohuesit komplotonin kundër teje: për të të burgosur, vrarë ose dëbuar. Ata bënin kurthe, por edhe Allahu ngrinte kurthe** (kundër tyre)**. Allahu është planifikuesi më i mirë.**" (Enfal, 8/30)

I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati marrë vesh se idhujtarët do ta kapnin atë natë që ai do të shkonte të flinte në shtëpinë e Ebu Bekrit (radijallahu anhu). Andaj, bashkë me Ebu Bekrin, ai u nis për rrugë drejt një shpelle që gjendej në malin e Theurit. Kjo është shpella që përmendet edhe në ajetin e dyzetë të sures "Teube" në Kur'an. Atë natë, Aliu (radijallahu anhu), në fshehtësi të plotë, u shtri të flinte në vendin ku flinte zakonisht Profeti ynë. Gjatë gjithë natës, kurejshët nuk mundën të arrinin në një vendim përfundimtar. Kur agoi, ata shkuan dhe në shtrat gjetën Aliun. E pyetën se ku ishte profeti.

- "Nuk e di.", - u përgjigj ai. E kuptuan që ishte larguar nga Meka. U hipën menjëherë kuajve dhe dolën ta kërkojnë në çdo anë nga mund të kishte ikur. U dërguan fjalë të gjithë atyre që banonin afër burimeve të ujit, duke u premtuar të gjithëve se atyre që do ta gjenin do t'u jepej një shpërblim shumë i majmë. Shkuan deri në malin e Theurit, aty ku gjendeshin edhe Profeti ynë me Ebu Bekrin (radijallahu anhu), dhe rrinin aty në njërin prej shpateve të tij. I Dërguari i Allahut i pati dëgjuar zhurmat e hapave të tyre, ndërsa Ebu Bekri (radijallahu anhu) pati filluar të shqetësohej. Profeti ynë e pati ndierë shqetësimin e Ebu Bekrit, ndaj i pati thënë: "*Mos u mërzit, se Allahu është me ne!*" Profeti ynë u lut dhe, pas lutjes së tij, në zemrën e Ebu Bekrit u rikthye qetësia dhe paqja shpirtërore. Si përfundim, ja se si paraqitet ajo situatë në Kur'anin Famëlartë:

"**Nëse ju nuk e ndihmoni atë** (Muhamedin a.s.)**, Allahu tashmë e ka**

ndihmuar ditën kur atë e dëbuan mohuesin vetë të dytin, kur ishin në shpellë e ai i thoshte shokut të vet (Ebu Bekrit)**: 'Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!' Atëherë, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të, e ndihmoi me një ushtri të padukshme** (engjëjsh) **dhe bëri që fjala e mosbesimtarëve të jetë më e poshtëruara, kurse Fjala e Allahut të jetë më e lartësuara. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."** (Teube, 9/40)

Në Mekë Ebu Bekri (radijallahu anhu) kishte dele që i jepnin shumë qumësht. I dërgoi fjalë Amir bin Furejres, i cili ishte një mysliman shumë i mirë dhe i besueshëm. E ai, për t'u ardhur në ndihmë në një situatë të këtillë, pagoi Ibnu'l-Ijkatin nga fisi i bijve të Abd bin Adijit, që t'u shërbente si udhërrëfyes. Ky njeri ishte njëherazi, edhe bashkëpunëtor i kurejshëve, edhe vetë ishte idhujtar. Por rrugët i njihte në pëllëmbë të dorës.

Në ato net kur Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu) qëndronin të fshehur, i biri i Ebu Bekrit, Abdullahu, vinte tek ata atëherë kur binte errësira e plotë e natës; u njoftonte atyre të rejat se çfarë kishte ndodhur në Mekë gjatë ditës. Amir bin Fuhejreja nxirrte delet të kullotnin andej pari dhe nganjëherë një pjesë të deleve e çonte pranë tyre, që t'i milnin e t'u pinin qumështin e ndonjërën ta zgjidhnin për ta therur, që të hanin nga pak mish. Amiri, të nesërmen, do të zgjohej më shpejt se të tjerët, që të shkonte te çobanët e tjerë, e askush të mos kuptonte gjë se ku kishte qenë gjatë natës. Mandej, kur situata u duk më e sigurt, Amir bin Fuhejreja, bashkë me Ibnul-Ejkatin, u çuan atyre dy deve. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu) patën ndenjur në shpellë dy ditë e dy net. U hipën deveve dhe u nisën për në Medinë. I shoqëronte Amir bin Fuhejreja, i cili u shërbente për çdo nevojë që kishin gjatë rrugës; Ibnul-Ejkati u rrëfente udhën. Me vete nuk kishin askënd tjetër."[1]

Përgatitjet e Ebu Bekrit për rrugëtimin e hixhretit

Aishja (radijallahu anha) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), çdo ditë, në mbrëmje ose në darkë, do të vinte medoemos

[1]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/63 (9902).

te babai, Ebu Bekri. Atë ditë që Allahu i Madhërishëm ua lejoi të mërgonin, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi tek Ebu Bekri në një orar që ai nuk e priste, aty në pikën e drekës. Kur e pa, Ebu Bekri tha me vete:

- "Qoftë për hair, inshallah, se i Dërguari i Allahut nuk vjen në këtë orë, diçka shumë e rëndësishme duhet të ketë ndodhur!" I Dërguari i Allahut hyri brenda dhe Ebu Bekri u ngrit nga jastëku në të cilin po rrinte i ulur, që aty të ulej Profeti ynë. Në shtëpi nuk kishte njeri tjetër, veç meje dhe motrës sime, Esmasë. I Dërguari i Allahut i tha:

- "*Thuaji të dalin pak jashtë, që ke në shtëpi!*", - duke ia bërë me shenjë.

Ebu Bekri iu përgjigj:

- "Vajzat e mia janë. Ty t'u qofshin falë, nëna dhe babai im, çfarë ka ndodhur, o Resulallah?"

- "*Allahu i Madhërishëm më dha leje që të largohem prej këtu, duke mërguar në ndonjë vend tjetër.*"

- "O Resulallah, dua të vij edhe unë me ju."

- "*Po, do të vish edhe ti me mua, ti do të jesh shoqëruesi im i rrugës, do të ikim bashkë.*"

Aishja (radijallahu anha) thotë se: "Uallahi nuk kisha parë ndonjëherë që njeriu të qante nga gëzimi. Ebu Bekri që pashë atë ditë qante vazhdimisht nga gëzimi."

Pastaj Ebu Bekri tha:

- "O Resulallah, edhe këto dy deve për atë punë i kam përgatitur."

- "*Kjo është një punë që nuk bëhet, më duhet të ta blej njërën nga devetë.*", - dhe sakaq e pagoi me çmimin e një deveje. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) bashkë me Ebu Bekrin paguan dikë që e quanin Abdullah bin Ejkat nga fisi i Beni Duil bin Bekrit, që t'u shërbente si udhërrëfyes gjatë rrugës. Ky udhërrëfyes vetë ishte idhujtar. Nënën e kishte nga fisi i bijve të Sehm bin Amrit. Devetë ia dorëzuan atij. Deri në ditën që ranë dakord se do të niseshin do të kujdesej ai për devetë, do t'u jepte për të ngrënë dhe për të pirë."[2]

[2]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/178.

Vajza e Ebu Bekrit, Esmaja (radijallahu anha) tregon: (...) Më vonë ne nisëm nga përgatitjet e nevojshme të rrugës. Preva një pjesë nga brezi im dhe me të lidha grykën e torbës së ushqimeve. Ata ikën, u nisën. Për njëfarë kohe ata pritën në shpellën e malit të Theurit. Kur mbërritën para shpellës, brenda i pari hyri Ebu Bekri, me shqetësimin se mos aty kishte ndonjë kafshë të rrezikshme dhe mbylli mirë e mirë të gjitha vrimat që ishin të hapura mes shkëmbinjve. Nga ana tjetër, kurejshët kishin kohë që kishin nisur nga kërkimet për ta. Madje patën përhapur edhe lajmin se atë që do të kapte të Dërguarin e Allahut do ta shpërblenin, duke i dhënë plot njëqind deve. Nuk lanë mal të Mekës pa e kërkuar pikë për pikë. Mbërritën në malin e Theurit. Kur njëri prej tyre u afrua deri në grykën e shpellës, Ebu Bekri, i shqetësuar, tha:

- "O Resulallah, ky njeri do të na gjejë tani!"

- "*Jo, nuk na sheh dot; sepse engjëjt janë këtu dhe po na mbulojnë me krahët e tyre.*" Ai njeri u ul në gjunjë dhe urinoi. Profeti ynë tha:

- "*Po të na kishte parë nuk do ta bënte këtë!*" Ata qëndruan tri net në shpellë.

Largimi nga shpella

U larguan nga shpella. Ndoqën rrugën e Medinës, duke ecur në drejtim të rrugës së bregdetit. Për të qenë gjithmonë i gatshëm për t'i ardhur në ndihmë Profetit tonë në rast rreziku të mundshëm, Ebu Bekri ecte herë para Profetit tonë, herë vinte nga pas. Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte një njeri që e dinin dhe e njihnin mirë të gjithë. Sa herë që rastisnin ndokënd rrugës dhe ai e pyeste:

- "Kush është ky njeri që paske me vete?" Ebu Bekri u përgjigjej:

- "E kam udhërrëfyes, e kam marrë që të më tregojë rrugën." Në fakt, me këto fjalë ai kishte parasysh udhërrëfimin e Profetit tonë në fenë islame; kurse ata që pyesnin nuk kuptonin vetëm atë që mund të kuptohej në kuptimin e parë të fjalëve!

Kur mbërritën në fushën e quajtur Kudejd, nëpërmjet së cilës kalonin të gjitha rrugët, dikush që i pa shkoi menjëherë të lajmëronte të bijtë e Mudlixhit, të cilëve u tha:

- "Pashë dy njerëz me deve, të cilët po ecnin rrugës së bregut të detit, ma merr mendja se duhet të jetë ai që po kërkojnë kurejshët, bashkë me shokun e tij!"

Suraka bin Maliku i tha atij njeriu:

- "Ata dy njerëz që ke parë ti duhet të jenë vërtetë ata për të cilët na kanë ardhur fjalë!", - e sakaq thirri aty robinjën e tij dhe i tha që t'i përgatiste kalin e tij në fshehtësi të plotë. Një të marrë kalin dhe u nis menjëherë në ndjekje të gjurmëve."[3]

Si e lëvdonte Omeri (r.a.) shokun e mërgimit të Resulullahut, Ebu Bekrin

Ibni Sirini tregon: "Në kohën e kalifatit të Omerit (radijallahu anhu), disa vetë patën thënë ca fjalë që nënkuptonin njëfarë epërsie të Omerit (radijallahu anhu) ndaj kalifit të parë, Ebu Bekrit (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu) i kishte dëgjuar ato fjalë, ndaj u foli atyre:

- "Uallahi, një natë e vetme e Ebu Bekrit është më e mbarë se të gjithë pjesëtarët e familjes së Omerit. Një ditë e vetme e Ebu Bekrit është më e mirë se i gjithë fisi i Omerit. Unë ju betohem tek Allahu, se atë natë që Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkoi në shpellë, me të ishte edhe Ebu Bekri. Ai, herë vinte nga pas të Dërguarit të Allahut, herë ecte përpara, për t'u paraprirë rreziqeve. Ai, të Dërguarit të Allahut, që e pati pyetur, '*O Ebu Bekër, po pse më del njëherë nga para, e njëherë më vjen nga pas?*', i pati dhënë këtë përgjigje:

- "O Resulullah, sa herë që në mendje më shkon se mund të na vijnë nga pas, dal t'ju vij nga pas, e, sa herë që në mendje më vjen se mund të na dalin nga përpara, të na ndërpresin rrugën, dal para, që të jem unë i pari që do të përballem me ta!" I Dërguari i Allahut i pati thënë:

- "*Më thuaj, o Ebu Bekr, a do që të të ndodhë ty e keqja që do të më ndodhte mua?*"

- "Po!", i qe përgjigjur Ebu Bekri.

---

[3]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 24/106 (284).

- "Atë dua, të betohem për Allahun që të dërgoi ty me fenë e së vërtetës, që atë dua!" Kur mbërritën në grykën e shpellës, Ebu Bekri i pati thënë Profetit tonë:

- "O Resulullah, ti më mirë prit këtu, të hyj njëherë unë, që edhe ta pastroj shpellën, të jetë e pastër kur të hysh ti." E pastroi atë shpellë, pastaj doli. Kur iu kujtua se një prej vrimave mes gurëve kishte mbetur ende e hapur, i tha:

- "Prit edhe pak, o Resulullah.", – dhe hyri prapë brenda dhe, pasi e mbylli edhe atë vrimë, doli dhe i tha:

- "Ejani, o Resulullah." Pasi i tregoi të gjitha këto, Omeri (radijallahu anhu) u tha kështu besimtarëve që ishin aty në atë çast:

- "Ju betohem për Allahun, se ja, ajo natë e mërgimit të Ebu Bekrit është më e mbarë se e tërë familja e Omerit!"[4]

Ebu Bekri (r.a.) shqetësohej për Resulullahun

Hasan Basriu tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe Ebu Bekri hynë në shpellë. Kur kurejshët, që kishin kohë që po e kërkonin kudo Profetin tonë, iu afruan hyrjes së shpellës dhe panë se aty kishte një rrjetë merimange, thanë:

- "Këtu nuk ka hyrë askush." Kur, në të vërtetë, brenda ishte i Dërguari i Allahut që po falte namaz në këmbë dhe Ebu Bekri që bënte roje. Ebu Bekri i foli:

- "O Resulullah, këta janë duke të kërkuar ty. Uallahi nuk më vjen aspak keq për veten, por kam shumë merak për ty, jam shumë i shqetësuar se mund të të ndodhë ndonjë gjë e keqe!" I Dërguari i Allahut ia priti duke i thënë:

- "*O Ebu Bekr, mos ki frikë! Allahu është me ne.*" Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër të kësaj ndodhie, i Dërguari Fisnik i thotë kështu:

- "*A nuk më thua, o Ebu Bekr; a është e drejtë që dikush të shqetësohet për dy vetë, i Treti i të cilëve është vetë Allahu?*"[5]

---

[4]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/180.
[5]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/181.

Suraka u vihet pas grupit të muhaxhirëve

Bera bin Azibi (radijallahu anhu) tregon: "Ebu Bekri i kishte blerë babait tim, Azibit, një samar për trembëdhjetë dirhemë dhe i pati thënë:

- "Jepja Berasë, ta çojë në shtëpinë time." Kurse babai im i tha:

- "Punë që nuk bëhet, vetëm me një kusht: po më tregove historinë e mërgimit!" Pas kësaj, Ebu Bekri filloi të tregojë historinë e mërgimit:

- "Kur ra errësira dolëm nga shpella dhe u nisëm për rrugë. Atë ditë dhe atë natë patëm bërë goxha rrugë, pasi kishim ecur edhe shpejt. Filloi vapa e drekës, kështu që unë fillova të shëtitja sytë përreth, mbase gjeja ndonjë vend për të gjetur pak hije. Sytë më zunë një shkëmb të madh, ndaj zbrita të shikoja; hija atje ishte e mirë. E pastrova vendin mirë e mirë dhe e bëra gati për Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i shtrova dhe një lëkurë të mirë që e mbaja për ta veshur dhe i thirra:

- "O Resulallah, ejani të pushoni pak." Profeti ynë erdhi dhe u shtri. Ndërkaq, unë dola sipër dhe po kontrolloja, a kishte ndonjë njeri përreth. Sytë më zunë një bari dhensh.

- "Djalosh, bariu i kujt je ti?", – e pyeta. Emrin që më dha e njihja, ishte dikush nga kurejshët, të cilin e njihja.

- "A ke ndonjë dele me qumësht?", – e pyeta.

- "Kam!", – m'u përgjigj ai.

- "A mund t'ia mjelësh qumështin për mua?", – e pyeta, e ai më tha:

- "Patjetër." Kapi menjëherë një dele dhe unë i thashë që t'ia pastronte mirë sisët deles, t'i pastronte mirë edhe duart dhe ai bëri ashtu siç i thashë. Me vete kisha një calik (enë uji), pjesën e sipërme të së cilës e kisha mbyllur me një copë beze. Bariu moli pak qumësht për mua. Që të freskohej pak, e derdha qumështi në një enë që e kisha marrë me vete. Pastaj, ashtu siç ishte, ia çova të Dërguarit të Allahut. Ai ishte zgjuar, ndaj ia dhashë enën, duke i thënë:

- "Urdhëroni, pijeni, o Resulullah." Piu sa më kënaqi që piu aq mirë.

- "Erdhi koha të nisemi për rrugë, apo jo?, – e pyeta unë dhe, sakaq, u nisëm menjëherë për rrugë. Kurejshët dhe shumë të tjerë ishin derdhur rrugëve, të kërkonin për ne. Megjithatë asnjëri syresh nuk mundi të na kapë, përveç Suraka bin Malik bin Xhu'shumit. Kur e pashë atë, i thashë të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulullah, ky njeri edhe pak dhe do të na arrijë!"

- "*Mos u mërzit, Allahu është me ne!*", – m'u përgjigj Krenaria e Njerëzimit.

Suraka na ishte afruar aq shumë, saqë mund t'ju them se distanca e mbetur nuk ishte më shumë se dy-tri shtiza.

- "O Resulullah, ky njeri po na arrin!", – i thashë unë të Dërguarit të Allahut dhe sakaq sytë m'u mbushën me lot.

- "*Po pse qan?*", – më pyeti.

- "Uallahi nuk qaj për vete; qaj për ty!"

Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut u lut me këto fjalë për atë njeri që po na arrinte:

- "*O Zot! Na ruaj ne prej tij ashtu si të duash Ti!*" Kur, sa hap e mbyll sytë, me të mbaruar lutja e Resulullahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), këmbët e kalit të atij njeriu u zhytën menjëherë në dheun e ngjeshur të asaj toke. Ai njeri u hodh menjëherë nga kali dhe thirri:

- "O Muhamed, unë e di që kjo është nga ato punët e tua. Lutju Allahut për mua, të më shpëtojë prej kësaj gjendjeje. Uallahi, kam për t'ua ngatërruar gjurmët të gjithë atyre që janë duke të kërkuar. Ja ku e ke harkun tim; merr një shigjetë dhe kur të shkosh në aksh vend do të hasësh në kopetë e mia të deveve dhe të deleve. Po ua tregove barinjve këtë shigjetë, kërkoju atyre dhe do të të japin sa të kesh nevojë." Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu përgjigj duke i thënë:

- "*Nuk kam nevojë as për devetë, as për delet e tua!*" U lut për Surakan dhe kali i Surakas shpëtoi, e Suraka u nis të kthehej te shokët e tij. Ne vazhduam rrugën. Më në fund mbërritëm në Kuba, që është shumë pranë Medinës. Njerëzit kishin dalë nëpër rrugë të prisnin të Dërguarin e Allahut, madje disa syresh ishin ngjitur nëpër çatitë e shtëpive. Me shërbëtorë e fëmijë ishin grumbulluar të gjithë, të kapur dorë për dorë dhe thoshin:

- "Allahu Ekber! Erdhi i Dërguari i Allahut! Erdhi Muhamedi!" Medinasit filluan të grindeshin me njëri-tjetrin, te kush do të shkonte Profeti atë ditë. I Dërguari i Allahut pati thënë:

- "*Sonte do të rri te bijtë e Nexharit, dajët e Abdulmuttalibit. Me këtë rast do të respektoj edhe kushërinjtë e mi.*" Sapo gdhiu, Ai shkoi në atë vend ku i ishte urdhëruar prej Allahut.[6]

Mbërritja e Profetit tonë në Kuba dhe në Medinë dhe gëzimi i pamasë i medinasve

Urue bin Zubejri (radijallahu anhu) na ka treguar: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në rrugë e sipër u takua me Zubejr bin Auamin, i cili po udhëtonte me një karvan tregtarësh myslimanë që po ktheheshin nga Damasku. Zubejri i veshi të Dërguarin e Allahut dhe Ebu Bekrin me rroba të bardha.

Myslimanët e Medinës e kishin dëgjuar që Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte nisur nga Meka. Prandaj, çdo ditë paradreke ata dilnin në vendin e quajtur "Harre" dhe vështronin rrugën të emocionuar, derisa fillonte të binte i nxehti përvëlues i drekës. Edhe një ditë, kishin dalë dhe kishin pritur për një kohë të gjatë, por pastaj qenë kthyer, e secili kishte shkuar në shtëpinë e vet. Në atë kohë, një hebre ishte ngjitur në një prej majave më të larta që u përkisnin hebrenjve për një punë të vetën. Sytë i patën zënë menjëherë Resulullahun dhe sahabët e tij që vinin të mbuluar në të bardha, të cilët po vinin duke çarë në mes vapën e rrezet e diellit. Hebreu nuk e mbajti dot veten, ndaj bërtiti me sa zë të kishte në kokë:

- "O arabë! Ja tek po vjen ai njeri të cilin keni ditë që po e prisni!" Myslimanët, një të dëgjuar atë zë, morën menjëherë armët, çallmat dhe dolën që ta prisnin të Dërguarin e Allahut në Harre. I Dërguari i Allahut, bashkë me ata që po vinin me të dhe me të gjithë ata që kishin dalë për ta pritur, morën drejt anës së djathtë të Medinës, ku ishte lagjja e bijve të Amr bin Aufit. Ishte një ditë e hënë e muajit Rabiul-euuel. Me ata që kishin dalë për të pritur, foli Ebu Bekri. Madje, ata ensarë që nuk e kishin parë ndonjëherë më parë Profetin tonë, kur

[6]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/187-188.

mbërritën, ata përshëndetën të parin Ebu Bekrin, duke i thënë 'mirë se na erdhët!' Njerëzit e kuptuan se kush ishte i Dërguari i Allahut vetëm kur Ebu Bekri zgjati teshat e tij për të mbuluar diellin që kish filluar t'i binte të Dërguarit të Allahut në fytyrë.

I Dërguari i Allahut ndenji për afro dhjetë net te bijtë e Amr bin Aufit. (Gjatë kësaj kohe ai krijoi kushtet e një faltoreje, duke u bazuar në parimin e devotshmërisë dhe fali namaz atje.) Mandej, ai i hipi devesë dhe u largua bashkë me një grup shumë të madh njerëzish. Kur mbërriti brenda në Medinë, deveja u ul vetë në vendin ku ngrihet sot xhamia e Resulullahut. Zaten edhe një pjesë e myslimanëve aty kishin falur namazin deri asokohe. Ajo tokë ishte një kopsht hurmash që u përkiste dy jetimëve të quajtur, njëri Suhejl, e tjetri Sehl, që i kishte nën kujdestari Esad bin Zurareja (radijallahu anhu). Kur deveja e të Dërguarit u ul pikërisht në këtë vend, ai tha:

- "*Me lejen e Zotit, ky është vendi i faljes.*" Pastaj Resulullahu i thirri ata djem jetimë dhe u kërkoi që t'ua blinte atë tokë me vlerën që ajo kishte asokohe, për ta bërë faltore të myslimanëve. Ata djem i thanë: kjo ishte një punë që nuk bëhej me para.

- "Jo. Kjo nuk bëhet me para. Ne atë do të ta dhurojmë ty, o Resulullah!" I Dërguari i Allahut nuk donte të pranonte dhuratën e dy fëmijëve jetimë, ndaj ua bleu tokën me para. Pastaj, aty u ndërtua xhamia ku do të faleshin myslimanët.

I Dërguari i Allahut mbante qerpiçë me krahë, bashkë me sahabët, duke u ardhur atyre në ndihmë gjatë ndërtimit të faltores dhe teksa ua çonte ato sahabëve të tij, murmurinte këto vargje:

- "*Kjo barrë nuk është si barra e hurmave të famshme të Hajberit. Por këta qerpiçë janë më të mirë e më të pastër se çdo gjë tjetër. S'ka dyshim, shpërblimi i vërtetë është ai që do të jepet në ahiret. Zoti ynë, mëshiroji Ti Ensarët dhe Muhaxhirët!*"[7]

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) ka thënë kështu:

- "Unë po vrapoja mes fëmijëve. Të gjithë po thoshin:

- "Ka ardhur Muhamedi!" Unë vrapoja, po ende nuk po e shikoja

[7]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/186.

dot. Pastaj ata filluan prapë të thoshin:

- "Ka ardhur Muhamedi!" Unë vrapoja prapë, po nuk shikoja dot gjë. Më në fund, Profeti ynë i nderuar dhe shoku i tij, Ebu Bekri, erdhën. Ne ishim fshehur në një prej rrënojave të Medinës. Për t'i lajmëruar Ensarët se kishin ardhur, ata dërguan dikë nga fshati. Me të marrë lajmin, pesëqind vetë nga Ensarët i dolën përpara, për ta pritur. Ensarët brohorisnin:

- "Tani je në tokë të sigurt, e ne nën urdhrat e tua na ke, mirë se erdhët." Pas kësaj, i Dërguari i Allahut dhe shoku i tij filluan të ecin në mesin e Ensarëve. Jashtë kishte dalë e tërë Medina. Vajzat e rritura ishin ngjitur mbi tarracat e shtëpive dhe i thoshin njëra-tjetrës:

- "Kush është Muhamedi prej këtyre të dyve?" Ishte hera e parë që shikonim një skenë si ajo.

Enesi (radijallahu anhu) thotë se:

- "Kam qenë i pranishëm, si në atë ditë, kur, në Medinë, erdhi Profeti ynë, ashtu edhe në atë ditë kur ai u largua nga kjo jetë. Ditë si ato të dyja nuk më kanë zënë kurrë më sytë!"

Veç kësaj, sipas asaj që na përcillet nga ana e Bejhakiut, "kur Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mbërriti në Medinë, gratë dhe fëmijët e pritën me këto fjalë: "Ne mbi krye Hëna se ç'na lindi, tej nga majat e Uedasë / Të falënderojmë duhet, se Allahu ne na ftoi."[8]

2. HIXHRETI I OMERIT (r.a.) DHE I SAHABËVE TË TJERË

Ata që mërguan të parët nga Meka Fisnike për në Medinën e Ndritur

Bera bin Azibi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Të parët sahabë të Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) që erdhën te ne ishin Musab bin Umejri me Ibni Umi Mektumin (radijallahu anhuma). Ata na mësuan Kur'anin. Më vonë erdhën edhe Amari, Bilali dhe Sadi. Fill pas tyre, bashkë me një karvan të përbërë prej njëzet vetash, erdhi edhe Omer bin Hatabi (radijallahu anhu). Më vonë pati ardhur Profeti ynë. Nuk i kam parë ndonjëherë medinasit që të jenë kënaqur ndonjëherë aq

[8]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/197.

shumë për ndonjë gjë tjetër. Para se i Dërguari i Allahut të nderonte Medinën me ardhjen e tij, unë kisha lexuar suren 'A'la' dhe disa sure të tjera të Kur'anit."[9]

Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Kur unë vendosa të mërgoja për në Medinë, e lamë me Ajash bin Ebi Rabian dhe Hisham bin Asin, që të takoheshin në vendin e quajtur Sherif, i cili gjendej në luginën ku ishte hauzi i bijve të Gifarit dhe me njëri-tjetrin folëm që "kushdo që nuk vjen në mëngjes ose vonohet, të tjerët nuk do të presin, por do të vazhdojnë rrugën." Unë me Ajashin u takuam në luginë. Hishami nuk erdhi. "E humbi mundësinë.", – i thamë ne njëri-tjetrit. Kur mbërritëm në Medinë, zbritëm në tokat e bijve të Amr bin Aufit në Kuba. Mirëpo në Medinë erdhën edhe Ebu Xhehli me Harith bin Hishamin, për të marrë mbrapsht djalin e xhaxhait të tyre, Ajashin, të cilin e kishin edhe vëlla nga nëna gjithashtu, e të ktheheshin në Mekë bashkë me të. Asokohe, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte ende në Mekë. Ata folën me Ajashin. I thanë:

- "Nëna është betuar, se nuk do ta çojë më krehrin në kokë, do ta braktisë jetën; nuk do të ulet më në hije." Ajashit filloi t'i vinte keq për nënën e tij. I thashë:

- "Uallahi, qëllimi i tyre është të të bëjnë të heqësh dorë nga feja, bëj kujdes! Uallahi, nëna, me të filluar t'i zënë flokët morra, nga shqetësimi do të fillojë t'i krehë flokët, ashtu siç edhe kur i nxehti i Mekës t'i bëhet i padurueshëm, ajo nuk do ta përballojë dot e do të futet menjëherë në hije! Mos më thuaj që nuk të thashë!"

- "Po mirë, kështu as nuk e hedh poshtë betimin e nënës, as nuk më mbetet pasuria që kam atje havadan. Mund të shkoj e t'i marr."
- "Uallahi, ti e di shumë mirë, se unë jam më i pasuri në të gjithë Kurejshin; merr gjysmën e pasurisë sime ta kam falur, por mos u kthe me ta."

Kur ai këmbënguli se do të kthehej me ta, i thashë:

- "Meqë po këmbëngul kaq shumë, atëherë merr këtë devenë time. Është kafshë e urtë dhe e pastër, në daç hipi, në daç mos i zbrit fare. Po fillove të dyshosh prej tyre, mbi shpinën e saj mund të shpëtosh kokën."

[9]. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef,* 7/344 (36611).

Ata dolën të gjithë bashkë nga Medina. Pasi bënë një copë rrugë, Ebu Xhehli i tha Ajashit:

- "O vëlla, uallahi, mua m'u lodh deveja, a t'i ndërrojmë?"

- "Po, mirë, i ndërrojmë.", – i tha Ajashi dhe, sakaq, e bëri devenë të ulej. Edhe të tjerët ulën devetë e tyre. Kur zbritën, ata iu vërsulën Ajashit, e mbërthyen dhe e lidhën; duke vepruar kështu ata menduan se po ta fusnin në Mekë ashtu të lidhur dhe t'i kërkonin që të kthehej sërish në fenë e të parëve, ai do të pranonte. Ne mendonim se, "Allahu i Madhërishëm nuk e pranon pendimin e atij që kthehet nga feja e Allahut." Të këtij mendimi ishin edhe gjithë të tjerët që linin fenë e tyre, për të besuar në një fe tjetër. Kur Profeti ynë erdhi në Medinë, Allahu pati zbritur ajetet 53-55 të sures "Zumer":

"**Thuaj: 'O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.' Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij, para se t'ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t'ju ndihmojë kush. Ndiqni më të mirën e asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë dënimi papritmas, pa e ndier atë, që të mos thotë njeriu: 'Mjerë për mua që nuk i kam kryer detyrimet ndaj Allahut, madje, edhe jam tallur!'**"

Unë i shkrova menjëherë këto ajete dhe ia nisa Hisham bin Asit."

Hishami thotë se: "Kur e mora letrën, fillova ta lexoja atë në vendin e quajtur Dhi-Tuva. Mirëpo, nuk e kuptoja plotësisht, se çfarë do të thoshte. Më vonë u luta:

- "O Zot, jepi shpirtit tim frymëzim që ta kuptoj domethënien e këtyre ajeteve". Pas kësaj lutjeje, Allahu më fali një frymëzim në zemër, e unë fillova të ndieja se këto ajete ishin zbritur për ne që mendonim se pendesa jonë nuk do të pranohej dhe për të gjitha ç'thuheshin për ne. Shkova menjëherë te deveja ime dhe i hipa mbi shpinë, u nisa me shpejtësi dhe shkova t'i bashkohesha Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në Medinë."[10]

[10]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 3/604.

3. HIXHRETI I OSMAN BIN AFANIT (r.a.)

Ebu Katade (radijallahu anhu) tregon: "I pari që mërgoi në rrugën e Allahut bashkë me familjen e tij ishte Osman bin Afani. Unë e kam dëgjuar nga Nadr bin Enesi. Kurse ai kishte dëgjuar të atin, Enesin, kur tregonte: Osman bin Afani dhe bashkëshortja e tij Rukija, u nisën të shkonin në Abisini. I Dërguari i Allahut nuk po merrte asnjë lajm prej tyre, ndaj dilte në rrugë dhe priste mos vinte ndokush dhe i thoshte ndonjë të re për Osmanin. Kur, një ditë, një nga gratë e kurejshëve i tha atij:

- "O Muhamed, pashë dhëndrin tënd, kishte edhe të shoqen me vete."

- "*Po si ishin?*", – e pyeti Profeti ynë atë grua.

- "E kishte hipur të shoqen në një gomar shumë të dobët, thuajse të mbaruar fare, si këto kafshët që janë gati për të ngordhur; ndërsa vetë ecte përpara, duke tërhequr gomarin nga pas."

- "*Allahu i Madhërishëm qoftë i dashuri dhe ndihmëtari i tyre. Pas Lutit (alejhis'selam), Osmani është myslimani i parë që po mërgon me gjithë familjen.*", – tha ai.[11]

4. HIXHRETI I ALIUT (r.a.)

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë: "Atëherë kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mërgoi për në Medinë, mua më tha se duhet të qëndroja në Mekë edhe për njëfarë kohe, e më pati porositur që t'u shpërndaja disa porosi për ata që më pati dhënë emrat. Atë, prandaj e quanin "i Besuari", sepse nuk linte amanet pa e ndjekur gjer më një. Pasi ikën ata, unë qëndrova edhe tri ditë të tjera. Vija vërdallë dhe nuk u fsheha qoftë edhe për një çast të vetëm. Pastaj ndoqa itinerarin që më pati këshilluar i Dërguari i Allahut se duhet të ndiqja dhe shkova në tokat e bijve të Amr bin Aufit. Aty qëndronte Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Mua më priti mysafir Kulthum bin Hidmi. Aty ishte vendosur edhe i Dërguari i Allahut."[12]

[11]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/66; Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/305.
[12]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 16/956 (46324).

5. HIXHRETI I XHAFER BIN EBI TALIBIT DHE I DISA SAHABËVE TË TJERË, NJËHERË NË ABISINI, MANDEJ NË MEDINË

Kurejshët dërgojnë Amr bin Asin, që t'i kërkojë Nexhashiut t'i kthejë mbrapsht sahabët e strehuar tek ai

Umu Selemeja (radijallahu anha) tregon: "Sahabëve të të Dërguarit të Allahut, për shkak të vuajtjeve, vështirësive dhe torturave që mekasit ushtronin mbi ta, Meka kishte filluar t'u rrinte ngushtë, madje kishte edhe nga ata që ishin detyruar të hiqnin dorë nga feja e tyre. Askush nuk e prekte të Dërguarin e Allahut, pasi atë e kishin marrë në mbrojtje fisi i vet dhe xhaxhai në veçanti, e atij nuk i bëhej asgjë nga ato që u bëheshin sahabëve të tij. Duke qenë se Resulullahut nuk i mjaftonte forca për t'i penguar torturat që ushtroheshin mbi sahabët, ai u tha atyre:

- "*Në Abisini është një mbret; askujt nga njerëzit që jetojnë nën sundimin e tij nuk i bëhet asnjë padrejtësi. Hajde, nisuni dhe shkoni atje. Të qëndroni atje, derisa Allahu i Madhërishëm të tregojë një rrugëzgjidhje dhe çlirimin e vërtetë për ju!*" Kësisoj, ne u ndamë në grupe, që të mërgonim për në Abisini. Më në fund, ne u takuam të gjithë atje. Ishim strehuar te një vend dhe te një fqinj shumë i mirë. Askush nuk na kanosej për shkak të fesë sonë, e ne nuk kishim as pikën e frikës, se mos dikush na bënte keq pse ishim myslimanë. Kur kurejshët morën vesh se ne kishim ikur në një vend të sigurt, atyre nuk u erdhi aspak mirë. Organizuan menjëherë një mbledhje enkas për ne dhe për të bindur Nexhashiun, sundimtarin e Abisinisë, që të na kthente pas, vendosën të dërgonin një përfaqësues. Si përfaqësues zgjodhën Amr bin Asin dhe Abdullah bin Ebi Rabian. Ata u dhanë atyre me vete dhurata për të gjithë, pa përjashtim, duke filluar nga vetë Nexhashiu e deri tek të gjithë komandantët e ushtrisë së tij dhe i porositën:

- "Para se të flisni me ta, jepuni atyre, komandantëve, dhuratat njëherë. Pastaj çojini edhe Nexhashiut dhuratat e tij. Po mundët, përpiquni të arrini t'i merrni myslimanët në dorëzim, para se të flasë

Nexhashiu me ta!"

Erdhën Amri me Abdullahun. U dhanë dhuratat secilit prej komandantëve. Të gjithë komandantëve me të cilët u takuan, ata u thanë:

- "Ne na ka dërguar paria jonë, që t'ju kërkojmë të na dorëzoni ata budallenjtë tanë, që kanë braktisur fenë dhe popullin e tyre dhe kanë ardhur të gjejnë mbështetje pranë mbretit tuaj. Ju lutemi, kur ne të flasim me mbretin tuaj, bëjini atij një shenjë, që ta pranojë kërkesën tonë." Dhe ata pranuan të gjithë. Mandej ata shkuan te Nexhashiu, për t'i dhënë atij dhuratat që i kishin dërguar kurejshët. Dhurata e mekasve që i pëlqeu më së shumti Nexhashiut, ishin tabakët e lëkurëve të kafshëve. Kur i çuan përpara mbretit, ata i thanë atij:

- "O sundimtar! Disa të rinj pa mend tanët, kanë braktisur fenë dhe popullin e tyre dhe kanë ardhur të strehohen në tokat tuaja, pa e pranuar fenë tënde. Ata kanë shpallur një fe të re, të sajuar, që ne as nuk e njohim, as nuk e pranojmë. Tani ata janë strehuar në tokat tuaja. Të afërmit, baballarët, xhaxhallarët dhe familjet e tyre na kanë dërguar ne tek ti, e të luten që ti t'ua kthesh ata atyre, sepse ata i njohin më mirë se ju këta që kanë ardhur këtu. Ata nuk kanë pranuar as fenë tënde, që ti t'i pranosh e të kujdesesh për ta!"

Nexhashiu u nevrikos shumë dhe iu përgjigj:

- "Jo! Nuk kam për t'jua dhënë kurrë!", – dhe shtoi:

- "Unë ju betohem për Zotin, se pa i thirrur njëherë këtu, përpara meje, e pa e kuptuar mirë e mirë se si qëndron puna e ç'na qenka kjo fe e tyre, unë nuk kam për t'jua dorëzuar ata kurrë! Ata janë njerëz që kanë ardhur të kërkojnë mbrojtje nga unë, pra janë njerëz që kanë zgjedhur mbrojtjen time para mbrojtjes që mund t'u jepnin shumë njerëz të tjerë. Nëse është ashtu siç thonë të afërmit e tyre, atëherë po, mund edhe t'jua dorëzoj. Po, nëse nuk është ashtu e vërteta, atëherë ata do t'i mbroj unë; nuk do t'i poshtëroj ata duke i kthyer mbrapsht, e t'jua lë juve në dorë!

Biseda që u zhvillua mes sahabëve të të Dërguarit të Allahut dhe Nexhashiut

Kur dolën para Nexhashiut, myslimanët e përshëndetën atë me përshëndetjen e Islamit. Nuk iu përulën. Atëherë Nexhashiu u tha:

- "O njerëz, pa më thoni, pse nuk më përshëndetët edhe ju ashtu siç më përshëndetën këta njerëz që kanë ardhur po nga populli juaj? Çfarë mendimi keni ju për profetin Isa? Cila është feja juaj? Të krishterë jeni ju?"

- "Jo!", – u përgjigjën ata.

- "Po çfarë jeni atëherë, judenj?"

- "Jo!", – u përgjigjën ata sërish.

- "Atëherë cilës fe i përkisni ju?"

- "Feja jonë është Islami.", – thanë ata.

- "Ç'është Islami?", – filloi t'i pyesë Nexhashiu.

- "Ne adhurojmë vetëm Allahun, duke mos i bërë Atij as shok, as ortak, në krijimin e gjithësisë! Nuk njohim zot tjetër përveç Tij!"

- "Kush ju futi ju në këtë fe?", – vazhdoi t'i pyesë Nexhashiu.

- "Ai që na e solli këtë fe është një prej nesh. Ne e njohim shumë mirë atë, ashtu siç njohim edhe farefisin e tij. Allahu na e ka dërguar ne atë si profet, ashtu siç u pati dërguar profetë edhe shumë popujve të tjerë përpara nesh. Ai na ka urdhëruar ne të bëjmë mirë, të japim lëmoshë, t'i qëndrojmë besnikë fjalës së dhënë dhe të kujdesemi për gjithë ç'na lihet amanet. Ai na ka ndaluar të adhurojmë idhujt dhe na ka urdhëruar që adhurimet të mos i kryejmë vetëm se për Allahun, i Cili është Një dhe i Vetëm e nuk ka asnjë shok a ortak në krijimin e gjithësisë. E, kështu, ne e pranuam dhe e mësuam fjalën e Allahut, sepse kemi besim të plotë që ato që profeti na ka sjellë janë prej Allahut. Dhe, kur ne bëmë kështu, atëherë populli ynë u bë armiku më i madh i profetit të drejtë dhe i të gjithë neve, besimtarëve: e përgënjeshtruan, deshën edhe që ta vrisnin dhe ç'nuk bënë që të na detyrojnë, që ne t'u përulemi zotave të tyre. Andaj, ne vendosëm të largohemi nga njerëzit tanë, që të mund të shpëtojmë jetën dhe besimin tonë.", – i thanë ata

Nexhashiut.

Nexhashiu u tha:

- "Uallahi, feja që ju më përshkruat dhe feja e Musait i përkasin të njëjtit burim.", – atëherë Xhaferi (radijallahu anhu) vazhdoi të shpjegojë:

- "Ndërsa, për sa i përket çështjes së përshëndetjes: Profeti ynë na ka mësuar neve se përshëndetja e banorëve të Xhenetit është thjesht "es-selam", ndaj edhe na ka urdhëruar që edhe ne kështu t'i përshëndetim njerëzit. Për këtë arsye, ne ju përshëndetëm edhe ju ashtu siç përshëndetim njëri-tjetrin, me mënyrën më të mirë të mundshme. Kurse, për çështjen e Isait, të birit të Merjemit, ne dimë: Ai është robi dhe i dërguari i Zotit. Ai është një Fjalë e Allahut të Madhërishëm, që Ai ia përçoi Merjemit. Ai është i biri i Merjemit, që ishte një grua shumë e ndershme dhe e virgjër." Me të dëgjuar këtë fjalë, Nexhashiu mori një shkop dhe tha:

- "Fjalët e Isait, të birit të Merjemit, nuk kanë qenë më shumë se fjalët që tha ky njeri, as sa pesha e papërfillshme e këtij shkopi që kam në dorë." Kur Nexhashiu tha këto fjalë, e tërë paria e Abisinisë, që gjendej e pranishme aty në ato çaste, i thanë atij:

- "Uallahi, po të dëgjoi populli duke folur kështu, kanë për të të zbritur nga froni."

- "Unë ju betohem në Allahun, se unë nuk them asgjë më tepër për Isain (alejhis'selam). Allahu i Madhërishëm, kur ma dha mua këtë fron, nuk iu bind dëshirave që kishte populli im për mua, që unë të ul kokën e t'u bindem dëshirave të njerëzve kur të mendoj a të flas për fenë e Allahut. Zoti më ruajttë nga diçka e tillë!", – tha ai.[13]

Në një transmetim tjetër që i bën Imam Ahmedi nga bashkëshortja e tij, Umu Selemeja (radijallahu anha) kësaj ngjarjeje, ne dallojmë edhe disa hollësi të tjera: - "... Nexhashiu dërgoi një njeri për të thirrur sahabët. Kasneci i Nexhashiut shkoi i lajmëroi dhe sahabët u mblodhën menjëherë. Kur disa syresh i pyetën:

- "Çfarë do t'i thoni Nexhashiut për Isain (alejhis'selam) kur të dilni

[13]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 1/201 (1740).

përpara tij?", – ata iu përgjigjën me këto fjalë:

- "Uallahi, ato që dimë do t'i tregojmë. Ne nuk do të bëjmë asgjë tjetër, pos asaj që Profeti ynë na ka urdhëruar të themi!"

Ata i çuan pranë Nexhashiut dhe aty ishin mbledhur edhe dijetarët e krishterë, që kishin hapur librat përpara tyre dhe qëndronin përreth Nexhashiut. Ai i pati pyetur sahabët:

- "Ç'është kjo fe që ju ka bërë të largoheni nga njerëzit tuaj? Ndërkohë që, me ç'kam dëgjuar, ju as nuk jeni bërë të krishterë, as keni zgjedhur fenë e ndonjë prej popujve të tjerë përreth."

Në emër të të gjithë sahabëve foli Xhaferi (radijallahu anhu), i cili dha këtë përgjigje:

- "O sundimtar! Ne ishim një popull i paditur dhe tejet i ashpër. Adhuronim idhuj, hanim mish të ngordhur dhe nuk linim imoralitet pa kryer. Nuk i ruanim marrëdhëniet e ngushta me të afërmit dhe e nëpërkëmbnim raportin me fqinjët tanë dhe nuk kujdeseshim që të ishim sa më të drejtë me ta. Kush ishte më i fortë mund t'i shtypte të gjithë ata që ishin më të dobët. Megjithëse në këtë gjendje, Allahu i Madhërishëm na dërgoi neve si profet një njeri, të cilit ne ia njihnim shumë mirë, si prejardhjen, ashtu edhe drejtësinë dhe që ishte më i besuari dhe më i ndershmi ndër të gjithë ne. Ai ne na bëri thirrje që ne të njohim Allahun, ta adhurojmë Atë, duke i braktisur të gjithë idhujt që kishin adhuruar të parët tanë më parë dhe ne tani. Ai na urdhëroi të mos flisnim asgjë përveç së vërtetës, të tregoheshim të besës ndaj amanetit, t'i ruanim lidhjet të forta me prindërit, të silleshim mirë me fqinjët dhe të mos derdhnim gjak. Ai na e ndaloi ne që të biem pre e epshit tonë, të bëhemi dëshmitarë në të rreme, të hamë nga pasuria e atyre që janë jetimë dhe të shpifim për gratë e ndershme. Ai na tha të adhuronim Allahun, të mos i bënim Atij asnjë shok, apo ortak, të falim namazin dhe të japim zekatin. Dhe ne pranuam, i besuam atij dhe vendosëm t'i ndjekim pikë për pikë gjithë sa ai na ka sjellë. Ne jemi robër të Allahut që është Një, i Vetëm. Filluam të mos i bëjmë Atij asnjë objekt si shok a ortak. I quajtëm të ndaluara të gjitha ato që Allahu na i shpalli të ndaluara (haram) dhe të gjitha ato që Ai na i shpalli si të lejuara (hallall) i quajtëm të lejuara. Për këtë, populli

ynë u armiqësua me ne dhe filluan të ushtrojnë gjithfarë torturash ndaj nesh. Na detyronin që ne të hiqnim dorë prej Allahut dhe të adhuronim idhujt, të kthehesim nga feja dhe t'i quanim 'të lejuara' të gjitha ato ndyrësi që ne bënim më parë. Na ushtruan trysni aq shumë sa padrejtësia filloi të bëhej e padurueshme dhe, që të mos i lejonim më që të hynim mes nesh dhe fesë sonë, vendosëm të mërgonim e të vinim në vendin tënd, duke të zgjedhur ty para të tjerëve, pasi shpresuam se ti do të na mbrosh.

O Sundimtar! Ne erdhëm këtu me shpresën se ti nuk do të tregohesh i padrejtë karshi nesh."

Nexhashiu i pyeti:

- "A keni me vete ndonjë gjë nga ato që ju ka prurë ai profet nga Allahu?"

- "Po, kemi!", – iu përgjigj Xhaferi.

- "Ma lexo atëherë.", – urdhëroi Nexhashiu.

Paskëtaj Xhaferi (radijallahu anhu) u lexoi atyre që ishin të pranishëm një pjesë nga sureja "Merjem". Nexhashiut iu mbushën sytë me lot dhe nisi të qante; aq shumë qau, saqë lotët ia lagën krejt mjekrën. Bashkë me të qanë edhe përfaqësuesit e fesë së krishterë, që qëndronin pranë tij; aq shumë qanë, sa që lotët ua lagën krejt faqet e librave që i kishin të hapur përpara duarve. Pastaj Nexhashiu tha:

- "Këto që ju më lexuat mua janë të vërteta dhe i përkasin të njëjtit burim prej nga kanë ardhur edhe ato të vërteta që iu dërguan Musait!" U drejtua nga Amr bin Asi dhe Abdullahu që kishin nisur kurejshët, duke u thënë:

- "Ju ikni. Uallahi, unë këta njerëz nuk do t'jua dorëzoj kurrë, as nëpër mendje të mos e çoni!"

Umu Selemeja thotë se: "Kur ata dy mëkëmbës, Amri dhe Abdullah bin Ebi Rabia, u larguan prej Nexhashiut, Amri i tha shokut të tij:

- "Uallahi, unë do të shkoj nesër te Nexhashiu dhe do t'u flas aq keq për ata, saqë Nexhashiu do të dojë t'i fshijë nga sytë këmbët!" Më duket, se Abdullah bin Ebi Rabia, i cili ishte pak më i kuptueshëm, i tha atij:

- "Për mua mos e bëj këtë, o Amr, edhe pse i kemi kundërshtarë, ata janë të afërmit tanë."

- "Uallahi, unë do t'ia them Nexhashiut, që ata thonë se profeti Isa ishte 'rob' i Allahut!" Ditën tjetër, ata shkuan pranë mbretit dhe Amri i tha:

- "O sundimtar i Abisinisë! Ata thonë edhe fjalë shumë të rënda për Isain, të birin e Merjemit. Dërgo fjalë t'i thërrasin dhe pyeti edhe njëherë se çfarë thonë për profetin Isa!" Nexhashiu u dërgoi fjalë myslimanëve që të vinin pranë tij, sepse do t'u bënte disa pyetje për profetin Isa.

Nëna jonë, Ummu Selemeja thotë se:

- "As që na kishte shkuar në mendje diçka e këtillë. Disa myslimanë na thanë:

- "Çfarë do të thoni po ju bëri pyetje për Isain, të birin e Merjemit?"

- "Uallahi, ne do t'i themi ato që na kanë thënë Allahu i Madhërishëm dhe Profeti i Tij!", – u përgjigjën të tjerët. Myslimanët shkuan pranë Nexhashiut dhe ai filloi t'i pyesë:

- "Çfarë janë ato që ju mendoni e thoni për Isain, të birin e Merjemit?"

Xhafer bin Ebi Talibi iu përgjigj:

- "Ato që ne mund t'ju themi ju rreth tij janë ato të vërteta që na ka thënë Profeti ynë: "Isai është robi dhe i dërguari i Allahut. Ai është një fjalë e Allahut të Madhërishëm, që Ai ia la si amanet Merjemit, mishërimit të dëlirësisë."

Nexhashiu zgjati dorën dhe mori një shkop nga toka dhe tha:

- "Uallahi, mes atyre që thotë ky njeri për Isain dhe asaj që themi ne për të nuk ka dallim as sa ç'është i hollë ky shkop që unë mbaj në duar!"

Patriarkët që ishin aty të pranishëm, e që i dëgjuan këto fjalë të Nexhashiut, vrenjtën buzët. Nexhashiu u tha:

- "Daç t'ju vijë mirë, daç të mos ju vijë mirë e t'ju nevrikosë kjo që them unë, por kjo është e vërteta!"

Kurse myslimanëve u tha:

- "Ikni tani, se ju do të jeni të sigurt në tokat e mia. Kushdo që ju fyen ju do të ndëshkohet, se sikur edhe male të tëra me florinj të më sjellin, që unë të shqetësoj ndonjërin prej jush, nuk kam për t'i pranuar!", – duke i përsëritur plot tri herë fjalitë e tij të fundit. Ai iu drejtua njerëzve që kishte pranë, duke u thënë:

- "Tani kthejuani këtyre njerëzve pas të gjitha dhuratat që kanë sjellë për mua, nuk kam nevojë për to. Uallahi, Allahu i Madh mua nuk më pati marrë ndonjë ryshfet kur më dha mundësinë e mbretërimit, kështu që unë nuk mund të marr ryshfet në këmbim të fesë së Tij! E kur ma dorëzoi mua këtë fron, nuk pyeti njëherë njerëzit, që mua të më duhet t'u bindem njerëzve për fenë e Tij!" Amri me Abdullahun u ndienë sikur t'ua kishin përplasur fytyrës ato dhurata, aq të rënda ishin këto fjalë për ta, kështu që u larguan në një gjendje aspak të këndshme prej Nexhashiut.

"Tanimë ne jetonim në një vend shumë të bukur, nën mbrojtjen e një fqinji shumë të mirë. Ai kujdesej jashtëzakonisht shumë për ne, çka bëri që një ditë dikush t'i kanosej se do t'ia merrte fronin nga duart. Uallahi, sa jemi mërzitur atëherë nuk mbaj mend të ishim mërzitur ndonjëherë më herët. Qemë frikësuar se ai njeri mund ta mundte Nexhashiun, ndaj edhe qemë mërzitur shumë, sepse Nexhashiu që ruante me përpikëri çdo të drejtë tonën, do të ikte, e në vend të tij do të vinte dikush që nuk na njihte." Nexhashiu i shtypi ata, mes kryengritësve dhe atij qëndronte lumi Nil. Sahabët e Resulullahut bisedonin me njëri-tjetrin:

- "Kush do të shkojë të shohë çfarë po ndodh, e të vijë të na e njoftojë edhe neve?"

- "Shkoj unë.", – u hodh e tha Zubejr bin Auami, që ishte edhe më i riu nga ne.

- "Po mirë, shko ti!", – thanë të tjerët.

Paskëtaj frynë një calik. Ai e lidhi atë fort pas kraharorit dhe me të u hodh në lumë, për të kaluar mes të dyja grupeve, që të kuptonte më mirë se çfarë ishte duke ndodhur. Ne iu lutëm pa ndërprerje Allahut, që të nxirrte fitimtar Nexhashiun, e të ishte po ende ai që do të sundonte

mbi njerëzit. Ndërkohë që prisnim se kush ishte përfundimi, që tutje ia behu Zubejri. Vinte duke vrapuar dhe rrobat i kishte qull në ujë.

- "Lajme të gëzuara! Lajme të gëzuara! Fitimtar doli Nexhashiu! Allahu i mundi armiqtë e tij, duke e kurorëzuar edhe njëherë mbret të vendit të vet.", – brohoriste ai. Aq shumë na gëzoi ky lajm kaq i bukur që po na jepte Zubejr bin Auami, saqë nuk mbaj mend të ishim gëzuar ndonjëherë më shumë se sa atë ditë. Nexhashiu u kthye si fitimtar; kishte vendosur edhe njëherë paqen në atdheun e tij. Kështu, ne vijuam të jetojmë të lumtur dhe të qetë në shtetin e Nexhashiut, derisa u kthyem pranë Profetit tonë në Mekë."[14]

Transmeton një njeri që e kishte dëgjuar nga Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu), se: "Kur Profeti ynë na pati dërguar ne te Nexhashiu, ne bëheshim gjithsej tetëdhjetë meshkuj. Në mes atyre që mërguan për në Abisini kishte edhe njerëz si Abdullah bin Mesudi, Xhafer bin Ebi Talibi, Abdullah bin Urfutaja, Osman bin Madhuni dhe Ebu Musa (radijallahu anhum). Pas mbërritjes së Mërgimtarëve në shtetin e Nexhashiut, kurejshët dërguan te Nexhashiu Amr bin Asin dhe Umare bin Uelidit, të cilëve u dhanë edhe shumë dhurata për mbretin e Abisinisë me vete. Kur dolën para Nexhashiut, këta dy përfaqësues e përshëndetën atë duke iu përulur në sexhde. Pastaj, njëri kaloi në anën e djathtë, e tjetri në anën e majtë të Nexhashiut. Ata e filluan fjalën e tyre duke thënë:

- "Në tokat e tua kanë ardhur disa kushërinj tanët. Ata janë dezertorë, që na kanë braktisur ne dhe, mbi të gjitha, kanë braktisur popullin e tyre."

- "Ku janë ata?", – pyeti Nexhashiu.

- "Këtu, në tokat e tua janë vendosur. Lajmëroji të vijnë.", – i thanë ata Nexhashiut.

Mbreti dërgoi menjëherë fjalë që t'i sillnin mërgimtarët myslimanë. Xhaferi (radijallahu anhu) pa nga shokët e tij dhe tha:

- "Sot në emrin tuaj do të flas unë." Ata e pranuan këtë gjë, ndaj e ndoqën nga pas. Kur mbërriti te mbreti, Xhaferi e përshëndeti atë

[14]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/24 (9842); Ibn Is'hak, *Sijer,* 9/144.

me përshëndetjen islame, jo duke iu përulur në sexhde. Ata që ishin të pranishëm filluan të reagonin duke thënë:

- "Pse nuk përulesh përpara mbretit tonë?"

- "Ne në sexhde i përulemi vetëm Allahut!", – u përgjigj Xhaferi.

- "Cila është arsyeja, pse veproni kështu?", – e pyeti sërish Nexhashiu.

- "Allahu na dërgoi ne një profet, e nëpërmjet tij, Ai na mësoi e na urdhëroi se si duhet t'i përulemi vetëm Atij në sexhde, të falim namazin dhe të paguajmë zekatin."

Aty ndërhyri dhe e mori fjalën menjëherë Amri, duke thënë:

- "Ata kanë një besim ndryshe nga i yti për Isain, të birin e Merjemit!"

- "Po mirë, pa më thoni, ç'janë këto që ju thoni për Isain, të birin e Merjemit?", – i pyeti ata Nexhashiu.

- "Ne besojmë ato që na ka thënë Allahu i Madhërishëm: Ai është fjala dhe fryma e Allahut, që Allahu ia çoi Merjemit, që ishte një grua e ndershme dhe e dëlirë, të cilën, deri në atë ditë, nuk e kishte prekur askush me dorë.", – i tha atij Xhafer bin Ebi Talibi. Kur dëgjoi këtë përgjigje, Nexhashiu mori një shkop nga toka dhe tha:

- "O njerëz të Abisinisë, ju o murgj dhe ju o priftërinj! Uallahi ata nuk thanë për Isain asgjë që nuk e themi edhe ne!" Pastaj, iu drejtua myslimanëve, duke u thënë kështu:

- "Përshëndetje për të gjithë ju, si edhe për atë njeri që ju ka dërguar ju këtu! Unë dëshmoj se ai duhet të jetë medoemos i Dërguari i Allahut. Ne i kemi lexuar cilësitë e tij edhe në Ungjill. Ai duhet të jetë profeti, për të cilin na ka lajmëruar edhe Isai, i biri i Merjemit! Zgjidhni një vend që ju pëlqen më së shumti prej vendit tim dhe vendosuni atje. Uallahi, po të mos kisha mbi supe këtë barrë të fronit, do të kisha shkuar menjëherë tek ai njeri, që t'i shërbeja e të isha unë ai që do t'i lidhte sandalet!" Pastaj u dha urdhër njerëzve të tij, që kurejshëve t'u jepeshin me vete të gjitha dhuratat që ata kishin sjellë për të.

Abdullah bin Mesudi nuk qëndroi edhe shumë gjatë në Abisini. Kur Profeti ynë u tha sahabëve që të mërgonin drejt Medinës, edhe ai u

largua prej andej, shkoi në Medinë dhe mori pjesë në luftën e Bedrit."[15]

Xhafer bin Ebi Talibi (radijallahu anhu) tregon: "Kurejshët dërguan te Nexhashiu Amr bin Asin me Umare bin Uelidin, duke u dhënë edhe shumë dhurata me vete për Nexhashiun, në emër të Ebu Sufjanit. Kur ishim në shtetin e Nexhashiut, përfaqësuesit e kurejshëve i patën thënë mbretit:

- "Një grup njerëzish pa mend janë arratisur prej nesh dhe kanë ardhur të jetojnë këtu, në tokat e tua, kemi ardhur që ti të na i japësh mbrapsht ata!"

- "Jo, më parë më duhet t'i dëgjoj njëherë, pse kanë ardhur!", – u tha Nexhashiu atyre dhe sakaq na dërgoi lajm që të shkonim pranë tij.

- "Ç'thonë kështu këta për ju?", – na pyeti kur iu afruam.

- "Këta janë idhujtarë, politeistë. Allahu i Madhërishëm na dërgoi ne një profet. Ne e besuam dhe e pranuam çdo fjalë të tij.", – i thamë ne.

- "Po mirë, çfarë i keni ju këta njerëz? Skllevërit tuaj janë këta?", – i pyeti Nexhashiu përfaqësuesit e kurejshëve.

- "Jo!", – u përgjigjën ata.

- "Atëherë, lërini të qetë këta njerëz, pasi ju nuk mund t'u prekni atyre as qimen e flokut.", - kundërshtoi Nexhashiu. (...) Më në fund ai u kthye nga ne dhe na tha:

- "Ju ka shqetësuar njeri në vendin tonë?"

- "Po!", – iu përgjigjëm ne.

Atëherë ai ktheu kokën nga njëri prej njerëzve të tij dhe e porositi:

- "Kushdo që prek ndonjërin prej tyre, si dënim do t'i paguajë atij që ka ngacmuar a prekur një gjobë katër dërhemësh.", – dhe kërkoi që për këtë të lajmërohej i tërë populli.

- "A është ky një ndëshkim i mjaftueshëm?", – na pyeti ai ne.

- "Jo!", – iu përgjigjëm ne.

Sakaq, ai e dyfishoi gjobën e caktuar për këdo që do të na ngacmonte ne."

[15]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/69.

Kthimi i muhaxhirëve në Medinë dhe pranimi i Islamit nga Nexhashiu

Në vijim të transmetimit të tij, Xhafer bin Ebi Talibi (radijallahu anhu) thotë që: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mërgoi në drejtim të Medinës dhe kur pati vendosur njëfarë udhëheqjeje myslimane atje, ne shkuam te Nexhashiu dhe i thamë: "I Dërguari i Allahut doli fitimtar, ka mërguar në Medinë; i ka vrarë të gjithë armiqtë, për të cilët ne të kemi folur. Tani ai do që ne të kthehemi pranë tij, kështu që duam të na japësh leje, që ne të largohemi tashmë."

- "Në rregull!", – na u përgjigj ai; na siguroi kafshë udhëtimi dhe ushqime të mjaftueshme që do të na duheshin për gjatë rrugës dhe u kthye nga ne e na foli:

- "Tregojani Profetit tuaj ato që unë kam bërë për ju. Ky këtu është mëkëmbësi im; do ta dërgoj atë të vijë bashkë me ju. Unë ju dëshmoj, se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Ai është i Dërguari i Allahut. Ju lutem, thojini atij që t'i lutet Allahut për mua, që të më falë."

Dolëm nga Abisinia. Mbërritëm në Medinë. Mua doli të më priste vetë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur mbërrita, m'u hodh menjëherë në qafë dhe më tha:

- "*Nuk e di! Për çfarë të gëzohem më shumë, për ngadhënjimin mbi Hajber, apo që erdhe ti, o Xhafer?*" Ne kishim mbërritur në Medinë pikërisht në atë kohë që ishte arritur edhe ngadhënjimi i Hajberit. Pastaj, i Dërguari i Allahut u ul. Ai mëkëmbës, që Nexhashiu e kishte dërguar me ne, tha:

- "Ja tek e ke Xhaferin! Pyete, si është sjellë mbreti ynë me të."

- "Po, na ka pritur, duke u sjellë kështu e ashtu me ne.", – tha Xhaferi. – "Madje, edhe tani që u kthyem, Ai na dha me vete kafshë rruge e ushqime me tepricë. Dëshmoi edhe se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut, madje, ndër të tjera, më tha edhe:

- "Thuaji Profetit, t'i lutet Allahut për mua, që Ai të më falë."

Atëherë i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u çua, mori abdes, pastaj bëri tri herë lutjen:

- "*O Zot! Fale Nexhashiun!*" Ndërsa myslimanët i thanë të gjithë "amin" njëzëri kësaj lutjeje. Unë i thashë atëherë mëkëmbësit të Nexhashiut:

- "Hajde, kthehu tani dhe njoftoje mbretin tënd për ato që pe prej Resulullahut."[16]

Virtytet e atyre që mërguan në Abisini dhe pastaj mërguan edhe njëherë tjetër, për t'u kthyer pranë të Dërguarit të Allahut

Tregon Lejla, vajza e Ebu Hasmes: "Uallahi ne po përgatiteshim për t'u nisur në drejtim të Abisinisë. Amiri kishte dalë jashtë, që të siguronte disa prej nevojave që ne kishim para se të niseshim. Aty na u shfaq Omeri, i cili nuk ishte bërë ende mysliman, e ishte ende idhujtar; na zuri rrugën. Nuk ishin të pakta vuajtjet që na kishte shkaktuar ai, për të mos thënë se ai na kishte shkaktuar vuajtje nga më të rëndat.

- "Për ku kështu, o Umu Abdullah, do të niseni në ndonjë rrugë?"

- "Po, ne do të largohemi drejt ndonjë copëz tjetër toke të Allahut, sepse Allahu na tregoi ne një rrugëdalje prej vuajtjeve e torturave që ju na keni shkaktuar deri më tani."

- "Zoti ju ndihmoftë!", – tha Omeri.

Seç dallova një butësi që nuk e kisha vërejtur ndonjëherë më herët tek Omeri. Pastaj u largua disi i mërzitur. Me sa duket, gjendja jonë e pati mërzitur shumë. Në atë kohë, aty erdhi Amiri.

- "Vetëm të ishe këtu, o Ebu Abdullah! Të kishe parë atë gjendje aq delikate të Omerit, më duket se i erdhi keq për ne!", – i thashë unë.

- "Çfarë, mos më thuaj që pandehe se do të bëhet mysliman?", – ma preu ai.

- "Po!", – i thashë unë.

- "Më përpara mund të bëhet mysliman gomari i Hattabit, e ky njeri nuk bëhet kurrë mysliman!", – tha Amiri.

Amiri pati folur kështu, pasi e njihte mjaft mirë ashpërsinë e Omerit dhe e dinte se ai ishte një njeri shumë i sertë dhe i dhunshëm, e as që

[16]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/71.

e mendonte se ai mund të bëhej mysliman një ditë."[17]

Nga Halid bin Said bin Asi na është transmetuar: Halidi dhe vëllai i tij, Amri, ishin ndër mërgimtarët që shkuan në Abisini. Kur u kthyen, ata i pati pritur vetë i Dërguari i Allahut. Ata u kthyen kur kishte kaluar thuajse një vit që kur ishte zhvilluar lufta e Bedrit. Mërgimtarët e Abisinisë qenë mërzitur jashtëzakonisht shumë që nuk kishin marrë dot pjesë në atë luftë. Andaj, i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u pati thënë:

- "*Po pse mërziteni ju? Të gjithë njerëzit kanë mërguar vetëm një herë, kurse ju keni mërguar dy herë. Shkuat në Abisini, pastaj latë një vend si ai i sundimtarit të Abisinisë dhe mërguat prapë, për të ardhur pranë meje.*"[18]

Ebu Musai (radijallahu anhu) tregon: "Kur ne ishim në Jemen, na erdhi lajmi për ardhjen e Profetit (dhe se ai kishte mërguar për në Medinë). Prandaj, ne, unë dhe dy vëllezërit e mi, Ebu Burdeja dhe Ebu Ruhmi – unë isha më i vogli nga të tre – dhe pesëdhjetë e tre a pesëdhjetë e dy vetë të popullit tonë u nisëm për rrugë, që të mërgonim për atje ku ishte i Dërguari i Allahut. Hipëm në një anije. Për shkak të kushteve shumë të këqija atmosferike, kapiteni i asaj anijeje vendosi që të na linte në tokat e mbretit të Abisinisë, Nexhashiut. Atje u takuam me Xhafer bin Ebi Talibin (radijallahu anhu). Për njëfarë kohe ne qëndruam të gjithë bashkë në Abisini. Më vonë, të gjithë tok u nisëm në drejtim të Medinës. Mbi Hajberin nuk ishte ngadhënjyer ende. Disa myslimanë, për kthimin tonë nga Abisinia me anije, na thoshin:

- "Ne jua kaluam juve për sa i përket nderit të mërgimit." Një ditë, Esma binti Umejsi, që bashkë me burrin e saj, ishin prej atyre që kishin ardhur nga Abisinia, erdhën te gruaja e Profetit tonë dhe vajza e Omerit (radijallahu anhu), Hafsa (radijallahu anha), për ta vizituar. Në atë kohë, edhe Hafsa ishte nga ato që kishte mërguar drejt tokave të Nexhashiut me një karvan që shkonte atje: Në atë kohë, te Hafsa erdhi edhe Omeri. Kur pa Esmanë, ai e pyeti të bijën:

- "Kush është kjo grua?"

- "Esma binti Umejsi.", – iu përgjigj ajo.

---

[17]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/79.
[18]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 16/949 (46302).

- "Kjo është ajo që ka mërguar në Abisini duke udhëtuar nëpër det?"

- "Po, unë jam!", – iu përgjigj vetë Esmaja kësaj here.

- "Ne jua kaluam juve për sa i përket mërgimit, sepse ne jemi më afër me të Dërguarin e Allahut."

Fjalët e Omerit e rënduan shumë Esmanë, andaj vendosi t'i përgjigjej:

- "Nuk është aspak e vërtetë. Uallahi, ndërkohë që ju ishit me Resulullahun, ai u jepte atyre që ishin të uritur të hanin dhe këshillonte të paditurit se si duhet të sillen. Kurse ne, që ishim në një vend të largët si Abisinia, jetuam në një vend ku njerëzit nuk na kishin qejf dhe na urrenin. Megjithatë, ne ishim të kënaqur dhe i duronim të gjitha, mjaft që Allahu dhe i Dërguari i Tij të ishin të kënaqur me ne. Ju betohem për Allahun, se nuk kam për të futur asnjë kafshatë bukë në gojë e nuk do të pi asnjë gllënjkë ujë, derisa t'ia tregoj Profetit tonë ato që më the dhe të pyes atë se çfarë të bëj. Uallahi, as nuk do të gënjej, as nuk do t'u shtoj ndonjë fjalë më shumë fjalëve të tua; do të ruhem që në fjalët e mia të mos ketë asgjë jo të vërtetë!" Bash në atë çast aty erdhi Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Esmaja e priti atë me fjalët:

- "O Resulallah, pak më parë Omeri më tha kështu kështu!", – duke ia përcjellë një e nga një të gjitha fjalët që i pati thënë Omeri. I Dërguari i Allahut i tha:

- "*Po mirë, po ti si iu përgjigje?*"

- "Unë i thashë atij se kështu e kështu..." – Mandej, i Dërguari i Allahut i tha asaj:

- "*Omeri nuk është më i afërt tek unë sesa jeni ju, sepse për Omerin dhe shokët e tij vetëm një shpërblim të Hixhretit ka. Kurse ju që keni mërguar edhe me anije! Për ju do të ketë shpërblim sa për dy mërgime.*"

Esmaja (radijallahu anha) thotë se: "Uallahi (kur u dëgjua kjo ngjarje) pashë që Ebu Musai dhe sahabët e anijes po vinin të gjithë, si grup, drejt meje, që të më pyesnin se çfarë më kishte thënë i Dërguari i Allahut. Me të vërtetë, asnjë pasuri e kësaj bote nuk do të kishte ndikuar dhe nuk do të kishte shkaktuar aq shumë gëzim në zemrat e tyre, sa ç'i gëzuan ata ato fjalë prej sihariqi që kishte thënë Resulullahu për ta."[19]

[19]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/205.

6. HIXHRETI I SUHEJB BIN SINANIT (r.a.)

Said bin Musejjebi tregon: Suhejbi (radijallahu anhu) ishte nisur për të mërguar për te Profeti ynë në Medinë. Një grup të rinjsh të kurejshëve iu vunë nga pas. Suhejbi qëndroi diku për të pushuar dhe i hoqi nga krahu shigjetat që kishte marrë në çantën e harkut:

- "O kurejshë! Ju e dini shumë mirë se unë jam shigjetari më i mirë nga të gjithë ju. Ju betohem në Allahun, se nuk ju lë të më afroheni pa ju gjuajtur njëherë me të gjitha shigjetat që kam këtu me vete. E, kur të më mbarojnë shigjetat, atëherë, do të nxjerr shpatën dhe do të përleshem me ju, ashtu siç më ka hije. Ju e dini vetë! Ose po deshët, t'ju tregoj se ku e kam lënë pasurinë në Mekë, shkoni e merreni po të doni, por tani m'u hiqni sysh."

- "Në rregull.", – i thanë ata, duke u marrë vesh në këtë pikë. Kështu, Suhejbi u tregoi atyre se ku e kishte lënë pasurinë e tij në Mekë. Në lidhje me këtë ngjarje, Allahu i Madhërishëm zbriti ajetin e dyqindeshtatë të sures "Bekare", me përmbajtjen: "**Ka njerëz që e flijojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robtë e Vet.**" (Bekare, 2/207)

Profeti, kur u takua me Suhejbin, i tha atij:

- "*O Eba Jahja, tregti me shumë fitim bëre. O Eba Jahja, goxha me fitim e bëre tregtinë.*", – duke i kënduar atij ajetin e mësipërm, që i ishte zbritur sakaq nga Allahu i Madhërishëm.[20]

Suhejbi (radijallahu anhu) tregon: "Kur unë desha të zhvendosesha nga Meka, në Medinë, për të shkuar pranë Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kurejshët m'u hakërryen:

- "Suhejb! Kur erdhe tek ne ti nuk kishe asgjë, ishe shumë i varfër. Ndërsa tani je një prej njerëzve më të pasur. Uallahi, kjo nuk mund të ndodhë, është e pamundur."

- "Çfarë thoni? Do të më lini të qetë, e të më hapni rrugën, nëse jua jap juve të tërë pasurinë time?", – i pyeta unë.

- "Në rregull, ashtu po, atëherë ne të lëmë të lirë.", – mu përgjigjën ata dhe unë ua dhashë atyre gjithçka që kisha, ndërsa ata më lanë që

[20]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/173.

të largohesha i qetë. U nisa për rrugë dhe mbërrita në Medinë. Kur e njoftova Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) se çfarë më kishte ndodhur, një për një, ai tha dy herë:

- "*Suhejbi doli i fituar, Suhejbi doli i fituar!*"[21]

7. HIXHRETI I ABDULLAH BIN OMERIT (r.a.)

Ashtu siç na është transmetuar, Ibni Omeri, kur kalonte pranë shtëpive të tyre të vjetruara, i mbyllte sytë, e nuk e shihte dot atë shtëpi; nuk qëndronte dot fare afër saj. Megjithatë, "Ibni Omeri do të qante medoemos sa herë që do të përmendej emri i Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), e kur kalonte afër shtëpive të atyre që kishin mërguar nga Meka."[22]

8. HIXHRETI I DAMRE BIN EBI'L-AJSIT (r.a.)

Said bin Xhubejri ka treguar: "Kur zbriti ajeti: "**Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Allahu i ngre një shkallë lart ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta. Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi, por i ka dalluar ata që luftojnë mbi ata që nuk luftojnë me shpërblim të madh: me shkallë të veçanta, me falje dhe mëshirë. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**" (Nisa, 4/95), disa myslimanë, të cilët i kishin me të vërtetë ato mangësi që përmenden në këtë ajet, vazhduan të qëndronin në Mekë. Në fund, zbriti edhe ajeti: "**Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me faje, u thonë: 'Ku ishit?' Ata përgjigjen: 'Ishim të pafuqishëm në Tokë.'** (Engjëjt) **do t'u thonë: 'A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?' Këta janë ata** (njerëz)**, vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; eh, sa i keq është ai vendbanim!"** (Nisa, 4/97) Pas kësaj, myslimanët e Mekës thanë: "Ky paralajmërim e qortim është aq i rëndë, saqë na bëri të lëkundet toka nën këmbë." Mandej zbriti ajeti i nëntëdhjetetetë i së njëjtës sure, me përmbajtjen: "**Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave**

[21]. Ibn Kethir, *Tefsir,* 1/247.
[22]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/303; Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/349.

dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë, mbase Allahu i fal, se Allahu, me të vërtetë, është Shlyes dhe Falës i gjynaheve." (Nisa, 4/98)

Kur u zbrit ky ajet, Damre bin Ajsi, nga fisi i bijve të Lejthit, por që ishte jashtëzakonisht shumë i pasur, tha:

- "Unë nuk jam prej atyre që bëjnë pjesë në këtë përjashtim, sepse unë mund ta gjej një rrugë për të mërguar; sepse unë jam edhe i pasur, edhe skllevër kam plot! Hajde, hipmëni menjëherë mbi deve." Ashtu e ngjitën mbi deve, të sëmurë, siç ishte. Deveja nisi të ecte rëndë-rëndë. Damre bin Ajsi ndërroi jetë sapo mbërriti në vendin e quajtur Ten'im. Xhenazenë e tij e varrosën pranë xhamisë së Ten'imit. Andaj, ajeti: "**Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në Tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**" (Nisa, 4/100) - është zbritur enkas pas kësaj ngjarjeje të Damre bin Ajsit.[23]

9. HIXHRETI I UASILE BIN ESKAIT (r.a.)

Uasile bin Eskai (radijallahu anhu) tregon: "U largova nga familja ime dhe u nisa në mërgim, vetëm e vetëm për t'u bërë mysliman. Kur shkova pranë Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), atë e gjeta duke falur namazin. Kështu, edhe unë u lidha në namaz në safin e fundit. U fala bashkë me ta. I Dërguari i Allahut përfundoi namazin, unë isha ende aty, në rreshtin e fundit. Më erdhi afër dhe më tha:

- "*A ke ndonjë nevojë, të duhet gjë?*"

- "Dua të bëhem mysliman.", – iu përgjigja unë.

- "*Kjo do të jetë diçka shumë e mirë për ty. Po mirë, a do të mërgoje në emër të Allahut?*"

- "Po!", – u përgjigja unë prapë.

- "*Po mirë, për ku do të mërgosh, do të bësh mërgimin e shkretëtirës, apo do që të mërgosh drejt pjatës së madhe?*", – më pyeti ai sërish.

- "Kush është më e mirë për mua?", – thashë unë.

[23]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/212.

- "*Më e mira është të mërgosh në shkretëtirë, sepse, të mërgosh në shkretëtirë do të thotë të qëndrosh pranë të Dërguarit të Allahut. Kurse mërgimi tjetër është që ti të mërgosh drejt vendbanimit tënd, duke qëndruar larg të Dërguarit të Allahut.*", – duke shtuar, – "*Si në kohë të vështira, ashtu edhe në kohë të kamjes; në çaste plot shqetësime, apo pa shqetësime, ti do të bindesh, edhe nëse të tjerët janë më të parapëlqyer se ty.*"

- "Po, pranoj."

Zgjati dorën dhe i zgjata edhe unë dorën time. Kur e pa se nuk po bëja asnjë përjashtim për hir të kënaqësisë vetjake, më tha:

- "*Me aq sa forcë të kesh.*"

- "Në rregull, me të gjithë fuqinë që do të kem." Mandej, mbi duart tona vendosi edhe dorën tjetër."[24]

10. FJALËT QË U THUHESHIN SAFUAN BIN UMEJES DHE DISA TË TJERËVE QË MËRGONIN

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Safuan bin Umejeja jetonte në lagjen veriore të Mekës; kur i thanë, "nuk ka fe ai që nuk mërgon", ai pati thënë:

- "Nuk do të shkoj më në shtëpi pa mërguar në Medinë.", – duke u nisur sakaq në drejtim të Medinës. Kur erdhi, ai bujti si mysafir te babai im Abasi. Më vonë, ai shkoi edhe te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). I Dërguari i Allahut tha:

- "*Çfarë të ka prurë deri këtu, o Ebu Uehb?*"

- "Thonë se nuk ka fe ai që nuk mërgon; prandaj kam ardhur, të të pyes se si qëndron e vërteta."

- "*Shiko, o Ebu Uehb, kthehu në shtëpinë tënde, në shtratin e përmbytjeve, në luginën e Mekës. Vazhdoni të qëndroni nëpër shtëpitë tuaja. Mërgimi mbaroi; por xhihadi dhe nijeti është i përjetshëm, qëndroni të gatshëm, derisa t'ju thërrasin në luftë.*"[25]

Tausi përcjell: Kur i thanë Safuan bin Umejes, "kush nuk mërgon është i rrënuar", Safuani shkoi menjëherë tek i Dërguari i Allahut,

[24]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 16/949 (46304).
[25]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 16/952 (46312).

pasi ishte betuar se nuk do ta lante më kokën, derisa të pyeste atë, se si qëndronte e vërteta. I hipi devesë dhe u nis për rrugë në drejtim të Medinës. Në hyrje të Xhamisë së Profetit, ai u takua me Profetin tonë.

- "O Resulullah! Thonë se janë të rrënuar të gjithë ata që nuk kanë mërguar. Andaj kam ardhur, të të pyes, si qëndron e vërteta e kësaj çështjeje. Jam betuar se nuk do të vë ujë në kokë, derisa të mësoj të vërtetën."

- "*Safuani ka dëgjuar për Islamin dhe e ka pranuar si fe të vërtetë në zemrën e tij. Me ngadhënjimin e Mekës ka përfunduar edhe koha e mërgimit. Megjithatë, xhihadi dhe nijeti kanë për të qenë gjithmonë të përhershëm. Rendni për të luftuar, sapo t'ju thërrasin në luftë.*", – tha i Dërguari i Allahut.[26]

"*Sot nuk ka më mërgim. Në të shkuarën, kur besimtarëve iu kanoseshin fatkeqësi për shkak të besimit të tyre, ata mërgonin për hir të fesë dhe të të Dërguarit të Allahut. Kurse tani Allahu e ka nxjerrë Islamin fitimtar. Sot, besimtarët kanë mundësi që ta adhurojnë Zotin e tyre në çdo vend, mirëpo, xhihadi dhe nijeti do të jenë përherë të përjetshëm.*"[27]

11. HIXHRETI I GRAVE DHE I FËMIJËVE

Hixhreti i Familjes së Bekuar të Resulullahut dhe i pjesëtarëve të familjes së Ebu Bekrit

Aishja (radijallahu anha) tregon: "Atëherë kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u nis të mërgonte, ne dhe vajzat na la pas, në Mekë. Kur u vendos mirë në Medinë, ai dërgoi te ne dy të liruarit prej tij, Zejd bin Harithen dhe Ebu Rafiun. Ai u kishte dhënë atyre edhe pesëqind dërhemë me vete, që ata të blinin aq kafshë rruge sa do të nevojiteshin. Paratë dhe dy devetë ia morën Ebu Bekrit (radijallahu anhu), në emër dhe në llogari të të Dërguarit të Allahut. Ebu Bekri (radijallahu anhu), bashkë me dy a tri deve, mori edhe Abdullah bin Urajkitin me vete, si dhe i dërgoi një letër djalit të tij Abdullahut që të na hipë në deve, nënën time, Ummu Rumanin, mua dhe motrën time Esmanë, dhe që të na shoqëronin. Tre shokë u nisën. Kur mbërritën

[26]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/615 (13441).
[27]. Buhari, *Sahih,* 4/1567 (4058).

në vendin e quajtur Kudejd, Zejd bin Haritheja bleu tri deve me ato pesëqind dërhemë që kishte marrë me vete. Pastaj, kur hynë në Mekë, ata u takuan me Talha bin Ubejdullahun; donte edhe ai të mërgonte, kështu që e morën edhe atë me vete.

Zejdi dhe Ebu Rafi'u morën me vete Fatimen, Ummu Kulthumin dhe Seude binti Zem'anë. Veç kësaj, Zejdi mori me vete edhe Umu Ejmenin dhe të birin e tyre dhe, sakaq, u larguam nga Meka. Në atë karvan gjendeshim edhe ne. Mbërritëm në lagjen e quajtur Bejda, ne ishim ulur mbi kurrizin e mesëm të devesë dhe ndiem, që, papritur, deveja jonë u tremb. Nëna filloi të qajë:

- "Ah, moj bija ime." Deveja u qetësua vetëm pasi kishim kaluar shtratin e kodrës së Hershasë. Ishte mirësi e Allahut, që patëm shpëtuar. Mandej, mbërritëm në Medinë. Unë dhe familja e Ebu Bekrit zbritëm të parët. Familja e të Dërguarit të Allahut ndaluan pranë tij. Në atë kohë, i Dërguari i Allahut po ndërtonte disa dhoma përreth xhamisë. E vendosi Familjen e tij të Bekuar në këto dhoma. Ne pritëm edhe disa ditë, derisa punimet përfunduan tërësisht.[28]

Hixhreti i vajzës së Profetit tonë, Zejnebit (r.a.)

Zejnebi (radijallahu anha) tregon: "Isha bërë gati për të mërguar, kur përpara më doli Hindi, e bija e Utbes, e cila më tha:

- "O bijë e Muhamedit! Me sa kam dëgjuar, paske vendosur të shkosh pranë babait?"

- Nuk është e vërtetë.", – i thashë. Ajo më tha:

- "Mos ma fshih, o bijë e xhaxhait! Nuk ke pse të më mbash të fshehta. Armiqësia mes burrave nuk ka pse të kthehet edhe në armiqësi mes ne grave." Uallahi, ishte e sinqertë. Megjithatë, unë kisha frikë, ndaj e mohova që isha duke u bërë gati."

Ibni Is'haku thotë se, "kur Zejnebi u bë gati, i kunati, Kinane bin Rabia, i dha asaj një deve. Zejnebi i hipi devesë. Kinaneja i mori harkun dhe rrobën e shigjetave. Megjithëse ishte ende ditë dhe mund ta shihnin të gjithë, Zejnebi u largua nga Meka e hipur mes gungave

[28]. Ibn Abdilberr, *el-Istiab,* 4/450.

të devesë që i kishte dhënë i kunati. Më vonë, meshkujt e kurejshëve u mblodhën dhe diskutuan për këtë çështje, ata iu vunë pas Zejnebit, për ta kapur pa mbërritur në Medinë. Në vendin e quajtur Dhi-Tuua e arritën. I pari atje arriti Hebar bin Esued el-Fihriu. Shkoi dhe duke e prekur me majën e heshtës, ai e trembi shumë Zejnebin. Me çfarë thonë, Zejnebi ishte shtatzënë dhe ajo e trembur i kushtoi asaj jetën e fëmijës që mbante në trupin e saj. Kunati i saj, Kinaneja u ul në gjunjë dhe i derdhi përdhe të gjitha shigjetat, duke thënë:

- "Uallahi, kush afrohet do ta gjuaj me shigjetë." Pas kësaj, ata folën me njëri-tjetrin dhe u tërhoqën. Pak më vonë, aty erdhi Ebu Sufjani, bashkë me një bashkësi nga kurejshët, i cili i tha Kinanes:

- "Ule, more njeri, atë hark e të flasim." Atëherë, ai e uli harkun dhe shigjetën që kishte përgatitur në të.

Ebu Sufjani i shkoi mbi krye dhe i tha:

- "Ti, megjithëse i di shumë mirë ato që na ka bërë ne Muhamedi, se çfarë fatkeqësish na kanë ardhur për faj të tij, ti e rrëmbeve këtë grua në sy të të gjithëve, në mes të ditës dhe do që ta nxjerrësh nga Meka. Po e çove vajzën e tij kështu, në sy të të gjithëve, të tërë njerëzit do të na përgojojnë, se jemi të dobët, të pafuqishëm, e që kemi hequr dorë nga armiqësia me Muhamedin. Të betohem me jetë, ne nuk na ka fare hije që, për faj të babait, të burgosim këtë vajzë të re. Prandaj, merre këtë grua dhe ktheje mbrapsht, e merre t'ia çosh të atit fshehtas atëherë kur të fillojnë fjalët e njerëzve se ne arritëm ta kthenim atë njëherë mbrapsht. Dhe ai veproi ashtu siç pati dhënë fjalën."[29]

Aishja (radijallahu anha) tregon: "Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte larguar më herët nga Meka, ndaj e bija e tij, Zejnebi (radijallahu anha) u largua nga Meka e shoqëruar nga kunati i saj, Kinaneja. Kurejshët i ndoqën nga pas. Hebar bin Esuedi e arriti dhe me majën e heshtës ngacmoi devenë e Zejnebit. Deveja u tremb dhe e rrëzoi atë. Zejnebi ishte shtatzënë, kështu që ajo e humbi fëmijën e saj, shoqëruar me dhimbje dhe vuajtje të shumta. Nga kjo që ndodhi mes bijve të Hashimit dhe bijve të Umejes nisi një sherr shumë i madh. Bijtë e Umejes thoshin:

[29]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/330.

- "Ne kemi më shumë të drejta te Zejnebi; ajo është e martuar me djalin e xhaxhait tonë, Ebu'l-Asin. Në kohën e sherrit, vajza e Profetit ishte pranë vajzës së Utbes, Hindit. Hindi i tha Zejnebit:

- "Për faj të babait tënd po ndodhin të gjitha këto ngatërresa." Më vonë, i Dërguari i Allahut i tha Zejdit, djalit të Harithes:

- "*A nuk shkon të ma marrësh edhe Zejnebin?*"

- "Si të urdhëroni ju, o Resulallah.", – iu përgjigj Zejdi.

- "*Merre këtë unazë timen; jepja Zejnebit, që ajo të bindet se të kam dërguar unë që ta marrësh.*", – e porositi i Dërguari i Allahut atë. Në rrugë ai rastisi me një bari. Ai e pyeti atë:

- "Bariu i kujt je ti?"

- "Bariu i Ebul-Asit.", – iu përgjigj bariu.

- "Po këto dele, të kujt janë?", – e pyeti Zejdi.

- "Këto janë delet e vajzës së Muhamedit, Zejnebit."

Zejdi bëri edhe një pjesë të rrugës me atë bari, pastaj i tha:

- "Shiko, sikur të të jap një porosi, a mund të shkosh e t'ia çosh Zejnebit pa i thënë njeriu?"

- "Po!", – iu përgjigj bariu. Zejdi nxori unazën dhe ia dha në dorë bariut, ndërsa ai ia dorëzoi atë Zejnebit. Ajo e njohu menjëherë unazën e babait të saj të dashur.

- "Kush ta dha ty këtë unazë?", – e pyeti ajo bariun.

- "Një burrë.", – iu përgjigj bariu.

- "Po ku është tani ai njeri?"

- "Në aksh vend."

Zejnebi nuk tha më asnjë fjalë, por priti sa të binte nata. Kur gjithkah ishte mbështjellë nga errësira, ajo doli nga shtëpia, për të shkuar pranë Zejdit. Zejnebi erdhi dhe Zejdi qëndronte i hipur mbi deve:

- "Eja, ngjitu në shpinën e përparme të devesë sime."

- "Jo, ti do të hipësh përpara, në devenë time.", – ia priti Zejnebi dhe ashtu bënë... Kur Zejnebi shkoi pranë Profetit tonë, i Dërguari i Allahut gjithmonë thoshte:

- "*Nga vajzat e mia Zejnebi është më e mbara. Ajo ka kaluar sa e sa fatkeqësi për mua.*"[30]

Hixhreti i Durres, së bijës së Ebu Lehebit

Tregojnë Ibni Omeri, Ebu Hurejreja dhe Amar bin Jasiri (radijallahu anhum): "E bija e Ebu Lehebit mërgoi dhe zbriti në shtëpinë e Rafi bin Mual'la ez-Zurekiut (radijallahu anhu). Aty kishin ardhur si mysafire gratë e fisit të bijve të Zurejkut, të cilat i thanë Durres:

- "Ti je vajza e Ebu Lehebit. E Ebu Lehebit, për të cilin Allahu ka thënë: 'Iu thafshin të dyja duart Ebu Lehebit. Dhe iu thanë. Atij nuk i bënë dobi as pasuria, as fitimet.' Andaj, ty nuk të ndihmon dot mërgimi!" Durreja shkoi pranë Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ajo iu ankua atij për ato fjalë që i kishin thënë ato gra. I Dërguari i Allahut i kërkoi asaj të qetësohej dhe i tha:

- "*Mirë, po ulu njëherë.*" Pasi u fali namazin e drekës të gjithë xhematit, ai u ul mbi minber dhe u foli të gjithëve:

- "*O njerëz! Pse prekem unë, kur njerëzit flasin për pjesëtarët e familjes së bekuar? Ju betohem për Allahun, në ditën e Kiametit, ndërmjetësimi im do të arrijë madje deri edhe te fiset e Ha-it, Hakemit, Sudasë dhe Sehlebit.*"[31]

[30]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 22/431 (1051).
[31]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 24/259 (660).

ENSARËT: SIMBOLI I PËRKRAHJES SË MYSLIMANËVE

Si i vunë Ensarët shpatullat kësaj feje të lartësuar, që të çon kah rruga më e drejtë dhe më e vërtetë? Si iu kthye vënia e shpatullave Islamit, për t'u dalë zot myslimanëve, në diçka më të dashur se kjo botë dhe gjithçka tjetër që i përket asaj? Si krenoheshin ata me ndihmën e dhënë dhe me sakrificat e panumërta që kishin bërë? Krahas kësaj, si i nënvlerësonin ata kënaqësitë e kësaj bote? Vërtet, ata, të gjitha këto, i patën bërë e realizuar me qëllimin për të fituar pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut, si dhe për të shfaqur bindjen e plotë dhe të padiskutueshme ndaj të Dërguarit të Tij.

1. ENSARËT KRYEJNË DETYRËN

Ç'ka thënë Aishja (r.a.) lidhur me këtë çështje?

Aishja (radijallahu anha) ka thënë kështu: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkonte çdo vit nëpër fiset arabe dhe u kërkonte atyre që ata ta strehonin e ta pranonin në mesin e tyre, në mënyrë që ai ta kishte më të lehtë për të realizuar shpalljen e fjalës dhe të mesazheve të

Allahut; në këmbim të kësaj ai u premtonte atyre Xhenetin. Megjithatë, ende asnjë prej fiseve të arabëve nuk e pati pritur mirë, ndaj edhe nuk e patën pranuar, këtë kërkesë të tijën.

Derisa, më në fund, Allahu i Madhërishëm e nxori fitimtare fenë e Tij. Ai e ndihmoi të Dërguarin e Vet, duke përmbushur diçka që kish qenë ndër premtimet e Tij qysh në krye të herës. Ai e dërgoi më të Dashurin e Tij Fisnik në atdheun e Ensarëve. Ishin ata që iu përgjigjën pozitivisht, duke e pranuar menjëherë kërkesën e Profetit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kësisoj, Allahu i Madhërishëm, e bëri vendin e tyre vendbanimin e mërgimit për më të Dashurin e Tij Fisnik.[1]

Mendimet e Omerit (r.a.) për këtë çështje

Ka thënë Omeri (radijallahu anhu): "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur ishte në Mekë, në çdo stinë të Haxhit, shkonte fis më fis dhe u kërkonte të gjithë arabëve, që ta pranonin në mesin e tyre, mirëpo nuk pati gjetur dot askënd që ta pranonte. Në fund, Allahu i Madhërishëm na fali ne Ensarët. Allahu u fali atyre gëzimin dhe një vlerë të paçmueshme, duke i bërë bujtësit e Profetit, të cilin e mbështetën dhe e përkrahën deri në fund. Allahu atyre u dhëntë të mira e begati pa kufi për atë ndihmë që i dhanë Profetit të tyre. Unë i betohem Allahut, që ne nuk ia shlyem dot kurrë ato të mira që ata bënë për ne. Ne u thamë atyre: 'Drejtues jemi ne Mërgimtarët, mirëpo ju, Ensarët, jeni ndihmësit tanë më të mirë.' Ju betohem, se po pata jetë deri në fillim të vitit, të gjithë mëkëmbësit (valinjtë) që do të caktoj do të jenë prej Ensarëve."[2]

Hadithi që përcjell Xhabir bin Abdullahu

Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu) ka thënë: "Profeti ynë, çdo vit, kur vinte stina e haxhit, shkonte nëpër çadrat ku qëndronin fiset e arabëve në Mekë dhe u thoshte atyre:

- "*A ka ndonjë njeri që do të më çojë pranë populllit të tij, sepse kurejshët nuk*

[1]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Eusat,* 6/294 (6454).
[2]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/49 (9879).

më lejojnë që unë t'u shpjegoj njerëzve fjalën e Zotit tim?" Njëherë, pranë tij erdhi dikush nga fisi i Hemdanit. I Dërguari i Allahut e pyeti atë:

- "*Ti i kujt je?*"

- "Unë jam prej fisit të Hemdanit.", – u përgjigj ai njeri.

- "*I fortë është fisi yt? A mund të më ruajnë ata mua?*", – e pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Po, patjetër që kanë aq fuqi sa të të dalin ty në mbrojtje." Mandej, ai njeri u shqetësua se populli i tij mund t'i bënte keq, ndaj shkoi te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- "O Resulullah, më lejo të kthehem njëherë pranë njerëzve tanë dhe t'i njoftoj edhe ata; pastaj, vitin tjetër unë do të vij prapë tek ti."

- "*Në rregull, atëherë, ashtu e bëjmë.*", – iu përgjigj Resulullahu.

Ai njeri iku dhe, në muajin Regaip, aty erdhi grupi përfaqësues i Ensarëve."[3]

Transmetimi i Urues për sa i përket kësaj çështjeje

Urueja tregonte: "Kur afroi stina e Haxhit, një grup myslimanësh nga Ensarët u nisën të shkonin të kryenin Haxhin. Këta ishin, Muadh bin Afraja dhe Esad bin Zurareja nga bijtë e Mazin bin Nexh'xharit; Rafi' bin Maliku dhe Dhekuan bin Abdulkajsi nga bijtë e Zurejkut; Ebul-Hejthem bin Tejjihani nga bijtë e Abdulesh'helit dhe Uvejm bin Saideja nga bijtë e Amr bin Aufit (radijallahu anhum).

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkoi pranë tyre. Pasi u bëri të ditur atyre se Allahu i Madhërishëm u kishte zgjedhur atë vetë si profet për të gjithë ata, u lexoi edhe ajete nga Kur'ani. Kur dëgjuan fjalët e Profetit tonë, ata heshtën, sepse edhe zemrat iu ngrohën jashtëzakonisht shumë ndaj ftesës që ai po u bënte. Iu kujtuan menjëherë ato cilësi të Profetit 'të kohës së fundit', për të cilin u kishin folur shpesh të krishterët dhe hebrenjtë, andaj e aprovuan menjëherë çdo fjalë të tijën, duke shpallur kësodore besimin e tyre tek ai. Si përfundim, ata u bënë shkas që e mira t'u shkonte edhe të gjithë atyre që do të vinin pas tyre. Gjatë takimit ata i thanë Profetit tonë:

[3]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 3/390 (15229).

"Ti e di mirë hasmërinë që ekziston mes fisit të Eusit dhe fisit të Hazrexhit. Ne nuk duam asgjë tjetër, veçse që Allahu i Madhërishëm ta nxjerrë ngadhënjimtar misionin tënd të bekuar. Ne do të punojmë e do të bëjmë gjithçka, me gjithë shpirt, për Allahun dhe për ty. Tani për tani, për hir të Allahut, qëndro këtu dhe prit. Të kthehemi njëherë pranë popullit tonë, e t'u bëjmë thirrje edhe atyre që të hyjnë në rrugën e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij. Ne jemi shpresëplotë, se Allahu i Madhërishëm do të vendosë paqen mes nesh dhe ne të bashkohemi të gjithë me njëri-tjetrin. Ne sot jemi shumë të distancuar nga njëri-tjetri, e, tani për tani, mes nesh nuk ka asnjë njeri që të mos ushqejë urrejtje për hasmin e tij. Po erdhe që tani pranë popullit tonë, në këtë kohë, atëherë kemi frikë se ne nuk do të bashkohemi dot, që të bëhemi xhemati yt. Të japim fjalën, se do të vijmë vitin tjetër, po në stinën e Haxhit."

Të Dërguarit të Allahut i patën pëlqyer shumë ato fjalë që i patën thënë Ensarët. Ata myslimanë u kthyen pranë njerëzve të tyre dhe filluan që t'u tregonin njerëzve fshehtazi për Islamin. Ata u folën atyre për Resulullahun; që Allahu e pati dërguar atë si profet, e që tani, nëpërmjet Kur'anit, po i ftonte njerëzit që t'i besonin Allahut. Ato ftesa, më në fund, bënë që nëpër shtëpitë e ensarëve të mos mbetej më asnjë familje ku nuk kishte të paktën një mysliman."[4]

Jahja bin Saidi tregon: "Dëgjova një grua të moshuar nga mesi i Ensarëve, e cila po thoshte: Unë pata parë Ibni Abasin, që shkonte te Sirma bin Kajsi dhe seç mësonte një poezi pak a shumë kështu:

Për dhjetë vite i Dërguar' i Allahut mes Kurejshëve ndenji.

I kështillonte, me shpresë se një mik të sinqertë mes tyre të gjente,

E çdo haxh u fliste t'arabëve fise se ai ishte bash vetë ai profeti,

Por as dikë që ta mbrojë, as dikë që në siguri ta ftojë, dot nuk e gjeti.

Kur te ne vendosi të vijë, populli ynë menjëherë e mbështeti.

Iu bë zemra mal, u gëzua, ndaj edhe i kënaqur prej nesh ai mbeti.

Tanimë prej zullumqarëve larg ai ishte, frikë brenda vetes më nuk

[4]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/46 (9876).

gjeti,

Nuk shqetësohej, se mos ata t'harbuar njerëz dëm' e t'këqija i sjellin.
Për të i harxhuam ne më të mirat pasuri që deri dje mbi to flinim,
Deri dhe jetën, për të, ne dhamë, se të gatshëm ishim ta jepnim!
Armiku ynë ish kushdo që vetë armik i Zotit të ishte pat' zgjedhur.
Edhe sikur miq tanët të pastër të ishin!
Fare mirë ne e dinim, se veç Zotit, jo, tjetër nuk kish të përjetshëm!
Librin e Allahut, të vetmin udhërrëfyes kishim zgjedhur!"[5]

2. VËLLAZËRIA E KRIJUAR MES MUHAXHIRËVE DHE ENSARËVE

Historia e Abdurrahman bin Aufit me Sad bin Rabian

Tregon Enesi (radijallahu anhu): "Në kohën që Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi në Medinë, ai i bëri vëllezër me njëri-tjetrin Abdurrahman bin Aufin (radijallahu anhu) me Sad bin Rabia el-Ensarin. Pas kësaj, Sad bin Rabia i tha Abdurrahman bin Aufit:

- "Vëllai im, në mbarë Medinën unë jam më i pasuri. Gjysmën e pasurisë sime kam vendosur të ta jap ty. Kam edhe dy gra, me të cilat jam i martuar; shiko, cilado që të pëlqen, më thuaj dhe unë do ta ndaj atë, që të martohesh ti me të."

Abdurrahman bin Aufi i tha:

- "Allahu i begatoftë, gratë e tua dhe pasurinë tënde; ti më trego mua rrugën e pazarit, mjafton." Kësisoj, ai i tregoi vëllamit të tij pazarin. Abdurrahmani shkoi atje, bleu diçka dhe e shiti duke nxjerrë edhe një fitim prej shitje-blerjes. Bleu pak bullgur dhe pak vaj dhe u kthye në shtëpi. Pas njëfarë kohe, Abdurrahmani ecte duke përhapur gjithandej një erëmim të mirë shafrani.

- "*Ç'është kjo aromë kështu?*", – e pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Unë u martova me një grua, o Resulullah.", – u përgjigj

[5]. Ibnu'l-Ethir, *Usdu'l-Gabe,* 1/518.

Abdurrahman bin Aufi.

- "*Po si mehr* (prikë garanci për vajzën)*, çfarë i dhe, o Abdurrahman?*", – vazhdoi i Dërguari i Allahut.

- "Një copë ari me peshën sa të një bërthame."

- "*Atëherë, shtro një sofër të martesës, qoftë edhe me një dele.*"

Abdurrahmani (radijallahu anhu) thotë se:

- "Uallahi, unë fitoja aq shumë, saqë edhe kur lëvizja ndonjë gur nga toka, shpresoja se aty do të dilte flori ose argjend."[6]

Muhaxhirë dhe ensarë, bëhen trashëgimtarë në pasurinë e njëri-tjetrit

Ibni Abasi (radijallahu anhu) thotë se: "Kur ata që mërguan nga Meka erdhën në Medinë, prej vëllazërisë që i Dërguari i Allahut kishte ndërtuar mes tyre dhe Ensarëve, herë-herë ndodhte që ata bëheshin trashëgimtarë të një linje të mëhershme se sa vetë kushërinjtë e tyre, më të cilët kishin edhe lidhje gjaku. Derisa, në fund, u zbrit ajeti: "**Gjithkujt Ne i kemi caktuar trashëgimtarët për çdo gjë që lënë prindërit ose të afërmit, ndërsa atyre me të cilët keni bërë marrëveshje, jepuni pjesën e vet. Sigurisht që Allahu është dëshmitar për çdo gjë.**" (Nisa, 4/33), që e anuloi gjykimin që kishin marrë vetë myslimanët mes veti, për t'i bërë mërgimtarët dhe ensarët trashëgimtarë në pasuritë e njëri-tjetrit."

Ndërsa, sipas një tjetër përcjellje që i bëhet këtij fenomeni, ajeti që i jep fund atij gjykimi thuhet se ishte ajeti: "**Edhe ata që u bënë besimtarë më vonë, që mërguan dhe luftuan bashkë me ju, janë vëllezërit tuaj; ndonëse, sipas Librit të Allahut, besimtarët që kanë lidhje farefisnore, janë më të afërt për njëri-tjetrin** (në ndarjen e trashëgimisë)**. Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.**" (Enfal, 8/75).[7]

Ensarët i ndihmojnë ekonomikisht muhaxhirët

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) transmeton: "Ensarët patën

[6]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/228,
[7]. Ibn Haxher, *Fet'hu'l-Bari,* 7/270 (3721).

ardhur tek i Dërguari i Allahut dhe i patën thënë:

- "O Resulullah, na i nda këto kopshte të hurmave që ne kemi me vëllezërit tanë që kanë mërguar në rrugën e Allahut." Mirëpo, i Dërguari i Allahut iu përgjigj atyre:

- "*Jo, kjo është një punë që nuk bëhet. Si, ju edhe do të punoni për t'u përkujdesur për ne, por edhe do të na bëni ne ortakë në prodhimin e asaj që ju e keni punuar? Jo, kjo është diçka që nuk mund ta pranojmë!*"

- "E drejtë është ajo që thua ti, ndaj të dëgjuam dhe të bindemi, o i Dërguari i Allahut.", – thanë ata."

Abdurrahman bin Zejd bin Eslemi (radijallahu anhu) transmeton: "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u pati thënë Ensarëve:

- "*Vëllezërit tuaj që kanë mërguar, braktisën tokat, pasurinë dhe fëmijët e tyre, për të ardhur pranë jush.*" Kur dëgjuan Resulullahun t'u thoshte këto fjalë, Ensarët i thanë Atij:

- "O Resulullah, ta ndajmë të gjithë pasurinë me ta."

- "*Jo këtë, por mund të bëjmë diçka tjetër!*", – u propozoi atyre i Dërguari i Allahut.

- "E çfarë është ajo, o Resulullah?", – pyetën Ensarët gjithë kureshtje.

- "*Muhaxhirët janë njerëz që nuk dinë të punojnë në punët e kopshteve dhe të arave, ndaj sikur t'i ndani edhe me ta ato fruta që do të merrni prej bahçeve tuaja?*"

- "Si të na thuash ti, o Resulullah!", – folën Ensarët e pranishëm njëzëri."

Enesi (radijallahu anhu) ka transmetuar: "Muhaxhirët i thanë të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulullah, ne nuk kemi parë kurrë më parë njerëz si këta ensarët, tek të cilët kemi ardhur të gjejmë strehë! Kjo është hera e parë që përballemi me një bashkësi të këtillë, që kur edhe për vete kanë shumë pak, kanë qejf që t'i ndajnë me të tjerët, edhe kur kanë shumë duan që t'ua japin të tjerëve pjesën më të madhe të asaj që kanë! Uallahi, jo vetëm që nuk na kanë lënë të bëjmë asgjë, që të punojmë edhe ne, por edhe kanë e ç'nuk kanë i ndajnë të gjitha me ne. Kemi frikë se të

gjitha shpërblimet e Allahut do t'i marrin ata, e jo ne." Resulullahu, i cili e dëgjoi shqetësimin që kishte kapluar mërgimtarët, u tha atyre:

- "*Për sa kohë që do t'i lavdëroni e do t'i mburrni cilësitë e të mirat e Ensarëve dhe për sa kohë që do t'i luteni Allahut për ta, mos u shqetësoni!*"[8]

Xhabiri (radijallahu anhu) tregon: "Ensarët mblidhnin hurmat, i ndanin në gjysmë, në atë mënyrë që një pjesë të kishte një hurmë më pak, pastaj degët e hurmave i vinin mbi pjesën ku kishte një hurmë më pak dhe i linin mërgimtarët të lirë, që të zgjidhnin ata të parët. Kështu, mërgimtarët merrnin pjesën ku kishte më shumë hurma, ndërsa Ensarët mbanin atë pjesë të hurmave ku kishte më pak të tilla. Kështu vazhdoi, deri kur u ngadhënjye mbi Hajberin. Kur u mor Hajberi, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu drejtua Ensarëve duke u thënë:

"*Ju e kryet më së miri detyrën tuaj. Po ju duk e drejtë, ju të hiqni dorë prej pjesës që ju takon prej Hajberit dhe të vazhdoni me frutat tuaja, asisoj që ato janë të gjitha tuajat këtej e tutje.*"

- "Po ti na pate vendosur disa kushte. Dhe ne, në këmbim të tyre të patëm kërkuar Xhenetin, e ne bëmë çdo gjë e bëmë në këmbim të Xhenetit!"

- "*Po mirë, atëherë ajo që ju takon është po e juaja.*", – tha i Dërguari Fisnik.[9]

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) thirri Ensarët. Do t'u jepte atyre pjesën që u takonte nga plaçka e luftës së Bahrejnit. Ata nuk pranuan, duke i thënë:

- "Ne nuk e pranojmë, nëse nuk do të marrin edhe vëllezërit tanë mërgimtarë njëlloj si ne!"

- "*Si, po më thoni 'jo'?*", – u tha atyre i Dërguari i Allahut.

- "*Atëherë prisni derisa unë të vij tek ju, sepse edhe juve do t'ju ngjitet sëmundja e zgjedhjes së të afërmve dhe kushërinjve tuaj para të tjerëve! Bëni shumë kujdes nga diçka e këtillë!*"[10]

---

[8]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/228.
[9]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 9/781 (16526).
[10]. Buhari, *Sahih,* 3/1381 (3581).

3. ENSARËT PREFERONIN MË SHUMË PËLQIMIN E KËNAQËSINË E ALLAHUT DHE TË TË DËRGUARIT TË TIJ SESA PASURITË E KËSAJ BOTE

Qëndrimi që mbajtën ensarët në Hunejn

Ebu Said Hudriu (radijallahu anhu) tregon: "Ditën që Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mori në dorë plaçkën e luftës së Hunejnit, e ndau atë mes atyre që sapo kishin pranuar Islamin nga radhët e kurejshëve, të cilët kishin nevojë për stimulim e afrim me zemër ndaj Islamit, pra të atyre që u duhej ngrohur zemra me Islamin, dhe arabëve të tjerë, por Ensarëve u mbeti ose shumë pak, ose asgjë fare. Kjo i shqetësoi shumë disa nga Ensarët. Madje, njëri sosh arriti gjer aty sa tha:

- "Uallahi, i Dërguari i Allahut, tani që u bashkua me popullin e tij, ne na harroi fare." Në emër të Ensarëve, te Profeti ynë shkoi Sad bin Ubadeja (radijallahu anhu), i cili i tha atij:

- "O Resulullah, aksh fis nga Ensarët është mërzitur me ty."

I Dërguari Fisnik tha:

- "*Për çfarë u ka ngelur qejfi?*"

- "Ngaqë ti e ndave plaçkën e luftës mes popullit tënd dhe arabëve të tjerë, e për ta nuk mbeti thuajse asgjë."

- "*Po mirë, o Sad, po ti si mendon për këtë gjë?*", – e pyeti Profeti ynë.

- "Unë jam vetëm njëri prej tyre.", – u përgjigj Sadi.

- "*Atëherë, mblidhe popullin tënd në aksh vend. Kur të mblidhen të gjithë, atëherë eja e më njofto edhe mua.*"

Sadi doli dhe i thirri të gjithë Ensarët të mblidheshin. Ata u mblodhën të gjithë sa ishin atje. Disa nga muhaxhirët i lejoi, kurse shumë të tjerë i ktheu pas. Pastaj, shkoi pranë të Dërguarit të Allahut dhe i tha:

- "O Resulullah, unë i mblodha ensarët ashtu siç më urdhëruat ju; po ju presim ju të gjithë."

I Dërguari i Allahut erdhi. Pa u ulur filloi t'u flasë atyre në këmbë. Pasi lëvdoi e lartësoi emrin e Allahut, ai u tha atyre kështu:

- "*O bashkësi e Ensarëve! A nuk erdha unë tek ju në një kohë që ju jetonit të zhytur në humbje? A nuk ju udhëzoi ju Allahu nëpërmjet meje? Kur ju ishit nevojtarë e të varfër, a nuk ishte Allahu Ai që ju lejoi të bëheshit të pasur? A nuk ishte Allahu Ai që jua ngrohu e jua ëmbëlsoi zemrat me njëri-tjetrin, duke i dhënë fund armiqësive, sepse ju ishit në hasmëri me njëri-tjetrin?*"

- "Po, o i Dërguari i Allahut.", – i thanë ata.

- "*O bashkësi e Ensarëve, pse nuk më përgjigjeni?*", – iu drejtua ai sërish atyre.

- "Ç'të të themi, o Resulullah, çfarë përgjigjeje të të japim? Ne i detyrohemi gjithçka Allahut dhe të Dërguarit të Tij."

- "*Po të donit, ju mund të thoshit edhe kështu, e prapë të vërtetën do të kishit thënë, e ne do t'jua pranonim: - 'O Muhamed, në një kohë që ty të patën përzënë të gjithë, ne të pranuam, të strehuam. Ti ishe nevojtar dhe ne të ndihmuam. Kishe frikë, por ne të dhamë siguri. Nuk kishe asnjë njeri, por ne të erdhëm në ndihmë!*"

- "Ne për gjithçka kemi i detyrohemi Allahut dhe të Dërguarit të Tij.", – përsëritën Ensarët.

I Dërguari i Allahut vazhdoi të fliste me këto fjalë:

- "*O xhemat i ensarëve! Vallë mos ju jeni mërzitur me mua, pse unë u dhashë disa njerëzve, për t'i afruar zemrat e tyre me Islamin, duke pasur besim të plotë te lidhja e fortë me Islamin që Allahu ju ka falur ju? Më thoni: A nuk doni ju, që ndërsa njerëzit e tjerë do të kthehen pranë familjeve të tyre me dhentë e devetë e marra prej meje, ju të ktheheni nëpër shtëpitë tuaja bashkë me të Dërguarin e Allahut? Unë ju betohem në Allahun, se sikur të gjithë njerëzit të shkojnë drejt një lugine dhe ensarët drejt një lugine tjetër, unë, prapësepraprë, luginës që do të ecin edhe ensarët do të eci. Po të mos kish qenë detyrimi për të mërguar, unë vetë një prej ensarëve do të doja të isha. O Zot, mëshiroji ensarët, fëmijët e ensarëve dhe nipërit e ensarëve!*"

Kjo fjalë e mbajtur nga Profeti ynë i bëri Ensarët të qanin me ngashërim, lotët u lagnin mjekrat, aq sa të gjithë njëzëri thanë:

- "Ne jemi të kënaqur prej Allahut Zot, e jemi sakaq të kënaqur edhe prej të Dërguarit të Tij si i dërguar." Paskëtaj, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u largua prej andej, ndërsa Ensarët u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre."[11]

[11]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/358.

Cilësitë e ensarëve

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: "Të Dërguarit të Allahut i kishin ardhur disa pasuri nga Bahrejni. Muhaxhirët dhe Ensarët, kur e dëgjuan këtë, frymën e mbajtën drejt e në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut. I Dërguari Fisnik u tha Ensarëve:

- "*Me sa di unë dhe me sa ju kam njohur unë ju, kur vjen puna te shërbimi dhe te mundimi për t'u ardhur njerëzve në ndihmë, ju jeni të parët që vraponi, e të parët që shmangeni e largoheni, kur vjen puna te interesat vetjakë dhe shpërblimet!*"[12]

Sipas një transmetimi, përcjellësi i të cilit është Enesi (radijallahu anhu), Ebu Talhaja (radijallahu anhu) pati shkuar te Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ai i pati thënë atij:

- "*Përshëndete nga unë popullin tënd dhe jepu atyre lajmin e mirë se: "Qëkur i kam njohur unë, Ensarët janë njerëz shumë të ndershëm dhe shumë të duruar.*"[13]

Sihariqi që i dha Profeti ynë Sad bin Muadhit në çastet e fundit të jetës

Abdullah bin Shedadi (radijallahu anhu) thotë se: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) erdhi pranë Sad bin Muadhit, i cili po jepte e po merrte frymëmarrjet e fundit në këtë jetë dhe i tha:

- "*Allahu i faltë të mira pafund të parit të popullit të Ensarëve. Uallahi, ti e mbajte fjalën që i dhe Zotit dhe pa dyshim, edhe Zoti do ta mbajë fjalën e dhënë ndaj teje.*"[14]

---

12. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 14/53 (37951).
13. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 14/53 (37950).
14. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/369.

XHIHADI

Si luftonin (bënin xhihad) në rrugën e Allahut Profeti i profetëve dhe sahabët e tij? Si niseshin ata qoftë edhe për luftë, për t'i ftuar njerëzit, të gjithë, me të rinj e me të moshuar, me të lumtur e me njerëz në vështirësi, që të pranonin e t'i besonin Allahut dhe të Dërguarit të Tij? Si përpiqeshin të gjithë, me këtë mision, pa dallim, të varfër e të pasur, pa u ankuar njeri se ishte dimër, apo ishte verë?

1. PROFETI YNË I SHTYN SAHABËT E TIJ TË BËJNË XHIHAD NË RRUGËN E ALLAHUT

Këshillimi i Profetit tonë me sahabët e tij në luftën e Bedrit

Alkame bin Uakas el-Lejthi (radijallahu anhu) transmeton: "Profeti ynë ishte nisur për në Bedër. Kur mbërritën në vendin e quajtur 'Reuha', ai u foli atyre që ishin me të duke u thënë:

- "*Po ju si mendoni?*"

Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha:

- "O Resulullah, sipas atyre që kemi dëgjuar, Kurejshët janë përgatitur jashtëzakonisht shumë."

- "*Po mirë, po ju çfarë mendimi keni?*", – i pyeti ai sahabët e tij sërish.

Omeri (radijallahu anhu) u çua dhe tha po ato që tha edhe Ebu Bekri (radijallahu anhu). Megjithatë, Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pyeti sërish ata:

- *"Çfarë mendoni ju?"*, – Sad bin Muadhi (radijallahu anhu) tha:

- "O Resulullah! Me sa duket e keni fjalën për ne Ensarët. Ne i betohemi Allahut që të lartësoi ty me mirësinë e profetësisë dhe me ty dërgoi Kur'anin, se unë nuk di asgjë për rrugën që do të ndjekim, ashtu siç nuk e dija fare rrugën që kemi bërë deri këtu! O Resulullah, ti sikur edhe deri në Berkul-Gimad në Jemen të shkosh, ne kurrsesi nuk do të ndahemi prej teje. Ne nuk do të bëhemi si ata që i thanë profetit të tyre, Musait (a.s.):

- "Ti dhe Zoti yt shkoni të luftoni kundër armikut, ne do t'ju presim këtu." Ne ju themi ju:

- "Ti dhe Zoti yt shkoni të luftoni kundër armikut, por do të vijmë edhe ne me ju, do t'ju ndjekim në çdo gjë deri më një." Nuk ka dyshim se ti nuk dole kot nga Medina; ma merr mendja se ishte Allahu që ty diç të urdhëroi. Ti vetëm ndiq urdhrin e Allahut dhe vazhdo rrugën të ecësh përpara. Mbaj marrëdhënie të mira me kë të duash, e priti lidhjet, kur të vijë puna, me kë të duash. Tregohu armik me kë të duash, bëj marrëveshje me kë të duash dhe merr sa të duash prej pasurisë sonë, sa herë që do të të nevojitet!" Fill pas këtyre fjalëve që i tha Sadi të Dërguarit të Allahut pati zbritur ajeti i pestë i sures "Enfal", në të cilin thuhej: "**Zoti yt të nxori nga shtëpia jote** (për të luftuar) **për një punë shumë të mirë e me vend, për të Vërtetën, edhe pse kjo nuk i pëlqeu një grupi prej besimtarëve.**" (Enfal, 8/5)[1]

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: "Pastaj Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) doli vetë para njerëzve dhe, për t'i nxitur ata që të luftonin në rrugën e Allahut, u tha atyre:

- "Unë i betohem Allahut, që e ka në dorën e Tij frymën time, që, sot, kushdo që lufton kundër idhujtarëve, pa i ikur përplasjes, duke duruar dhe duke pasur shpresë të plotë tek Allahu dhe vritet, Allahu

[1]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/264.

medoemos ka për t'i falur atij Xhenetin."

Mandej, Umejr bin Humami nga bijtë e Selimes, i cili po hante disa hurma që kishte në dorë, tha:

- "Pa shiko, shiko!.. Domethënë, që unë të hyj në Xhenet nuk ka asnjë pengesë tjetër veçse të më vrasë njëri prej tyre, hë?", – i hodhi hurmat që kishte në dorë përdhè, nxori shpatën dhe luftoi derisa dha jetën e ra dëshmor.[2]

Xhed bin Kajsi prej hipokritëve kërkon leje që të mos marrë pjesë në betejën e Tebukut

Abdullah bin Ebi Bekr bin Hazmi transmeton: "Në kohën që i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) deshi të dilte në luftë, ai e mbante të fshehtë qëllimin e tij, që të gjithë të ndiheshin sikur myslimanët ishin me tjetër qëllim dhe jo për të luftuar. Mirëpo, në betejën e Tebukut, ai nuk ndjeu nevojë për një masë të këtillë, kështu që tha:

- "*O njerëz, unë dua të nisem për luftë kundër bizantinëve.*", – duke e shprehur kësisoj haptas qëllimin e tij të vërtetë. Kjo ishte një thirrje për luftë në ditët më të thata e më të nxehta që kishte stina e verës. Aty, në fushën ku u vendosën, mbi gjithçka, sundonte thatësira dhe mungesa e burimeve. Ishte pikërisht ajo kohë kur sapo kishin filluar të piqeshin frutat, njerëzit donin të rrinin ulur nën hijen e pemëve duke soditur dhe që askush nuk donte të largohej prej kopshteve të tija. Një ditë, ndërkohë që i Dërguari i Allahut ishte i zënë me përgatitjet për ekspeditën e Tebukut, aty erdhi prijësi i hipokritëve, Xhed bin Kajsi, të cilit ai i tha:

- "*O Xhed! A do të luftosh me njerëzit e kryqit?*"

- "O i Dërguari i Allahut, më jepni mua leje, mos më merrni në qafë. Uallahi, populli im, Ensarët, e dinë shumë mirë, që nuk ka njeri më të dhënë pas grave sesa unë! Kam frikë se mos ndonjë prej grave të krishtera më prish mendjen! Prandaj, o i Dërguari i Allahut, më jepni mua leje të mos vij në luftë.", – i tha Xhedi të Dërguarit të Allahut.

---

[2]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/277.

- "*Në rregull, të kam dhënë leje.*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut dhe e largoi shikimin prej tij.

Ajeti i dyzetenëntë i sures "Teube" ka zbritur lidhur me këtë ngjarje: "**Disa prej atyre** (hipokritëve) **thonë: 'Më lejo** (të mungoj në luftë) **dhe mos më vër në sprovë!' Ja, ata ranë pikërisht në sprovë. Me të vërtetë, Xhehenemi i përfshin nga çdo anë mohuesit.**" (Teube, 9/49)

Ndërsa një pjesë tjetër e hipokritëve, nuk u mjaftuan vetëm me kërkimin e lejes, por, duke përdorur vapën si pretekst e justifikim, e këshilluan të Dërguarin e Allahut:

- "Mos u nisni për luftë në këtë vapë." Andaj, Allahu zbriti menjëherë ajetin: "**Ata që mbetën në shtëpitë e tyre, pas** (daljes për luftë të) **të Dërguarit të Allahut, u gëzuan; nuk u pëlqente të luftonin në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre dhe thanë: 'Mos shkoni në luftë nëpër vapë!' Thuaju: 'Zjarri i Xhehenemit është edhe më i nxehtë!' Veç sikur të kuptonin!**" (Teube, 9/81)

I Dërguari i Allahut i vijoi po njëlloj, po me të njëjtin seriozitet, përgatitjet e luftës, duke u urdhëruar njerëzve që t'i bashkoheshin atij. Ndërsa ata që ishin të pasur i nxiti që të jepnin nga pasuria e tyre në rrugën e Allahut dhe të blinin kafshë udhëtimi edhe për të tjerët që do të merrnin pjesë në luftë. Dhe ata kështu bënë, blenë kafshë rruge dhe ua shpërndanë të varfërve, duke dhënë kësisoj nga pasuria e tyre për kauzën e Allahut. Ndihmën më të madhe e pati bërë Osmani (radijallahu anhu), i cili pati blerë për luftëtarët plot dyqind deve të shëndetshme."[3]

Ndihmesa ekonomike e sahabëve gjatë betejës së Tebukut

I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i nxiti myslimanët që të merrnin pjesë në luftë dhe u kërkoi atyre që të jepnin prej pasurisë së tyre në këtë rrugë. Myslimanët, gjithë ç'kishin e përdorën për t'i ardhur në ndihmë të Dërguarit të Allahut dhe gjithë të tjerëve që kishin nevojë për ndihmë. Ebu Bekr Besniku (radijallahu anhu) i dha të tëra ato katërmijë dirhemë që kishte. Kur i Dërguari i Allahut e pyeti:

[3]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/4.

- "*Po familjes e fëmijëve, a u le gjë? Çfarë u le atyre?*" Ebu Bekri iu përgjigj me fjalët:

- "Atyre u lashë Allahun dhe të Dërguarin e Tij!" Më vonë, erdhi Omeri (radijallahu anhu), i cili solli gjysmën e tërë pasurisë së tij. I Dërguari i Allahut e pyeti:

- "*A u le gjë pjesëtarëve të tjerë të familjes?*" Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- "Po, o i Dërguari i Allahut! Këto që kam sjellë janë vetëm gjysma e asaj që kisha." Kur mori vesh se Ebu Bekri kishte sjellë të gjitha paratë që kishte, Omeri tha:

- "Sa herë që garojmë me njëri-tjetrin në të mirë, Ebu Bekri gjithmonë ma kalon!"

Ndër ata që ndihmuan ishin edhe Abas bin Abdulmutalibi dhe Talha bin Ubejdullahu. Abdurrahman bin Aufi pati sjellë plot dyqind okë argjend. Sad bin Ubadeja me Muhamed bin Meslemen patën dhënë po të njëjtën ndihmë. Asim bin Adijji pati dhënë plot nëntëdhjetë veshë hurmash. Osman bin Afani atë ditë armatosi as një më pak, as një më shumë, por një të tretën e tërë ushtrisë. Përballoi vetë gjithë shpenzimet e ushtrisë, duke u siguruar atyre deri edhe enët e ujit dhe thasët që do të shtronin në tokë për t'u shtrirë. Atë ditë, na përcillet se Profeti i profetëve ka thënë:

- "*Që sot e tutje, Osmanit nuk i sjell më dëm asgjë që do të bëjë!*"

Profeti ynë i nxiste të pasurit që të bënin sa më shumë vepra të mira. Ndërsa ata, shpërblimin e të mirave të tyre e prisnin prej Allahut. Ata që nuk ishin kaq të pasur, sa sahabët që u përmendën pak më sipër, përpiqeshin që të ndihmonin ata që ishin më të varfër me sa të kishin mundësi. Kur dikush sillte një deve, kur dikush u jepte për të ngrënë dy luftëtarëve të varfër, apo duke u thënë:

- "Merreni këtë deve, të hipni njëherë njëri, njëherë tjetri." Me aq sa kishin mundësi, vepra të mira përpiqeshin të bënin edhe gratë. Ummu Sinan el-Eslemijeja (radijallahu anha) ka thënë:

- "Uallahi, ndërsa të gjithë ishin duke bërë përgatitjet e nevojshme për betejën e Tebukut, në shtëpinë e Aishes (radijallahu anha) pashë

një beze të hapur, e cila ishte e shtruar përpara të Dërguarit Fisnik. Në të ishin vendosur byzylykët, varëset, vëthët dhe unazat që kishin dhuruar gratë. Populli ndihej shumë ngushtë në ato ditë. Ishte stina kur piqen frutat, ditë që njerëzit e donin shumë hijen. Njerëzit pëlqenin më shumë të uleshin në tokë, e u vinte shumë e rëndë që t'u kërkoje atyre të ngriheshin nga toka, për t'u marrë me ndonjë punë. Megjithatë, Profeti ynë e trajtoi me shpejtësi këtë çështje dhe çadrën e tij e ngriti në vendin e quajtur "Thenijetu'l-Ueda". Aq e madhe ishte në numër ajo ushtri, saqë asnjë fletore nuk mjaftonte për t'i shkruar të gjithë emrat e tyre. Po të mos ishin të shqetësuar se do të zbriste *shpallja*, ata që nuk donin të bashkoheshin me të tjerët, gati ishin, për të gjetur një mënyrë si e si për t'u shmangur. Kur i Dërguari i Allahut i përfundoi gjithë përgatitjet dhe vendosi për nisje, në Medinë la si mëkëmbës Siba bin Urfuta el-Gifarin. Sipas një transmetimi, ai la si mëkëmbës Muhamed bin Meslemenë. Profeti ynë u tha atyre:

- "*Merrni shumë këpucë e sandale me vete; sepse njeriu qubet kalorës për aq kohë sa mban të veshura këpucë.*"

Kur Resulullahu u nis, Ibni Ubej bin Seluli bashkë me një grup mynafikësh u kthyen pas dhe thanë:

- "Muhamedi, mirë që është i varfër, por, në mes të gjithë kësaj vape, do të shkuakësh të luftojë me bizantinët! Muhamedit më duket se i duket lojë të luftosh me bizantinët!" Mendimin e tij e pëlqyen edhe disa të tjerë që ishin me të, kështu që vazhduan me hipokrizinë e tyre. Më vonë, Ibni Ubeji filloi të përhapte edhe lajme të pakëndshme, por me qëllim, për të Dërguarin e Allahut dhe sahabët e tij. Ai thoshte:

- "Uallahi, më duket sikur pashë që Muhamedin dhe shokët e tij i kishin lidhur me zinxhirë!"

Kur Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u largua nga vendi i quajtur Thenijetu'l-Ueda, në drejtim të Tebukut, lidhi fort edhe flamujt dhe bajrakët e myslimanëve. Flamurin më të madh ia la ta mbante Ebu Bekri, ndërsa bajrakun ia dha Zubejrit. Flamurin e fisit të Eusëve ia la Usejd bin Hudajrit, ndërsa atë të Hazrexhëve ia dorëzoi Ebu Duxhanes; kurse, sipas një tjetër transmetimi, atë ai ia dha Hubab bin Mundhirit (radijallahu anhum).

Numri i ushtarëve që ishin në krah të të Dërguarit të Allahut atë ditë shkonte deri në tridhjetëmijë, dhjetëmijë prej të cilëve ishin kalorës. I Dërguari Fisnik i urdhëroi çdo familjeje ensare që të mbanin flamujt dhe bajrakët e vet. Ndërsa të gjitha fiset e tjera arabe mbanin flamujt dhe bajrakët e tyre."[4]

2. PROFETI YNË, NË SHTRAT, NË ÇASTET E FUNDIT TË JETËS URDHËRON USAMEN TË NISET PËR EKSPEDITË USHTARAKE DHE PËRKUJDESJA E VEÇANTË E EBU BEKRIT (r.a.) LIDHUR ME KËTË ÇËSHTJE NË DITËT E PARA TË KALIFATIT TË TIJ

Urueja tregon: "Profeti ynë vuri në krye të ushtrisë Usame bin Zejdin, duke e urdhëruar që të sulmonte befasishëm në vendin e quajtur Ubna. Më vonë, Ai i tha Usames:

- "Ec, ec me lejen dhe ndihmesën e Allahut." I dha atij edhe flamurin e qepur me kopsa, të cilin ai ia la në dorëzim ta mbante Burejde bin Husajbit. Siç e pati porositur i Dërguari i Allahut, Usameja e ngriti vendqëndrimin e ushtrisë në zonën e quajtur Xhurf, që i përkiste Medinës. Njerëzit nisën të mblidheshin. Ata që mbaronin punët e tyre dilnin në vendin ku ishte ushtria, ndërsa ata që nuk kishin përfunduar dot me punët e tyre, vazhdonin të punonin. Nga mërgimtarët e parë nuk mbeti asnjë pa u thirrur në këtë betejë. Omer bin Hatabi, Ebu Ubejdeja, Sad bin Ebi Uekasi, Said bin Zejd bin Amr bin Nufejli ishin ndër të parët që u përfshinë në radhët e atyre që do të merrnin pjesë. Disa nga mërgimtarët – ai që përdorte fjalët më të rënda ishte Ajash bin Ebi Rabia – thanë:

- "Si arrin i Dërguari i Allahut të vërë një djalë kaq të ri si udhëheqës, në krye të mërgimtarëve të parë?", – ndaj edhe kundërshtuan. Thashethemet lidhur me këtë çështje u përhapën shumë shpejt. Omeri (radijallahu anhu), një t'i dëgjuar fjalët që kishin filluar të përhapeshin, u dha të gjithëve përgjigjen e merituar, por nuk la pa ia treguar të Dërguarit të Allahut gjithë sa ishin thënë. Resulullahu qe mërzitur shumë nga kjo sjellje. Doli mbi minber, megjithëse kokën e kishte të

[4]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 2/39.

mbështjellë dhe kishte hedhur në shpinë një teshë si kadife dhe, pasi lëvdoi dhe lartësoi emrin e Allahut, tha kështu:

- "*O njerëz! Ç'janë ato fjalë që kam dëgjuar të thoni për mua, pse unë ju kam caktuar si komandant Usamen? Unë i betohem Allahut, që ju, edhe kur unë ju pata zgjedhur si komandant babanë e Usames, Zejdin, kohë më parë, ju edhe atëherë patët kundërshtuar! I betohem Allahut, se i biri, Usameja, e meriton të jetë komandant jo më pak seç e meritonte i ati i tij, Zejdi. Ashtu siç Zejdi ishte njeriu më i dashur për mua, edhe Usameja është një njeri, të cilin njerëzit e duan shumë. Të dy janë njerëz, që, përgjatë gjithë jetës, janë fiksuar pas asaj që është më e mirë dhe më e mbarë. Prandaj, unë ju këshilloj që të silleni mirë me Usamen. Ai është një ndër më të mirët prej jush!*"

Kur mbaroi fjalën i Dërguari i Allahut, ai zbriti nga minberi dhe u fut në dhomën e tij. Kjo ngjarje ka ndodhur një të shtunë, në ditën e dhjetë të muajit Rabiu'l-Euel.

Ata myslimanë që do të niseshin për të luftuar nën komandën e Usames (radijallahu anhu), shkuan të gjithë tek i Dërguari i Allahut, për t'u përshëndoshur me të. Mes tyre ishte edhe Omeri (radijallahu anhu). Resulullahu u tha atyre:

- "*Rregullojeni sa më shpejt punën, që ta dërgoni Usamen.*" Në atë kohë, aty hyri e ëma e Usames, Umu Ejmeni, e cila i tha të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulallah, nëse e lejoni, që Usameja të qëndrojë edhe pak më shumë në bazë, mbase i shtohet edhe pak numri i ushtarëve. Po u nis në këtë gjendje, kam frikë se nuk do të bëjë dot shumë."

Sërish i Dërguari i Allahut, tha:

- "*Niseni Usamen.*" Populli shkoi i tëri në bazën ushtarake, duke ndenjur të gjithë aty gjatë tërë mbrëmjes së të dielës. Ditën e diel, Usameja zbriti në Medinë. Në atë kohë, i Dërguari i Allahut ishte përkeqësuar ndjeshëm, madje në atë çast i kishte rënë të fikët a ishte në agoni. Atë ditë, të Dërguarit të Allahut ilaçet ia patën futur në gojë. Usameja, kur hyri pranë shtratit të të Dërguarit të Allahut, nuk i mbajti dot lotët; aty brenda ishin edhe Abbasi (radijallahu anhu)dhe gratë. Usameja u përkul dhe e puthi Profetin. Profeti ynë nuk thoshte asnjë fjalë. I ngriti duart lart dhe përqafoi Usamen.

Usameja (radijallahu anhu) tregon se: "Nga ai veprim unë e kuptova menjëherë, se i Dërguari i Allahut po lutej për mua. Më vonë, unë u ktheva sërish në vendqëndrimin e ushtrisë."

Ditën tjetër, me një fjalë ditën e hënë, Usameja gjendej në vendqëndrimin e ushtrisë, kur gjendja e të Dërguarit të Allahut u përmirësua, hapi edhe sytë madje. Usameja, me të marrë vesh, erdhi pranë Profetit tonë. I Dërguari Fisnik e porositi atë:

- "*Vepro me begatinë dhe ndihmesën e Allahut.*" Usameja u takua me të për herë të fundit. Megjithëse, aty, në ato çaste, i Dërguari i Allahut dukej shumë mirë. Madje, bashkëshortet e tij ishin aq të gëzuara që ai dukej më mirë, saqë të gjitha kishin filluar të krihnin flokët.

Në ato çaste, brenda hyri Ebu Bekri (radijallahu anhu), i cili tha:

- "Elhamdul'lil'lah, o Resulallah! Sot qenkeni gdhirë më mirë, qenkeni i vetëdijshëm. Sot është dita e së bijës së Harixhes (emri i njërës prej grave të Ebu Bekrit), po më dhatë leje, dua të shkoj tek ajo sot.", – dhe, sakaq, mori leje nga Resulullahu dhe u largua prej aty. Ebu Bekr Besniku, atë ditë, shkoi në shtëpinë e tij në Sunha, që shtrihej në pjesën e sipërme të Medinës. Usameja ishte bërë gati për t'u kthyer pranë ushtrisë, i hipi kalit dhe u bëri thirrje shokëve, se do të ktheheshin pranë ushtrisë. Kur mbërritën në bazë, ai zbriti nga kali dhe i dha ushtrisë urdhër për t'u nisur. Ajo ditë pati kaluar shumë shpejt.

Zbritja e ushtrisë në Medinë kur marrin vesh për ndarjen nga jeta të Profetit tonë të nderuar

Usameja sa po bëhej gati për t'u larguar nga vendi i quajtur Xhurf, kur aty ia behu e shqetësuar nëna e Usames, Umu Ejmeni (radijallahu anha), e cila u dha atyre lajmin e kobshëm:

- "Resulullahu po mbaron." Usameja, Omeri dhe Ebu Ubejdeja u kthyen bashkë, duke shkuar drejt e tek i Dërguari i Allahut. Krenaria e Gjithësisë po largohej nga kjo jetë! Profeti i profetëve ia dorëzoi shpirtin Mëshirëplotit në një ditë të hënë, aty në perëndim të diellit e në hyrje të natës së dymbëdhjetë të muajit të Rabiu'l-Euelit. Sakaq, ushtria që ishte e grumbulluar në vendin e quajtur Xhurf, u kthye

e gjitha në Medinë. Burejde bin Husajbi (radijallahu anhu) e pruri flamurin me thekë e kopsa, që i pati caktuar Usameja (radijallahu anhu) për ta mbajtur dhe e nguli në krye të portës së shtëpisë së Resulullahut. Kur përfundoi lidhja e besës me Ebu Bekrin (radijallahu anhu), kalifi Ebu Bekr e porositi Burejden që ta merrte flamurin dhe t'ia çonte Usames në shtëpi, duke i thënë:

- "Nuk kam për ta zgjidhur atë flamur, derisa Usameja të dalë të luftojë me ushtrinë e tij!"

Burejdeja thotë se: "E mora flamurin dhe e çova në shtëpinë e Usames. Më vonë, nën komandën e Usames, atë flamur e mbajta unë, të valëvitur, deri në Damask. Që andej, e prura po unë mbrapsht, në shtëpinë e Usames. Ai flamur i lidhur e me thekë qëndroi në shtëpinë e Usames deri në ditën që ai u nda nga kjo jetë."

Këmbëngulja e Ebu Bekrit (r.a.), që në krye të ushtrisë si komandant të jetë Usameja

Shumë nga arabët, kur morën vesh për ndarjen nga jeta e Profetit tonë të nderuar, u kthyen nga feja. Ebu Bekri (radijallahu anhu) thirri Usamen dhe e urdhëroi:

- "Ti do të shkosh për andej ku të pati drejtuar i Dërguari i Allahut!"

Pas kësaj, njerëzit filluan të mblidhen të gjithë në vendqëndrimin e ushtrisë, ku ishin mbledhur edhe më parë. Edhe Burejdeja e mori flamurin dhe shkoi në bazën e parë. Shumë prej mërgimtarëve nuk u pëlqeu edhe aq shumë këmbëngulja e Ebu Bekrit, që në krye të ushtrisë si komandant të ishte Usameja. Omeri, Osmani, Ebu Ubejdeja, Sad bin Ebi Uekasi dhe Said bin Zejdi (radijallahu anhum) shkuan tek Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe i thanë:

- "O kalifi i të Dërguarit të Allahut! Arabët janë bërë të gjithë bashkë kundër teje. Nuk arrin asgjë duke e përçarë ushtrinë. Këtë ushtri duhet ta përgatitësh për ata që janë kthyer nga feja, sepse duhet t'i ndëshkosh një orë e më parë *murtedët* (renegatët). Nga ana tjetër ne nuk jemi të sigurt që armiqtë tanë nuk do të guxojnë të ndërmarrin ndonjë sulm kundër Medinës. Shtyje për më vonë ekspeditën e

betejës me bizantinët, të paktën derisa të kthyerit të rikthehen sërish në Islam ose të neutralizohen nëpërmjet shpatës. Kur të kapërcehen këto kriza, atëherë mendojmë se mund ta dërgosh Usamen kundër bizantinëve. Veç kësaj, tani për tani, ne jemi të sigurt që bizantinët nuk po bëjnë ndonjë përgatitjeje për të na sulmuar ne."

Ebu Bekri (radijallahu anhu) i dëgjoi fjalët e tyre me kujdes, pastaj u tha atyre:

- "A ka ndonjë që ka për të thënë ndonjë gjë tjetër?"

- "Jo, nuk ka; ç'kishim për të të thënë, t'i thamë.", – u përgjigjën ata.

- "Unë i betohem Allahut që ka në kontroll frymën time, se; sikur ta di se do të shfaqen egërsira në Medinë e do të më hanë, unë nuk heq dorë nga të dërguarit e asaj ushtrie! Kjo duhet bërë një orë e më parë. I Dërguari i Allahut pati thënë: "*Dërgojeni ushtrinë e Usames.*", sepse ashtu e pati porositur shpallja hyjnore që iu zbrit, e si mund ta pengoj unë atë, që të mos niset? Vetëm se ka edhe diçka që duhet ta flas me Usamen. Unë do t'i kërkoj atij që ta lërë Omerin këtu, me mua; kemi shumë nevojë për Omerin. Uallahi, as këtë nuk e di, do të ma pranojë Usameja këtë kërkesë, apo jo. Po nuk pranoi, unë nuk do ta detyroj." Ai grup sahabësh, kur e kuptuan se Ebu Bekri ishte shumë i vendosur për ta dërguar atë ushtri, nuk thanë asgjë, heshtën.

Ebu Bekri (radijallahu anhu) shkoi te shtëpia e Usames. Foli me të, që t'ia linte atij Omerin, madje duke ia përsëritur disa herë njëra pas tjetrës pyetjen:

- "Domethënë, i jep me gjithë zemër leje Omerit, apo jo?" Dhe, në të gjitha herët, Usameja iu përgjigj:

- "Po!" Paskëtaj, më Besniku u tha lajmëtarëve:

- "Vendimi im është: Asnjë nga ata që i Dërguari i Allahut, kur ishte në jetë, pati urdhëruar që të niseshin në luftë nën komandën e Usames, të mos qëndrojë aty! Po pashë ndonjërin që e merr me të lehtë dhe nuk niset, do ta nis që t'i bashkohet ushtrisë në këmbë!" Pastaj pranë vetes thirri të vinin Muhaxhirët, që kishin folur me dyshim ndaj komandës së Usames, të cilëve u foli shumë rëndë dhe nuk u lejoi që të largoheshin pa garantuar se do t'i bashkoheshin ushtrisë, duke

pranuar që komandanti i tyre ishte Usameja. Kësisoj, askush nuk u nda nga radhët e ushtrisë. Për t'i përcjellë ata, Ebu Bekri doli edhe vetë me ta deri në të dalë të Medinës. Kur ushtria u largua prej Xhurfit, ajo ishte e përbërë nga tremijë ushtarë, njëmijë prej të cilëve ishin kalorës. Ebu Bekri, një copë të rrugës e bëri duke ecur në këmbë ndanë komandantit, Usames. Më vonë, ai iu drejtua Usames, duke i thënë:

- "Fenë, sigurinë dhe përfundimin e punëve të tua po ia lë Allahut. I Dërguari i Allahut ty të pati porositur. Ajo që ti duhet të bësh, është që t'u bindesh me përpikëri urdhrave të tij. Në këtë çështje, unë as nuk të urdhëroj dot për ndonjë gjë, as nuk kam se çfarë të të ndaloj; unë nuk po bëj asgjë tjetër, veçse po përpiqem të shoh të përmbushur një urdhër të të Dërguarit të Allahut!"

Usameja u largua me nxitim, në mënyrë që të kalonte i sigurt mespërmes tokave të fiseve të Xhuhejnes dhe Kudaave, të cilët nuk ishin kthyer ende nga Islami. Kur zbriti në vendin e quajtur "Uadi'l-Kura", ai dërgoi dikë që e quanin Hurejth, i cili i përkiste fisit të bijve të Udhres, që të mblidhte të dhëna. Hurejthi shkoi përpara dhe mbërriti në Ubna, mësoi se cila ishte gjendja atje dhe si ishte rruga deri atje dhe u kthye menjëherë pas. Usameja me Hurejthin u takuan në një largësi prej dy netësh udhëtimi nga Ubnaja. Hurejthi e njoftoi atë se populli nuk ishte në dijeni të asgjëje; e, kur i tha Usames se atje nuk ishte mbledhur asnjë i fortë nga populli, Usameja e porositi Hurejthin se do të vepronin befasishëm, pa u lënë atyre mundësi që të organizoheshin, por t'i zinin fill të papërgatitur."[5]

3. EBU BEKRI (r.a.) DËRGON USHTRI NË ZONAT PËRRETH, PËR TË LUFTUAR

Kasim bin Muhamedi tregon: "Një ditë, Ebu Bekri doli përpara xhematit për të mbajtur hutben. Pasi lëvdoi dhe lartësoi emrin e Allahut dhe i dërgoi salauate dhe përshëndetje të Dërguarit të Tij, tha këto fjalë:

[5]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/798 (30266).

- "Çdo punë ka anët e veta të mira, këto i mjaftojnë atij që i kryen ato. Kushdo që punon për Allahun, kjo është më se e mjaftueshme për të. Kushdo që punon për Allahun, atij i mjafton Allahu. Jini seriozë dhe fiksohuni pas një qëllimi të vetëm. Qëllimi është tejet i rëndësishëm! Bëni kujdes! Kush nuk ka besuar, nuk ka se si të ketë fe. Për asnjë prej atyre që nuk i kanë vënë vetes si qëllim kënaqësinë e pëlqimin e Allahut nuk ka shpërblim. Vepra e paqëllimtë nuk është e vlefshme: shpërblimi që premtohet në librin e Allahut varet nga xhihadi (lufta, në kuptimin e përpjekjes) që ju bëni në rrugën e Allahut. Çdo mysliman duhet të përgatitet gjithë dëshirë për të luftuar në rrugën e Zotit të vet, sepse rruga e çlirimit, që Allahu ka ravijëzuar për secilin prej nesh, kalon njëherë nëpërmjet të luftuarit dhe të të përpjekurit. Allahu i Madhërishëm, nëpërmjet xhihadit, i ka ruajtur njerëzit dhe shoqëritë nga poshtërimi; përmes xhihadit Ai i ka bërë të fisshme, si këtë botë, ashtu edhe amshimin."[6]

Letra që Ebu Bekri (r.a.) i dërgon Halid bin Uelidit (r.a.) për xhihadin

Kalifi, i pati dërguar Halidit, që asokohe gjendej në Jemame, këtë letër:

"Letër e Kalifit të Resulullahut, robit të Allahut, Ebu Bekrit, për Halid bin Uelidin, Muhaxhirët e Ensarët dhe të gjithë ata që i ndjekin me sinqeritet gjurmët e tyre!

Ju përshëndes të gjithëve dhe e përlëvdoj Allahun edhe në emrin tuaj. Atë Allah, që nuk ka zot tjetër veç Tij, që të meritojë të adhurohet.

Lëvduar qoftë Allahu, që e përmbushi premtimin e Tij, duke e ndihmuar robin e Tij dhe duke e bërë më të fortë mikun e Tij dhe duke e shpallur të poshtëruar armikun e Tij dhe duke i përballur me disfatë pas disfate të gjitha grupet e armiqve të fesë. Ai Allah, që veç Atij nuk ka asnjë zot tjetër, ka thënë:

"**Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu si i ka bërë ata para**

[6]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/3.

tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos Më shoqërojnë asgjë (në adhurim)**. Sa për ata që, pas kësaj, mohojnë** (besimin)**, pikërisht ata janë të mbrapshtët.**" (Nur, 24/55)

Ky është njëri prej premtimeve të Allahut. Ai nuk kthen nga fjala e thënë dhe e dhënë, e ato që thotë Ai nuk lënë as shenjën më të vogël të dyshimit. Ai ua shpalli besimtarëve detyrim luftën, duke u thënë: "**Lufta është bërë detyrim për ju, ndonëse e urreni. Por mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.**" (Bekare, 2/216)

Përpiquni ta përmbushni me përsosmëri atë që jua ka premtuar Allahu. Bindjuni Allahut në ato që Ai jua ka caktuar si detyrime, qoftë edhe nëse vështirësitë janë të shumta, fatkeqësitë të padurueshme, qoftë edhe nëse në atë rrugë do të humbisni gjithë pasurinë, madje edhe jetën tuaj. Vërtet, para madhësisë së shpërblimeve që ka premtuar Ai, çdo sakrificë e bërë nga ana jonë përsëri mbetet shumë e vogël. Lus Allahun që të sillet me mëshirë me ju, ndaj ejani dhe luftoni në rrugën e Allahut. "**Dilni në luftë, qofshi të shëndetshëm ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!**" (Teube, 9/41)

Më dëgjoni mirë! Halid bin Uelidin e pata urdhëruar që t'i drejtohej Irakut. Të mos largohet nga Iraku, derisa ky urdhër i imi të mbërrijë tek ai. Bashkë me të shkoni edhe ju, e të mos ndaheni prej tij për asnjë arsye. Kjo është një rrugë e atillë, që Allahu, atyre që ecin të sinqertë në të dhe atyre që e duan jashtëzakonisht shumë të mirën, ka për t'u dhënë shpërblime shumë të mëdha. Kur të mbërrini në Irak, qëndroni atje dhe mos u largoni, derisa t'ju vijë urdhër nga ana ime. Allahu është më se i mjaftueshëm për ne, si në punët e kësaj bote, ashtu edhe për amshimin. Qofshin mbi ju, përshëndetja, mëshira dhe begatia e Zotit."[7]

[7]. Bejheki, *Sunen,* 9/179 (18391).

Mbledhja e këshillimit që Ebu Bekri (r.a.) mban me parinë e sahabëve lidhur me të luftuarit me bizantinët

Abdullah bin Ebi Eufa el-Khuzaiu (radijallahu anhu) tregon: "Ebu Bekri deshi të organizonte një ekspeditë për ta nisur kundër bizantinëve, ndaj edhe vendosi të ftonte pranë tij Aliun, Omerin, Osmanin, Abdurrahman bin Aufin, Sad bin Ebi Uekasin, Said bin Zejdin, Ebu Ubejde bin Xherrahun dhe më të mëdhenjtë nga radhët e muhaxhirëve dhe të ensarëve (radijallahu anhum), për t'u këshilluar me ta. Ata erdhën të gjithë pranë kalifit. ('Në mes të atyre që ishin ftuar isha edhe unë,' - thotë Abdullah bin Ebi Eufa) Ebu Bekri nisi të fliste, duke thënë:

- "Të panumërta janë mirësitë që na ka falur Allahu dhe është krejtësisht e pamundur ta falënderosh për to! Lëvdimet dhe lartësimet i takojnë vetëm Allahut. Allahu na bashkoi ne rreth një fjale të vetme, jua ngrohu juve zemrat karshi njëri-tjetrit, duke na falur, sakaq, të gjithëve udhëzimin në rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës. Ai ua zhduku të gjitha mendimet e djallëzuara, të cilat nuk buronin veçse nga injoranca. Tanimë, edhe djalli i ka prerë shpresat, se ju mund t'i shoqëroni Allahut ndonjë ortak, duke përvetësuar edhe ndonjë zot tjetër krahas Allahut. Sot, të gjithë arabët janë si vëllezër të një nëne dhe një babai me njëri-tjetrin. Unë dua që t'i dërgoj myslimanët në Damask, që ata të luftojnë me bizantinët, në mënyrë që të shihet fare qartë se si Allahu ua ka bërë myslimanëve gjënë më të dashur besimin e plotë tek Ai dhe te fjala e njësimit të Allahut. Veç kësaj, në këtë luftë myslimanët do të fitojnë edhe shumë gjëra të tjera, sepse ata që do të vriten do të jenë dëshmorë. E për ata që janë zemërkulluar e që janë të lidhur fort me Allahun e Madhërishëm, mirësitë pranë Allahut janë mirësitë më të mira që mund të ekzistojnë. Kurse ata që do të mbeten të gjallë, jo vetëm që do të fitojnë shpërblimin që Allahu u ka premtuar luftëtarëve të Tij, por ata do ta vijojnë jetën si veteranë që jetën e kanë shkuar duke mbrojtur fenë e Allahut. Ky është mendimi im. Tani, më thoni edhe ju, secili mendimet e veta."

Fjala e shkurtër e Omerit (r.a.) për të aprovuar fjalët e Ebu Bekrit (r.a.)

Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) mbaroi së foluri, në këmbë u çua Omeri (radijallahu anhu)dhe mbajti këtë fjalë:

- "Lëvduar qoftë Allahu, i Cili veçon me mirësi kë të dëshirojë prej krijesave të Tij. O kalifi i mbarë myslimanëve, uallahi, sa herë që ne kemi ngarendur pas punëve të mira, ti gjithmonë na e ke kaluar, duke bërë më shumë se ne. Kjo është një mirësi e veçantë, që Allahu ua fal atyre që Ai Vetë i do. Allahu është zotëruesi më i madh i mirësive dhe i ndihmesës. Ju betohem: edhe unë vetë kam dashur të vij te ty, për të folur mbi këtë çështje. Por, me sa duket, as kjo mirësi nuk ka qenë e shkruar në kader, që të isha unë ai që e hapja këtë temë, e ti na e kalove prapë, duke e çelur vetë i pari. Punë shumë me vend. Allahu të ruajttë, që të vazhdosh e të mos largohesh kurrë nga rruga e drejtë! Dërgoji kalorësit njëherë me intervale, herë pas here, mandej dërgoji ata njëri pas tjetrit. Nuk ka dyshim, Allahu është ndihmësi më i madh i fesë së Tij; kam besim të plotë se Ai do t'i nxjerrë krenarë Islamin dhe ndjekësit e tij.[8]

4. NXITJA QË BËN OSMAN BIN AFANI (r.a.) PËR XHIHAD

Skllavi i liruar i Osman bin Afanit (radijallahu anhu), Ebu Salihu, na transmeton se: "E kam dëgjuar vetë Osmanin (radijallahu anhu), kur na pati folur nga minberi e na pati thënë:

Nga frika se mos largoheshit prej meje dhe iknit, jua kam mbajtur të fshehtë dhe nuk jua kam treguar një hadith që kam dëgjuar prej Resulullahut. Mirëpo, tani, në mënyrë që gjithsecili të bëjë zgjedhjen e tij, e kam parë të nevojshme që ta ndaj edhe me ju atë hadith. E kam dëgjuar vetë të Dërguarin e Allahut, kur ka thënë: "*Një ditë roje për hir të kënaqësisë së Allahut, është më e mirë dhe më e mbarë sesa njëmijë ditë të jetuara në çdo vend tjetër.*"[9]

Ndërsa, sipas një tjetër transmetimi, Osmani (radijallahu anhu) po

[8]. Taberi, *Tarih,* 3/473.
[9]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 1/65 (470).

mbante hutben mbi minber, kur pati thënë: "Do t'ju tregoj një hadith që e kam dëgjuar vetë prej Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Deri më sot nuk jua kam treguar dhe arsyeja e vetme se pse nuk jua kam treguar është se kam dashur që të rrinit gjithmonë pranë meje. Unë e kam dëgjuar vetë të Dërguarin e Allahut, kur ai ka thënë: "*Një ditë rojë në rrugën e Allahut është më e mirë dhe më e mbarë sesa njëmijë ditë të shkuara duke adhuruar Zotin gjatë natës dhe duke agjëruar gjatë ditës!*"[10]

5. SAHABËT E KËRKONIN VETË XHIHADIN ME ZEMËR E ME SINQERITET

Një shembull prej jetës së një sahabi

Përcillet nga Ebu Umameja (radijallahu anhu): "Kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) vendosi të dilte në luftën e Bedrit, edhe Ebu Umameja kishte shumë dëshirë të shkonte bashkë me të Dërguarin e Allahut. Mirëpo, daja i tij, Ebu Burde bin Dijnari i tha atij:

- "Ti qëndro këtu, që të kujdesesh për nënën. Pastaj, ti duhet të kujdesesh edhe për motrën." Kur kjo bisedë iu përcoll të Dërguarit të Allahut, Profeti ynë e urdhëroi Ebu Umamen që të qëndronte te kryet e nënës së tij e të mos vinte në luftë. Në luftë shkon Ebu Burdeja. Atë ditë që u kthye Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ndërron jetë edhe nëna e Ebu Umames. Kësisoj, namazin e xhenazes së saj e fali vetë i Dërguari ynë Fisnik."[11]

Çfarë ka thënë Omeri (r.a.)

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: "Sikur të mos ishin këto tri merita, do të dëshiroja shumë që të shkoja një orë e më parë pranë Allahut: të udhëtosh e të dalësh për të luftuar në rrugën e Allahut, të ulesh në sexhde, duke i vënë kryet në tokë, për t'iu përulur Allahut dhe për të mbledhur hurmat e mira prej atyre që janë rrëzuar përtokë, si dhe të ulesh për të biseduar me xhematin që e do aq shumë virtytin e mbledhjes dhe të përmendjes së fjalëve të bukura!"[12]

[10]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 1/61 (463).
[11]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 9/37.
[12]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 1/272 (792).

Omeri (radijallahu anhu) thotë: "Kryejeni adhurimin e Haxhit. Haxhi është njëra prej punëve më të mira që na ka urdhëruar Allahu të bëjmë; megjithatë, xhihadi qëndron shumë më lart dhe është më i virtytshëm."[13]

Dëshira e zjarrtë për të marrë pjesë në luftë e Abdullah bin Omerit

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Ditën e Bedrit, i çova fjalë të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), që të më pranonte edhe mua, por i Dërguari i Allahut nuk pranoi. Nuk mbaj mend ndonjë natë që ta kem kaluar ashtu, pa fjetur, i mërzitur tej mase dhe duke qarë tërë natën, sepse i Dërguari i Allahut nuk pati pranuar që të merrja edhe unë pjesë në luftë. Megjithatë, kur i shkova vitin tjetër, që të më pranonte edhe mua, ai më pranoi. Andaj e lëvdova shumë Allahun, që ma mundësoi edhe mua të merrja pjesë në luftë krah për krah me të Dërguarin e Tij.

Një prej të pranishmëve në kuvend thotë: "O Ebu Abdurrahman, (në luftën e Uhudit), kur ushtritë u përleshën me njëra-tjetrën, ju ia patët mbathur!" Për t'i prekur ata sahabë, ibni Omeri iu përgjigj:

- "Po! Por Allahu na fali të gjithëve. Unë e lëvdoj pafundësisht Allahun."[14]

Fjalët e Omerit (r.a.) për ata që bëjnë roje e qëndrojnë në krye të detyrës në rrugën e Allahut

Ertat bin Mundhiri tregon: "Omeri (radijallahu anhu) iu drejtua atyre që ishin ulur aty:

- "Cili është myslimani që fiton më shumë sevape e shpërblime?" Ata që ishin të pranishëm filluan të renditnin, kush agjërimin, kush namazin dhe i thanë: "Pas Prijësit të Myslimanëve, janë ata që kanë aksh e aksh cilësi."

Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "A doni t'jua them kush janë ata që fitojnë më shumë sevape e

[13]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/766 (11324).
[14]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/448 (37253).

shpërblime edhe se Prijësi i Myslimanëve dhe se çdokush tjetër?"

- "Po, po, na i trego!", – i thanë ata. Atëherë Omeri (radijallahu anhu) u tha atyre:

- "E keni parasysh atë trim e bir trimi që çohet nga qendra e Islamit e shkon deri në Siri, pa menduar a do t'i dalë ndonjë egërsirë përpara, a do ta pickojë ndonjë gjarpër nëpër shkretëtirë, apo a do t'i dalë përpara ndonjë armik! Ja, ai fiton shpërblimet më të mëdha!"[15]

Ato që u thotë Suhejl bin Amri liderëve të arabëve lidhur me këtë çështje

Tregon Hasan Basriu: "Një ditë, te porta e shtëpisë së Omerit (radijallahu anh), ishin mbledhur një grup njerëzish nga paria e nga njerëzit më të respektuar në mesin e kurejshëve, ndër të cilët ishin edhe Suhejl bin Amri me Ebu Sufjan bin Harbi. Portën e hapi ndihmësi i Omerit (radijallahu anhu) dhe brenda pranoi fillimisht ata që kishin qenë në luftën e Bedrit, si për shembull, Suhejbin dhe Bilalin, duke u thënë:

- "Uallahi, në Bedër ka qenë edhe Omeri. Ai i do shumë ata që kanë marrë pjesë në Bedër, ndaj ma kërkoi ai vetë, që brenda të marr njëherë këta." Ebu Sufjani tha:

- "Gjatë gjithë jetës sime, asnjëherë nuk jam përballur me një sjellje të tillë. U dha leje këtyre skllevërve të hyjnë përpara nesh, ndërsa ne nuk na përfilli fare!"

Pas kësaj, Suhejli tha këto fjalë:

- "O njerëz! Uallahi unë e kuptoj shumë mirë nervozizmin që është shfaqur në fytyrat tuaja. Nëse duhet të nevrikoseni, më mirë nevrikosuni njëherë me veten tuaj. Kur këta njerëz që ju i quani skllevër u ftuan të pranonin Islamin, e njëjta ftesë ju bë edhe juve. Mirëpo, ndërkohë që ata vraponin kush e kush ta pranonte fenë islame më parë, ju e mbajtët veten me të madh dhe mbetët vonë. Unë i betohem Allahut, se në vend që të mërziteni për atë farë nderi që keni

[15]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/771 (11338).

aq qejf ta vini të garojë me nderin e secilit prej jush, se e humbët pa të drejtë para kësaj porte, më mirë gjuani e shani veten tuaj për ato virtyte, për të cilat ata u treguan më të shpejtë dhe jua kaluan e i rrëmbyen ato përpara jush. Siç e shikoni, ata jua kaluan juve në virtyt, e kjo vështirë se mund të ndreqet më. Andaj, për ju është më mirë që të përqendroheni te xhihadi, të lidheni fort pas tij; ku i dihet, ndoshta Allahu ju shpërblen ju me mirësinë e të luftuarit dhe të të përpjekurit në rrugën e Allahut, apo me të rënët dëshmor në të." Pastaj shkundi petkat që kishte veshur e u çua dhe u nis në drejtim të Sirisë."

Hasan Basriu, pasi transmeton këtë ndodhi, shprehet: "Uallahi, Suhejli kishte të drejtë dhe ajo që tha ishte e vërteta, sepse Allahu i Madhërishëm nuk i barazon robin që vrapon pas Tij me atë që i merr gjërat lehtë e me të madh."[16]

Suhejli luftoi në rrugën e Allahut gjersa dha edhe jetën

Ebu Sad bin Fudaleja që ka qenë i pranishëm në bisedat e zhvilluara me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tregon: "Unë shkova bashkë me Suhejl bin Amrin në Siri. Atje ai më tregoi se e kishte dëgjuar vetë të Dërguarin e Allahut kur i pati thënë:

- "*Çdo çast që secili prej jush e kalon duke luftuar në rrugën e Allahut është më i mirë dhe më i mbarë sesa të gjitha punët e kryera gjatë gjithë jetës pranë familjes së tij.*" Suhejli, pasi më transmetoi këtë hadith, më tha: "Unë do të bëj roje këtu gjersa të më vijë vdekja, e nuk do të kthehem më kurrë në Mekë." Me të vërtetë, ai qëndroi në Siri, pa u larguar asnjëherë, derisa humbi jetën gjatë një epidemie të murtajës që u përhap asokohe në Amuas."[17]

Largimi i Harith bin Hishamit nga Meka për të luftuar

Ebu Neufel bin Ebi Akrebi tregon: "Në kohën që Harith bin Hishami u largua nga Meka me qëllimin për të marrë pjesë në luftë, njerëzit e Mekës u mërzitën shumë; të gjithë, pa përjashtim, dolën

[16]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/318 (5227).
[17]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 5/453.

nëpër rrugë, që ta përcillnin. Ai, kur mbërriti në pjesën e sipërme të Bat'has, apo diku atje, në rrethinat e saj, ndaloi. Përreth iu mblodh thuajse e tërë Meka, qanin për të. Harithi, kur pa gjithë atë mërzi në fytyrat e njerëzve, ai u tha atyre:

"O njerëz! Uallahi, unë nuk u nisa për rrugë se nuk doja të rrija më mes jush, apo se më pëlqeu më shumë ndonjë qytet tjetër sesa Meka. Kur u shfaq çështja e madhe e Islamit, Kurejshin e braktisën njerëz të atillë, që ata nuk ishin paria e Kurejshit. Sikur të gjitha malet e Mekës të shndërrohen në flori dhe ne ta shpenzojmë të gjithin atë ar në rrugën e Allahut, prapëseprapë, ne nuk u afrohemi dot virtyteve që ata myslimanë i kanë fituar vetëm në një ditë të vetme. Uallahi, ata na e kaluan në këtë botë, andaj ne duhet të përpiqemi që të shoqërohemi me ta në amshim!"

Ai që na e përcjell këtë hadith thotë: "Nëse një njeri përfshihet në mbrojtjen e Allahut dhe nuk e kërkon vetëm se prej Tij mbrojtjen, ai lartësohet dhe i shtohen vlerat. Me të vërtetë, Harithi lëvizi në drejtim të Sirisë, e i la pas plaçkat e çmuara dhe mërgimin. Ai ra dëshmor atje. Lusim Allahun që ta presë atë me mëshirë."[18]

Pasioni i Halid bin Uelidit për të luftuar në rrugën e Allahut

Tregon një prej skllevërve të familjes së Halidit (radijallahu anhu), Zejadi: Teksa po vdiste, Halidi pati thënë këto fjalë: "Në këtë tokë, asnjë natë nuk dua më shumë, sesa ajo natë e acartë, në të cilën ngrije nga të ftohtët, që kemi kaluar gjatë një ekspedite që patën organizuar Muhaxhirët! Atë natë, bashkë me sahabët patëm pritur agimin që të sulmonim mbi armiqtë. Edhe ju lidhuni fort pas të luftuarit dhe të të përpjekurit në rrugën e Allahut, kurrsesi të mos i braktisni këto!"[19]

Kajs bin Ebi Hazim tregon: Halid bin Uelidi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "As natën e parë me një grua që e dua, apo një natë që të më thonë lajmin 'Je bërë me djalë!' nuk e dua aq shumë sa ç'dua atë natë të ftohtë acar, në të cilën ngrije nga të ftohtët, që kam kaluar mes

[18]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 1/304.
[19]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 1/414.

një tabori ushtarësh nga Muhaxhirët, duke pritur agimin gati për të sulmuar mbi armikun."

Halid bin Uelidi ka thënë kështu: "Të luftuarit në rrugën e Allahut, shumë herë më ka penguar edhe të lexoj Kur'anin." Ndërkohë, sipas një transmetimi tjetër, na përcillet se Halidi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Të luftuarit nuk më ka lënë kohë as për të mësuar shumë pjesë të Kur'anit."[20]

Ebu Uaili tregon: "Në çastet e fundit të jetës, Halidi (radijallahu anhu) thoshte këto fjalë: "Uallahi, aq shumë kam dashur që të vritesha në dyluftim e sipër, në ato momente kur vdekjet ndodhin njëra pas tjetrës! Por paska qenë e thënë të vdes në shtrat! Mes punëve të mia në këtë jetë, pas fjalës së dëshmisë 'La ilahe il'lallah', veç asaj nate të ftohtë acar e që shiu binte me rrebesh, që prisja agimin, për t'iu vërsulur mohuesve, nuk kam asgjë tjetër që të më japë shpresë!" Më vonë ai tha këto fjalë: "Kur të vdes, amanet kujdesuni për shpatën dhe kalin, e mos ma lini shpatën pa e përdorur në rrugën e Allahut."

Kur Halidi vdiq, Omeri (radijallahu anhu) mori pjesë në xhenazen e tij, madje tha këto fjalë: "Grave të familjes së Uelidit u lejohet, mund ta qajnë e të derdhin lot për Halidin, me kushtin që të mos grisin teshat e të mos qajnë me zë të lartë!"[21]

Dëshira e zjarrtë e Bilalit (r.a.) për të marrë pjesë në luftë

Bilali (radijallahu anhu) shkoi pranë Ebu Bekrit (radijallahu anhu) dhe i tha:

- "O kalifi i të Dërguarit të Allahut! Kam dëgjuar Profetin tonë, që ka thënë: "*Puna më e virtytshme që mund të bëjë një besimtar, është të luftojë në rrugën e Allahut.*" Andaj, unë kam vendosur, që derisa të vdes, të bëhem syri rojtar i besimtarëve e të bëj roje në rrugën e Allahut."

- "Të lutem, o Bilal, për hir të dashurisë që ke për Allahun! Për respektin që ke për mua, mendo për marrëdhënien tonë me njëri-tjetrin, e mos ik, qëndro këtu. Ti e sheh, unë nuk jam më i njëjti, po plakem e fuqitë po më lënë dhe exheli po më afrohet."

[20]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 1/414.
[21]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 1/415.

Bilali nuk ia ktheu dhe ndenji. Kur vdiq Ebu Bekri (radijallahu anhu), edhe pasardhësi i tij, Omeri (radijallahu anhu) i kërkoi, po njësoj si Ebu Bekri (radijallahu anhu), Bilalit, që të rrinte në Medinë. Bilali nuk pranoi.

- "Po mirë, po ezanin kujt do t'ia lësh, o Bilal?", – e pyeti Omeri.

- "Ezanin po ia lë Sadit, sepse edhe ai e pati kënduar njëherë ezanin, kur ishim në Kuba dhe Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte ende mes nesh." Kështu, Omerit (radijallahu anhu) iu desh t'ia kalonte Ukbes dhe Sadit detyrën e të kënduarit të ezanit.[22]

Sipas asaj që na e përcjell Musa bin Muhamed bin Ibrahim Tejmiu, i ati i ka transmetuar atij se: "Kur u nda nga kjo jetë Vula e profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ende pa u vënë në tokë, Bilali këndoi ezanin. Myslimanët filluan të qanin të gjithë si xhemat. Kur e varrosën atë trup të bekuar, Ebu Bekri tha:

- "Bilal, këndo ezanin!"

- "Nëse ti më ke liruar, me kushtin që unë të mos ndahem kurrë prej teje, atëherë unë do të bëj ashtu siç do të më thuash ti. Por, nëse ti ma dhe lirinë për hir të Allahut, atëherë, më lër të qetë pashë Allahun!"

- "Po, nuk ka dyshim që të lirova për Allahun.", – iu përgjigj Ebu Bekri.

- "Atëherë, tani që nuk është më i Dërguari i Allahut, unë nuk do ta këndoj më ezanin për askënd."

- "Ti e di, o Bilal, si të duash!", – i tha Ebu Bekri.

Bilali ndenji në Medinë, derisa myslimanët filluan të dërgonin ushtarë në Siri. Më vonë ai iu bashkua grupeve të ushtarëve që largoheshin dhe bashkë me ta shkoi në Siri."

Said bin Musejebi tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) u ngjit dhe u ul në minber, duke u bërë gati për të mbajtur hutben, kur Bilali tha:

- "O Ebu Bekr!

- "Më thuaj, o Bilal.", – iu përgjigj Ebu Bekri.

- "Ti mua, për Allahun më lirove, apo për kënaqësinë tënde?"

[22]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/168.

- "Për hir të Allahut të lirova."

- "Po mirë, atëherë, më jep leje tani që unë të luftoj në rrugën e Allahut!"

Dhe Ebu Bekri i dha leje Bilalit dhe ai iku në Siri, ku edhe u nda nga jeta më vonë."[23]

Historia e luftës e Ebu Talhasë

Enesi (radijallahu anhu) na transmeton: "Një ditë, Ebu Talhaja po lexonte suren "Beraet" (Teube). Kur arriti tek ajeti: "**Dilni në luftë, qofshi të shëndetshëm ose të sëmurë dhe luftoni me pasurinë e jetën tuaj në rrugën e Allahut! Kjo është më mirë për ju, veç sikur ta dinit!**" (Teube, 9/41), ai tha:

- "E shoh, Zoti ne na kërkon, qofshim të rinj, qofshim të moshuar, të marrim pjesë në luftë të gjithë. Bijtë e mi! Më ndihmoni menjëherë të bëhem gati për luftë." Djemtë i thanë atij:

- "Zoti ty të mëshiroftë! Ti ke luftuar pranë Resulullahut, e luftove edhe krah për krah me Ebu Bekrin dhe Omerin deri në vdekjen e tyre. Mjafton, të luftojmë edhe ne pak në vendin tënd." Ebu Talhaja u tha:

- "Jo, në asnjë mënyrë! Më ndihmoni të përgatitem! Ndihmomëni!" Pas njëfarë kohe, Ebu Talhaja u nis në një luftë detare. Exheli i erdhi teksa ishte në det dhe u nda nga jeta. Vetëm pas shtatë ditësh arritën të gjenin një ishull, që të mund ta varrosnin. Kur e çuan në ishull, për ta varrosur, trupi i tij nuk qe prishur fare."[24]

Historia e luftës e Ebu Ejub el-Ensarit

Muhamed bin Sirini tregon: "Ebu Ejub el-Ensari (radijallahu anhu) pati shkuar pas të Dërguarit Fisnik, për të marrë pjesë në luftën e Bedrit. Përveç një viti, ai pati marrë pjesë bashkë me të gjithë veteranët e Islamit. Edhe atë vit që nuk pati marrë dot pjesë, ai nuk pati marrë pjesë, pasi në krye të ekspeditës ishte caktuar komandant një djalë i ri. Gjithmonë mërzitej shumë kur i kujtohej ai vit që nuk mori dot pjesë

[23]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/150.
[24]. Ibn Abdilberr, *el-Istiab,* 1/550.

në luftë, madje, herë-herë thoshte: "Ç'më duhej mua, ç'më duhej mua se kush ishte caktuar komandant!" Më vonë, ai u sëmur. Atëherë në krye të ushtrisë ishte Jezid bin Muauije. Jezidi pati ardhur ta vizitonte Ebu Ejubin dhe e pati pyetur:

- "Ke ndonjë kërkesë? Të nevojitet ndonjë gjë?" dhe Ebu Ejubi i qe përgjigjur:

- "Kërkesa që kam unë është kjo: Kur të vdes, trupin tim ma vendosni mbi shpinën e një kafshe dhe lidheni fort, pastaj më ço edhe mua deri atje ku do të përparosh edhe ti në territorin e armiqve dhe më lër atje. Nëse nuk arrin të bësh dot më përpara, atëherë më varros aty dhe kthehu."

Ai që e transmeton këtë ndodhi dhe këto fjalë thotë se: "Kur u nda nga jeta Ebu Ejubi, Jezidi e lidhi trupin e tij mbi një kafshë dhe e çoi në tokat e armiqve, e aty ku e pa se e kishte të pamundur që të shkonte më tej, e varrosi dhe u kthye pas."

Ebu Ejubi thoshte: "Allahu thotë, "**O besimtarë, si në shëndet të mirë, ashtu edhe në sëmundje, jini gati për të luftuar.**" Kurse unë herë ndihem mirë, herë ndihem i rënduar, kështu që në luftë duhet të marr pjesë edhe unë."[25]

Kurse transmetimi i Ahmed bin Hanbelit është i këtillë: "Ebu Ejjubi u nis bashkë me Jezid bin Muauijen në luftë. Në një çast ai i tha Jezidit: "Nëse vdes, atëherë më çoni në tokat e armikut dhe në vendin e parë që do të përballeni me ta, aty të më varrosni." Mandej, Ebu Ejubi i tha edhe këto fjalë: "Unë nga i Dërguari i Allahut kam dëgjuar, se, "Kush vdes pa i shoqëruar Allahut shok a ortak në krijim, do të hyjë në Xhenet."[26]

Ebu Hajthemeja (r.a.) niset për në luftë duke i lënë pas gjithë të mirat e kësaj bote

Ibni Is'haku transmeton: "Gjatë një udhëtimi për në luftë, Ebu Hajthemeja pasi eci për disa ditë në shoqërinë e të Dërguarit të Allahut, u largua prej tyre dhe u kthye pas. U kthye në shtëpinë e tij në

[25]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/49.
[26]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 8/59.

një ditë shumë të nxehtë. Dy gratë i gjeti në kopshtet e hurmave, po qëndronin ulur në njërin prej çardakëve. E lagën vendin mirë me ujë, që të freskohej disi dhe u çuan të përgatitnin ushqime dhe t'ia sillnin të shoqit, bashkë me ujin e ftohtë. Kur hyri brenda Ebu Hajthemeja qëndroi njëherë te porta pa lëvizur, e, pasi pa ato që gratë e tij kishin përgatitur për të, qëndroi për pak çaste i menduar dhe u tha grave:

- "I Dërguari i Allahut të rrijë nën diellin përvëlues, mes furtunave të rërës, kurse Ebu Hajthemeja të flladitet në hije e të shijojë gratë e tij të bukura, ushqimet e mira që ato i kanë përgatitur dhe pasurinë e tij! Kjo, jo vetëm që nuk është e drejtë, por do të thotë edhe të jesh i pamëshirshëm. Uallahi, nuk kam për t'u futur në asnjë çardak, por do të kthehem drejt e te Resulullahu! Më bëni menjëherë gati pak ushqim, se do ta marr me vete!"

Dhe gratë bënë ashtu siç u tha ai. Mandej, ai afroi devenë, ngarkoi ç'kishte për të ngarkuar dhe u nis për t'u rikthyer pranë të Dërguarit të Allahut. Në rrugë u takua me Umejr bin Uehb el-Xhumahin, i cili iu bë shok rruge. Profetin tonë e arritën pikërisht në kohën që edhe pak dhe do të mbërrinin në Tebuk. Kur iu afruan Tebukut, Ebu Hajthemeja i tha shokut të tij:

- "Unë jam mëkatar, rri pak mbrapa ti, që kur t'i afrohemi të Dërguarit të Allahut, të shkoj vetëm pranë tij." Dhe ai pranoi. Kur iu qasën ushtrisë, sahabët thanë:

- "Shikoni atje përtej, po vjen një kalorës."

- "*Dashtë Zoti të jetë Ebu Hajthemeja.*", – tha i Dërguari i Allahut.

- "Po, ai është!", – thanë sahabët. - "Uallahi, Ebu Hajthemeja është!" Ebu Hajthemeja uli devenë dhe përshëndeti Profetin tonë. I Dërguari i Allahut i tha atij:

- "*Ebu Hajtheme, për pak edhe do të rrënoheshe!*" Mandej, Ebu Hajthemeja i tregoi atij të gjitha, një e nga një, të vërtetën, çfarë kishte ndodhur.

- "*Ke vepruar mirë!*", – i tha atij i Dërguari i Allahut dhe iu lut Allahut që t'i jepte më të mbarën Ebu Hajthemesë.[27]

[27]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/7.

6. TRISHTIMI I ATYRE QË NUK KISHIN FUQI TË MERRNIN PJESË NË LUFTË DHE I ATYRE QË NUK KISHIN SE ÇFARË TË JEPNIN NË RRUGËN E ALLAHUT

Historia e Ebu Lejlasë dhe Abdullah bin Mugafelit

Transmeton Ibni Is'haku: "Një ditë, kur të gjithë po merreshin me përgatitjet për ekspeditën luftarake të Tebukut; Ibni Jamin en-Nadri pa Ebu Lejlanë dhe Abdullah bin Mugafelin që po qanin të dy.

- "Pse po qani?", – i pyeti ai dhe ata i dhanë këtë përgjigje:

- "Duam të nisemi për në luftë bashkë me të Dërguarin e Allahut. Shkuam tek ai që të na jepte ndonjë kafshë rruge, por nuk kishte që të na jepte. Andaj nuk do të dalim dot!" Paskëtaj, Ibni Jamini u dha të dyve nga një deve, u dhuroi edhe nga një masë të mirë hurmash, duke u bërë kësisoj shkas që të merrnin edhe ata të dy pjesë në luftë.

Junus bin Bukejri na tregon, duke na përcjellë prej Ibni Is'hakut, se: "Njëri prej atyre që nuk i kishin mundësitë për t'u bërë gati, që të niseshin edhe ata bashkë me ushtrinë, drejt Tebukut, ishte edhe Ulbe bin Zejdi. Ulbeja, fali namaz natë gjatë dhe qau shumë teksa lutej dhe në lutje thoshte:

"O Zot! Ti na urdhërove ne të luftojmë, duke na nxitur që të marrim pjesë gjithmonë. Mirëpo, unë nuk i kam mundësitë për të shkuar në luftë bashkë me Profetin. Dhe të Dërguarit Tënd Ti nuk i ke lënë më asnjë kafshë rruge, që të ma japë mua e të jem edhe unë mes tyre. Ndaj, unë nuk kam se ç'sadaka të të fal Ty, përveç padrejtësisë që myslimanët mund të bëjnë ndaj meje."

Kur agoi mëngjesi, i Dërguari i Allahut iu drejtua xhematit me fjalët:

- "*Ku është ai që na dha sadaka gjatë natës?*" Në këmbë nuk u ngrit asnjë. Ai foli sërish:

- "*Kush na dha sadaka të çohet.*" Sakaq, Ulbeja u çua në këmbë dhe filloi t'ia sqaronte të Dërguarit të Allahut se çfarë kishte ndodhur. Atëherë Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Lajme të mira për ty! I betohem Allahut që e ka në dorë frymën time, se sadakaja jote u regjistrua mes punëve të pranuara të besimtarëve!*"[28]

[28]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/5.

7. GJENDJA E ATYRE QË E SHTYNIN PËR MË VONË DALJEN NË LUFTË

Ibni Abasi (radijallahu anhu) ka treguar: "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), e pati dërguar Abdullah bin Reuahan në luftë, në krye të një grupi ushtarësh. Koha e nisjes përkoi me kohën kur do të falej namazi i xhumasë. Abdullahu i nisi para shokët e tij dhe tha me vete: "Unë më mirë të qëndroj këtu, të fal namazin e xhumasë me Profetin tonë, pastaj nisem dhe i arrij gjatë rrugës." Pasi fali namazin dhe u kthye, i Dërguari i Allahut e pa Abdullahun. Ai i tha atij:

- "*Po ti, pse nuk u nise bashkë me shokët, në mëngjes?*"

- "Desha që ta falja me ty namazin e xhumasë, ndaj mendova se mund t'i arrij pasi të mbarojë namazi.", – i tha Abdullahu.

- "*Sikur të gjitha pasuritë që gjenden mbi rruzullin tokësor t'i shpenzosh krejt në rrugën e Allahut, ti prapë nuk do ta arrish dot shpërblimin dhe gradën e lartë që kanë fituar hapat e tyre sot në mëngjes!*", – foli i Dërguari i Allahut.[29]

8. QORTIMI I ATYRE QË RRININ NË SHTËPI DHE NUK MERRNIN PJESË NË LUFTË

Interpretimi i Ebu Ejub el-Ensarit për kuptimin e ajetit "Mos e vini veten në rrezik me duart tuaja!"

Ajo që na përcjell Ebu Imrani është kështu: "Ne patëm shkuar deri në Kostandinopojë, për të luftuar nën komandën e Abdurrahman bin Halid bin Uelidit. Bizantinët i kishin lidhur shpresat fort pas mureve të kështjellës. Njëri prej nesh veproi hapur ndaj kundërshtarëve. Xhemati mysliman tha:

- "Shikojeni se çfarë bën ky njeri! Po e vë vetë veten e tij në rrezik!"

Paskëtaj u hodh e foli Ebu Ejub el-Ensari, i cili tha:

- "Ajeti, '**Mos e vini veten në rrezik...**' enkas për ne ensarët është zbritur. Asisoj që, kur Allahu i Lartësuar e ndihmoi Profetin e Tij dhe e nxori fitimtar Islamin, atëherë edhe ne si ensarë thamë: "Tani të

[29]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/242.

rrimë në krye të punëve e të pasurisë, që të marrim akoma edhe më shumë prodhim." Mirëpo, Allahu zbriti ajetin, '**Jepni nga e juaja në rrugën e Allahut dhe të mos e vini veten në rrezik në asnjë mënyrë...**' (Bekare, 2/195) Kësisoj, edhe ne e kuptuam se veten do ta vinim në rrezik duke braktisur luftën, për t'u qëndruar punëve mbi krye e duke u kujdesur vetëm që t'i shtonim edhe më prodhimet tona."

Ebu Imrani ka thënë se: "Ebu Ejubi luftoi në rrugën e Allahut deri në ditët e fundit të jetës, derisa, në fund, atë e varrosën në Kostandinopojë."[30]

Një tjetër transmetim shumë i shkurtër që përcillet prej Ebu Imranit thotë kështu: "Në Kostandinopojë, njëri prej muhaxhirëve veproi papritur në drejtim të radhëve të armikut. Me ne ishte edhe Ebu Ejub el-Ensari. Luftëtarët myslimanë thanë, se "ai e vuri më kot veten e tij në rrezik". Ebu Ejub el-Ensari, kur dëgjoi ato fjalë, tha:

- Ne e kuptojmë më mirë ajetin, "**Mos e vini vetë veten tuaj në rrezik.**" Ky ajet është zbritur për ne ensarët. Ne e përkrahëm menjëherë të Dërguarin e Allahut, morëm pjesë bashkë me të nëpër luftëra dhe nuk qëndruam kurrë pa i ardhur në ndihmë, sa herë që të kishte nevojë. Kur Islami u përhap dhe doli fitimtar ndaj mohimit dhe idhujtarisë; ne, si Ensarë, u mblodhëm fshehtas dhe filluam të themi, me vete dhe me njëri-tjetrin: "Allahu ne na nderoi duke na bërë shokë të profetit të Tij, e për më tepër, na fali edhe mundësinë që t'i vijmë në ndihmë fesë së Tij. Tanimë Islami u përhap, e numri i myslimanëve është shtuar ndjeshëm. Para grave dhe pasurisë sonë ne zgjodhëm të Dërguarin e Allahut. Tani që lufta me shpatë mbaroi, të kthehemi pranë pjesëtarëve të familjes e të qëndrojmë pranë tyre." Fill pas kësaj, Allahu i Madhërishëm zbriti ajetin: "**Jepni nga ajo që keni në rrugën e Allahut dhe kurrsesi mos e vini vetë veten në rrezik...**" (Bekare, 2/195) Për rrjedhojë, rreziku i vërtetë ishte të qëndroje pranë pjesëtarëve të familjes, në krye të punëve, të mallit e të plaçkës dhe të braktisje luftën.[31]

[30]. Bejheki, *Sunen,* 9/99 (17974).
[31]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 4/176.

9. FJALËT E RESULULLAHUT QË SHPREHIN SE SA TË RËNDËSISHME JANË NË RRUGËN E ALLAHUT DERI EDHE PLUHURI I RRUGËS

Rabi bin Zejdi tregon: "Një ditë, teksa Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) po bënte një shëtitje në rrugë si përditë, pa një djalosh nga kurejshët, që preu nga rruga dhe u largua më tutje.

- "*Po ky, a nuk është filani?*", – pyeti ai (a.s.).

- "Po, ai është!", – iu përgjigjën.

- "*Thirrmani!*", – tha i Dërguari i Allahut. Kur erdhi ai djalë i ri, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e pyeti:

- "*Pse u ndave nga rruga, e u largove andej?*" Ai iu përgjigj:

- "U largova për të shpëtuar nga pluhuri i rrugës."

Profeti ynë i tha atij djali të ri:

- "*Mos ec më i veçuar nga rruga! Unë të betohem në Allahun, se, në rrugën e Allahut edhe këto pluhura janë të barabarta me aromat e mira që mbizotërojnë gjithkah në Xhenet!*"[32]

Historia e Xhabir bin Abdullahut

Ebu'l-Musabih el-Mukraij tregon: "Një ditë, bashkë me një grup besimtarësh dhe nën komandën e Malik bin Abdullah el-Khath'amit, ne po përparonim në tokat e Bizantit, kur Maliku shkoi pranë Xhabir bin Abdullahut, që kishte zbritur nga mushka dhe po e tërhiqte dhe i tha:

- "O Ebu Abdullah, po pse nuk i hip kësaj mushke, Allahu ndaj ta ka dhënë, që t'i hipësh!"

- "Jam duke e çlodhur, e kështu as nuk po u bëhem shokëve barrë. Pastaj, unë kam dëgjuar vetë të Dërguarin e Allahut kur ka thënë: "*Flakëve të Xhehenemit u është ndaluar ta djegin atë njeri, të cilit i janë pluhurosur këmbët në rrugën e Allahut!*" Maliku eci dhe kur mbërriti në një distancë nga ku zëri do të vinte sërish deri te Xhabiri, i tha Xhabirit:

[32]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 5/69 (4608).

- "Allahu andaj ta ka dhënë atë kafshë, që t'i hipësh, po ti e di!" Xhabiri, kur e kuptoi se me çfarë qëllimi ia tha ato fjalë Maliku, tha:

- "Jam duke e çlodhur kafshën e gjorë, e nuk po u bëhem as shokëve barrë. E, megjithatë, unë kam dëgjuar që i Dërguari i Allahut ka thënë: "*Allahu ua ka ndaluar flakëve të Xhehenemit të djegin atë njeri, këmbët e të cilit janë pluhurosur në rrugën e Allahut!*"

Pas këtyre fjalëve, të gjithë luftëtarët një tu hedhur bënë nga shpina e kafshëve të tyre dhe zbritën. Asnjëherë tjetër nuk kam parë ndonjë ushtri që të ketë ecur më shumë në këmbë sesa kanë ecur ata luftëtarë atë ditë."[33]

10. AGJËRIMI DHE NAMAZI GJATË LUFTËS

Agjërimi gjatë të luftuarit në rrugën e Allahut

Umul-Derdaja (radijallahu anha) ka transmetuar se i shoqi i saj Ebu'd-Derdaja (radijallahu anhu) ka thënë: "E mbaj mend shumë mirë njëherë, kur ishim nisur për të luftuar, bashkë me të Dërguarin e Allahut, dhe ishte një ditë shumë e nxehtë vere (ishte muaj Ramazan). Nga i nxehti i tejskajshëm, njerëzit i mbanin të gjithë duart mbi kokë. Nga ne nuk agjëronte askush, veç të Dërguarit të Allahut dhe Abdullah bin Reuahas."[34]

Madje tregon edhe Ebu Said el-Hudriu (radijallahu anhu): "Gjatë muajit të Ramazanit, ne po shkonim në luftë me Resulullahun (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Disa nga ne agjëronin, disa të tjerë jo. Askush nuk e gjykonte njëri-tjetrin, as ata që po agjëronin ata që nuk kishin agjëruar pse nuk kishin agjëruar, as ata që nuk agjëronin ata që kishin agjëruar pse kishin agjëruar! Të gjithë mendonin për ata që mund të agjëronin se kjo ishte diçka shumë e mirë; e për ata që nuk kishin agjëruar dot mendonin se edhe atyre u bënte mirë të ngrënët."[35]

---

[33]. Ibn Haxher, *Fet'hul-Bari,* 6/30.
[34]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/258.
[35]. Ibn Hibban, *Sahih,* 8/324 (3558).

Kur Profeti ynë fal namazin në Bedër

Me sa na përcillet prej Aliut (radijallahu anhu), ai ka thënë këto fjalë: "Në ditën Bedrit, pranë nesh nuk kishte asnjë kalorës, përveç Mikdadit. E mbaj mend mirë, veç të Dërguarit të Allahut, ne të tjerëve na pati zënë gjumi të gjithë. I Dashuri i Allahut (alejhis'selam) fali namaz duke derdhur lot nën një pemë aty pranë deri në agim."[36]

Kur Abad bin Bishr el-Ensari fal namazin gjatë luftës

Xhabiri (radijallahu anhu) tregon: "Ne ishim nisur bashkë me Profetin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) për të luftuar në Dhatu'r-rika. Kur mbërritëm në vendin e quajtur "Nahl", një burrë u kap me fjalë me një grua nga të idhujtarëve. Në atë kohë i shoqi i saj nuk gjendej në shtëpi. Kur ishte larguar Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kishte shkuar në shtëpinë e atij idhujtari. Me të mësuar se çfarë kishte ndodhur, ai burrë u betua se nuk do të hiqte dorë nga ajo punë, pa derdhur të paktën gjakun e njërit prej sahabëve të Muhamedit të nderuar, ndaj edhe u vu menjëherë në kërkim të gjurmëve të tyre. Profeti ynë u vendos në një vend dhe i pyeti sahabët:

- "*Kush do të më mbrojë mua sot?*", – Nga muhaxhirët u hodh i pari Amar bin Jasiri, ndërsa nga ensarët Abad bin Bishri:

- "Ne, o Resulallah.", – thanë ata. I Dërguari i Allahut tha:

- "*Në rregull, atëherë prisni atje te shtegu i hyrjes së kësaj lugine.*" Ata shkuan të dy në vendin për ku i drejtoi i Dërguari i Allahut dhe kur mbërritën, Abadi i tha shokut të tij prej mërgimtarëve:

- "Kur do ta bësh pushimin ti, në të hyrë të natës, apo në pjesën e fundit të saj?" Muhaxhiri i tha:

- "*Në të hyrë.*", - dhe sakaq u shtri dhe fjeti.

Abad bin Bishri u çua në këmbë dhe filloi të falte namaz. Në atë kohë, aty ia behu ai burrë, që njëri prej sahabëve ishte ngatërruar me fjalë me të shoqen e tij. Pa një hije dhe e kuptoi se ishte hija e ndokujt që duhej të ishte duke bërë rojë, ndaj nxori një shigjetë dhe e goditi.

[36]. Ibn Kethir, *Sire,* 2/401.

Shigjeta u ngul në trupin e Abadit. Abadi arriti ta nxirrte shigjetën, mirëpo ai burrë e qëlloi sërish, për herë të dytë e për herë të tretë, e të dyja shigjetat u ngulën në trupin e Abadit. Pas secilës prej tyre Abadi përpiqej të qëndronte në këmbë, i palëkundur, e i nxirrte shigjetat një e nga një, derisa tha:

- "Çohu tani, o Amar, se unë u plagosa." Amari u çua menjëherë nga vendi. Ai idhujtar, kur pa se nuk ishte vetëm një roje, por dy, ia mbathi. Kur e pa se shoku i tij, Abadi, qëndronte i shtrirë dhe i mbuluar në gjak, Amari tha:

- "I Patëmetë je Ti, o Allah! Pse nuk më zgjove që me plagën e parë!"

Abadi iu përgjigj:

- "Isha duke kënduar një sure (sipas transmetimit që i bën Bejhakiu kësaj ngjarjeje, ka qenë sureja "Kehf"), e nuk desha ta ndërprisja namazin pa e mbaruar të gjithën. Mirëpo, kur filluan të më goditnin shigjetat njëra pas tjetrës, atëherë u përula në ruku dhe të zgjova. Por, unë i betohem Allahut, se po të mos më kaplonte frika se nuk do ta ruaja dot hyrjen e kësaj lugine, ashtu siç na urdhëroi Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), më mirë të vdisja, sesa të lija namazin në mes!"[37]

Të falurit e namazit të natës gjatë luftës

Urueja (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Kur dy ushtritë iu afruan njëra-tjetrës (ushtritë, ajo e myslimanëve dhe ajo e bizantinëve) në luftën e Jermukut, komandanti bizantin caktoi me detyrë një arab, që të shkonte e të mblidhte të dhëna rreth gjendjes dhe situatës në radhët e luftëtarëve myslimanë. Kur ai burrë i pa të gjitha mirë e mirë, e u kthye, komandanti e pyeti:

- "Si ishte gjendja?" Spiuni iu përgjigj:

- "Imzot, këta qenkan një popull, që natën e kalojnë duke adhuruar Zotin, njësoj si murgjit, ndërsa ditën si luftëtarë, të hipur mbi kuaj dhe deve!"[38]

---

[37]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/85.
[38]. Taberi, *Tarih,* 2/347.

Ebu Is'haku transmeton: "Herakliu i pyeti ushtarët e tij:

- "Çfarë ju ka gjetur, që të gjithë ktheheni të mundur prej myslimanëve?" Njëri prej më të mëdhenjve nga bizantinët u çua dhe tha:

- "Sepse ata gjatë gjithë natës i bëjnë adhurime Zotit, ndërsa ditën luftojnë duke mbajtur agjërim."[39]

11. TË PËRMENDURIT E ALLAHUT PA NDËRPRERJE GJATË LUFTËS

Sahabët, gjithë natën e parë të Ngadhënjimit mbi Mekën e kaluan duke bërë dhikr (duke përmendur Allahun)

Said bin Musejebi tregon: "Kur hynë myslimanët në Mekë, natën e parë të ndadhënjimit e kaluan duke kënduar tekbire, tehlile (*La ilahe il'lallah*) dhe duke u sjellë rreth Qabes. Ebu Sufjani i tha së shoqes, Hindit:

- "Si thua? Këto që po ndodhin, të gjitha nga Allahu janë?"

- "Po, nga Allahu.", – u përgjigj Hindi.

Kur agoi, Ebu Sufjani e mbajti frymën drejt e tek i Dërguari i Allahut. Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i tha atij:

- "*O Ebu Sufjan, ti a e pyete Hindin,* 'si thua, këto të gjitha nga Allahu vijnë?', *dhe ajo t'u përgjigj:* 'Po, nga Allahu.', duke i bërë kësisoj të ditur se ai ishte në dijeni edhe të bisedës që ata kishin pasur me njëri-tjetrin. Kur dëgjoi këto fjalë, Ebu Sufjani i tha atij:

- "Unë dëshmoj me siguri, se ti medoemos je robi dhe i Dërguari i Allahut. Unë jam i sigurt se ato fjalë që thashë nuk i dëgjoi askush tjetër veç Hindit!"[40]

Gjatë gjithë rrugës për në luftën e Hajberit sahabët e përmendën Allahun me zë të lartë

Ebu Musa el-Esh'ari (radijallahu anhu) ka thënë: "Profeti i

[39]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/15.
[40]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/304.

profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kur ishim në betejën e Hajberit, apo në mos gaboj gjatë rrugës për në Hajber dhe myslimanët patën mbërritur pranë një lugine, myslimanët filluan të këndonin tekbire me zë të lartë, duke thënë: '*Allahu Ekber, La ilahe il'lallah*". Kësodore, i Dërguari i Allahut tha:

- "*Mos e mundoni veten kështu! Ju nuk po thërrisni as ndonjë të shurdhër, as ndonjë që nuk është këtu me ju! Nuk ka pikë dyshimi, që ju po i luteni Dikujt që jo vetëm ju dëgjon ju mjaft mirë, por që është më pranë jush sesa kushdo tjetër.*" Ai që e transmeton këtë hadith, Ebu Musai thotë se: "Në ato çaste unë gjendesha pas kafshës së rrugës së të Dërguarit të Allahut. Kur dëgjoi që unë po thosha *'La haule ue la kuuete il'la bil'lah, robi nuk ka as forcë as fuqi; çdo gjë ndodh me fuqinë dhe me ndihmesën e Allahut.*', Ai më tha:

- "*A të të mësoj një fjalë që është prej thesareve të Xhenetit?*"

- "Ma mëso, o Resulallah! T'u bëfshin kurban nëna dhe babai im!", – i thashë unë.

I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u përgjigj:

- "*Ajo fjalë është 'La haule ue la kuuete il'la bil'lah*'.[41]

Sahabët, kur ngjitnin ndonjë të tatëpjetë thoshin 'Allahu Ekber', ndërsa kur e zbrisnin 'Subhanallah'

Xhabiri (radijallahu anhu) thotë se: "Kur na qëllonte t'i ngjiteshim ndonjë të tatëpjete, thoshim gjithmonë '*Allahu Ekber*', ndërsa kur zbrisnim ndonjë të tillë, thoshim '*Subhanallah*'. Ndërsa në një tjetër transmetim thuhet vetëm: "Kur zbrisnim i bënim *tesbih* (Subhanallah) Allahut."[42]

Fjalët që ka thënë Abdullah bin Omeri për luftëtarët, se si ata ndaheshin në dy grupe

Ibni Omeri (radijallahu anhu) thotë: "Njerëzit, në luftë, ndahen në dy grupe: Ka një pjesë, që, kur dalin në luftë, e përmendin shumë Allahun. Ata e kujtojnë vazhdimisht Allahun dhe, edhe kur janë

[41]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/213.
[42]. Buhari, *Sahih,* 3/1091 (2832).

në lëvizje, ata u shmangen nxjerrjes së ngatërresave, duke i ardhur përherë në ndihmë njëri-tjetrit e duke shpenzuar edhe nga gjërat e tyre më të çmuara, e më shumë sesa nga të fituarit, marrin kënaqësi nga të shpenzuarit në rrugën e Allahut; kur mbërrijnë në fushëbetejë, atyre u vjen shumë turp nga Allahu, që t'u shfaqet ndonjë dyshim, për të cilin nuk kanë qenë të vetëdijshëm deri atëherë, apo që të mendojnë gjëra të pakëndshme, siç mund të jetë të menduarit se myslimanët do të dalin të humbur, madje kjo i bën të dridhen nga droja që kanë karshi Allahut. Megjithëse kanë mundësi të marrin ndonjë gjë më tepër se ç'duhet nga plaçka e luftës, atyre kjo as nëpër zemër nuk u kalon. Djalli, jo vetëm që nuk i gënjen dot ata, por as dyshime e vesvese nuk hedh dot në zemrat e tyre. Allahu, me këta e lartëson fenë e Tij dhe në sajë të tyre i mund dhe i poshtëron ata njerëz që i shpallin armiqësi.

Ndërsa, grupi i dytë janë ata që, kur dalin për të luftuar as nuk e përmendin Allahun, as nuk bëhen shkas për t'u përmendur Allahu. Nuk u shmangen ngatërresave dhe e japin krejtësisht pa dëshirë atë që japin nga pasuria e tyre. Edhe ato që harxhojnë, ata i konsiderojnë si një borxh që do të vijë një ditë e do t'u kthehet pas. Ata djalli i cyt vazhdimisht, e ata qëndrojnë gjithmonë pas kur organizohen radhët e ushtrisë. Strehohen nëpër guva e në majat e maleve, që të shohin njëherë se si është gjendja e të dyja ushtrive. Kur Allahu i Madhërishëm u fal myslimanëve ngadhënjimin, ata, më shumë se kushdo, merren me llafazanërinë e punës dhe të fitores së arritur, duke numëruar pa mbarim kontributet e tyre në të. Me të gjetur ndonjë mundësi për të përfituar pak më shumë nga plaçka e luftës, ata, megjithëse Zoti e ka ndaluar, guxojnë, e bëjnë edhe këtë. Djalli i mashtron duke u futur në koka mendimin 'hë se plaçkë lufte është, nuk ka gjë po të merrni më tepër.' Një të arritur rehatinë dhe kamjen, atyre u rritet mendja. Ndërsa, kur bien në vështirësi, djalli i vë ata në sprovë me ambicien për këtë botë. Këta nuk do të arrijnë të marrin dot as grimcën e shpërblimeve që Allahu u ka premtuar besimtarëve. Veç faktit që janë bashkudhëtarë deri në fushëbetejë, ata nuk kanë kurrfarë lidhjeje e të përbashkëte me besimtarët, sepse ndryshe e kanë qëllimin, e tjetër synim kanë. Në

ditën e Kiametit, Allahu, këta njerëz që luftojnë bashkë me besimtarët, do t'i mbledhë bashkë dhe pastaj do t'i ndajë sërish prej njëri-tjetrit."[43]

12. RËNDËSIA E LUTJES KUR NISESHIN PËR TË LUFTUAR

Lutja e Profetit tonë teksa po mërgonte nga Meka

Muhamed bin Is'haku tregon: "I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur po mërgonte nga Meka për në Medinë për hir të kënaqësisë së Allahut, është lutur kështu:

- "*Lëvduar qoftë Allahu, që unë nuk ekzistoja, e Ai më krijoi mua. O Zot! O Zot, ndihmomë mua prej frikës së botës, prej fatkeqësive të kohës dhe prej vështirësive që sjellin ditët e netët! Bëhu Ti shoqëruesi im i rrugës dhe më trashëgo mua me familje të mirë. Begatoje atë rrësk që më ke taksur mua. E bëmë mua të jem një rob i denjë për Ty. Falmë mua moral të mirë, dhe bëmë që të jem i palëkundur në ruajtjen e moralit tim. O Zot, më jep mundësinë që unë të të dua ashtu siç e meriton Ti, e mos më lër mua në duart e njerëzve.*

O Ti Zoti im, që je Zgjidhja për të gjithë ata që nuk gjejnë dot zgjidhje! Ti je Zoti im! Unë vetëm Ty të kërkoj ndihmë e vetëm te fisnikëria e bujaria Jote, që ndriçon gjithësinë dhe i zhbën krejt errësirat, e kam shpresën e mund të kërkoj strehë, që Ti të më ruash e të mos e meritoj ndëshkimin Tënd të ashpër dhe të mos përballem me mërzitjen Tënde.

O Zot, unë vetëm Ty të drejtohem, për të të kërkuar ndihmë, që të mos na e marrësh nga duart të mirën që na ke falur, që, në fund, të mos përballemi papritur me ndëshkimin Tënd të ashpër dhe shëndeti e mirëqenia që na ke falur të mos na shndërrohet në fatkeqësi, se vetëm mëshira Jote është aq e madhe sa t'i vijë hakut çdo të keqeje. Për mendimin tim, po arrita që të fitoj pëlqimin e kënaqësinë Tënde, unë vështirë se mund të bëj dot më ndonjëherë ndonjë punë më të mbarë!

O Zot! Vetëm Ti je i Gjithëfuqishëm e i Gjithëpushtetshëm."[44]

---

[43]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/774 (11347).
[44]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/178.

13. LUTJA PARA SE TË FILLOJË LUFTA

Kur Profeti ynë lutet në Bedër

Omeri (radijallahu anhu) thotë që: "Kur afroi dita e Bedrit, Profeti ynë i nderuar pa njëherë nga sahabët e tij, të cilët bëheshin diku te treqind vetë. Pa njëherë edhe andej nga ishin idhujtarët. Ata ishin më shumë sesa njëmijë vetë. Megjithëse sipër kishte veshur një jelek dhe një pelerinë, ai u drejtua nga kibleja dhe filloi të lutej, duke thënë këto fjalë:

"*O Zoti im! Bëje realitet atë fjalë që më ke dhënë. O Zot, po u vra ky grusht njerëzish, xhemati i myslimanëve, nuk do të mbetet mbi Tokë kush të të adhurojë Ty!*"

I Dërguari i Allahut i përgjërohej vazhdimisht Allahut, duke u lutur pa pushim. Madje, njëherë, jeleku që kishte veshur i ra nga trupi. Ebu Bekri (radijallahu anhu) u afrua, ia rregulloi atë rrobë Resulullahut mbi shpinë dhe pa i dalë përpara, i tha:

- "O Resulallah, mjaft iu lute Zotit! Ai, nuk ka dyshim që do ta mbajë fjalën që të ka dhënë ty!"

Kur ndodhi kjo, Allahu i Madhërishëm zbriti ajetin e nëntë të sures "Enfal": "**Ju kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj: 'Unë do t'ju ndihmoj me njëmijë engjëj të cilët do të vijnë njëri pas tjetrit.'**" (Enfal, 8/9)[45]

Tregon Abdullah bin Amr bin Asi (radijallahu anhu): "Profeti ynë u nis për në luftën e Bedrit dhe me vete kishte një forcë të përbërë prej treqind e pesëmbëdhjetë luftëtarësh. Kur mbërritën në atë zonë ku u zhvillua edhe lufta, i Dërguari i Allahut nisi të lutej duke thënë këto fjalë:

- "*O Zoti im! Këta janë të gjithë në këmbë dhe këmbët i kanë zbathur! Falu atyre kafshë rruge. O Zoti im, sahabët e mi janë të zhveshur, vishi ata, o Zoti im! O Zot, ata janë të uritur, prandaj ushqeji Ti!*"

Pas këtyre lutjeve nga ana e të Dërguarit të Allahut, Allahu i Madhërishëm u fali myslimanëve fitoren. Kur u kthyen pas, ata ishin të veshur mirë dhe barkun e kishin të ngopur. Çdonjëri prej luftëtarëve

[45]. Muslim, *Sahih,* 3/1383 (1763).

po kthehej me një ose me dy deve me vete."[46]

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) thotë se: "Atë ditë që u zhvillua lufta e Bedrit, Muhamed Mustafaja (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu lut Zotit aq shumë, saqë unë nuk kam parë më ndonjëherë njeri që t'i jetë lutur Zotit më gjatë. Ja se si i përgjërohej Zotit i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem):

- "*O Zot! Të lutem, që të na e bësh realitet fjalën e premtimin që na ke dhënë! O Zot! Po lejove të shkatërrohet kjo bashkësi, atëherë në Tokë nuk ngelet më askush që të të adhurojë!*"

Pastaj Resulullahu u ngrit dhe u drejtua nga ne. Një pjesë e fytyrës i ndriçonte sikur të ishte një copë prej hënës; na tha:

- "*Tani, në këto çaste, më bëhet sikur shoh të gjitha vendet ku do të rrëzohen me radhë të gjithë idhujtarët aty në të rënë të muzgut!*"[47]

14. TË LUFTUARIT NË RRUGËN E ALLAHUT ME SINQERITET TË PLOTË

Atyre që luftojnë për këtë botë dhe për t'u bërë të famshëm nuk do t'u jepet asnjë shpërblim

Ebu Umameja (radijallahu anhu) tregon: "Një burrë erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha:

- "O Resulallah, po për ata që luftojnë për të nxjerrë fitime të kësaj bote e për t'u bërë të famshëm, çfarë mendoni? A ka edhe për ta shpërblim?"

- "*Për ata nuk mbetet asgjë!*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut.

Ai burrë e përsëriti plot tri herë pyetjen e tij. E në të tria herët Profeti ynë iu përgjigj:

- "*Nuk ka asnjë shpërblim për ta.*" Në fund, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha kështu:

- "*Ç'është e vërteta, Allahu pranon vetëm ato punë e ato vepra që bëhen*

[46]. Bejheki, *Sunen,* 9/57 (17763).
[47]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 3/276.

vetëm për Allahun e për asgjë e askënd tjetër, dhe vetëm për të fituar pëlqimin e kënaqësinë e Tij!"[48]

Historia e Kuzmanit

Asim bin Omer bin Katade (radijallahu anhu) tregon: "Në mesin tonë ishte edhe një njeri me emrin Kuzman, të cilin ne nuk e njihnim; nuk e njihte askush se kush ishte. Kur u përmend emri i atij njeriu, Profeti i Lavdishëm tha:

- "*Nuk ka dyshim se ai është prej banorëve të Xhehenemit.*" Kur u zhvillua lufta e Uhudit ai njeri luftoi me mish e me shpirt, madje në një rast ai mundi i vetëm shtatë-a tetë vetë prej idhujtarëve. Trupin e kishte shumë të fuqishëm. Në fund, plagët që kishte marrë gjatë betejës ia bënë të pamundur lëvizjen, kështu që e morën dhe e çuan në vendqëndrimin e bijve të Dhaferit. Myslimanët i thanë atij:

- "Uallahi, o Kuzman, sot ke kaluar prova shumë të vështira, të përgëzojmë!"

- "Po pse po më përgëzoni? Unë luftova vetëm për namin dhe nderin e popullit tim, përndryshe unë nuk vija për të luftuar!" Kur plagët iu hapën edhe më shumë dhe dhimbjet iu bënë të padurueshme, Kuzmani vrau veten me një prej shigjetave të veta."[49]

Historia e el-Usajrimit

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) u tregoi atyre që ishin të pranishëm: "Më tregoni një njeri që ka shkuar në Xhenet pa falur namaz." - Populli nuk dinte se ç'emër të thoshte, kështu që e pyetën Ebu Hurejren:

- "Kush është ai, pa na e thuaj?"

- "Ai është një person që e thërrisnin Usajrim, ishte nga bijtë e Abdulesh'helit, emrin e kishte Amr bin Thabit bin Uaksh.", – u përgjigj Ebu Hurejreja.

Husajni, që është gjithashtu një prej atyre që e përcjellin hadithin,

[48]. Mundhiri, *et-Tergib,* 2/193 (2070).
[49]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/36.

thotë se: "Unë pyeta Mahmud bin Esedin:

- "Si qëndron puna e këtij Usajrimit? Çfarë ka bërë ai?" Ai më tregoi:

- "Usajrimi bëhej vazhdimisht pengesë që asnjë nga familja e tij të mos bëhej mysliman. Atë ditë që u zhvillua lufta e Uhudit, ai e kuptoi të vërtetën dhe u bë mysliman. Pastaj, mori shpatën dhe doli të luftonte kundër armikut. Hyri në fushën e betejës dhe luftoi. Mori aq shumë plagë, saqë nuk lëvizte dot nga vendi. Në atë kohë kishte edhe ca njerëz nga fisi i bijve të Abdulesh'helit, të cilët kërkonin për ata që kishin humbur jetën nga radhët e tyre. Kur, në një çast, ata e gjetën Usajrimin, dhe thanë:

- "Ja, ky është Usajrimi! Ç'kërkon ky këtu, kur u ndamë me të ai ishte kundër Islamit." Ne iu afruam pranë dhe e pyetëm:

- "Pse ke ardhur, o Amr? Ke ardhur se të erdhi keq për fisin tënd, apo do të bëhesh mysliman?"

- "Kam ardhur të bëhem mysliman. I besoj Allahut dhe Profetit të Tij. Mora edhe shpatën, për të luftuar bashkë me Resulullahun; luftova derisa më rrëzuan këto plagë që kam marrë.", – tha Amri. Nuk zgjati shumë dhe ai dha shpirt në duart e tyre. Kur ia treguan edhe të Dërguarit të Allahut gjithë sa kishin ndodhur me atë njeri, ai tha:

- "*Ai është prej banorëve të Xhenetit.*"[50]

Historia e një burri prej beduinëve

Shedad bin Hadi na përcjell: "Te Profeti i profetëve erdhi një beduin, i cili i shpalli atij se kish besuar dhe se donte t'i bashkohej atij, duke i thënë:

- "Dua të mërgoj këtu tek ti." Kështu, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i kërkoi njërit prej sahabëve të tij, që të kujdeseshin për të. Kur u zhvillua lufta e Hajberit dhe Resulullahu po bënte ndarjen e plaçkës së luftës, ndau edhe pjesën e tij dhe ia dha njërit prej sahabëve të tij për t'ia dorëzuar. Kur erdhi, ata i dhanë atij pjesën e vet.

- "Ç'është kjo?", – pyeti beduini.

- "Kjo është pjesa e plaçkës që morëm në luftë, e ndau i Dërguari i

[50]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/37.

Allahut për ty!", – iu përgjigj sahabi.

Aty, beduini u largua të shkonte pranë të Dërguarit të Allahut. Kur mbërriti, ai i tha atij (a.s.):

- "Unë nuk erdha tek ti për të fituar plaçkë e pasuri!", dhe duke bërë me shenjë te fyti i tha:

- "Unë vij pas teje që të ha një shigjetë mu këtu, të vritem e të shkoj në Xhenet."

- "*Nëse je i sinqertë me Allahun, nuk ka dyshim që Allahu nuk ka për të të nxjerrë gënjeshtar në ato që the, medoemos ka për të ta dhënë atë që kërkon ti.*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) atij beduini.

Shkuan prapë në luftë, për t'u përballur me armiqtë. Pas njëfarë kohe, aty prunë trupin e tij. Shigjeta e kishte goditur bash në vendin që ai i kishte treguar të Dërguarit të Allahut me dorë. I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Ky! Ky është ai?*"

- "Po, ai është!", – iu përgjigjën sahabët.

- "*Paska thënë të vërtetën. Allahu ia provoi duke i dhënë atë që kërkonte.*", – tha Resulullahu. Pastaj Resulullahu e mbështolli atë me xhyben e tij dhe i fali atij namazin e xhenazes. Kur ishte në namaz, u dëgjua që Resulullahu tha:

- "*O Zot! Ky është robi Yt, që u nis të mërgonte në rrugën Tënde. Ra dëshmor. Për këtë jam edhe unë dëshmitar!*"[51]

Historia e njeriut me ngjyrë

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Një njeri erdhi tek i Dërguari Fisnik dhe i tha:

- "O Resulullah! Unë jam një njeri me ngjyrë të zezë, fytyrën e kam të shëmtuar dhe nuk kam asnjë pasuri mbi tokë. A hyj në Xhenet, nëse vritem duke luftuar me idhujtarët?"

- "*Patjetër!*", – u përgjigj Profeti ynë.

Ai njeri gati sa nuk u hodh përpjetë nga gëzimi. Filloi lufta dhe ai luftoi me shpatë, derisa e qëlloi një prej armiqve dhe ai ra dëshmor.

[51]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/191.

Kur e sollën trupin e pajetë te Resulullahu, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Uallahi, Allahu ta paska zbukuruar fytyrën, paske marrë një aromë të mirë dhe pasurinë ta shtoi.*", dhe pasi tha këto, shtoi:

- "*E pashë hurinë e parë që u bë gruaja e tij, i kishte sytë shumë të bukur: duket sikur po bëjnë garë me njëra-tjetrin, kush e kush të hyjë më parë brenda xhybes së tij.*"[52]

Fjalët e Omerit (r.a) për dëshmorët

Ebul-Bakhteri et-Taij tregon: "Ushtarët që ishin pranë babait të El-Muhtar bin Ebu Ubejdit ranë dëshmorë në përplasjen që ndodhi në rrethinat e urës së Ebu Ubejdit në Kufe. Vetëm dy a tri syresh patën arritur të sulmonin në radhët e armiqve dhe u kthyen në Medinë. Ishin ulur dhe po u tregonin atyre që ishin të pranishëm se çfarë kishte ndodhur, kur aty erdhi Omeri (radijallahu anhu).

- "Çfarë po thoshit për ta?", – i pyeti ai.

- "Iu lutëm Allahut që t'i falë dhe t'i presë me mirësitë e Tij.", – u përgjigjën ata.

- "M'i thoni një e nga një të gjitha ato që thatë për ta, përndryshe askush nuk ju shpëton dot prej meje!", – tha Omeri (radijallahu anhu).

- "Thamë që ata ranë dëshmorë.", – u përgjigjën ata.

- "I betohem Atij që nuk ka zot tjetër veç Tij, që e dërgoi Muhamedin me më të drejtën e të vërtetën më të madhe, që vetëm me lejen e Tij do të ndodhë Kiameti; askush që është ende në jetë nuk mund ta dijë shkallën pranë Allahut të atyre që kanë vdekur. Këtë e dinte vetëm i Dërguari Fisnik, të cilit i ishin falur të gjitha gabimet e nuk kishte asnjë mëkat. I betohem Allahut, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, që e dërgoi Muhamedin me të drejtën dhe udhëzimin, se një njeri mund të luftojë edhe për t'u dukur, mund të luftojë nga inati e urrejtja që ndien karshi armikut, mund të luftojë për të fituar prej gjërave të kësaj bote, e mund të luftojë edhe për të fituar pasuri! (Ne nuk e dimë përse kanë luftuar ata, pasi nuk mund t'ua dimë qëllimin e vërtetë.) Shkalla dhe

[52]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/191.

grada e atyre që marrin pjesë në luftë varet nga qëllimi që ata mbajnë të fshehur në zemrat e tyre."[53]

15. PARALAJMËRIMI I PROFETIT TONË SE NUK KA XHIHAD "QË U PRET RRUGËN NJERËZVE DHE SULMON NJERËZIT E PAFAJSHËM NËPËR SHTËPITË E TYRE"

Sehl bin Muadh el-Xhuheniu, transmeton se nga babai i tij i është përcjellë kështu: "Unë kam luftuar pranë Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në aksh e aksh betejë. Disa nga ushtarët patën ndërmarrë sulme ndaj shtëpive, e disa të tjerë u patën prerë rrugën udhëtarëve. I Dërguari i Allahut, kur dëgjoi për këtë, dërgoi një tellall në mes të popullit, i cili u bëri thirrje të gjithëve me zë të lartë: "Ai që sulmon shtëpitë dhe u pret rrugën njerëzve të pafajshëm nuk mund të quhet se ka luftuar në rrugën e Allahut."[54]

16. NUK E LININ PAS DORE LUFTËN AS KUR U DUHEJ TË DURONIN SËMUNDJE NGA MË TË NDRYSHMET

Historia e Ubej bin Kabit (r.a.)

Sipas një transmetimi nga ana e Ebu Saidit Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë:

- "*Nuk ka asgjë që e shqetëson trupin e besimtarit, që Allahu të mos ia pranojë atij si shlyerje të mëkateve të tija.*" Ubej bin Kabi, kur dëgjoi për këtë që kishte thënë i Dërguari i Allahut, filloi t'i lutej Zotit:

- "O Zot! Të lutem që ta bësh trupin e Ubej bin Kabit të kapet nga sëmundja e veremit, me kushtin që ajo të mos e pengojë nga të falurit e namazit, nga agjërimi, nga haxhi, nga umreja dhe nga të luftuarit në rrugën Tënde dhe ajo t'i vazhdojë deri në ditën që do të rikthehet tek Ti.", dhe u largua prej andej e pas njëfarë kohe u kap prej sëmundjes së veremit. Ajo sëmundje i zgjati deri në ditën që vdiq. Megjithëse i sëmurë, ai vinte në faltore në çdo kohë të namazit, agjëronte, kryente haxhin, bënte umre dhe merrte pjesë në çdo luftë."[55]

---

[53]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/782 (11367).
[54]. Bejheki, *Sunen,* 9/152 (18239).
[55]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 3/1289 (8637).

17. PLAGËT E MARRA GJATË LUFTËS

Plagosja e Profetit tonë

Xhundub bin Sufjani (radijallahu anhu) tregon: "Teksa po ecnim në rrugë, Profetit tonë iu pengua këmba në një gur dhe iu plagos një nga gishtërinjtë e tij të bekuar, i cili filloi të rrjedhë gjak. Paskëtaj, i Dërguari i Allahut tha me vete:

- "*Po pse, ti nuk je veçse një gisht që rrjedh gjak? Kjo ngjarje që ti u përballe sot nuk të ndodhi në asnjë vend tjetër, porse në rrugën e Allahut!*"[56]

Trimëria e pashoqe e Enes bin Nadrit (r.a.)

Kasimi nga bijtë e Adijit tregon: "Në luftën e Uhudit, xhaxhai i Enes bin Malikut, Enes bin Nadri, shkoi pranë një vendi ku gjendeshin edhe Omeri me Talhanë (radijallahu anhuma), të cilët ishin ulur bashkë me një grup muhaxhirësh dhe ensarësh dhe po bisedonin dhe u tha:

- "Pse rrini ashtu, të habitur?"

- "Kanë vrarë të Dërguarin e Allahut.", – i thanë ata.

- "Po tani që ka vdekur ai, ju ç'kuptim ka që të jetoni?", – u tha atyre Enes bin Nadri, – "Vdisni edhe ju në atë rrugë ku vdiq edhe vetë i Dërguari i Allahut!" Dhe, sakaq, u vërsul në mes të armiqve dhe luftoi me mish e me shpirt, derisa dha edhe jetën.[57]

Enesi (radijallahu anhu) e tregon kështu: "Xhaxhai im, Enes bin Nadri, nuk pati marrë pjesë dot në luftën e Bedrit, sepse ishte shumë larg vendit ku u zhvillua beteja. Prandaj, ai i pati thënë të Dërguarit të Allahut: "O Resulallah, unë nuk pata marrë dot pjesë në luftën tuaj të parë kundër idhujtarëve, qëndrova larg Bedrit. Po, po më përballi ndonjëherë Allahu me idhujtarët, Allahu ka për t'jua treguar se ç'do të heqin ata nga duart e mia." Atë ditë që u zhvillua lufta e Uhudit, kur u zbërthyen myslimanët, xhaxhai im, Enesi (radijallahu anhu) tha:

- "O Zoti im, të kërkoj falje për këtë që po bëjnë myslimanët

[56]. Nesai, *Sunen,* 6/143
[57]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/34.

kështu, ashtu siç prej Teje kërkoj të më mbështetësh kundër atyre paudhësive që po bëjnë këta idhujtarë." Pastaj, u vërsul në drejtim të fushës së betejës, atje ku po përjetoheshin skenat më të ashpra të saj. Në atë kohë përpara i doli Sad bin Muadhi. Enes bin Nadri i tha atij:

- "O Sad bin Muadh, unë kam vetëm një dëshirë: të hyj në Xhenet. Unë i betohem Zotit të Enes bin Nadrit se, që nga atje tej, nga shtrati i Uhudit, ndiej aromat e mira të Xhenetit! "

Sad bin Muadhi tha:

- "As unë nuk i bëra dot ato që bëri ai njeri."

Enesi (radijallahu anhu) thotë se:

- "Kur e gjetëm xhaxhain, kraharorin e kishte të copëtuar nga të prerat e shpatave dhe në trup kishte diku te tetëdhjetë plagë shigjetash të ngulura. Idhujtarët e patën torturuar atë, duke e shpërfytyruar; i kishin prerë veshët, hundën dhe të gjitha organet e gjymtyrët e tjera, aq sa askush nuk e pati njohur dot më. Atë e njohu vetëm e motra, duke i dalluar majat e gishtave. Na e merr mendja, se për të dhe të gjithë njerëzit si ai duhet të jetë zbritur ajeti: "**Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.**" (Ahzab, 33/23)[58]

Plagët e marra prej Xhafer bin Ebi Talibit

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), në betejën e Mu'tes pati caktuar si komandant Zejd bin Harithin, duke thënë:

- "*Po vdiq Zejdi, komandant do të bëhet Xhaferi. Po e vranë edhe Xhaferin, atëherë komandën ta marrë përsipër Abdullah bin Reuaha.*"

Në mes të atyre që morën pjesë në atë betejë isha edhe unë. E kërkuam Xhafer bin Ebi Talibin gjithandej, por nuk e gjetëm dot askund, derisa e gjetëm në mesin e të rënëve. Në trup i dalluam gjithsej

[58]. Bejheki, *Sunen,* 9/43 (17696).

nëntëdhjetë plagë shigjetash dhe topuzësh. Sipas një transmetimi të caktuar: "Në shpinë nuk kishte marrë asnjë plagë.", - madje tregohet edhe shumë më tepër.[59]

Kur Ebu Sufjani humbet njërin sy në Taif

Said bin Ubejd ethThekafij (radijallahu anhu) tregon: "Ditën e Taifit, kam parë Ebu Sufjan bin Harbin (radijallahu anhu). Ishte ulur në kopshtin e hurmave të Ebu Ja'lasë dhe diç po hante. I hodha një shigjetë dhe ajo e kapi në sy. Ebu Sufjani erdhi tek i Dërguari i Allahut dhe i tha:

- "Shikoje, një shigjetë më goditi në sy dhe ma mori syrin në rrugën e Allahut." Profeti ynë i tha kështu:

- "*Po deshe, unë mund t'i lutem Allahut, që Ai të ta rikthejë syrin në gjendjen e mëparshme. Ose, po deshe, të ta shpërblejë me Xhenetin e amshuar.*" Ebu Sufjani i tha:

- "Po zgjedh Xhenetin më mirë."[60]

18. DËSHIRA PËR TË RËNË DËSHMOR NË RRUGËN E ALLAHUT

Profeti ynë donte shumë që të binte dëshmor në rrugën e Allahut

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) na transmeton se ai e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë:

- "*I betohem Allahut, se po të mos ishte për disa besimtarë të varfër, të cilët nuk e durojnë dot që nuk marrin dot pjesë në luftë bashkë me mua, sepse nuk kishin asnjë mundësi për të gjetur ndonjë kafshë, me të cilën të nisen e të vijnë në fushëbetejë, unë nuk do të ngurroja as edhe për një çast për të qenë i pranishëm në çdo ushtri që niset për të luftuar në rrugën e Allahut. Unë i betohem Allahut, se gjëja që dua më shumë është të vritem në rrugën e Allahut dhe të ringjallem prapë, pastaj të më vrasin sërish, e unë po prapë të ringjallem, pastaj të më vrasin sërish, e unë po prapë të ringjallem, pastaj, në fund të më vrasin sërish.*"[61]

---

[59]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 2/245.
[60]. Ibnu'l-Ethir, *Usdu'l-Gabe,* 1/538.
[61]. Buhari, *Sahih,* 1/22 (36).

Nga Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) përcillet se: "I Dërguari i Allahut tha kështu:

- "*Allahu i Madhërishëm ka thënë për çdokënd që del nga shtëpia për hir të kënaqësisë së Allahut: 'Nëse robi im del nga shtëpia vetëm me qëllimin për të luftuar në rrugën Time, për të më besuar mua, për të provuar profetësinë dhe fjalën e drejtë të profetëve të mi, e për kurrfarë arsyeje tjetër, ju jap fjalën se unë jo vetëm që do ta vendos atë në Xhenetin e amshuar, por edhe do ta rikthej sërish në shtëpinë e tij, madje duke i siguruar edhe plaçkë lufte me vete.'*"

"*I betohem Allahut se kushdo që plagoset në atë rrugë, në ditën e Kiametit, përpara Allahut do të futet po me atë plagë, madje edhe gjaku do t'i rrjedhë, por përreth tij ai do të lëshojë aromat më të mira të Xhenetit. Po ashtu unë i betohem Allahut, se; po të mos shqetësohesha se do të ishte paksa e vështirë për myslimanët, unë do të dilja të luftoja në çdo betejë a luftë që zhvillohet në rrugën e Allahut, kurrsesi nuk do të ngurroja. Por, ç'të bëj, nuk kam mundësi t'u gjej të gjithëve kafshë për rrugën, e as ata vetë nuk kanë asnjë mundësi që t'i gjejnë. I betohem Allahut, se unë nuk dua me gjithë shpirt asgjë tjetër, veçse që të luftoj në rrugën e Allahut, të vritem, pastaj të ringjallem sërish e po sërish të vritem, pastaj të ringjallem sërish e po sërish të luftoj, derisa të bie dëshmor në rrugën e Tij!*"[62]

Dëshira e flaktë e Omerit (r.a.) për të rënë dëshmor

Kajs bin Ebi Hazim na përcjell: "Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) mban një fjalim përpara xhematit, ku ndër të tjera u tha atyre:

- "Në parajsën e Adnit gjendet një vilë me pesëqind porta. Në secilën nga ato porta qëndrojnë plot pesëmijë huri të ndryshme. Aty mund të hyjë vetëm një profet." Mandej, Omeri (radijallahu anhu) u kthye me trup nga varri i të Dërguarit të Allahut dhe tha:

- "O i zoti i atij varri, i shenjtë e i bekuar të qoftë ai vend!" Mandej, duke thënë: "... pastaj hyn edhe Besniku", ai u drejtua dhe pa në drejtim të varrit të Ebu Bekrit dhe tha: - "O Ebu Bekr, e gëzofsh edhe ti atë vend e i shenjtë të qoftë!" Dhe, në fund, tha: - "... hyjnë edhe dëshmorët.", – e kësaj here ai iu drejtua vetvetes:

- "Ku ti, e ku të rënët dëshmor, o Omer?" Pasi mbaroi së u ankuari për veten, ai tha:

[62]. Muslim, *Sahih,* 3/1495 (1876).

- "Ai Allah, që mua më dha mundësinë të mërgoja nga Meka në Medinë, i ka të gjitha fuqitë që të më bëjë edhe ndër dëshmorët e rënë në rrugën e Tij!"

Ibni Mesudi (radijallahu anhu) thotë se: "Me të vërtetë, Allahu i Madhërishëm i fali Omerit gradën e lartë të dëshmorit, duke bërë që ai të binte si i tillë nga dora e skllavit të Mugires, nga dora e krijesës më të keqe."[63]

Ja se si lutej Omeri (radijallahu anhu): "O Zot! Falmë mua mirësinë të bie dëshmor në rrugën Tënde. Falma edhe mua mundësinë të vdes edhe unë në qytetin e Profetit tonë!"

Hafsa (radijallahu anha) thotë se: "Kur e kam dëgjuar babanë tim, Omerin, teksa i lutej Allahut "që t'ia mundësonte edhe atij vdekjen në rrugën e Allahut dhe që t'i falte atij mundësinë, që edhe ai të jepte shpirt në qytetin e profetit," unë e pyeta atë:

- "Po si do të ndodhë kjo?" Ai më dha këtë përgjigje:

- "Kjo ka për të ndodhur kur t'i vijë koha, pra, atëherë kur të dojë Ai."[64]

Abdullah bin Xhahshi kërkon të bjerë dëshmor

Sipas një transmetimi, i cili na vjen prej Sad bin Ebi Uekasit, Abdullah bin Xhahshi i ka thënë atij:

- "A nuk do që t'i lutemi bashkë Allahut?" Të dy u tërhoqën mënjanë, në një vend ku do të ishin vetëm. Në fillim filloi të lutej Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu):

- "O Zoti im! Kur të luftojmë, përballmë mua me një luftëtar të atillë, që unë të përleshem njëherë mirë e mirë me të. Pastaj nxirrmë mua fitimtar, jepmë mua mundësinë që ta vras atë dhe t'ia marr të gjitha si plaçkë lufte." Dhe Abdullah bin Xhahshi i tha 'Amin' lutjes së tij. Pas tij filloi të lutej edhe Abdullah bin Xhahshi:

- "O Zot! Nxirrmë mua përballë një njeri të atillë, që të jetë një luftëtar shumë i fuqishëm, të përleshem me të për emrin Tënd, e pastaj ai të më kapë, të m'i presë mua hundë e veshë, që, kur të dal para Teje

[63]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Eusat,* 9/163 (9430).
[64]. Ibn Haxher, *Fet'hu'l-Bari,* 4/101 (1791).

dhe Ti të më pyesësh: 'Kush t'i ka prerë hundën e veshët?', - unë të të përgjigjem: - 'O Zoti im, ato m'i prenë duke luftuar në rrugën Tënde dhe të të Dërguarit Tënd.' - Aty Ti të më thuash: 'Të vërtetën the!' - dhe, sakaq e mbyll lutjen e tij.

Sad bin Ebi Uekasi, i cili e transmeton këtë ndodhi, i thotë kështu atij që ia përcjell atë:

- "Shiko, o bir, sesa më e bukur ishte lutja e Abdullah bin Xhahshit se lutja ime. Kur e pashë në darkë, atij i ishte pranuar fjalë për fjalë ajo lutje."[65]

Dëshira e Bera bin Malikut (r.a.) që të binte dëshmor

Enesi (radijallahu anhu) transmeton: "I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë se:

- "*Ka sa e sa njerëz, të cilët mbi trup mbajnë rroba të vjetra e që populli nuk u jep shumë vlerë, që po të luten në emër të Allahut, për të kërkuar ndonjë gjë, Allahu ua plotëson atyre menjëherë dëshirat e nuk i nxjerr kurrë gënjeshtarë në betim. Ja, një prej tyre është edhe Bera bin Maliku.*"

Në luftën e Tusterit, që përfundoi me disfatën e myslimanëve, ngaqë e dinin këtë hadith të Profetit, myslimanët i thanë Berasë:

- "O Bera, sikur t'i betohesh Allahut dhe t'i lutesh për ne!" Dhe Beraja ashtu bëri, filloi të lutej me fjalët:

- "O Zot, në dorën Tënde unë kam rënë. Të përgjërohem, na nxirr ne fitimtarë kundër armikut! E jepmë mua mundësinë që të takohem me Profetin Tënd." Dhe, nuk kaloi shumë kohë, e ai ra dëshmor."[66]

Dëshira e Numan bin Mukarrinit (r.a.) për të rënë dëshmor

Makil bin Jesari tregon: "Omeri (radijallahu anhu), kur vendosi të dërgonte ushtritë e tij kundër Iranit, u këshillua me Hurmuzanin, duke e pyetur:

- "Po ti, ç'mendim ke? Me Iranin t'ia filloj, apo me Azerbajxhanin ose Isfahanin?"

---

[65]. Bejheki, *Sunen,* 6/307 (12549).
[66]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/350.

Hurmuzani iu përgjigj:

- "Irani me Azerbajxhanin nuk janë veçse krahët, koka është Isfahani. Edhe sikur të presësh vetëm njërin nga krahët, prapë mbetet tjetri. Por, po u preve kokën, atëherë edhe krahët do të rrëzohen vetvetiu. Nëse më pyet mua, filloja me kokën." Mandej, Omeri (radijallahu anhu)hyri në Xhaminë e Profetit. Në atë kohë, aty ishte edhe Numan bin Mukarrini, i cili ishte duke falur namaz. U ul pranë tij dhe kur Numani përfundoi së faluri namazin, ai i tha atij:

- "Dua të të bëj udhëheqës."

- "Shiko, nëse ke ndërmend të më dërgosh për të mbledhur taksa gjëkundi, nuk e bëj! Nuk mund ta pranoj. Po nëse ke ndërmend të më dërgosh në luftë, që të luftoj në rrugën e Allahut, atëherë po, atë e pranoj.", – i tha atij Numani.

- "Do të shkosh të luftosh.", – u përgjigj Omeri (radijallahu anhu) dhe sakaq e dërgoi atë në Isfahan. (...) Mugire bin Shu'beja (radijallahu anhu) i tha Numanit (radijallahu anhu):

- "Allahu të mëshiroftë. Shiko, armiku u tregua më i shkathët, po na gjuajnë me shigjeta, andaj, bëhu gati t'i sulmosh edhe ti rëndë." Numani iu përgjigj:

- "Uallahi, ti je një njeri shumë i zgjuar dhe largpamës. Unë kam marrë pjesë në luftë edhe krah për krah me Profetin tonë. Sa herë që ai nuk luftonte në orët e para të ditës, e shtynte luftën deri në orën kur bëhej gati të binte muzgu, e bashkë me të nisnin edhe erërat dhe nga qielli fillonte të zbriste ndihmesa hyjnore. Shiko, unë do ta tund tri herë flamurin tim. Kur ta tund për herë të parë, të gjithë të kryejnë nevojat e tyre dhe të marrin abdes. Kur ta tund për herë të dytë, të gjithë të kontrollojnë mirë armët dhe këpucët, duke parë secili mos i ka ngelur ndonjë gjë mangët. Dhe, kur ta tund për herë të tretë, mos prisni më për asnjë çast, por vërsuluni armikut, pa parë nga njëri-tjetri! Askush të mos i qëndrojë te kryet e Numanit, edhe nëse qëllon që ta vrasin. Tani unë do t'i lutem Allahut. Ju urdhëroj, që teksa i thoni 'Amin' lutjes sime, t'i luteni edhe ju Allahut duke thënë: "O Zot! Fali Numanit mirësinë që ai të bjerë dëshmor, në mënyrë që myslimanët të dalin sot fitimtarë; falu myslimanëve ngadhënjimin!"

Ai e tundi flamurin herën e parë. Pastaj e tundi edhe herën e dytë.

Por, kur e tundi herën e tretë, porsi rrufe të njëpasnjëshme myslimanët iu vërsulën armikut. I pari që u rrëzua ishte Numani. Unë shkova menjëherë pranë tij. Pastaj në mendje më erdhi fjala e tij, "askush të mos qëndrojë te kryet e Numanit nëse vritet", ndaj lashë aty një shenjë dhe u largova. Sa herë që ne vrisnim ndonjë prej armiqve, shokët e tij na harronin ne dhe merreshin me të rënin e tyre. Më vonë nga mushka ra edhe komandanti i ushtrisë perse, Dhu'l-Haxhibejni, të cilit iu ça i gjithë barku, duke iu bërë trupi copë-copë. Allahu i Madhërishëm i nxori ata humbës. Pastaj unë shkova pranë Numanit. Me vete kisha edhe dy rroba me ujë. Ia hodha në fytyrë dhe ia pastrova atë.

- "Kush je ti?", – më pyeti.

- "Makil bin Jesari.", - iu përgjigja unë.

- "Ç'bënë luftëtarët?", – më pyeti.

- "Allahu i nxori ata fitimtarë!", – i thashë unë.

- "Allahu qoftë pafundësisht i lëvduar. Shkruajini dhe njoftojeni menjëherë Omerin.", – tha ai dhe, fare pa lëvizur nga vendi, dha shpirt sa hap e mbyll sytë."[67]

19. KUR SAHABËT NGARENDNIN PËR TË LUFTUAR NË RRUGËN E ALLAHUT

Kur Hajthemeja (r.a.) hedh short me të birin, Sadin, se kush prej të dyve do të marrë pjesë në luftën e Bedrit

Sulejman bin Bilali (radijallahu anhu) tregon: "Në kohën që i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) mori vendimin për të dalë në luftën e Bedrit, në luftë donin të shkonin edhe Sadi me babanë e tij, Hajthemen. Shkuan t'i thoshin të Dërguarit të Allahut, e Profeti ynë u tha atyre se vetëm njëri nga të dy mund të merrte pjesë. Për këtë, ata vendosën të hidhnin short me njëri-tjetrin. Para se të hidhej shorti, Hajthemeja i tha të birit:

- "Njëri nga ne të dy do të qëndrojë këtu; pse nuk rri ti me gratë!" Sadi iu përgjigj të atit:

- "Po të mos bëhej fjalë për Xhenetin, por për gjithçka tjetër, unë

[67]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/332 (5279).

do të të zgjidhja ty e jo atë. Por kësaj here unë kam shumë shpresë se do të bie dëshmor.", dhe, sakaq hodhën short se kujt do t'i binte. Shorti i ra Sadit. Me Profetin tonë në Bedër shkoi Sadi. Ai u vra nga Amr bin Abdi Udi, e kështu ai ra dëshmor siç edhe e pati parandjerë qysh në krye."[68]

Historia se si ra dëshmor Ubejde bin Harithi (r.a.)

Transmeton Muhamed bin Husejni, nipi i Aliut (radijallahu anhu): "Në luftën e Bedrit, kur Utbeja i ftoi myslimanët në duel, përballë Uelid bin Utbes pati dalë Aliu (radijallahu anhu). Ishin të dy të rinj dhe ishin për të luftuar me njëri-tjetrin në duel. Aliu me një të goditur të vetme e përplasi përdhe dhe e vrau. Pastaj doli Ibni Rabia. Për t'u përballur me të, nga myslimanët doli Hamzai (radijallahu anhu), shtatdrejtë e i palëkundur, e edhe ata ishin bashkëmoshatarë. Hamzait nuk iu desh vetëm se një lëvizje e vetme e shpejtë dhe Shejbeja ra në tokë, kështu që Hamzai (radijallahu anhu) nuk u lodh shumë për ta vrarë. Pastaj doli Utbe bin Razia. Përpara tij doli Ubejde bin Harithi. Të dy ishin shtathedhur, me shpatullat të mbushura. Ata u goditën disa herë me njëri-tjetrin. Një të goditur i bën shpatës Ubejdeja dhe në supin e Utbes hapet një e çarë e madhe. Utbeja u afrua dhe siç e kishte në dorë shpatën, e goditi Ubejden në këmbë, duke i prerë një pjesë të pulpës. Hamzai dhe Aliu (radijallahu anhuma), të cilët po qëndronin pak më pas, ndërhynë dhe i dhanë fund jetës së Utbes. E morën peshë Ubejden e plagosur dhe e çuan pranë të Dërguarit të Allahut, i cili po qëndronte i ulur në një nga çardakët e ngritur për myslimanët. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e shtriu Ubejden, e vuri këmbën si jastëk nën kryet e Ubejdes dhe filloi t'i pastronte dheun që i ishte ngjitur pas fytyrës. Ubejdeja (radijallahu anhu) i tha të Dërguarit të Allahut:

- "Po të më shihte Ebu Talibi në këtë gjendje, do ta kuptonte se këto fjalë i meritojmë më shumë ne, sesa ai: "Ne nuk ia dorëzojmë kurrsesi Muhamedin armiqve, pa luftuar njëherë krah për krah me të, me mish e me shpirt, qoftë edhe sikur të na duhet t'i harrojmë me gra

[68]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 1/176.

e me fëmijë!" Mandej Ubejdeja i tha atij:

- "O Resulallah, a nuk jam dëshmor unë?"

- "*Po, unë jam dëshmitar se ti je dëshmor.*", – iu përgjigj i Dërguari Fisnik. Pastaj Ubejdeja dha shpirt. I Dërguari i Allahut atë e varrosi në një vend në luginën e Safras, e cila gjendet diku mes Medinës dhe Bedrit. Madje, në varrin e hapur për të zbriti edhe vetë. Përveçse për Ubejden, Profeti ynë nuk ka zbritur kurrë në varrin e askujt."[69]

Dëshira e zjarrtë e Aliut (r.a.) për të dhënë jetën në rrugën e Allahut

Aliu (radijallahu anhu) ka thënë: "Në ditën e Uhudit, kur myslimanët u shpërndanë prej Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), unë kërkova për të në mesin e të vrarëve. Kur nuk e gjeta, bëja çudi, ndaj fillova të thosha me vete: 'I betohem Allahut, se ai nuk e braktis fushën e betejës! As në mes të të rënëve nuk e gjeta dot. Mos ndoshta Allahut nuk i pëlqeu asfare gabimi që ne bëmë dhe e mori në qiej profetin e Tij. Tanimë, për mua nuk ka gjë më të mirë, sesa të luftoj në rrugën e Allahut, derisa të vijë dikush e të ma marrë edhe jetën!' Me shpatën të zhveshur një të vërsulur bëra dhe u përfshiva në radhët e armikut, duke i sulmuar ata në grup. Kur u tërhoqën, në një moment, dhe unë arrita të shoh më tutje, i Dërguari i Allahut kishte mbetur i vetëm, duke luftuar në mesin e idhujtarëve!"[70]

Historia e Sad bin Rabias

Zejd bin Thabiti (radijallahu anhu) tregon: "Gjatë luftës së Uhudit, i Dërguari Fisnik më pati dërguar mua të kërkoja për Sad bin Rabian, duke më thënë:

- "*Po e pe, përshëndete nga ana ime dhe thuaji: 'I Dërguari i Allahut më urdhëroi të të pyes, si ndihesh?*'" Kështu, unë fillova ta kërkoj në mesin e të vdekurve. Më në fund, e gjeta, por ai ishte duke përjetuar çastet e fundit të jetës. Kishte marrë plagë heshte, plagë shigjetash dhe plagë topuzi, që mund të bëheshin diku te shtatëdhjetë plagë gjithsej.

---

[69]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/705 (30008).
[70]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/712 (30027).

- "O Sad! Të kam prurë përshëndetjet e të Dërguarit të Allahut. 'Si ndihesh?' - më urdhëroi i Dërguari i Allahut të të pyes.

- "Përshëndetje edhe nga unë, edhe ty, edhe të Dërguarit të Allahut! Thuaji të Dërguarit të Allahut nga ana ime: 'Unë po vdes, e më duket sikur kam filluar që ta ndiej që tani aromën e mrekullueshme të Xhenetit.' Ndërsa popullit tim ensarëve thuaju këto fjalë: 'Për sa kohë që në popullin tuaj do të mbetet qoftë edhe një njeri i vetëm që i hap dhe i mbyll qepallat e syve, e të Dërguarit të Allahut i ndodh ndonjë gjë e keqe, ta dini se për këtë nuk e jepni dot llogarinë përpara Allahut!" Kaq tha dhe ia dorëzoi Allahut shpirtin."[71]

Ndodhia e Rexhij'ut

Asim bin Omer bin Katade (radijallahu anhu) tregon: "Pas luftës së Uhudit, tek i Dërguari i Allahut erdhi një bashkësi nga fiset e Adalit dhe Karas, të cilët i thanë Atij:

- "O Resulallah, ne kemi myslimanë mes nesh, sikur të na japësh një grup prej sahabëve të tu me vete, që të na mësojnë fenë; të na shpjegojnë Kur'anin dhe ligjësitë e Islamit."

I Dërguari i Allahut ua plotësoi kërkesën dhe me vete u dha një grup të përbërë prej gjashtë sahabësh. Kur mbërritën në Rexhij', që është edhe burimi i ujit të fisit të Hudhejlit, në hyrje të Hed'esë, e cila gjendet mes Usfanit dhe Mekës, ata i tradhtuan myslimanët. Thirrën edhe fisin e Hudhejlit, që t'u vinin në ndihmë. Myslimanët u rrethuan befasishëm. Nxorën menjëherë shpatat. Pjesëtarët e fisit të Hudhejlit thanë:

- "Uallahi, qëllimi ynë nuk është t'ju vrasim. Ne do t'ju dorëzojmë te mekasit, që ata të na japin ndonjë shpërblim të majmë. Ne ju japim fjalë në emër të Zotit, nuk do t'ju vrasim!" Merthedi, Halid bin Bukejri dhe Asim bin Thabiti (radijallahu anhum) u thanë atyre:

- "Uallahi, ne i betohemi Allahut se nuk do ta pranojmë kurrë fjalën dhe betimin e një idhujtari!"

Më vonë, nga goja e Asim bin Thabitit nisën të vargëzoheshin këto fjalë:

[71]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/221 (4906).

"Kurrfarë arsyeje nuk kam, ju t'ju dorëzohem!/ Se unë, i fuqishëm jam, e harkun shumë mirë e përdor. / E harkun të fortë e të mirëlidhur bukur e kam,/ Shigjetat të gjata e prej druri t'rrëshkitshëm n'hulli t'harkut i kam./ Vdekja është e vërteta e e gënjeshtërt është jeta!/ Ajo që caktoi Allahu do t'i ndodhë njeriut në fund./ Se pas kaderit të vet rend çdo njeri./ Shkatërruar qofsha, zaten, me ju po s'luftova!/ Me hekur i bën Asimi shigjetat e veta, se shigjetar më t'mirë se unë nuk ka./ E harkun si Xhehenem të përndezur e kam./ Se trimat deveve të tyre rendin/ apo veshin mburoja të bëra prej lëkurës së kaut/ jo mua kjo nuk më tremb aspak./ Se unë Kur'anit që iu zbrit Muhamedit shyqyr o Zot i kam besuar./ Unë dhe ata si unë hedhim shigjetat,/ se popull i nderuar është i tërë fisi ynë."

Asimi (radijallahu anhu), pasi tha këto fjalë, u hodh në mesin e armiqve dhe nisi të përleshej me ta. Në fund, si ai, ashtu edhe dy shokët e tij ranë dëshmorë. Kur u vra Asimi, fisi i Hudhejlit deshi të merrte kokën e tij, për t'ia shitur një gruaje të quajtur Sulafe binti Sadit. Kur Asimi pati vrarë djalin e kësaj gruaje, në luftën e Uhudit, ajo ishte betuar:

- "Po arrita t'ia marr kokën atij që më vrau djalin, unë do t'ia mbush kafkën me verë dhe do të pi prej saj." Mirëpo hudhejlitë nuk iu afruan dot trupit, sepse sikur t'i ketë dërguar Allahu për të mbrojtur trupin e tij, aty gumëzhinë një numër i jashtëzakonshëm bletësh mjalti. Hudhejlitë thanë:

- "Të presim darkën. Kur të bjerë errësira, shkojmë ia ndajmë kokën nga trupi." - kështu e lanë me njëri-tjetrin. Mirëpo, pas pak, Allahu dërgoi një përmbytje të jashtëzakonshme dhe ujërat e rrëmbyer e morën tutje trupin e Asimit, sepse Asimi i ishte betuar Allahut se nuk do të prekte kurrë një idhujtar, pasi ata ishin të pistë e nuk mund të preknin në trupin e tij.

Kur dëgjoi se si trupin e Asimit e kishin ruajtur bletët, Omeri (radijallahu anhu) tha këto fjalë:

- "Allahu i mbron robërit e Tij që besojnë tek Ai. Asimi, sa ishte në jetë, ishte betuar se dora e tij nuk do të prekte kurrë mbi një idhujtar, madje as ata nuk do t'i lejonte që ta preknin. Kështu, Allahu

i Madhërishëm jo vetëm në shëndet që e ruajti atë të mos i prishej betimi, por nuk lejoi që ai betim t'i prishej qoftë edhe në vdekje."[72]

Historia e Zejd bin Desines

Shokët e Asim bin Thabitit, Khubejbi, Zejd ibni'd-Desineja dhe Abdullah bin Tariku u bënë më të butë, zgjodhën të jetonin, ndaj edhe u dorëzuan vetë, duke rënë robër. Hudhejlitë i morën ata dhe i përgatitën për t'i çuar në Mekë, që t'i shisnin. Kur iu afruan luginës së Dhahranit, e cila është shumë afër me Mekën, Abdullah bin Tariku arriti t'i zgjidhë duart dhe mori shpatën. Hudhejlitë u larguan sa për të hapur rrezen dhe filluan ta godasin me gurë, derisa e vranë. Edhe sot e kësaj dite varri i Abdullahut është në Dhahran.

Ndërsa Hubejbin dhe Zejdin ata i çuan në Mekë dhe i ndërruan me dy skllevër të Hudhejlive. Hubejbin e mori Huxhejr bin Ebi Ihab et-Temimiu. Kurse Zejdin e bleu Safuan bin Umejeja, për të marrë hakun e të atit të vrarë. Safuani ia dorëzoi Zejdin një skllavit të vet të liruar, Nistasit. Ky e mori Zejdin dhe, për ta vrarë, vendosi që ta nxirrte nga Meka, andaj edhe e shpuri në vendin e quajtur Ten'im. Ebu Sufjani dhe një grup njerëzish u mblodhën aty enkas, për të parë vrasjen e Zejdit. Kur e afruan për ta vrarë, Ebu Sufjani tha:

- "Shiko, o Zejd, të betohem për Allahun! A do të doje që tani, përpara nesh, të mos ishe ti, po të ishte Muhamedi dhe ne mos të të vrisnim ty, por atë, ndërsa ti të ishe pranë familjes tënde, a do të doje?" Zejdi (radijallahu anhu) tha:

- "Uallahi, lëreni qëndrimin tim pranë familjes, por sikur një gjemb i vetëm t'i hyjë në këmbë Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) unë nuk do ta doja veten!"

Ebu Sufjani e dëgjoi atë me vëmendje dhe tha:

- "Kurrë nuk kam parë ndonjëherë njeri që të dojë dikë kështu siç e duan shokët e tij Muhamedin!", - Pastaj, Nistasi e vrau Zejdin.

[72]. Buhari, *Sahih,* 3/1108 (2880).

Burgosja e Khubejbit në Mekë

Siç e tregon Abdullah bin Ebi Nexhihu, robinja e liruar e Huxhejr bin Ebi Ihabit, Mauije (kjo grua më vonë ka pranuar Islamin dhe është bërë myslimane) ka transmetuar se: "Khubejbin e izoluan në shtëpinë time. Uallahi, një ditë, Khubejbin e pashë duke ngrënë një vesh shumë të madh rrushi, sa një kokë njeriu. Nuk mbaj mend që të jetë ngrënë ndonjëherë, në atë stinë, në ndonjë vend të botës."

Ibni Is'haku vazhdon: "Më vonë Hubejbin e sjellin në Ten'im, për ta varur. Khubejbi u tha idhujtarëve:

- "Më lejoni të fal dy rekate namaz."

- "Po, mirë, falu.", - ia pritën ata. Kësisoj, Khubejbi i fali ashtu siç duhej ato dy rekate namaz, duke i ndjekur me përpikëri të gjitha imtësitë dhe të gjitha kushtet e namazit. Pastaj, u kthye nga ata që ishin të pranishëm dhe u tha:

- "Uallahi, po të mos më zinte frika e të pandehja se po e zgjatja atë namaz për të vonuar vrasjen, do të isha falur më gjatë!"

I pari që e nisi traditën e të falurit të dy rekateve namaz para varjes ka qenë pikërisht Khubejbi. Pastaj ata e mbështetën atë mbi një copë dërrase dhe e lidhën fort. Në atë çast Khubejbi filloi t'i lutej Allahut:

- "O Allah! Ne u përpoqëm ta përhapim mesazhin që Ti i ngarkove të Dërguarit Tënd! Bëja ti të ditur të Dashurit Tënd Fisnik këtë që po na bëjnë mohuesit! Numëroji, një e nga një, të gjithë këta idhujtarë, o Allah dhe vriti ata, një e nga një, e mos lër asnjërin prej tyre të gjallë!" Menjëherë pas këtyre fjalëve ata e vranë Khubejbin dhe ai shkoi pranë Allahut si një prej dëshmorëve në rrugën e Tij.

Muauije bin Ebi Sufjani thotë se:

- "Atë ditë atje isha edhe unë. Babai im u tremb nga lutja e Khubejbit, kështu që më mori dhe më shtriu përdhe, sepse, në kohën e injorancës njerëzit "besonin se po ta shtrije në brinjë personin që ishte mallkuar, mallkimi i bërë ndaj tij nuk do ta prekte."

Ndërsa, në transmetimin e Musa bin Ukbes ne do të rastisim edhe në një përcjellje të tillë: "Hubejbi dhe Zejd ibni'd-Desineja janë vrarë në të njëjtën ditë. Atë ditë që u vranë ata, ne dëgjuam të Dërguarin e

Allahut të thoshte:

- "*Paqja e Allahut qoftë mbi ty* (a mbi ju)*! Kurejshët vranë Khubejbin!*"

Kur do ta varnin Zejdin, në fillim menduan ta godisnin njëherë me shigjeta, me shpresën se ai mund të trembej dhe kthehej nga feja islame. Mirëpo, kjo sjellje nga ana e tyre jo vetëm që nuk e ktheu atë, por ia bëri besimin edhe më të fortë.

Urueja dhe Musa bin Ukbeja tregojnë: "Kur kurejshët e ngjitën mbi dërrasë Khubejbin, i thanë:

- "Na thuaj për hir të Allahut, a do të doje që tani, në vendin tënd, këtu të ishte Muhamedi?"

Khubejbi u përgjigj:

- "Kurrën e kurrës, zemra ime kurrsesi nuk do të kënaqej edhe sikur të më thoshit se do të më zbrisnit prej këtu në këmbim të një gjembi të hyrë në atë këmbën e tij të bekuar!" Atëherë, kur dëgjuan këtë përgjigje, idhujtarët nisën të gajaseshin duke qeshur me sa kishin në kokë.[73]

Urue bin Zubejri transmeton: Khubejbin e vranë djemtë e atyre që ai kishte vrarë në luftën e Bedrit. Kur e ngjitën mbi dërrasën e varjes në litar, Khubejbi nisi të recitojë këto vargje:

"Uallahi, m'u mblodhën të gjithë armiqtë mbi krye. I kanë prurë këtu të gjithë, me fise, me fëmijë e me gra. Më lidhën pas këtij trungu të trashë e të fortë. Unë vetëm Allahut mund t'i ankohem për këtë gjendje në të cilën ndodhem, për këtë fatkeqësi që më ka ardhur mbi krye, e për gjithë këto përgatitje që këta njerëz janë duke bërë veçanërisht për vdekjen time!

O Ti që je Zotëruesi i Fronit Hyjnor! Më jep durim ndaj gjërave që duan të më bëjnë këta njerëz. Mishin ma prenë në copa, duke ma vjedhur çdo shpresë që kisha. Veç këtyre të gjithave, unë po bëj durim në rrugën Tënde, që të të marr pëlqimin. Po deshi Ai, edhe këto copa të trupit tim do të m'i bëjë të bekuara. Ju betohem, nuk jam aspak i mërzitur pse po vdes si mysliman. Sido që të vdes, unë e di që do të vdes për hir të Allahut. Ata më detyruan mua të zgjedh mes mohimit

[73]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/63.

dhe vdekjes. Nuk u mërzita, por nga sytë seç më rrodhën disa pika lot. Por nuk jam aspak i shqetësuar se do të vdes! Se unë do të vdes që do të vdes një ditë. Shqetësimi i vërtetë që kam unë është zjarri i Xhehenemit, që më bëhet sikur ia shoh ato shkëndijat përvëluese që dalin vlim. Nuk ia ul kryet armikut, e as nuk kam për t'iu përgjëruar, se unë e di se kthimin po tek Allahu e kam!"[74]

LUFTA E MU'TES

Lutja e Abdullah bin Reuahas (r.a.)

Uruete bin Zubejri tregon: "I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), në muajin Xhumada'l-Ula të vitit të tetë të mërgimit, dërgoi në Mu'te një ushtri të përbërë prej tremijë luftëtarësh. Në krye u caktoi si komandant Zejd bin Harithen dhe i urdhëroi ata:

- "*Nëse bie dëshmor Zejdi, në krye të vihet Xhafer bin Ebi Talibi, e nëse bie dëshmor edhe ai, atëherë në krye të vihet Abdullah bin Reuaha.*" Kur ushtria u pajis me armë e me ushqime dhe u bë gati për t'u nisur, njerëzit përcollën komandantët e të Dërguarit të Allahut dhe, ndërsa po largoheshin, ata panë se Abdullah bin Reuaha po qante. E pyetën:

- "Pse po qan?" E ai u përgjigj:

- "Unë i betohem Allahut, se arsyeja përse po qaj nuk është ngase e dua shumë jetën, apo ngase po ndahem nga ju. Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut që ka kënduar një ajet të tillë nga Kur'ani: "**Asnjë prej jush nuk mund t'i shpëtojë Xhehenemit. Ky është një vendim i prerë lart, tek Allahu.**" (Merjem, 19/71) Ja, unë nuk e di se si do të dal prej Xhehenemit, kur të kem hyrë atje! Prandaj po qaj!", – tha ai.

Myslimanët u thanë atyre, duke iu lutur Allahut për ta:

- "Allahu qoftë i dashuri dhe ndihmuesi juaj, ne e lusim Atë t'i mbajë larg jush të këqijat, e ju, me lejen e Tij, të ktheheni shëndoshë e mirë!" Në atë kohë, nga goja e Abdullah bin Reuahas dolën këto fjalë:

- "Po unë dua që Allahu, Mëshirëploti, të më falë. Unë dua që gjaku të më derdhet me vrull nga ndonjë e çarë shpate ose syngjia e ndonjërit që është i etur për gjak të m'i çajë zorrët e të ma nxjerrë

[74]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/67.

mushkërinë vendit. Të paktën, kur të kalojnë njerëzit ndanë varrit tim, të mund të thonë: 'O Zot, mëshiroje atë që është i shtrirë këtu dhe vendose në parajsën Tënde; se edhe në këtë botë mirë ka jetuar!'"

I Dërguari i Allahut i shoqëroi luftëtarët deri në të dalë të Medinës. Teksa po kthehej prapë për në Medinë, Ibni Reuaha filloi të recitonte me zë të ulët këto vargje:

"Përshëndetje, o ti që më përcolle gjer në kopshtet me hurma,/ më thoni, ka njeri më të mirë që të të përcjellë!/ ... dhe të gjithëve ju, o miqtë e mi, që pas ju lamë!"

Etja e pashuar e Abdullah bin Reuahas për të rënë dëshmor

Zejd bin Erkami (radijallahu anh) tregon: "Unë isha jetim dhe më ka rritur Abdullah bin Reuaha. Në betejën e Mu'tes ai më pati marrë edhe mua me vete. Unë isha ulur mbi torbat e tij, në devenë e tij. Uallahi, atë natë, ai, edhe drejtonte devenë, edhe përsëriste pareshtur me zë të ulët këto vargje; i drejtohej devesë:

"Kur të më çosh në anën e armiqve ti pastaj je e lirë, nuk do të të përdor më për të udhëtuar. Sepse unë nuk do të kthehem më pranë familjes. Myslimanët erdhën dhe më prunë mua deri në skajin më të fundmë të tokave siriane. Të prunë tek Ai, që është Mëshirëploti, ty që i preve të gjitha marrëdhëniet me njerëzit e tu, madje edhe ato të vëllazërisë. Unë, këtu, nuk përgëzoj më as frutat, as hurmat e mira!"

Kur ia dëgjova këto fjalë, fillova të qaja. Më ngacmoi me kamxhik dhe më tha, për të më qetësuar:

- "Ore, ndjellakeq! Pse qan ti, ngaqë Allahu do të më pranojë mua prej dëshmorëve të Tij, hë, prandaj qan? Kur të vdes unë, ti mbush torbat plot dhe kthehu!"[75]

Fjalët që tha Ibni Reuaha në Mu'te

Abad bin Abdullah bin Zubejri transmeton: "Burri, bashkëshortja e të cilit është nëna ime nga gjiri, më ka thënë:

[75]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/231 (10220).

"Kur vranë Xhaferin (radijallahu anhu), flamurin e mori Abdullah bin Reuaha (radijallahu anhu) dhe i dha kalit përpara. Pastaj, u lëkund për pak çaste, që të zbriste, apo të mos zbriste, dhe tha këto fjalë:

- "O egoja ime! Unë jam betuar, do të zbresësh! Edhe po nuk deshe, nuk ke nga t'ia mbash, do të zbresësh! Nuk e kuptoj, pse po më duket sikur nuk ta ka ënda Xhenetin? T'u bë kohë e gjatë, më duket, që jeton e qetë dhe në mes të gjithë të mirave...

Ah, moj fryma ime! Edhe po nuk të vranë, do të vijë një ditë e do të vdesësh. Vdekja ka për të ardhur, është e pashmangshme, ti gjithnjë afër saj je, do, apo s'do ti, vdekja do të vijë! Nëse bën ashtu siç bënë Zejdi dhe Xhaferi, atëherë shpëtove, se do të hysh në Xhenet."

Ibni Reuaha, pasi tha këto fjalë si në vargje, zbriti nga kali. Djali i xhaxhait të tij, i pruri një kockë, në të cilën kishte mbetur edhe pak mish dhe i tha:

- "Haje këtë, të vish pak në vete. Se ato vështirësi që ke pasur këto ditë nuk i ke pasur kurrë." Ibni Reuaha e mori atë copë kocke me pak mish, këputi pak mish me dhëmbë dhe kur dëgjoi vringëllimat e shpatave që vinin nga ana tjetër, i tha vetes:

- "Po ti çfarë kërkon ende në këtë botë!", – dhe e hodhi tutje atë kockë që i kish mbetur në dorë. Nxori shpatën dhe u hodh përpara e luftoi fort, derisa ra dëshmor."[76]

LUFTA E JEMAMES

Kur Ebu Akili (r.a.) u bënte thirrje ensarëve për në Jemame

Xhafer bin Abdullah bin Eslem el-Hemdaniu tregon: "I pari që u plagos në luftën e Jemames ishte Ebu Akil el-Unejfi. E goditi një shigjetë, i hyri mes dy shpatullat dhe iu qe ngulur në zemër, e ai u rrëzua në vend. Por ende nuk kishte vdekur. Ia nxorën shigjetën, mirëpo, krahun e majtë nuk e lëvizte dot, kishte mbetur i paralizuar. E morën dhe e futën në çadër. Pastaj, kur lufta u përndez edhe më shumë dhe ushtarët myslimanë po përjetonin humbje të njëpasnjëshme, ata hoqën dorë nga sulmi dhe filluan të tërhiqeshin, mirëpo Ma'n bin

[76]. Ibn Kethir, *Sire,* 3/462.

Adiji (radijallahu anhu) filloi t'u bënte thirrje ensarëve:

- "Kini frikë Allahun, kini frikë Allahun, ejani t'i hidhemi prapë armikut në sulm!" Ma'ni (radijallahu anhu) nxitoi dhe u hodh mbi ushtarët e armikut. Kjo e thirrur e Ma'nit ka ndodhur pikërisht kur ensarët kishin filluar t'i thërrisnin njëri-tjetrit fort:

- "O ensarë, kaloni në anën tonë, kaloni në anën tonë!"

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) thotë se: "Ebu Akili pati dëgjuar Ma'nin që u pati bërë thirrje ensarëve. U çua në këmbë, që të përfshihej në mesin e ensarëve, të cilët ishin populli i tij. Unë i thashë:

- "O Eba Akil, ti je i plagosur, çfarë kërkon të bësh kështu? Ti nuk je në gjendje të luftosh!"

- "A nuk e dëgjon? Tellalli po më thërret mua në emër!", – u përgjigj Ebu Akili.

- "Ai është duke thirrur ensarët, jo të plagosurit!", – i thashë unë.

- "Po edhe unë ensar jam, ndaj, edhe sikur këmbadoras, më duhet t'i përgjigjem asaj thirrjeje!", – më tha dhe u bë gati. Pastaj, ende pa veshur mburojën, mori shpatën në dorë dhe zuri të bërtasë:

- "Ensarë! Ensarë! Çfarë bëni kështu, kthehuni pas njësoj siç bëtë në luftën e Hunejnit, që u rikthyet sërish dhe e sulmuat armikun në befasi! Kjo e thirrur e Ebu Akilit sikur i tronditi ensarët dhe i bëri të vinin në vete, ndaj ata u bënë edhe njëherë bashkë dhe i vunë përpara armiqtë, duke i shtyrë ata deri në kopshtijen ku qëndronte Musejlemeja i fshehur, ku edhe i zunë ngushtë. Tanimë dy ushtritë po kacafyteshin me njëra-tjetrën. Mes nesh shihje vetëm shpata që ngriheshin e fluturonin njëra mbi tjetrën. Në atë kohë pashë Ebu Akilin; i ishte këputur shigjeta që kishte marrë në sup dhe ishte rrëzuar përtokë. Kishte marrë plot katërmbëdhjetë plagë, e që të gjitha dukeshin, ishin plagë vrastare. Ky ishte sulmi kur u vra edhe armiku i Allahut, Musejlemeja. Unë shkova pranë Ebu Akilit. Kishte rënë pa ndjenja në tokë dhe ishte duke përjetuar çastet e tij të fundit. Unë i thashë:

- "Ebu Akil!" Ebu Akili me vështirësi lëvizte buzët dhe gjuhën dhe m'u përgjigj duke më thënë:

- "Më thuaj, kush e fitoi luftën?"

- "Lajme të mira, o Ebu Akil! E vramë armikun e Allahut.", – i thashë unë. Kur mori lajmin e gëzuar, e ngriti gishtin tregues në drejtim të qiellit dhe lëvdoi Allahun, e kjo zgjati shumë pak çaste dhe ai dorëzoi edhe shpirtin.

Pasi u kthyem në Medinë, unë shkova dhe ngjarjen ia tregova një e për një edhe babait tim, Omerit. Ai më tha:

- "Allahu e mëshiroftë Ebu Akilin! E vetmja dëshirë që kishte, ishte të binte dëshmor. Me sa di unë, ai ka qenë një nga myslimanët e parë dhe një prej sahabëve më të mirë të Profetit tonë."[77]

LUFTA E JERMUKUT

Kur bie dëshmor Ikrime bin Ebi Xhehli

Thabit el-Bunanij (radijallahu anhu) tregon: "Ikrime bin Ebi Xhehli (radijallahu anhu) pati filluar njëfarë kohe që të luftonte si ushtar i thjeshtë, pa u matur mirë, ndaj Halid bin Uelidi (radijallahu anhu) e pati qortuar:

- "Çfarë bën kështu, o Ikrime! Mos bëj kështu! Po u vrave ti, ka për të qenë një humbje shumë e hidhur për të gjithë myslimanët!" Ikrimeja iu përgjigj:

- "M'u hiq nga rruga, Halid! Ti i ke besuar të Dërguarit të Allahut më parë. Kurse unë dhe babai im kemi qenë armiqtë më të paepur të Profetit të profetëve.", – dhe sakaq bëri përpara dhe luftoi trup më trup me armiqtë, derisa ra dëshmor."[78]

Dëshira e zjarrtë e Amar bin Jasirit për të rënë dëshmor

Ebu'l-Bahteriu dhe Mejsereja tregojnë që të dy: "Amar bin Jasiri po luftonte ethshëm në luftën e Sifinit; mirëpo fati i tij nuk qëllonte të ishte fati i dëshmorit. Andaj, ai shkonte tek Aliu (radijallahu anhu) dhe i thoshte:

- "O Prijësi i Besimtarëve! Unë sot kam luftuar kështu e kështu,

[77]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/474.
[78]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/510 (37419).

por prapë nuk ndodhi ajo që dua!" Ndërsa Aliu (radijallahu anhu) i jepte gjithmonë të njëjtën përgjigje:

- "Hiq dorë nga ky mendim."

Amari, këtë mendim të tijin, ia shprehu Aliut (radijallahu anhu) plot tri herë me radhë. Pastaj atij i prunë pak qumësht. Piu prej tij dhe tha:

- "Krenaria e Njerëzimit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më pati lajmëruar që herët, *'gjëja e fundit që do të pish në këtë botë ka për të qenë qumështi."* Pastaj u ngrit sërish dhe luftoi derisa ra dëshmor."[79]

20. TRIMËRIA E SAHABËVE FISNIKË

Trimëria e Ebu Bekrit (r.a.)

Një ditë, Aliu (radijallahu anhu) i pyeti besimtarët:

- "O njerëz! A mund të më thotë ndonjëri prej jush, se kush është më trimi nga të gjithë njerëzit?" Ata i thonë:

- "Ti je, o Prijësi i Besimtarëve!"

- "Vërtet, unë me këdo që jam përleshur, ia kam treguar vendin. Por nuk jam unë; ma tregoni kush është trimi më i paepur nga tërë njerëzia!"

- "Po ne nuk e dimë kush qenka, kush është ai?", – thanë njerëzit e pranishëm.

- "Ai është Ebu Bekri (radijallahu anhu), sepse, në luftën e Bedrit, ne patëm ngritur një çardak për të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Dhe, që të Dërguarin Fisnik të mos vinte e të mos e sulmonte ndonjë prej idhujtarëve. Ne pyetëm, "po mirë, kush do të qëndrojë pranë të Dërguarit të Allahut?", asnjë nuk u hodh të thoshte "Unë!", përveç Ebu Bekrit. Ishte Ebu Bekri që nxori shpatën dhe i qëndroi Profetit tonë te kryet përgjatë gjithë kohës. Sa herë që vinte ndonjë nga idhujtarët, për të sulmuar Resulullahun, përpara i dilte menjëherë Ebu Bekri. Ja pra, me pak fjalë, më trimi nga të gjithë njerëzit ka qenë Ebu Bekri!"[80]

---

[79]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/141.
[80]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/759 (35690).

Trimëria e Omer bin Hatabit (r.a.)

Aliu (radijallahu anhu) tregon: "Nga të gjithë ata që mërguan nga Meka në Medinë, përveç Omerit, të gjithë sa njoh unë patën mërguar në fshehtësi të plotë. Kur vendosi Omeri të mërgonte, vetëm mori shpatën, hodhi harkun mbi sup, mori ca shigjeta me vete dhe doli në Qabe. Në atë kohë aty ishte edhe e gjithë paria dhe njerëzit më të njohur të kurejshëve, të cilët rrinin ulur në avllinë e Qabes. Omeri e shëtiti Qaben shtatë herë përreth, fali dy rekate namaz në Mekamin e Ibrahimit dhe i vizitoi grupet e vogla të idhujtarëve kurejsh, duke u thënë të gjithëve:

- "Kush do që ta bëjë nënën e vet për të qarë, t'i lërë fëmijët jetimë dhe të shoqen vejushë, ejani e më arrini se nga aksh luginë do të kaloj!" Askush nuk pati guxim të ngrihej e ta ndiqte nga pas."[81]

Aliu (r.a.) vret Amr bin Abdiuedin

Urueja me Abdullahun, duke përcjellë prej Kab bin Malik el-Ensarit (radijallahu anhum), na tregojnë: "Në luftën e Hendekut, Amr bin Abdiuedi kishte vendosur nishanet e tij, në mënyrë që ta dallonin të gjithë dhe erdhi me kalë dhe u ngul aty, në fushëbetejë. Aliu (radijallahu anhu) tha:

- "O Amr! Me sa kam dëgjuar, ti i ke dhënë fjalën kurejshëve në emër të Allahut: "Që kur dikush të të detyrojë të zgjedhësh diçka mes dy gjërash, ti do të zgjedhësh medoemos njërën, e vërtetë është kjo?"

- "Po, e vërtetë është.", – tha Amri. Aliu (radijallahu anhu) i tha:

- "Po mirë atëherë, unë po të ftoj ty të zgjedhësh Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Islamin!" Amri iu përgjigj:

- "Unë nuk kam nevojë për këtë!"

- "Atëherë unë të ftoj në duel!", – i propozoi atij Aliu (radijallahu anhu).

- "Po pse, nipi im? Unë nuk dua të të vras!", – iu përgjigj Amri.

- "Kurse unë, uallahi dua të të vras ty.", – i tha shkurt Aliu

[81]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/797 (35796).

(radijallahu anhu).

Amri u nxeh keqas nga kjo përgjigje e Aliut (radijallahu anhu), kështu që e sulmoi. Zbritën të dy nga kuajt dhe u përleshën me njëritjetrin në fushë. Në fund, Aliu (radijallahu anhu) e vrau Amrin."[82]

Aliu (r.a.) e heq fare vendit portën e kështjellës së Hajberit

Xhabiri (radijallahu anhu) tregon: "Në luftën e Hajberit, Aliu i nderuar e kapi portën e kështjellës siç ishte, e ngriti dhe e hoqi vendit fare, pastaj myslimanët hynë të gjithë me radhë dhe ngadhënjyen mbi kështjellën. Më vonë, edhe pse u përpoqën plot dyzet vetë për ta ngritur portën në të njëjtën kohë, nuk mundën ta ngrinin."[83]

Trimëria dhe heroizmi i Talha bin Ubejdullahut

Talhaja (radijallahu anhu) tregon: "Në atë ditë që ndodhi lufta e Uhudit, unë kam recituar këtë poezi: "Ne jemi mbrojtësit e Allahut, të Vetmit Fitimtar, të vetmit Sundimtar, Profetin tonë të Bekuar, atë mbrojmë ne. Goditje pas goditjeje i japim ne armikut, njësoj siç përpiqen devetë trupmëdha e gunga të fryra, që dheun me këmbë aq fort e rrahin."

Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ende pa u kthyer nga lufta e Uhudit, i pati thënë Hasan bin Thabitit:

- "*Më thuaj ndonjë gjë për Talhanë.*" E ai i lexoi atij këtë poezi:

- "Talhaja ndihmoi Muhamedin në luftën e Uhudit./ E kjo ndihmë ish një ndihmë që erdhi në çastin më të vështirë e më plot shqetësime që kish pasur ndonjëherë Muhamedi./ Me duar i priste ai heshtat që trupin e tij të bekuar t'mos e preknin./ Me shpatë e goditën, gishtërinjtë me damarë ia prenë, e ai mbet' i përgjakur e i padorë./ Pas Muhamedit, ai ishte në krye të të gjithëve./ E mbajti përherë mbi vete kularin e pavarësisë së Islamit, ndaj sot ai gëzon pavarësinë."

Ndërsa Ebu Bekr Siddiku (radijallahu anhu) këndonte këtë poezi,

[82]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/105.
[83]. Ibn Kethir, *Sire,* 3/359.

kur donte të thurte lavde për Talhanë:

- "Kalorësit armiq t'Dërguar'n e Allahut e ndiqnin/ Po Profetin e drejtë Talhaja e mbrojti./ Edhe kur disa myslimanë prej tyre trembeshin,/ ai nuk u tërhoq, e nxuarr kraharorin, se fenë e tij donte të mbronte./ Ti parajsën meriton, Talha bin Ubejdullah. Atë dhe t'martohesh me huri me sytë si sorkadhe!"

Omeri (radijallahu anhu) ka kënduar këtë strofë:

- "Kur të gjithë myslimanët e braktisën fushën e betejës, Talhaja nuk e futi shpatën në mill, por qëndroi aty, për të mbrojtur Profetin e së drejtës!" Kur Omeri (radijallahu anhu) e pati thënë njëherë këtë në prani të të Dërguarit të Allahut, ai i pati thënë:

- "*Mirë e the, ashtu është e vërteta, o Omer!*"[84]

Trimëria dhe heroizmi i Zubejr bin Auamit

Said bin Musejebi ka thënë kështu: "I pari që ka nxjerrë shpatën për të luftuar në rrugën e Allahut ka qenë Zubejr bin Auami. Deri sa, një drekë atë e kishte zënë gjumi, mirëpo kishte dëgjuar një zë që kishte thirrur:

- "Kanë vrarë të Dërguarin e Allahut.", ndaj ish ngritur menjëherë, kishte nxjerrë edhe shpatën. Kur doli, i Dërguari i Allahut e pyeti:

- "Çfarë ndodhi, o Zubejr?" Ai iu përgjigj:

- "O i Dërguari i Allahut, dëgjova një zë që më tha se të kanë vrarë ty!"

- "Po të ishte e vërtetë, çfarë do të bëje?", – e pyeti Profeti ynë.

- "Uallahi, do të vrisja çdo mekas që do të më dilte përpara!", – i tha Atij Zubejr bin Auami.

Për këtë përgjigje që i dha Zubejri, i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u lut për të mirën e tij. Madje, Esediu ka thënë këto fjalë lidhur me këtë ngjarje:

"Shpata e parë që u ngrit në ajër nga inati, për të fituar pëlqimin dhe kënaqësinë e Allahut, ishte shpata e Zubejrit. Kjo është shenja e parë e heroizmit të tij të ethshëm. Por, në të njëjtën kohë, kjo është

[84]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/179 (36607).

edhe një shenjë shumë e mirë e sa e sa heroizmave që besimtarët do të shihnin nga ai."[85]

Sulmet e para të Zubejrit (r.a.) gjatë luftërave të Hendekut dhe të Jermukut

Abdullah bin Zubejri (radijallahu anhu) tregon: "Në luftën e Hendekut, mua më patën lënë në kështjellë, që të kujdesesha për gratë dhe fëmijët. Bashkë me mua ishte edhe Omer bin Ebi Selemeja. Ai përkulej, e unë i hipja mbi shpinë, për të parë andej nga po zhvillohej beteja. Pata parë babain tim, Zubejrin. Sulmonte njëherë këtej e njëherë andej. Ngarendte atje ku të kishte më shumë nevojë për të. Kur ra darka, babai erdhi në vendin ku gjendeshim edhe ne.

- "Baba, sot të pashë se si po luftoje.", – i thashë unë.

- "Vërtet, më pe, o bir?", – më pyeti ai.

- "Po!", – iu gjegja unë. U kthye nga unë dhe më tha:

- "Kurban t'u bëfshin ty nëna e babai im!"[86]

Heroizmi i Hamzait (r.a.) në luftën e Bedrit

Harith et-Tejmiu tregon: "Hamzai (radijallahu anhu), për t'u dalluar mirë nga të tjerët në luftën e Bedrit, në kraharor kishte vendosur pupël struci. Në fund të përleshjes, një prej idhujtarëve pati pyetur:

- "Kush ishte ai burrë që kishte vendosur pupël struci në kraharor?" – Kur i thanë se ai kishte qenë Hamzai, i biri i Abdulmutalibit, ai ankimin e vet e pati shprehur me fjalët:

- "Ja, ai na katandisi në këtë gjendje!"[87]

Trishtimi i Profetit tonë kur pa Hamzanë (r.a.) që kishte rënë dëshmor

Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu) tregon: "Kur pati

[85]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/184 (36621).
[86]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/107.
[87]. El-Hakim, *Mustedrek,* 2/128 (2548).

përfunduar beteja e Uhudit dhe njerëzit ishin duke u kthyer pas, i Dërguari i Allahut nuk e kishte parë askund Hamzanë, xhaxhain e tij, ndaj edhe e shihnin të gjithë që vazhdimisht shihte sa majtas sa djathtas. Një burrë tregoi se e kishte parë:

- "Unë e pashë atë te kjo pema këtu. Thoshte pa ndërprerë:

- "Unë jam luani i Allahut, unë jam luani i të Dërguarit të Tij! O Zot, unë vetëm tek Ti kërkoj ndihmë ndaj bëmave të Ebu Sufjanit dhe të të afërmve të tij; të kërkoj falje, nëse myslimanët do të dalin të humbur e do të pësojnë disfatë."

I Dërguari Fisnik vrapoi menjëherë në atë drejtim që i pati treguar ai burrë. Hamzain (radijallahu anhu) e njohu nga balli i tij, nuk e mbajti dot veten dhe u kaplua nga të qarët me ngashërim. Pa që e kishin shpërfytyruar, i kishin nxjerrë sytë, i kishin prerë hundën dhe veshët, nuk i mbante dot lotët, qante me ngashërim. Pastaj pyeti:

- "Ka ndonjëri qefin?" U ngrit një njeri dhe i hodhi një rrobë sipër. Pastaj Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "Në ditën e Kiametit, Hamzai do të jetë prijësi i të gjithë dëshmorëve."[88]

Vrasja e Hamzait (r.a.), siç e tregon Uahshiu

Tregon Xhafer bin Amr bin Umejetu'd-Damriu: "Në kohën e Muauijes, ne u nisëm, bashkë me Abdullah bin Adij bin Khijarin, për të shkuar tek Uahshiu. Kur shkuam tek ai, ne i thamë atij:

- "Deri këtu kemi ardhur që të na tregosh se si e vrave Hamzain. Si e pate vrarë?" Ai e filloi fjalën e tij duke na thënë:

- "Edhe juve do t'jua tregoj ashtu siç ia pata treguar edhe të Dërguarit të Allahut, kur më pati pyetur.

Asohere unë isha skllavi i Xhubejr bin Mut'imit. Xhubejrit i kishin vrarë xhaxhain, Tuajme bin Adijin, në luftën e Bedrit. Kur kurejshët u nisën në drejtim të Uhudit, Xhubejri u kthye nga unë dhe më tha:

- "Në këmbim të xhaxhait tim do të vritet xhaxhai i Muhamedit,

[88]. El-Hakim, *Mustedrek,* 2/130.

Hamzai; po e vrave, je i lirë." Kësisoj, bashkë me kurejshët u nisa edhe unë. Unë isha një habeshij (abisinas) dhe isha shumë i mirë në hedhjen e heshtës. Kur të dyja palët u përballën me njëra-tjetrën, unë u distancova, kërkoja për Hamzain dhe, më në fund, e gjeta. E pashë siluetën e tij në mesin e luftëtarëve, askush nuk qëndronte gjatë në këmbë përpara tij. Uallahi, edhe unë po bëja hesap me mend, se si do ta vrisja. U fsheha pas një peme dhe një guri, derisa ai të më afrohej edhe pak. Në një moment pashë se para meje kaloi Siba' bin Abduluzza, që iu sul Hamzait. Kur e pa, Hamzai i tha atij:

- "Hajde edhe ti, hajde, o i biri i rrethprerëses!" dhe me një goditje të rrufeshme ia fluturoi kokën tej Siba' bin Abduluzzas, ndërsa vetë dukej sikur nuk e kishte bërë ai fare atë lëvizje. Në atë kohë edhe unë përgatita heshtën dhe kur u mata mirë, që do ta rrokja, e gjuajta dhe heshta u ngul mes barkut dhe kraharorit të Hamzait, çau tejpërtej dhe doli në shpinë. Filloi të ecë rëndë-rëndë, për të ardhur drejt meje, por nuk ia doli dot. E lashë ashtu, pa e prekur. Kur i doli shpirti, tërhoqa pas heshtën. Pastaj u ktheva pranë ushtrisë sonë, nuk luftova, por qëndrova ulur, pa u përzierë më me luftën. Edhe Hamzain, andaj e pata vrarë, për të fituar lirinë. Dhe, me të vërtetë, kurejshët e mbajtën fjalën, sepse, kur u kthyem, ata më lanë të lirë.

Deri në kohën që Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ngadhënjeu mbi Mekën, unë qëndrova në Mekë, nuk u largova. Pas ngadhënjimit u zhvendosa në Taif, ku edhe vendosa të vazhdoja jetën. Kur edhe taifasit filluan të dërgonin njerëz tek i Dërguari i Allahut, për t'u bërë myslimanë, unë atëherë nuk dija më seç të bëja. Thashë me vete, "mos është më mirë që të zhvendosem në Siri ose në Jemen.", e ndërsa mendohesha kështu me vete, te mua erdhi një burrë dhe më tha:

- "Turp të të vijë! Uallahi, Muhamedi nuk vret askënd që e pranon vërtet fenë e tij dhe i beson Allahut." Kur ai burrë më tha kështu, u nisa menjëherë të shkoja në Medinë. Mbërrita, nuk e kisha lajmëruar të Dërguarin e Allahut dhe me sa munda u përpoqa të mos i shfaqesha askund. Kur më pa, më pyeti:

- "*Ti, Uahshiu je?*"

- "Po, o i Dërguari i Allahut!", – i thashë unë të Dërguarit të Allahut.

- "*Ulu dhe më trego, si e vrave Hamzanë?*", – më tha. Dhe unë i tregova atij, njësoj siç jua tregova edhe juve tani. Kur përfundova së treguari, ai më tha:

- "*Përpiqu të mos më shfaqesh përpara syve. Tani e tutje nuk mundem të të shoh!*" Nuk kam shkuar më kurrë, në asnjë vend ku mund të ishte edhe i Dërguari i Allahut. Dhe kështu vijoi përgjithmonë, deri kur Allahu e mori pranë Vetes të Dërguarin e Tij.

Kur myslimanët shkuan në Jemame, për të luftuar kundër Musejleme Mashtruesit, bashkë me ta isha edhe unë. Me vete mora edhe heshtën, me të cilën pati rënë dëshmor Hamzai. Pashë njëherë kur u përballën të dyja ushtritë me njëra-tjetrën; Musejlemeja rrinte me shpatën e tij në dorë. Unë nuk e njihja atë. U përgatita. Nga ana tjetër pashë që edhe dikush nga ensarët po përgatitej për të bërë po të njëjtën gjë. Të dy donim të vrisnim Musejlemen. E bëra gati heshtën dhe pasi u mata njëherë mirë, një të lëshuar i bëra heshtës dhe ajo u ngul në trupin e Musejlemes. Mandej, atij njeriu nga ensarët nuk i mbeti gjë tjetër për të bërë, veçse i shkoi pranë dhe e copëtoi me shpatë. Zoti e di se kush e vrau përfundimisht atë njeri. Nëse e kam vrarë unë, atëherë unë kam për të qenë njeriu që ka vrarë njëherazi, edhe njeriun më të mirë pas të Dërguarit të Allahut, edhe njeriun më të ligë të mbarë njerëzisë, Musejlemen."[89]

Dy djelmoshët trima që vranë armikun e Allahut, Ebu Xhehlin, në luftën e Bedrit: Muadh bin Amr bin Xhemuhu dhe Muadh bin Afraja

Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) tregon: "Atë ditë që ndodhi lufta e Bedrit, lufta po vazhdonte me gjithë vlugun që e karakterizon luftën, në të djathtën e në të majtën time pashë që kisha dy djem shumë të rinj, të cilët ishin nga ensarët. Ai që dukej se ishte më i forti ma shtoi shumë ëndjen që po luftoja me të, kur njëri prej tyre më shkeli syrin dhe më pyeti:

- "Xhaxha, ti e njeh Ebu Xhehlin?"

- "Po e njoh, ç'e do ti Ebu Xhehlin?, – iu përgjigja unë.

[89]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/18.

- "Me sa kam dëgjuar unë, Ebu Xhehli shakësh Resulullahun tonë të dashur, nuk lënkësh gjë pa thënë për të! I betohem Allahut, se po e pashë, do ta ndjek këmba-këmbës dhe do të luftoj me të derisa të vijë exheli i njërit prej nesh, kush ta ketë më të afërt të vdesë!", – më tha ai mua. U çudita nga ato fjalë. Kurse djali tjetër, më shkeli edhe ai syrin dhe më tha të njëjtat fjalë. Ndërkaq, sytë më kapën Ebu Xhehlin. Po ecte në mes të ushtarëve kurejshë. U thashë menjëherë atyre dy djemve:

- "A e shikoni atë burrin atje tej? Ai është ai që më pyetët!" Të dy ata djelmosha nxorën shpatat dhe e goditën aq shumë herë Ebu Xhehlin, derisa e lanë të vdekur në vend. Kur mbaruan, u kthyen pranë Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe ia treguan një për një të gjitha sa kishin ndodhur.

I Dërguari i Allahut i pyeti ata:

- "*Kush nga ju të dy e vrau atë?*" Ata të dy iu përgjigjën njëzëri:

- "Unë e vrava."

- "*Po shpatat, a i pastruat?*", – i pyeti i Dërguari i Allahut.

- "Jo!", – thanë ata. Paskëtaj, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i pa njëherë të dyja shpatat dhe tha:

- "*Ju e paskeni vrarë të dy atë.*" Megjithatë, sendet e Ebu Xhehlit ai ia dha vetëm Muadh bin Amr bin Xhemuhut, sepse ishte ai që e kishte goditur më shumë Ebu Xhehlin. Djaloshi tjetër ishte Muadh bin Afraja."[90]

Heroizmi i Ebu Duxhanes (r.a.)

Zubejr bin Auami (radijallahu anhu) tregon: "Në ditën e Uhudit, Resulullahu na tregoi neve një shpatë dhe na pyeti:

- "*Kush do ta marrë këtë shpatë, me kushtin që t'i japë hakun?*" Në këmbë u ngrit Ebu Duxhaneja, i cili tha:

- "O Resulullah, po e marr unë, do t'ia jap unë hakun, cili është haku i saj?" I Dërguari Fisnik ia dha shpatën Ebu Duxhanes. Ebu Duxhaneja doli. Unë po e ndiqja nga pas. Çdo idhujtar, me të cilin përballej, Ebu

[90]. Buhari, *Sahih,* 3/1144 (2972).

Duxhaneja e ndante në dysh. Kur, ec e ec, ai mbërriti në shpatin e malit, ku ishte një grup me gra. Në mes të grave ishte edhe e shoqja e Ebu Sufjanit, Hindi. Hindi ishte duke recituar këto vargje:

- "Ne jemi vajzat e agimit/ e veç mbi jastëkë vëmë ne këmbën/ në gërsheta kemi ne aromën e miskut./ ju vini te ne, e ne kraharorin ju hapim./ Po shpinën po na kthyet, atëherë as ne për ju s'na e ndien, ikim ju braktisim!"

Ebu Duxhaneja thotë se:

- "Unë iu vërsula Hindit, ndërsa gratë e tjera zunë të ulërinin. Askush nuk u erdhi në ndihmë. Kur pashë që nuk erdhi askush, atëherë e lëshova atë grua. Zubejr bin Auami tregon se: "Unë i thashë Ebu Duxhanes:

- "I pashë të gjitha çfarë bëre dhe u çudita. Po atë grua nuk e vrave, pse e lëshove?" Ai m'u përgjigj duke më thënë:

- "Kur e sulmova, ajo lëshoi një piskamë të fortë; por askush nuk i erdhi në ndihmë. Pse, më thuaj ti, më kishte hije mua, që, me shpatën që më dha i Dërguari i Allahut të vrisja një grua të pambrojtur nga askush?"[91]

Katade bin Numani (r.a.) humbet syrin në rrugën e Allahut

Katade bin Numani (radijallahu anhu) tregon: "Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i kishin dhuruar një hark, ndërsa ai ma pati dhënë mua atë hark në Uhud. Atë ditë unë qëndrova pranë Resulullahut dhe kam hedhur aq shumë shigjeta, saqë harku filloi të hahej në të dyja anët. Nuk lëvizja nga vendi, e të gjitha shigjetat e hedhura në drejtim të Resulullahut, unë përpiqesha t'i prisja me fytyrë. Sa herë që në drejtim të fytyrë së Profetit tonë të nderuar vinte ndonjë shigjetë, unë zgjatja menjëherë kokën në atë drejtim. Një prej shigjetave të fundit më pati goditur në sy, sa që bebja e njërit syrit më ra në dorë. E mora syrin në dorë dhe shkova pranë Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Nuk i mbajti dot lotët kur më pa në atë gjendje dhe filloi t'i lutej Allahut:

[91]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 6/156 (10069).

- "*O Zoti im! Katadeja fytyrën e tij e bëri mburojë për të mbrojtur profetin tënd. Bëje syrin e dalë të tij syrin më të bukur e më të mprehtin, që të shohë çdo gjë!*" Ai që e transmeton këtë hadith thotë se: "Profeti ynë u lut dhe kur ia vunë syrin prapë në vend, syri i Katades u bë syri më i bukur dhe syri më i mprehtë që mund të jetë parë ndonjëherë."[92]

Heroizmi i Halid bin Uelidit (r.a)

Vetë Halid bin Uelidi thotë: "Në luftën e Mu'tes plot nëntë shpata m'u thyen në dorë. Me vete kisha edhe vetëm një shpatë me buzë të trashë, e cila ishte punim Jemeni."[93]

Halidi (r.a.) qante se do të ndërronte jetë në shtrat, e jo në betejë

Transmeton Ebu'z-Zinadi: "Kur do të ndahej nga kjo jetë, Halidi filloi të qante dhe, në një çast, tha:

- "Kam marrë pjesë në sa e sa luftëra, e nuk më ka mbetur asnjë pëllëmbë vend në trup, ku të mos kem shenja plagësh, që i kam marrë të paktën nga ndonjë e prerë shpate, nga ndonjë e çarë heshte, apo ku të mos më jetë ngulur ndonjë shigjetë. Mirëpo, tani... tani, po vdes në shtrat, njësoj siç ngordhin devetë. Gjumë mos u hyftë në sy frikacakëve!"[94]

Heroizmi i Amar bin Jasirit (r.a.)

Ibni Omeri (radijallahu anhu) transmeton: "Në atë ditë që u bë lufta e Jemames kam parë Amar bin Jasirin, i cili, megjithëse veshin e kishte të prerë e i rrinte varur, ai ishte ngjitur mbi një shkëmb dhe bërtiste kështu:

- "O bashkësi e myslimanëve! Kujt po i ikni, parajsës? Unë jam Amari, i biri i Jasirit! Hë, më thoni, parajsës po i përvidheni kështu? Unë jam Amari, hë, ejani tek unë!" Atë ditë, lufta që pati bërë Amari ishte një ndër më rreptat."[95]

92. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 19/8 (10069).
93. Buhari, *Sahih,* 4/1555 (4017).
94. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/114.
95. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/434 (5657).

21. GJYKIMI NDAJ ATYRE QË IA MBATHNIN NGA LUFTA

Sahabët gjykojnë Seleme bin Hishamin

Umu Selemeja (radijallahu anha) tregon: "Unë shkova tek e shoqja e Seleme bin Hisham el-Mugires dhe i thashë:

- "Nuk po e shoh burrin tënd, Selemen, pranë të Dërguarit të Allahut dhe të sahabëve të tij, në xhami, për të falur namazin, çfarë i ka ndodhur?" Ajo m'u përgjigj duke më thënë:

- "Uallahi, Selemeja nuk del nga shtëpia, sepse, dolën njëherë dhe njerëzit filluan t'i thërrisnin:

- "Ah, ju ikacakë! Nga ia mbathët, nga të luftuarit në rrugën e Allahut?" Andaj edhe ai është mbyllur në shtëpi, nuk del." Selemeja kishte ikur nga lufta e Mu'tes, ku po luftonin nën komandën e Halid bin Uelidit."[96]

22. PENDIMI QË NDIENIN ATA QË I IKNIN LUFTËS

Mërzia dhe pendimi që ndjenë Ibni Omeri me shokë, ngaqë ishin prej të arratisurve nga lufta e Mu'tes

Tregon Abdullah ibni Omeri (radijallahu anhu): "Unë isha në një prej ekspeditave që pati dërguar Resulullahu. Një grup qe larguar nga ekspedita dhe ia patën mbathur. Në mes tyre isha edhe unë. Gjatë rrugës u penduam, e të gjithë thamë:

- "Çfarë do të bëjmë tani? Ikëm nga fusha e betejës, e ajo që meritojmë tani është ndëshkimi i ashpër i Allahut." Megjithëse, më vonë, në mendje na erdhi mendimi që të ktheheshim në Medinë dhe ta kalonim natën nëpër shtëpitë tona, prapë, hoqëm dorë edhe prej tij dhe thamë:

- "Të shkojmë njëherë andej nga i Dërguari i Allahut dhe t'ia shpjegojmë të gjitha sa ndodhën. Për ne do të jetë më mirë, nëse ka ndonjë mënyrë që pendimi ynë të jetë i vlefshëm! Nëse jo, atëherë kthehemi pas, në mesin e luftëtarëve tanë." Pas namazit të drekës, ne

[96]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/249.

mbërritëm te porta e Resulullahut. Ai doli jashtë dhe na pyeti:

- "*Po ju, çfarë jeni?*"

- "Ne jemi arratisur nga lufta!", – i thamë.

- "*Jo! Ju jeni nga ata që kanë ardhur këtu dhe duan të kthehen pas, sepse ju jeni të mitë dhe unë jam i juaji.*" Atëherë, ne u zgjatëm dhe i puthëm duart.[97]

23. GJETJA E ARMËVE DHE NDIHMESAT PËR LUFTËTARËT E RRUGËS SË ALLAHUT

Profeti ynë, edhe kur nuk merrte pjesë vetë në luftë, armën ia jepte me vete Usames (r.a.) ose Aliut (r.a.)

Xhebele bin Haritheja (radijallahu anhe) na përcjell: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), edhe kur nuk merrte pjesë vetë luftë, ai armën ia jepte me vete ose Aliut ose Usames (radijallahu anhuma)."[98]

Ata që u vinin në ndihmë atyre që donin të luftonin në rrugën e Allahut

Ebu Mesud el-Ensari (radijalahu anhu) ka treguar: "Një burrë, erdhi te Profeti ynë dhe i tha atij:

- "O Resulullah, kafshën e rrugës e kam të lodhur, kam mbetur në rrugë, si thua, sikur të më hipësh në ndonjë tjetër." I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

- "*Tani nuk kam asnjë kafshë rruge me vete, ku të të hip?!*" Nga ana tjetër, bisedën e zhvilluar mes tyre e dëgjoi një burrë tjetër, i cili u hodh e tha:

- "O Resulullah, unë mund të të tregoj dikë që mund t'i mundësojë atij një kafshë për t'i hipur." Atëherë, Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) tha:

- "*Kushdo që bëhet shkas për një të mirë, edhe atij i shkruhet e njëjta e mirë që i shkruhet edhe atij që e kryen të mirën vetë!*"[99]

---

97. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 2/70 (5384).
98. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 2/286 (2194).
99. Muslim, *Sahih,* 3/1506 (1893).

Ndërsa një tjetër transmetim i tiji lidhur me këtë temë është i këtillë:

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: "Një djalosh nga fisi i Eslemit erdhi tek i Dërguari Fisnik dhe i tha:

- "O Resulullah, unë dua të luftoj; vetëm, se nuk kam asnjë mundësi për t'u përgatitur për luftë." Resulullahu i tha atij:

- "*Shko te filani nga ensarët, ai ishte bërë gati për t'u nisur për në luftë, mirëpo u sëmur. Thuaji atij, 'të kam prurë përshëndetjet e të Dërguarit e Allahut, më tha të m'i japësh mua përgatitjet që pate bërë për të marrë pjesë në luftë'.*" Kështu bëri ai djalosh, shkoi atje ku i kishte thënë i Dërguari i Allahut dhe i çoi atij përshëndetjen. Ai burrë iu drejtua së shoqes, duke i thënë:

- "Grua! Jepja këtij djali ato gjërat që pata bërë unë gati për në luftë, mos lër asgjë, jepja të gjitha. Kujdes se mos të ndonjë prej tyre pa ia dhënë, që të jenë të shumta shpërblimet edhe për ty!"[100]

Gjendja e atyre që shkonin në luftë me ndihmën dhe mbështetjen e dikujt tjetër dhe gjendja e atyre që ndihmonin të tjerët për të marrë pjesë në luftë

Mejmune binti Sad (radijallahu anha) i pati bërë Profetit tonë (sal'allahu alejhi ue sel'lem) këtë pyetje:

- "O Resulallah, na jep fetva lidhur me një çështje: Cila është gjendja e atij njeriu që nuk ka mundësi të marrë pjesë në luftë, por që jep plaçkën e pasurinë e tij, që të shkojë dikush tjetër që nuk i ka mundësitë? A e merr edhe ai shpërblimin e luftës, apo e merr të gjithin ai që merr pjesë në luftë me plaçkën e tij?" I Dërguari i Allahut i dha asaj këtë përgjigje:

- "*Ai që dërgon dikë në luftë merr shpërblimin e pasurisë që u ka dhënë të tjerëve, kurse i që shkon të marrë pjesë në luftë shpërblehet për sinqeritetin dhe qëllimin (nijetin) e tij.*"[101]

---

[100]. Ebu Daud, *Sunen,* 2/99 (2780).
[101]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 25/38 (69).

24. PËRCJELLJA E LUFTËTARËVE QË NISESHIN TË LUFTONIN NË RRUGËN E ALLAHUT

Kur Ebu Bekri (r.a.) përcjell ushtrinë, komandanti i së cilës ishte Usame bin Zejdi

Tregon Hasan Basriu (radijallahu anhu): "Ebu Bekri (radijallahu anhu) doli nga Meka dhe shkoi pranë ushtrisë që ishte nisur për në luftë. U dha motivim luftëtarëve dhe i përcolli. Usamen e përcolli duke ecur në këmbë. Ndërsa kafshën e rrugës së Ebu Bekrit po e tërhiqte nga frerët Abdurrahman bin Aufi. Kurse Usameja ishte mbi kalë. Usameja tha:

- "O kalifi i të Dërguarit të Allahut, ose hipni edhe ju, ose unë do të zbres!" Ebu Bekri (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- "Uallahi, as ti nuk ke për të zbritur, as unë nuk do të hipi. E ç'do të më gjejë se do të më pluhurosen pak këmbët në rrugën e Allahut? Për një luftëtar kjo do të thotë që të fitojë shtatëqind sevape për çdo hap që hedh, ai ngrihet shtatëqind gradë dhe i fshihen plot shtatëqind mëkate. Kështu ka për të qenë, derisa të mbarojë lufta." Mandej, Ebu Bekri i tha Usames:

- "Do të ishte mirë, po të ma lije mua Omer bin Hatabin, se më vjen në ndihmë për shumë gjëra." Atëherë, ai i dha leje Omerit (radijallahu anhu) që të qëndronte."[102]

Jahja bin Saidi tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) pati dërguar gjithsej katër ushtri për në Siri. Teksa ishte duke përcjellë njërin prej komandantëve të tyre, Jezid bin Ebi Sufjanin, Ebu Bekri (radijallahu anhu) po ecte në këmbë. Thonë se Jezidi i pati thënë Ebu Bekrit (radijallahu anhu):

- "Ose hip edhe ti mbi kalë, ose të zbres unë." Ndërsa Ebu Bekri i përgjigjet:

- "As ti nuk ke për të zbritur, as unë nuk kam për të hipur. Unë shpërblimin e këtyre hapave që po hedh në këmbë e pres prej Allahut!"[103]

Xhabir el-Bur'ini (radijallahu anhu) transmeton: "Ebu Bekr Siddiku

[102]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 10/798 (30268).
[103]. Bejheki, *Sunen,* 9/89 (17927).

(radijallahu anhu) po përcillte një nga ushtritë e tij, e ndërkohë, vetë ecte në këmbë. Atëherë pati thënë:

- "Lëvduar qoftë Allahu! Na u pluhurosën këmbët në rrugën e Allahut." Dikush e pati pyetur:

- "Ne thjesht sa i përcollëm, si na u pluhurosën këmbët në rrugën e Allahut?" Ebu Bekri (radijallahu anhu) i dha atij përgjigje këto fjalë:

- "Ne i ndihmuam ata me përgatitjet e luftës, i përcollëm dhe u lutëm për ta!"[104]

Kur Abdullah bin Omeri përcillte luftëtarët

Muxhahidi tregon: "Unë isha nisur për në njërën prej betejave. Na përcillte vetë Ibni Omeri. Kur erdhi koha që ai të kthehej, ai na tha neve:

- "Nuk kam asgjë, që t'jua jap me vete. Por unë kam dëgjuar Resulullahun, i cili ka thënë:

- "*Kur diçka ia lini si amanet Allahut, Allahu e ruan atë për ju.*" Dhe unë, fenë tuaj, ju vetë dhe përfundimin e veprave tuaja po ia lë amanet Allahut."[105]

Myslimanët presin sahabët që kthehen nga lufta e Tebukut

Saib bin Jezidi (radijallahu anhu) tregon se: "Kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u kthye nga lufta e Tebukut, populli e priti në Thenijjetu'l-Ueda. Unë atëherë isha ende fëmijë dhe bashkë me fëmijët e tjerë, kishim dalë edhe ne për të pritur të Dërguarin e Allahut."[106]

25. SHKRIMI I EMRAVE TË ATYRE QË DO TË DILNIN TË LUFTONIN NË RRUGËN E ALLAHUT

Nga Ibni Abasi (radijallahu anhu) është përcjellë se Profeti i profetëve ka thënë:

- "*Asnjë burrë të mos rrijë kokë më kokë me një grua që nuk është intimiteti*

---

104. Bejheki, *Sunen,* 9/173 (18360).
105. Bejheki, *Sunen,* 9/173 (18358).
106. Bejheki, *Sunen,* 9/175 (18368).

i tij (që nuk ka *nikah*-celebrim islam me të); *asnjë grua të mos dalë në udhëtim, pa pasur dikë nga njerëzit më të afërt e të rrethit intim të saj!*' Kur i Dërguari i Allahut tha këto fjalë, dikush u çua në këmbë dhe tha:

- "O Resulallah, në këtë luftë e pata shkruar edhe unë emrin, mirëpo gruaja ime është përgatitur për të shkuar në Haxh dhe është nisur tanimë, çfarë më urdhëroni të bëj?" Atëherë, Resulullahu e porositi atë burrë:

- "*Shko dhe kryej adhurimin e Haxhit bashkë me tët shoqe.*"[107]

Falja e namazit dhe gostitja me ushqim pas udhëtimit të kryer për Allahun

Është transmetuar prej Kabit (radijallahu anhu), se: "I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) sa herë që vinte paradite nga ndonjë udhëtim, ende pa u ulur për t'u çlodhur e pa e marrë veten mirë, falte njëherë dy rekate namaz."[108]

Ndërsa, nga Xhabir bin Abdullahu (radijallahu anhu) është transmetuar: "Njëherë, gjatë një udhëtimi unë isha bashkë me Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kur mbërritëm në Medinë, ai më tha mua:

- "*Hyr në xhami dhe fal dy rekate namaz.*"[109]

26. EDHE GRATË MERRNIN PËRSIPËR DETYRA GJATË LUFTËRAVE TË ZHVILLUARA PËR TË FITUAR KËNAQËSINË E ALLAHUT

Pjesëmarrja në luftë e Umu Haramit, tezes së Enesit (r.a.)

Nga Enesi (radijallahu anhu) është transmetuar se: "Një ditë, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) shkoi në shtëpinë e Umu Haram binti Milhanit, u mbështet diku dhe e zuri gjumi. Pak më vonë u zgjua duke buzëqeshur. Umu Harami e pati pyetur:

- "Pse po buzëqeshni, o i Dërguari i Allahut?"

[107]. Buhari, *Sahih,* 3/1094 (2844).
[108]. Buhari, *Sahih,* 3/1123 (2922).
[109]. Buhari, *Sahih,* 2/920.

- "*Në ëndërr pashë disa nga njerëzit e umetit tim po ngjiteshin nëpër anije, njësoj si sundimtarët që ulen-ngjiten në fronin e tyre dhe m'u shfaq sikur ata po shkonin të luftonin në rrugën e Allahut. Me atë po buzëqesh.*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut. Tezja ime, Umu Harami i tha:

- "O Resulullah, a nuk lutesh që të jem edhe unë një syresh." Atëherë, i Dërguari i Allahut filloi të lutej:

- "*O Zot! Bëje të jetë edhe Umu Harami një prej tyre!*" Më vonë, Resulullahu vuri kokën në jastëk dhe fjeti edhe për njëfarë kohe. Pastaj u zgjua prapë, përsëri duke buzëqeshur. Umu Harami e pyeti:

- "O Resulullah, po pse po buzëqeshni sërish?" I Dërguari Fisnik iu përgjigj pa hezituar:

- "*Kësaj here pashë një pjesë të umetit tim, që po shkonin në luftë, me një qëndrim si ai sundimtarëve kur ngjisin shkallët e fronit të tyre.*" Tezja ime i kërkoi:

- "Lutjuni Allahut, që të më bëjë të jem edhe unë një prej tyre." Resulullahu iu përgjigj:

- "*Ti je nga të parët, jo nga ata që do të vijnë nga pas.*"

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: "Në atë çast tezja ime ishte e martuar me Ubade bin Samitin. Ajo pati marrë pjesë në luftën detare, bashkë me gruan e Muauijes, Binti Karazan. Kur zbritën nga deti në tokë, kalin e saj diç e trembi dhe ajo u rrëzua dhe humbi jetën."[110]

Shërbimi i grave në luftërat që bëheshin në rrugën e Allahut

Umu Sulejmi (radijallahu anha) tregon: "Sa herë që i Dërguari i Allahut nisej për në luftë, një grup grash nga ensarët merrnin pjesë në luftë, bashkë me të, për t'u dhënë qumësht të sëmurëve dhe për të mjekuar të plagosurit."[111]

Rubeji' binti Muauidh (radijallahu anha) ka thënë: "Ne, sa herë që kemi marrë pjesë në luftë bashkë me të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), mbanim ujin, mjekonim të plagosurit dhe ngrinim trupat e myslimanëve të rënë në fushën e betejës."[112]

Sipas një transmetimi që na është përcjellë nga Umu Atijetu'l-

[110]. Buhari, *Sahih,* 3/1055 (2722).
[111]. Ibn Hibban, *Sahih,* 11/26 (4723).
[112]. Buhari, *Sahih,* 3/1056 (2726).

Ensarijeja (radijallahu anha), thuhet se ajo ka thënë: "Unë kam marrë pjesë në shtatë luftëra bashkë me të Dërguarin e Allahut. Prisja mbi plaçkën e luftëtarëve, u përgatitja atyre për të ngrënë, mjekoja të plagosurit, u qëndroja pranë atyre që ishin të sëmurë e dihej që nuk do të mbijetonin, kujdesesha për ta."[113]

Gratë që kanë shërbyer në luftën e Uhudit

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Në luftën e Uhudit, ushtria e myslimanëve pati dalë e humbur dhe shumica e luftëtarëve qenë shpërndarë. Uallahi, atë ditë, vajzën e Ebu Bekrit, Aishen dhe nënën time, Umu Sulejmin, i kam parë kështu: Kishin përveshur fundin e këmbëve, aq sa kishte filluar t'u dukej kyçi i këmbëve. Mbanin ujë në enë dhe u jepnin luftëtarëve të pinin. Pastaj iknin, i mbushnin prapë ato enë dhe u jepnin luftëtarëve të pinin."[114]

Thalebe bin Ebi Maliku (radijallahu anhu) transmeton kështu: "Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) u pati shpërndarë grave të Medinës tesha prej leshi, por një palë i kishin tepruar. Njëri prej atyre që ishin aty, i pati thënë atij:

- "O Prijësi i Besimtarëve, atë jepjani gruas suaj, Umu Kulthum binti Aliut." Kalifi i myslimanëve, Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "Ummu Selijti e meriton më shumë këtë rrobë, sepse ajo është nga gratë e ensarëve dhe është një prej grave që kanë lidhur besën me të Dërguarin e Allahut. Veç kësaj, Umu Selijti na ka arnuar enët e ujit, kur na shqepeshin."[115]

Hashrexh bin Zijadi transmeton se stërgjyshja e tij i ka transmetuar: "Ne patëm dalë bashkë me Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në luftën e Hajberit. I Dërguari i Allahut na pati pyetur:

- "*Po ju, pse vini bashkë me ne?!*" Dhe ne i dhamë këtë si përgjigje:

- "Vijmë të bëjmë punët tona, të tjerrim leshin, për shembull, dhe t'ju ndihmojmë juve në rrugën e Allahut, si edhe për të mjekuar të plagosurit e luftës."[116]

[113]. Muslim, *Sahih,* 3/1444 (1812).
[114]. Buhari, *Sahih,* 3/1055 (2724).
[115]. Buhari, *Sahih,* 3/1056 (2725).
[116]. Ebu Daud, *Sunen,* 2/82 (2729).

27. KUR GRATË LUFTONIN NË RRUGËN E ALLAHUT ME KUPTIMIN E PLOTË TË FJALËS

Pjesëmarrja e Umu Umaras (r.a.) në Uhud

Umu Sadi (radijallahu anha), e bija e Sad bin Rabias, tregon: "Shkova atje ku ishte Umu Umare (radijallahu anha) dhe i thashë:

- "Teze, a nuk më tregon, si pate luftuar ti në luftën e Uhudit?" Ja se si ma tregoi:

- "Në orët e para të ditës, dola nga çadra, për të parë se çfarë ishin duke bërë njerëzit. Me vete kisha edhe një enë me ujë të pijshëm. Shkova tek i Dërguari i Allahut. Profeti ynë i nderuar gjendej mes sahabëve të tij. Myslimanët ishin në rrugën e fitores. Mirëpo, fati na u kthye përkundër dhe, kur myslimanët pësuan disfatë, unë shkova dhe fillova të luftoja krah për krah me Resulullahun. Përpiqesha ta mbroja me shpatë e me shigjeta, derisa, në fund, u plagosa edhe unë."

Kur i pashë Umu Umaras një shenjë të madhe, si vrimë, në shpatull, vendosa që ta pyesja:

- "Po këtë, kush ta ka bërë?"

- "Ibni Kamia", – më tha dhe vazhdoi të tregonte, – "Allahu e shkatërroftë. Ja se si ndodhi: Atë ditë, disa sahabë u larguan nga Resulullahu dhe Ibni Kamiaja filloi të bërtiste dhe thoshte:

- "Më tregoni ku është Muhamedi, po shpëtoi ai për mua nuk ka më kuptim të jetoj më!" Sakaq, unë dhe disa të tjerë, që nuk ndaheshin kurrë prej Musab bin Umejrit dhe prej të Dërguarit të Allahut, iu hakërryem. Ai burrë më goditi disa herë me shpatë dhe kjo është një nga plagët që më ka ngelur në trup prej atyre goditjeve. Edhe pse e godita edhe unë disa herë me shpatë, nuk arrita dot që ta vrisja, sepse kishte veshur dy parzmore, njëra mbi tjetrën, armiku i Allahut."[117]

Kurse përcjellja që i bën Omeri (radijallahu anhu) kësaj ndodhie është e këtillë:

- "Unë e kam dëgjuar vetë Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur ai ka thënë:

[117]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/470.

- "*Në ditën e Uhudit, sa herë që shikoja ndonjëherë në të djathtë dhe sa herë që shikoja ndonjëherë në të mëngjër, sytë nuk më shihnin vetëm se Umu Umaren* (Nesibe binti Kab)*, që përpiqej të më ruante mua.*"[118]

Safija (r.a.) pati luftuar edhe në Uhud, edhe në Hendek

Sipas transmetimit të Ibni Sadit; në ditën e Uhudit, në çastet që sahabët po përjetonin disfatë, në fushën e luftës hyri Safija (radijallahu anha) me heshtën në dorë; me të godiste idhujtarët në fytyra. Kur e pa i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) se çfarë po bënte, thirri Zubejr bin Auamin, të birin e Safijes, duke i thënë:

- "*Zubejr, mbro nënën.*"

Tregon Abadi: "Safija (radijallahu anha) na i ka treguar ngjarjet që ndodhën kur u strehuan në kështjellën e poetit të Profetit tonë, Hasan bin Thabitit:

"Hassani ishte bashkë me ne, gratë dhe fëmijët. Rreth e përqark kështjellës seç vërtitej një hebre. Në atë kohë, edhe hebrenjtë e fisit të të bijve të Kurejdhas i patën shpallur luftë të Dërguarit të Allahut, ndaj edhe Resulullahu kishte shkëputur çdo marrëdhënie me ta. Prandaj, nëse do të vendosnin të na sulmonin, ne nuk kishim askënd që të na mbronte. I Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe myslimanët po përlesheshin trup me trup me armiqtë dhe ishte e pamundur që të shkëputeshin e të vinin tek ne; në ato çaste ishte e pamundur. Kur, pranë nesh ia behu dikush. E thirra Hasanin dhe i thashë:

- "Shiko Hasan, me sa kam parë, është një hebre që po i vërtitet kështjellës sonë rreth e qark. Uallahi nuk jam e sigurt, por më duket sikur ai po na ruan ne, për të mbledhur informata mirë e mirë, që t'ua çojë mandej hebrenjve të tjerë. Resulullahu dhe sahabët janë të zënë me armikun, kështu që hajde, zbrit njëherë poshtë dhe vrite atë njeri." Hasani më dha këtë përgjigje:

"Të bekoftë Zoti o bija e Abdulmutalibit! Uallahi, ti mund t'ia

[118]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/479.

dalësh fare më mirë se unë kësaj pune, se unë nuk ia dal dot."

Kur ai më tha kështu, atëherë unë e lidha fort belin, mora edhe një dru të trashë me vete dhe zbrita poshtë nga kështjella, e godita atë burrë me trungun e drurit që kisha në dorë dhe ai mbeti i vrarë në vend; kur e pashë se e kisha mbaruar atë punë me sukses, u ktheva prapë në kështjellë. Aty i thashë Hasanit:

- "Hasan, zbrit njëherë poshtë dhe merrja plaçkat atij njeriu. Duke qenë se ishte mashkull, unë nuk mund t'ia merrja."

- "O bija e Abdulmutalibit, po unë nuk kam nevojë për teshat e tij!", – m'u përgjigj Hasani.[119]

Kur Umu Sulejmi (r.a.) mbante edhe kamë me vete, kur merrte pjesë në luftën e Hunejnit

Enesi (radijallahu anhu) ka thënë: "Ebu Talhaja (radijallahu anhu), në ditën e Hunejnit, erdhi pranë të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha:

- "O Resulullah, a e ke parë gjë Umu Sulejmin? Ka marrë edhe kamën me vete!" I Dërguari i Allahut e pyeti Umu Sulejmin:

- "Çfarë kërkon të bësh me këtë?" Umu Sulejmi iu përgjigj:

- "Kur të më afrohet ndonjë nga idhujtarët, do t'ia ngul në bark, andaj e kam marrë me vete." Pasi tha këtë fjalë, i Dërguari i Allahut nisi të qeshë."[120]

Esma binti Jezidi pati vrarë plot nëntë vetë në luftën e Jermukut

Transmetohet nga Muhaxhiri se: "E bija e xhaxhait të Muadh bin Xhebelit, Esmaja, pati hequr shtizën që shërbente si këmbë për çadrën dhe me të pati vrarë plot nëntë vetë nga bizantinët."[121]

---

[119]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/108. Te Bejhekiu është e regjisturar se "Safija është e para grua myslimane që ka vrarë një idhujtar burrë."
[120]. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef,* 7/416 (36937).
[121]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 24/157 (403).

Njerëzve fillon të mos u pëlqejë që gratë e kthyen në zakon të dalët në luftë

Sipas transmetimit që i bën Taberaniu kësaj çështjeje, Ummu Kebsheja, e cila ishte një nga më të rejat e fisit të Beni Kuda'së, vjen te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i kërkon leje të marrë pjesë në luftë, duke i thënë:

- "O Resulullah, a do të më japësh leje, që të dal edhe unë në luftë me aksh tabor?" I Dërguari i Allahut iu përgjigj shkurt:

- "*Jo!*"

Gruaja tha:

- "O Resulullah, unë nuk dua të marr pjesë si luftëtare, por dua të ndihmoj në mjekimin e të plagosurve dhe të sëmurëve!" I Dërguari i Allahut tha:

- "*Sikur të mos kisha shqetësimin se kjo do të bëhet zakon dhe njerëzit do të thonë: 'Aksh grua mori pjesë në luftë!', patjetër që do të të jepja leje. Prandaj, ti ik tani dhe qëndro në shtëpi.*"[122]

Veprime që për gratë janë njësoj sikur të kishin marrë pjesë në luftë

Ibni Abasi (radijallahu anhu) transmeton: Një grua erdhi tek i Dërguari Fisnik (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i tha atij:

- "O Resulullah, mua më kanë dërguar si përfaqësuese gratë. Allahu ua ka shpallur luftën si detyrim vetëm burrave, nga ku ata mund të fitojnë shpërblime të shumta nëse dalin fitimtarë, apo të fitojnë gradën e epërme të të qenët dëshmorë të Zotit kur vriten. Kurse ne, gratë, thjesht merremi me punët e tyre, duke u ardhur në ndihmë për nevojat që mund të kenë ata. Po mirë, po për ne nuk ka vend, që të luftojmë edhe ne në rrugën e Allahut?" Profeti ynë i tha asaj:

- "*Thuaju grave që ke ardhur deri këtu t'i përfaqësosh: 'Edhe të tregosh respekt për të drejtat e burrit, duke i përmbushur ato të gjitha me përpikëri ka të njëjtin shpërblim si edhe lufta. Vetëm se shumë pak nga ju e arrijnë ta bëjnë këtë ashtu siç duhet!*'"[123]

[122]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 25/176 (431).
[123]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 4/560 (7631).

28. PJESËMARRJA E FËMIJËVE NË LUFTË

Kur bie dëshmor Umejr bin Ebi Uekasi (r.a.)

Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) tregon: "Në luftën e Bedrit, para se të vinte Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) për të na kontrolluar, unë pashë vëllanë tim, Umejrin, i cili po orvatej të dukej pak më i madh nga ç'ishte në të vërtetë.

- "Çfarë bën ashtu, vëllai im? Të ka ndodhur gjë?", – e pyeta unë atë.

- "Kam frikë se do të më dallojë i Dërguari i Allahut.", – m'u përgjigj ai. – "Dua të marr edhe unë pjesë në luftë. Kam shumë shpresë, që Allahu të më falë edhe mua mirësinë e të bie edhe unë dëshmor në rrugën e tij." Nëna e tij pati shkuar vetë tek i Dërguari i Allahut, për t'i kërkuar që ai të mos e merrte me vete djalin e saj të vogël, dhe i Dërguari i Allahut e pati kthyer mbrapsht Umejrin. Vëllai qau shumë dhe, kur e pa sesa shumë po qante, atëherë Resulullahu nuk ia prishi qejfin, ndaj, në fund i dha atij lejen që të vinte edhe ai me ne në luftë. Ia lidha unë kaishin e shpatës, sepse Umejri ishte shumë i vogël. Ishte apo nuk ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç kur e vranë dhe ra dëshmor."[124]

[124]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 3/149.

RËNDËSIA QË I JEPNIN SAHABËT FISNIKË UNITETIT DHE PËRBASHKIMIT

Si u kujdesën sahabët që ta ruanin fare të paprekur unitetin dhe bashkimin mes tyre? Si u shmangën ata nga të ngatërruarit me njëri-tjetrin, apo nga rënia në përçarje, ndërsa i ftonin njerëzit dhe luftonin në rrugën e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij?

1. ÇFARË MENDONIN SAHABËT PËR PËRÇARJEN ME NJËRI-TJETRIN

Mendimet e Ebu Bekrit (r.a.) në lidhje me këtë temë

Na e transmeton Ibni Is'haku: "Pasi ishte ndarë nga jeta Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), sahabët po diskutonin me njëri-tjetrin rreth çështjes së përçarjes në kuvendin e fisit të Beni Saides, të cilët ishin prej ensarëve dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu) pati thënë këto fjalë lidhur me këtë temë:

"Nuk është e lejuar që mbi kryet e myslimanëve të qëndrojnë dy imamë njëherësh. Në raste të tilla, punët dhe gjykimet e myslimanëve nisin të dyzohen, prishet uniteti dhe mes tyre fillojnë të shfaqen mosmarrëveshje dhe ngatërresa nga më të ndryshmet. E, për rrjedhojë,

njerëzit zënë të braktisin traditën profetike (sunetin), shfaqen gjëra të reja, që nuk kanë ekzistuar ndonjëherë më parë në fe dhe mendimet ngatërrestare sa vijnë e shtohen më shumë. Me një fjalë, nuk ka asnjë kuptim dhe nuk i bën askujt dobi, që ne të vazhdojmë të këmbëngulim në një çështje si kjo e udhëheqjes së vendit nga dy prijës të ndryshëm njëherësh!"[1]

Fjalët e Omerit (r.a.) për këtë çështje

Salim bin Ubejdi përcjell se: "Atëherë kur po diskutohej çështja e lidhjes së besës me Ebu Bekrin (radijallahu anhu), njëri prej ensarëve u hodh dhe tha:

- "Le të ketë dy imamë, njëri të jetë nga ne dhe njëri të jetë nga ju muhaxhirët." Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi propozimin dhe i dha këtë përgjigje këtij njeriu:

- "Ashtu siç është e pamundur që dy shpata të qëndrojnë në të njëjtin mill, pa u përkuar me njëra-tjetrën, po aq e pamundur është edhe që të merren vesh mirë me njëri-tjetrin dy imamë!"[2]

Qasjet e Abdullah bin Mesudit (r.a.) lidhur me këtë çështje

Abdullah bin Mesudi (radijallahu anhu) ka thënë këto fjalë:

"O njerëz! Bindjuni drejtuesve që ju janë caktuar mbi krye e mos u ndani nga bashkësia; sepse bashkësia (xhemati) është litari i Allahut. Allahu ju ka urdhëruar ju që të mbaheni fort pas atij litari. Ato gjëra që nuk ju pëlqejnë në mesin e xhematit janë shumë herë më të mira sesa ato gjëra që do t'ju pëlqenin e ju të ishit të përçarë me njëri-tjetrin. Allahu i Madhërishëm (xhel'le xhelaluhu) ka caktuar një fund për çdo krijesë që ka krijuar. E ardhmja e Islamit është e ndritur dhe ajo tashmë është fiksuar fort! Nuk do të zgjasë shumë dhe Islami do të mbërrijë në majat e caktuara për të. Mandej, deri kur të vijë Kiameti, herë do të forcohet e herë do të dobësohet. Tregues të dobësisë janë varfëria dhe skamja. Ka për të ardhur një ditë, që skamja do të thellohet aq shumë, saqë një i varfër nuk do të gjejë dot askënd, të cilit do të

[1]. Bejheki, *Sunen,* 8/145 (16327).
[2]. Bejheki, *Sunen,* 8/145 (16326).

mund t'i kërkojë ndihmë. Kurse i pasuri do të mendojë se ajo pasuri që ai ka nuk i mjafton as për veten. Njeriu do t'ia tregojë vuajtjen dhe vështirësinë e vet të vëllait, apo djalit të xhaxhait, por ata nuk do t'i vijnë në ndihmë. Lypësi do ta mbajë dorën të zgjatur, duke kërkuar diçka, por askush nuk do t'i vërë asgjë në dorë. Pasi të ndodhin të gjitha këto, nga toka do të dëgjohet një zë buçitës. Të gjithë do të mendojnë se ai zë erdhi vetëm në zonën e vet. Pastaj, Toka do të gjejë qetësinë, ashtu siç do të dojë vetë Allahu i Madhërishëm. Pas kësaj periudhe të qetësisë, rruzulli tokësor do t'i nxjerrë jashtë gjithë ç'mban brenda saj."

- "O Eba Abdurrahman, çfarë do të thuash me 'gjithë ç'mban brenda saj?'", – e pyetën ata që ishin të pranishëm dhe Abdullah bin Mesudi u ka dhënë atyre këtë përgjigje:

- "Damarët e arit dhe të argjendit! Megjithëse, që prej asaj dite e deri në ditën e Kiametit as ari, as argjendi nuk do të përftojnë kurrfarë dobie."[3]

Ibni Mesudi (r.a.): "Përçarja është vetë e keqja!"

Nga Katadeja (radijallahu anhu) na është transmetuar: "Si Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ashtu edhe Ebu Bekri, Omeri, por edhe Osmani (radijallahu anhum) në fillimet e kalifatit të tyre, kur ishin në Mekë dhe në Mina, meqenëse ishin udhëtarë, ata i falnin namazet e detyruara me nga dy rekate në secilën kohë të namazit. Më vonë, Osmani (radijallahu anhu) filloi t'i falë ato me nga katër rekate. Kur kjo gjë erdhi në vesh të Ibni Mesudit (radijallahu anhu), ai tha njëherë '*Inna lil'lahi ue inna ilejhi raxhiun*', dhe filloi edhe ai t'i falë namazet e detyruara me nga katër rekate. Kur e pyetën:

- "Po ti, edhe e gjykove edhe vetë namazin po e fal po me katër rekate; si do të na e shpjegosh, pse e bën këtë?" Atëherë, Ibni Mesudi u dha atyre këtë përgjigje:

- "Përçarja është vetë e keqja!"[4]

---

[3]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 7/634 (12457).
[4]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 8/411 (22759).

Aliu (r.a.): "Unë e urrej përçarjen."

Na është transmetuar se Aliu (radijallahu anhu) ka thënë: "Namazet t'i falni njësoj siç i keni falur gjer më tani, sepse mua nuk më pëlqen përçarja. Ashtu siç populli nuk u copëtua e nuk u përça asnjëherë më parë, në kohën e shokëve të mi, po ashtu, derisa të vdes unë, myslimanët do të vazhdojnë të jetojnë në unitet dhe të përbashkuar!"[5]

Sulejman bin Kajs el-Amiriu tregon se: "Ibnu'l-Keuaja, i cili ishte nga paria e Harixhijve, shkoi tek Aliu (radijallahu anhu) dhe e pyeti për domethënien e fjalëve "sunet, bidat, xhemat dhe përçarje mes myslimanëve". Aliu (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- "Shiko, o Ibnu'l-Keua, mbaje mend e fiksoje mirë përgjigjen, ashtu siç e ke mësuar mirë përmendësh edhe domethënien e këtyre fjalëve që po më pyet. Ajo që ti e quan sunet, uallahi, është rruga e Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Bidat do të thotë të largohesh prej asaj rruge. Xhemat, uallahi, do të thotë, që edhe pse mund të përbëjnë pakicën, ata qëndrojnë të bashkuar, pa u ndarë nga e drejta dhe janë gjithmonë në anën e atyre që kanë të drejtë. Ndërsa, përçarje, do të thotë që edhe pse mund të jenë në anën e atyre që janë më të shumtë në numër, të bëhesh bashkë me ata që mbajnë anën e asaj që është e rreme!"[6]

2. QËNDRIMET E SAHABËVE PËR ÇËSHTJEN E KALIFATIT PAS NDARJES NGA JETA TË PROFETIT TONË TË NDERUAR

Bashkimi në një mendje i sahabëve tanë (r.a.) se kalifatin duhet ta merrte Ebu Bekri (r.a.)

Nga Urue bin Zubejri (radijallahu anhu) na është transmetuar se: "Kur u nda nga kjo jetë Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Ebu Bekri (radijallahu anhu) doli nga shtëpia e tij në lagjen e Sunhut (Në rrethinat e Medinës gjendeshin disa mëhalla, të cilat kishin marrë emrin e përbashkët Auali. Sunhi është emri i vetëm njërës prej tyre.), i hipi kalit dhe erdhi në Medinë, duke zbritur mu te porta e

[5]. Buhari, *Sahih,* 3/1359 (3504).
[6]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 1/574 (1644).

xhamisë. Dukej, ishte i shqetësuar. Kërkoi leje të hynte në dhomën e vajzës së tij, Aishes (radijallahu anha). Aishja (radijallahu anha) i dha leje. Kur hyri Ebu Bekri (radijallahu anhu), Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte aty, i shtrirë mbi jastëk. Edhe gratë e tij ishin ulur në anën e tij. Ebu Bekri (radijallahu anhu) e ngriti mbulesën prej fytyrës së bekuar të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), u përkul në gjunjë, e puthi atë në ballë (mu midis dy vetullave) dhe duke qarë tha:

- "Omeri nuk di se ç'flet! I Dërguari i Allahut ka vdekur, unë i betohem Allahut (xhel'le xhelaluhu) që e ka në dorë shpirtin tim, se ka vdekur! O Resulullah, mëshira e Allahut qoftë mbi ty. Sa të bukur e ke edhe vdekjen, ashtu siç kishe edhe jetën!" Pastaj, ai e mbuloi edhe njëherë fytyrën e bekuar të të Dërguarit të Allahut. Fill pas saj, doli me nxitim në drejtim të xhamisë dhe sikur të ishte duke kërcyer mbi shpatullat e njerëzve doli përpara të gjithëve, në anën e minberit. Omeri (radijallahu anhu), kur e pa se Ebu Bekri (radijallahu anhu)po shkonte drejt tij, u ul. Ebu Bekr Besniku qëndroi aty, ndanë minberit dhe filloi t'i fliste bashkësisë që ishte mbledhur aty me zë të lartë. Njerëzit u afruan edhe më shumë duke u ngjeshur me njëri-tjetrin. Zhurmat e zërave u ndërprenë, sepse njerëzit u dhanë fund bisedave kalimtare që ishin duke bërë. Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha këto fjalë:

"O njerëz! Allahu e mori pranë Vetes Profetin e Tij. Mirëpo, Allahu është i Përjetshëm, Ai është në mesin tuaj. Ejani në vete, kjo është vdekja; askush prej jush nuk do të shpëtojë prej saj, e të mbetet i gjallë. I vetmi që do të jetë përherë i gjallë është Allahu! Mandej, ai u këndoi atyre ajetin:

"**Muhamedi është vetëm i Dërguar, para të cilit ka pasur edhe të dërguar të tjerë. Nëse ai vdes ose vritet, a mos do të ktheheni ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, nuk i bën kurrfarë dëmi Allahut. Dhe Allahu do t'i shpërblejë falënderuesit.**" (Al 'Imran, 3/144)

Omeri (radijallahu anhu) e tregon kështu, se si është ndierë atë ditë:

- "Uallahi, derisa Ebu Bekri këndoi atë ajet nga sureja "Al 'Imran", unë nuk e besoja se Profeti kishte ndërruar jetë. Sikur ta kisha harruar

fare, që ai ajet ishte zbritur kohë përpara asaj dite!"

Veç tij, në ligjëratën që mbajti, Ebu Bekri këndoi edhe disa ajete të tjera, një e nga një:

"**Sigurisht që edhe ti** (o Muhamed) **do të vdesësh një ditë e, sigurisht edhe ata do të vdesin.**" (Zumer, 39/30)

"**Mos adhuro zot tjetër, krahas Allahut! S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij! Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës** (Ekzistencës) **së Tij! Atij i përket vendimi dhe tek Ai do të ktheheni të gjithë!**" (Kasas, 28/88)

"**Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra** (Ekzistenca) **e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.**" (Rahman, 55/26-27)

"**Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t'u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i Xhehenemit dhe hyn në Xhenet, ai ka fituar** (gjithçka që mund të dëshirohet)**. Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.**" (Al 'Imran, 3/185)

Pasi këndoi njëherë këto ajete, Ebu Bekri (radijallahu anhu) vijoi t'u thoshte besimtarëve këto fjalë:

"Besimtarë! Allahu i dha jetë Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), për aq kohë sa Ai ta nxirrte fitimtare fenë e Tij, duke u shpallur të gjithë njerëzve mesazhet e përjetshme të Allahut. E, tani që ai i përplotësoi të gjitha këto detyra hyjnore, Allahu e mori pranë Vetes shpirtin e tij. Muhamedi (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ju la ju në një rrugë të gjerë e të hapur. Ata që do të zvarriten drejt shkatërrimit janë ata që do të zgjedhin të rremen pasi ka ardhur Muhamedi dhe Kur'ani Famëlartë. Kushdo që njeh Allahun si Zot, ta dijë mirë, se Allahu është i Gjallë, Ai është Jetëdhënësi, e nuk vdes. E, kushdo që gjer më sot ka adhuruar Muhamedin, duke e ngritur atë drejt ndonjë shkalle hyjnore, kjo nuk ka më dyshim, ai ka vdekur!

O njerëz! Kijeni frikë Allahun dhe lidhuni fort pas fesë suaj, besojini Zotit. Feja e Allahut është e shëndoshë, në këmbë dhe e palëkundur. Fjala e Tij u plotësua dhe Allahu gjithmonë ka për të qenë ndihmëtari më i madh i atyre që ndihmojnë fenë e Tij. Ai do ta lartësojë fenë e Tij. Ne Fjalën e Allahut e kemi tashmë në mesin tonë. Ajo është vetë

drita, ajo është vetë shërimi. Allahu, Profetit tonë të nderuar, me atë, me Librin, ia tregoi rrugën e së drejtës dhe të së vërtetës, e brenda tij gjenden të shkruara, si ato që janë të lejuara, ashtu edhe ato që janë të ndaluara. Uallahi, mos ua vini veshin atyre që do të ngrenë krye ndaj nesh. Shpatat e Allahut kanë dalë njëherë prej millit dhe ne nuk na ka hije që t'i fusim prapë në të e të tërhiqemi. Ne do të vazhdojmë të luftojmë me ata që dalin kundër nesh, njësoj siç kemi luftuar deri më sot, krah për krah me të Dërguarin e Allahut. Ata që dalin kundër nesh, nuk do t'i bëjnë keq askujt përveçse vetes së tyre."

Ebu Bekri (radijallahu anhu) e përfundoi fjalën e tij dhe zbriti nga minberi, për të shkuar, bashkë me muhaxhirët, pranë xhenazes së të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).[7]

Ligjërata e Omerit (r.a.) dhe besëlidhja e përbashkët e sahabëve ndaj Ebu Bekrit (r.a.)

Sipas transmetimit, Enesi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Në ditën e dytë pas ndarjes nga jeta e Profetit tonë, Omeri (radijallahu anhu) u ngjit në minber dhe mbajti një ligjëratë (hutbe) përpara besimtarëve. Në atë kohë aty ishte i pranishëm edhe Ebu Bekri, mirëpo po ruante qetësinë dhe nuk tha asgjë. Omeri foli kështu:

"Unë vetë shpresoja që Profeti ynë do të vdiste pas të gjithëve ne. Edhe pse Muhamedi (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) nuk është më mes nesh, Allahu është i Përhershëm! Ai ju ka lënë juve pas një dritë që do t'jua ndriçojë pandërprerë rrugën e jetës. Allahu (xhel'le xhelaluhu), pikërisht me këtë dritë e pati udhëzuar edhe Muhamedin. Ebu Bekri është shoku më i mirë i Profetit tonë, sepse ai ishte i dyti i dy personave që ishin bashkë në shpellë. Në mesin e të gjithë myslimanëve, nuk ka tjetër që të jetë më i denjë dhe që ta meritojë më shumë sesa ai udhëheqjen e jetës dhe të punëve. Çohuni dhe lidhni besën me të!"

Pak çaste para se të mbante këtë fjalë Omeri (radijallahu anhu), besën e kishin lidhur edhe një bashkësi nga kuvendi i bashkësisë së Beni Saides. Ndërsa, besëlidhja e përgjithshme u mbajt te shkallët e minberit. Pastaj, (pasi kishte mbaruar hutben) Omeri iu drejtua Ebu

[7]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/243.

Bekrit duke i thënë:

- "Ngjitu lart, në minber!", – me këmbëngulje. Më në fund, Ebu Bekri u ngjit mbi minber dhe populli i shprehu atij lidhjen e besës, duke e konsideruar atë, tani e tutje, imamin e kalifin e tyre."[8]

Betimi ndaj Ebu Bekrit (r.a.) në kuvendin e Beni Saides

Enesi (radijallahu anhu) ka thënë kështu: "Ebu Bekri (radijallahu anhu), në ditën e dytë pas lidhjes së besës me të, u ngjit mbi minber dhe u ul. Ende pa e nisur mirë fjalën Ebu Bekri, Omeri (radijallahu anhu) u ngrit në këmbë. Pasi e lëvdoi Allahun e Madhërishëm me cilësitë më të denja të Tij, tha këto fjalë:

- "O njerëz! Dje, unë ju pata thënë juve disa gjëra. Ato nuk janë as në librin e Allahut, as ndër ato porosi që na i ka lënë trashëgim i Dërguari i Allahut të gjithëve ne. Megjithatë, unë kam pandehur gjithmonë se i Dërguari i Allahut do të shkonte në atë botë kohë pas nesh. Allahu ju ka lënë në mesin tuaj librin e Tij. Edhe Muhamedin, me të e pati udhëzuar në rrugën e drejtë. Nëse ju kapeni e përqafoheni fort pas tij, atëherë, nuk ka dyshim, se Allahu do t'ju udhëzojë edhe ju në rrugën e drejtë, njësoj siç pati udhëzuar në të drejtën e në të vërtetën edhe Muhamedin. Allahu i Madhërishëm misionin tuaj e ngarkoi mbi shpatullat e Ebu Bekrit, shokut të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), të atij që ishte i dyti i atyre të dyve që gjendeshin në shpellë. Ngrihuni tani dhe lidhni besën me të."

Kësisoj, njerëzit u ngritën dhe lidhën besën me Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Pas mbledhjes së kuvendit në ballkonet e Beni Saides, u krye betimi i përgjithshëm i njerëzve. Menjëherë pas kësaj, Ebu Bekri u çua dhe pasi lëvdoi Allahun, duke e përmendur me cilësitë e Tij, ai iu drejtua njerëzve me këto fjalë:

- "O njerëz! Megjithëse unë nuk jam më i virtytshmi ndër ju, ju më zgjodhët mua për t'jua drejtuar punët. Nëse sillem mirë dhe veproj drejt me ju, ju lutem më ndihmoni; nëse sillem keq, atëherë tregomëni rrugën e drejtë. E drejta dhe e vërteta janë amanet, ndërsa gënjeshtra

[8]. Buhari, *Sahih,* 6/2639 (6793).

nuk është asgjë veçse tradhti. Ai që është i dobët ndër ju, në krahun tim do të jetë i fortë e i fuqishëm, dhe, dashtë Zoti, që unë t'ia kthej të drejtat që i ka shkelur i forti. Ashtu siç edhe ai që është i fortë mes jush, në sytë e mi është fare i dobët dhe, dashtë Zoti, unë do t'ia marr hakun e të dobëtit prej tij. Të mos e braktisni luftën, sepse Allahu e lë të zhytur në poshtërim atë popull që braktis përpjekjet dhe luftën në rrugën e Allahut. Nëse në mesin e një populli fillon të përhapet imoraliteti gjerësisht, atëherë Allahu i dërgon fatkeqësi të gjithë atij populli. M'u bindni mua për aq kohë sa unë do t'i bindem Allahut dhe të Dërguarit të Tij. E, nëse unë ngre krye dhe kundërshtoj Allahun dhe të Dërguarin e Tij, atëherë nuk ka nevojë që të më bindeni. Tani, ejani çohuni të falim namazin! Allahu ju mëshiroftë."[9]

Një tjetër transmetim lidhur me besëlidhjen në kuvendin e Beni Saides

Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Kur njerëzit filluan të flisnin për ndarjen nga jeta të Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), neve na erdhi një lajm: "Ensarët janë mbledhur në ballkonet e bijve të Saides; po lidhin besën me Sad bin Ubaden!" - Pas këtij lajmi, ne, unë, Ebu Bekri dhe Ubejde bin Xherrahu, u çuam dhe u vumë në rrugë për të shkuar atje. Ishim të shqetësuar se mos mes myslimanëve lindte ndonjë ngatërresë. Në rrugë rastisëm Uejm bin Saiden dhe Man bin Adijin, të cilët ishin prej ensarëve. Të dy njiheshin si burra të drejtë. Ata na pyetën:

- "Për ku jeni nisur kështu?"

- "Po shkojmë për te njerëzit tuaj, se na kanë ardhur ca fjalë për ta." Ata na u përgjigjën:

- "Kthehuni pas! Më kot e keni, ata nuk bëjnë asgjë kundër jush; nuk guxon askush të bëjë diçka që nuk do t'ju pëlqejë juve."

Ne vazhduam rrugën. Duke qenë se unë kisha menduar të flisja atje, në mendje po bluaja disa mendime që doja t'i shprehja medoemos. Mbërritëm, më në fund, tek ensarët. Pamë njëherë, ensarët ishin

[9]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 5/248.

mbledhur mbi kryet e Sad bin Ubades. Sadi ishte shtrirë mbi një rrobë të ngritur pakëz lart. Kur ne hymë, ensarët filluan të na flisnin:

- "O njerëz të Kurejshit, le të ketë një prijës nga ju, një prijës nga ne."

Hubab bin Mundhiri:

- "Unë jam njësoj si trungu i shëndoshë i hurmës, ku qasen devetë për t'u kruar, që të gjejnë rehat, me një fjalë, sa herë që njerëzit kanë ndonjë shqetësim, ata vijnë tek unë; unë përpiqem t'u gjej zgjidhje problemeve të tyre. Uallahi, o banorë të Eusit, po deshët, të bëjmë edhe njëherë një luftë të madhe."

Ebu Bekri (radijallahu anhu):

- "Ndaluni pak, mos u nxitoni." Edhe pse u përpoqa edhe unë të merrja fjalën, Ebu Bekri më tha:

- "Omer, ti hesht!", – pastaj lëvdoi dhe përgëzoi emrin e Allahut dhe u tha ensarëve:

- "O ensarë! Uallahi, askush nga ne nuk i mohon dot virtytet që ju keni, apo vendin e veçantë që zini ju në fenë islame, e aq më pak nuk i mohojmë dot ato që ne ju detyrohemi. Mirëpo, edhe ju, e dini mjaft mirë, se askush nuk e mohon dot vendin që zënë kurejshët ndër fiset e arabëve dhe arabët vetëm rreth dikujt që i përket fisit të Kurejshit do të mblidheshin e do të qëndronin të përbashkuar. Ne jemi prijës, ndërsa ju do të jeni ndihmësit e përfaqësuesit tanë në çdo punë. Kijeni frikë Allahun. Mos e përçani Islamin. E mos u bëni ju ndër ata që do të sjellin përçarjen e parë në Islam. Më dëgjoni me kujdes. (Dhe duke bërë me shenjë nga unë dhe Ebu Ubejde bin Xherrahu) Unë dua që ju t'i bindeni njërit nga këta të dy. Lidheni besën me kë të doni prej këtyre të dyve, sepse të dy janë besnikë dhe tejet të zotë."

Ebu Bekri, atë ditë, hiq fjalinë e fundit, i preku të gjitha ato që doja të thosha edhe unë. I betohem Allahut, se po të mos bëhej shkas për kryengritje, do të doja që më mirë të vritesha, pastaj të ringjallesha, pastaj të vritesha prapë e pastaj të ringjallesha prapë, sesa të bëhesha prijës i një populli, në mesin e të cilit do të ishte edhe Ebu Bekri. Mandej u çova unë dhe u thashë:

- "O bashkësi e ensarëve, o bashkësi e myslimanëve! Ai që e

meriton më së shumti t'i prijë misionit të të Dërguarit të Allahut, pas Resulullahut, është Ebu Bekri, që ishte bashkë me të në shpellë gjatë mërgimit, që është më i pari për të bërë mirë dhe që është edhe më i vjetri ndër ju.", – dhe, sakaq, e mora dorën e Ebu Bekrit, mirëpo Beshir bin Sadi nga ensarët u tregua më i shkathët dhe e përplasi më përpara dorën mbi dorën e Ebu Bekrit, për të lidhur besën me të."[10]

3. SAHABËT SJELLIN EBU BEKRIN (r.a.) NË KRYE TË KALIFATIT DHE NUK U LËNË SHKAS PËRÇARJES DHE PËRPLASJEVE

Vlerësimi i Ebu Ubejdes për kalifatin e Ebu Bekrit (r.a.)

Ebu Bekri (radijallahu anhu) i dërgoi Ebu Ubejdes këtë njoftim:

- "Eja, të të vendos ty në krye të kalifatit, sepse unë e kam dëgjuar vetë Resulullahun (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) që ka thënë: "*Çdo popull i një profeti ka njeriun e sigurt e besnik të vetin. O Ubejde, më i sigurti i popullit tim je ti!*" Ndërsa Ebu Ubejdeja i ktheu atij këtë përgjigje:

- "Unë nuk dal kurrsesi përpara atij që Resulullahu e ka urdhëruar të na prijë neve të gjithë në namaz."[11]

Mendimi i Osmanit (r.a.)

Humrani ka transmetuar se Osman bin Afani (radijallahu anhu) ka thënë kështu:

-"Ebu Bekri e meriton më shumë se kushdo kalifatin, sepse ai është besniku, i dyti i dy vetëve të shpellës dhe shoku i rrugës së mërgimit i të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem)."[12]

Një bisedë e zhvilluar mes Aliut (r.a.) dhe Ebu Sufjanit rreth kalifatit të Ebu Bekrit (r.a.)

Suejd bin Gafleja (radijallahu anhu) transmeton: "Ebu Sufjani

[10]. Ibn Kethir, *Sire,* 4/486.
[11]. El-Hindi, *Kenzu'l-Umal,* 5/854 (14117).
[12]. El-Hindi, *Kenzu'l-Umal,* 5/862 (14142).

erdhi tek Aliu (radijallahu anhu), i cili në atë kohë ishte me Abasin (radijallahu anhu) dhe i tha:

- "O Ali dhe ti, o Abas! Pse kalifati është duke kaluar në duart e fisit më të dobët e më të vogël në numër të Kurejshit? Uallahi, po deshët ju, unë mund ta mbush gjithë Medinën me kalorës dhe luftëtarë, gati për t'u sulur mbi Ebu Bekrin." Atëherë, Aliu (radijallahu anhu) i dha Ebu Sufjanit këtë përgjigje:

- "Uallahi, punë që nuk bëhet! Nuk dua ta mbushësh Medinën me kalorës dhe luftëtarë, e aq më pak që të sulmojmë Ebu Bekrin, sepse, nëse ne nuk do ta kishim parë Ebu Bekrin si të denjë për këtë punë, atëherë nuk e linim që ta merrte ai në dorë kalifatin. O Ebu Sufjan! Islami është i vetmi popull që përbëhet nga besimtarë, të cilët sillen ngrohtë e me sinqeritet karshi njëri-tjetrit, e që nuk duan vetëm se të mirën për të tjerët. Besimtarët, edhe sikur të jenë larg në distancë, ata duhen me njëri-tjetrin. Krejt ndryshe, hipokritët, ata janë, që edhe pse mund të jenë shumë afër njëri-tjetrit, ata e mashtrojnë shoku-shokun dhe përpiqen si e si ta rrëzojnë vëllanë e tyre."[13]

Sipas një tjetër transmetimi, Aliu (radijallahu anhu) i është përgjigjur kështu Ebu Sufjanit:

- "Ti ke qenë për një kohë të gjatë armik i Islamit dhe i ndjekësve të tij! Mirëpo, ajo armiqësia nuk u bëri asnjë dëm as Islamit, as ndjekësve të tij. Ebu Bekrin e pamë ne të denjë për pozicionin e kalifit të mbarë myslimanëve!"[14]

Një bisedë e zhvilluar mes Omerit (r.a.) dhe Halid bin Saidit (r.a.) lidhur me zgjedhjen si kalif të Ebu Bekrit (r.a.)

Tregon Sakhri, rojtari i të Dërguarit të Allahut: "Halid bin Said bin Asi (radijallahu anhu) ishte në Jemen kur Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishte ende në jetë. Atje ishte edhe kur u nda nga jeta i Dërguari i Allahut. Një muaj pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, ai u kthye për në Medinë dhe mbi trup kishte hedhur një xhybe prej mëndafshi. Atje ai u takua me Omerin dhe Aliun (radijallahu

[13]. El-Hindi, *Kenzu'l-Umal,* 5/863 (14144).
[14]. Ibn Abdi'l-Berr, *el-Istiab,* 1/298.

anhuma). Omeri (radijallahu anhu) po u fliste atyre që i kishin vajtur nga pas:

- "Grisjani këtij këtë xhybe! Çfarë ka veshur kështu, mëndafsh ka veshur? Si guxon ky të veshë mëndafsh tani që jemi në kohë lufte, kur mëndafshi ne na është ndaluar që ta veshim edhe kur jemi në kohë paqeje?" Kështu, ata u bënë bashkë dhe ia grisën xhyben Halidit. Halidi iu drejtua Aliut (radijallahu anhu):

- "O Ebu'l-Hasen, dhe ju o bijtë e Abdi Menafit! Ç'ju ka gjetur kështu, dolët të humbur në çështjen e zgjedhjes së prijësit?" Aliu (radijallahu anhu) tha:

- "Po ti, si e sheh këtë çështje, si një çështje të të dalit i fituar ose i humbur, apo si një çështje të kalifatit të mbarë myslimanëve?" Halidi:

- "O bijtë e Abdi Menafit! Po kush e meriton më shumë se ju atë detyrë!" Atëherë, Omeri (radijallahu anhu)iu drejtua Halidit, duke i thënë:

- "Zoti ta marrtë atë shpirt! Uallahi, edhe sikur t'i thoshte një gënjeshtar kësi fjalësh, si këto që thua ti, vetëm vetes do t'i bënte dëm!"[15]

Një ngjarje e ndodhur mes Ebu Bekrit dhe Halid bin Saidit (r.a.)

Vajza e Halid bin Saidit, Umu Halidi tregon: "Pasi u krye besëlidhja me Ebu Bekrin, në Medinë erdhi babai, i cili asokohe ishte në Jemen, e iu drejtua Aliut dhe Osmanit (radijallahu anhuma):

- "O bijtë e Abdi Menafit! Si ndiheni tani, jeni të kënaqur që erdhën të tjerët dhe jua morën misionin e kalifatit?" Omeri (radijallahu anhu) ia përçoi Ebu Bekrit (radijallahu anhu) këto fjalë, mirëpo ai as nuk ia përplasi në fytyrë ato fjalë, e as nuk e gjykoi pse i kishte thënë. Kaluan plot tre muaj dhe Halidi nuk e kishte lidhur ende besën me Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Derisa, një ditë, në drekë, në shtëpinë e Halidit erdhi vetë Ebu Bekri (radijallahu anhu). Halidi e pyeti:

- "Do që unë të lidh besën me ty?" – Dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu)iu përgjigj:

[15]. Taberi, *Tarih,* 2/331.

- "Patjetër, se dua që t'u bashkohesh edhe ti gjithë myslimanëve të tjerë."

- "Po mirë, atëherë, unë po vij në xhami pas dreke, që të lidh besën me ty." Kur Halidi erdhi në xhami, Ebu Bekri (radijallahu anhu) qëndronte i ulur në minber: aty u betua Halidi ndaj kalifit të ri të myslimanëve.

Mendimet që kishte Ebu Bekri për Halidin ishin shumë të mira dhe ai e vlerësonte shumë babanë. Kur dërgoi ushtritë në drejtim të Sirisë, ai e pati vendosur atë në krye të ushtrisë së myslimanëve, madje ia pati sjellë vetë, me duart e tij, flamurin e Islamit. Omeri (radijallahu anhu) pati dalë kundër zgjedhjes së Halidit si komandant:

- "Ebu Bekr, mora vesh se si komandant ke zgjedhur Halidin, mirëpo ti e di shumë mirë se çfarë ka thënë ai për ty.", – madje, këmbënguli për një kohë shumë të gjatë në kundërshtimin e tij. Pas kësaj, Ebu Bekri (radijallahu anhu)dërgoi te Halidi Ebu Erua ed-Deusi. Ebu Erua ed-Deusi i tha Halidit:

- "Kalifi i të Dërguarit të Allahut thotë që të na e kthesh flamurin që të ka sjellë." Halidi e nxori flamurin dhe teksa po ia dorëzonte Ebu Erua ed-Deusit, i dërgoi Ebu Bekrit këto fjalë:

- "Uallahi, t'ju them të vërtetën, nuk u gëzova aspak kur u zgjodha komandant, ndaj as lirimi nga detyra nuk më mërzit aspak. Unë e di, nuk je ti që e bën këtë, por tjetërkush."

Më kujtohet fare mirë, te babai pati ardhur vetë Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe me ngulm e pati porositur që të mos thoshte asnjë fjalë të keqe për Omerin (radijallahu anhu). Uallahi, edhe babai, derisa vdiq, nuk tha veçse fjalë të mira për Omerin."[16]

Orvatja e Ebu Bekrit për të marrë pjesë edhe vetë në luftë dhe qortimi i Aliut (r.a.) për këtë

Aishja (radijallahu anha) tregon: "Babai kishte veshur shpatën, kishte hipur mbi kalë dhe u nis për rrugë drejt Dhu'l-Kasasë. Aty

[16]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/847 (14098).

erdhi Ali bin Ebi Talibi (radijallahu anhu), e kapi kalin e babait nga frerët dhe i tha:

- "Për ku je nisur kështu, o kalif i të Dërguarit të Allahut! Unë do të të kujtoj ato fjalë që Resulullahu t'i pati thënë atë ditë që u zhvillua lufta e Uhudit: '*Vëre në mill shpatën, që të mos na vijë ndonjë fatkeqësi as ty, as ne bashkë me ty!*' O kalifi i të Dërguarit të Allahut! Unë i betohem Allahut, se po të humbëm ty dhe na gjen ndonjë e keqe, atëherë Islamin e kaplon anarkia dhe përçarja!" Ky qortim i Aliut (radijallahu anhu) e bëri babanë të kthehej pas dhe ta dërgonte ushtrinë vetëm në luftë."[17]

Kur Ebu Bekri (r.a.) do që ta kthejë pas detyrën e ngarkuar të kalifatit

Ebu Bekri (radijallahu anhu), gjatë një ligjërate që pati mbajtur me xhematin, u pati thënë atyre:

- "O njerëz! Nëse ju pandehni se unë e mora përsipër këtë detyrë të kalifatit se e ndiej veten më të lartë se ju, apo se të gjithë myslimanët e tjerë, atëherë ta dini se gaboheni! Jo, uallahi! Unë i betohem Allahut, se unë nuk e mora përsipër këtë barrë të të qenët kalif i mbarë myslimanëve nga dëshira, apo ngase e shihja veten time sipër jush. Nuk e kam pasur kurrë ambicien për të qenë kalifi juaj, as edhe për një ditë të vetme. Kam Allahun dëshmitar, që nuk e kam kërkuar diçka të tillë as haptazi, as në fshehtësi. Mbi supe m'u lëshua një barrë shumë e rëndë, që e kapërcen disa herë fuqinë e shpatullave të mia, e i mjeri unë, jam i mbaruar sikur të mos kem ndihmesën e Allahut. Tani, unë, këtë detyrë të të qenët kalif i të Dërguarit të Allahut dua që ta marrë përsipër njëri prej sahabëve, të cilin e di që do të sillet me ju me drejtësi! Tanimë, ja ku po jua them, unë jua kam kthyer pas detyrën e kalifatit. Ju nuk keni më besëlidhje me mua. Atë mund t'ia ngarkoni kujt të doni. Këtej e tutje, unë jam njësoj si ju, njëri prej jush!"

Përgjigjja që i dhanë sahabët Ebu Bekrit (r.a.)

Isa bin Atijeja tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu), një ditë pasi

[17]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/871 (14166).

njerëzit i kishin dhënë besën, mbajti një ligjëratë ndaj njerëzve, ku, ndër të tjera, ai u tha atyre:

- "O njerëz! Unë e zhbëra besën që ju më dhatë, sepse unë nuk jam më i miri nga ju, andaj, unë them që ju duhet të lidhni besën me atë që është më i miri dhe më i mbari në mesin tuaj."

Pas këtyre fjalëve të tij, xhemati u ngrit në këmbë dhe thanë:

- "O kalif i të Dërguarit të Allahut! Të betohemi, në mesin tonë ti je më i miri dhe më i mbari!" Ebu Bekri, i dëgjoi ato fjalë dhe tha:

- "O njerëz! Njerëzit e pranuan Islamin dhe u bënë myslimanë, me dëshirë ose pa dëshirë. Megjithatë, tani ata kanë të gjithë mbrojtjen e Allahut. Përpiquni, që Allahu të mos ju kërkojë llogari për njëri-tjetrin, për shkak të detyrave që ju ka ngarkuar. Unë kam me vete një djall që më shoqëron gjatë gjithë kohës e që nuk më ndahet për asnjë çast. Prandaj, më qëndroni larg sa herë që të shihni se jam i nevrikosur, në mënyrë që të mos ju rëndoj.

O njerëz! Pyetni mirë për plaçkën dhe pasurinë që do t'ju sjellin skllevërit tuaj, sepse një trup që ushqehet me pasuri të ndaluar nuk është i denjë të hyjë në Xhenet. Më dëgjoni me kujdes, më ndiqni me kujdes, si mua, ashtu edhe për punët që unë do të bëj. Nëse tregohem i drejtë dhe veproj me drejtësi, atëherë më ndihmoni. Por, nëse shikoni që unë devijoj nga ajo që është e drejtë, atëherë dua që të më korrigjoni e të m'i ndreqni të metat. Bindmuni për aq kohë sa unë do t'i bindem Allahut të Madhërishëm. E, nëse unë ngre krye ndaj Allahut, atëherë mos iu bindni fjalës sime."[18]

Fjalët e Aliut (r.a.) drejtuar Ebu Bekrit (r.a.): "Ne nuk e pranojmë dorëheqjen tënde dhe nuk duam që ti të tërhiqesh!"

Zejd bin Aliu na ka përcjellë nga gjyshërit e tij se: "Një ditë Ebu Bekri (radijallahu anhu) u ngjit mbi minber dhe tha:

- "A ka ndonjë prej jush që nuk më do mua për kalif? Më thoni, që, nëse ka, t'ia kthej pas besën që ai më ka dhënë!" Dhe këto fjalë

[18]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/852 (14112).

i përsëriti plot tri herë. Sa herë e përsëriti, po aq herë u ngrit Aliu (radijallahu anhu)dhe iu përgjigj duke i thënë:

- "Jo, uallahi as nuk pranojmë të heqësh dorë, as nuk duam që ti të tërhiqesh. E kush mund të kërkojë të të lërë ty pas, kur në krye të ka nxjerrë vetë i Dërguari i Allahut?!"[19]

Ebu Bekri (r.a.) mbyllet në adhurim pasi e vendosin në krye të kalifatit

Tregon dikush nga familja e Rabias: "Kur e vunë në krye të detyrës së kalifatit, Ebu Bekri (radijallahu anhu) i trishtuar dhe i mërzitur u mbyll në shtëpi, për të adhuruar Zotin. Tek ai shkoi Omeri (radijallahu anhu), por Ebu Bekri e kundërshtoi Omerin (radijallahu anhu), duke i thënë:

- "Këtë punë ti ma ngarkove mbi supe!", – duke iu ankuar se gjykimi për njerëzit ishte një detyrë shumë e vështirë. Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- "O Ebu Bekr! Po ti, a nuk e di se i Dërguari i Allahut ka thënë: '*Ta dini se për vendimmarrësin që gjykon në lidhje me një çështje dhe gjen e rrok atë që është më e drejta, ka dy shpërblime, dhe nëse ai gjykon dhe gabon, atëherë për të ka vetëm një shpërblim.*'?, – dhe këto fjalë e qetësuan shumë atë.[20]

4. KUR KALIFI CAKTON PASARDHËSIN E TIJ

Ebu Bekri (r.a.) këshillohet me shokët se çfarë do të bëjnë kur ai të jetë i sëmurë

Ebu Seleme bin Abdurrahmani dhe shumë të tjera na kanë përcjellë se: "Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte i sëmurë rëndë, thirri Abdurrahman bin Aufin (radijallahu anhu) dhe i tha atij:

- "Ç'mendim ke për Omer bin Hatabin si kalif?" Dhe ai iu përgjigj:

- "Po ti, mua më pyet për Omerin, kur ti e njeh atë më mirë se kushdo tjetër!" Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha:

[19]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 8/863 (14145).
[20]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/851 (14110).

- "Prapëseprapë, ti më thuaj mendimin tënd!" Abdurrahman bin Aufi tha:

- "Uallahi, ndër të gjithë ata që ti i mendon se mund të jenë kalifë të të Dërguarit të Allahut, pa dyshim, ai është më i miri." Mandej, Ebu Bekri (radijallahu anhu) thirri Osman bin Afanin (radijallahu anhu) dhe e pyeti:

- "Ç'mendim ke për Omerin si kalif?"

- "Po, nga ne askush nuk e njeh atë më mirë sesa ti.", – iu përgjigj Osmani (radijallahu anhu).

- "Megjithatë, ti më thuaj mua mendimin tënd.", – ia priti Ebu Bekri (radijallahu anhu).

- "Të ta them hapur: Ajo që di unë është se ai është më i mirë nga brenda sesa nga jashtë dhe vështirë të gjesh një të dytë si ai në mesin tonë."

- "Zoti të faltë, uallahi, po të qëllonte që të hiqja dorë prej Omerit, unë nuk do të mendoja askënd tjetër përpara teje."

Lidhur me këtë çështje, Ebu Bekri (radijallahu anh) thirri me radhë, Said bin Zubejrin, Usejd bin Hudajrin, si dhe të gjithë ata që gëzonin më shumë respekt në radhët e muhaxhirëve dhe të ensarëve, për t'u këshilluar edhe me ta se si duhej të vepronte. Usejd bin Hudajri i tha atij:

- "Kam Allahun dëshmitar, pas teje, Omeri është më i zgjedhuri e më i veçanti në mesin tonë. Gjithë ç'do, për Allahun e do, dhe vetëm për hir të Allahut gëzohet, sa herë që gëzohet; e po për Allahun nevrikoset; është më i mirë nga brenda sesa nga jashtë. Nuk njoh askënd tjetër, që të jetë më i denjë sesa ai për një detyrë të këtillë!"[21]

Testamenti i Ebu Bekrit (r.a.), që zgjedh Omerin (r.a.) si pasardhës të tij

"Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

[21]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/876 (14175).

Ky është testamenti i Ebu Bekr bin Ebi Kuhafes, në çastet e fundit të jetës, pikërisht në ato çastet e fundit, kur njeriu bëhet gati të përfshihet në ahiret, kur mohuesi bëhet besimtar, kur mëkatari kupton të vërtetën e zhveshur, ashtu siç është, e që edhe ai që është gënjeshtar nuk thotë vetëm se të vërtetën. Pas meje, në krye të kalifatit ju kam zgjedhur Omer bin Hatabin. Ta dëgjoni dhe t'i bindeni atij. Unë jam përpjekur që të mos lë asgjë mangët në kërkim të asaj që është më e mira dhe më e virtytshmja, si për Allahun, të Dërguarin e Tij, fenë e Tij dhe për veten time, ashtu edhe për të gjithë ju. Nëse vepron me drejtësi, që unë jam i bindur se asisoj do të sillet, atëherë sa mirë! Por, nëse ndryshon dhe i largohet së drejtës, atëherë ta dini, se çdo mëkat që do të bëjë do të ketë ndëshkimin e tij. Unë thjesht u përpoqa të kërkoja për atë që do të ishte më e mira për ju, por të ardhmen e të panjohurën e kam të pamundur që t'i di."

Testamentin e tij Ebu Bekri (radijallahu anhu) e përmbylli me ajetin e dyqindenjëzeteshtatë, dhe të fundit, të sures "Shu'ara": "**Përveç atyre** (poetëve) **që besojnë, bëjnë vepra të mira, e përmendin shumë Allahun dhe mbrohen, vetëm pasi u është bërë padrejtësi. Sigurisht, të padrejtët do ta shohin se në çfarë mundimi do të kthehen** (pas vdekjes)." (Shu'ara, 26/227)[22]

Përgjigjja që iu dha Talhasë (r.a.), i cili e kundërshtoi caktimin Omerit (r.a.) si pasardhës të Ebu Bekrit

[...] Kur u dëgjua se si pasardhës i Ebu Bekrit (radijallahu anhu) ishte caktuar Omeri (radijallahu anhu), Talha bin Ubejdullahu shkoi pranë Ebu Bekrit dhe i tha:

- "Unë kam ardhur këtu tek ti në emër të popullit. Ata më kërkuan të të thosha: 'Ti e di mjaft mirë, se sa ashpër është sjellë Omeri me ne që në gjalljen tënde. Imagjino se ç'mund të na bëjë pasi të kesh ikur ti, nëse ti na lë ne në dorën e tij! Ta dish, se Allahu ka për të të pyetur ty edhe për këtë vendim që po merr sot, ndaj mendohu mirë se ç'përgjigje do të japësh!'"

[22]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/199.

- "Më ngrini, se dua të qëndroj i ulur.", – tha Ebu Bekri (radijallahu anhu). Dhe ata kështu bënë, e ngritën, që të qëndronte ulur.

- "Ju po më bëni thirrje, që unë t'i frikësohem Allahut, kështu? Allahu më shkatërroftë e poshtëroftë mua si njeri, nëse unë nuk jam duke i dhënë shumë rëndësi çështjes suaj! Nëse Allahu i Madhërishëm do të më pyesë atje, unë do t'i përgjigjem: 'O Zot! Unë robërve të Tu u lashë si kalif atë që ishte më i miri e më i mbari ndër ta!' Hajde, shko tani dhe bëjua të ditura njerëzisë të gjitha sa të thashë!", – u përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).[23]

5. ZGJEDHJA E ATIJ QË DO TË VIHET NË KRYE TË SHTETIT DUKE U KËSHILLUAR ME TË GJITHË

Kur e plagosën, Omeri (r.a.) ua la gjashtë vetëve çështjen e zgjedhjes së një kalifi

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): "Omerin (radijallahu anhu) e pati plagosur Ebu Lu'luja, duke i ngulur kamën e tij në dy vende të ndryshme të trupit. Omeri (radijallahu anhu), kur i ndodhi kjo, mendoi se kushedi seç gabim duhet të kishte bërë ndaj njerëzve pa dashje, ndaj thirri menjëherë Ibni Abasin. Babai e donte shumë Ibni Abasin, e mbante gjithmonë afër dhe herë-herë i kërkonte edhe këshilla për shumë çështje nga më të ndryshmet. Ai i kërkoi atij:

- "Dua të di se si qëndron puna për këtë që ndodhi, kush e bëri këtë, ndonjë grup nga mesi i popullit? Dil e kërko." Ibni Abbasi filloi të vërtitej sokak më sokak, në kërkim të zbardhjes së asaj ngjarjeje. Kudo që shkoi, njerëzit i gjeti duke qarë. U kthye pranë Omerit (radijallahu anhu)dhe i tha:

- "O Prijësi i Besimtarëve! Kudo që shkova e me këdo që u takova, e gjeta duke qarë njësoj sikur t'u kishte vdekur ndonjë nga fëmijët."

- "Po mirë, kush më qëlloi mua, atëherë?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Ty të paska qëlluar skllavi i Mugire bin Shubes, Ebu Lu'luja, i cili vetë është prej atyre që adhurojnë zjarrin."

[23]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/877 (14178).

Ibni Abasi thotë se: "Kur dëgjoi këto fjalë, Omeri (radijallahu anhu) u gëzua tejmase dhe lëvdoi Allahun, duke thënë:

- "Lëvduar qoftë Allahu, që nuk më sprovoi me ndonjë mysliman që ka dëshmuar njëherë, duke thënë 'La ilahe il'lallah'." Mandej, ai më tha mua:

- "Unë e pata ndaluar që në mesin tonë të afroheshin mohuesit që nuk ishin arabë dhe që janë të fortë; mirëpo ju nuk i qenkeni bindur fjalës sime. Tani më thirr vëllezërit e mi, të vijnë këtu!", – urdhëroi.

- "Po kush janë vëllezërit e tu?", – e pyetën, e ai u përgjigj:

- "Vëllezërit e mi janë Osmani, Aliu, Talhaja, Zubejri, Abdurrahman bin Aufi dhe Sad bin Ebi Uekasi." Pastaj e vendosi kryet mbi prehrin tim dhe ashtu qëndroi derisa erdhën ata që ai kishte kërkuar të vinin. Kur erdhën, i thashë:

- "Erdhën të gjithë ata që ti kërkove të vinin."

"Tani, unë jam menduar gjerë e gjatë lidhur me çështjen se kush do ta marrë përsipër drejtimin e myslimanëve! Ndaj edhe ju kam thirrur ju të gjashtë! Unë ju shoh ju, që të gjashtë, si prijësit dhe udhëheqësit më të mirë që mund të drejtojnë myslimanët. Vetëm në shpatulla si tuajat mund të ngarkohet ky mision. Për sa kohë që ju do të jeni të drejtë, edhe punët e njerëzve kanë për të shkuar siç duhet. Nëse ndodh ndonjë përçarje, ta dini se ajo do të vijë si rezultat i përçarjes që do të ekzistojë mes jush.", – tha Omeri (radijallahu anhu).

"Kur dëgjova babanë të niste fjalinë: 'Nëse ndodhin përçarje dhe ndarje...', e kuptova se kjo medoemos do të ndodhte një ditë, sepse e kisha parë, që të gjitha ato që ai na i kishte thënë se do të ndodhnin në të ardhmen, kishin ndodhur pikërisht ashtu siç na i pati treguar ai. Mandej, nga plaga e babait filloi të rridhte gjaku me vrull. Ata të gjashtë filluan të pëshpëritnin me njëri-tjetrin. Kisha frikë se ata do të lidhnin besën me ndonjërin syresh, andaj me vete thashë: "Prijësi i Besimtarëve është ende gjallë, e nuk ka hije që të ketë dy kalifë njëri mbi tjetrin."

"Më ngrini!", – u tha Omeri (radijallahu anhu) atyre. E ngritëm. U drejtua atyre të gjashtëve dhe u tha:

- "Këshillohuni me njëri-tjetrin për tri ditë me radhë. Gjatë kësaj kohe, namazin për xhematin ta falë Suhejbi." Dhe ata e pyetën:

- "Me kë të këshillohemi, o Prijësi i Besimtarëve?"

- "Pyetini e këshillohuni me muhaxhirët, me ensarët dhe me komandantët e ushtrive që gjenden këtu tani për tani.", – i këshilloi ata Omeri (radijallahu anhu). Mandej, ai tha se donte pak qumësht për të pirë. Ia sollën dhe e piu të gjithin. Qumështi i doli jashtë, siç e kishte pirë, nga dy plagët që kishte të hapura në trup. E kuptoi se do të vdiste, ndaj tha:

- "Në këtë çast, gjithë bota të ishte e imja, do ta kisha dhënë si garanci, vetëm e vetëm që të shpëtoja nga tmerri i ditës së Kiametit. Lëvduar qoftë Allahu, që më duket se jam më mirë kështu siç jam."

Ibni Abasi tha:

- "Edhe pse ti flet kështu, nuk ka dyshim se Allahu ty do të të shpërblejë me më të mirat, sepse, ndërkohë që myslimanët jetonin të frikësuar në Mekë, a nuk iu lut Allahut i Dërguari i Allahut që ta forconte këtë fe dhe myslimanët duke të udhëzuar edhe ty në Islam? Dhe, kur u bëre ti mysliman, Islami u forcua ndjeshëm. Sajë teje i Dërguari i Allahut dhe sahabët e tij filluan ta përhapnin Islamin haptazi. Mërgove drejt Medinës dhe mërgimi yt si një ngadhënjim ishte. Nuk ngurrove të ishe i pranishëm në çdo luftë që luftoi edhe Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe Resulullahu ishte i kënaqur prej teje kur u nda nga kjo jetë. Pas të Dërguarit të Allahut, ti vazhdove të ishe mbështetja kryesore për Ebu Bekrin. Bashkë me myslimanët u tregove vendin të gjithë atyre që vendosën të braktisin Islamin, për t'u kthyer në besimet e mëparshme. Njësoj siç u kujdese e u bëre shkas që edhe ata që ishin të lëkundur të pranonin Islamin, duke u bërë myslimanë. Më tej, pas të Dërguarit të Allahut, edhe kalifi i tij, Ebu Bekri, ishte i kënaqur prej teje, ndërsa përgatitej për t'u larguar nga kjo botë. Pas tij ishe ti që i drejtoi më së miri punët e shtetit të myslimanëve. Nëpërmjet teje Allahu u fali Islamin sa e sa qyteteve të reja. E ishte po në kohën tënde, që thesaret e pasuritë e myslimanëve u shumëfishuan, armiqtë u larguan dhe myslimanët filluan të ndienin qetësi dhe rehati në jetën e tyre të kësaj bote dhe atë të të jetuarit të

fesë. Sakaq, më në fund, Allahu të fali edhe ty mundësinë që jetën ta përmbyllësh si dëshmor! Urime për ty, o Omer, dëshmor i Allahut!"

Atëherë, prej Omerit (radijallahu anhu) u dëgjuan fjalët:

- "Uallahi, më duket sikur po ma ledhatojnë krenarinë gjithë këto fjalë kaq të bukura që ju po më thoni." Mandej, kthehet nga Ibni Abasi dhe e pyet:

- "O Abdullah! Në Ditën e Gjykimit, a do të dëshmosh në të mirën time?"

- "Po!", – u përgjigj Ibni Abasi. Atëherë, pas këtyre fjalëve që i tha Ibni Abasi, Omeri (radijallahu anhu) thirri të birin, Ibni Omerin:

- "Abdullah bin Omer, ma vër faqen përdhe!" Kështu, Ibni Omeri e mori me kujdes kokën e të atit, që deri në atë çast e kish mbajtur në prehër dhe e vuri mbi kërci. Ai i kërkoi sërish:

- "Ma vendos përdhe, të thashë!" E mori me kujdes dhe e tërhoqi nga këmba dhe e la në tokë. Koka e tij e bekuar preku tokën. Aty, ai filloi të murmurinte me veten:

- "Mjerë ti, o Omer, nëse Allahu nuk të fal! Mjerë ti, e mjerë nëna jote!", – kaq tha, sikur të ish duke iu ankuar vetes për veten dhe nuk kaloi shumë dhe shpirti i tij iu dorëzua Mëshirës së Mëshirëplotit."

Me ndarjen nga kjo jetë e Omerit (radijallahu anhu), ai grup i sahabëve, të cilëve iu caktua të këshilloheshin me njëri-tjetrin, i dërgoi lajm Abdullah bin Omerit, që në mbledhjen e këshillimit të merrte edhe ai pjesë. Abdullahu u ktheu atyre përgjigjen, në të cilën u bënte të ditur:

- "Unë nuk vij pranë jush, nëse ju nuk këshilloheni edhe me parinë e ensarëve, të muhaxhirëve dhe komandantët kryesorë të ushtrisë, të cilët janë sot të gjithë këtu."[24]

Borxhet e Omerit (r.a.)

Na e tregon Amr bin Mejmuni: "Omeri (radijallahu anhu), pasi u plagos nga Ebu Lu'luja dhe e mjekuan, i tha të birit Abdullahut:

[24]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 9/77 (579).

- "Më llogarit pak borxhet që u kam njerëzve!" Dhe ai ia llogariti një për një dhe iu përgjigj në çast:

- "Tetëdhjetë e gjashtëmijë."

- "Nëse pasuria e familjes së Omerit mjafton për t'i përballuar të tëra këto borxhe, atëherë paguaji. Nëse nuk i përballon dot, atëherë shko dhe kërkoji bijve të Adij bin Kabit. Nëse as ata nuk e përballojnë dot këtë borxh, atëherë shko dhe kërkoji kurejshëve, por pa shkuar tek asnjë tjetër. M'i paguaj menjëherë ato që u detyrohem njerëzve! Shko dhe te nëna e të gjithë besimtarëve, Aishja (radijallahu anha), përshëndete nga unë dhe thuaji:

- "Omeri, i biri i Hatabit, kërkon lejen tënde, që ta varrosim pranë dy shokëve të tij.", – madje edhe duke e paralajmëruar, – "Në asnjë mënyrë të mos i thuash 'Prijësi i Besimtarëve kërkon leje', sepse unë nuk jam më Prijësi i Besimtarëve." Sakaq, kur Abdullah bin Omeri mbërriti tek Aishja (radijallahu anha), Aishen (radijallahu anha) e gjeti të ulur e duke qarë. Abdullahu e përshëndeti nënën e të gjithë besimtarëve dhe i tha:

- "Omeri, i biri i Hatabit do lejen tënde, që ta varrosin afër dy shokëve të tij." Aishja e nderuar (radijallahu anha) i tha:

- "Uallahi, unë atë vend e kisha menduar për vete. Megjithatë, sot unë do të zgjedh Omerin përpara vetes." Kur Abdullahu u kthye pas dhe Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- "Ç'lajme më ke prurë?"

- "Ta dha lejen.", – u përgjigj ibni Omeri.

- "Elhamdulil'lah, kjo ishte puna më e rëndësishme që më kishte mbetur pa zgjidhur.", – tha Omeri (radijallahu anhu) dhe fjalën e vijoi duke e porositur të birin:

- "Kur të vdes, siç jam i shtrirë në këtë nim[25] të më çoni në Dhomën e Lumturisë, ku jetoi i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). O bir, kur të më çoni atje, kërkoji sërish leje Aishes. 'Omer bin Hattabi të

[25]. Shtrat i ulët, prej dërrasash etj., që vihet anës murit dhe që shtrohet me një dyshek të hollë e me mbulesë për të ndenjur; minder. (*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, shën. red.)

kërkon leje', – t'i thuash. Nëse ajo më lejon, atëherë aty të më varrosni, nëse ajo nuk ju jep leje, atëherë më ço në varrezën e myslimanëve!"

Teksa e patën marrë Omerin (radijallahu anhu) mbi supe dhe po e çonin në Dhomën e Lumturisë, njerëzit i kishte kapluar një mërzi e pikëllim, që sikur nga qielli t'u kishin ardhur gjithë të këqijat dhe fatkeqësitë më të mëdha. Kur mbërritën, Abdullah bin Omeri i tha prapë Aishes (radijallahu anha):

- "Omer bin Hatabi të kërkon leje." Dhe Aishja (radijallahu anha) ua lejoi. Ishte si një mirësi nga ana e Allahut, që Omeri (radijallahu anhu) u varros aty, mjaft afër Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe Ebu Bekrit (radijallahu anhu).

Ai që e përcjell këtë ndodhi thotë: "Kur Omeri (radijallahu anhu) ishte në çastet e fundit të jetës dhe njerëzit i thanë që të caktonte pasardhësin e tij, ai u përgjigj:

- "Unë, për këtë gradë, nuk njoh ndokënd që të jetë më i denjë dhe që ta meritojë më shumë sesa ata prej të cilëve ishte i kënaqur edhe i Dërguari i Allahut dhe ashtu u largua nga kjo jetë, i kënaqur me ta. Njëri prej tyre të zgjidhet kalif.", – dhe, sakaq, përmendi emrat e Aliut, Osmanit, Talhasë, Zubejrit, Abdurrahman bin Aufit dhe Sad bin Ebi Uekasit (radijallahu anhum) dhe porositi:

- "Nëse kalif zgjidhet Sadi, ai është më se i denjë për një detyrë të tillë; nëse nuk zgjidhet, atëherë ai që do të zgjidhet si kalif, të përfitojë prej tij, duke e ngarkuar me detyra të rëndësishme. Unë nuk e lirova atë nga detyra e të qenët valiu i Kufes as se ai kishte ndonjë mangësi, as se ishte i dobët, as se bëri ndonjë gabim." Omeri (radijallahu anhu), të birin, Abdullahun e pati përfshirë në mbledhje për arsyen e vetme që ai të shprehte ndonjë mendim, duke u vënë të gjithëve kushtin që ai nuk duhet të zgjidhej kalif i të gjithë myslimanëve. Me pak fjalë, në mbledhjen e këshillimit Abdullah bin Omeri po merrte pjesë vetëm si këshillues, e jo për të kërkuar që të zgjidhnin atë vetë si kalif. Kur ata personalitete që iu përmendën emrat, u mblodhën të diskutonin çështjen e kalifatit, Abdurrahman bin Aufi tha:

- "T'ia japim të drejtën e vendimit tre vetëve prej nesh." Sakaq,

Zubejri të drejtën e tij ia dha Aliut, Talhaja Osmanit, ndërsa Sadi ia dha vetë Abdurrahman bin Aufit. Kur puna u zvogëlua kësisoj në vetëm tri alternativa, Abdurrahman bin Aufi tha:

- "Ka ndonjë prej jush që tërhiqet vetë nga detyra e kalifatit?", – mirëpo as Aliu i nderuar, as Osmani (radijallahu anhuma), nuk thanë asnjë fjalë. Sakaq, Abdurrahman bin Aufi u tha dy shokëve të tij:

- "Atëherë, a do ma lini mua të merrem me zgjedhjen? Kam Allahun dëshmitar, se unë do të bëj çmos për të zgjedhur atë që qëndron më lart nga ju e që është më i hairit e më i dobishmi për të gjithë myslimanët." Dhe ata e pritën mirë, duke i thënë:

- "Dakord, ta kemi dhënë ty zotësinë e zgjedhjes." Abdurrahman bin Aufi kërkoi të takohej vetëm për vetëm me Aliun, të cilin, në bisedë e sipër, e pyeti:

- "O Ali, ti je i afërm e farefis i të Dërguarit të Allahut dhe, për më tepër, je edhe një nga të parët që janë bërë myslimanë. Kjo përbën një përparësi për ty. Unë kam Allahun dëshmitar, që nëse të zgjedh ty si kalif, e di që ti do të na udhëheqësh ne me drejtësi. Ashtu siç edhe po zgjodha Osmanin, e di edhe që ti do t'ia dëgjosh fjalën e do t'i bindesh çdo urdhri të tij; kështu është, apo jo?"

- "Po!", – iu përgjigj Aliu (radijallahu anhu). Mandej, Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhu) u takua edhe me Osmanin (radijallahu anhu) vetëm për vetëm dhe edhe atij i tha të njëjtat gjëra që i kish thënë edhe Aliut (radijallahu anhu). Edhe Osmani, të njëjtën përgjigje i ktheu. Abdurrahman bin Aufi, pasi u mori fjalën atyre të dyve, iu drejtua Osmanit dhe i tha:

- "Zgjatma dorën, o Osman!" Dhe Osmani (radijallahu anhu) zgjati dorën. Ai lidhi besën me Osmanin (radijallahu anhu). Pas tij, besën e lidhi Aliu (radijallahu anhu) dhe i tërë populli me radhë, duke e pranuar të gjithë se tanimë kalifi i tyre ishte Osmani (radijallahu anhu)."[26]

[26]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/339.

6. CILËSITË E TIPARET E ATYRE QË ISHIN TË DENJË PËR POZICIONIN E KALIFATIT

Pikëpamjet e Ebu Bekrit (r.a.) lidhur me këtë çështje

Asimi na tregon se: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte sëmurur dhe u urdhëroi atyre që kishte pranë që të mblidheshin njerëzit dhe atë vetë ta ngjitnin në minber, sepse kishte për t'u thënë njerëzve disa gjëra. Kjo ishte edhe hutbeja e fundit e Ebu Bekrit. Lëvdoi dhe përgëzoi emrin e Allahut, pastaj mbajti këtë fjalë të bukur:

- "O njerëz! Druhuni prej botës, mos i besoni asaj, sepse ajo është gënjeshtare. Zgjidhni më mirë ahiretin sesa këtë botë; atë të doni ahiretin. Dhe ta dini se dashuria për njërën syresh do të thotë neveri për tjetrën. Gjykimi për mbylljen e kësaj çështjes së kalifatit që na është vënë mbi supe e duhet ta zgjidhim, do të varet edhe nga fakti se sa e shëndoshë do të jetë në krye ajo çështje. Për këtë arsye, detyrën dhe misionin e vështirë të kalifatit duhet ta marrë përsipër ai që është më i forti ndër ju, ai që ka më shumë kontroll mbi veten, ai që është më i vendosuri, kur duhet përdorur forca, e ai që është më i buti, atëherë kur duhet vepruar me butësi e delikatesë, ai që di më mirë se si të përftojë dobi edhe nga mendimet e të tjerëve, që janë të aftë për të gjykuar e për të dhënë mendim; detyrën ta marrë përsipër një njeri që nuk merret me punët që nuk kanë të bëjnë me të, që nuk ka turp të mësojë rreth atyre gjërave që ai vetë nuk i di, që nuk e shushatin ndodhitë e papritura që ia behin, që di ta ruajë plaçkën e të tjerëve, që nuk nxehet e si pasojë e nevrikosjes të tradhtojë atë që i është lënë si amanet, për ta ruajtur, që nuk ka mangësi në largpamësi e që di ta kuptojë se si do të jetë e ardhmja pas çdo vendimi të marrë dhe që cilësi kryesore të vetën ka të vepruarit çdoherë me maturi dhe që i frikësohet pa masë mosbindjes ndaj urdhrave të Allahut. Dhe ai që i mishëron të gjitha këto cilësi është Omeri!"[27]

Çfarë mendimi kishte Omeri (r.a.) lidhur me këtë?

Na e tregon Abdullah bin Abasi (radijallahu anhu) se: "Unë i

[27]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/879 (14183).

kam shërbyer Omerit (radijallahu anhu). Kisha shumë respekt për të dhe e çmoja shumë si njeri. Një ditë shkova në shtëpinë e tij. Omeri (radijallahu anhu) ishte vetëm, në dhomën e tij. Psherëtiu aq fort, saqë mendova se i doli shpirti nga vendi. Pastaj ngriti kryet lart dhe mori njëherë frymë thellë-thellë. Unë mblodha gjithë forcën brenda vetes dhe me vete po thosha:

- "Uallahi, do ta pyes se pse psherëtiu ashtu." Dhe ashtu bëra, e pyeta:

- "O Prijësi i Besimtarëve, uallahi, do të më thuash, çfarë ta shkaktoi atë frymëmarrje ashtu thellë? Çfarë shqetësimi të mundon, që psherëtive aq fort?"

- "Po, shqetësimi më bëri të psherëtij; dhe ç'fatkeqësi se! Nuk po gjej që nuk po gjej dot dikë për t'i lënë amanet këtë misionin e epërm të kalifatit. Ka gjasa që edhe ti do të më thuash se më i denji për këtë detyrë është Aliu, të cilin ti e do aq shumë.", – m'u përgjigj ai.

- "O Prijësi i Besimtarëve! Po pse, për ju a nuk është Aliu ai që e meriton më së shumti kalifatin, duke pasur parasysh mënyrën se si ai mërgoi, që ai ka qenë i pranishëm thuajse në të gjitha bisedat me të Dërguarin e Allahut dhe, për më tepër, ai është edhe nga familja e tij?", – vijova ta pyesja unë.

- "Po, ashtu është, e vërtetë. Mirëpo është shumë shakaxhi. Dhe këtë detyrë mund ta përballojë vetëm dikush që di të tregohet i butë pa u shfaqur i dobët, që di të tregohet i rreptë duke iu shmangur dhunës, që sillet bujar pa rënë në shpërdorim dhe që di se si të jetë i matur pa u treguar dorështrënguar.", – tha ai, duke shtuar:

- "Këtë punë mund ta përballojë e ta kryejë me sukses vetëm një njeri që nuk i përulet askujt, që i shmanget dyfytyrësisë, që nuk shkon pas dëshirave të veta, që në vend se të flasë shumë hyn menjëherë në veprim, që nuk devijon nga ajo që është e drejtë, qoftë edhe kundër të afërmve të vet, që di ta ruajë nderin e që nuk e mohon atë as kur është fare vetëm."[28]

Ndërsa, në një tjetër transmetim, të cilin na e përcjell Selman

[28]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/907 (14255).

Farisiu (radijallahu anhu), ai na tregon se si Omeri (radijallahu anhu) i ka thënë:

- "Çfarë jam unë, mbret, apo kalif?", – më pati pyetur.

- "Nëse ti merr nga toka e myslimanëve taksë qoftë edhe një dirhem më pak ose më shumë dhe nuk e vendos aty ku duhet, atëherë ti nuk je më kalif, por mbret!", – i qeshë përgjigjur unë.

Kjo përgjigje e Selmanit e pati prekur shumë Omerin (radijallahu anh) dhe e pati futur në të thella, duke e bërë të mendohej gjerë e gjatë për veten."[29]

Drejtpeshimi i butësisë me ashpërsinë te një kalif

Said bin Musejebi (radijallahu anhu) tregon: "Kur detyra e kalifatit iu kalua Omer bin Hatabit (radijallahu anhu), ai u ngjit në minberin e të Dërguarit të Allahut; pasi lëvdoi dhe përgëzoi Allahun e Madhërishëm, ai mbajti edhe një fjalë përpara besimtarëve:

- "O njerëz! E di, jo pak herë ju më keni parë mua të sillem i ashpër dhe disave prej jush mund t'u jem rënduar jo pak. Shkaku i të gjitha sjelljeve të mia ka qenë ky: unë kam qenë me Resulullahun e dashur; unë kam qenë një shërbëtor i tij. Ai ishte ashtu siç e përshkruan edhe Allahu i Lartësuar në ajetin e njëqindenjëzetetetë të sures "Teube", '**i dhembshur dhe gjithë mëshirë ndaj besimtarëve**'. Ndërsa unë, krahasuar me të isha si një shpatë e nxjerrë nga brezi. Po të mos më vendoste ai në mill, apo po të mos ishte ai që të më pengonte nga të bërët e ndonjë veprimi, isha unë ai që u jepja njerëzve mësimin e merituar, duke qenë se ai ishte shumë i butë. Derisa vdiq Resulullahu, ky ka qenë pozicioni im pranë tij. Dhe ai u largua nga kjo botë shumë i kënaqur prej meje. Pafundësisht lëvduar qoftë Allahu, e unë jam shumë i kënaqur për këtë. Edhe më pas, të njëjtin pozicion e mbajta edhe pranë kalifit të të Dërguarit të Allahut, Ebu Bekrit (radijallahu anhu). Ju e dini se sa bujar, sa i fisëm dhe se sa i butë ishte ai si njeri. Edhe pranë tij u gjenda si ndihmës. Unë isha si një shpatë e tij. Butësia e tij dhe ashpërsia ime plotësonin një të tërë. Po të mos më pengonte

[29]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/800 (35805).

ai, Ebu Bekri (radijallahu anhu), që unë të tërhiqesha, unë hidhesha menjëherë në sulm. Pra, këtë pozicion kam pasur edhe pranë Ebu Bekrit (radijallahu anhu), derisa Allahu i Madhërishëm ia ndau shpirtin prej trupit. Edhe ai u largua nga kjo jetë i kënaqur me mua. Lëvduar qoftë Allahu, se edhe kjo është diçka që më bën të ndihem fatlum.

Kjo detyrë për t'ju prirë ju sot m'u kalua mua. Unë e di fare mirë, se disa prej jush do të thotë: 'Ky nuk ishte kalif dhe sillej shumë ashpër me ne; imagjino tani, që u bë kalif, kushedi se sa i egër do të jetë me ne!' Nuk ka nevojë të pyesni askënd për mua, ju më njihni dhe më keni provuar vetë. Me aq sa di unë, ju e dini mjaft mirë edhe sunetin e Profetit tuaj dhe rrugën e ndjekur prej tij gjatë gjithë jetës. Sot unë nuk kam asnjë çështje, për të cilën të ndihem i penduar, 'që pse nuk e pyeta Resulullahun tonë të nderuar!'; sepse unë atë kam pyetur për çdo gjë. Ta dini mirë, se, ajo ashpërsi që keni vërejtur tek unë deri më sot, që nga çasti që jam caktuar si kalif mbi të gjithë besimtarët, është shumëfishuar edhe më shumë, derisa të vë në vend të drejtat e myslimanëve që janë të dobët e të pafuqishëm e t'u tregoj vendin të gjithë atyre që i kanë shkelur këto të drejta. Por, krahas kësaj ashpërsie, unë do t'i përulem gjer në tokë të gjithë juve që jeni të ndershëm, që u qëndroni larg të këqijave dhe që u bindeni me përpikëri urdhëresave të Allahut. Nëse bie në kundërshti apo do të kem mosmarrëveshje me ndonjërin prej jush, unë nuk druhem aspak që të shkoj vetë tek ai që pretendon ndonjë të drejtë prej meje (për verifikim). Andaj, kushdo prej jush që do të ketë ndonjë problem me mua, apo ndonjë çështje për t'u zgjidhur, të mos ngurrojë, por t'i kërkojë me ngulm të drejtat e tij.

O robt e Allahut! Kini frikë e mos ngrini krye ndaj Allahut. Mos m'u bëni mua pengesë në punët e mira që do të bëj, por më ndihmoni, sepse kjo është edhe në interesin tuaj. Më ndihmoni që të jem sa më i drejtë në realizimin sa më mirë të kësaj detyre të udhëheqjes, që Allahu më ngarkoi mbi supe, që t'i urdhëroj njerëzit në të mirë dhe t'i pengoj ata nga çdo keqbërje!"[30]

Ndërsa Muhamed bin Zejdi (radijallahu anhu) tregon: "Një ditë,

[30]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/879 (14184).

Aliu, Osmani, Zubejri, Talhaja, Abdurrahman bin Aufi dhe Sadi (radijallahu anhum), u mblodhën në një vend. Në mesin e tyre ai që mund të fliste më lirshëm me Omerin (radijallahu anhu) ishte Abdurrahman bin Aufi. Ata i kërkuan atij:

- "Abdurrahman, sikur të shkoje njëherë tek Prijësi i Besimtarëve e të flisje me të dhe t'i thuash: Njerëzit nevojtarë po vijnë deri tek ti; mirëpo nga druajtja prej ashpërsisë sate nuk arrijnë të ta tregojnë dot se çfarë problemi kanë, kështu që kthehen pa e zgjidhur problemin që kanë." Abdurrahman bin Aufi shkoi menjëherë tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- "O Prijësi i mbarë Besimtarëve! Duhet të tregohesh më i butë me njerëzit, sepse shumë njerëz që kanë ndonjë nevojë vijnë këtu, deri tek ti, mirëpo, druhen dhe ikin pa ta treguar dot se ç'problem kanë."

- "Shiko, o Abdurrahman.", – i tha atij Omeri (radijallahu anhu), – "më thuaj, për hir të Allahut, kush të dërgoi ta flasësh këtë me mua, Aliu, Osmani, Talhaja, Zubejri dhe Sadi?"

- "Kam Zotin dëshmitar, ata më dërguan.", – ia priti Abdurrahmani.

- "Uallahi, Abdurrahman, në fillim u përpoqa të tregohesha shumë i butë me njerëzit; madje aq tolerant fillova të tregohem, saqë fillova të kem frikë nga Allahu. Kësisoj, nisa të sillem sërish me autoritarizëm. Dhe tani kam filluar të kem frikë nga Allahu për ashpërsinë me të cilën po sillem me njerëzit; më thuaj ti një rrugëdalje, si t'ia bëj?"

Abdurrahmani, pasi mori këtë përgjigje, u ngrit menjëherë në këmbë, kishte filluar të qante. E tërhoqi zvarrë rrobën që kishte hedhur mbi trup dhe teksa ishte duke dalë thoshte:

- "Mjerë ky popull kur të vdesësh edhe ti! Mjerë gjendja e këtyre njerëzve kur ti të mos jesh më!"[31]

Sipas transmetimit të Sha'bit, Omeri (radijallahu anhu) ka thënë kështu:

- "Uallahi, për hir të pëlqimit dhe të kënaqësisë së Allahut mua zemra më zbutet aq shumë, saqë më duket më e butë edhe se ajka e qumështit. E po prapë, po për hir të pëlqimit dhe të kënaqësisë së

[31]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/788 (35770).

Allahut, ajo më ashpërsohet aq shumë, saqë më e duket më e ngurtë se guri."[32]

Kur kalifi i detyronte disa njerëz të caktuar që të vendoseshin diku tjetër, në mënyrë që ata të mos përfshiheshin në mesin e umetit, pasi mund të nxirrnin probleme

Sha'biu tregon: "Deri kur Omeri (radijallahu anhu) u nda nga kjo jetë, kurejshët ishin bezdisur jashtëzakonisht shumë nga sjellja e tij, sepse Omeri (radijallahu anhu) i pati detyruar ata që të vendoseshin në Medinë, duke ua ndaluar që të lëviznin në drejtim të ndonjë vendi tjetër. U pati përmbushur çdo nevojë që mund të kishin në ato vende ku i pati vendosur dhe u pati thënë:

- "Ajo që kam më shumë frikë se do të më duhet të jap llogari për këtë umet, është që ju mund të përhapeni nëpër vende të ndryshme!"

Kur një prej këtyre muhaxhirëve, që ishin detyruar të jetonin në Medinë, i kërkoi Omerit leje për të marrë pjesë në luftë, Omeri (radijallahu anhu) i qe përgjigjur duke i thënë:

- "Ti ke luftuar mjaftueshëm në prani të Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe ke fituar gjithçka që mund të fitoje. Sot, për ty është më e hairit që ti të mos e shohësh botën dhe bota mos të të shohë ty."

Në kohën që detyra e kalifatit iu kalua Osmanit (radijallahu anhu), ai i la të lirë të mërguarit e kurejshëve. Kësisoj, ata u shpërndanë nëpër rrethinat përreth dhe populli filloi të mblidhej përreth tyre. Dy prej atyre që e përcjellin këtë ndodhi, Muhamedi dhe Talhaja thonë se:

- "I pari lëshim dhe e para dobësi që u shfaq në mesin e umetit të Islamit ka qenë lënia e lirë e të mërguarve të Kurejshit."[33]

Kajs bin Ebi Hazmi tregon se: "Zubejri (radijallahu anhu) erdhi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i kërkoi leje për të marrë pjesë në luftë. Omeri (radijallahu anhu) i tha atij:

- "Rri më mirë në shtëpi, se ti ke marrë pjesë në luftë edhe në kohën

[32]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/51.
[33]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 14/63 (37978).

e të Dërguarit të Allahut, kjo mjafton për ty." Kur Zubejri (radijallahu anhu) ia përsëriti disa herë rresht lutjen e tij, Omeri (radijallahu anhu) e urdhëroi atë:

- "Rri në shtëpi! Të betohem tek Allahu, se nëse ti dhe njerëzit e tu dalin nga Medina, ju do t'i sillni fatkeqësi shumë të mëdha mbi krye umetit dhe sahabëve të Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem)!"[34]

7. PËRFITIMI NGA MENDIMET E NJERËZVE TË MENÇUR DHE LARGPAMËS

Këshillimi i sahabëve me Profetin tonë të dashur

Na është përcjellë prej Enesit (radijallahu anhu) se: "Profeti ynë, kur mori vesh se karvani i tregtisë i kurejshëve me në krye Ebu Sufjanin po ktheheshin nga Siria, ai u ul të këshillohej me sahabët e tij, për t'u marrë edhe atyre mendimin rreth asaj që do të ishte më e mira."[35]

Ndërkohë, në një hadith që ai na e ka transmetuar në lidhje me luftën e Bedrit, Omeri (radijallahu anhu) na thotë:

"Për të diskutuar lidhur me robërit e luftës së Bedrit, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u këshillua me mua, me Ebu Bekrin dhe Aliun. Ebu Bekri i tha të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulullah! Këta janë djemtë e xhaxhallarëve të mi, i kam kushërinj, janë vëllezërit e mi. Unë mendoj që të na paguajnë gjobën e robit të luftës dhe t'i lini të lirë. Me gjobat e mbledhura prej tyre jo vetëm që do të forcohemi më shumë karshi mohuesve, por ku i dihet, ndoshta Allahu u fal atyre mundësinë e udhëzimit dhe ata mund të na bëhen edhe krahë." I Dërguari Fisnik e pyeti Omerin:

- "*Omer, i biri i Hattabit! Po ti ç'mendim ke?*"

- "Uallahi, unë nuk jam i një mendjeje me Ebu Bekrin. Unë them që ju të na urdhëroni e unë t'i pres aksh njeriu kokën, të cilin e kam të afërm, Aliu vëllait të tij Akilit dhe Hamzai vëllait të tij Abasit, në mënyrë që Allahu t'ua tregojë të gjithëve faqeza, se ne nuk ushqejmë as më të imtën ndjenjë të keqardhjes kundrejt idhujtarëve. Këta janë

[34]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/129 (4612).
[35]. Muslim, *Sahih,* 3/1403 (1779).

paria e idhujtarëve, janë prijësit e tyre dhe njerëzit më të respektuar ndër ta."

I Dërguari i Allahut anoi nga mendimi që pati dhënë Ebu Bekri. Nuk i aprovoi fjalët e mia. Dhe, si përfundim, i liroi ata në këmbim të gjobës së robit të luftës. Në ditën tjetër, që në mëngjes, unë shkova tek i Dërguari i Allahut dhe tek Ebu Bekri; të dy ishin duke qarë.

- "O Resulullah, çfarë ju ka bërë ty dhe shokun tënd më të mirë për të qarë? Më thoni, që të qaj edhe unë, e edhe nëse nuk qaj dot, të përpiqem të qaj."

I Dërguari i Allahut tha:

- "*Qajmë prej ndëshkimit që mund t'u vijë shokëve të tu, të cilët morën gjobën e lirimit të robërve të luftës.*" Tregoi një pemë që gjendej aty pranë, m'u tregua se fatkeqësia që do t'u ndodhë është më afër se ajo pemë, dhe më këndoi ajetin Kur'anor: "**Asnjë profet s'ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.**" (Enfal, 8/67)[36]

Kur Profeti ynë këshillohet me Sad bin Ubaden dhe Sad bin Muadhin për hurmat e Medinës

Zuhriu na tregon: "Gjatë ditëve kur u zhvillua lufta e Hendekut dhe njerëzit u gjendën përballë vështirësish shumë të mëdha, i Dërguari Fisnik u dërgoi lajm të mëdhenjve të fisit të Gatafanit, Ujejne bin Hisnit dhe Harith bin Auf el-Murriut, që të hiqnin dorë së luftuari me myslimanët dhe, në këmbim, u premtoi se do t'u jepte atyre një të tretën e hurmave të Medinës. Si rezultat, mes të Dërguarit të Allahut dhe palës kundërshtare u vendos paqja. Paqen ata e zbardhën edhe në letër. Vetëm se, para se të caktohej nënshkrimi i atij dokumenti, Resulullahu u dërgoi lajm Sad bin Muadhit dhe Sad bin Ubades, për të marrë edhe mendimin e tyre lidhur me këtë vendim. Të dy ata sahabë i thanë të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulullah, për vete po na e kërkon diçka të tillë? Na thuaj, që

[36]. Muslim, *Sahih,* 3/1383 (1763).

t'i bindemi menjëherë dëshirës sate! Apo, mos bëhet fjalë për ndonjë urdhëresë hyjnore, së cilës ne duhet t'i bindemi me çdo kusht? Apo kjo është pjesë e ndonjë marrëveshjeje që ti po bën për të mirën tonë?"

- "*Jo, këtë unë po e bëj për ju, sepse po shoh se si arabët po ju shigjetojnë sikur të ishin të gjithë duke goditur nga një hark i vetëm, e po ju zënë ngushtë. Unë desha që t'ua thyej sulmin, të paktën në njëfarë mase të caktuar.*", – iu përgjigj i Dërguari i Allahut.

- "O Resulullah! Po ne, edhe kur i bënim Zotit ortakëri, duke adhuruar idhujt, kur nuk e adhuronim Allahun e madje as që e njihnim fare Atë, ata nuk guxonin të hanin qoftë edhe një kokërr të vetme prej atyre hurmave. Tani do t'u japim ne atyre prej mallit tonë, tani që Allahu na nderoi ne me Islamin dhe që na lartësoi duke na bërë ndjekësit e tu dhe të Islamit? Nuk kemi nevojë për një paqe të këtillë. Derisa Allahu të japë vendimin përfundimtar mes nesh dhe atyre, ne nuk kemi asgjë për t'u dhënë atyre veç shpatës!", – tha Sad bin Muadhi.

- "*Ti e di.*", – u përgjigj i Dërguari i Allahut. Dhe, sakaq, letrën e marrëveshjes e mori Sad bin Muadhi dhe tha:

- "Hajde, të vijnë të na sulmojnë po ua mbajti!"[37]

Omeri (radijallahu anhu) thotë se: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më merrte dhe mua me vete, dhe të dy tok shkonim tek Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe me njëri-tjetrin diskutonim për punët e problemet e myslimanëve."[38]

Këshillimi i Ebu Bekrit (r.a.) me të zotët e fjalës

Ibni Sadi na përcjell nga Kasimi se: "Sa herë që i shfaqej ndonjë problem, Ebu Bekr Besniku (radijallahu anhu) thërriste disa përfaqësues nga mërgimtarët dhe ensarët; veçanërisht Omerin, Osmanin, Aliun, Abdurrahman bin Aufin, Muadh bin Xhebelin, Ubej bin Ka'bin dhe Zejd bin Thabitin (radijallahu anhum). Të gjithë këta ishin njerëz që jepnin mendime dhe këshilla për çështje nga më të ndryshme në kohën e kalifatit të Ebu Bekrit. Pyetjet që bënin

[37]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/105.
[38]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 7/364 (18670).

njerëz u çoheshin t'i gjykonin ata njëherë. Edhe kur pas Ebu Bekrit (radijallahu anhu) në krye të kalifatit erdhi Omeri (radijallahu anhu), ai vazhdonte t'i thërriste këta personalitete dhe këshillohej me ta për çdo gjë. Në kohën e udhëheqjes së Omerit (radijallahu anhu) çështjet e ndryshme që kishin nevojë për fetva i trajtonin Osmani, Ubeji dhe Zejdi (radijallahu anhum)."[39]

Dialogu i Ebu Bekrit (r.a.) me Omerin (r.a.) për dhënien e një toke thesari të thatë

Tregon Abideja: "Ujejne bin Hisni me Akra bin Habisin erdhën pranë Ebu Bekrit dhe i thanë:

- "O kalifi i të Dërguarit të Allahut! Shumë afër nesh gjendet një fushë shterpë, nuk mbin as bar as ndonjë gjë tjetër me vlerë. Nëse e sheh me vend, na e jep neve atë tokë, që ta punojmë e të përpiqemi të mbjellim në të."

Menjëherë, Ebu Bekri ua caktoi atyre atë tokë, madje u lëshoi edhe një dokument për të dëshmuar vullnetin e tij; veç kësaj, ai u kërkoi atyre që të shkonin njëherë të merrnin edhe mendimin dhe nënshkrimin e Omerit (radijallahu anhu). Mirëpo, në atë kohë, Omeri (radijallahu anhu) nuk gjendej aty. Megjithatë, ata të dy e morën letrën që u dha Ebu Bekri (radijallahu anhu) dhe shkuan të gjenin Omerin (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu), kur dëgjoi ato që thuheshin në atë letër, ua mori atë nga dora dhe e grisi. Ujejneja me Akranë u nevrikosën, madje edhe thanë fjalë të pahijshme për Omerin (radijallahu anhu). Megjithatë, Omeri (radijallahu anhu) u tha atyre:

- "Profeti ynë i nderuar, për t'i ngrohur zemrat tuaja me Islamin në ato ditë kur Islami ishte shumë i dobët, ju pati njohur një varg privilegjesh. Mirëpo, sot, Allahu e ka bërë Islamin të fuqishëm. Kështu që, ejani tani, kthehuni nga keni ardhur a shkoni ku të doni! Bëni ç't'u vijë ndoresh, e më ngrini edhe pusi po deshët. E nëse bëni ndonjë gjë kundër meje, Allahu jua ktheftë juve të keqen që do të çoni nëpër

[39]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/849 (14105).

mend!" Të nevrikosur, siç ishin, ata dy vetë u kthyen tek Ebu Bekri (radijallahu anhu), për t'i thënë atij:

- "Uallahi, nuk kuptuam asgjë; ti je kalif këtu, apo Omeri?", – e pyetën ata Ebu Bekrin (radijallahu anhu).

- "Përkundrazi, ai është kalifi!", – u përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).

- "Po të donte ai, do të ishte bërë edhe ajo që kërkonit ju, e për të cilën keni ardhur deri këtu." Në atë kohë, tek Ebu Bekri (radijallahu anhu) hyri Omeri (radijallahu anhu) gjithë nerva, qëndroi te kryet e Ebu Bekrit dhe i tha:

- "Pa më thuaj njëherë, pasurinë tënde e kishe atë tokë që deshe t'ua jepje atyre dy njerëzve, apo ishte ndonjë nga tokat e përbashkëta, që u përkasin të gjithë myslimanëve?"

- "Ishte pronë e përbashkët e të gjithë myslimanëve.", – u përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).

- "Atëherë, pse ua caktove atyre të dyve dhe jo ndonjë bashkësie tjetër prej myslimanëve?", – iu kundërvu Omeri (radijallahu anhu). Mirëpo Ebu Bekri (radijallahu anhu)tha:

- "U këshillova me aksh e aksh person që i kisha afër në atë kohë dhe ata më këshilluan që t'ua jepja."

- "Po pse, mos vallë, kur këshillohesh me ndonjë grup të caktuar njerëzish që ke afër në atë kohë, kjo do të thotë që ke marrë pëlqimin e të gjithë myslimanëve?"

- "Unë ty ta pata thënë, që ti je më i denjë për këtë detyrë të kalifit, mirëpo ti ishe ai që më bindi mua dhe unë ia vura vetes këtë barrë mbi supe.", – u përgjigj Ebu Bekri (radijallahu anhu).[40]

Këshillimi i Ebu Bekrit (r.a.) me sahabët gjatë luftës

Abdullah bin Amri (radijallahu anhu) na tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) i pati shkruar Amr bin Asit këtë letër: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) këshillohej vazhdimisht me ata

[40]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 3/1496 (9151).

që kishte përreth në lidhje me luftën, aman, as ti mos e lër pas dore këshillimin me të tjerët!"[41]

Këshillimi i Omerit (r.a.) me të zotët e fjalës

E tregon Ebu Xhaferi: "Omeri (radijallahu anhu) i kërkoi Aliut (radijallahu anhu) dorën e së vajzës, Ummu Kulthumit. Aliu (radijallahu anhu) tha:

- "Vajzat kisha menduar t'ua jepja djemve të Xhaferit."

- "O Ali, martoje atë me mua! Uallahi, mbi tokë nuk ka njeri që mund të kujdeset për të më mirë sesa unë."

- "Në rregull, ta dhashë dorën e saj.", – tha Aliu (radijallahu anhu).

Pas njëfarë kohe, Omeri (radijallahu anhu) erdhi në Xhaminë e Profetit, ku gjendet edhe varri i bekuar, ku ishin ulur muhaxhirët. Aty ishin ulur bashkë Aliu, Osmani, Zubejri, Talhaja dhe Abdurrahman bin Aufi (radijallahu anhum). Dhe, sa herë që vinte ndonjë lajm nga jashtë, Omeri (radijallahu anhu) vinte pranë tyre, u bënte të ditur se si qëndronte puna dhe u kërkonte t'i jepnin mendim se çfarë të bënin. Kësaj here, kur erdhi, ai u tha atyre:

- "Dua të më martoni!"

- "E kë kërkon për nuse?", – e pyetën ata.

- "Vajzën e Ali bin Ebi Talibit!", – dhe shkakun ua përshkroi atyre me fjalët:

- "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na ka thënë se 'në ditën e Kiametit të gjitha lidhjet farefisnore do të zhbëhen, përveç lidhjeve farefisnore të familjes së tij. Unë kam qenë shoku i tij në këtë botë; desha të jem afër tij edhe në jetën e përtejme, duke u lidhur me të nëpërmjet farefisnisë."[42]

Këshillimet e Omerit (r.a.) dhe Osmanit (r.a.) me Ibni Abasin

Ata bin Jesari tregon: "Omeri (radijallahu anhu), por edhe Osmani

[41]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 5/575 (9623).
[42]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 3/44 (2633).

(radijallahu anhu), e thërrisnin Ibni Abasin pranë dhe këshilloheshin me të, duke i kërkuar mendim lidhur me ndonjë çështje që i shqetësonte. Megjithëse Ibni Abasi ishte ende një djalë i ri, ai kishte qenë këshilltari i dy kalifëve që kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit dhe u jepnin njerëzve gjykime dhe fetva në lidhje me çështje nga më të ndryshmet. Derisa vdiqën, ata ishin njerëzit që u morën me dhënien e gjykimit dhe të lejimeve."

Jakub bin Jezidi tregon: "Omeri (radijallahu anh), për çdo çështje që i dukej e një rëndësie të posaçme këshillohej me Ibni Abasin dhe i thoshte:

- "Pa eja këtu, o zhytës! Zhytu njëherë në këtë çështje, shih si mund ta zgjidhim!"

Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) thotë se: "Unë nuk kam parë ndonjëherë ndonjë njeri që t'i kuptonte çështjet më shpejt se Ibni Abasi, njeri më të ditur dhe, përveçse të ditur edhe po aq të butë në temperament. Më kujtohet mjaft mirë, edhe Omeri (radijallahu anhu), për ato çështje që i dukeshin shumë të vështira për t'u zgjidhur, megjithëse pranë vetes i rrinin njerëz që kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit, atë thërriste dhe i thoshte:

- "Ja ku të erdhi edhe një tjetër çështje e vështirë për t'u zgjidhur.", – dhe kurrë nuk dilte nga fjala e tij."

E tregon Ibni Shihabi: "Omeri (radijallahu anhu), kur i dilte ndonjë problem i vështirë për t'i gjetur zgjidhje, thërriste të rinjtë dhe këshillohej me ta, për t'u peshuar mprehtësinë e mendjes (zgjuarsinë)."

Ibni Sirini thotë se: "Omeri (radijallahu anhu) këshillohej me të gjithë, madje edhe me gratë. Ndonjëherë qëllonte që i pëlqente mendimi i ndonjërës prej tyre dhe ashtu vepronte, sipas fjalës së saj."[43]

Një hutbe plot retorikë e Omerit (r.a.) për këshillimin me të tjerët

Se si ka ndodhur na e tregojnë Muhamedi, Talhaja dhe Zijadi (radijallahu anhum): "Omeri (radijallahu anhu) ishte nisur për në luftë. Në vendin e quajtur "Uji i Sirarit" ndaluan dhe e ngritën aty

[43]. Bejheki, *Sunen,* 10/113 (20119).

vendpushimin e ushtrisë. Njerëzit nuk e dinin qëllimin e Omerit (radijallahu anhu): Omeri (radijallahu anhu), do të vazhdonte rrugën, apo do të qëndronte aty për njëfarë kohe? [...] Osmani (radijallahu anhu) e pyeti atë:

- "Çfarë ke ndërmend të bësh?" Dhe Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj duke i thënë:

- "Essalatu xhamiatun." dhe i ftoi sakaq njerëzit të bëheshin gati për të falur namazin. Të gjithë u mblodhën përreth tij. Omeri (radijallahu anhu) u dërgoi fjalë edhe Aliut (radijallahu anhu), të cilin e kishte lënë në Medinë si mëkëmbësin e tij, ashtu si edhe Talhasë (radijallahu anhu), të cilin e kishte vendosur në krye të forcave pararojë, që të vinin aty edhe ata. Pastaj në krahun e djathtë të ushtrisë caktoi Zubejrin (radijallahu anhu), ndërsa në të majtin caktoi Abdurrahman bin Aufin (radijallahu anhu). Paskëtaj u çua në këmbë dhe mbajti këtë fjalë:

- "O njerëz! Allahu i bashkoi zemrat e të gjithë myslimanëve nëpërmjet Islamit, ua ngrohu atyre zemrat kundrejt njëri-tjetrit, duke i shndërruar ata në vëllezër në fe. Ata që besojnë janë të gjithë si një trup i vetëm dhe çdo lëvizje në një organ të caktuar të trupit ndihet menjëherë edhe në çdo organ tjetër. Andaj, myslimanët duhet të jenë përherë në unitet e të përbashkuar, dhe çdo punë që do të bëjnë, duhet ta kryejnë atë duke u këshilluar ndërmjet veti, duke marrë edhe mendimin e të gjithë atyre që janë të zgjuar dhe largpamës. Për sa kohë që ky popull të jetë i bashkuar, të gjithë do t'i binden atyre që u është caktuar detyra për t'i drejtuar të tjerët. Ashtu siç edhe drejtuesi është përgjegjës dhe duhet t'u bindet vendimeve të grupeve të këshillimit.

O njerëz! Edhe unë një individ si ju isha, e kisha shumë dëshirë, që bashkë me ju, të merrja edhe unë pjesë në luftë. Mirëpo të zotët e fjalës e të mendimit në mesin tuaj më bënë të hiqja dorë nga kjo dëshirë. Prandaj, e pashë me vend që vetë të qëndroj në qytet dhe në krye të ushtrisë t'ju caktoj një tjetër si komandant. Prandaj edhe kërkova që kur t'jua bëja të ditur këtë vendim, këtu të ishin të pranishëm edhe Aliu, të cilin e pata lënë si mëkëmbës në Medinë, edhe Talhaja, të cilin e kisha caktuar në krye të pararojës."[44]

[44]. Taberi, *Tarih,* 2/381.

8. EMËRIMI I DREJTUESVE

Komandanti i parë i emëruar: Abdullah bin Xhahshi

Sad bin Ebi Uekasi (radijallahu anhu) na tregon: "Kur erdhi Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) në Medinë, aty erdhi një grup nga fisi i Xhuhejnes, të cilët thanë:

- "O Muhamed! Ti zgjodhe të vish në mesin tonë, na jep edhe neve një garanci, që të vijmë edhe ne të gjithë si fis e të bëhemi myslimanë." Kur i Dërguari i Allahut u dha atyre garancinë e kërkuar prej tyre, njerëzit e atij fisi u bënë të gjithë myslimanë.

Në muajin Rexhep, Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na pati dërguar ne të sulmonim një degë nga fisi i bijve të Kinanes, të cilët ishin fqinj me fisin e Xhuhejnes. Nuk bëheshim më shumë sesa njëqind vetë. I sulmuam, mirëpo ata ishin të shumtë në numër. Për këtë arsye, ne kërkuam mbrojtje nga fisi i Xhuhejnes dhe ata na mbrojtën, por na pyetën:

- "Po pse po luftoni tani, në muajin Rexhep, ne e dimë se ky është një muaj, në të cilin është e ndaluar të luftohet?"

- "Kësaj here është ndryshe. Kësaj here ne po luftojmë me njerëz që na përzunë nga toka e bekuar dhe për më tepër në këtë muaj të bekuar.", – u justifikuam ne.

Pastaj iu drejtuam njëri-tjetrit dhe thamë:

- "Po tani ç'do të bëjmë?" Dikush thoshte: "Të shkojmë të vëmë në dijeni të Dërguarin e Allahut."; dikush tjetër thoshte: "Jo, të qëndrojmë këtu." Sakaq, unë dhe disa shokë thamë:

- "Jo, më mirë të ikim; t'ia presim rrugën karvanit të kurejshëve."

Asokohe, gjykimi në lidhje me plaçkën e luftës ishte ky: "Kushdo mund të merrte gjithçka që arrinte ta merrte vetë. Prandaj, edhe ne vendosëm të sulmonim karvanin e kurejshëve që do të kalonte atypari, ndërsa shokët e tjerë u kthyen pranë Profetit tonë. Kur i treguan se çfarë kishte ndodhur, i Dërguari i Allahut ishte nxehur shumë, aq sa fytyra i ishte bërë e kuqe flakë, ishte çuar në këmbë dhe kishte thënë:

- "*Megjithëse nga unë u larguat të bashkuar, ju tani po ktheheni të përçarë?*

Ata që erdhën përpara jush kjo i shkatërroi, vetëm e vetëm përçarja. Tani, megjithëse nuk është më i miri dhe më i mbari ndër ju, unë do t'ju caktoj juve si komandant atë që i duron më së shumti, si urinë, ashtu edhe etjen, dhe do t'ju nis për atje!", – dhe ashtu bëri, i dërgoi prapë për andej nga kishin ardhur, duke u vënë si komandant në krye Abdullah bin Xhahsh el-Esediun. Kësisoj, Abdullah bin Xhahshi u bë komandanti i parë i emëruar në Islam."[45]

Emërimi i një komandanti për një grup prej dhjetë vetash

Shihab el-Anberiu tregon: "Zjarrin e parë në portën e qytetit të Tusterit e pata ndezur unë. Ebu Musa el-Esh'ari ishte plagosur nga një shigjetë. Në çastin që myslimanët ngadhënjyen mbi qytet, Ebu Musai më caktoi mua si komandant në krye të një grupi të përbërë prej dhjetë vetash."[46]

Kur caktohet një imam gjatë udhëtimit

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: "Kur tre vetë dalin për të udhëtuar, të caktojnë njërin syresh si imam. Ky njeri është njësoj si imamët e emëruar prej të Dërguarit të Allahut."[47]

9. KUSH DUHET BËRË DREJTUES?

Në mesin e bashkësisë rolin e drejtuesit e meriton ai që e di më shumë Kur'an

Na është transmetuar prej Ebu Hurejres (radijallahu anhu) se: "Njëherë, Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) do të dërgonte diku një ekspeditë ushtarake shumë të madhe në numër dhe i vuri të gjithë sa ishin pjesë e asaj ushtrie të këndonin një pjesë nga Kur'ani. Secili këndoi atë pjesë që dinte më mirë. Sakaq, Resulullahu u afrua pranë njërit që dukej se ishte më i ri nga të tjerët dhe e pyeti:

- "*O filan, sa pjesë di ti përmendësh nga Kur'ani?*" E ai iu përgjigj:

- "Di këtë e atë sure, por di edhe të gjithë suren 'Bekare'."

---

[45]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/278.
[46]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/109.
[47]. Ebu Daud, *Sunen,* 2/42 (2608).

- "*Domethënë ti e di përmendësh të tërë suren 'Bekare', apo jo?*"

- "Po!", – u përgjigj ai djalë.

- "Nëse është kështu, atëherë në krye do të kalosh ti. Ti do të jesh komandanti i ushtrisë.", – i tha atij i Dërguari i Allahut.

Në atë çast një që ishte ndër njerëzit më të nderuar në radhët e luftëtarëve u hodh edhe tha:

- "Uallahi, ajo që më ka penguar mua ta mësoj suren 'Bekare' përmendësh ka qenë shqetësimi se mos pastaj nuk veproj ashtu siç duhet; nuk kam asnjë arsye tjetër."

- "*Mësojeni Kur'anin dhe lexojeni atë duke e kënduar. Kush e mëson Kur'anin dhe e lexon vazhdimisht atë, do të fillojë t'i ngjajë një parfumi erëmirë, aromat e të cilit shpërndahen gjithkah e shkaktojnë kënaqësi. Kushdo që e mëson Kur'anin dhe edhe pse e di atë përmendësh, bie të flejë pa kënduar prej tij, është njësoj si një enë parfumi e mbyllur.*", – tha atëherë i Dërguari i Allahut.[48]

Droja e Ebu Bekrit (r.a.) nga caktimi komandant ndonjërin prej luftëtarëve të luftës së Bedrit

E tregon Ebu Bekr bin Muhamed el-Ensari: "Ebu Bekrin (radijallahu anhu) e patën pyetur:

- "O kalifi i të Dërguarit të Allahut! Pse nuk zgjedh asnjëherë ndonjë prej atyre që kanë marrë pjesë në luftën e Bedrit si komandant në krye të ushtrisë?" Dhe ai u dha këtë përgjigje:

- "Unë i njoh mjaft mirë vlerat e tyre! Por nuk dua që t'i ndot ata me ndyrësitë e kësaj bote!"[49]

Një letër e Omerit (r.a.) në lidhje me emërimin e një valiu

Harithe bin Mudarribi tregon: "Omeri (radijallahu anhu) na pati shkruar ne këtë letër:

- "Unë po ju dërgoj juve Amar bin Jasirin si vali, ndërsa Abdullah bin Mesudin si mësues dhe ndihmës të tij. Që të dy janë prej sahabëve

[48]. Tirmidhi, *Sunen,* 5/156 (2876).
[49]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/37.

më të dalluar të të Dërguarit Fisnik dhe që të dy kanë qenë luftëtarë në luftën e Bedrit. Ata do t'ju mësojnë juve fenë, ndaj binduni fjalës së tyre. Jua dërgova vërtet Abdullah bin Mesudin, por ta dini se duke e dërguar atë atje, tek ju, në fakt, unë kam privuar veten, duke menduar më shumë për ju sesa për veten. Kurse në rrethinat dhe fshatrat e Irakut kam dërguar Osman bin Hunejfin dhe, si pagesë për ta kam caktuar një dele në ditë. Gjysma e deles dhe të përbrendshmet i takojnë Amar bin Jasirit; kurse gjysma tjetër t'u ndahet të treve në mënyrë të barabartë."[50]

Ata që e morën përsipër detyrën e valiut dhe gjetën shpëtimin

Shakik bin Selemeja tregon: "Omeri (radijallahu anhu) caktoi Bishr bin Asimin (radijallahu anhu) për të mbledhur zekatin e fisit të Heuazinit. Bishri u ndrojt dhe nuk shkoi. Kur u takua me të, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- "Po pse nuk shkove atje ku të dërgova unë? A nuk e ke për detyrim që të ma dëgjosh fjalën dhe t'i bindesh asaj?"

- "Pa diskutim!", – u përgjigj menjëherë Bishr bin Asimi. – "Unë e di që jam i detyruar t'i bindem të parit tonë në çdo fjalë që thotë. Mirëpo unë kam dëgjuar Profetin kur ka thënë se:

- "*Kushdo prej myslimanëve që e merr përsipër një detyrë, në ditën e Kiametit do ta sjellin dhe do ta mbajnë mbi urën e Xhehenemit. Nëse është sjellë mirë, atëherë ai është i shpëtuar, por nëse nuk ka vepruar mirë e drejt, atëherë toka ku vë këmbë ai do të çahet dhe ai do të rrokulliset në një humbellë shtatëdhjetë vite të thellë.*"

Omeri (radijallahu anhu) e dëgjoi me kujdes përgjigjen e Bishrit dhe pa thënë asnjë fjalë, u largua së andejmi i trishtuar dhe i mërzitur sa më s'ka. Në rrugë ai u takua me Ebu Dherrin. Ebu Dherri ia priti duke i thënë:

- "O Prijësi i Besimtarëve, po të shoh shumë të lodhur e të mërzitur."

- "E si të mos jem i mërzitur, isha me Bishr bin Asimin. Më tregoi hadithin e të Dërguarit të Allahut që thotë: "*Kushdo nga myslimanët që e*

[50]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/878 (11636).

merr përsipër një detyrë..." Ebu Dherri e pyeti:

- "Po pse, a nuk e kishe dëgjuar ti nga Resulullahu vetë këtë hadith?"

- "Jo!", – u përgjigj Omeri (radijallahu anhu) dhe tha:

- "Unë dëshmoj përpara Allahut se unë Resulullahun e kam dëgjuar se ka thënë: "*Kushdo nga myslimanët që i ngarkon një punë një tjetër myslimani, atë njeri do ta sjellin në Ditën e Gjykimit dhe do ta lënë në mes të urës së Xhehenemit. Nëse ai e ka kryer mirë detyrën e tij, do të shpëtojnë, si ai që e ka kryer atë detyrë, ashtu edhe ai që ia ka ngarkuar atë detyrë. Përndryshe, nëse e ka kryer keq detyrën, atëherë toka në të cilën qëndron do të çahet dhe ai do të rrokulliset në një humbellë të zezë pus shtatëdhjetë vite të thellë.*"

- "Po mirë, kush nga këta hadithe të shkaktoi më shumë dhimbje në zemër?", – e pyeti Ebu Dherri.

- "Që të dy ma çanë zemrën në mes. Kush është ai që e merr përsipër detyrën e kalifatit i gjendur përballë kaq shumë rreziqesh?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu)Ebu Dherrin.

- "Kalifatin vetëm ai që Allahu ia ka fshirë hundën përdhe dhe që e ka shpallur të poshtër mund ta kërkojë. Unë kaq të them ty, o Omer, ne nuk dimë asgjë veç të mirave për ty. Por, nëse kalifatin do t'ia lësh dikujt që nuk do të dijë të veprojë me drejtësi, atëherë ta dish se nuk do t'i shpëtosh dot barrës së përgjegjësisë!"[51]

10. SAHABËT NUK PRANOJNË DETYRA DREJTUESE

Fjalët e të Dërguarit të Allahut për Mikdad bin Esuedin

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e pati dërguar Mikdad bin Esuedin si drejtues në një vend. Nuk kaloi shumë kohë dhe kur Mikdadi u kthye prej andej, i Dërguari i Allahut i pati thënë:

- "*Si t'u duk të qenët drejtues?*"

- "Pashë që njerëzit herë më ngrinin në qiell, herë më poshtëronin e më fusnin nën dhe. Asisoj që, pas njëfarë kohe fillova të dyshoj te vetja!", – u përgjigj Mikdadi.

---

[51]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 5/371 (9040).

- "*Po, kështu është kur je drejtues.*", – ia priti Resulullahu ynë i dashur.

- "Unë i betohem Allahut që të dërgoi ty me fenë e së vërtetës, se këtej e tutje unë nuk do të pranoj më asnjë rol drejtues.", – tha Mikdadi.

Kur besimtarët i thoshin:

- "O Mikdad, dil përpara e na e fal ti namazin.", – ai edhe nga të dalët imam, për t'u falur namazin të tjerëve, druhej."[52]

Kurse, në një tjetër përcjellje që i bëhet kësaj ngjarjeje, Mikdad bin Esuedi (radijallahu anhu) ka thënë: "Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi mua si komandant në krye të një ekspedite luftarake. Kur u ktheva, ai më pyeti:

- "*Si e ndien veten?*" Dhe unë iu përgjigja e i thashë:

- "Më kaploi një ndjesi e atillë, që të gjithë sa kisha përreth më dukeshin si shërbëtorët dhe ndihmësit e mi. Uallahi, këtej e tutje, nuk dua të jem më drejtues, qoftë edhe midis dy vetëve."[53]

Këshillat e Ebu Bekrit (r.a.) për ata që kishin role drejtuese

E tregon Rafi et-Taiu: "Gjatë një lufte më ra rasti të isha bashkudhëtar me Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Teksa po ktheheshim, e pyeta:

- "O Ebu Bekr! Më jep ndonjë këshillë të vyer." Ai m'u përgjigj:

- "Fali në kohën e tyre namazet që janë detyrim për besimtarët dhe jepe me gjithë zemër pjesën e zekatit të caktuar nga pasuria jote, agjëro gjatë muajit të Ramazanit dhe kryej detyrën e haxhit. Në Islam, hixhreti është një gjë shumë e mirë. Por, nëse gjatë mërgimit të bie që edhe të luftosh, kjo është diçka edhe më e mirë. Vetëm një gjë, mos u bëj kurrë drejtues! Ajo shkallë e të qenët drejtues që sot njerëzit i shmangen e i druhen pranimit të saj, nuk do të kalojë shumë kohë dhe do të përhapet aq shumë, sa që shumë herë do të kalojë edhe në duart e shumë njerëzve që nuk janë të denjë për të. Në ditën e Kiametit, drejtuesit (udhëheqësit) do të duhet të japin llogari shumë herë më gjatë dhe do të meritojnë ndëshkime shumë herë më të ashpra sesa të tjerët. Gjithë të tjerët, që nuk kanë qenë drejtues do ta kenë të

[52]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 5/364 (9024).
[53]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 20/258 (609).

lehtë llogaridhënien e të pakta do t'i kenë edhe shqetësimet, sepse në pozicionin e drejtuesit ekzistojnë gjithmonë mundësitë për t'u treguar i padrejtë me besimtarët. Nëse u bëjnë padrejtësi besimtarëve, ata do të shkelin fjalën që i kanë dhënë Allahut, sepse besimtarët janë fqinjët e Allahut, janë robërit më të zgjedhur të Tij. Unë i betohem Allahut, se, ashtu siç çdonjëri prej jush shqetësohet gjatë natës se mos i ndodh ndonjë gjë deles a devesë së fqinjit të vet dhe nervozoheni nëse ndodh dhe thoni: "Aman, ç'i ndodhi deles, devesë së fqinjit tim!", edhe Allahu mërzitet akoma edhe më shumë kur besimtarëve, të cilët janë fqinjët e Tij, u bëhet ndonjë padrejtësi."[54]

Rafiu thotë se: "Kishte kaluar vetëm një vit nga ky takim, kur unë dëgjova që Ebu Bekri ishte zgjedhur kalif. I hipa kafshës dhe u nisa të shkoja tek Ebu Bekri, e kur mbërrita i thashë atij:

- "Mua më quajnë Rafi, kam bërë inspektime në aksh e aksh vend, sipas porosive që më pate dhënë ti.", – i thashë unë.

- "Po, të njoha.", – m'u përgjigj ai.

- "Ti më pate porositur që unë të mos bëhesha drejtues; mirëpo, për vete paske pranuar të marrësh përsipër rolin drejtues më të lartë, që është ai i të qenët kalif i mbarë umetit!", – i thashë unë.

- "Ashtu është, ke të drejtë.", – më tha mua Ebu Bekri. – "Mirëpo mallkimi i Allahut qoftë mbi atë që nuk vepron sipas librit të Allahut me umetin e Muhamedit!"[55]

Sahabët fisnikë zgjidhnin më mirë të luftonin në rrugën e Allahut, sesa të ishin drejtues

Sipas një transmetimi të Said bin Omer bin Said bin Asit, xhaxhallarët e tij, Halidi, Ebani dhe Amr bin Saidi, me të marrë vesh se ishte ndarë nga kjo jetë Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ata e braktisën detyrën e tyre, për t'u kthyer në Medinë. Ebu Bekri (radijallahu anhu) u tha atyre:

- "Askush nuk mund të jetë më i denjë për këto detyra sesa ata që i

[54]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/290 (14288).
[55]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 5/365 (9029).

ka caktuar vetë Resulullahu. Kështu që, edhe ju kthehuni ku ishit dhe kryejeni mirë detyrën tuaj." Mirëpo ata i thanë Ebu Bekrit:

- "Ne nuk bëhemi nëpunësit e askujt tjetër, pos Profetit të nderuar.", – duke u zhvendosur ndërkaq në drejtim të territoreve të Sirisë, atje morën pjesë nëpër luftëra, derisa ranë të tre dëshmorë njëri pas tjetrit."[56]

Ebu Hurejreja nuk e pranon propozimin e Omerit (r.a.) për ta bërë atë vali

Është një transmetim i përcjellë prej vetë Ebu Hurejres (radijallahu anhu); Omeri (radijallahu anhu) e thërret atë për ta caktuar diku si vali. Ebu Hurejreja nuk pranon. Omeri (radijallahu anhu) e pyet atë:

- "Po ti pse nuk e pranon një detyrë, të cilën e ka kërkuar edhe dikush tjetër që është më i mirë se ti?"

- "E kush na qenkësh ai njeri më i mirë se unë, pa më thuaj?", – e pyet Ebu Hurejreja me qesëndi.

- "I biri i profetit Jakub, profeti Jusuf!", – ia pret Omeri (radijallahu anhu).

- "Po Jusufi është profet e bir profeti! Kurse unë nuk jam veçse Ebu Hurejreja, i biri i Umejmes. Unë kam shumë frikë nga dy-tri gjëra.", – thotë Ebu Hurejreja.

- "Thuaj më mirë që ke frikë nga pesë gjëra!", – ia pret Omeri (radijallahu anhu).

- "Kam shumë frikë se mos them ndonjë gjë që nuk e di mirë as vetë, se mos jap vendime të pabazuara mirë, se mos ma punon kush pas shpine, se mos ma merr dikush pasurinë nga duart dhe se mos del dikush e më shan nderin.", – u përgjigj Ebu Hurejreja."[57]

Ibni Omeri nuk pranon të bëhet gjykatës

Sipas një transmetimi të Ibni Omerit (radijallahu anhu), kur Osmani

[56]. El-Hakim, *Mustedrek* 3/278 (5085).
[57]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/380.

(radijallahu anhu) i ka propozuar që të bëhet gjykatës, Ibni Omeri nuk ka pranuar, duke i thënë:

- "Unë kam dëgjuar Resulullahun (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) kur ka thënë këto fjalë: "*Gjykatësit janë tri farësh: njëri prej tyre shpëton, dy të tjerët hidhen në zjarr. Ata që japin vendime të padrejta, apo që vendosin sipas dëshirave të tyre personale do të shkatërrohen. Vetëm ata që i japin vendimet duke u bazuar tek e drejta janë të shpëtuar!*"[58]

11. RESPEKTI PËR KALIFËT DHE DREJTUESIT E TJERË DHE BINDJA E PAKUSHTËZUAR NDAJ URDHRAVE TË TYRE

Një ndodhi që ka ngjarë mes Halid bin Uelidit (r.a.) dhe Amar bin Jasirit (r.a.)

Na e tregon Ibni Abasi (radijallahu anhu): "Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi një ekip ushtarak nën komandën e Halid bin Uelidit (radijallahu anhu). Pjesë e atij ekipi ishte edhe Amar bin Jasiri. U nisën. Gjatë natës, ata u vendosën për të pushuar në një vend që nuk ishte edhe aq larg vendit për ku ishin nisur. Njerëzit e bashkësisë që do të sulmonin myslimanët ia patën mbathur, duke i braktisur tërësisht vendbanimet e tyre. Aty kishte mbetur vetëm një njeri i vetëm, i cili nuk kishte ikur si të tjerët. Bashkë me pjesëtarët e familjes së tij ai ishte bërë mysliman, pra edhe ai që ishte aty ishte një besimtar. Ky njeri u kishte urdhëruar familjarëve të tij që të mblidhnin plaçkat dhe të prisnin aty, pa lëvizur, derisa të kthehej ai dhe, sakaq, kishte shkuar në vendin ku po pushonin ushtarët myslimanë nën komandën e Halid bin Uelidit, kishte pyetur se ku mund të gjente Amar bin Jasirin, pati shkuar pranë tij dhe i pati thënë:

- "O Eba Jakdhan, unë dhe pjesëtarët e tjerë të familjes sime u bëmë myslimanë. Siç e dini, populli ynë ia mbathi. Vallë, a na bën ne ndonjë dobi fakti që u bëmë myslimanë?"

- "Mos lëviz nga vendi yt, ti je i sigurt, askush nuk do të të bëjë keq.", – i qe përgjigjur Amari dhe kësodore ai njeri qe kthyer te familja e tij.

---

[58]. Ibn Hibban, *Sahih,* 11/440 (5056).

Në të aguar, kur Halidi u vërsul mbi atë vend, atje nuk gjeti askënd, veç atij njeriu dhe familjarëve të tij, të cilët qenë bërë të gjithë myslimanë, megjithatë i lidhi edhe ata. Edhe pse Amari u hodh e i tha:

- "Mos e prek atë njeri! Ai është bërë mysliman.", Halidi ia priti me fjalët:

- "Ç'lidhje ke ti me këtë njeri? Këtu komandanti jam unë, me ç'të drejtë ngrihesh ti dhe u jep njerëzve garanci?"

- "Po, ti je komandanti, por edhe unë kam të drejtë të jap garanci në emrin tënd, sepse ai njeri ka besuar. Po të donte mund të kishte ikur edhe ai bashkë me shokët e vet. Por nuk iku, qëndroi në vend, pasi u bë mysliman dhe unë i thashë të rrinte e të mos largohej.", – u përgjigj Amari.

Diskutuan për një kohë të gjatë. Kur u kthyen në Medinë, ata vendosën të shkonin tek i Dërguari i Allahut, që të vendoste ai se kush ishte më e drejta e kësaj çështjeje. Amari tregoi gjithçka për atë njeri dhe i tha të Dërguarit të Allahut se ai ishte një njeri që kishte besuar dhe ishte bërë sakaq mysliman. Resulullahu e cilësoi të vlefshme garancinë që kishte dhënë Amari; mirëpo, që prej asaj dite ai ua ndaloi besimtarëve që t'i jepnin ndokujt garanci pa njoftuar njëherë komandantin që kanë mbi krye. Këto dy personalitete hodhën e pritën ndaj njëri-tjetrit edhe në praninë e Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Halidi tha:

- "O Resulallah! Si guxon ky skllav të më ofendojë mua në praninë tënde? I betohem Allahut, që po të mos ishe ti ky njeri nuk do të guxonte të fliste kështu me mua!"

- "*Halid!*", – ndërhyri Profeti ynë i dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), – "*Mos i bjer Amarit në qafë! Sepse atë që e merr inat Amari e merr inat edhe Allahu dhe atë që mallkon Amari e mallkon edhe Allahu.*"

Amari u ngrit me vërtik dhe ashtu siç ishte, i nevrikosur, u largua prej andej. Halidi i vrapoi nga pas dhe e kapi pas petkut që kishte veshur; u përpoq ta merrte me të mirë. Por edhe Amari ia bëri vetë të ditur se ia kishte bërë hallall gjithë sa kishte thënë për të. Për këtë ngjarje është zbritur edhe ajeti: "**O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në**

ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është për ju më e mira dhe shpjegimi më i bukur." (Nisa, 4/59)[59]

Një ngjarje e ndodhur mes Auf bin Malikut dhe Halid bin Uelidit

E tregon Auf bin Malik el-Esh'ari (radijallahu anhu): "Në mesin e myslimanëve që u nisën për në luftën e Mu'tes, nën komandën e Zejd bin Harithes, kam qenë edhe unë. Njëri prej luftëtarëve të forcave mbështetëse që kishin ardhur nga Jemeni për të na u gjendur në ndihmë u bë shok me mua. Ky shok nuk kishte asgjë tjetër, pos shpatës. Në rrugë e sipër, njëri prej myslimanëve theri një deve. Ai shok i imi nga Jemeni i kërkoi atij një copë nga lëkura e devesë dhe ia dhanë. Ai e bëri atë mburojë për vete. Mandej ne vazhduam rrugën, derisa përballë na u shfaqën tokat e bizantinëve. Në mesin e bizantinëve gjendej një burrë i hipur mbi një kalë jelet e të cilit ishin veshur me flori. Edhe shpatën, dukej, e kishte të larë në flori. Ai kalorës bizantin filloi t'u shkaktonte shumë humbje njëra pas tjetrës radhëve të myslimanëve. Shoku im nga Jemeni i zuri pusi pas një shkëmbi që gjendej aty. Kur atypari kaloi kalorësi bizantin, ai një të vërsulur bëri dhe ia preu këmbët e kalit. Kalorësi u rrëzua përtokë. Ai shok nga Jemeni iu hodh përsipër dhe e vrau, mandej i mori edhe kalin dhe shpatën. Kur u pa se Allahu u kishte falur myslimanëve fitoren, Halid bin Uelidi (radijallahu anhu) i dërgoi fjalë atij luftëtari nga Jemeni, që të vinte tek ai bashkë me të gjitha plaçkat e atij kalorësi, që ishte veshur i tëri në flori. Me të marrë vesh, unë shkova menjëherë te Halidi dhe i thashë:

- "Halid! Ti a e di që i Dërguari i Allahut ka shpallur se plaçka e armikut të vrarë i takon atij që e ka vrarë?"

- "Po, e di; mirëpo ato janë shumë të çmuara, ndaj janë tepër për një njeri të vetëm.", – u përgjigj Halid bin Uelidi.

- "Halid, ose do t'ia japësh atij njeriu atë plaçkë që ai e ka marrë vetë me shpatën e tij, ose unë do të ankohem tek i Dërguari i Allahut për ty!"

[59]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 2/511 (4343).

Halidi nuk ia dha. Kur u kthyem në Medinë, u mblodhëm të gjithë pranë Resulullahut. Unë i tregova atij për ngjarjen e ndodhur mes Halidit dhe shokut tim nga Jemeni.

- "*O Halid! Çfarë të shtyu të veproje në këtë mënyrë?*"

- "O Resulullah, plaçka e atij që u vra vlen shumë dhe duke menduar se është tepër për një njeri të vetëm, vendosa t'ia merrja.", – u përgjigj Halid bin Uelidi.

- "*Halid, ktheja mbrapsht ato që i ke marrë!*", – urdhëroi Resulullahu.

- "Hë Halid, e shikon? A të thashë?", – iu drejtova unë Halidit.

- "*Si është puna? Çfarë ka ndodhur?*", – u hodh i Dërguari i Allahut e më pyeti mua kësaj radhe.

Unë ia tregova një më një fjalët që i kisha thënë Halidit dhe i Dërguari i Allahut u nevrikos e tha:

- "*Halid! Mos i kthe mbrapsht ato që ke marrë! A nuk është e mundur që të mos ndërhyni mes meje dhe komandantëve të mi? Të gjitha vështirësitë i heqin ata, kurse ju hani ajkën, në fund!*"[60]

Një ngjarje që ka ndodhur mes Amr bin Asit (r.a.) dhe Omerit (r.a.)

Tregon Abdullah bin Jezidi: "Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) pati dërguar një ekspeditë luftarake për në luftën e Dhatu's-Selasilit. Në atë ekspeditë merrnin pjesë edhe Ebu Bekri me Omerin (radijallahu anhuma). Kur mbërritën në vendin për ku ishin nisur, Amr bin Asi i paralajmëroi ata që kishte përreth që të mos ndizte askush zjarr. Omeri (radijallahu anhu) u nevrikos dhe vendosi të shkonte vetë tek Amri, mirëpo Ebu Bekri (radijallahu anhu) nuk e lejoi, duke i thënë:

- "Profeti ynë i nderuar e vendosi atë komandant mbi ty, sepse ai e njeh luftën më mirë nga të gjithë." Ky qortim i Ebu Bekrit (radijallahu anhu) mjaftoi për ta qetësuar Omerin (radijallahu anhu)."[61]

[60]. Ebu Daud, *Sunen,* 2/79 (2719).
[61]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/788 (35768).

Një fjalë e Ijad bin Gunmit për respektin që duhet të tregohet ndaj një komandanti

Xhubejr bin Nufejri na tregon: "Në kohën kur u ngadhënjye mbi Daranë, një prej qyteteve të Irakut, Ijad bin Gunmi pati rrahur udhëheqësin e Darasë. Hisham bin Hakimi erdhi pranë Ijadit dhe e qortoi, duke i thënë se nuk kishte vepruar aspak mirë duke e rrahur atë njeri në sy të të gjithëve. Më vonë, Hishami priti për disa net, por pastaj nuk duroi dot më dhe shkoi pranë Ijadit dhe i tha:

- "O Ijad! Po ti, a nuk e ke dëgjuar të Dërguarin e Allahut, që ka thënë se në ditën e Kiametit ndëshkimin më të ashpër do ta vuajnë ata që në këtë botë u kanë shkaktuar dhimbje dhe vuajtje njerëzve."

- "Hisham! Edhe ne e kemi dëgjuar këtë që ke dëgjuar ti, e i kemi parë të gjitha ato që i ke parë edhe ti, ashtu siç kemi marrë pjesë në të njëjtat mësime që ke marrë pjesë edhe ti. Por, o Hisham, po ti, a nuk e ke dëgjuar të Dërguarin e Allahut, kur ka thënë:

- "*Nëse ndonjëri prej jush do t'i japë ndonjë këshillë komandantit apo udhëheqësit të shtetit, të mos ia thotë atë në sytë e të gjithëve. Ta kapë përdore, ta çojë diku ku do të jenë vetëm për vetëm, atëherë t'ia thotë. Nëse e pranon këshillën tuaj, mirë, por nëse nuk e pranon, atëherë ai që e këshillon do të ketë bërë atë që i takon dhe duhet ta bëjë!*"

- "Hisham, si guxon ti të sillesh në atë mënyrë me një udhëheqës në fuqi! A nuk ke frikë se një udhëheqës, që i bindet urdhrave të prijësve të Allahut, mund të të vrasë, e ti do të jesh një prej atyre që është vrarë prej autoritetit të së lejuarës?"[62]

Fjalët e Hudhejfes (r.a.) kundrejt personit, cili i drejtoi shpatën udhëheqësit të tij, për gabimin e bërë

Tregon Zejd bin Uehbi: "Populli kishte ngritur krye kundër valiut të vendit ku jetonte edhe Hudhejfeja (radijallahu anhu) në lidhje me diçka. Hudhejfeja po rrinte i ulur në xhami, 'Xhaminë e Madhe', kur aty hyri një njeri që filloi të futej në mes të radhëve të besimtarëve,

[62]. El-Hakim, *Mustedrek,* 3/329 (5269).

derisa mbërriti te kryet e Hudhejfes, të cilit iu drejtua me fjalët:

- "O sahab i të Dërguarit të Allahut! Po ti a nuk je i ngarkuar me detyrën për të urdhëruar të mirën e për të parandaluar të keqen?" Hudhejfeja ngriti kokën. E kuptoi se ku donte të dilte ai njeri, andaj iu përgjigj atij duke i thënë:

- "Urdhërimi për mirë dhe ndalimi i së keqes është diçka shumë e mirë; mirëpo, as nxjerrja dhe as drejtimi i shpatës ndaj valiut (udhëheqësit territorial) të vendit tënd nuk bën pjesë në sunetin e të Dërguarit të Allahut!"[63]

Një tjetër transmetim për respektin që duhet treguar ndaj atij që ju drejton

E tregon Zijad bin Kesib el-Adeuiu: "Abdullah bin Amiri, kur lexonte ligjëratën e së premtes, vishej gjithmonë me rroba të holla e të lehta dhe tregonte një kujdes tejet të veçantë për krehjen e flokut. Edhe një ditë, ai fali namazin dhe u fut në shtëpinë e tij. (Njëri prej sahabëve) Ebu Bekreja ishte ulur ndanë minberit. Një njeri i quajtur Ebu Bilal Mirdasi i tha atij:

- "Shikoje njëherë prijësin e njerëzisë, shikojeni njëherë! Është veshur me rroba të lehta, do që t'u ngjajë të shthururve!" Ebu Bekreja kur dëgjoi fjalët e Mirdasit, ai i tha të birit:

- "Ma thirr pak Ebu Bilalin, të vijë këtu tek unë." Dhe ai e thërriti. Kur erdhi, Ebu Bekreja e priti me fjalët:

- "Pak më parë më erdhën në vesh fjalët që paske thënë për prijësin tonë. Unë kam dëgjuar Resulullahun, i cili fjalë për fjalë ka thënë: "*Kushdo prej jush që tregon respekt ndaj drejtuesit që i është caktuar mbi krye, edhe Allahu do të sillet me respekt ndaj tij e do t'i falë shumë të mira. E, kushdo që nuk tregon respekt ndaj drejtuesve të vet dhe përpiqet që t'i ulë ata në sytë e njerëzve, dijeni se Allahu e poshtëron atë njeri.*"[64]

---

[63]. Hejthemi, *Mexhmeu'z-Zeuaid,* 5/404 (9134).
[64]. Bejheki, *Sunen,* 8/163 (16436).

Myslimanët i binden vetëm atij komandanti dhe atij drejtuesi që është legjitim!

Sipas një transmetimi të ardhur prej Aliut (radijallahu anhu): Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) caktoi në krye të një ekspedite ushtarake një ensar. Teksa po i përcillte për në luftë, ai i paralajmëroi ushtarët që t'ia dëgjonin fjalën komandantit të tyre dhe të tregonin respekt ndaj çdo urdhri të ardhur prej tij. Mirëpo, diçka ndodhi dhe ata se ç'bënë që e nxehu tejmase komandantin e tyre. Andaj, ai u tha atyre:

- "Dilni e më mblidhni dru." Kështu bënë, dolën dhe mblodhën dru.

- "Tani ndizni një zjarr.", – i urdhëroi ai sërish. Edhe zjarrin e ndezën. Atëherë, komandanti tha:

- "A ju urdhëroi Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) që të më bindeni?"

- "Po!", – u përgjigjën ushtarët.

- "Atëherë hyni në zjarr!", – u tha ai atyre.

Ushtarët panë njëherë nga njëri-tjetri dhe thanë:

- "Po ne prandaj vendosëm të bëhemi ndjekës të të Dërguarit të Allahut dhe t'i besojmë atij, që të mos na hedhin në zjarr (me një fjalë në Xhehenem). Nuk kaloi shumë dhe mërzia e komandantit u fashit dhe zjarri i ndezur ishte në të shuar. Kur u kthyen ata ia treguan Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) të gjitha sa kishin ndodhur. I Dërguari i Allahut tha për ta:

- "Po të ishin hedhur në atë zjarr as në ahiret nuk do të dilnin dot prej zjarrit! Prijësve dhe komandantëve t'u bindemi vetëm për ato urdhra që janë për gjëra të lejuara."[65]

Këshillat që i dha Krenaria e Njerëzimit Ebu Dherr el-Gifarit për bindjen dhe respektin që duhet të kishte ndaj të parit të vendit

E tregon Esma binti Jezidi (radijallahu anha): "Ebu Dherri

[65]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/226.

(radijallahu anhu) rrinte pranë Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i shërbente për çfarëdo gjëje që kishte nevojë, pastaj, kur i mbaronte të gjitha punët, shkonte në xhami. Xhaminë e kishte shtëpi dhe atje binte edhe për të fjetur. Një natë, në xhami hyri i Dërguari i Allahut dhe e gjeti Ebu Dherrin që ishte shtrirë e po flinte mbi pjesën me dhe të faltores. E ngacmoi me këmbë që të zgjohej. Ebu Dherri u ngrit dhe qëndroi ulur. Resulullahu i tha:

- "*Ç'është kështu? Pse ke fjetur këtu?*"

- "Ku të fle, o Resulullah? Unë nuk kam shtëpi tjetër, veç xhamisë!", – iu përgjigj Ebu Dherri. I Dërguari i Allahut e dëgjoi Ebu Dherrin e u ul pranë tij dhe e pyeti:

- "*Po të nxorën nga xhamia, çfarë do të bësh?*"

- "Do të iki në Siri, sepse Siria është atdheu i mërgimtarëve, është vendi ku mblidhen të gjithë, veç të gjitha këtyre, është edhe atdheu i profetëve. Do të bëhem një prej banorëve të atij vendi.", – u përgjigj Ebu Dherri.

- "*Po po të nxorën edhe nga Siria?*"

- "Atëherë do të kthehem prapë në këtë xhami, sepse unë nuk kam shtëpi tjetër veç kësaj."

- "*Po po të përzunë sërish, për së dyti herë, edhe që këtu, çfarë ke ndërmend të bësh?*"

- "Atëherë do të marr shpatën dhe do të luftoj derisa të vdes!", – u përgjigj Ebu Dherri.

I Dërguari i Allahut buzëqeshi me këtë përgjigje të Ebu Dherrit, ia mori dorën dhe e vuri mbi supin e vet dhe i tha:

- "*A do që unë të të tregoj një rrugëzgjidhje më të mirë se kjo?*"

- "Kurban t'u bëfshin nëna dhe babai, o Resulullah, ma trego atë rrugë!"

- "*Le të të përzënë, kudo që të të përzënë, ti do të dëgjosh fjalën e tyre e do të shkosh atje ku do të të kërkojnë ata. Do të bësh durim, derisa të vish atje, tek unë!*", – e porositi i Dërguari i Allahut Ebu Dherrin.[66]

Ndërsa, në përcjelljen që na bën Tausi, gjenden edhe disa përshkrime

[66]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 6/457 (27629).

të tjera: - "Kur Ebu Dherrin (radijallahu anhu) e dërguan në Rebedhe, atje ai u takua me një skllav me ngjyrë të Osmanit (radijallahu anhu). Ai njeri me ngjyrë thirri ezanin dhe, pasi këndoi edhe ikametin, iu drejtua Ebu Dherrit dhe i tha:

- "O Ebu Dherr, imam dil ti, na e fal ti namazin!"

- "Jo! Më ka porositur i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), '*sikur edhe një skllav me ngjyrë të kesh mbi krye, do t'i bindesh.*' Paskëtaj, imam doli ai skllav me ngjyrë dhe Ebu Dherri e fali namazin pas tij si çdo besimtar i thjeshtë i bashkësisë atje."[67]

Një ngjarje e vërtetë lidhur me respektin ndaj prijësit, që ka ngjarë mes Omerit (r.a.) dhe Alkames

Tregon Hasan Basriu: "Ishte mesnatë, Omeri (radijallahu anhu) u takua rastësisht me Alkame bin Alathen. Nga pamja e jashtme Omerin (radijallahu anhu) e ngatërronin mjaft shpesh me Halid bin Uelidin. Prandaj, Alkameja e pandehu për Halid bin Uelidin dhe iu drejtua Omerit (radijallahu anhu) e i tha:

- "Halid, më duket se Omeri ty të largoi nga detyra ngaqë është dorështrënguar. Unë kisha ndërmend të shkoja tek ai me djalin e xhaxhait, për t'i kërkuar diçka, por tani që mora vesh se të ka shkarkuar ty, hoqa dorë, nuk kam për t'i kërkuar asgjë."

- "Vazhdo, më trego, ç'gjëra të tjera di për Omerin?", – ia priti Omeri (radijallahu anhu).

- "Unë e di, që drejtuesit kanë më shumë të drejta mbi ne. Por shiko, se mos bën ndonjë gjë, mos i dil kundër? Ne të bëjmë atë që na takon, sepse shpërblimin do të na e japë Allahu."

Kur agoi, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti Halidin:

- "Çfarë të tha Alkameja mbrëmë?"

- "Uallahi, nuk më ka thënë asgjë.", – u përgjigj Halidi.

- "Shiko, edhe betohesh pale!"

Mandej, Omeri (radijallahu anhu) e pa që Alkame ishte treguar i drejtë

[67]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/950 (14376).

dhe e shpërbleu atë, duke ia përmbushur të gjitha nevojat që kishte."[68]

Fjalët e një gruaje me lebër lidhur me domosdoshmërinë e bindjes ndaj prijësit të vendit

Ibni Ebi Mulejkeja tregon: "Omeri (radijallahu anhu) pa një grua që ishte e sëmurë me lebër, e cila po i vinte Qabes përreth dhe shkoi e i foli:

- "A moj grua, pse nuk qëndron më mirë në shtëpi, e të mos i shqetësosh njerëzit me këtë gjendje që je!" Ajo grua e dëgjoi Omerin dhe shkoi e u mbyll në shtëpi. Pas njëfarë kohe, kur dikush qëlloi që shkoi në shtëpinë e asaj gruaje i tha asaj:

- "Ai njeriu që të ndaloi ty të dilje jashtë vdiq, tani mund të dalësh." Mirëpo e dini se cila ishte përgjigjja e asaj gruaje të sëmurë:

- "Atij që i jam bindur në çdo urdhër në të gjallë nuk mund t'i ngre krye në të vdekur!"[69]

12. KUR DREJTUESIT JETOJNË NË HARMONI TË PLOTË ME NJËRI-TJETRIN

Një ngjarje e ndodhur mes Amr bin Asit dhe Ebu Ubejde bin Xherrahut

E tregon Urue bin Zubejri: "Në Dhatu's-Selasil, një prej rrethinave më të bukura të Sirisë, Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dërgoi bijtë e Belijit dhe të Abdullahut, si dhe disa vetë nga Kudaatët, të cilët njiheshin si të afërm të tyre, dhe si komandant në krye u caktoi edhe Amr bin Asin (radijallahu anhu). Bijtë e Belijit ishin njëkohësisht edhe dajat e As bin Uailit. Me të mbërritur atje, Amri i shqetësuar prej faktit se armiqtë ishin të shumtë në numër, i dërgoi fjalë të Dërguarit të Allahut, që ai t'u dërgonte forca mbështetëse. Kësisoj, edhe Profeti ynë u dërgoi atyre një grup të përbërë kryesisht nga muhaxhirët, në mesin e të cilëve gjendeshin edhe Ebu Bekri me Omerin (radijallahu anhuma) dhe si komandant të tyre pati caktuar

[68]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 4/557.
[69]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,*10/172 (28504).

Ebu Ubejde bin Xherrahun. Sapo mbërritën pranë Amrit, Amri u tha atyre:

- "Komandant këtu jam unë; sepse unë i dërgova lajm të Dërguarit të Allahut dhe i kërkova të vinit ju." Mirëpo, muhaxhirët ia pritën:

- "Jo, ti je komandanti i atyre ushtarëve me të cilët të dërgoi i Dërguari i Allahut të luftoje. Komandanti i muhaxhirëve është Ebu Ubejdeja, edhe atë i Dërguari i Allahut e caktoi si komandant."

- "Jo, ju jeni forca shtesë që i kërkova unë.", – ua priti Amri dhe, sakaq, Ebu Ubejdeja që njihej si një njeri shumë i qetë, por po aq edhe i urtë e me edukatë, u hodh edhe tha:

- "Ta dish mirë, o Amr: Këshilla e fundit që i Dërguari i Allahut më dha para se të nisesha ishte kjo: '*Kur të mbërrish te shoku yt, merruni vesh e të shkoni mirë me njëri-tjetrin.*' Prandaj, meqë ti nuk do të më bindesh mua, atëherë do të të bindem unë ty.", – e kësodore ia dorëzoi Amr bin Asit komandën.[70]

Të drejtat e të parit të vendit mbi njerëzit e thjeshtë

Tregon Seleme bin Shihab el-Abdiu (radijallahu anhu): "Omeri (radijallahu anhu) ka thënë:

- "O njerëz! Ne kemi shumë të drejta mbi ju: ju duhet të na bëheni krah e të na mbështesni, qoftë edhe me fjalë, si dhe të na ndihmoni me çfarë t'ju vijë ndoresh. Në sytë e Allahut nuk ka gjë më të bukur e më të mirë sesa një udhëheqës që është i butë dhe sillet mirë me njerëzit që udhëheq. Allahu nuk e do fare kryetarin e një shteti që është i paditur, i ashpër dhe i egër, e për më tepër kur është i pazoti."[71]

Gjendja e atij që nuk ia thotë drejtuesit të vërtetën në sy

Urueja (radijallahu anhu) tregon: "Shkova tek Abdullah bin Omeri (radijallahu anhu) dhe e pyeta:

- "O Abdullah! Ne shkojmë te drejtuesit tanë dhe ulemi të bisedojmë me ta. Ata, nganjëherë, na thonë gjëra që nuk janë aspak të

[70]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/273.
[71]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/936 (14334).

vërteta, megjithatë ne nuk i kundërshtojmë, por, përkundrazi, edhe i mbështetim në vendimet e tyre të padrejta dhe jo vetëm kaq, por edhe u themi se na pëlqejnë shumë vendimet e tyre! Si mendoni ju, a kemi vepruar drejt?" Ibni Omeri u përgjigj duke më thënë:

- "Shiko, nipi im! Unë nuk e di se çfarë do të mendoni ju, por, në kohën e të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), sjellje të tilla ne i konsideronim dyfytyrësi!"[72]

Sha'biu (radijallahu anhu) tregon këtë: "Ne shkuam tek Ibni Omeri dhe e pyetëm:

- "Kur shkojmë te drejtuesit dhe udhëheqësit tanë, ne u flasim atyre duke u ardhur pas qejfit, e kur largohemi themi krejt të kundërtën e asaj që i kemi thënë në sy; si mendon ti për këtë?" Ibni Omeri na dëgjoi me vëmendje dhe tha:

- "Ne, një sjellje si kjo, në kohën e të Dërguarit të Allahut, i konsideronim hipokrizi!"[73]

Kufizimi i të folurit kot dhe i të qeshurit pa arsye në prani të drejtuesve

E tregon Alkame bin Uekasi (radijallahu anhu): "Ishte njëherë një burrë i papunë, që vinte vërdallë më kot. Shkonte te udhëheqësit e kohës dhe përpiqej t'i bënte për të qeshur. Gjyshi im i tha atij njeriu:

- "Turp të të vijë! Pse shkon atje, tek ata njerëz dhe i bën për të qeshur? Mua ka treguar njëri prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Bilal bin Harith el-Muzenit, se Resulullahu ka thënë: "*Robi thotë një fjalë që Allahut i pëlqen shumë. Në të vërtetë ai nuk e di se në ç'shkallë pranë Allahut ngjitet ajo fjalë. Mirëpo, vetëm në sajë të asaj fjale Allahu kënaqet jashtë mase për takimin me atë rob të Tij në Ditën e Gjykimit. Poashtu, dikush, pa u matur dhe pa i dhënë shumë rëndësi thotë një fjalë që meriton ndëshkimin e Allahut, pa e ditur se cila është domethënia e saj tek Allahu. Mirëpo, Allahu, në ditën e takimit të madh, e ndëshkon atë njeri vetëm për hir të asaj fjale të padenjë.*"[74]

---

[72]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 12/331 (13265).
[73]. Bejheki, *Sunen,* 8/164 (16438).
[74]. Bejheki, *Sunen,* 8/165 (16442).

Një fjalë e Ebu Hudhejfes në lidhje me dyert e atyre që janë në role drejtuese

Një ditë Ebu Hudhejfeja (radijallahu anhu) na tha:

- "Aman, qëndrojini larg vendeve ku ka shpifje dhe ngatërresa!" Ata që ishin aty të pranishëm e pyetën:

- "O Ebu Abdullah, kush qenkan këto vende të shpifjes dhe të ngatërresave?" Atëherë, Ebu Hudhejfeja u dha atyre këtë përgjigje:

- "Dyert e drejtuesve janë vende ku shpifet dhe ku nxirren më së shumti ngatërresa. Nëse ndonjëri nga ju shkon te drejtuesit e vet, ua aprovon çdo fjalë që thonë, megjithëse nuk është e drejtë a e vërtetë, madje edhe duke e përgëzuar për ato cilësi që ai nuk i ka, atëherë ta dini, se ai ka shkaktuar një ngatërresë tejet të madhe."[75]

Këshillat e Abdullahut, djalit të Abasit (r.a.), për këtë çështje

Tregon vetë Ibni Abasi: "Babai më pati thënë:

- "O bir, kam parë që Prijësi i Besimtarëve (Omeri radijallahu anhu) të thërret dhe përpiqet të kalojë sa më shumë kohë me ty; të kërkon mendime edhe kur është në praninë e shumë sahabëve të tjerë të të Dërguarit të Allahut. Dua të të jap tri këshilla, mbaji mirë vathë në vesh: Frikësoju Allahut, mos gënje, mos ia trego askujt të fshehtat që të beson ai dhe mos përgojo askënd në praninë e tij!"[76]

13. TË THUASH TË VËRTETËN NË PRANI TË DREJTUESVE DHE TË MOS I MBËSHTESËSH ATA NË VEPRIMTARITË QË BIEN NDESH ME URDHËRESAT E ALLAHUT

Omeri (r.a.): "Nuk vjen mirësi nga ai drejtues, në praninë e të cilit nuk mund të thuhet dot e vërteta!"

Hasan Basriu tregon: "Njëherë Omeri (radijallahu anhu) nuk e pranoi një ajet të lexuar prej Ubej bin Kabit, madje edhe e mohoi, dhe Ubeji i tha atij:

---

[75]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/277.
[76]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 10/265 (10619).

- "O Omer! Unë këtë e kam dëgjuar nga vetë i Dërguari i Allahut, kur ti bëje tregti në Baki!" Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "E vërtetë! Unë thjesht desha t'ju vija në provë, 'a do të dalë ndonjëri që ta thotë të vërtetën ashtu siç është.', sepse nuk vjen mirësi prej një drejtuesi që nuk thotë të vërtetën dhe që në praninë e tij nuk mund të thuhet dot e vërteta siç është!"[77]

Qortimi i Beshir bin Sa'dit për Omerin (r.a.): "Nëse vepron ashtu, ne dimë shumë mirë se si të të drejtojmë, njësoj siç drejtojmë shigjetat!"

Një ditë Omeri (radijallahu anhu) po rrinte ulur me një grup muhaxhirësh dhe ensarësh. Ai i pyeti ata:

- "Çfarë do të bënit ju, nëse shihni se unë i mbaj me hatër disa prej jush?" Askush nuk u përgjigj. Omeri (radijallahu anhu) e përsëriti edhe dy a tri herë atë pyetje, mirëpo i vetmi që foli ishte Beshir bin Sa'di (radijallahu anhu):

- "Nëse vepron ashtu, ne dimë shumë mirë të të drejtojmë, njësoj siç drejtojmë shigjetat." Omerit (radijallahu anh) i pëlqeu tej mase kjo përgjigje, ndaj u tha atyre:

- "Kështu, vetëm kështu ju do të kishit kryer detyrën tuaj siç duhet! Ja, vetëm kështu do të kishit kryer detyrën tuaj siç duhet!"[78]

Muhamed bin Meslemeja ia thotë gjithçka në fytyrë Omerit (r.a.)

Tregon Musa bin Ebu Isai: "Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) shkoi te pusi i fisit të bijve të Harithes. Atje u takua me Muhamed bin Meslemenë.

- "Ç'mendim ke për udhëheqjen time, o Muhamed?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Uallahi, unë të shoh ty ashtu siç duhet të jesh, ashtu siç të shohin edhe të gjithë ata që të duan të mirën! Për shembull, më dukesh shumë i suksesshëm në mbledhjen e tagrave dhe të taksave. Veç kësaj, ti je një

[77]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/236 (36766).
[78]. Buhari, *Tarihu'l-Kebir,* 2/98 (1825).

udhëheqës që nuk ke sy në pasurinë e përbashkët, e gjithmonë e ndan me drejtësi atë që është për t'iu ndarë të tjerëve. Por po ndryshove, duke hequr dorë nga e drejta dhe drejtësia, atëherë ne dimë mirë se si të të sjellim në vete, njësoj siç i fusim shigjetat në zjarr, për t'i rregulluar!"

- "Me një fjalë, ti po më thua se 'ne të rregullojmë edhe ty, nëse devijon nga e drejta, njësoj siç fusim shigjetat në zjarr, për t'u dhënë formën e duhur!', kështu hë? Lëvduar qoftë Allahu i Madhërishëm që më ka bërë mua udhëheqës të një bashkësie që di të më kthejë tek e drejta nëse devijoj prej saj.", – tha Omeri (radijallahu anhu).[79]

Kur Muauija (r.a.) thotë: "Ky njeri po na këshillon për jetë shpirtërore" për një njeri që i kundërshtoi fjalën

Tregon Ebu Kubejli: "Një dite të premte, Muauije bin Ebi Sufjani u ngjit në minber. E, teksa po u fliste besimtarëve, ai u tha atyre:

- "Pasuria është pasuria jonë, e e jona është e gjithë plaçka që është fituar në rrugë paqësore! Ne ia japim atë kujt të duam dhe nuk i japim kurrkujt që nuk duam t'i japim!" Askush nuk iu përgjigj Muauijes (radijallahu anhu). Të premten tjetër, Muauija përsëriti prapë të njëjtat fjalë. Prapë nuk doli askush që ta kundërshtonte. Kësisoj, ato fjalë u përsëritën edhe të premten e tretë, por kësaj here, nga xhemati u ngrit dikush dhe tha:

- "Jo, nuk është ashtu! Pasuria është pasuria jonë, e e jona është edhe plaçka e luftës! Kushdo që ndërhyn në mes dhe nuk na jep atë që na takon, atëherë ne dimë se si t'ia lëmë Allahut në dorë drejtësinë dhe të nxjerrim shpatat!" Muauija (radijallahu anhu) zbriti nga minberi dhe pas namazit u fut në dhomën e tij personale. Dërgoi njerëz që t'i sillnin atë njeri që e kundërshtoi përpara xhematit. Në atë kohë, të gjithë njerëzit filluan të mendonin: "Iku ai i shkretë, kaq e pati!" Mirëpo, më vonë, njerëzit shkuan te Muauija (radijallahu anhu) dhe ç'të shihnin, Muauija ishte ulur bashkë me të në të njëjtin nim! Muauija u tha të pranishmëve:

- "Ky njeri më dha mua një mësim të mirë, i fali jetë shpirtit tim, ndaj

[79]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/786 (35763).

edhe Allahu i dhëntë jetë shpirtit të tij! Unë kam dëgjuar Resulullahun, i cili ka thënë: "*Pas meje do të vijnë ca udhëheqës, të cilët do të thonë diçka dhe askush nuk do t'i kundërshtojë; askush nuk do t'ua kundërshtojë fjalën e thënë prej tyre. Ata do të shtyhen e do të grinden me njëri-tjetrin në flakët e Xhehenemit, njësoj siç shtyhen e grinden majmunët!*" Kur unë i thashë ato fjalë të premten e parë, askush nuk u ngrit të më kundërshtojë. Unë i thashë ato prapë të premten e dytë, por prapë nuk doli askush që të më kundërshtonte, ndaj fillova të mendoj se edhe unë jam një udhëheqës si ata, për të cilët na ka folur edhe i Dërguari i Allahut. Kësisoj, në të premten e tretë u ngrit ky burrë dhe i kundërshtoi fjalët e mia, më dha jetë, më qetësoi. Lus Allahun që t'i falë edhe atij jetë të pasur si materiale, ashtu edhe shpirtërore."[80]

14. TË DREJTAT E POPULLIT MBI DREJTUESIT E TYRE

Omeri (r.a.) i pyet gjithë grupet e vizitorëve që vijnë tek ai se si sillen drejtuesit e tyre

Tregon Esued bin Jezidi: "Omeri (radijallahu anhu) i pyeste të gjithë ata që vinin tek ai për vizitë, se si silleshin drejtuesit me ta. Ai i pyeste ata:

- "A u shkojnë drejtuesit tyre për vizitë atyre që janë të sëmurë, a u përgjigjen ftesave të skllevërve? Si është qëndrimi që ata mbajnë ndaj tyre, si sillen me ta? A ka shumë njerëz që presin te porta e drejtuesve?" Kur qëllonte që ndonjëri syresh thoshte ndonjë fjalë jo të mirë, ai e shkarkonte menjëherë drejtuesin e caktuar në atë vend.[81]

Urdhri i parë i Omerit (r.a.) për çdo drejtues të emëruar

Asim bin Ebi'n-Nuxhudi tregon: "Omeri (radijallahu anhu), sa herë që emëronte ndonjë drejtues, ai u vinte atyre kushtet, që 'të mos hipnin në kuaj me stoli të tepruara, të mos hanin bukë të zgjedhur, të mos vishnin rroba të holla dhe që krijonin përshtypjen e madhështisë, t'i mbanin dyert përherë të hapura për nevojtarët', duke u bërë të ditur

[80]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 19/393 (925).
[81]. Bejheki, *Sunen,* 10/108 (20083).

se 'nëse nuk bënin ndonjërën prej këshillave të tij, ata do të hiqeshin menjëherë nga detyra!' Edhe kur i përcillte, ai u thoshte atyre:

- "Unë nuk po ju dërgoj atje që t'u kanoseni jetës, trupit, nderit, apo pasurisë së myslimanëve! Unë ju dërgoj që t'u falni atyre namazin, t'ua ndani me drejtësi plaçkën e fituar në rrugë paqësore dhe që të vendosni me drejtësi për punët e tyre. Nëse do të keni ndonjë problem që e keni të vështirë ta zgjidhni, të më njoftoni menjëherë!"[82]

Ebu Huzejme bin Thabiti tregon se: "Omeri (radijallahu anhu), kur do të caktonte ndonjë vali për ndonjë vend të caktuar, merrte një bashkësi ensarësh dhe të tjerësh si dëshmitarë dhe e porosiste atë që do të emëronte:

- "Ta dish se unë nuk po të bëj ty drejtues, që ti t'u kanosesh jetës dhe shpirtrave të myslimanëve."[83]

Mendimi i Omerit (r.a.) për detyrat e personave të emëruar drejtues

Transmeton Abdurrahman bin Thabiti: "Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi fjalë Said bin Amir el-Xhumehiut, të vinte menjëherë tek ai. I tregoi atij kuvendin që kishte mbledhur aty dhe i tha:

- "Ne po të caktojmë ty në krye të atyre njerëzve, ti do të shkosh të jetosh në tokat e tyre e do të luftosh bashkë me ta."

- "O Omer, të lutem mos më përziej mua me belanë e të qenët drejtues!", – i tha ai Omerit, mirëpo Omeri (radijallahu anhu) nuk ia vuri veshin.

- "Uallahi, njerëzit si ty unë nuk i lë aq lehtë! A ma ngarkuat mua mbi qafë përgjegjësinë e kalifatit, tani doni edhe që të më lini vetëm. Ta dish mirë, se ti nuk je njeriu më i virtytshëm ndër ata njerëz ku unë po të dërgoj. Unë nuk po të dërgoj ty atje, që ti t'u marrësh atyre pasurinë, apo që t'u shkelësh atyre njerëzve nderin. Unë po të dërgoj ty atje, që ti të luftosh krah për krah me ta, si dhe që t'ua ndash me drejtësi plaçkën e fituar nga lufta."[84]

---

[82]. Abdurrez'zak, *Musannef,* 11/324 (20662).
[83]. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef,* 6/461 (32920).
[84]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/887 (14203).

Ebu Musa el-Esh'ari (radijallahu anhu) i ka thënë kështu banorëve të qytetit në të cilin e kishin emëruar vali:

- "Prijësi i Besimtarëve, Omeri (radijallahu anhu) mua më ka dërguar t'ju mësoj librin e Zotit dhe sunetin e Profetit tuaj, si dhe që t'ju pastroj rrugët."[85]

Letra që i dërgon Omeri (r.a.) Amr bin Asit lidhur me drejtuesit që rrinë të distancuar ndaj popullit dhe që nuk kujdesen për nevojtarët

Ebu Temim el-Xhejshaniu (radijallahu anhu) tregon: "Omeri (radijallahu anhu) i shkroi Amr bin Asit (radijallahu anhu) një letër ku thuhej:

- "Kam dëgjuar se paske ndërtuar një minber. Ngjitesh atje dhe i sheh njerëzit nga lart! Nuk të mjafton që njerëzit të shohin vetëm takat kur ti ngulesh në këmbë dhe u flet? Të urdhëroj: Thyeje menjëherë dhe ma zhduk atë minber!"[86]

Një letër e Omerit (r.a.) drejtuar Ebu Osman en-Nehdiut për të njëjtën gjë

E tregon Ebu Osmani (radijallahu anhu): "Kur ishim në Azerbaixhan, na erdhi një letër prej Omerit (radijallahu anhu). Në atë letër, ndër të tjera, shkruhej:

- "Utbe bin Farkad! Ato mundësi që të janë dhënë nuk janë fryt as i punës sate, as i punës së babait, as i punës së nënës sate. Atë që ha ti në shtëpi do t'ua japësh ta hanë edhe myslimanët në shtëpitë e tyre. Në asnjë mënyrë të mos e teproni me shpenzimet! Qëndrojini larg veshjes me mëndafsh dhe mbulimit me tesha si ato të idhujtarëve!"[87]

Omeri (r.a.) qorton valiun e Humusit

Tregon Urue bin Ruejmi: "Omeri (radijallahu anhu) filloi të shëtiste

---

[85]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/887 (14205).
[86]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/937 (14337).
[87]. Bejheki, *Sunen,* 3/269 (5875).

i vetëm në radhët e besimtarëve që vinin për të kryer adhurimin e haxhit, që t'u maste pulsin dhe t'i pyeste se si shkonin punët në vendet e tyre. Kur shkoi pranë banorëve të Humusit, ai i pyeti ata:

- "Si e keni valiun?"

- "Është drejtues i mirë; mirëpo ka ndërtuar një dhomë më të lartë se gjithë ndërtesat e tjera dhe jeton atje tani.", – iu përgjigjën ata.

Omeri (radijallahu anhu) i shkroi menjëherë një letër atij valiu, ndërsa postierit i dha porosinë që, me të mbërritur atje, t'i vinte flakën e ta digjte atë dhomë. Ai postier mbërriti në Humus, mblodhi një masë të madhe drush dhe pasi i shpërndau drutë përreth mureve të asaj dhome, i vuri flakën. Njerëzit shkuan menjëherë të lajmëronin valiun, mirëpo ai ua priti me fjalët:

- "Lëreni, ai është një lajmëtar." Ai i dha letrën dhe valiu e mori letrën, i hipi kalit dhe u nis për rrugë. Kur e pa Omeri (radijallahu anhu) që kishte ardhur aty, i tha që ta ndiqte dhe e çoi atje ku mbaheshin devetë e zekatit. Ai i tha valiut:

- "Zhvishu." I dha atij një petk të bërë prej leshit të devesë, që vishej prej arabëve dhe i tha:

- "Tani merr kovën, nxirr ujë nga pusi dhe jepu deveve të pinë derisa të nginjen." Valiu tërhiq e tërhiq kovën me ujë u lodh. Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- "Sa kohë u bë që je valiu i Humusit?"

- "Nuk kam shumë kohë, tani kam shkuar, jam i ri o Prijësi i Besimtarëve.", – u përgjigj ai.

- "Prandaj e ngrite atë dhomë atje lart, që t'i shohësh nga lart të varfrit, të vejat dhe jetimët që jetojnë në atë vend? Tani kthehu në krye të detyrës dhe të mos dëgjoj ta bësh më këtë!", – përfundoi Omeri (radijallahu anhu).[88]

[88]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/937 (14339).

15. DREJTUESIT U MASNIN SHPESH PULSIN POPULLIT TË TYRE

Dy histori nga Omeri (r.a.) dhe Ebu Bekri (r.a.)

Ebu Salih el-Gifari tregon: "Omeri (radijallahu anh) shkonte shpesh dhe kontrollonte gjendjen e një gruaje të verbër, e cila jetonte në periferi të Medinës, t'i çonte ujë për të pirë dhe t'i vinte në ndihmë duke i përmbushur ndonjë nevojë që mund të kishte. Mirëpo, sa herë që shkonte, ai shihte se dikush ia kishte kaluar dhe kishte shkuar më parë dhe ia kishte përmbushur të gjitha nevojat. Për ta kuptuar se kush ishte ai që ia kalonte dhe e bënte më parë atë të mirë, që ai vetë donte ta kryente, një ditë doli më herët dhe u fsheh në një vend aty pranë, të shihte kush do të vinte. Por ç'të shihte: kalifi Ebu Bekr Besniku!

- "Për Zotin, e kush mund të ishte përveç teje!", – tha Omeri (radijallahu anhu)[89]

Tregon El-Euzaiu: "Një natë, Omeri (radijallahu anhu) kishte dalë jashtë. Talhaja (radijallahu anhu) e kishte parë dhe i qe vënë pas, ta ndiqte. E pa Omerin (radijallahu anhu) të hynte në një shtëpi, pastaj doli prej andej dhe hyri në një shtëpi tjetër. Në mëngjes, në të aguar, Talhaja (radijallahu anhu) shkoi në njërën prej atyre shtëpive. Atje gjeti një grua të moshuar të verbër, e cila nuk ngrihej dot nga vendi... E pyeti atë grua:

- "Pse vjen këtu tek ti, çdo natë, ai burri që erdhi edhe mbrëmë?"

- "U bë kohë e gjatë që vjen tek unë, më ndihmon me ndonjë nevojë që mund të kem, pastron dhe më jep ujë për të pirë dhe largohet.", – u përgjigj e moshuara. Talhaja (radijallahu anhu) i dëgjoi ato fjalë të asaj gruaje dhe me vete u ankua: "Zoti të dhëntë të mira, o Talha, ty të mbeti të kërkosh se mos i gjen Omerit ndonjë të metë!"[90]

"Vlerësimi i sjelljeve nga dukja e tyre"

Abdullah bin Utbe bin Mesudi (radijallahu anhu) transmeton: "Unë e kam dëgjuar vetë Omerin (radijallahu anhu) kur ka thënë:

[89]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/731 (35607).
[90]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/48.

- "Kur ishte gjallë Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), të fshehtat e njerëzve deshifroheshin dhe zbuloheshin nga ajetet e zbritura. Tanimë shpallja reshti, nuk do të zbriten më ajete dhe ne jemi të detyruar të veprojmë me njëri-tjetrin sipas veprave të gjithsecilit. Ata, punët e të cilëve i konsiderojmë të mira, do t'i pranojmë si të besueshëm, e do t'i mbajmë pranë. Nuk na intereson shumë gjendja e tyre shpirtërore, apo ajo e zemrës, sepse bota e brendshme i përketvetëm Allahut. Kurse ata që sillen keq, edhe pse mund të pretendojnë se e kanë zemrën të pastër, nuk u besojmë; nuk mbështetemi tek ta!"[91]

Kur udhëheqësi i shtetit inspekton drejtuesit që ka emëruar

Tregon Tausi (radijallahu anh): Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) u tha atyre që kishte përreth:

- "A quhet që e kam kryer mirë detyrën time dhe e kam përmbushur të tërë përgjegjësinë time mbi ju, nëse mbi ju do të zgjedh atë që e njoh si më të mirin dhe i urdhëroj që të jetë sa më i drejtë karshi jush? Si mendoni?"

- "Po, ti quhesh se e ke kryer më së miri atë që duhej të bëje.", – thanë ata.

- "Jo! Unë kurrsesi nuk mund të konsiderohem se e kam kryer më së miri detyrën time, nëse nuk i inspektoj ata vazhdimisht, sesi i zbatojnë ata urdhrat e mi, i zbatojnë, apo nuk i zbatojnë ata!", – tha ai.[92]

Dërgimi i ushtarëve në krye të detyrës me turne, me afat të caktuar

Abdullah bin Ka'b bin Malik el-Ensari tregon: "Në frontin e Iranit ishte edhe një ushtri e përbërë nga ensarët dhe komandantët e tyre. Omeri (radijallahu anhu), çdo vit i tërhiqte mbrapsht ata ushtarë dhe, në vend të tyre, dërgonte të tjerë. Megjithatë, njëherë, kishte ardhur koha e ndërrimit të turnit, mirëpo ai nuk pati gjetur kohë për të bërë zëvendësimet e nevojshme. Andaj, ushtria, e mësuar me këtë

[91]. Bejheki, *Sunen,* 8/201 (16627).
[92]. Bejheki, *Sunen,* 8/163 (16432).

rregull, u kthye vetë. Omeri (radijallahu anhu) u nevrikos shumë me komandantin e tyre. Megjithëse ata ishin sahabë të të Dërguarit të Allahut, ai i kërcënoi duke u thënë se për këtë do të ndëshkoheshin. Ndërsa ata iu përgjigjën:

- "Ti na harrove. Nuk iu binde urdhrit të Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), që luftëtarët të ndërrohen vazhdimisht, me turne!"[93]

16. UDHËHEQËSI I SHTETIT MBRON POPULLIN E TIJ NDAJ RREZIKUT QË I KANOSET

Një ngjarje e ndodhur mes Omerit (r.a.) dhe Ebu Ubejde bin Xherrahut kur në Amuas u përhap murtaja

Ebu Musai tregon: "Kalifi Omer (radijallahu anhu) mori vesh që në Siri ishte shfaqur sëmundja e murtajës dhe i shkroi menjëherë një letër Ebu Ubejde bin Xherrahut, në të cilën i thoshte:

- "Kam nevojë për ty, duhet të takohemi sa më parë! Nëse e merr këtë letër në darkë, nisu në mëngjes, pa aguar, nëse e merr në mëngjes, atëherë nisu ende pa rënë nata! Të urdhëroj!"

Ebu Ubejdeja e mori letrën dhe tha:

- "E kuptova, kalifi paska nevojë për mua. Mesa duket do të shpëtojë një njeri, vdekja e të cilit është e pashmangshme!", – dhe i shkroi atij një letër:

- "Unë jam në krye të një ushtrie myslimane, e nuk i lë dot vetëm ata, ndaj më lër të qëndroj këtu me ushtarët e mi. E kuptova mirë edhe se cila ishte nevoja që të ka shtyrë të më kërkosh me kaq nxitim. Ti do të mbash në jetë një njeri, vdekja e të cilit është e pashmangshme. Ndaj, kur ta marrësh këtë letër, tërhiqe urdhrin e dhënë dhe më lejo të qëndroj këtu."

Omeri (radijallahu anh), kur e lexoi letrën që i kishte dërguar Ebu Ubejdeja, filloi të qajë me ngashërim. Një prej atyre që i gjendeshin pranë e pyeti:

---

[93]. Bejheki, *Sunen,* 9/29 (17627).

- "Çfarë ka ndodhur? Mos ka vdekur Ebu Ubejdeja?"

- "Jo, nuk ka vdekur, por sikur të kishte vdekur më ka shkruar!", – tha Omeri (radijallahu anhu).

Ebu Ubejdes ai i shkroi edhe një letër të dytë, në të cilën i thoshte:

- "Tokat e Jordanisë kanë shumë lagështirë, janë moçalishte, e janë vende më se të përshtatshme për t'u kapur nga murtaja. Tokat e Xhabijes janë të pastra dhe ndodhen shumë larg territorit të pushtuar nga murtaja, merri muhaxhirët dhe zhvendosuni atje!" Ebu Ubejdeja, kur e lexoi atë letër, tha:

- "Tani po, tani do t'ia dëgjojmë fjalën Prijësit të Besimtarëve! Si të na urdhërojë ai!"

Ebu Musai thotë se: "Ebu Ubejdeja më urdhëroi mua që t'i hipja kafshës së rrugës dhe t'i transferoja njerëzit drejt Xhabijes. Mirëpo, bash në atë kohë ndodhi që gruan time e zuri murtaja. Njoftova Ebu Ubejden dhe ai filloi të merret vetë me zhvendosjen e ushtarëve. Megjithatë, nuk kaloi shumë kohë dhe murtaja e zuri edhe atë, derisa një ditë vdiq. Pas vdekjes së tij, murtaja nuk qe më aq e fortë si në fillim."

Ebu'l-Muexhihu thotë se: "Ka gjasa që ushtria e komanduar prej Ebu Ubejdes të ketë qenë diku te tridhjetegjashtë mijë ushtarë. Tridhjetë mijë prej tyre vdiqën nga murtaja dhe vetëm gjashtë mijë arritën të shpëtonin."[94]

Udhëheqësi i shtetit duhet të jetë i dhembshur

Tregon Ebu Xhaferi (radijallahu anhu): "Ebu Usejdi seç kishte prurë disa robër lufte nga Bahrejni dhe i solli ata te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Kur i Dërguari Fisnik pa që një grua prej atyre robërve po qante, e pyeti:

- "*Pse qan?*"

- "Ai njeri ma shiti djalin.", – u përgjigj ajo. Atëherë, i Dërguari i Allahut u drejtua nga Ebu Usejdi dhe i tha:

- "*E vërtetë është kjo, a e ke shitur ti djalin e saj?*"

[94]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/918 (11749).

- "Po!", – iu përgjigj Ebu Usejdi.

- "*E kujt ia shite?*"

- "Ua shita bijve të Absit."

- "*Ti, tani, do t'i hipësh kësaj kafshe, do të shkosh që tani të marrësh djalin e saj, dhe do ta sjellësh atë menjëherë këtu!*", – urdhëroi i Dërguari i Allahut.[95]

Tregon Ebu Osman en-Nehdiu: "Omeri (radijallahu anhu) kishte caktuar me detyrë një burrë nga fisi i Beni Esedit. Ai njeri pati ardhur tek Omeri (radijallahu anhu), për të marrë dokumentin që dëshmonte marrjen e detyrës në ngarkim. Bash në atë çast, tek Omeri (radijallahu anhu) erdhi edhe njëri prej fëmijëve të tij. Omeri (radijallahu anhu) e puthi atë fëmijë dhe ky i tha:

- "O Prijësi i Besimtarëve! Ti po e puth atë!? Uallahi, unë kurrë nuk kam puthur ndonjë fëmijë!"

- "Nëse është kështu, uallahi, ty duhet të të mungojë edhe mëshira ndaj njerëzve, kështu që po e tërheq mbrapsht urdhrin e emërimit tënd. Këtej e tutje ti nuk mund të jesh më nëpunësi im!", – tha Omeri (radijallahu anhu). Dhe ai burrë e dorëzoi mbrapsht pusullën që kishte marrë nga duart e vetë kalifit.[96] Në një përcjellje tjetër të kësaj ngjarjeje thuhet se Omeri (radijallahu anhu) i ka thënë atij njeriu:

- "Ç'faj kam unë se në zemrën tënde nuk ka mbetur më pikë mëshire? Allahu nuk mëshiron veçse robërit e Tij që janë të mëshirshëm. Ti nuk arrin dot të tregohesh i mëshirshëm as me fëmijën tënd, si do të tregohesh i mëshirshëm ndaj njerëzisë?", – dhe, sakaq, e liroi nga detyra aty për aty.[97]

17. DREJTËSIA E TË DËRGUARIT FISNIK DHE E SAHABËVE TË TIJ

Drejtësia e Profetit tonë të nderuar

Ja se si e tregon Urueja: "Atë vit që u ngadhënjye mbi Mekën, një grua nga fisi i Beni Mahzumit kishte bërë një vjedhje. Për këtë arsye,

---

[95]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/313 (10044).
[96]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/933 (14326).
[97]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 16/817 (45949).

fisi i asaj gruaje pati shkuar menjëherë tek Usame bin Zejdi (radijallahu anhu), për t'i kërkuar ndihmë që të hynte si ndërmjetës te Profeti ynë dhe ajo grua të shpëtonte. Megjithatë, Usameja (radijallahu anhu) ia bëri të ditura të gjitha të Dërguarit të Allahut dhe fytyra e të Dërguarit të Allahut ndryshoi në vend. Ai e kundërshtoi Usamen:

- "*Usame! Ti ke ardhur tek unë të më kërkosh të fal një prej dënimeve që i ka caktuar vetë Allahu, si mund të më kërkosh mua ndihmë për diçka të këtillë?*"

- "Të kërkoj ndjesë. Lutjuni Allahut që të më falë, o i Dërguari i Allahut!", – tha Usameja (radijallahu anhu).

Ndaj muzgu Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u çua dhe pasi e lëvdoi Allahun dhe e përgëzoi me shumë e shumë cilësi të epërme, që i takojnë vetëm e vetëm Allahut, foli këto fjalë:

- "*Shkaku pse u shkatërruan popujt e tjerë përpara jush është ky: nëse ndonjë njeri i nderuar e i fisëm ndër ta kryente ndonjë vjedhje, ata e linin të lirë atë. Dënimin e merituar e zbatonin vetëm për njerëzit pa njeri dhe të dobët. Unë i betohem Allahut, se sikur edhe Fatimja, e bija e Muhamedit, të bëjë ndonjë vjedhje, unë po njësoj do ta dënoja atë.*" Mandej, Resulullahu kërkoi që ta sillnin aty atë grua dhe zbatoi vendimin e përcaktuar për të. Që prej asaj dite ajo grua u pendua thellë, madje edhe u martua. Aishja (radijallahu anha) thotë se: "Ajo grua vinte shpesh tek unë. Dhe unë i thosha të Dërguarit Fisnik për çdo nevojë që ajo më shprehte."[98]

Një transmetim për Ebu Kataden në lidhje me këtë çështje

Tregon Ebu Katadeja (radijallahu anhu): Ishim nisur, bashkë me Profetin tonë të nderuar, për në Hunejn, të luftonim. Kur u përballëm fillimisht me idhujtarët, myslimanët filluan të tërhiqen dhe, në atë çast pashë se një idhujtar sulmoi njërin prej tanëve. E godita menjëherë në shpinë me shpatë dhe mburoja e tij u copëtua. Ai njeri u kthye dhe filloi të më sulmojë mua dhe më mbërtheu e më shtrëngoi aq shumë, saqë mendova se aty do të vdisja. Mirëpo, nuk kaloi as një çast i vetëm, kur atij njeriu i erdhi exheli dhe vdiq në vend, vetëm në këtë mënyrë arrita të shpëtoj. Renda menjëherë e shkova tek Omeri (radijallahu

[98]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/318.

anhu) dhe i thashë:

- "Ç'bëhet kështu? Njerëzit janë në gjendje shumë të vështirë."

- "Është urdhri i Allahut.", – m'u përgjigj Omeri (radijallahu anhu).

Pas kësaj fjale të Omerit (radijallahu anhu), ushtarët myslimanë u mblodhën sërish dhe falë një strategjie të re, luftën e fituan ata dhe jo armiqtë e Allahut. Pas fitores, i Dërguari i Allahut u ul dhe tha:

- "*Kush vret ndonjërin dhe arrin të sjellë dëshmitar për atë që ka vrarë, plaçka personale e të vrarit i takon atij që e ka vrarë atë.*" - Me të dëgjuar ato fjalë të të Dërguarit të Allahut u çova dhe thashë:

- "Kush do të dëshmojë për mua?", – dhe u ula në vend. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i përsëriti disa herë ato fjalë. Edhe unë u çova sa herë që foli ai dhe i pyeta besimtarët:

- "Kush do të dalë dëshmitar për mua?" Resulullahu përsëriti të njëjtat fjalë, bëra të çohesha prapë, kur Profeti ynë tha:

- "*Po ti çfarë ke kështu, o Ebu Katade?*" E unë ia shpjegova pse po këmbëngulja. Dikush tjetër u ngrit dhe tha:

- "Ebu Katadeja thotë të vërtetën, ja, i kam unë këtu plaçkat personale të atij idhujtari. Merre pëlqimin e tij edhe në emrin tim, që këto sende t'i mbaj unë." Në fjalë e sipër ndërhyri edhe Ebu Bekri, i cili tha:

- "Jo, punë që nuk bëhet, uallahi! Nëse i Dërguari i Allahut t'i jep ty plaçkat e gjithë ç'mbante mbi trup ai idhujtar, kjo do të jetë një padrejtësi e hapur ndaj të gjithë luftëtarëve që luftojnë në rrugën e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij!"

- "*Ebu Bekri ka të drejtë. Ti duhet t'ia japësh Ebu Katades sendet e atij idhujtari të vrarë!*" Kështu, ai burrë u ngrit dhe m'i dorëzoi mua ato sende që kishte mbledhur. Me to unë bleva një kopsht hurmash në tokat e fisit të Beni Selemes. Kjo ishte pasuria ime e parë qëkurse pranova fenë islame dhe u bëra mysliman."[99]

[99]. Buhari, *Sahih,* 4/1570 (4066).

Një ngjarje e vërtetë që ka ndodhur mes Abdullah bin Ebi Hadredit dhe një hebreu

Abdullah bin Ebi Hadred el-Eslemiu (radijallahu anhu) tregon: "Unë i kisha një hebreu një borxh prej katër dërhemësh. Ai shkoi te Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) të ankohej për borxhin tim, duke i thënë:

- "O Muhamed! Aksh njeri më ka katër dërhemë për të më dhënë, e nuk m'i jep; duhet të më ndihmosh, që ai të bindet, e të m'i japë."

- "*Jepi këtij njeriu atë që është e tija.*", – më tha mua i Dërguari i Allahut.

- "Unë i betohem Atij që të dërgoi ty me fenë e së vërtetës, se unë tani nuk kam që t'ia kthej ato katër dërhemë këtij njeriu.", – i thashë unë.

- "*Jepi çfarë i takon.*", – më tha sërish i Dërguari i Allahut.

- "I betohem Allahut që e ka në dorë jetën time, nuk kam fuqi t'ia paguaj tani! I thashë, që ti do të na dërgosh në Hajber dhe kam shumë shpresë se do të mund të fitoj ndonjë gjë prej andej dhe një t'u kthyer prej Hajberit, do t'ia paguaj.", – iu përgjigja unë. Mirëpo, i Dërguari i Allahut e përsëriti për herë të tretë:

- "Jepi këtij njeriu atë që i takon.", – dhe, kur Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) e thoshte një fjalë tri herë, ajo çështje ishte e mbyllur. Ai që e përcjell këtë ndodhi, thotë se: "Paskëtaj Abdullahu doli në çarshi. Në krye mbante një çallmë, ndërsa në trup kishte një veshje që e përdorte edhe si petk. E hoqi çallmën nga koka, e zgjidhi dhe e lidhi pas belit. Hoqi edhe veshjen dhe ia drejtoi atij hebreu:

- "Të të jap këtë veshje." Dhe, ai hebre e mori atë veshje për katër dërhemë. Në atë kohë, një grua e moshuar, që e pa Abdullahun në atë gjendje, iu afrua atij dhe i tha:

- "O shoku i të Dërguarit të Allahut, ç'je katandisur në këtë gjendje?" E ai i tregoi se çfarë i kishte ndodhur. Ajo grua i tha:

- "Urdhëro, merr këtë veshjen time.", – e sakaq ia dhuroi atij veshjen e saj, duke ia hedhur mbi supe.[100]

[100]. Ibn Haxher, *el-Isabe,* 2/295.

Një ngjarje e përjetuar nga dy ensarë

Tregon Umu Selemeja (radijallahu anha): "Dy vetë nga ensarët erdhën tek i Dërguari i Allahut dhe i thanë se nuk po merreshin dot vesh me njëri-tjetrin lidhur me një çështje trashëgimie. Kishte kaluar një kohë shumë e gjatë dhe asnjëri prej tyre nuk kishte dëshmitarë. Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) u tha atyre:

- "*Ju, të dy, keni ardhur tek unë dhe po më thoni se akuzoni njëri-tjetrin, duke mbrojtur secili veten. E unë, për ato çështje që nuk më është zbritur kurrfarë shpalljeje hyjnore, nuk mund të vendos vetëm se sipas mendimit e gjykimit tim personal. Nëse unë vendos për ty, duke i pranuar si prova të gjitha ato që pretendoni ju, për t'ia marrë vëllait atë pasuri, unë them se, në asnjë mënyrë të mos ia marrësh! Sepse, duke i dhënë atë pjesë unë do t'i kem dhënë atij një masë zjarri të marrë prej zjarrit të Xhehenemit. Ai që rrëmben pjesën që i takon vëllait të tij, në ditën e Kiametit do të ringjallet me atë copë zjarri të varur në qafë!*" Këto fjalë i bënë të qanin ata dy vëllezër që ishin kthyer në armiq të njëri-tjetrit, ndaj ata të dy i thanë të Dërguarit të Allahut:

- "O Resulallah, le ta marrë ai edhe pjesën time." Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu përgjigj duke u thënë:

- "*Nëse thoni kështu, atëherë shkoni, kërkoni mirë e mirë se si qëndron e vërteta dhe pastaj ndajeni mes veti duke e hedhur në short. Bëjani njëri-tjetrit hallall, nëse i keni hyrë në pjesë vëllai vëllait.*"[101]

Historia e një beduini

Tregon Ebu Saidi (radijallahu anhu): "Një beduin erdhi te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i kërkoi atij atë që i detyrohej. U soll mbarë e prapë me të Dërguarin e Allahut dhe i tha:

- "Do të ma paguash menjëherë tani borxhin që më ke."

- "Turp të të vijë, a e di ti se me kë je duke folur?", – u hodhën e i thanë sahabët atij njeriu.

- "Unë dua atë që më takon.", – u përgjigj beduini, madje dukej që këmbëngulte për këtë.

[101]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 6/230 (26760).

- "*Po ju, a nuk duhet të ishit në anën e atij që kërkon të drejtën e tij?*", – i pyeti i Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) sahabët e tij dhe i dërgoi fjalë Haule binti Kajsit:

- "*Nëse ke ndonjë hurmë me vete, a m'i huan mua, e t'i paguaj kur të na vijnë hurma të tjera?*"

- "Kam, o Resulullah, kurban t'u bëfshin ty nëna dhe babai im.", – ktheu përgjigje Hauleja, duke i dhënë Profetit tonë të nderuar aq hurma borxh sa donte. Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) i dha atij beduini hakun, duke e ngopur me hurma. Atëherë, ai beduin që kishte për të marrë prej të Dërguarit të Allahut, i tha atij a.s.:

- "Ti e pagove të gjithë borxhin, ndaj edhe ty Allahu mos të lëntë kurrë pa të dhënë me tepri." Pas kësaj çështjeje i Dërguari i Allahut tha:

- "*Ata që i paguajnë borxhet janë më të mirët ndër të gjithë njerëzit. Nuk mund të jetë popull i pastër një popull ku të dobëtit dhe të pafuqishmit e kanë të pamundur të marrin atë që u takon dhe është e tyrja, pa vuajtur e pa u ofenduar.*"[102]

Drejtësia e Ebu Bekrit (r.a.)

Tregon Abdullah bin Amr bin Asi (radijallahu anhu): "Një dite të premte Ebu Bekri (radijallahu anhu) iu drejtua besimtarëve që ishin mbledhur në xhami dhe u tha:

- "Nesër, që në mëngjes, të sillni devetë e zekatit, që t'ua ndajmë njerëzve. Mirëpo, asnjëri të mos vijë tek unë pa marrë njëherë leje!" Një grua, që i dëgjoi këto fjalë, pyeti të shoqin: "O burrë, merri këta frerë, ku i dihet, ndoshta Allahu na fal edhe ne ndonjë deve." Kur erdhi ai burrë, Ebu Bekri dhe Omeri (radijallahu anhuma) kishin hyrë në vendin ku gjendeshin devetë. Nga pas, aty hyri edhe ai. Ebu Bekri e pa dhe e pyeti:

- "Kush të dha leje të hyje këtu?", – dhe i mori frerët dhe me to e fshikulloi dy herë atë njeri. Pasi u ndanë devetë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) e thirri pranë vetes atë burrë, i dorëzoi frerët dhe i tha:

- "Zgjidh devenë që do, merre dhe shko."

[102]. Mundhiri, *et-Tergib,* 2/380 (2800).

- "Uallahi, kjo është punë që nuk bëhet, Ebu Bekr!", – u hodh e tha Omeri (radijallahu anhu).

Atëherë, kalifi i Profetit tonë, Ebu Bekri (radijallahu anhu) tha:

- "Unë e rraha pa të drejtë atë njeri; kush do të më shpëtojë mua nga ndëshkimi i Allahut në ditën e Kiametit?"

- "Po mirë, nëse është kështu, atëherë fitoja zemrën atij njeriu."

Pas kësaj bisede mes Ebu Bekrit dhe Omerit (radijallahu anhuma), Ebu Bekri i dha urdhër skllavit të tij që aty të sillte një deve të pajisur me të gjitha takëmet e nevojshme, një pëlhurë të kadifenjtë dhe pesë dinarë. Të gjitha i deshi për t'ia dhënë atij burri, që t'i fitonte zemrën e ai të mos mbetej i hidhëruar me kalifin e të Dërguarit të Allahut."[103]

Drejtësia e Omerit (r.a.)

Tregon Sha'biu: "Midis Omerit (radijallahu anhu) dhe Ubej bin Kabit kishte lindur një mosmarrëveshje. Omeri (radijallahu anhu) i propozoi atij, që të zgjidhnin dikë si gjykatës e të vendoste ai në mes tyre, se kush kishte të drejtë. Dhe, për këtë punë zgjodhën Zejd bin Thabitin. Shkuan tek ai, të vendoste ai mes tyre.

- "Tek ti kemi ardhur, që të bësh drejtësi mes nesh.", – i tha atij Omeri (radijallahu anhu). Në ato kohë, për të bërë drejtësi, shkohej në shtëpinë e atij që zgjidhej si gjykatës me pranimin e të dyja palëve. Kur dy hasmit hynë te Zejdi, ai u hapi atyre vend në minderin ku ishte ulur vetë dhe tha:

- "Ulu këtu, o Prijësi i Besimtarëve."

- "Sapo e bëre padrejtësinë e parë, o Zejd! Unë do të ulem pranë hasmit tim.", – tha Omeri (radijallahu anhu) dhe kështu, u ulën të dy pranë njëri-tjetrit, përballë Zejdit.

Ubej bin Ka'bi (radijallahu anhu) i tregoi atij se si qëndronte puna. Omeri (radijallahu anhu) i mohoi fjalët e tij. Sipas ligjit islam ai që mohonte ishte i detyruar të betohej, edhe pse Zejdi i tha Ubejit:

- "Të mos e detyrojmë Prijësin e Besimtarëve të betohet." Omeri

[103]. Bejheki, *Sunen,* 8/49 (15804).

(radijallahu anhu) u betua, duke thënë:

- "Zejdi nuk gjykon dot asnjë çështje, derisa përballë Omerit të vijë një mysliman si Omeri."[104]

Biseda e Abasit (r.a.) me Omerin (r.a.) kur do të zgjeronin Xhaminë e Profetit

Tregon Zejd bin Eslemi (radijallahu anhu): "Xhaxhai i Profetit tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Abasi (radijallahu anhu) kishte një shtëpi shumë afër Xhamisë së Profetit. Omeri donte ta zgjeronte xhaminë, ndaj shkoi tek Abasi dhe i tha:

- "Ma shit mua atë tokë." Mirëpo, Abasi (radijallahu anhu) nuk deshi ta shesë.

- "Atëherë, ma fal mua.", – i tha atij Omeri (radijallahu anhu), por Abasi nuk e pranoi as këtë propozim.

- "Po mirë, shtoja vetë xhamisë.", – këmbënguli Omeri (radijallahu anhu), e prapë Abasi (radijallahu anhu) nuk pranoi.

- "Kjo është e pamundur, je i detyruar të zgjedhësh një prej mundësive që të propozova unë.", – i tha atij Omeri (radijallahu anhu), por Abasi (radijallahu anhu) nuk ia vuri veshin.

Për këtë arsye, Omeri i tha atij:

- "Zgjidh dikë, që të bëjë gjyqësinë e kësaj pune." Atëherë, Abasi zgjodhi si gjykatës Ubej bin Ka'bin. Ata shkuan tek Ubeji dhe i parashtroi secili mendimin e vet. Ubej bin Ka'bi i dëgjoi dhe atëherë, iu drejtua Omerit (radijallahu anhu) me fjalët:

- "Ti nuk e nxjerr dot nga shtëpia këtë njeri, pa e bindur, duke e lënë të kënaqur!"

- "Kur e more këtë vendim, ku u bazove, ke ndonjë argument që e gjete në librin e Allahut, apo në sunetin e Profetit?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu) Ubejin.

- "U mbështeta te suneti i Resulullahut.", – u përgjigj Kabi. – "Unë e kam dëgjuar vetë Profetin tonë të nderuar (sal'lallahu alejhi ue

[104]. Bejheki, *Sunen,* 10/144 (20297).

sel'lem), i cili ka thënë: "*Kur Sulejmani, i biri i Daudit (alejhimas'selam) po ndërtonte Kudsin, çdo mëngjes e gjenin të shndërruar në rrënoja murin që kishin ndërtuar një ditë më parë. Allahu i Drejtë i shpalli Sulejmanit (alejhis'selam): - "Mos ndërto gjë aty pa pasur fillimisht pëlqimin e atij që është i zoti i asaj toke.*" Mjaftoi ky hadith që u përcolli Ubeji, që Omeri (radijallahu anhu) ta linte të qetë Abasin (radijallahu anhu). Në fund, edhe Abasi e dhuroi vetë me gjithë zemër shtëpinë, që ajo t'i shtohej tokës së xhamisë, e kështu u zgjerua edhe xhamia e Krenarisë së Njerëzimit."[105]

Kalifi Omer ndëshkon djalin e tij, Abdurrahmanin

Tregon Ibni Omeri (radijallahu anhu): "Vëllai im, Abdurrahmani, me Ukbe bin Harithin, të cilin të gjithë e thërrisnin Ebu Seruea, kur kishin qenë në Egjipt, në kohën e kalifatit të Omerit (radijallahu anhu), ishin ndalur diku dhe kishin pirë gjersa ishin dehur të dy. Në të gdhirë, ata patën shkuar vetë tek Amr bin Asi, sepse ai ishte udhëheqës i Egjiptit asokohe dhe i patën thënë:

- "Na ndëshko ashtu siç e urdhëron feja jonë, e na pastro nga kjo ndyrësi; sepse ne pimë derisa u dehëm." Vëllai im, Abdurrahmani, më pati treguar edhe mua se si ishin dehur dhe unë i pata thënë:

- "Hyr brenda në shtëpi, do të ta jap unë dënimin sipas ligjit islam, që të shpëtosh nga pesha e mëkatit." Por nuk e dija që ata kishin shkuar tek Amr bin Asi. Më vonë, këtë ma tha vetë Amr bin Asi. Unë i thashë atij:

- "Eja, mos e qeth kokën përjashta, në sy të të gjithëve, të qeth unë brenda në shtëpi.", sepse, në atë kohë, përpos ndëshkimit që parashikonte ligji, atij që kishte gabuar i qethej floku. Vëllanë e qetha unë. Mandej, Amr bin Asi i ndëshkoi ata sipas ligjit islam.

Nuk kaloi shumë kohë dhe kjo që kishte ndodhur shkoi edhe në vesh të Omerit (radijallahu anhu). Ai i dërgoi fjalë Amr bin Asit:

- "Ta hipësh menjëherë mbi një deve me barrë e ta nisësh për tek unë!" E ai kështu bëri, siç i kishte kërkuar Prijësi i Besimtarëve. Kur mbërriti Abdurrahmani tek ai, Omeri (radijallahu anhu) e dënoi, pastaj

[105]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 8/532 (23095).

e ktheu prapë në Egjipt. Vëllai im, Abdurrahmani, jetoi në Egjipt edhe për ndonjë muaj shëndoshë e mirë, pastaj i erdhi exheli dhe vdiq. Njerëzit filluan të mendonin se ai vdiq nga dënimi që i kishte dhënë Omeri; por kjo nuk ishte e vërtetë. Kjo është e vërteta, ai vdiq me exhelin e vet.[106]

Omeri (r.a.) dhe një grua që kish humbur të shoqin

Tregon Hasan Basriu: "Brenda ishte një grua që nuk e kishte të shoqin. Seç hynin vazhdimisht ca njerëz në shtëpinë e saj. Omerit (radijallahu anhu) nuk i pëlqeu aspak kjo gjë, ndaj i dërgoi asaj fjalë që të vinte tek ai.

- "Të kërkon Omeri.", – i thanë.

- "O Zot, ç'punë ka Omeri me mua?", – u shqetësua ajo. Teksa po ecte rrugës për të shkuar te kalifi, nga frika dhe shqetësimi asaj i nisën të prerat e lindjes. E futën menjëherë në një shtëpi, mirëpo fëmija i saj dështoi. Fëmija klithi dy herë në të qara, pastaj dha shpirt e vdiq. Omeri (radijallahu anhu) u këshillua me sahabët më të afërt të Profetit tonë. Disa i thoshin:

- "Ti nuk je i detyruar të bësh asgjë. Ti je një udhëheqës dhe je edhe komandanti i të gjithëve, që përpiqesh t'i edukosh besimtarët." Mirëpo aty ishte edhe Aliu (radijallahu anhu), i cili rrinte i heshtur, nuk thoshte asnjë fjalë. Omeri (radijallahu anhu) iu drejtua edhe atij duke e pyetur:

- "O Ali, po ti si mendon?"

- "Edhe pse të gjithë ta dhanë një mendim, unë mendoj se ajo që të thanë ata është e gabuar! Veç kësaj ata folën siç do të ta kishte ënda ty, por nuk të dhanë këshillë të mirë e nuk të këshilluan më të mirën. Unë jam i mendimit, se ti ke hyrë në gjakun e atij fëmije, sepse ti e tromakse atë grua dhe ajo e dështoi foshnjën për fajin tënd.", – tha Aliu (radijallahu anhu).

Pasi e dëgjoi fjalën e Aliut, Omeri (radijallahu anhu) ia ngarkoi kurejshëve dietën e gjakut të atij fëmije dhe caktoi Aliun (radijallahu

[106]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/874 (36014).

anhu) të merrej me mbledhjen e pjesës që duhet të jepte secili, sepse ajo vrasje kishte ndodhur pa dashje. Prandaj, dieta e gjakut i ngarkohej fisit të atij që e kishte shkaktuar vdekjen."[107]

Çfarë u thoshte Omeri (r.a.) besimtarëve që vinin në haxh për valitë

Tregon Ataja (radijallahu anhu): "Omeri (radijallahu anhu) i urdhëronte valitë e tij që të vinin tek ai në kohën e haxhit dhe kur zinin të mblidheshin njerëzit ata u thoshin njerëzve:

- "O njerëz! Unë valitë nuk i kam dërguar që t'ju rrahin, t'ju rrëmbejnë pasurinë e plaçkën, apo që t'ju nëpërkëmbin nderin. Unë i dërgoj ata që të vendosin rendin dhe të krijojnë harmoni në shoqëritë tuaja, si dhe që t'ju ndajnë plaçkën e luftës me drejtësi. Nëse ka ndonjë këtu, valiu i të cilit nuk është sjellë kështu, të çohet e të flasë."

Kështu kishte ndodhur gjatë një viti, ishin mbledhur njerëzit dhe ai i pati pyetur, nëse kishin apo jo ndonjë ankesë për drejtuesit e tyre. Ndërkaq, u çua një burrë dhe tha:

- "O Prijësi i Besimtarëve, valiu që ti na ke caktuar mua më ndëshkoi me njëqind fshikullime kamxhikë." Omeri (radijallahu anhu) u kthye nga valiu, të cilit i drejtohej kjo ankesë dhe e pyeti:

- "Pse e ke rrahur këtë njeri?", – dhe, pasi e qortoi mirë e mirë, i tha të ankuarit:

- "Çohu dhe ktheja me të njëjtën monedhë." Kur dha këtë vendim Omeri (radijallahu anhu), Amr bin Asi u ngrit në këmbë dhe tha:

- "O Prijësi i Besimtarëve, nëse e bën këtë, atëherë ankesat do të shtohen pa masë. Kjo do të kthehet në një zakon edhe për ata që do të vijnë pas teje." Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "Si të mos vendos që ky njeri të përgjigjet me të njëjtën monedhë, kur unë kam parë vetë të Dërguarin e Allahut që e ka zbatuar edhe për vete këtë mënyrë, kjo nuk bën vaki."

- "Atëherë na e lër neve atë njeri, dimë ne si ta bindim e ta kënaqim atë njeri.", – tha Amri.

---

[107]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 15/146 (40201).

- "Në rregull, po jua lë juve, fitojani zemrën e lëreni të kënaqur.", – u tha Omeri (radijallahu anhu) Amrit dhe të tjerëve.

Menjëherë, ata i paguan atij njeriu një shpagim prej dy dinarësh për çdo fshikullim kamxhiku që kishte ngrënë, duke e lënë të kënaqur me plot dyqind dinarë."[108]

Historia e të birit të Amr bin Asit me një egjiptian

Enesi (radijallahu anhu) tregon: "Një egjiptian erdhi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- "O Prijësi i Besimtarëve, kam ardhur tek ti, që të më mbrosh nga padrejtësia që më është bërë."

- "Ti erdhe të kërkosh mbrojtje në strehën më të sigurt!", – iu përgjigj atij Omeri (radijallahu anhu).

- "Ne bëmë një garë me djalin e Amr bin Asit dhe unë ia kalova. Djali i Amr bin Asit më tha mua:

- "Unë jam fisnik e bir fisniku, si nga nëna, ashtu edhe nga babai!", – dhe më rrahu, – iu ankua ai Prijësit të Besimtarëve.

Omeri (radijallahu anhu) i shkroi një letër Amr bin Asit, në të cilën i thoshte që të merrte edhe të birin e të vinin pranë tij, në Medinë. Amri erdhi pak më vonë.

- "Ku është ai djali nga Egjipti?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Merre këtë kërbaç dhe qëlloje tani, njësoj siç të qëlloi ai ty.", – i tha djaloshit nga Egjipti, kur e sollën përpara tij.

Djaloshi nga Egjipti e mori kërbaçin dhe filloi të qëllojë mbi djalin e Amr bin Asit.

- "Bjeri mirë të birit të dy prindërve të pagdhendur.", – i thoshte Omeri (radijallahu anhu). Ju betohem tek Allahu, se ai djalë nga Egjipti e rrahu mirë të birin e Amrit; ç'është e vërteta, edhe ne na u bë qejfi. Ai e rrahu atë, derisa ne i thamë 'mjaft'. Mandej, Omeri (radijallahu anhu) i tha atij djali nga Egjipti:

- "Tani merre kamxhikun dhe fshikullo kokën qerose të Amrit!", –

[108]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/872 (36007).

dhe u kthye nga Amri dhe e qortoi me fjalët:

- "Sa shpejt që i skllavëruat njerëzit e lindur nga nëna të lirë?"

- "O Prijësi i Besimtarëve, nuk e dija; ai nuk erdhi tek unë të më tregojë!", – ishin fjalët e vetme që tha Amr bin Asi (radijallahu anhu).[109]

Omeri (r.a.) qorton valiun e Bahrejnit

Ja se si e tregon Jezid bin Ebi Mansuri: "Ibnu'l-Xharudi, valiu i Bahrejnit, kishte prova të sigurta se një person i quajtur 'Erdijas' kishte mbajtur korrespondencë me armiqtë e myslimanëve dhe se synonte të arratisej tek ata dhe e kishte vrarë atë. Kur po e vrisnin, Erdijasi pati bërtitur me sa të kishte në kokë:

- "Ku je, Omer? Ku je, Omer, eja shpejt!" Kur mësoi se çfarë kishte ndodhur, Omeri i shkroi një letër valiut të Bahrejnit, në të cilën i bënte thirrje të shkonte menjëherë në Medinë. Omeri (radijallahu anhu) e priti atë me një heshtë në dorë. Ai shkoi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe Omeri e priti me fjalët:

- "Erdha, Erdijas! Erdha, Erdijas!", – dhe një të ngritur i bëri heshtës dhe e goditi valiun në mjekër.

- "O Prijësi i Besimtarëve! Ai njeri u kishte shkruar armiqve të myslimanëve, për t'u bërë të ditur të fshehtat e myslimanëve dhe kishte ndërmend të arratisej tek ata.", – tha Ibnu'l Xharudi.

- "Domethënë, ti e vrave atë se kishte ndërmend të kalonte në anën e armiqve, kështu hë? E kujt prej nesh nuk i shkon ndërmend të vrasë dikë! Po të mos ndruhesha se vrasja e valiut do të kthehet në zakon, ty do të të kisha vrarë unë tani!", – iu hakërrye Omeri (radijallahu anhu).[110]

Si e tregon Zejd bin Uehbi të njëjtën ngjarje

"Një ditë, Omeri (radijallahu anhu) kishte vënë duart te veshët dhe thoshte me vete:

---

[109]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/873 (36010).
[110]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 15/135 (40168).

- "Ja, këtu jam! Ja, këtu jam!", – dhe doli jashtë. Ata që gjendeshin aty filluan të pyesin:

- "Çfarë e ka gjetur Omerin?" Një nga të afërmit e Omerit u tregoi se si qëndronte puna.

"I erdhi letër nga një prej komandantëve: ushtria e Islamit nuk e kishte kaluar dot një lumë, e nuk kishin gjetur dot as varka për të kaluar. Komandanti kishte thënë:

- "Na gjeni dikë që e di thellësinë e këtij lumi." E ata i kishin sjellë një burrë të moshuar. Ishte edhe shumë ftohtë. Edhe pse ai burrë i moshuar u kish thënë se kishte shumë frikë nga të ftohtët, komandanti e kishte futur në ujë me zor. Ai burrë i moshuar nuk e kishte duruar dot të ftohtin dhe ishte mbytur duke bërtitur:

- "Ku je, o Omer?" Omeri (radijallahu anhu) me të marrë vesh për këtë që kishte ndodhur, i shkroi letër komandantit që të kthehej në Medinë. Omeri (radijallahu anhu) nuk i pa as në fytyrë besimtarët për disa ditë. Kështu bënte, sa herë që mërzitej me ndokënd. Ai e pyeti komandantin:

- "Çfarë faji kishte bërë ai burrë, që e vratë?"

- "O Prijësi i Besimtarëve, unë nuk desha ta vrisja. Nuk gjetëm dot asnjë mundësi për ta kaluar atë lumë, ndaj na duhej të mësonim se sa i thellë ishte. Veç kësaj, ne ngadhënjyem edhe në këto vende.", – u justifikua komandanti.

- "Për mua, jeta e një myslimani është më e çmuar se çdo gjë që mund të më sjellësh ti! Sikur të mos ndruhesha se kjo do të kthehej në rregull, apo zakon, do të ta kisha prerë kokën mu këtu në vend. Hajde, mu zhduk sysh tani dhe paguaju të afërmve të atij njeriu shpagimin e gjakut të tij. Hajde hiqmu sysh, të mos të shoh më!", – ishin fjalët e fundit që tha Omeri (radijallahu anhu)."[111]

Historia e Ebu Musa el-Esh'ariut me një burrë

E tregon Xheriri (radijallahu anhu): "Ushtria, me në krye Ebu Musa el-Esh'ariun (radijallahu anhu) si komandant pati fituar shumë

[111]. Bejheki, *Sunen,* 8/322 (17333).

plaçkë lufte. Ndërsa po ndante plaçkën e luftës, një burri Ebu Musai nuk i dha sa duhej. Ai burrë këmbënguli që t'i jepnin aq sa ç'i takonte, Ebu Musai urdhëroi ta qëllonin atë njeri me njëzet kamxhikë dhe nuk u mjaftua me kaq, por urdhëroi dhe që t'ia qethnin kokën. Ai burrë e mblodhi gjithë flokun e rënë përtokë dhe shkoi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe ia vuri flokun e tij përpara syve.

- "Çfarë ke? Çfarë të ka ndodhur?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu) atë njeri. Dhe ai burrë i tregoi gjithë sa kishte ndodhur. Omeri (radijallahu anhu) i shkroi këtë letër Ebu Musait:

- "Paqja e Zotit qoftë mbi ty! Filani i biri i Filanit më përcolli një ndodhi, që ju kish ndodhur kështu e kështu. Urdhri im është: nëse ato që i ke bërë këtij njeriu ia ke bërë në sy të të gjithëve, atëherë do të dalësh edhe ti përpara njerëzve, do të ulesh përpara këtij burri dhe ai do të të marrë hakun me urdhrin tim. Nëse e ke bërë diku në të fshehtë, ku nuk ka pasur njeri, atëherë edhe ti ulu në një vend ku nuk ka të tjerë, që ai të të marrë hakun e asaj që i ke bërë!"

Ebu Musai, me të lexuar letrën e ardhur nga kalifi i të Dërguarit të Allahut, u ul menjëherë që të zbatohej ndëshkimi me të njëjtën monedhë, por ai burrë u tërhoq duke thënë:

- "Unë do ta fal Ebu Musain për hir të Allahut."[112]

Historia e Fijruz ed-Dejlemiut me një djalosh nga kurejshët

Harmauiu tregon: "Omeri (radijallahu anhu) i shkroi Fijruz ed-Dejlemiut këtë letër:

"Me sa kam dëgjuar, të kanë rrëmbyer buka e bardhë dhe mjalti dhe ke filluar të mos dalësh më të luftosh në rrugën e Allahut! Kur të të mbërrijë kjo letër e imja, nisu me ndihmesën e Allahut dhe lufto në rrugën e Tij."

Fijruzi, një të marrë atë letër u nis për në Medinë. Kërkoi leje për t'u takuar me Omerin (radijallahu anhu) dhe leja iu dha. Teksa po hynte të takohej me Omerin, në të hyrë e shtyu një djalosh nga kurejshët, i cili donte po ashtu të takohej me Omerin (radijallahu anhu). Sakaq,

[112]. Bejheki, *Sunen,* 8/50 (15806).

Fijruzi e goditi me shpullë atë djalë të ri. Djalit filloi t'i rrjedhë gjak nga hundët dhe siç ishte, ashtu, me gjak në fytyrë, u fut tek Omeri (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu)e pyeti:

- "Kush ta bëri këtë?"

- "Fijruzi më qëlloi.", – tha i riu.

Fijruzi në atë kohë ishte te dera. I thanë të hynte brenda. Kur hyri, Omeri (radijallahu anhu) e priti me fjalët:

- "Ç'është kjo kështu, Fijruz?"

- "O Prijësi i Besimtarëve! Ne sapo dolëm nga sundimi mbretëror. Pikë së pari, ti më dërgove mua letër dhe jo këtij djaloshi. Së dyti, ti më dhe leje mua të hyj dhe jo atij. Mirëpo, ai nuk priti, por deshi të takohej me ty nëpërmjet lejes sime. Prandaj edhe i ndodhi ajo që i ndodhi.", – u përgjigj Fijruzi.

- "Atëherë do të të qëllojë edhe ai siç e qëllove ti.", – tha Omeri (radijallahu anhu).

- "Me të vërtetë?"

- "Pa diskutim që po."

Atëherë Fijruzi u ul në gjunjë. Ai i ri sapo u çua ta qëllojë Fijruzin, kur ndërhyri Omeri (radijallahu anhu):

- "Ku shkon, djalosh! Dale njëherë, të të tregoj një hadith që e kam dëgjuar vetë nga goja e të Dërguarit të Allahut. Njëherë, në mëngjes, Resulullahu na tha: "*Sonte u vra Esued el-Ansiu që gënjente e pretendonte se ishte profet. Atë e vrau një nga robërit më të mirë të Allahut, Fijruz ed-Dejlemiu!*" A je ende i mendimit që të zbatosh ndëshkimin me të njëjtën monedhë ndaj Fijruzit edhe tani që dëgjove fjalët plot përgëzim të Profetit për të?"

- "Në rregull,", – u përgjigj djaloshi, – "e kam falur."

- "Po, tani që unë e pranova vetë fajin dhe ai më fali mua pa u detyruar nga askush, a quhet se unë kam shpëtuar nga barra e gabimit tim?", – pyeti Fijruzi.

- "Po!", – iu përgjigj shkurt Omeri (radijallahu anhu).

- "Megjithatë, të kam ty dëshmitar, unë po i fal këtij djaloshi shpatën

time, kalin dhe tridhjetëmijë dërhemë nga pasuria ime.", – tha Fijruzi.

- "Ah mor vëllai im kurejsh! Ti e fale këtë njeri me shpresën që të ta shpërblejë Allahu, por more edhe një çmim shumë të mirë qysh në këtë botë!", – i tha Omeri (radijallahu anhu) djalit të ri."[113]

Një robinjë dhe drejtësia e Omerit (r.a.)

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Një robinjë shkoi tek Omeri (radijallahu anhu) dhe i tha:

- "O prijësi ynë, zotëria im më akuzoi se kam bërë mëkat dhe më detyroi të ulesha mbi zjarr, ndaj jam djegur tërësisht në mes e poshtë."

- "Zotëria yt, e kishte parë me sytë e tij që ti kishe bërë mëkat?", – e pyeti atë Omeri (radijallahu anhu).

- "Jo!", – u përgjigj ajo.

- "Po, mirë, ti a pranove gjë që kishe bërë ndonjë mëkat?"

- "Jo!"

- "Atëherë, thirrmani të vijë tek unë ai njeri."

Kur erdhi ai burrë, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- "Domethënë ti ke filluar të ndëshkosh, duke përdorur dënimin e Allahut, kështu hë?"

- "O Prijësi i Besimtarëve, po unë kisha dyshime shumë të forta!"

- "Domethënë nuk ke parë asgjë me sytë e tu, që kjo grua ka kryer mëkat?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu) atë burrë.

- "Jo, nuk e kam parë."

- "Po ajo vetë, të pranoi se kishte bërë ndonjë mëkat?"

- "Jo, ajo nuk pranoi asgjë.

- "I betohem Allahut që e ka në dorë frymën time, se, po të mos kisha dëgjuar nga Resulullahu, se 'zotërisë për skllavin e tij dhe babait për fëmijën e tij nuk i zbatohet ndëshkimi me të njëjtën monedhë', do ta kisha urdhëruar këtë robinjë që të të ndëshkonte në të njëjtën mënyrë!"

---

[113]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/537 (37474).

Omeri (radijallahu anhu) e gjuajti atë burrë me njëqind kamxhikë. Ndërsa asaj robinje i tha:

- "Ik tani, për hir të kënaqësisë së Allahut këtej e tutje je e lirë. Ti je e liruara e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij. Unë e kam dëgjuar vetë nga Resulullahu, kur ka thënë:

- "Kushdo që vihet për t'u djegur në zjarr, apo gjymtohet nga i zoti (duke iu nxjerrë sytë, duke iu prerë veshët, apo duke iu prerë hunda) është menjëherë i lirë. Ai njeri quhet i liruar nga Allahu dhe i Dërguari i Tij."[114]

Letra që i dërgon Omeri (r.a.) Ebu Ubejdes lidhur me vrasjen e një hebreu

E tregon Kasim bin Ebi Bezeja: "Në Siri, myslimanët vranë një hebre, të cilit i ishte dhënë garanci se nuk do ta prekte askush me dorë. Kjo ngjarje iu bë e ditur menjëherë edhe Ebu Ubejdes, i cili asokohe ishte vali i Sirisë. Ndërsa ai i shkroi menjëherë Omerit (radijallahu anhu). Omeri (radijallahu anhu) iu përgjigj duke i shkruar:

- "Nëse ai mysliman e ka kthyer vrasjen në një zakon të tijin, atëherë nxirre dhe vrite në sy të të gjithëve. Por, nëse e ka vrarë në nerva e sipër, atëherë jepi gjykimin që t'i paguajë katërmijë dinarë (ose dërhemë) familjes së të ndjerit."[115]

Omeri (r.a.)u shkruan letër komandantëve të tij, që të mos vrasin idhujtarë

Sipas fjalës së një personi nga Kufeja, Omeri (radijallahu anhu) i pati shkruar kështu njërit prej komandantëve tij, të cilin e kishte nisur në luftë:

"Me sa kam dëgjuar, disa prej jush u janë vënë pas adhuruesve të zjarrit; kurse ata janë arratisur maleve. Dhe, tani që nuk u ka mbetur më asnjë mundësi për t'i kapur, u japin garanci dhe u dërgojnë fjalë:

[114]. Bejheki, *Sunen,* 3/36 (15726).
[115]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 15/137 (40174).

"Mos kini frikë, nuk do t'ju bëjmë gjë.", – dhe, një t'i kapur, i vrasin! Unë i betohem Allahut, se po dëgjova edhe njëherë se ndonjëri prej jush ka bërë diçka të këtillë, atë që do të gabojë kam për t'ia prerë kokën me duart e mia."[116]

Omeri (r.a.) dhe Hurmuzani, njëri prej komandantëve persë

Enes bin Maliku (radijallahu anhu) tregon: "Ne kishim rrethuar Tusterin. Njëri prej komandantëve persë zbriti dhe u dorëzua vetëm me kushtin që të merrte vendim Omeri (radijallahu anhu). Tek Omeri (radijallahu anhu)e çova unë. Omeri (radijallahu anh) i tha Hurmuzanit:

- "Fol!"

- "Si të flas, si dikush që do të vdesë pas pak, apo si një njeri që do të jetojë?", – pyeti Hurmuzani.

- "Fol, se ne nuk do të të bëjmë keq!", – ia priti Omeri (radijallahu anhu).

- "O arabë! Para se Allahu i Madhërishëm t'ju dërgonte juve një profet, ne gjithmonë ju kemi vrarë, ju kemi përdorur si skllevër dhe jua kemi rrëmbyer gjithë ç'keni pasur. Por, qëkurse Allahu ju dërgoi juve Profetin e Tij dhe u bë me ju, ne na janë prerë krahët fare."

Enesi (radijallahu anhu) thotë se: "Omeri (radijallahu anhu) më pyeti mua:

- "Ç'të bëjmë me të, si mendon?

- "O Prijësi i Besimtarëve, ti ke lënë pas një armik shumë të madh në numër. Nëse e vret atë njeri, atëherë pjesa tjetër që ka mbetur pas do ta humbasë çdo shpresë për jetën, kështu që nuk do t'u ngelet asgjë tjetër për të bërë, veçse të luftojnë.", – i thashë unë. Por Omeri (radijallahu anhu) ma priti duke më thënë:

- "Ç'po më thua, që unë do të ndruhem të vras dikë që ka vrarë dy sahabë nga më të mëdhenjtë, siç ishin Bera bin Maliku dhe Mixhzee bin Theuri?" Kisha frikë se Omeri (radijallahu anhu) do ta vriste Hurmuzanin, prandaj, edhe njëherë, i thashë:

- "Nuk e vret dot; sepse i dhe garanci, i the 'fol, nuk do të të ndodhë

[116]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/811 (11449).

asgjë e keqe'."

- "Ç'të ka ndodhur kështu, mos të ka dhënë para që t'i dalësh në mbrojtje, mos të ka dhënë ryshfet?", – më tha Omeri (radijallahu anhu).

- "Uallahi, nuk kam marrë as ryshfet, as ndonjë gjë tjetër prej atij njeriu!", – i thashë unë.

Në moment, Omeri (radijallahu anhu) u kthye nga unë dhe m'u kanos duke më thënë:

- "Atëherë ti do të më sjellësh mua këtu një dëshmitar, që unë i dhashë garanci Hurmuzanit dhe i thashë: "Fol, se nuk do të të ndodhë asgjë e keqe." Në të kundërt, do të të dënoj ty të parin!" Nuk kisha se ç'të bëja, dola të kërkoja dëshmitar. Në rrugë rastisa Zubejr bin Auamin, erdhi edhe ai me mua si dëshmitar, e vetëm ashtu arritëm që ta bindnim Omerin (radijallahu anhu), të hiqte dorë e të mos e vriste Hurmuzanin. Pas njëfarë kohe, edhe Hurmuzani u bë mysliman, madje ishte vetë Omeri (radijallahu anhu) që i caktoi edhe një pagë."[117]

Omeri (r.a.) i cakton pagë një hebreu

Abdullah bin Ebi Hadred el-Eslemiu (radijallahu anhu) tregon: "Njëherë, kur ne shkuam në Xhabije bashkë me Omerin (radijallahu anhu), atje pamë një të moshuar që ishte duke lypur. Omeri (radijallahu anhu) pyeti se kush ishte ai njeri.

- "Është një hebre nevojtar i moshuar.", – i thanë. Omeri (radijallahu anhu) ia hoqi menjëherë taksën që duhet të paguante. Ndërsa drejtuesve të Xhabijes u dha një qortim të mirë:

- "Ju i patët vënë atij taksën e xhizjes kur ishte i shëndetshëm, ndërsa tani që e kanë lënë fuqitë e keni lënë të dalë e të lypë, apo jo?" Ndërsa atij burri të moshuar e nevojtar, megjithëse ai kishte njerëz që mund të kujdeseshin për të, nga thesari i lidhi një pension prej dhjetë dërhemësh."[118]

---

[117]. Bejheki, *Sunen,* 9/96 (17962).
[118]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/825 (11491).

Omeri (r.a.) dhe një jomysliman

Tregon Jezid bin Ebi Maliku: "Në kohën që myslimanët ishin në Xhabije, atje pati ardhur edhe Omeri (radijallahu anhu). Tek Omeri (radijallahu anhu) pati ardhur një jomysliman, që t'i ankohej se ushtarët i kishin ngrënë rrushin. Omeri (radijallahu anhu) doli të kontrollojë. Dhe, kur njërit prej luftëtarëve i gjeti një vesh rrushi në duar, i tha:

- "Edhe ti?"

- "O Prijësi i Myslimanëve, isha shumë i uritur!", – u përgjigj ai.

Paskëtaj Omeri (radijallahu anhu) dha urdhër që të zotit të vreshtit t'i paguhej vlera e rrushit që kishin marrë ushtarët myslimanë."[119]

Omeri (r.a.) gjykon një çështje mes një myslimani e një hebreu dhe i jep të drejtë hebreut

Said bin Musejebi tregon: "Një mysliman kishte një mosmarrëveshje me një hebre dhe, për t'i gjetur zgjidhje, ata erdhën të dy tek Omeri (radijallahu anhu), që të gjykonte ai se kush kishte të drejtë. Omeri (radijallahu anhu) e pa që në të drejtë ishte hebreu, ndaj vendosi menjëherë për të. Ai hebre tha:

- "Uallahi, ti gjykove me drejtësi!" Omeri (radijallahu anhu) mori kërbaçin dhe gjuajti mbi hebreun dhe e pyeti:

- "Nga e di ti që gjykova drejtë?" Hebreu i shushatur iu përgjigj:

- "Uallahi, ne e kemi lexuar në Teurat: Kur një gjykatës gjykon drejtë, fjalën e tij e aprovojnë dy engjëj, një në të djathtë, një në të majtë të tij. Ata engjëj e ndihmojnë atë të dalë faqebardhë, për aq kohë sa ai vendos gjithmonë me drejtësi. E, nëse ndodh që gjykatësi të devijojë nga e drejta, atëherë, edhe ata engjëj e braktisin dhe e lënë vetëm atë."[120]

DREJTËSIA E OSMANIT (r.a.)

Një ndodhi e Osmanit (r.a.) me njërin prej skllevërve të tij

Tregon Ebu'l-Furati: "Osmani (radijallahu anhu) kishte një skllav.

[119]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 4/814 (11457).
[120]. Bejheki, *Sunen,* 10/88 (19953).

Një ditë, Prijësi i Besimtarëve, Osmani (radijallahu anhu) i tha skllavit të tij:

- "Të kam tërhequr veshin njëherë, ndaj tani do të ma kthesh edhe ti po njësoj!" Skllavi e kapi Osmanin (radijallahu anhu) për veshi. Osmani (radijallahu anhu) i tha atij:

- "Tërhiqe, përthyeje fort. Se nëse diçka kthehet me të njëjtën monedhë që në këtë botë, në ahiret nuk mbetet nevojë për t'u vënë drejtësia në të njëjtën mënyrë!"[121]

Vendimi i drejtë i Osmanit (r.a.) për një pëllumb

Nafi bin Abdulharithi tregon: "Në Mekë kishte ardhur Omeri (radijallahu anhu). Të premten ai hyri në Daru'n-Nedue, sepse donte të ishte sa më afër Xhamisë së Shenjtë. Hoqi jelekun dhe e vari diku. Mbi jelek erdhi dhe ndaloi një pëllumb. Ai e trembi pëllumbin, se mos ia bënte pis jelekun. Afër pëllumbit ishte afruar një gjarpër, kështu që me vërtikun e pëllumbit gjarpri një të hedhur bëri, e pickoi pëllumbin dhe ai ngordhi. Teksa Omeri (radijallahu anhu) po u falte besimtarëve namazin e xhumasë, në faltore shkuam unë dhe Osmani (radijallahu anhu). Ai na tha neve:

- "Dua që të vendosni për një gjë që kam bërë unë sot!", – dhe na tregoi se çfarë i kishte ndodhur, duke na thënë:

- "Në fakt, zogu ishte ulur në vend të sigurt, por e detyrova unë të zhvendosej dhe kur fluturoi u pickua nga gjarpri. U bëra shkak për ngordhjen e atij pëllumbi." Aty unë ndërhyra dhe i thashë Osmanit (radijallahu anhu):

- "Si thua, sikur të vendosim që Prijësi i Besimtarëve të presë kurban një dhi të murrme trevjeçare?"

- "Po, mirë e ke gjetur, edhe unë i atij mendimi jam!", – tha Osmani (radijallahu anhu). Kështu, Omeri (radijallahu anhu)kërkoi të therej një dhi e atillë, me ato cilësi siç e patëm përcaktuar ne."[122]

---

[121]. Muhamed Rida, *Uthman bin Affan,* 1/37.
[122]. Bejheki, *Sunen,* 5/205 (9782).

DREJTËSIA E ALIUT (r.a.)

Aliu (r.a.) ndan plaçkën e ardhur prej Isfahanit

Tregon Kulejbi: "Aliut (radijallahu anhu) i kishte ardhur plaçkë lufte nga Isfahani. Ai e ndau atë në shtatë pjesë. Në mesin e asaj plaçke kishte edhe bukë të bardhë; edhe atë e ndau në shtatë pjesë dhe secilën pjesë e vuri mbi shtatë pjesët e plaçkës që kishte ndarë më parë. Pastaj thirri shtatë komandantët dhe ua dorëzoi plaçkën me short."[123]

Një bisedë e Aliut (r.a.) me një grua arabe

Ja se si e ka treguar këtë ndodhi Isa bin Abdullah el-Hashimiu:

Tek Aliu (radijallahu anhu) erdhën dy gra; njëra ishte arabe, kurse tjetra ishte robinja/shërbëtorja e saj. Donin që Aliu (radijallahu anhu) t'u jepte ndonjë gjë dhe ai u dha secilës nga gjashtëdhjetë masa grurë dhe nga dyzet dërhemë në vlerë paraje. Shërbëtorja i mori ato që iu dhanë dhe iku, kurse gruaja tjetër i tha:

- "Po edhe mua, aq sa ç'i dhe shërbëtores sime më dhe, o Prijësi i Besimtarëve? Po unë jam grua arabe, ndërsa ajo është një shërbëtore!" Aliu (radijallahu anhu) e dëgjoi atë grua dhe i tha:

- "Unë e kam lexuar Kur'anin me kujdes; askund nuk hasa në ndonjë shenjë që ata që kanë ardhur nga soji i profetit Ismail janë më të lartë sesa ata që kanë ardhur nga soji i profetit Is'hak!"[124]

Një dialog mes Aliut (r.a.) dhe Xha'de bin Hubejres

Tregon Ali bin Rabia: "Xha'de bin Hubejre erdhi pranë Aliut (radijallahu anhu) dhe i tha: "O Prijësi i Besimtarëve! Tek ti po vjen një njeri që të do më shumë se veten, se familjen dhe pasurinë e tij; por edhe një njeri, që po t'i jepet mundësia, do të të mbysë në vend. Kurse ti më rri e më vendos drejtësi në anën e atij që ka mllef ndaj teje, e kundër atyre që të duan?" Aliu (radijallahu anhu) i rrahu gjoksin Xha'des dhe i tha:

---

[123]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/940 (14347).
[124]. Bejheki, *Sunen,* 6/349 (12769).

- "Po të ishte për mua dhe për ato çfarë ndiej e mendoj unë, ndoshta ashtu do të veproja; mirëpo, fjala është për një të drejtë që e ka vendosur Allahu, andaj kurrsesi nuk mund të veproj ashtu siç më këshillon ti!"[125]

DREJTËSIA E ABDULLAH BIN REUAHAS

Abdullah ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Abdullah bin Reuaha (radijallahu anhu) shkonte çdo vit në Hajber; pasi u përcaktonte hebrenjve me përllogaritje hurmat dhe rrushin, u kërkonte atyre që të jepnin gjysmën e asaj mase si taksë. Hebrenjtë qenë ankuar menjëherë tek i Dërguari i Allahut, se Abdullah bin Reuaha tregohej shumë i përpiktë kur bënte përllogaritjen e prodhimit. Nga ana tjetër, ata u përpoqën që t'i jepnin edhe ndonjë ryshfet Abdullah bin Reuahas. Pas kësaj, Abdullah bin Reuaha u tha atyre:

- "O armiqtë e Allahut! Ç'kërkoni të bëni, doni të më shtyni mua të ha atë që është e ndaluar? Unë i betohem Allahut, këtu kam ardhur për të kryer detyrën që më ka ngarkuar njeriu më i dashur ndër njerëz, i Dërguari i Allahut. Pa, po të jetë për mua, mua edhe majmunët dhe derrat më duken më të dashur sesa ju. Megjithatë, edhe pse unë ju urrej, dashuria që ushqej ndaj të Dërguarit të Allahut nuk më lejon të veproj me ju me padrejtësi!" Atëherë, ata e përgëzuan Ibni Reuahan, duke thënë:

- "Ja, është pikërisht kjo drejtësi, që i mban ende në këmbë Tokën dhe qiejt!"[126]

DREJTËSIA E MIKDAD BIN ESUEDIT

Tregon Harith bin Suejdi: "Mikdad bin Esuedi ishte pjesë e një grupi luftëtarësh që ishin nisur për të luftuar. Papritur ata u rrethuan nga armiku dhe komandanti i myslimanëve u tha ushtarëve të tij të mos i nxirrnin kafshët dhe bagëtitë për të kullotur. Por njëri nuk e dëgjoi fjalën e komandantit dhe i pati nxjerrë ato. Me të mësuar për këtë, komandanti e rrahu paq atë njeri. Teksa ktheheshin, ai njeri tha:

[125]. Ibn Asakir, *Tarihu Dimashk,* 42/488.
[126]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 4/199.

- "Kurrë nuk kam përjetuar ndonjëherë ditë si kjo, kaq të keqe." Pas një farë kohe, Mikdadi (radijallahu anhu) shkoi tek ai njeri dhe i tha:

- "Pse më dukesh kaq i mërzitur?" E ai njeri i tregoi të gjitha sa i kishin ndodhur, duke i shpjeguar pse ndihej i mërzitur. Mikdadi e dëgjoi, nxori shpatën dhe e mori me vete atë njeri, që të shkonin te komandanti. U takuan me komandantin dhe ai i tha:

- "Tani do të më lejosh që të të kthej me të njëjtën monedhë ndëshkimin që më dhe!" Megjithatë, edhe pse komandanti ia dha lejen, ai njeri vendosi ta falte komandantin, duke ia bërë hallall atë sjellje që kishte treguar ndaj tij pa të drejtë. Ndërsa po ktheheshin pas, Mikdadi (radijallahu anhu) thoshte:

- "Nuk ka pikë dyshimi, kur të vdes unë, Islami do të jetë i fuqishëm dhe ngadhënjimtar ndaj kujtdo!"[127]

18. KALIFËT I FRIKËSOHESHIN TEJMASE ALLAHUT

Vetëdija e përgjegjësisë e Ebu Bekrit (r.a.) ndaj Allahut

Dahaku tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) pa një zog që ishte ulur në një degë peme dhe tha:

- "Sa mirë që je ti, o zog! Sa shumë do të doja të kisha qenë një zog si ti: do të haja frutat më të mira të pemëve, pastaj do të fluturoja. As nuk ke frike se një ditë do të japësh llogari, as se do të ndëshkohesh për gabimet e tua! Uallahi, jo zog, por do të doja të isha një pemë ndanë rrugës... Vetëm njeri të mos isha!..."[128]

Përgjegjësia që ndiente Omeri (r.a.) ndaj Allahut

Sipas asaj që na përcjell Dahaku, Omeri (radijallahu anh) ka thënë:

- "Ah sikur të kisha qenë një prej deshve të familjes dhe ata të më ushqenin. E të më thernin kur të bujte ndonjë mik, të ma piqnin një pjesë të mishit, ndërsa pjesën tjetër të ma thanin e ta hanin vetë... Ah

[127]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/176.
[128]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/764 (35703).

sikur të mos kisha qenë njeri!"[129]

Një dialog i zhvilluar mes Omerit (r.a.) dhe Ebu Musa el-Esh'ariut

Ibni Omeri (radijallahu anhu) tregon: "Një ditë, babai im, Omeri u takua me Ebu Musa el-Eshariun dhe i tha:

- "O Ebu Musa, përveç punëve që ke bërë me të Dërguarin e Allahut, të tjerat i ke njësoj, si të mirat, ashtu edhe të këqijat; a je i kënaqur, si të jenë në të mirën tënde, si të mos jenë?" Ebu Musai (radijallahu anhu) iu përgjigj:

- "Jo o prijës! Nuk jam kurrsesi i kënaqur. Uallahi, kur shkova në Basra, atje mbizotëronin padrejtësia dhe injoranca. Unë u mësova atyre njerëzve Kur'anin dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut. Edhe luftova në rrugën e Allahut, bashkë me ta. Andaj, kam shpresë se Allahu do të tregohet i mirë e do të më falë prej mirësisë së Tij."

- "Unë nuk dua, që ato punë që kam bërë pas ikjes së të Dërguarit të Allahut, të më peshohen, si në të mirën, ashtu edhe në dëmin tim. Mjaft që të më mbeteshin vetëm i Dërguari Fisnik dhe ato që kam bërë kur kam qenë me të!"[130]

Vetëdija e përgjegjësisë ndaj Allahut e Omerit (r.a.), vetëm pak çaste para se të ndahej nga jeta

Ibni Abasi (radijallahu anhu) tregon: "Në kohën që u plagos Omeri (radijallahu anhu), unë shkova menjëherë tek ai dhe i thashë:

- "Ky është një sihariq për ty, o Prijësi i Besimtarëve! Sajë teje Allahu ngriti sa e sa qytete të reja të Islamit dhe sajë teje zhduku hipokrizinë dhe përçarjet, duke i bërë myslimanët edhe më të kamur, me pasuri paanë."

- "O Ibni Abas, çfarë po thua, po më përgëzon se kam qenë një prijës i mirë?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Jo, o Omer, e kam fjalë për punët e tjera që ke bërë, jo si udhëheqës."

---

[129]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/52.
[130]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/839 (35917).

- "I betohem Zotit, se Ai e ka në dorë jetën time, se do të doja shumë, që nga kjo botë të largohesha ashtu siç erdha, pa asnjë mëkat. Do të doja të mos kisha as punë të mira, as mëkate mbi shpinë!"[131]

Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër, Omeri (radijallahu anhu) i ktheu Ibni Abasit këtë përgjigje:

- "Ti po më përgëzon mua se kam merituar Xhenetin: unë i betohem Zotit, veç të Cilit nuk ka asnjë zot tjetër, se Ai e ka në dorë jetën time, se sikur të miat t'i kisha gjithë ç'mban sipër kjo botë, do t'i jepja të gjitha pa një e pa dy, pa u menduar dy herë se kush do të ishte përfundimi, si shpagim, vetëm e vetëm të mund të shpëtoja nga ndëshkimi i Xhehenemit që më pret. E, për sa u përket atyre që më the lidhur me udhëheqjen time; nuk dua të kem asgjë as në dobinë time, as në dëmin tim, kaq më mjafton! Shpresa e vetme që kam është se unë kam jetuar e kam biseduar bashkë me të Dërguarin e Allahut."[132]

Në një përcjellje tjetër, Omeri (radijallahu anhu) u ka thënë të pranishmëve:

- "Më ngrini, dua të qëndroj ulur!" E ngritën dhe ai iu drejtua Ibni Abasit:

- "Pa ma thuaj edhe njëherë, çfarë më the?" Dhe ai ia tha. Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- "Po mirë, o Ibni Abas, po në ditën e në sheshin e gjykimit, kur të dalësh përpara Zotit, a do të dëshmosh për mua po kaq mirë?"

- "Po, patjetër që do të dëshmoj.", – ia ktheu Ibni Abasi.

Kjo përgjigje e Ibni Abasit e gëzoi jashtëzakonisht shumë Omerin (radijallahu anhu)."[133]

A duhet të ketë frikë nga kritikat ai që është Prijësi i Besimtarëve?

Said bin Jezidi tregon: "Një burrë e pyeti Omerin (radijallahu anhu):

- "Çfarë është më e mirë për mua, të marr ndonjë detyrë drejtuese dhe për hir të Allahut të duroj kritikat e njerëzve, apo të largohem nga

[131]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/52.
[132]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/353.
[133]. Ibn Sa'd, *Tabakatu'l-Kubra,* 3/354.

njerëzit dhe t'i përkushtohem adhurimit të Zotit?"

- "Çdokush që merr përsipër ndonjë punë që ka lidhje me myslimanët, nuk ka pse të ketë frikë nga kritikat për hir të Allahut; çdo mysliman, të cilit nuk i është dhënë ndonjë detyrë drejtuese, të merret me punën e tij; e ta këshillojë atë që ka mbi krye të bëjë atë që është më e drejta.", – iu përgjigj Omeri (radijallahu anhu).[134]

19. KËSHILLAT E KALIFËVE PËR NJËRI-TJETRIN DHE PËR VALITË

Këshillat e Ebu Bekrit (r.a.) për Omerin (r.a.)

Tregon El-Egarri nga fisi i bijve të Malikut: "Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) deshi të zgjidhte Omerin (radijallahu anhu) si pasardhës, ai e thirri atë të vinte tek ai dhe i tha këto fjalë:

- "Kur të vdes, dua që detyrën e kalifatit, që është një mision shumë i lodhshëm, ta marrësh ti përsipër. O Omer, frikësoju Allahut dhe bindju urdhëresave të Tij, sepse njeriu që është i devotshëm, ka përherë mbrojtjen dhe mbështetjen e Allahut. Grada e kalifatit u duhet propozuar atyre që mund t'i japin hakun pozicionit në të cilin gjenden dhe që mund të përmbushin të gjitha detyrat e epërme që parashikon ai si mision. Nëse dikush i urdhëron të tjerët të bëjnë atë që është më e mirë e më e drejtë dhe vetë ngarend pas gjërave të kota dhe u flet njerëzve për të mirën, ndërsa vetë kryen gjithë të zezat, nuk kalon shumë kohë dhe ai njeri e humb besueshmërinë, e të gjitha sa ka bërë i shkojnë dëm. Nëse e merr ti përsipër drejtimin e myslimanëve, duart mbaji larg gjakut të tyre, e barkun larg pasurisë së tyre, dili zot gjuhës e mos ua thyej sedrën. Forca dhe fuqia nuk janë vetëm se të Allahut."[135]

Amaneti i Ebu Bekrit (r.a.) pak para se të ndahej nga jeta

Abdurrahman bin Sabiti tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte duke vdekur, ndaj kërkoi që t'i gjenim Omerin (radijallahu anhu) e t'ia sillnim aty. Omeri erdhi dhe ai i la atij këtë amanet:

---

[134]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/930 (14316).
[135]. Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 1/59 (37).

"O Omer! Ta kesh frikë Allahun! Dhe ta dish: Ka disa punë që Allahu na kërkon që t'i kryejmë gjatë ditës, të cilat nuk i pranon, nëse ato kryhen gjatë natës. Por ka edhe disa punë, të cilat kërkon që ne t'i bëjmë gjatë natës, që, nëse i kryejmë gjatë ditës, ato nuk pranohen. Nëse detyrimet nuk përmbushen siç duhet, Allahu nuk i pranon as adhurimet që ne i kryejmë vetë për veten tonë. Në ditën e Kiametit, që peshorja e dikujt të anojë nga ana e të mirave dhe e shpërblimit, varet vetëm nga ajo sesa ai i është bindur Allahut. Dhe peshorja, në të cilën vihen të mirat patjetër që anon nga e mira, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Ashtu siç, shkaku, që në ditën e Kiametit, peshorja e dikujt të jetë e lehtë në anën e punëve të mira dhe e shpërblimeve, e të mos anojë ashtu, është vetëm se nga rendja pas punëve të kota. Është më se normale, që pjata e peshores në të cilën vendosen punët e kota të mos rëndojë fare. Kur i përmend banorët e Xhenetit, Allahu i Madhërishëm i përmend ata duke përmendur punët më të mira që ata bëjnë në këtë jetë, nuk është ndalur asfare në sjelljet e këqija të tyre. Sa herë që më kujtohen banorët e Xhenetit, në vete më kaplon një shqetësim tejet i thellë dhe them: 'E si mund të jem unë një prej tyre!' Kurse banorët e Xhehenemit Allahu i Drejtë i përmend duke përmendur punët më të këqija që ata bëjnë, ndërsa punët e mira ua përplas në fytyrë! Më ngjethet mishi kur i kujtoj dhe me vete them: 'Mos vallë unë jam një prej tyre?'"

Përcjellësit thonë se: "Pas këtyre fjalëve Ebu Bekri këndoi disa ajete të mëshirës dhe të ndëshkimit prej Kur'anit Fisnik, mandej tha:

"O Omer! Një rob i Allahut, i cili beson tek Ai duhet të qëndrojë diku mes shpresës dhe frikës. Ai nuk duhet të kërkojë kurrsesi asgjë tjetër vetëm se të vërtetën e të drejtën, pa e humbur kurrë shpresën te mëshira e Allahut. Njeriu nuk duhet ta vërë veten në rrezik me duart e veta. O Omer, nëse do ta mbash mirë këtë amanet që po të lë, dije se edhe vdekjen ke për ta pritur me një dëshirë të papërshkrueshme. Por nëse nuk e mban atë ashtu siç e meriton, atëherë, pas vdekjes vështirë të urresh ndonjë gjë tjetër më shumë! Dhe vdekjes është e pamundur t'i ikësh!"[136]

[136]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/878 (14180).

Këshillat e Ebu Bekrit (r.a.) për Amr bin Asin

Abdullah bin Ebi Bekr bin Muhamed bin Amr bin Hazmi tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) kishte vendosur të dërgonte një ushtri në drejtim të Sirisë, ndaj, fillimisht ai dërgoi një ushtri nën komandën e Amr bin Asit në drejtim të qytetit të "Ejles" në Palestinë. Amri kishte thuajse tremijë ushtarë, në mesin e të cilëve kishte shumë muhaxhirë dhe ensarë. Ebu Bekri doli të ecë bashkë me Amrin, për të përcjellë ushtrinë dhe për t'i dhënë atij porositë e fundit:

"O Amr! Kije frikë Allahun në çdo gjë që bën, qoftë ajo haptas, apo e fshehtë që e di vetëm ti, të të vijë turp prej Tij, sepse Ai të sheh edhe ty, edhe bëmat e tua, në çdo çast dhe në çdo vend. O Amr, në mesin e shumë besimtarëve që janë bërë myslimanë përpara teje e që janë shumë herë më të dobishëm për Islamin, unë të zgjodha ty në krye të kësaj ushtrie. Andaj edhe ti bëhu një prej atyre që punojnë për amshimin e tyre, çdo gjë që do të bësh bëje për hir të kënaqësisë së Allahut dhe tregohu i dhembshur me njerëzit, porsi një baba, mos kërko t'u zbulosh atyre të metat e gabimet e fshehta që mund të kenë, mjaftohu me atë që sheh, ji i vendosur kur merr vendim dhe bëji durim daljes përballë armikut, mos u tremb, sepse Allahu i ndëshkon menjëherë ata që e tradhtojnë rrugën e Tij. Kur t'i këshillosh njerëzit, fol pak dhe qartë. Ndreqe ti veten i pari, që njerëzit të ta dëgjojnë fjalën e të të binden!"[137]

Këshillat e Ebu Bekrit (r.a.) për Amrin dhe Uelid bin Ukben

E tregon Kasim bin Muhamedi: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) pati caktuar Amr bin Asin dhe Uelid bin Ukben, që të mblidhnin zekatin e fisit të Kudaave. Në nisje ata i përcolli edhe Ebu Bekri (radijallahu anhu), duke i dhënë secilit disa këshilla.

Pas njëfarë kohe ai u shkroi atyre edhe një letër:

"Kijeni frikë Allahun në çdo gjë që bëni, haptas, apo në fshehtësi. Allahu ua ka hapur deri në fund portat e shpëtimit të gjithë atyre që janë të devotshëm e i frikësohen Allahut, duke i shpërblyer në mënyra

[137]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/36.

të atilla që ata as nuk i kanë imagjinuar dot ndonjëherë. Kush e ka frikë Allahun, edhe Allahu ia fal atij gabimet, duke i dhënë edhe shpërblime të shumëfishta. Këshilla më e mirë që robt e Allahut mund t'i japin njëri-tjetrit është që ata të jenë të devotshëm. Ti tani je në një prej rrugëve të Zotit, ndaj do të ishte shumë e gabuar, nëse ti tregohesh i kujdesshëm më shumë për përfitimet e tua personale, duke u treguar i dobët dhe shpërfillës ndaj çështjeve fetare, apo ato të kësaj bote që kanë të bëjnë me jetën e myslimanëve. Prandaj, ti nuk duhet të tregohesh kurrsesi i dobët apo i lodhur nga kjo detyrë e madhe që ke marrë përsipër."[138]

Këshillat e Ebu Bekrit (r.a.) për Shurahbil bin Hasenenë

Muhamed bin Ibrahim bin Harith et-Tejmiu tregon: "Ebu Bekri (radijallahu anhu) e pati liruar nga detyra e komandantit Halid bin Saidin (radijallahu anhu) dhe në krye të ushtrisë përzgjodhi Shurahbil bin Hasenenë, të cilin e porositi:

"Nderoje dhe respektoje Halid bin Saidin, e mos harro kurrë të drejtat që ai ka mbi ty. Mendo pak se çfarë do të prisje prej tij po të ishte ai komandanti yt dhe ashtu sillu edhe ti me të. Ti e di mjaft mirë pozicionin e tij në Islam. Kur vdiq Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), Halid bin Saidi ishte vali i emëruar nga vetë ai. Edhe unë në të njëjtën detyrë e emërova; por, më vonë, m'u duk më me vend që ta liroja nga ajo përgjegjësi. Ndoshta kështu do të jetë edhe më mirë për të. Kur i thashë që ta zgjidhte vetë se në ushtrinë e cilit komandant donte të bënte pjesë, atij ti i pëlqeve më shumë sesa të tjerët, madje edhe sesa djali i tij i xhaxhait, Jezid bin Ebi Sufjani. Sa herë që të kesh nevojë për mendimin e një njeriu të devotshëm e që do të të këshillojë gjithmonë për mirë, në fillim të shkosh tek Ebu Ubejde bin Xherrahu, pastaj te Muadh bin Xhebeli, e së treti, te Halid bin Saidi. Nuk ka dyshim se secili prej tyre ka për të të dhënë këshillat e mendimet më të mira që mund të marrësh prej ndokujt. Mos bëj asgjë pa u këshilluar njëherë me ta, e lajmet e letrat që do të marrësh tregojua edhe atyre njëherë."[139]

---

[138]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/846 (14095).
[139]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/848 (14100).

Këshillat e Ebu Bekrit (r.a.) për Jezid bin Ebi Sufjanin

Harith bin Fudajli tregon se: "Në kohën kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) zgjodhi në krye të ushtrisë Jezid bin Ebi Sufjanin, ai u ul pranë tij dhe i tha:

"O Jezid, ti je ende i ri, por njerëzit të njohin prej disa punëve shumë të mira që ke bërë. Të gjitha ato janë sjellje që të interesojnë vetëm ty. Unë desha të të vija në provë. Thashë të të largoj njëherë nga familja, e të shoh se si do të sillesh, ç'aftësi ke dhe të shoh nëse mund të jesh një komandant i mirë, apo jo. Nëse punon mirë dhe do të jesh i suksesshëm, më vonë do të të jap edhe shumë detyra të tjera. Në të kundërt, nëse tregohesh drejtues i keq, ta dish se do të të shkarkoj menjëherë. Të kam zgjedhur komandant të ushtrisë që drejtonte Halid bin Saidi. Shiko, unë të këshilloj të sillesh mirë me Ebu Ubejde bin Xherrahun. Ti e di se çfarë vendi ka ai në Islam, sepse Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ka thënë me gojën e tij: *"Çdo popull i një profeti ka të besuarin e vet dhe i besuari i këtij populli është Ebu Ubejde bin Xherrahu.*" Andaj, dua që të mos e harrosh kurrë epërsinë dhe vendin e lartë që zë Ebu Ubejdeja në Islam. Edhe ndaj Muadh bin Xhebelit, trego respekt dhe dëgjoja fjalën me kujdes. Ti e di, ai ka marrë pjesë në çdo luftë ku ka qenë edhe Resulullahu. E ke dëgjuar, i Dërguari i Allahut për të ka thënë: "*Në ditën e Kiametit, Muadh bin Xhebeli do të qëndrojë një shigjetë më përpara se të gjithë njerëzit e ditur.*" Mos merr asnjë vendim pa u këshilluar njëherë me këta dy njerëz. Zaten, as ata nuk do ta kursejnë kurrë të mirën ndaj teje."

Pasi i dëgjoi me kujdes të tëra këshillat e Ebu Bekrit (radijallahu anhu), Jezid bin Ebi Sufjani i tha atij:

- "O kalif i të Dërguarit të Allahut! Këshilloji edhe ata kështu siç më këshillove mua."

- "Patjetër, patjetër që do t'i këshilloj.", – i dha fjalën Ebu Bekri.

- "Zoti të mëshiroftë, e Ai t'i shpërbleftë me mirësitë e Tij të gjitha shërbimet që po i bën Islamit!", – i tha atëherë Jezidi Ebu Bekrit (radijallahu anhu)."[140]

[140]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/844 (14089).

Jezid bin Ebi Sufjani (radijallahu anhu), sipas një transmetimi tjetër ka thënë:

- "Kur Ebu Bekri (radijallahu anhu) më dërgoi mua në Siri, ai më këshilloi:

"Shiko, Jezid! Ti ke shumë të afërm e shumë kushërinj. Frika më e madhe që kam për ty, është se mos ti zgjedh të afërmit e tu në vend të atyre që e meritojnë të jenë drejtues. Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) na ka porositur: "*I mallkuar qoftë te Zoti kushdo që merr përsipër drejtimin e punëve të myslimanëve dhe me nepotizëm u vë atyre mbi krye një njeri që është më i afërm me të! Allahu nuk ia pranon tij as adhurimet e detyruara, as ato që ai i kryen me përkushtimin e tij, madje, e përgatit atë drejt e për në Xhehenem. I mallkuar qoftë te Zoti kushdo që merr atë që i takon të vëllait dhe ia jep dikujt tjetër! Allahu i ka ftuar njerëzit që ata t'i besojnë Atij, duke hyrë kësisoj nën mbrojtjen e Tij. Prandaj, ai që tregohet i padrejtë me dikë që ka marrë garanci prej Allahut, nuk ka sesi të mos preket nga mallkimi dhe ndëshkimi i ashpër i Allahut.*"[141]

Këshillat e Omerit (r.a.) për atë që do ta pasojë si kalif

Omeri (radijallahu anhu) ka thënë: "Këshilla ime për atë që do të vihet kalif pas meje është që ai të mbrojë të gjitha të drejtat që u takojnë muhaxhirëve, e të mos shfaqë as mungesën më të vogël të respektit ndaj tyre. Kurse muhaxhirëve, atyre u këshilloj që të sillen mirë me ensarët, të cilët ende pa nisur hixhreti e kthyen Medinën në atdhe dhe shtëpi të besimit tek Allahu, t'ua pranojnë çdo të mirë me gëzim dhe t'ua falin nëse kanë ndonjë të metë. Atij që do të vihet kalif, i propozoj që të tregohet i mirë edhe ndaj bashkësive të tjera, që jetojnë në të tjera qytete, sepse ata janë ndihmëtarët e Islamit dhe mbështetësit kryesorë të kapitalit të myslimanëve. Të mos u marrë atyre më tepër vetëm atë që ata do t'ia japin me vullnetin e tyre nga çfarë u tepron pas përmbushjes së nevojave të tyre. Gjithashtu, atë që do të më pasojë mua si kalif e këshilloj të sillet mirë edhe me arabët e tjerë, beduinët, sepse ata janë rrënja e arabëve, fara prej së cilës lindi dhe lulëzoi Islami. Ata që janë të pasur ndër ta, ç'kanë të vogël t'ua

[141]. Ahmed bin Hanbel, *Musned,* 1/6 (21).

japin atyre që janë më të varfër e më në nevojë. T'i përmbushë me përpikëri të drejtat e të gjithë atyre që kanë lidhur besë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij, t'i mbrojë dhe të mos u ngarkojë barrë më të rëndë nga ajo që mund të mbajnë."[142]

Sipas asaj që na përcjell Kasim bin Muhamedi, Omeri (radijallahu anhu) ka thënë:

- "Ai që do ta marrë përsipër këtë detyrë pas meje, ta dijë mirë, se të gjithë, afër ose larg, do të kenë shumë kërkesa prej tij. Unë e kam ndierë shumë këtë peshë. Po të kisha parë se në mes të këtij populli gjendet dikush më i fuqishëm se unë, për ta mbajtur mbi supe denjësisht këtë përgjegjësi të kalifatit, do të kisha dashur më shumë që të isha vrarë prej tij, sesa të isha prijës mbi të."[143]

Këshillat e Omerit (r.a.) për Ebu Ubejden

Salih bin Kejsani tregon: "Letra e parë që shkroi Omeri (radijallahu anhu) kur u vendos në krye të kalifatit, ishte letra e shkarkimit të Halid bin Uelidit dhe e emërimit të Ebu Ubejde bin Xherrahut si komandant në krye të ushtrisë. Ja se çfarë shkruhej në atë letër:

"Të këshilloj që t'i frikësohesh Allahut, sepse vetëm Ai është i Përjetshëm, e çdo gjë tjetër është kalimtare. Ai na nxori ne nga humbja e na tregoi rrugën e drejtë, duke na udhëzuar në të, na nxori nga errësira e mohimit dhe na tregoi ndriçimin e plot shkëlqim të besimit. Këtej e tutje të kam emëruar në krye të ushtrisë së komandant Halid bin Uelidit. Përmbushi me kujdes gjithë të drejtat e ushtarëve dhe mos i zvarrit ata nëpër aventura të rrezikshme nga dëshira për të fituar më shumë plaçkë. Kurrë mos u vendos në një vend që nuk e njeh, nuk ke dëgjuar për të, e që nuk ia ke kontrolluar mirë çdo hyrje dhe çdo dalje. Kur të dërgosh ndonjë trupë ushtarësh gjëkundi, të dërgosh gjithnjë më tepër, është më mirë që ushtarët të jenë gjithmonë shumë. Bëj kujdes e mos i vër në rrezik as veten, as myslimanët. Allahu po të sprovon ty me mua, ndërsa mua me ty. Mbylli sytë ndaj kësaj bote dhe mos e lër zemrën të humbë kohë me gjërat e saj të kota. Të mos

[142]. Ibn Ebi Shejbe, *Musannef,* 7/435 (37059).
[143]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/881 (14188).

kthehet bota në fatkeqësi edhe për ty, siç pati rrënuar ata që kanë ardhur përpara teje. Ti tanimë e di se çfarë i rrëzoi e çfarë i çoi ata drejt rrënimit!"[144]

Këshillat e Omerit (r.a.) për Sad bin Ebi Uekasin

Muhamed bin Talha tregon: "Omeri (radijallahu anhu) dërgoi fjalë te Sad bin Ebij Uekasi (radijallahu anhu) që të vinte tek ai. Ai e emëroi atë në krye të frontit të Irakut dhe e këshilloi:

"O Sad, Sadi i bijve të Uhejbit! Mos të të mashtrojë fakti se të gjithë të përmendin si dajën e të Dërguarit të Allahut, apo se je ndër sahabët e Resulullahut. Allahu i Gjithëfuqishëm nuk e fshin të keqen me të keqe, sepse vetëm bëmat e mira i lajnë mëkatet e kryera. Kriteri i vetëm i vlefshëm mes Allahut dhe robërve të tij nuk është fisnikëria, por bindja ndaj urdhëresave të Tij. Në sytë e Allahut, si fisnikët, si ata që duken të dobët e të pafuqishëm, janë të njëjtë. Allahu është Zoti i të gjithëve dhe të gjithë janë robt e Tij. Epërsia e tyre matet vetëm me se sa ata janë të devotshëm. Në shkallët më të larta tek Allahu nuk mund të ngjitesh vetëm se nëpërmjet bindjes. Ti e ke parë Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), sesi ka jetuar, që nga ajo ditë që u dërgua si shpëtim për ne e për botët, e deri sa u nda nga kjo jetë. Duhet të tregohesh shumë i kujdesshëm! T'i ndjekësh këshillat e tij me përpikëri! Nuk kam se ç'këshillë më të mirë të të jap. Nëse nuk m'i dëgjon këshillat që po të jap, atëherë punë që do të bësh do të jetë e kotë; do të jesh prej atyre që humbasin në rrugën e fitores."

Kur po e përcillte Sad bin Ebi Uekasin, Omeri (radijallahu anhu) e këshilloi atë:

"Të kam caktuar komandant të frontit të Irakut, ndaj m'i dëgjo fjalët me kujdes. Ti po shkon në një detyrë shumë të rëndë e shumë të vështirë. Ti do të jesh i suksesshëm vetëm nëse tregohesh i drejtë dhe vepron me drejtësi. Mësoje me të mirën, si veten, ashtu edhe ata që do të kesh përreth, ndaj filloja gjithmonë me më të mirën. Ta dish, çdo punë ka një fazë përgatitore. Dhe faza përgatitore e së mirës është durimi! Tregohu i duruar ndaj fatkeqësive që mund të të ndodhin;

[144]. Taberi, *Tarih,* 2/355.

sepse nuk ka rrugë tjetër, veç durimit. Durimi të bën të fitosh shumë, e veç të tjerash, të bën të fitosh edhe respektin për Allahun. Në dy vende respekti për Allahun është i detyruar: në bindjen ndaj Allahut dhe në shmangien e të ngriturit krye ndaj Tij. Allahut i binden ata që e braktisin këtë botë me zemër dhe priren kah amshimi. Ndërsa krye i ngrenë ata që e duan shumë këtë botë dhe e urrejnë jetën e përtejme. Mos u step nga asnjë veprim që do të të bëjë të dashur për njerëzit, sepse edhe profetët i luteshin vazhdimisht Allahut që Ai t'i bënte ata të dashur në sytë e njerëzve. Kur Allahu e do robin e Vet, Ai e bën atë të dashur edhe për njerëzit; ndërsa atë që e përbuz e bën jo të dashur në sytë e njerëzve. Prandaj, edhe ti përpiqu që vlerën, që ke tek Allahu, ta dallosh nga vendi që zë në sytë e njerëzve pranë teje!"[145]

Këshillat e Omerit (r.a.) për Utbe bin Gazuanin

Abdulmelik bin Umejri tregon: "Omeri (radijallahu anhu), para se ta niste Utbe bin Gazuanin në Basra, i tha:

"O Utbe! Të kam emëruar vali të Basras. Basra është një vend i madh, që është në duart e armikut. Kam fort shpresë te ndihmesa e Allahut, se ju do të ngadhënjeni mbi Basrën dhe popullin e saj. I kam dërguar edhe një letër Ala bin el-Hadramiut, që të të nisë menjëherë Urfuxhe bin Herthemen, që ta kesh krah e të të vijë në ndihmë. Urfuxheja ka luftuar shumë me armiqtë dhe i njeh mjaft mirë kurthet që ata mund të ngrenë, ndaj ta mbash atë afër dhe të këshillohesh vazhdimisht me të.

Utbe! Njerëzit që do të takosh fillimisht ftoji të pranojnë fenë e Allahut; pranoji menjëherë nëse të thonë 'po'. Nëse nuk anojnë nga pranimi, atëherë lufto me ta. Kije frikë Allahun gjatë kryerjes së kësaj detyre. Mos të të marrë peng mendjemadhësia e të ta rrënojë jetën e përtejme. Ti ke marrë pjesë në mësimet e të Dërguarit të Allahut dhe edhe pse dikur jetoje në mes të poshtërimit, ti u shndërrove në një njeri krenar, ishe i dobët, por u bëre i fuqishëm, derisa u shndërrove në një komandant që ia dëgjojnë fjalën të gjithë dhe në një vali të respektuar nga i tërë populli! Sa të flasësh ti një fjalë, njerëzit mbajnë

[145]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/35.

menjëherë vesh; ti urdhëron dhe urdhri yt zbatohet menjëherë. Po, nuk ka dyshim, kjo është një mirësi më vete shumë e madhe! Nuk dua që gjithë këto të mira të të shtyjnë që ta teprosh, e të të rritet mendja karshi atyre që ke nën vete! Ruaju nga e keqja që sjellin me vete të mirat dhe kamja, njësoj siç ruhesh nga rënia në mëkat. Nëse do të më pyesësh mua, rreziku më i madh që të kanoset ty është rreziku nga mirësitë. Mirësitë mund të të gënjejnë dhe, Zoti na ruajttë, ato mund të bëhen shkak që të të priten këmbët e ti të rrokullisesh Xhehenemit të thepisur. Lus Allahun me përgjërim, të na ruajë nga diçka e tillë, si ty, si mua. Njerëzit nisën të ngarendin drejt Allahut, mirëpo bota nisi t'u buzëqeshë njerëzve me tërë tundimin e saj. Kësodore shumë njerëz e harruan synimin e vërtetë dhe filluan të kërkojnë edhe më shumë prej botës. Kurse ti më mirë kërko Allahun, kurrsesi mos kërko këtë botë; përpëlitu frike nga një fund i keq si ai i zullumqarëve, të cilët u rrokullisën të gjithë nëpër humnerat e humbjes pa kthim!"[146]

Këshillat e Omerit (r.a.) për Ala bin el-Hadramiun

Transmeton Sha'biu (radijallahu anhu): "Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi Ala bin el-Hadremiut, i cili asokohe gjendej në Bahrejn, një letër, në të cilën shkruhej:

"Të shkosh tek Utbe bin Gazuani, sepse detyrën e tij ta kam caktuar ty. Diçka duhet ta mbash vath në vesh; ti po shkon te një njeri që është prej muhaxhirëve të parë, për të cilët Allahu ka premtuar shpërblime tejet të mëdha. Unë nuk e shkarkova atë ngase nuk m'u duk i ndershëm dhe i përkushtuar ndaj fesë, apo për ndonjë arsye tjetër si këto. E shkarkova thjesht sepse mendova se ti do të ishe më i dobishëm për myslimanët që jetojnë atje. Andaj, t'ia dish mirë vlerën Utbes e mos e kurse kurrë respektin ndaj tij. Para teje unë kam emëruar dikë si vali, mirëpo ai vdiq ende pa shkuar në krye të detyrës. Ndaj, nëse Allahu do që ta marrësh ti përsipër këtë detyrë, do ta marrësh; por, nëse ka vendosur që në krye të detyrës të qëndrojë vali Utbeja, ta dish se gjykuesi dhe fermanshkruesi i vërtetë i botëve është Allahu, Zoti ynë. Ta dish mirë, se askush nuk mund ta ndryshojë dot atë që e urdhëron

[146]. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/47; Taberi, *Tarih,* 2/440.

e cakton Allahu. Asnjëherë mos e hiq nga mendja përse je krijuar dhe bëj kujdes, puno për atë qëllim dhe braktise çdo gjë tjetër. Kjo botë është kalimtare, vetëm ahireti është i përjetshëm. Mos të të gënjejë kjo botë, që i ka të përkohshme mirësitë, duke të bërë që ta harrosh rrezikun e ndëshkimit dhe të vuajtjeve të përjetshme. Kërkoji Allahut të të mbrojë nga ndëshkimi i Tij i ashpër. Allahu ua fal urtësinë dhe mirësinë e dijes atyre që do Ai. Ne i përgjërohemi Allahut, që, si ty, ashtu edhe ne, të mos na privojë nga mirësia që ne t'i bindemi Atij e t'ia kemi frikën ndëshkimit të Tij..."[147]

Këshillat e Omerit (r.a.) për Ebu Musa el-Esh'ariun

Dabe bin Mihsani na ka përcjellë: "Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi Ebu Musait një letër, në të cilën shkruhej:

"Njerëzit janë të ndrojtur para atyre që kanë mbi krye. Kjo më bën t'i kërkoj Allahut të më ruajë e të mos bëhem një drejtuesi i një populli që i qëndron larg Atij. Edhe pse mund të ketë mbetur shumë pak kohë nga ardhja e muzgut, zbatoji dënimet. Nëse je i detyruar që të zgjedhësh mes dy punësh, njëra prej të cilave është për hir të Allahut, ndërsa tjetra në dobi të jetës sate në këtë botë, ti shih e bëj atë që është për hir të Allahut, sepse kjo botë është kalimtare, ahireti është i përjetshëm. Frikësoji ata që ngrenë krye, mos i lër të qëndrojnë gjëkundi të bashkuar dhe përpiqu t'i mbash sa më larg njëri-tjetrit. Shkoi për vizitë myslimanëve që janë të sëmurë dhe merr pjesë në varrimet e tyre, derën mbaje gjithmonë të hapur për ta. Ndryshimi i vetëm yti me ta të jetë ai që ti e ke më të madhe barrën që mban mbi supe. Me sa kam dëgjuar, ti dhe pjesëtarët e familjes sate keni filluar të visheni më mirë, të hani më mirë dhe të përdorni kafshë më të mira se të tjerët. Po jetoni një jetë më të mirë sesa ajo që jetojnë myslimanët e tjerë.

O rob i Allahut! Ta ndaloj që të jetosh si një kafshë që nuk ka mendim tjetër pos atij të gjetjes së ndonjë lugine me bar të njomë e të bollshëm, që edhe kur ngopet i vjen koha për t'u therur. Ti duhet ta dish, se kur drejtuesit devijojnë nga e drejta, njerëzit largohen edhe

[147]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/889 (14207).

më shumë nga rruga e drejtë. Nuk ka njeri më fatkeq sesa drejtuesi që i zvarrit njerëzit drejt mjerimit."[148]

Sipas asaj që na përcjell Dahaku, Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi Ebu Musa el-Esh'ariut (radijallahu anhu) këtë letër:

"Ju do të jeni të suksesshëm vetëm nëse punën e sotme nuk do ta lini për nesër. Nëse nuk e kryeni çdo punë në ditën e vet, atëherë punët do t'ju grumbullohen stivë dhe ju nuk do të dini më se nga t'ia filloni, derisa ato t'ju zënë nën vete. Çdokush prej jush, kur të përballet me një punë për hir të Allahut dhe me një punë në dobi të jetës së tij të kësaj bote, të zgjedhë atë që është më e dobishme për jetën e përtejme, sepse kjo botë është kalimtare, ahireti është i përjetshëm. Tregoni respekt ashtu siç duhet ndaj Allahut dhe mësojeni librin e Tij, sepse ai është burimi i çdo diturie, pranvera e çdo zemre."[149]

Amaneti i Osmanit (r.a.)

Ala bin el-Fadli na përcjell se nëna i ka transmetuar: "Kur ra dëshmor Osmani (radijallahu anhu), kërkuan nëpër dollapin ku ai mbante sendet e tij personale dhe në të gjetën një sënduk të vogël të mbyllur me kyç. Kur e hapën, brenda tij ishte një letër në të cilën shkruhej:

"Ky është amaneti i Osmanit:

Bismil'lahir'rahmanir'rahim.

Osman bin Afani dëshmon se nuk ka zot tjetër pos Allahut. Ai është Një, i Vetëm dhe pa kurrfarë ortaku a shoku në krijimin e gjithçkaje. Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij. Xheneti dhe Xhehenemi janë të vërtetë. Në ditën e Kiametit, për të cilën nuk ka pikë dyshimi, Allahu ka për t'i ngjallur të gjithë banorët e varrit. Allahu nuk e shkel kurrë premtimin e dhënë. Osmani, me këtë besim do të jetojë, me këtë besim do të vdesë dhe, – dashtë Zoti, me këtë besim do të ngjallet."[150]

---

148. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/889 (14209).
149. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 16/188 (44205).
150. Ibn Kethir, *el-Bidaje,* 7/184.

Një dialog mes Osmanit (r.a.) dhe Aliut (r.a.) kur anarkistët rrethuan shtëpinë e Osmanit (r.a.)

Shedad bin Eusi (radijallahu anhu) tregon: "Osmani (radijallahu anhu) ishte në shtëpinë e vet. Kur aty ia behën kryengritësit dhe e rrethuan shtëpinë nga të gjitha anët, ai doli mbi çati dhe u tha atyre:

- "O robt e Allahut!"

Pashë Ali bin Ebij Talibin (radijallahu anhu) të dilte nga shtëpia e vet, në kokë kishte vënë çallmën e të Dërguarit të Allahut dhe shpatën në dorë. Para Aliut (radijallahu anhu) vinin i biri Hasani me Abdullah bin Omerin dhe një grup i përbërë nga muhaxhirë dhe ensarë. U sulën mbi kryengritësit dhe i shpërndanë, mandej u kthyen pranë Osmanit (radijallahu anhu). Aliu (radijallahu anhu) i tha atij: "Përshëndetjet e Zotit, o Prijësi i Besimtarëve! Profeti ynë i nderuar (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) këtë fe e mbajti në këmbë duke i mundur të gjithë ata që donin ta shkatërronin fenë. Uallahi, unë e shoh, këta duan të të vrasin. Na jep urdhër, të luftojmë me ta."

- "Për hir të Allahut, të gjithë atyre që besojnë se kjo është e drejta e Allahut dhe e drejta ime u them se nuk dua që për mua të derdhet as gjaku i tyre, as i ndonjë tjetri!", – u përgjigj Osmani (radijallahu anhu).

Aliu (radijallahu anhu) i përsëriti edhe njëherë ato që kishte thënë, mirëpo Osmani (radijallahu anhu) këmbënguli. Teksa po dilte nga dera, Aliu (radijallahu anhu) tha:

- "O Zot! Ti e di, ne bëmë çdo gjë." Mandej, ai shkoi në xhaminë e të Dërguarit të Allahut. Me të hyrë koha e namazit, besimtarët i thanë atij:

- "O Ali, dil të na prish, na e fal ti namazin." Aliu (radijallahu anhu) tha:

- "Unë nuk dal t'jua fal namazin, kur kalifi i të Dërguarit të Allahut është i rrethuar! Unë do ta fal vetëm!" Dhe kështu bëri, e fali i vetëm namazin dhe shkoi në shtëpi. I biri, Hasani (radijallahu anhu) e ndoqi nga pas dhe i tha:

- "Uallahi, o baba, kryengritësit hynë në shtëpinë e Osmanit."

- "Uallahi, ata do ta vrasin atëherë. 'In'na lil'lahi ue in'na ilejhi raxhiun'", – tha ai.

- "O Ebu'l-Hasan! Ku e ka vendin Osmani?", – e pyetën Aliun (radijallahu anhu).

- "Uallahi në Xhenet, shumë afër Xhenetit!", – u përgjigj ai.

- "Po ata që e vranë, ku janë?"

- "Uallahi, ata janë në zjarr.", – tha ai duke e përsëritur tri herë këtë fjali."[151]

Një tjetër transmetim rreth kësaj çështjeje

Ebu Hurejreja (radijallahu anhu) thotë kështu: "Kryengritësit rrethuan shtëpinë e Osmanit dhe me Osmanin isha edhe unë. Njërin prej nesh e goditën me shigjetë.

- "O Prijësi i Besimtarëve! Tani na u bë e lejuar lufta me këta njerëz. Kanë vrarë njërin prej njerëzve tanë.", – i thashë Osmanit (radijallahu anhu).

- "Shiko, Ebu Hurejre, të urdhëroj ta hedhësh shpatën. Ata duan të më vrasin mua. Unë do të vetësakrifikohem, që të mund t'i ruaj myslimanët nga anarkia.", – më tha.

Dhe ashtu bëra, e hodha tutje shpatën. Nuk e di ç'u bë me të, as se kush e mori."[152]

Këshillat e Aliut (r.a.) për valinjtë dhe komandantët

Tregon Muaxhir el-Amiriu: "Aliu (radijallahu anhu) i shkroi këtë letër njërit prej udhëheqësve të tij:

- "Derën ta mbash përherë të hapur për njerëzit, sepse nuk ka gjë më të sikletshme sesa situata që krijohet kur drejtuesit u mbyllin dyert popullit të tyre. Kur bëhet fjalë për valinjtë, nëse ata jetojnë të distancuar nga populli, ata fillojnë të mos i njohin më problemet që hasin njerëzit. Në të tilla raste populli nuk di të dallojë ç'është e mirë e ç'është e keqe; zë e i duket e vogla e madhe dhe e madhja e vogël,

[151]. Muhamed Rida, *Uthman bin Affan,* 1/188.
[152]. Said bin Mensur, *Sunen,* 2/334 (2936).

e bukura e shëmtuar dhe e shëmtuara e bukur; dhe, si përfundim, e vërteta ngatërrohet me të rremen. Edhe ai që është vali, njeri është, nuk ka sesi t'i dijë ato që populli ia mban të fshehta. Fjalët që thuhen nuk kanë ndonjë vulë, që të dallohen vetvetiu, janë të vërteta apo të gënjeshtra, ndaj ai nuk ka sesi ta dijë të vërtetën vetiu, e t'u dalë njerëzve në ndihmë kurdoherë. Kësisoj, edhe ti gjendesh përballë alternativës për të qenë një prej këtyre dy lloj njerëzve: ose do të jesh një njeri që tregohesh shumë i kujdesshëm me vënien në vend të asaj që është më e drejta, duke i mbajtur përherë të ngushta lidhjet me popullin tënd, në mënyrë që t'u japësh secilit hakun që i takon, ose do të jesh prej atyre që nuk kanë kurrfarë kujdesi se cila është më e drejta dhe e vërteta. Në të tilla raste, është populli i pari që do të fillojë të të largohet, aq sa vjen një çast dhe e humbet fare shpresën se ti mund t'i vish në ndihmë, ndaj nuk t'i shpreh fare shqetësimet që mund të ketë. Ç'është e vërteta, pjesa më e madhe e gjërave që njerëzit kërkojnë prej teje janë gjëra që nuk të vënë në vështirësi. Përpiqu të përfitosh sa më shumë nga fjalët që të kam shkruar. Shih të tregohesh i përkorë dhe të mjaftohesh me atë që të është caktuar e të ka rënë për hise, e të mos kërkosh më tepër."[153]

Mesazhi i Aliut (r.a.) për një vali tjetër

Tregon Medainij: "Aliu (radijallahu anhu) i pati dërguar këtë letër njërit prej valinjve të tij:

"Kur të marrësh vendime, mos u ngut! Imagjino veten sikur je në prag të vdekjes dhe në atë pikë ku ata që i ka gënjyer vetja lëngojnë 'Moosss! Mooos!', ata që nuk kanë asnjë punë të mirë i drejtohen pendesës, zullumqarët luten e betohen, se 'ah sikur të na kthenin edhe njëherë në jetë, e ta adhurojmë edhe ne Allahun!', sikur ty po të jepet libri i punëve të tua! Mendo këto njëherë, pastaj vendos."[154]

---

[153]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/160 (36553).
[154]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/160 (36554).

20. KUR POPULLI KËSHILLON DREJTUESIN E SHTETIT

Këshilla e Said bin Amirit për Omerin (r.a.)

E tregon Mekhuli: "Said bin Amir bin Xhudhejm el-Xhumehiu (radijallahu anhu), një prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut, i tha një ditë Omerit (radijallahu anhu):

- "O Omer, dua të të jap një këshillë."

- "Po, pa më thuaj njëherë.", – iu përgjigj Omeri (radijallahu anhu).

- "Të këshilloj që ta kesh frikë Allahun kur vendos drejtësi mes njerëzve, si dhe që t'i druhesh popullit kur përmbush atë që është e drejta e Allahut. Çdo fjalë që do të thuash duhet të jetë në lartësinë e çështjes për të cilën bëhet fjalë, sepse fjala më e mirë e një njeriu është ajo që e provojnë edhe sjelljet e tij. Mos merr dy vendime për të njëjtën çështje! Përndryshe, ajo punë mbyllet krejt në të kundërtën e pritshmërive të tua dhe ti del i devijuar nga drejtësia dhe e vërteta. Nëse vendos për çështje që i kanë provat do të kesh sukses, e Allahu do të të ndihmojë, duke i udhëzuar njerëzit, sajë teje, kah e vërteta. Të gjithë të afërmit e myslimanëve, drejtimin e të cilëve Allahu ta ka ngarkuar ty, qofshin të afërt a të largët, duhet t'i konsiderosh të barabartë. Tregohu njësoj i drejtë ndaj të gjithëve, duke kërkuar edhe për ta të njëjtat gjëra që kërkon edhe për veten e familjen tënde. E ato që nuk të duken të përshtatshme për vete e për familjen tënde, mos i shiko të përshtatshme as për ta. Të shumta janë vështirësitë në rrugën që të çon kah më i Drejti e më i Vërteti, ndaj përballoji ato me durim. Ndërsa ecën në rrugën e Allahut, kurrë mos ki frikë nga përbaltjet apo zhurmat e atyre që bëjnë thashetheme!", – e këshilloi ai.

Omeri (radijallahu anhu) e pyeti:

- "Po kush mund t'ia dalë mbanë e t'i kryejë të gjitha këto sa më the?

- "Një si ti.", – u përgjigj Said bin Amiri. – "Këtyre u del mbanë një si ti, të cilin Allahu e ka vënë në krye të umetit të Muhamedit (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), një si ti, që askush nuk guxon të hyjë mes tij dhe Allahut."[155]

---

[155]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 12/801 (35807).

Letra e Ebu Ubejdes (r.a.) dhe Muadhit (r.a.) për Omerin (r.a.) dhe përgjigjja e tij

Muhamed bin Suka tregon: "Një ditë, unë shkova te Nuajm bin Hindi dhe ai më nxori një letër të shkruar dhe ma dha mua. Në atë letër shkruhej:

"Kjo është një letër e Ebu Ubejde bin Xherrahut dhe Muadh bin Xhebelit për Omer bin Hatabin:

Përshëndetja e Zotit qoftë me ty! Megjithëse ne e dimë mjaft mirë se sa i kujdesshëm je ti në edukimin e egos sate, ne, prapëseprapë, duam të të japim disa këshilla: "Ti ke marrë përsipër drejtimin e të gjithë këtij umeti, pavarësisht në janë njerëz me ngjyrë, apo ezmerë. Pranë teje qëndrojnë të ulur si fisnikë, ashtu edhe njerëz të thjeshtë. Ka edhe armiq edhe miq. Çdokush meriton pjesën e vet nga ajo që është e drejtë. Andaj, o Omer, shih e tregohu sa më i kujdesshëm që të veprosh përherë me drejtësi. Ne të këshillojmë që kurrë të mos e heqësh nga mendja atë ditë kur kokat do të ulen, zemrat do të ndalin së rrahuri, e nuk do të ketë asnjë provë e asnjë argument tjetër përpos provave dhe argumenteve të Allahut të Lartësuar. Ajo është një ditë e atillë, që nuk do të mbetet krijesë pa e ulur kokën dhe që nuk do ta mbajë shpresën te mëshira e Allahut, të kapluar nga drithërimat e frikës nga ndëshkimi i ashpër i Tij.

O Omer! E mban mend kur rrinim tok me njëri-tjetrin dhe bisedonim e thoshim: 'Do të vijë një ditë, që njerëzit e këtij umeti do të shfaqen si miq të njëri-tjetrit, por përbrenda do të ushqejnë armiqësi.' I lutemi Allahut dhe prej Atij e kërkojmë mbrojtjen, nëse kjo letër, të cilën ta shkruam për të të shprehur ndjenjat dhe mendimet tona më të sinqerta, keqkuptohet, ndryshe nga qëllimi i vërtetë i shkrimit të saj. Nuk ta shkruam vetëm se për të të këshilluar e për të të ardhur në ndihmë. Ues'selamu alejke!"

Dhe Omeri (radijallahu anhu) u ktheu atyre këtë përgjigje:

"Nga Omeri, për Ebu Ubejden dhe Muadhin:

Përshëndetje. E mora letrën tuaj. Më shkruani se, megjithëse e dini që unë bëj çdo përpjekje për ta edukuar egon time, ju ndieni nevojën të më këshilloni, pasi unë kam marrë përsipër përgjegjësinë e udhëheqjes

së të gjithëve, si të fisnikëve, ashtu edhe të njerëzve të thjeshtë, se siç kam miq, kam edhe armiq, se më duhet të tregohem i drejtë ndaj të gjithëve dhe për këtë të tregohem shumë i kujdesshëm.

Më lejoni t'ju them, se në dorën e tij Omeri nuk ka fare fuqi. Omeri punon dhe përpiqet t'i vërë punët në vijë falë forcës dhe fuqisë që i ka dhënë Allahu. Ju më paralajmëroni, që të mos lejoj që të kemi edhe ne të njëjtin fund që kanë pasur edhe popujt që kanë ardhur para nesh. Qysh në krye të herës, ndjekja e natës nga dita dhe e ditës nga nata nuk ka bërë gjë tjetër vetëm se ka konsumuar jetën e njeriut, ka afruar atë që ka qenë larg dhe ka vjetruar të renë, duke sjellë çdo gjë që ka qenë e premtuar se do të vijë. Dhe kështu ka për të vazhduar, derisa njerëzit të zënë vendin e tyre në Xhenet ose Xhehenem!

Mandej, ju më shkruani se pasuesit e këtij umeti, më vonë, do t'i shfaqen njëri-tjetrit si miq, por në zemra do të ushqejnë ndjenja armiqësie; ndaj edhe më bëni thirrje që të tregohem tejet i kujdesshëm në këtë pikë. Ju nuk jeni prej asi njerëzish dhe as kjo nuk është ajo kohë për të cilën më thoni! Kjo do të ndodhë në një periudhë kur do të mbizotërojë prirja e njerëzve kah kjo botë, njerëzit do të kenë më shumë frikë prej njëri-tjetrit sesa nga ndonjë gjë tjetër dhe kur njerëzit do ta përgëzojnë sa për sy e faqe njëri-tjetrin, si e si për të vënë në vijë ndonjë interes të jetës në këtë botë!

Gjithashtu, ju i luteni Allahut që t'ju mbrojë nga çdo keqkuptim i kësaj letre, ndryshe nga qëllimi i saj i vërtetë. E di shumë mirë, që këtë letër ju ma keni shkruar vetëm e vetëm për të mirën time dhe jua besoj me gjithë zemër çdo fjalë që më thoni. Mos e lini pas dore shkrimin e letrave të tilla, pasi kam nevojë për këshillat tuaja. Ues'selamu alejkuma."[156]

Amaneti i Ebu Ubejde bin Xherrahut pak çaste para se të ndahej nga jeta

Tregon Said bin Musejebi (radijallahu anhu): "Ebu Ubejdeja (radijallahu anhu), kur u prek nga murtaja në Jordani, i ftoi myslimanët të shkonin tek ai dhe u foli:

[156]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/238; Taberani, *Mu'xhemu'l-Kebir,* 20/32 (45).

"Dua t'ju jam disa këshilla. Nëse i pranoni dhe i vini në zbatim, ju do të jeni përherë të lumtur e do të keni një jetë të begatë; faleni më së miri namazin. Mbani agjërim gjatë muajit të Ramazanit. Jepeni zekatin, shkoni në haxh dhe vizitojeni Qaben. Këshillojeni vazhdimisht njëri-tjetrin për mirë. Këshillat mos i kurseni as ndaj atyre që keni mbi krye, e mos ua punoni atyre pas krahëve, duke vepruar si dredharakë. Të mos ju rrënojë lakmia për këtë botë. Sikur edhe njëmijë vjet të jetojë një njeri, fundi i tij nuk do të jetë ndryshe nga fundi i këtyre njerëzve që shemben përtokë nga murtaja! Allahu u ka caktuar bijve të Ademit që të shijojnë vdekjen, andaj të gjithë do të vdesin! Kjo është arsyeja pse më të mençur janë ata që i binden Zotit të tyre, duke bërë çmos për amshimin e tyre. Mbi ju qoftë paqja dhe mëshira e Allahut! Muadh bin Xhebelit: në namaz priju ti njerëzve."

Kur dha shpirt Ebu Ubejdeja (radijallahu anhu), Muadhi (radijallahu anhu) doli përpara njerëzve dhe u mbajti këtë fjalë:

"O njerëz! Pendohuni përpara Allahut për të gjitha mëkatet tuaja. Nëse një rob del përpara Allahut i penduar për mëkatet e tij, nuk ka dyshim se Allahu i Drejtë e fal atë. Kush ka borxhe t'i paguajë, sepse, në ahiret, njeriu mbahet peng për shkak të borxhit të papaguar që ka. Nëse mes jush ka që janë të hidhëruar me njëri-tjetrin, të pajtohen, sepse, për një mysliman, nuk është e lejuar që ai të qëndrojë i hidhëruar me vëllanë e tij në fe për më shumë se tri ditë.

O myslimanë! Sot ju ka tronditur vdekja e një njeriu të atillë, që, më besoni, nuk ma merr mendja të ketë njeri me zemër më të bardhë, në të cilën nuk gjendet as njolla më e vogël, që i ka dashur e i do dhe që u ka bërë myslimanëve më shumë të mira sesa ai. Lutjuni Allahut që ta mëshirojë. Tani, ejani, bëhuni gati të falim namazin."[157]

21. JETESA E KALIFËVE DHE E DREJTUESVE TË TJERË

Mënyra e jetesës e Ebu Bekrit (r.a.) pasi që u bë kalif

E tregojnë Ibni Omeri (radijallahu anhu), Aishja (radijallahu anha), Ibnu'l-Musejebi (radijallahu anhu) dhe shumë të tjerë:

[157]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 13/199 (36666).

Besëlidhja me Ebu Bekrin (radijallahu anhi) ra në një ditë të hënë, të hënës së dymbëdhjetë të muajit Rabiuleuel të vitit të njëmbëdhjetë të hixhretit. Ai e kishte shtëpinë në lagjen Sunh në atë zonë të Medinës që asokohe quhej Auali. Në të ai rrinte me të shoqen e tij, Habiben. Në Sunh shtëpinë e kishte bërë me thurje në trajtë çadre. Vetëm aty pati jetuar, derisa u zhvendos brenda në Medinë. Pasi iu ngarkua misioni i kalifatit, vijoi të qëndrojë atje edhe për gjashtë muaj. Nisej çdo mëngjes dhe vinte në Medinë duke ecur. Shumë rrallë mund ta kenë parë të hipur në kalë dhe kishte një veshje tejet të thjeshtë. Në Medinë vinte rregullisht, për t'u falur njerëzve namazin në kohë. Pasi u falte edhe jacinë, ai nisej drejt shtëpisë së tij në Sunh, për t'iu bashkuar familjes që e priste. Kur nuk ishte ai, imam bëhej Omeri (radijallahu anhu). Të premteve, paraditen e kalonte në Sunh, ngjyente flokët dhe mjekrën dhe aty në të afruar të kohës së namazit të xhumasë vinte në qytet dhe u falte njerëzve të xhumanë.

Ebu Bekri (radijallahu anhu) ishte tregtar. Çdo ditë, herët në mëngjes, ai zbriste në pazar dhe shiste e blinte mallra të ndryshëm. Kishte një tufë dhensh, të cilat herë i nxirrte vetë për të kullotur, herë nxirrte të tjerë. Milte jo vetëm delet e veta, por edhe delet e tërë mëhallës. Aq sa, kur njerëzit lidhën besën me të dhe e pranuan si kalif, një e vajzëtha:

- "Këtej e tutje nuk ka për të na i mjelë më delet." Mirëpo Ebu Bekri (radijallahu anhu) e dëgjoi dhe tha:

- "Ju betohem që unë do të vazhdoj t'jua mjel bagëtitë. Shpresoj shumë, që një ditë kjo detyrë që po marr përsipër të mos m'i ndryshojë zakonet." Vërtet, pasi u bë kalif, Ebu Bekri (radijallahu anhu) vijoi t'ua milte po njësoj bagëtitë fqinjëve të tij. Madje, asaj vajzë që i pati folur në ditën e besëlidhjes i thoshte:

- "Si t'i mjel, me shkumë, apo pa shkumë? Si e doni qumështin?"

- "Me shkumë!", – i përgjigjej ajo dhe Ebu Bekri (radijallahu anhu) bënte siç i thoshte vajza.

Kështu vazhdoi jeta e Ebu Bekrit (radijallahu anhu) edhe për gjashtë muaj të tjerë pasi u bë kalif. Më vonë, ai u zhvendos në qendër të qytetit, për të jetuar që prej asaj dite. U mendua ca dhe tha:

- "Jo, uallahi, marrja me tregti po më pengon të merrem punët e njerëzve. Më duhet të ndaj më shumë kohë për t'i ndihmuar njerëzit në zgjidhjen e problemeve.", – dhe, sakaq, e la edhe tregtinë. Kështu, Ebu Bekrit (radijallahu anhu) dhe pjesëtarëve të familjes së tij iu caktua një pagë vjetore prej gjashtëmijë dërhemësh, që ata do t'i përdornin për të jetuar dhe për haxhin dhe vizitat e tyre në Qabe.

Në çastet e fundit të jetës, ai u la amanet të tijve:

- "Çfarë na ka mbetur nga ajo që na kanë dhënë myslimanët kthejuani. Nuk dua të mbetet tek unë as gjëja më e vogël. Tokat dhe arat që kam në aksh vend po ia fal thesarit të myslimanëve, për ato që kam shpenzuar deri më sot." Kështu, bashkë me tokën, tek Omeri (radijallahu anhu) u dorëzuan një deve që jepte shumë qumësht, një skllav që ishte usta për t'u dhënë shpatave shkëlqim dhe një copë kadifeje me vlerë pesë dërhemë. Kur i pa, i dëshpëruar, Omeri (radijallahu anhu)nuk duroi dot dhe tha për të:

- "Iku e na la një jetë të pamundur për t'u jetuar!"[158]

Jetesa e valiut të Humusit, Umejr bin Sa'dit

Omeri (radijallahu anhu) e kishte caktuar vali të Humusit Umejr bin Sa'd el-Ensarin. Megjithëse kishte kaluar vetëm një vit, ai nuk pati marrë asnjë lajm prej tij, kështu që i tha shkruesit të tij:

- "Shkruaji menjëherë një letër Umejrit; kam filluar të mendoj se ai na ka tradhtuar." Ja se cila ishte letra që i kërkoi ai shkruesit të hidhte në fletë:

"Kur ta marrësh këtë letër eja menjëherë këtu! Me vete të sjellësh edhe tagrat që u ke mbledhur myslimanëve."

Umejri (radijallahu anhu), një të lexuar letrën, mori çantën, pak ushqim për rrugën, vuri edhe çanakun në çantë, mataranë e lidhi pas trupi, kërrabën në dorë dhe u nis në këmbë nga Humusi për në Medinë. Kur mbërriti në Medinë, ishte zbehur fare në fytyrë, fytyra i ishte mbuluar nga pluhuri dhe balta, ndërsa flokët i ishin rritur shumë. Ashtu doli përpara kalif Omerit (radijallahu anhu), duke i thënë:

[158]. El-Hindi, *Kenzu'l-Ummal,* 5/840 (14077).

- "Es-selamu alejke, o Prijësi i Besimtarëve! Mbi ty qofshin mëshira dhe begatia e Allahut."

- "Ç'je katandisur kështu?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Pse, si jam? I shëndetshëm jam, gjakun e kam të pastër, këtë botë e kam kapur për brirësh e tërheq zvarrë pas vetes!", – tha Umejri.

- "Çfarë ke sjellë, çfarë ke aty me vete?"

- "Me vete kam pak ushqim për gjatë rrugës dhe çantën ku mbaj çanakun. Atë çanak e përdor edhe për të ngrënë, edhe për të larë kokën e ndonjë rrobë që më është bërë pis. Kam mataranë, që e mbush me ujë, ta kem për të pirë ose për të marrë abdesin dhe një kërrabë tek e cila mbështetem kur më lodhen eshtrat, por edhe për t'u mbrojtur nëse më del ndonjë kafshë grabitqare. Uallahi, nuk kam asgjë tjetër veç këtyre në këtë botë."

- "Po duke ecur ke ardhur deri këtu?", – e pyeti Omeri.

- "Po!"

- "Po mirë, askush nuk ka dalë nga ai popull që të të japë një kafshë, që mund t'ia hipësh kur të duhet të udhëtosh?"

- "Unë nuk ua kam kërkuar, por as ata nuk ma kanë dhënë vetë!"

- "Ç'njerëz të këqij qenkan myslimanët që drejton ti!"

Këtu, Umejri e kundërshtoi Omerin (radijallahu anhu):

- "O Omer! Ki frikë nga Zoti! Allahu ua ka ndaluar myslimanëve të përgojojnë njëri-tjetrin. Unë jam dëshmitar që ata e falin të gjithë namazin e sabahut."

- "Po unë me çfarë detyre të pata ngarkuar, kur të nisa për atje? Çfarë ke bërë ti atje?"

- "Pse po ma pyet këtë, o Prijësi i Besimtarëve?"

- "Subhanallah!", – psherëtiu Omeri (radijallahu anhu) i çuditur, kur Umejri ia ktheu:

- "Sikur të mos kisha frikë se do të të mërzitja ty, nuk të tregoja asgjë. Ti më dërgove dhe unë shkova menjëherë, mblodha njerëzit më të mirë e të rregullt dhe i ngarkova me mbledhjen e taksave dhe tagrave. Pastaj taksat e mbledhura i shpërndava sipas nevojave që ishin

atje; patjetër që do të t'i kisha dërguar deri më tani, nëse do të kishte tepruar gjë!"

- "Ç'do të thotë kjo? Nuk na ke sjellë asgjë?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu)atë.

- "Jo!", – u përgjigj Umejri.

Paskëtaj, Omeri iu drejtua shkruesit dhe i tha:

- "Ripërtërijeni urdhrin e emërimit të Umejrit!" Umejri tha:

- "Unë nuk të kërkova asnjë detyrë dhe këtë detyrë nuk do të vazhdoj ta bëj më as për ty, as për ata që do të vijnë pas teje! Vështirë të shpëtoj, për të mos thënë e pamundur, sepse unë i thashë njëherë një të krishteri: "Zoti të poshtëroftë." Duke thënë këtë, Umejri (radijallahu anhu) donte të theksonte se këto fjalë e kishin prekur shumë atë njeri jomysliman dhe kjo e kishte shqetësuar tej mase, sepse i Dërguari Fisnik ua kishte ndaluar atyre t'i fyenin, apo t'u shkaktonin vuajtje jomyslimanëve. Atëherë, Umejri i përmbylli fjalët e tij kështu:

- "O Omer! Ti je shkaktari i kësaj. O Omer! Nuk ka ditë më të kobshme për mua sesa ditët që kam kaluar duke kryer detyrën e ngarkuar prej teje dhe nuk vdiqa bashkë me shokët e mi që u larguan nga kjo botë!" Mandej, Umejri kërkoi leje dhe u kthye në shtëpi.

Shtëpinë Umejri e kishte disa kilometra larg Medinës. Omeri (radijallahu anhu) nuk e mposhti dot dyshimin që e brente përbrenda vetes dhe tha:

- "Prapëseprapë, ky njeri mund të na ketë tradhtuar!" Kështu që i dha njëqind dinarë dikujt me emrin Harith dhe e porositi:

- "Do të shkosh në shtëpinë e Umejrit dhe do të sillesh si mik. Nëse sheh që është i pasur, atëherë eja dhe m'i kthe paratë. Por, nëse të duket i varfër, atëherë jepja atij këto njëqind dinarë." Harithi shkoi dhe kur mbërriti në fshat, e gjeti Umejrin të ulur ndanë një muri teksa pastronte këmishën. Burri i dha selam Umejrit. Ai ia ktheu selamin dhe i tha:

- "Zoti të faltë! Zbrit poshtë, nga po vjen?"

- "Vij nga Medina.", – iu përgjigj Harithi.

- "Si është Prijësi i Besimtarëve?"

- "Mirë është."

- "Po myslimanët, si janë?"

- "Edhe ata mirë janë."

- "Po Prijësi i Besimtarëve vazhdon t'i ndëshkojë keqbërësit?"

- "Po!"

- "O Zot! Ndihmoje Omerin. Unë e di që ai të do shumë, o Zot!", – tha atëherë Umejri.

Harithi qëndroi tri ditë në shtëpinë e Umejrit. Umejri nuk gatuante dot gjë tjetër, veç një buke elbi. Edhe atë ia jepte mikut, ndërsa vetë dhe familja qëndronin të uritur e pa ngrënë. Në çastin që uria arriti kulmin, Umejri i tha Harithit:

- "Na le të uritur, mund të nisesh, nëse ke për të shkuar gjëkundi!" Harithi nxori dinarët dhe ia dha Umerit e i tha:

- "Këto t'i dërgon Prijësi i Besimtarëve, Omeri (radijallahu anhu), përdori për ndonjë nevojë që mund të kesh."

Umejri nuk i pranoi, madje edhe ia ktheu me një britmë:

- "Nuk kam nevojë për to."

- "Merri, more burrë, kemi nevoja, edhe po nuk deshe t'i përdorësh, ia jep ndokujt si lëmoshë.", – i tha atij e shoqja.

- "Uallahi, unë nuk kam as ku t'i vë!", – ia preu Umejri.

Sakaq, e shoqja grisi një copë nga rroba që kishte veshur dhe ia dha. Ai i mori paratë, i mbështolli me atë beze dhe doli nëpër mëhallë. Ua shpërndau të tëra të varfërve dhe jetimëve të dëshmorëve. Harithi pati pritur që t'ia jepte atij një pjesë të parave, mirëpo Umejri nuk i dha asgjë. Pasi i shpërndau, ai i tha Harithit:

- "Dërgoi selamet e mia Prijësit të Besimtarëve.", – dhe e përcolli.

Kur Harithi u kthye në Medinë, Omeri (radijallahu anhu) e pyeti Harithin se si i qe dukur Umejri.

- "Shumë të varfër e shumë nevojtar.", – iu përgjigj Harithi.

- "Po çfarë bëri me paratë që i dhe ti?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Nuk e di!", – tha Harithi.

Atëherë, Omeri (radijallahu anhu) i dërgoi edhe një letër tjetër Umejrit, duke i shkruar:

- "Eja menjëherë tek unë, sapo ta lexosh këtë letër." Umejri, një ta lexuar letrën, erdhi në Medinë dhe shkoi drejt e tek Omeri (radijallahu anhu).

- "Ç'i bëre dinarët?", – e pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Bëra atë që bëra! Po pse më pyet?", – ia ktheu Umejri.

- "Për hir të Allahut, më thuaj të vërtetën, çfarë bëre me to?"

- "I dhashë lëmoshë, që t'i kem si ushqim rruge në jetën e përtejme!", – u përgjigj ai.

- "Zoti të dhëntë veç të mira.,– tha Omeri (radijallahu anhu) dhe urdhëroi që Umejrit t'i jepej një deve e ngarkuar me grurë dhe dy masa rrobë për veshje.

- "Nuk kam nevojë për të ngrënë dhe derisa ta kem ngrënë këtë bukë që kam marrë me vete, Zoti medoemos do të ma nxjerrë riskun!", – tha ai duke mos i pranuar ushqimet e dhëna prej Omerit (radijallahu anhu).

- "Po, sa për teshat, do t'i marr, se nëna e aksh njeriu nuk ka asgjë për të veshur, do t'ia shpie asaj.", – dhe e mori atë copë dhe u kthye në shtëpi. Nuk është se jetoi edhe shumë paskëtaj.

Omeri (radijallahu anhu) u hidhërua jashtë mase kur mori lajmin se kishte vdekur Umejri. Iu lut Allahut që ta mëshironte dhe u lut shumë për të. Bashkë me shokët ata ecën deri në varrezën Baki. Në një moment, ai u tha atyre që kish pranë:

- "Të më thotë secili prej jush nga një dëshirë e nga një kërkesë."

- "O Prijësi i Besimtarëve! Po të isha i pasur, për hir të pëlqimit e kënaqësisë së Allahut do të doja të liroja një skllav; kjo është ajo që dua më së shumti!", – u hodh e tha njëri.

- "O Prijësi i Besimtarëve! Sikur të kisha pak pasuri, e të mund ta jepja lirshëm në rrugën e Allahut!", – tha një tjetër.

- "Do të doja të isha i fuqishëm, e të nxirrja ujë prej pusit të zemzemit dhe të shkoja t'u jepja të pinin atyre që vijnë për të vizituar Shtëpinë e Zotit!", – tha sakaq një tjetër.

Në fund shprehu edhe Omeri (radijallahu anhu) dëshirën e tij, duke thënë:

- "Ah të kisha një njeri si Umejr bin Sadi, që t'i kërkoja të më ndihmonte, për t'i kryer më mirë punët e myslimanëve! Ja, kjo është ajo çfarë dua unë më shumë!"[159]

Mënyra e jetesës e valiut të Humusit, Said bin Amir el-Xhumehiut

Halid bin Midani na tregon: "Omeri (radijallahu anhu) si vali të Humusit pati emëruar Said bin Amirin (radijallahu anh). Kur Omeri (radijallahu anhu) shkoi njëherë në Humus, ai u tha vendasve:

- "O njerëz të Humusit, si po ju duket valiu, ç'mendim keni për të? A jeni të kënaqur prej tij?" Populli i Humusit iu ankua Omerit (radijallahu anhu) për Saidin. Meqenëse Humusi ankohej shumë shpesh për drejtuesit e vet, herë-herë atë vend e quanin edhe "Kufja e vogël"

- "Ne kemi katër ankesa për valiun: E para, ai nuk vjen tek ne pa u ngjitur mirë dielli në qiell!", – thanë ata

- "Ky është një gabim shumë i madh! Po tjetër?..", – ndërhyri Omeri (radijallahu anhu).

- "Kur bie nata, ai nuk pret më asnjeri."

- "Edhe kjo është shumë e gabuar! Po tjetër?..", – tha Omeri (radijallahu anhu).

- "Një ditë në muaj ai nuk vjen fare tek ne!"

- "Edhe kjo, e metë shumë e madhe është! Po tjetër, tjetër?..", – pyeti Omeri.

- "Ka disa ditë, që ai kalon kriza, na duken si shenja të çmendurisë!", – thanë ata.

Omeri (radijallahu anhu) vendosi që t'i vinte ata ballë për ballë me valiun e tyre. Meqenëse vetë kishte një mendim shumë të mirë për të:

- "O Zot! Mos më lër të dal i zhgënjyer nga Saidi.", – u lut ai. Me të ardhur Saidi, Omeri (radijallahu anhu)iu drejtua popullit:

[159]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/247.

- "Cilat ishin ankesat tuaja?"

- "Nuk vjen te ne pa ardhur mesi i ditës.", – thanë ata. Aty Omeri e pyeti Saidin, se cila ishte arsyeja që e bënte këtë.

- "Uallahi, nuk doja ta thosha, por jam i detyruar: unë nuk kam shërbyes, e më duhet ta ndrys vetë brumin e bukës, të pres sa të vijë brumi dhe kur të vijë, më duhet ta pres sa të piqet. Më vonë, marr abdes dhe vij te besimtarët.", – u përgjigj Saidi.

- "Po tjetër, çfarë ankese patët?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "Nuk pranon të takojë askënd gjatë natës.", – thanë ata.

- "Po për këtë çfarë do të thuash, o Said?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu).

- "As këtë nuk do të doja të ta thosha! Ç'është e vërteta, unë ditën ua kam ndarë njerëzve, kurse netët Zotit tim!", – u përgjigj Saidi.

- "Ankesa e tretë?", – tha Omeri (radijallahu anhu).

- "Një ditë në muaj nuk vjen fare pranë nesh.", – u hodhën ata.

- "Po për këtë, çfarë do të thuash, o Said?", – ndërhyri Omeri (radijallahu anhu) duke iu drejtuar Saidit.

- "Meqenëse nuk mbaj shërbyes, që të më lajë teshat, dhe nuk kam vetëm se një veshje të vetme, në atë ditë unë laj teshat dhe më duhet të pres derisa të thahen. Pasi thahen teshat, aty në të rënë të muzgut, unë dal e shkoj pranë tyre!", – u tha Saidi.

- "Seç kishit edhe një ankesë tjetër, pa ma thoni edhe njëherë?", – pyeti Omeri (radijallahu anhu) sërish.

- "Ka disa ditë që seç kalon ca si kriza, të cilat duken si shenja të çmendurisë!", – folën ata.

- "Po për këto, çfarë do të thuash, o Said?", – tha Omeri (radijallahu anhu), kur Saidi ndërhyri menjëherë:

- "O i Pari i Besimtarëve! Unë kam qenë aty, në Mekë, kur vranë Khubejbin (radijallahu anhu) dhe e kam parë me sytë e mi se si e vranë. Kurejshët e vranë atë duke ia prerë mishin çikë e nga një çikë, ia vunë trupin mbi një trung dhe e pyetën:

- 'A do të doje, që, tani, këtu në vendin tënd të ishte Muhamedi dhe

jo ti?' Ndërsa ai iu përgjigj duke u thënë:

- 'I betohem Allahut, jo që nuk dua që të ishte ai këtu, në vendin tim; por më drithërohet zemra sikur edhe një gjemb t'i hyjë në këmbë atij!' Mandej Khubejbi thirri:

- 'O Muhamed!' Në atë kohë unë isha ende idhujtar, e nuk kisha besuar tek Allahu. Tani, sa herë që më vjen në kujtesë ajo ditë, më duket se Allahu nuk do të ma falë kurrë që nuk i erdha në ndihmë Khubejbit atë ditë, e për këtë më zënë gulçima e drithërima!'"

Pasi dëgjoi përgjigjet e Said bin Zejdit (radijallahu anhu), Omeri (radijallahu anhu) tha:

- "Lëvduar qoftë Allahu, Saidi nuk më zhgënjeu." Mandej, i dërgoi Saidit njëmijë dinarë ari, duke i thënë:

- "Këto t'i përdorësh për nevojat e tua." E shoqja e Saidit, një të marrë vesh se Omeri (radijallahu anhu) kishte dërguar dinarë, i tha të shoqit:

- "Lëvduar qoftë Allahu që nuk na la nevojtarë, sa ti të bëheshe shërbëtor tek të tjerët.", – dhe u gëzua pa masë. Said bin Zejdi ia ktheu së shoqes, duke i thënë:

- "O grua, a do që këto para t'i harxhojmë për një punë akoma më të mirë e të mbarë? Si thua, sikur t'ua japim atyre që janë më nevojtarë se ne?", – dhe thirri dikë të besuar nga familja e tij dhe i dha disa monedha.

- "Këto t'ua çosh të vejave të aksh familjeve, jetimëve të aksh shtëpive, aksh të skamurve dhe atyre që u prekën nga fatkeqësitë." Për vete ruajti vetëm një monedhë ari të vetme. Ia dha gruas dhe i tha:

- "Merre, këtë ndaje ti me të tjerët." Mandej u kthye të merrej me punët e tij të përditshme. E shoqja i tha:

- "Të na kishe marrë të paktën një shërbyese! Nuk na bënë asnjë punë gjithë ato para, zotëri!"

- "Mos ki merak, o grua, se ato para medoemos do të të kthehen në një ditë kur do të kesh nevojë për to më shumë se kurrë!", – u përgjigj Said bin Amir (radijallahu anhu).[160]

[160]. Ebu Nu'ajm, *Hilje,* 1/245.

PËRMBAJTJA

DY FJALË LEXUESIT 5
HYRJE 7

1. Ajete dhe hadithe që urdhërojnë bindjen ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij 7
2. Ajete rreth Profetit (a.s.) dhe sahabëve të tij 13
3. Karakteristikat e të Dërguarit të Allahut 16
4. Veçoritë e sahabëve 21

FTESA, THIRRJA PËR TEK ALLAHU DHE I DËRGUARI I TIJ 25

1. Dashuria për t'u treguar njerëzve për më të drejtin 25
2. Ata që u bënë myslimanë me thirrjen për në Islam të të Dërguarit të Allahut 35
3. Ata që ftoheshin në Islam nga dy e nga tre 61
4. Ata që nuk e pranuan ftesën Resulullahut për në Islam 63
5. Shpallja e Islamit para grupesh të mëdha me njerëz 65
6. Profeti ynë fton njerëzit në Islam duke shëtitur rrugë më rrugë e pazar më pazar 90
7. Profeti ynë fton të afërmit e tij në Islam 91
8. Profeti ynë i fton njerëzit në Islam gjatë udhëtimeve 92
9. Profeti ynë udhëtonte në këmbë, që të mund t'u fliste dhe t'i ftonte në Islam të gjithë njerëzit që takonte gjatë rrugës 93
10. Ftesa në Islam nëpër fushëbeteja 93
11. Profeti ynë cakton mësues, që të shkonin nëpër qyteza të ndryshme dhe t'u mësonin njerëzve Islamin 94
12. Ftesë për të përmbushur parimet kryesore të Islamit 97
13. Profeti ynë u dërgon letër mbretërve të kohës për t'i ftuar edhe ata në Islam 101
14. Morali i lartë i Resulullahut dhe sjelljet e tij, që u bënë shkak për udhëzimin e njerëzve 123
15. Paqja e Hudejbijes 126
16. Historia se si u bë mysliman Amr bin Asi 139
17. Halid bin Uelidi pranon Islamin 142

18. Ngadhënjimi i Mekës 146
19. Hyrja në islam e Ikrimes, djalit të Ebu Xhehlit 153
20. Hyrja e Safuan bin Umejes në Islam 156
21. Pranimi i Islamit nga Urue bin Mesudi dhe fisi i thakifëve të Taifit 159
22. Huuejtib bin Abdul'uzza pranon Islamin 162
23. Sahabët ftojnë njerëzit në Islam një e nga një 164
24. Sahabët u bëjnë thirrje fiseve arabe që të pranojnë Islamin 174
25. Kur sahabët fisnikë dërgohen si mëkëmbës për të ftuar njerëzit në Islam 183
26. Sahabët dërgojnë letra për t'i thirrur njerëzit në Islam 184
27. Në kohën e Profetit tonë, sahabët i ftonin njerëzit në Islam edhe kur ishin në fushën e betejës 187
28. Kur sahabët përhapnin Islamin në kohë lufte gjatë kalifatit të Ebu Bekrit(r.a.) 188
29. Kur sahabët përhapnin Islamin në kohë lufte gjatë kalifatit të Omerit (r.a.) 192
30. Morali dhe sjelljet e bukura të sahabëve që bëheshin shkas për njerëzit që të gjenin udhëzimin 205

LIDHJA E BESËS 211

1. Lidhja e besës për t'u bërë mysliman 211
2. Lidhja e besës për praktikat e Islamit 212
3. Lidhja e besës për mërgim pas ngadhënjimit mbi Mekën 216
4. Lidhja e besës se do ta mbështesnin Profetin e Allahut në misionin e tij të Profetësisë ..217
5. Lidhja e besës për të luftuar 222
6. Lidhja e besës se do t'i dëgjojnë fjalën dhe do t'i binden 223
7. Betimi i grave të ensarëve, kur Profeti ynë shkeli në Medinë 223
8. Lidhja e besës me fëmijët që nuk e kishin arritur ende moshën e pubertetit 226
9. Lidhja e besës së sahabëve me kalifët 227

VUAJTJET E PROFETIT TONË KUR I FTONTE NJERËZIT NË RRUGËN E ALLAHUT 229

1. Vuajtjet që duroi i Dërguari Fisnik 229
2. Si bënin durim ndaj vuajtjeve sahabët fisnikë? 244
3. Sahabët i bënin ballë çdo vështirësie 267
4. Të duruarit e urisë gjatë thirrjes së njerëzve për t'u bërë myslimanë 269
5. Kur sahabët përballeshin me urinë 282
6. Etja e tejskajshme që vuanim kur dilnim të ftonim njerëzit në Islam 285
7. Durimi i të ftohtit të acartë në rrugën e Allahut 287
8. Vështirësitë në rrugën e Allahut për t'u veshur 287

9. Përballja me gjithfarë frikërash në rrugën e Allahut 290
10. Durimi ndaj plagëve dhe sëmundjeve në rrugën e Allahut 293

HIXHRETI 295

1. Hixhreti i të Dërguarit të Allahut dhe Ebu Bekrit (r.a.) 295
2. Hixhreti i Omerit (r.a.) dhe i sahabëve të tjerë 306
3. Hixhreti i Osman bin Afanit (r.a.) 309
4. Hixhreti i Aliut (r.a.) 309
5. Hixhreti i Xhafer bin Ebi Talibit dhe i disa sahabëve të tjerë, njëherë në Abisini, mandej në Medinë 310
6. Hixhreti i Suhejb bin Sinanit (r.a.) 325
7. Hixhreti i Abdullah bin Omerit (r.a.) 326
8. Hixhreti i Damre bin Ebi'l-Ajsit (r.a.) 326
9. Hixhreti i Uasile bin Eskait (r.a.) 327
10. Fjalët që u thuheshin Safuan bin Umejes dhe disa të tjerëve që mërgonin 328
11. Hixhreti i grave dhe i fëmijëve 329

ENSARËT: SIMBOLI I PËRKRAHJES SË MYSLIMANËVE 335

1. Ensarët kryejnë detyrën 335
2. Vëllazëria e krijuar mes muhaxhirëve dhe ensarëve 339
3. Ensarët preferonin më shumë pëlqimin e kënaqësinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij sesa pasuritë e kësaj bote 343

XHIHADI 347

1. Profeti ynë i shtyn sahabët e tij të bëjnë xhihad në rrugën e Allahut 347
2. Profeti ynë, në shtrat, në çastet e fundit të jetës urdhëron Usamen të niset për ekspeditë ushtarake dhe përkujdesja e veçantë e Ebu Bekrit (r.a.) lidhur me këtë çështje në ditët e para të kalifatit të tij 353
3. Ebu Bekri (r.a.) dërgon ushtri në zonat përreth, për të luftuar 358
4. Nxitja që bën Osman bin Afani (r.a.) për xhihad 362
5. Sahabët e kërkonin vetë xhihadin me zemër e me sinqeritet 363
6. Trishtimi i atyre që nuk kishin fuqi të merrnin pjesë në luftë dhe i atyre që nuk kishin se çfarë të jepnin në rrugën e Allahut 373
7. Gjendja e atyre që e shtynin për më vonë daljen në luftë 374
8. Qortimi i atyre që rrinin në shtëpi dhe nuk merrnin pjesë në luftë 374
9. Fjalët e Resulullahut që shprehin se sa të rëndësishme janë në rrugën e Allahut deri edhe pluhuri i rrugës 376
10. Agjërimi dhe namazi gjatë luftës 377

11. Të përmendurit e Allahut pa ndërprerje gjatë luftës 380
12. Rëndësia e lutjes kur niseshin për të luftuar 383
13. Lutja para se të fillojë lufta 384
14. Të luftuarit në rrugën e Allahut me sinqeritet të plotë 385
15. Paralajmërimi i Profetit tonë se nuk ka xhihad "Që u pret rrugën njerëzve dhe sulmon njerëzit e pafajshëm nëpër shtëpitë e tyre" 390
16. Nuk e linin pas dore luftën as kur u duhej të duronin sëmundje nga më të ndryshmet 390
17. Plagët e marra gjatë luftës 391
18. Dëshira për të rënë dëshmor në rrugën e Allahut 393
19. Kur sahabët ngarendnin për të luftuar në rrugën e Allahut 398
20. Trimëria e sahabëve fisnikë 411
21. Gjykimi ndaj atyre që ia mbathnin nga lufta 422
22. Pendimi që ndienin ata që i iknin luftës 422
23. Gjetja e armëve dhe ndihmesat për luftëtarët e rrugës së Allahut 423
24. Përcjellja e luftëtarëve që niseshin të luftonin në rrugën e Allahut 425
25. Shkrimi i emrave të atyre që do të dilnin të luftonin në rrugën e Allahut 426
26. Edhe gratë merrnin përsipër detyra gjatë luftërave të zhvilluara për të fituar kënaqësinë e Allahut 427
27. Kur gratë luftonin në rrugën e Allahut me kuptimin e plotë të fjalës 430
28. Pjesëmarrja e fëmijëve në luftë 434

RËNDËSIA QË I JEPNIN SAHABËT FISNIKË UNITETIT DHE PËRBASHKIMIT 435

1. Çfarë mendonin sahabët për përçarjen me njëri-tjetrin 435
2. Qëndrimet e sahabëve për çështjen e kalifatit pas ndarjes nga jeta të Profetit tonë të nderuar 438
3. Sahabët sjellin Ebu Bekrin (r.a.) në krye të kalifatit dhe nuk u lënë shkas përçarjes dhe përplasjeve 445
4. Kur kalifi cakton pasardhësin e tij 451
5. Zgjedhja e atij që do të vihet në krye të shtetit duke u këshilluar me të gjithë 454
6. Cilësitë e tiparet e atyre që ishin të denjë për pozicionin e kalifatit 461
7. Përfitimi nga mendimet e njerëzve të mençur dhe largpamës 467
8. Emërimi i drejtuesve 475
9. Kush duhet bërë drejtues? 476
10. Sahabët nuk pranojnë detyra drejtuese 479
11. Respekti për kalifët dhe drejtuesit e tjerë dhe bindja e pakushtëzuar ndaj urdhrave të tyre 483

12. Kur drejtuesit jetojnë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin 492
13. Të thuash të vërtetën në prani të drejtuesve dhe të mos i mbështesësh ata
në veprimtaritë që bien ndesh me urdhëresat e Allahut 495
14. Të drejtat e popullit mbi drejtuesit e tyre 498
15. Drejtuesit u masnin shpesh pulsin popullit të tyre 502
16. Udhëheqësi i shtetit mbron popullin e tij ndaj rrezikut që u kanoset 504
17. Drejtësia e të Dërguarit Fisnik dhe e sahabëve të tij 506
18. Kalifët i frikësoheshin tejmase Allahut 530
19. Kështillat e kalifëve për njëri-tjetrin dhe për valitë 533
20. Kur populli këshillon drejtuesin e shtetit 548
21. Jetesa e kalifëve dhe e drejtuesve të tjerë 551
PËRMBAJTJA 562

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kandehleui ed-Dihleui, Muhamed Jusuf ibn Muhamed Iljas
Jeta e sahabëve / M. Jusuf Kandehleui ;
përkth. Silvester Manaj ;
red. Andrin Rasha, Mehmet Disha, Detin Kotrri.
Tiranë : Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2020
Vëllimi 1: 568 f. ; 14.8x21 cm.
Tit. origj.: Hajatu's-sahabe
ISBN 978-9928-194-85-5
1. Feja islame 2. Myslimanë 3. Histori